

VENDIM
Nr.463, datë 5.7.2006

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË
STABILIZIM-ASOCIIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Integritimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Integritimit bashkërendon punën dhe monitoron zbatimin e planit kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe raporton në Këshillin e Ministrave.

3. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave, raportojnë pranë Ministrisë së Integritimit, në fillim të çdo muaji, për realizimin e detyrimeve, që rrjedhin nga plani kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

4. Ngarkohet Ministria e Financave të monitorojë përfshirjen, në programin buxhetor afatmesëm, të nevojave financiare, të pambuluara nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e përparësive afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të parashikuara në planin kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

5. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave, për të cilat në planin kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimet nr.634, datë 30.8.2004 “Për miratimin e planit të veprimit në zbatim të përparësive të partneritetit evropian” dhe nr.317, datë 13.5.2005 “Për miratimin e planit kombëtar të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian dhe zbatimit të angazhimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asociimit”, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Pasqyra e lëndës

- 1 KITERI POLITIK
 - 1.1 DEMOKRACIA DHE SHTETI I SE DREJTET
 - 1.1.1 Funksionimi I Administrates Publike
 - 1.1.2 Reforma e Decentralizimit
 - 1.1.3 Zgjedhjet dhe ceshtje te tjera parlamentare
 - 1.1.4 Gjendja Civile
 - 1.1.5 Sistemi gjyqesor
 - 1.1.6 Lufta kunder korrupsionit
 - 1.2 TE DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE
 - 1.2.1 Respektimi I te drejtave te njeriut
 - 1.2.1.1 Permiresimi i sistemit te burgjeve
 - 1.2.1.2 Permiresimi i funksionimit te sistemit permbarimor
 - 1.2.2 Minoritetet
 - 1.3 TREGU I PASURIVE TE PALUAJTSHME
 - 1.3.1 Reforma e tokes bujqesore, tregu, administrimi i qendrueshem dhe mbrojtja e tokes
 - 1.3.2 Regjistrimi fillestar
 - 1.3.3 Kthimi dhe Kompensimi I Pronave
 - 1.3.4 Legalizimi I pasurise se paluajtshme
 - 1.4 BASHKEPUNIMI RAJONAL DHE NDERKOMBETAR
 - 1.4.1 Marreveshjet e Tregtise se Lire
 - 1.4.2 Zbatimi i angazhimeve te ndermarra ne OBT
 - 1.4.3 Antidumpingu
 - 1.4.4 Politika e Jashtme dhe Siguria e Perbashket
 - 1.4.5 Cminimi
- 2 KITERI EKONOMIK
 - Stabiliteti makroekonomik
- 3. AFTESIA PËR TE PERBALLUAR DETYRIMET E ANTARSISE NE BE
 - 3.1 LEVIZJA E LIRE E MALLRAVE
 - 3.1.1 Fusha Horizontale
 - 3.1.1.1 Standartizimi dhe Certifikimi
 - 3.1.1.2 Akreditimi
 - 3.1.1.3 Metrologjia Ligjore dhe Para-paketimet
 - 3.1.1.4 Vleresimi i Konformitetit
 - 3.1.2 Direktivat e Perafrimit Teknik
 - 3.1.2.1 Direktivat e Perafrimit Teknik (New Approach)
 - 3.1.2.1.1 Pajisje elektrike
 - 3.1.2.1.2 Enet me presion
 - 3.1.2.1.3 Lodrat
 - 3.1.2.1.4 Materiale Ndertimit
 - 3.1.2.1.5 Perputhshmeria elektromagnetike
 - 3.1.2.1.6 Makinerite
 - 3.1.2.1.7 Pajisjet e mbrojtjes personale
 - 3.1.2.1.8 Pajisje me gaz
 - 3.1.2.1.9 Mbi kerkesat per eficencen e boilereve te rinj qe punojne me lende djegese te lengeta dhe te gazta
 - 3.1.2.1.10 Lendet plasese per perdorim civil
 - 3.1.2.1.11 Pajisjet dhe sistemet mbrojtese te perdorshme ne atmosfera potencialisht shperthyese
 - 3.1.2.1.12 Ashensoret
 - 3.1.2.1.13 Pajisjet mjekesore
 - 3.1.2.1.14 Barnat për Perdorim Njerezor

- 3.1.2.1.15 Materialet dhe Teknologjite me Perdorim te Dyfishte
- 3.1.2.1.16 Pajisje fundore te Radio Telekomunikacionit
- 3.1.2.1.17 Mjetet detare dhe mjetet lundruese argetuese
- 3.1.2.1.18 Sistemi hekurudhor i shpejtesise se larte
- 3.1.2.1.19 Paketimi dhe paketimi i mbetjeve
- 3.1.2.1.20 Instalime kabllore per transport personash
- 3.1.2.1.21 Eficenca energjitike e pajisjeve frigoriferike
- 3.1.2.2 Direktivat e Perafrimit te Vjeter (Old Approach Directives)
- 3.1.2.2.1 Mallrat ushqimore
- 3.1.2.2.2 Mjetet motorrike
- 3.1.2.2.3 Qelqi
- 3.1.2.2.4 Tekstilet
- 3.1.2.2.5 Kepucet
- 3.1.2.2.6 Druri
- 3.1.2.2.7 Kimikatet
- 3.1.2.2.8 Detergjentet
- 3.1.2.2.9 Pleherat kimike
- 3.1.2.2.10 Produktet kozmetike
- 3.1.2.2.11 Produktet veterinare dhe mjekesore
- 3.1.3 Mbrojtja e konsumatorit dhe mbikqyrja e tregut
- 3.1.4 Levizja e lire e mallrave kulturore
- 3.2 LIRIA E VENDOSJES DHE LIRIA PER TE OFRUAR SHERBIME
- 3.2.1 Liria e vendosjes dhe liria per te ofruar sherbime (procedurat e regjistrimit dhe te licensimit)
- 3.2.2 Njohja reciproke e diplomave
- 3.2.3 Njohja reciproke e kualifikimeve për Profesionet e Lira
- 3.2.4 Sherbimet Postare
- 3.2.5 Sherbimet financiare
- 3.2.5.1 Banka
- 3.2.5.2 Sigurimet
- 3.3 LEVIZJA E LIRE E KAPITALEVE
- 3.4 LEGJISLACIONI PËR SHOQERITE TREGTARE
- 3.5 TE DREJTAT E PRONESISE INTELEKTUALE DHE INDUSTRIALE
- 3.5.1 Pronesia Intelektuale
- 3.5.2 Pronesia Industriale
- 3.6 KONKURRENCA DHE NDIHMA SHTETERORE
- 3.6.1 Konkurrenca
- 3.6.2 Ndhma Shteterore
- 3.7 PROKURIMI PUBLIK
- 3.8 BUJQESIA
- 3.8.1 Siguria ushqimore
- 3.8.2 Agroperpunimi dhe marketingu
- 3.8.3 Blegtoria
- 3.8.4 Sherbimet Veterinare
- 3.8.5 Prodhimi bimor
- 3.8.6 Mbrojtja e bimeve
- 3.8.7 Zhvillimi rural dhe strukturat bujqesore
- 3.8.8 Pyjet dhe kullotat
- 3.9 PESHKIMI
- 3.10 TRANSPORTI
- 3.10.1 Infrastruktura rrugore
- 3.10.2 Siguria rrugore
- 3.10.3 Transporti rrugor
- 3.10.4 Transporti hekurudhor
- 3.10.5 Transporti detar

- 3.10.6 Transporti Ajror
- 3.11 TATIMET
- 3.12 DOGANAT
- 3.13 STATISTIKAT
- 3.14 PUNESIMI DHE KOHEZIONI SOCIAL
 - 3.14.1 Dialogu social
 - 3.14.2 Punesimi
 - 3.14.3 Mbrojtja dhe Sigurimet Shoqerore
 - 3.14.3.1 Mbrojtja shoqerore
 - 3.14.3.2 Sigurimet Shoqerore
 - 3.14.4 Shendetit dhe siguria ne pune
 - 3.14.5 Barazia gjinore
- 3.15 ENERGJIA
 - 3.15.1 Sektori i energjise
 - 3.15.2 Sektori i hidrokarbureve
- 3.16 POLITIKAT INDUSTRIALE
 - 3.16.1 Politikat Industriale
 - 3.16.2 Sektori i Minierave
- 3.17 NDERMARRJET E VOGLA DHE TE MESME
- 3.18 ARSIMI DHE SHKENCA
 - 3.18.1 Arsimit dhe formimi profesional
 - 3.18.2 Mosdiskriminimi ne arsim
 - 3.18.3 Arsimit parauniversitar
 - 3.18.4 Arsimit i larte
 - 3.18.5 Kerkimi shkencor
- 3.19 TELEKOMUNIKACIONI
- 3.20 TURIZMI
- 3.21 POLITIKAT AUDIO-VIZUALE
- 3.22 MJEDISI
 - 3.22.1 Legjislacioni horizontal
 - 3.22.2 Cilesia e ajrit
 - 3.22.3 Manaxhimi i mbetjeve
 - 3.22.4 Uji
 - 3.22.4.1 Administrimi i burimeve ujore
 - 3.22.4.2 Cilesia e ujit te pijshem
 - 3.22.4.3 Parandalimi i ndotjes se ujit dhe manaxhimi i ujit te pijshem
 - 3.22.5 Mbrojtja e natyres
 - 3.22.6 Ndotja dhe rreziket industriale
 - 3.22.7 Kimikatet
 - 3.22.8 Organizmat e Modifikuar Gjenetikesht
 - 3.22.9 Zhurmat
 - 3.22.10 Siguria Berthamore dhe Mbrojtja nga Rrezatimet
 - 3.22.11 Ndryshimet klimatike
 - 3.22.12 Emergjencat civile, Mbrojtja e popullates civile ne kuadrin mjedisor
- 3.23 SHENDETI PUBLIK
- 3.24 BASHKEPUNIMI NE DREJTESI DHE CESHTJE TE BRENDSHME
 - 3.24.1 Bashkepunimi Gjyqesor Nderkombetar
 - 3.24.2 Mbrojtja e te dhenave personale
 - 3.24.3 Menaxhimi i Kufinjve
 - 3.24.4 Politikat e Migracionit
 - 3.24.5 Azili
 - 3.24.6 Politika e vizave
 - 3.24.7 Krimi i Organizuar dhe trafiket e paligjshme
 - 3.24.8 Lufta kunder droges
 - 3.24.9 Parandalimi i Pastrimit te Parave

3.24.10 Lufta kunder terrorizmit

3.24.11 Policia

3.25 MANAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE

3.25.1 Buxhetimi dhe Kontrolli Financiar

3.25.2 Planifikimi buxhetor

3.25.3 Auditimi i Jashtem

3.25.4 Kontabiliteti Publik

Aneksi 1: Lista e Inisiativave Ligjore sipas Fushave

Aneksi 2: Kostot e Përkthimit dhe Pergatitjes së Legjislacionit sipas institucioneve në vite

Aneksi 3: Numri i Punonjesve sipas Viteve

Aneksi 4: *Trajnimet*

Aneksi 5: Kostot e Infrastruktures, IT dhe Konsulences sipas Institucioneve në vite

Aneksi 6: Lista e Aktiviteteve zbatuese sipas fushave

LISTA E SHKURTIMEVE

AITPP	Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit te Pronave Publike
AK	Autoriteti i Konkurrences
AKE	Agjensia Kombetare e Energjise
AKH	Agjensia kombetare e hidrokarbureve
ARM	Agjencite Rajonale te Mjedisit
AP	Akademia e Policise
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
BB	Banka Boterore
BEI	Banka Evropiane per Investime
BERZH	Banka Evropiane per Rindertim dhe Zhvillim
BSPSH	Bashkimi i Sindikatave te Pavarura Shqiptare
CAM- A	Misioni i Asistences Komunitare ne Shqiperi
CARDS	Asistenca Komunitare per Rindertim dhe Zhvillim
DAP	Departamenti i Administrates Publike
DPAC	Drejtoria e Pergjithshme e Aviacionit Civil
DPB	Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve
DPD	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave
DPMK	Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise dhe Kalibrimit
DPPSH	Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit
DPQ	Drejtoria e Policise se Qarkut
DPRR	Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve
DPS	Drejtoria e Pergjithshme e Standardizimit
DPSHTRr	Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor
DPT	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve
DQPK	Drejtoria Qendrore e Policise Kufitare
DQPR	Drejtoria Qendrore e Policise se Rendit
ERE	Enti Rregullator i Energjise
ERT	Enti Rregullator i Telekomunikacionit
FMN	Fondi Monetar Nderkombetar
ILO	Organizata Nderkombetare e Punes
IMO	Organizata Detare Nderkombetare
INSIG	Instituti I Sigurimeve
IOM	Organizata Nderkombetare e Migracionit
ISHP	Instituti i Shendetit Publik
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqerore
IST	Instituti i Studimeve te Transportit
ITAP	Instituti i Trainimit te Administrates Publike
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
KKB	Keshilli konsultativ i biznesit
KKRT	Keshilli Kombetar i Radiove dhe Televizioneve

KLSH	Kontrolli i Larte i Shtetit
KM	Keshilli i Ministrave
KRRTRSH	Keshilli i Rregullimit te Territorit te Republikes se Shqiperise
KSSH	Konfederata e Sindikatave Shqiptare
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkences
MD	Ministria e Drejtesise
MBUMK	Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se konsumatorit
METE	Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes
MF	Ministria e Financave
MI	Ministria e Integritimit
MPJ	Ministria e Puneve te Jashtme
MTKRS	Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve
MM	Ministria e Mbrojtjes
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave
MPÇSSHB	Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta
MB	Ministria e Brendshme
MSA	Marreveshja e Stabilizim Asocimit
MSH	Ministria e Shendetesise
MTL	Marreveshjet e Tregtise se Lire
MPPT	Ministria e Puneve Publike, Transporte dhe Telekomunikacionit
OBSh	Organizata Boterore e Shendetesise
OBT	Organizata Boterore e Tregtise
OIML	Organizata Nderkombtare e Metrologjise Ligjore
OJF	Organizata JoFitimprurese
OST	Kompania e Transmetimit te Energjise elektrike
PAK	Persona me Aftesi te Kufizuar
PAMECA	Misioni i Asistences Policore te Komisionit Evropian per Shqiperine
PBA	Programi Buxhetor Afatmesem
PBB	Produkti i Brendshem Bruto
PVKM	Projekt- Vendim i Keshillit te Ministrave
SEC-I	Bashkepunimi I Vendeve te Europes Jug-Lindore
SECI	Nisma e Bashkepunimit per Europen Juglindore
SHISH	Sherbimi Informativ i Shtetit
SHKB	Sherbimi i Kontrollit te Brendshem (Ne Ministrine e Brendshme)
SHKP	Sherbimi Kombetar i Punesimit
SHQLKD	Sherbimi Qendror i Luftes Kunder Drogës
SHSSH	Sherbimi Social Shqiptar
SKZHES	Strategjia Kombetare e Zhvillimit Ekonomik dhe Social
TVSH	Tatimi mbi Vleren e Shtuar
UNDP	Programi i Zhvillimit te Kombeve te Bashkuara
UNHCR	Komisioni i Larte i Kombeve te Bashkuara per Refugjatet
VKK	Vend Kalimi Kufitar
VKM	Vendim i Keshillit te Ministrave
WIPO	Organizata Boterore e Pronesise Intelektuale

1. KRITERI POLITIK

1.1 DEMOKRACIA DHE SHTETI I SE DREJTES

1.1.1 FUNKSIONIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

1. Objektivi politik

Qeveria Shqiptare angazhohet për një reformë të thellë të vërtetë të administratës publike, trajtim dhe vlerësim bazuar në meritën, përkushtimin e nëpunësve të saj, krijimin e një rrjeti institucional efektiv dhe eficient, si dhe të një administrate të qëndrueshme, të përkushtuar ndaj zbatimit të ligjit dhe të ofrimit të shërbimeve më të mira për qytetarët, me nëpunës civilë të rekrutuar dhe të vlerësuar sipas meritës dhe përkushtimit në kryerjen e detyrave individuale.

Administrata publike do të forcohet e konsolidohet sipas principeve të shërbimit publik, mbi bazën e meritës dhe të performancës. Qeveria do të përmirësojë kualitetet profesionale në administratën publike nëpërmjet një procesi të hapur e konkurrues rekrutimi e karriere, motivimi e shpërblimi të performancës së mirë dhe ndëshkimit të performancës së dobët e pandershmerisë së nëpunësve si dhe trajnimin e tyre profesional. Statusi i nëpunësit civil do të shtrihet në pjesën me të madhe të organeve të administratës publike.

Qeveria Shqiptare do të ketë si objektivi final krijimin e një administrate publike eficiente dhe të aftë të përballojë realizimin e plotë të angazhimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Në fushën e funksionimit të administratës publike ekziston një bazë e gjerë legislative, ku si legjislacion parësor mund të përmendet:

Ligji nr. 8549 datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”;

Ligji nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”;

Ligji nr. 8487, datë 13.05.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9000 datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”;

Ligji nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;

Ligji nr. 8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”;

Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

2.2 Kuadri institucional

Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe politikat e qeverisë, për fushën e funksionit të administratës publike, janë përgjegjëse këto institucione:

1) Departamenti i Administratës Publike, i përbërë nga 18 punonjës , të ndarë tre sektorë: Sektori i menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore, Sektori i zhvillimit organizativ, funksional dhe pagave dhe Sektori i Informatizimit të Administratës dhe Koordinimit të Projekteve. *Departamenti i Administratës Publike* ka si fokus të punës së tij:

Menaxhimin e përgjithshëm të shërbimit civil në të gjitha institucionet e administratës qendrore, të cilat hyjnë në fushën e veprimit të ligjit “Statusi i nëpunësit civil” (rekrutimi, karriera, përshkrimi i punës, vlerësimi i punës, masa disiplinore, trajnimi);

Rishikimin funksional dhe stukturor të institucioneve të administratës publike;

Reformën në fushën e pagave për institucionet e administratës publike;

Rritjen e përdorimit të teknologjive të informacionit në fushën e qeverisjes elektronike (e-government);

Gjithashtu, në përputhje me nenin 4 të ligjit nr. 8549 datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, *Departamenti i Administratës Publike*, ushtron kompetencat e tij në:

zhvillimin, zbatimin dhe mbikqyrjen e politikave qeveritare në shërbimin civil dhe çështje të tjera në lidhje me personelin;

përgatitjen e një raporti vjetor mbi situatën e përgjithshme të shërbimit civil të cilin ia paraqet Këshillit të Ministrave;

ushtrimin e çdo kompetence mbi çështje të personelit, që nuk i janë dhënë shprehimisht me ligj institucioneve të administratës qendrore.

2) Komisioni i Shërbimit Civil është institucion i krijuar në bazë të ligjit nr. 8549 datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe ka për detyrë: zgjidhjen e ankesave ndaj vendimeve lidhur me pranimin në shërbimin civil, periudhën e provës, ngritjen në detyrë, lëvizjen paralele, vlerësimin, masat disiplinore e të drejtat e nëpunësit civil, dhe mbikqyr zbatimin e ligjshmërisë në menaxhimin e burimeve njerëzore në të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të ligjit të përmendur më sipër.

3) Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, i ngritur me qëllim përgatitjen dhe dhënien e trajnimeve për nëpunësit e administratës publike. ITAP varet nga Këshilli i Ministrave dhe drejtohet nga Departamenti i Administratës Publike për sa i përket përcaktimit të objektivave dhe planeve të punës. ITAP vepron si një strukturë menaxhuese e trajnimeve. Pas vlerësimit të nevojave për trajnim dhe hartimit të programeve të punës, ITAP kontraktin ekspertë të jashtëm për hartimin e kurrikulave të trajnimit dhe dhënien e trajnimeve.

4) Departamenti i Zhvillimit të Politikave dhe Koordinimit në Këshillin e Ministrave, ka një rol të veçantë në kuadrin e reformës në administratën publike duke shërbyer si filtër ndërmjet Aparatit të Këshillit të Ministrave dhe ministrive të linjës për zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Funksionet bazë të këtij Departamenti janë:

Koordinimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe problemeve të ndryshme teknike ndërmjet ministrive, veçanërisht për çështje të lidhura me përgatitjen e propozimeve për politika zhvillimi, projektligje e projektvendime, të cilat paraqiten për shqyrtim në mbledhjet e Këshillit të Ministrave dhe të komiteteve ndërministrave;

Mbikqyrja e hartimit, nga ministritë, e programeve të punës afatmesme e vjetore dhe matricave përkatëse;

Monitorimi i zbatimit të programeve të punës dhe matricave të ministrive, nëpërmjet shfrytëzimit të monitorimeve të veçanta të realizuara për këtë qëllim nga strukturat homologe të ministrive dhe nëpërmjet shfrytëzimit efektiv të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit, si mjet kryesor për realizimin e procesit të monitorimit;

Përgatitja e raporteve 6-mujore dhe vjetore të monitorimit të programeve të ministrive, në formën e analizave vlerësuese mbi gjendjen aktuale të arritjes së objektivave dhe prioriteteve të Qeverisë;

Bashkëpunimi me struktura të tjera të Administratës Publike me qëllim përmirësimin dhe harmonizimin e strategjive dhe politikave të zhvillimit; sistemeve të monitorimit, matricave të planifikimit dhe raportimit të realizimeve.

2.3 Asistenca teknike

Asistenca teknike që po zbatohet aktualisht për fushën e administratës publike si dhe projektet financuara në të ardhmen për këtë fushë fokusohen në:

Rikonstruksionin dhe pajisjen e ndërtesës së re të ITAP-it, asistencën teknike për zhvillimin e

sistemit të trajnimit të nëpunësve civilë dhe pajisje IT për rrjetin qeveritar, financuar nga CARDS 2004 me një shumë prej 2 mil euro;

Përmirësimin e menaxhimit të procesit të integritetit Evropian në Shqipëri, financuar nga CARDS 2005 me një shumë prej 1.2 mil euro;

Përmirësimin e procesit rregullues, mbikëqyrjes dhe të hartimit të politikave, financuar nga CARDS 2005 me një shumë prej 1 mil euro;

Përmirësimin e transparencës dhe efikasitetit të procedurave të administratës publike nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, financuar nga CARDS 2005 me një shumë prej 1 mil euro;

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si me poshtë:

Të sigurohet zbatimi i Ligjit mbi Shërbimin Civil për emërimet dhe punën e administratës publike;

Rekrutimi, transferimi dhe shkarkimi i nëpunësve civilë të kryhet sipas rregullave të përcaktuara;

Të përdoret në mënyrë të plotë dhe efikase Sistemi i Planifikimit të Integruar.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ndryshimi i ligjit nr. 8549 date 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil";

Hartimi akteve nënligjore në zbatim të ligjit "Statusi i nëpunësit civil".

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Përshtatja e strukturës ekzistuese me dispozitat e ndryshuara të ligjit "Statusi i nëpunësit civil";

Ofrimi i aktiviteteve trajnuese nga ITAP;

Hartimi i përshkrimeve të punës në të gjitha institucionet e ekzekutivit sipas formatit të miratuar;

Përcaktimi i metodologjisë lidhur me funksionimin e institucioneve të varësisë;

Vënia në funksionim dhe përdorimi i aplikacioneve të bazës së të dhënave për nëpunësit publike të ministrave të linjës;

Hartimi i udhëzimeve për veprimtarinë e komitetit ad-hoc të testimit dhe i manualeve për mënyrën e hartimit të testeve dhe subjekteve;

Fillimi i zbatimit të strukturës së re të pagave në disa institucione pilot;

Shtirja e funksionimit të bazës së të dhënave për punonjësit publikë në institucionet e varësisë;

Rishikimi i organizimit të institucioneve të varësisë, mbështetur në politikat e miratuara;

Përmirësimi i procesit rregullues, mbikëqyrës dhe të hartimit të politikave;

Përmirësimi i transparencës dhe efikasitetit të procedurave të administratës publike nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

3.2 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008 – 2009 janë si më poshtë:

Sektorët e administratës që janë përgjegjës për zbatimin e dispozitave të MSA-së dhe ato që merren me zbatimin e asistencës financiare të KE-së, të trajnohen mjaftueshëm dhe të pajisen me mjetet e duhura për të kryer detyrat e tyre;

Të sigurohet trajnim për nëpunësit civilë dhe menaxhim të orientuar drejt rezultateve;

Të hartohet dhe të zbatohet një strukturë rrogash e shërbimit civil, që mundëson planifikim të duhur buxhetor dhe një strukturë motivuese për karrierën.

3.2 Aktivitete zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të kryhet aktivitete i mëposhtem:

Shtirja e strukturës së re të pagave mbështetur në rezultatet e aplikimit pilot.

Duhet të theksohet që aktivitetet zbatuese të përcaktuara për periudhën afatshkurtër konsiderohen si angazhime që do të adresojnë në tërësi jo vetëm prioritetet afatshkurtra por dhe ato afatmesme, duke pasur parasysh që afatet e realizimit të plotë të një pjese të tyre shtrihen përtej afateve të periudhës afatshkurtër.

Tabela: Shtesë e kapaciteteve institucionale në kuadër të funksionimit të Administratës Publike

investime	NJësia e matjes	Gjendja aktuale	2006	2007
Shtese personeli	Nepunes	18	+ 5	
Investime IT			800	
Investime infrastrukture/paisje	000/leke		650	
Konsulence (e huaj)	000/leke			50.000

1.1.2 REFORMA E DECENTRALIZIMIT

1. Objektivi politik

Qeveria Shqiptare do të zbatojë në përputhje me kartën europiane të autonomisë lokale dhe rajonale, me ritme të përshpejtuara dhe të qendrueshme reformën e decentralizimit të pushtetit ekzekutiv pasi vlerëson se decentralizimi përmirëson cilësitë qeverisëse, qoftë në drejtim të efikasitetit dhe efektivitetit po aq edhe në drejtim të forcimit të përgjegjshmërisë, rritjes së transparencës si dhe rritjes së përfshirjes së qytetarëve dhe komuniteteve e grupeve të ndryshme shoqërore në qeverisje.

Qeveria Shqiptare do të mbështetet tërësisht në strategjitë dhe dokumentat e tjera europine që ndihmojnë Demokracinë dhe Autonomine lokale, me qëllim arritjen e rezultateve konkrete në këto komponente kaq të rëndësishme të shtetit ligjor dhe demokracisë, sic janë institucionet dhe qeverisja vendore, si dhe Decentralizimi si një proces, që synon të mobilizojë kontributin e të gjithëve, në nivel qendror dhe vendor për më shumë autonomi vendore, për institucione vendore të konsoliduara, për administrata të bashkive, komunave e qarqeve të afta të sigurojnë për qytetarët dhe komunitetet e tyre shërbime sa më të mira publike, për më shumë demokraci e pjesëmarrje të qytetarëve në nivel vendor.

Prioritetet e Qeverisë Shqiptare synojnë që me përmirësimet e domosdoshme ligjore, ndërhyrje të fuqishme dhe të vazhdueshme institucionale, konsolidimin e kapaciteteve njerëzore, alokimin e burimeve të mjaftueshme e të qendrueshme për garantimin e procesit, të përmirësojnë ndjeshëm procesin e Decentralizimit, statusin e të zgjedhurve vendore, konsolidimin e administratës vendore, garantimin e shërbimeve për qytetarët, procesin e buxhetimit vendor dhe kombëtar, që lidhen me qeverisjen vendore, transparencën e domosdoshme dhe marrëdhëniet qeverisje qendrore-qeverisje vendore, garantimin e vazhdueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së burimeve në dispozicion të njësive të qeverisjes vendore.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Me VKM nr. 651, datë 29.12.1999 është aprovuar Strategjia e Decentralizimit dhe Autonomisë Vendore, si një ndër dokumentat strategjike më të rëndësishëm të miratuar në fushën e Decentralizimit si dhe Strategjia Kombëtare e Trajnimit për Pushtetin Vendor, e miratuar me VKM nr.12, dt 28.01.2002. Në këto dokumenta strategjike janë përcaktuar objektivat që do të realizohen përsa i përket reformës së decentralizimit në sektorët e shërbimeve publike, arsim parauniversitar, shëndet parësor, ndihmë ekonomike, shërbimeve sociale, zhvillimit ekonomik vendor etj.

Ligjet parësore në fushën e decentralizimit janë:

Ligji nr.8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore”.

Ligji nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me Ligjin nr.9208, datë 18.3.2004

Ligji nr.8653, datë 31.7.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.9123, datë 29.7.2003.

Ligji nr.8699, datë 23.11.2000 “Për ratifikimin e konventës në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar të bashkive dhe autoriteteve territoriale dhe 2 protokollet e saj shtesë”.

Ligji nr.8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës”, ndryshuar me ligjin nr.8335, datë 23.4.1998”.

Ligji 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”.

Ligji nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në

njësitë e qeverisjes vendore”

Ligji nr.8978, datë 12.12.2002 “Për taksën vendore për biznesin e vogël”.

Ligji nr.8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar

Ligji nr..8560, datë 22.12.1999, amenduar prej ligjit No. 9460, datë 21.12.2005, No 9333 datë 06.12.2004 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”

Ligji nr..9464 datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”.

Ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”

Ligji nr.8991, datë 23.01.2003 “Për disa ndryshime në ligjin 8405 “Për urbanistikën”

2.2 Kuadri institucional

Strukturat aktuale për realizimin e reformës së decentralizimit janë.

1) Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Vendore dhe Decentralizimit në Ministrinë e Brendshme, misioni i së cilës është ndjekja dhe bashkëpunimi për realizimin e reformës së decentralizimit në fushën fiskale vendore, për shërbimet publike, në sektorët e arsimit: shëndetësisë, transportit, transferimit të pronave publike të pushtetit vendor, ndihmës sociale, zhvillimit ekonomik vendor, hartimit të programeve rajonale e vendore të zhvillimit ekonomik e social.

2) Komiteti Ndërministror i Decentralizimit (KND), misioni i të cilit është të ndjekë reformën e decentralizimit nëpërmjet analizës së programit të qeverisë dhe planit të veprimit të reformës së decentralizimit si dhe t’i propozojë Këshillit të Ministrave masa për thellimin e reformës së decentralizimit

3) Grupi i Ekspertëve të Decentralizimit (GED) misioni i të cilit është të ndjekë zbatimin e planit vjetor të decentralizimit, të bashkërendojë aktivitetet mes drejtorive të MPVD-së dhe ministrive të linjës dhe shoqatave vendore, e donatorëve për hartimin e dokumentave, akteve ligjore dhe nënligjore, për t’i paraqitur për shqyrtim në Komitetin Ndërministror të Decentralizimit (KND), sipas planit të veprimit të aprovuar nga Komiteti.

4) Agjencia e Inventarizimit të Pronave të Paluajtshme, misioni i së cilës është kryerja e inventarizimit të pronave të paluajtshme dhe hartimi i procedurave për transferimin e pronave nga pushteti qendror në Njësitë e Qeverisjes Vendore.

5) Agjencia Kombëtare e Trajnimit të Pushtetit Vendor, e cila ka status të veçantë si Organizatë jo-fitim prurëse. Kjo agjensi përgatit planin vjetor të trajnimit dhe përcakton temat dhe listat e kurseve të trajnimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Vendore dhe Decentralizimit, në Ministrinë e Brendshme, bashkëpunon me:

Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për hartimin e dokumentit të politikave të decentralizimit në fushën e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale

Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për hartimin e udhëzuesit për peëdorimin e grantit kushtezues në sektorin e arsimit parauniversitar për të menaxhuar me efektivitet fondet publike

Ministrinë e Shëndetësisë për ndarjen e përgjegjësisë dhe kompetencave të përbashkëta midis pushtetit qendror dhe vendor në fushën e shëndetit publik dhe kujdesit shëndetësor parësor

Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për planifikimin e investimeve në sektorin e zhvillimit rural, ku është hartuar “Strategjia e Zhvillimit Rural”, në të cilën është përcaktuar ngritja e Inspektoriateve për Mbrojtjen e Tokës në nivel Qarku.

Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për ndryshimin e neneve të Kodit Rrugor me objektiv transferimin e rrugëve vendore dhe dytësore tek NJQV.

Ministrinë e Financave me qëllim rritjen e autonomisë lokale vendore dhe aksesit të qeverisë vendore në tregun e kapitaleve.

2.3 Asistenca teknike

Asistenca teknike për fushën e reformës së decentralizimit konsiston në disa projekte në kuadër të programit CARDS. Ndër to mund të përmendet:

Mbështetje për zhvillimin e komuniteteve lokale, financuar nga programi CARDS 2001/2002 në shumën prej 17.4 mil euro;

Program trajnimi për autoritetet lokale , financuar nga programi CARDS 2005 në shumën prej 1mil euro;

Program pilot për mbështetjen e planeve të zhvillimit rajonal, financuar nga programi CARDS 2005 në shumën prej 0.9 mil euro;

Mbështetje për zhvillimin e komuniteteve lokale, financuar nga programi CARDS 2003/2004/2005 në shumën prej 17.8 mil euro.

3. Prioritetet

3.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Hartimi dhe miratimi nga Këshilli i Ministrave i draft-vendimeve "Për transferimin e të gjithë Sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve në pronësi të njësive të qeverisjes vendore"

Ndryshim i VKM -së nr.550 datë 7.11.2002 "Dokumenti i politikave për decentralizimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimit"

Përgatitja e një Udhëzimi të përbashkët ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave "Për transferimin e të gjithë Sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve në pronësi të njësive të qeverisjes vendore"

Amendim i ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës", ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.4.1998

Hartimi dhe miratimi i projekt-ligjit "Për përcaktimin e përgjegjësisë dhe kompetencave të pushtetit vendor për funksionet e përbashkëta"

Hartimi dhe miratimi i ligjit "Për disa ndryshime në ligjin nr.8743, dt.22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit"

Hartimi i një ligji të ri "Për Prefektin"

Hartimi dhe miratimi i projekt-ligjit "Për krijimin e standarteve të shërbimeve publike, uniformiteti dhe përcaktimi i nivelit minimal të tyre"

Ndryshimi i ligjit "Për nëpunësin civil" për përfshirjen e administratës së komunave në shërbimin civil.

Ndryshime të ligjeve mbi T.V.SH. dhe Sistemin e Taksave Vendore

Hartimi dhe miratimi i ligjit "Për financat vendore" (pjesa e pushtetit vendor)

Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri "Për Këshillin e Qarkut"

Hartimi dhe miratimi Projektligjit "Për Urbanistikën"

Hartimi dhe miratimi i P/ligjit "Për financat e pushtetit vendor për marrëdhëniet ndërqeveritare"

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Transferimi i gjithë ujësjellësave tek njësitë e qeverisjes vendore rast pas rasti;

Krijimi i grupit negociator për modalitetet e transferimit midis përfaqësuesve të Pushtetit Qendror dhe Lokal;

Realizimi i trajnimeve për Grupin e Eksperteve të Decentralizimit dhe konsolidimi i grupeve të specialistëve për decentralizimin;

Ngritja e Bordeve qendrore dhe ad-hoc, përbërë prej MPPTT, MB, MF dhe përfaqësuesve të Shoqatave të Bashkive, Komunave dhe Qarqeve ;

Ngritja e Bordeve rajonale ad-hoc të përbërë nga Prefekti, përfaqësuesve të MPPTT, MB, MF dhe përfaqësuesve të Shoqatave të Bashkive, Komunave dhe Qarqeve ;

Ngritja e Grupeve të negocimit ad-hoc rast pas rasti, duke përfshirë përfaqësues të Pushtetit Qendror dhe Qeverisjes Vendore;

Ngritja e policisë bashkiake dhe komunale;

Transferimi i kompetencave të arsimit parauniversitar në Njësitë e Qeverisjes Vendore;

Ndarja dhe transferimi i kompetencave njësive të Qeverisjes Vendore në shëndetësi

Sigurimi i një baze të dhënash për të dhënat financiare të bizneseve të vogla ndaj Bashkive dhe Komunave respektive ;

Realizimi i trajnimeve dhe i një fushate sensibilizuese për fillimin e administrimit të taksës së biznesit të vogël nga Bashkitë dhe Komunat;

Ngritja e Grupit të Punës për shqyrtimin e buxhetit vendor vjetor;

Organizimi i trajnimeve për përmirësimin e funksionimit të Këshillave Bashkiake dhe Komunale;

Ngritja e grupit të punës për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së buxhetit për Pushtetin Vendor;

Ndërmarrja e studimeve për llogaritjen e kostove kombëtare dhe lokale të shërbimeve publike

dhe për huamarrjen e Pushtetit Lokal;

Realizimi i trajnimeve për financat dhe huamarrjen e Pushtetit Lokal;

Sigurimi i paisjeve për krijimin e një database për administrimin e financave dhe huamarrjen në PV dhe Grupin e Ekspertëve të Decentralizimit;

Zhvillimi i Programeve të Trainimit mbi buxhetimin; zbatimin e buxhetit; menaxhimin financiar; raportimin financiar për Pushtetin Vendor; Trajnime për Zyrtarë të Pushtetit Qendror;

Realizimi i trajnimeve në fushën e shërbimeve për administratën vendore;

Vendosja e sistemeve kompjuterike në zyrat e pritjes së publikut në Bashki me qëllim arritjen e uniformitetit të shpërndarjes së shërbimeve.

1.1.3 ZGJEDHJET DHE ÇËSHTJE TË TJERA PARLAMENTARE

1. Objektiv i politik

Zgjedhjet e lira e të ndershme do të jenë burimi i vërtetë i legjitimitetit të institucioneve demokratike. Kthimi i besimit të publikut tek zgjedhjet është një prioritet absolut i Qeverisë Shqiptare. Për këtë qëllim, do të përfundohet reforma zgjedhore në bashkëpunim dhe mirëkuptim me të gjitha forcat politike, si dhe me mbështetjen e konsultimin me partneret ndërkombëtarë e me të gjithë faktoret e tjerë shoqërorë.

Kuvendit të Shqipërisë, si organi më i lartë ligjvënës, që ushtron funksionin e tij me qëllimin e vetëm që të përmbushë në mënyrë sa më demokratike të gjitha kërkesat e kohës, në përputhje me standartet e kërkuara nga marrëveshja e stabilizim – asociimit, do t'i jepet një dimension i ri si tempull i demokracisë parlamentare dhe shprehës i vullnetit të zgjedhësve. Në veçanti, do të marrë një rëndësi të vecantë roli kontrollues i deputetit dhe i Kuvendit në tërësi mbi të gjithë veprimtarinë e ekzekutivit dhe të institucioneve të tjera, mbi të cilat ai e ushtron këtë kompetencë.

Kuvendi do të jetë një organizëm tërësisht i hapur për të dëgjuar dhe thithur mendimin e publikut e të grupeve të ndryshme të interesit në iniciativat e tij ligjvënëse.

Gjithashtu, një rëndësi madhore do të ketë dhe forcimi i i garantimit të lirisë së shprehjes dhe mediave, duke synuar garantimin e lirisë së shtypit, mbrojtjen e tij në ushtrimin e funksionit dhe misionit për informimin publik, rregullimin e marrëdhënieve mes shtypit dhe publikut të gjerë, organeve shtetërore si dhe rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet gazetarëve dhe organeve drejtuese të medias së shkruar.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Kuadri ligjor bazë në këtë fushë fokusohet në:

Kushtetutën e Shqipërisë.

Ligjin nr 9341 datë 10.1.2005 "Për miratimin e amendimeve të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar.

Ligjin nr 8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve hetimore të Kuvendit".

Ligjin nr 8550 datë 18.11.1999 "Për statusin e deputetit".

Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë", miratuar me vendim të Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004.

2.2 Kuadri institucional

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, për fushën e Zgjedhjeve dhe çështjeve të tjera parlamentare janë përgjegjës:

1) Kuvendi i Shqipërisë. Për reformën zgjedhore, në janar 2006 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me propozimin e një grupi deputetësh miratoi Vendimin nr. 17, datë 19.1.2006 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore". Në këtë Vendim përcaktohej formula e përbërjes së komisionit, i cili do të kishte 22 anëtarë të ndarë 12 (6+6) nga dy partitë e mëdha dhe 1 anëtar për çdo parti parlamentare. Vendimet do të merreshin me shumicë votash (12 vota) kur pro tyre kishin votuar në unanimitet përfaqësuesit e dy partive të mëdha (6+6). Afati i veprimtarisë së këtij komisioni do të ishte 3 muaj nga data e vendimit.

Në 4 maj 2006, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në bazë të detyrimit ligjor të Kodit Zgjedhor, u njoh me raportin vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në seancë plenare dhe miratoi një rezolutë për vlerësimin e punës së këtij Komisioni. Në rezolutë u mbajtën parasysht edhe rekomandimet e dhëna nga OSBE-ODIHR në "Raportin përfundimtar të Misionit të vëzhgimit të

Zgjedhjeve”. Në kuadër të zgjedhjeve vendore për vitin 2006 Kuvendi kërkoi që KQZ të realizojë objektivat e përcaktuara në rezolutë.

Si rezultat i marrëveshjeve politike mes partive parlamentare, në kuadër të nismës për fillimin e reformës zgjedhore, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare miratoi Vendimin nr. 38, datë 18.5.2006 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore”. Në këtë vendim përcaktohet formula e re e përbërjes së komisionit, i cili do të ketë 18 anëtarë të ndarë 9 nga shumica dhe 9 nga opozita parlamentare.

Detyrë e këtij Komisioni është përgatitja e amendamenteve të nevojshme të kuadrit ligjor për arritjen e standarteve në zgjedhjet, mbështetur në rekomandimet e paraqitura në Raportin e Komisionit Vëzhgues të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2005. Përveç kësaj komisioni mund të trajtojë dhe të përgatisë amendamente për çështjet të tjera që kanë qenë pjesë e rekomandimeve të ODIHR-it për Kodin Zgjedhor në Shqipëri. Në mbledhjet e para të tij komisioni ka trajtuar çështjet që lidhen me përgatitjen e listës së zgjedhjeve, sidomos për përgatitjen e tyre për zgjedhjet e radhës për pushtetin vendor. Në këtë kuadër është paraqitur një projekt, i cili po i nënshtrohet diskutimeve dhe shqyrtimit në komision.

2) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është një organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha aspektet, që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe referendumet, si dhe shpall rezultatet e tyre.

Për të garantuar zbatimin në praktikë të amendimeve të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndërmerr iniciativë për sa më poshtë

Miratimin e planit të veprimit në zbatim të Kodit Zgjedhor të ndryshuar

Miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e KQZ-së

Fushata Edukuese për Zgjedhjet Parlamentare

Ngritja e komisioneve zgjedhore

Trajnimin dhe ngritja profesionale e komisionereve të niveleve të dyta dhe të treta

Miratimin i Dokumentacionit Zgjedhor.

Trajnimin i komisionerëve të komisioneve të niveleve të dyta dhe të treta

3) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme , e cila është e ngarkuar me:

nxjerrjen e akteve nënligjore lidhur me administrimin dhe përditësimin e përbërësve zgjedhorë në regjistrin themeltar të shtetasve dhe regjistrin e përkohshëm të shtetasve.

nxjerrjen e udhëzimeve për ndarjen e listës së zgjedhësve në dy pjesë me numër përafërsisht të barabartë zgjedhësish, për rastet kur një zonë qendre votimi, ka më shumë se 1000 zgjedhës.

dërgimin tek kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, (jo më vonë se nëntë muaj para mbarimit të mandatit të organeve për të cilat zhvillohen zgjedhjet) listat e zgjedhësve të përditësuar, sipas zonave të qendrave të votimit, të nxjerra nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;

verifikimin e listave paraprake të zgjedhësve me regjistrin e përkohshëm, dhe i kërkon kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore të bëjë ndryshimet e nevojshme.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka përmirësuar ndjeshëm programin e përdorur në zgjedhjet e fundit. Janë shtuar më shumë raporte, është rikompozuar formati i listës së printuar të zgjedhësve, është krijuar mundësia e kërkimit dhe eliminimit të dublimeve brenda zyrës së gjendjes civile, ku hartohen listat e zgjedhësve. Gjithashtu, ky program identifikon shtetasit me një numër unik brenda bazës, për të bërë të mundur kontrollin dhe unifikimin e zgjedhësit në këto lista. (Për më tepër, referohu tek pjesa “Gjendja Civile”).

4) Njësitë e qeverisjes vendore dhe kryetarët e tyre, të cilët në bazë të Nenit 52, pika 1, të Kodit Zgjedhor, janë autoritetet, që hartojnë dhe miratojnë listat e zgjedhësve për njësinë përkatëse.

2.3 Asistenca teknike

Me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Hollandës dhe OSBE -së, do të fillojë të zbatohet në të ardhmen projekti për mbështetjen e Parlamentit Shqiptar (Faza II), me një shumë prej 1.5 mil Euro. (Për më tepër, referohu tek pjesa “Gjendja Civile”).

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për këtë fushë janë:

Të përgatiten në kohë dhe siç duhet zgjedhjet vendore të 2006 në zbatim të rekomandimeve të OSBE/ODIHR, sidomos duke përmirësuar listat e votuesve dhe të ndërmerren paraprakisht veprime

për t'u përgatitur në kohë për zgjedhjet e ardhshme parlamentare.

Të rritet liria e medias, veçanërisht duke përshpejtuar miratimin e ligjeve të duhura për median e shkruar

Të përmirësohet funksionimi i Institucionit të Kuvendit

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ndryshimi i ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

Miratimi i Projektligjit "Për shtypin"

Ndryshimi i ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit".

Ndryshimi i ligjit "Për statusin e deputetit"

Miratim i akteve normative në zbatim të Rregullores së Re të Kuvendit

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e një komisioni të posaçëm për amendimin e ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit"

Përmirësimi i imazhit dhe arritja e standarteve të kërkuara europiane në kuadër të projektit për "Modernizimin e Kuvendit"

Plotësimi i nevojave financiare dhe logjistike për ristrukturimin fizik dhe përmbajtësor të kuvendit në kuadër të projektit për "Modernizimin e Kuvendit"

Trajnimi i deputetëve dhe stafit të Kuvendit për legjislacionin e BE -së dhe strukturat vendimmarrëse të tij.

Forcimi i kapaciteteve të mirëfillta legjislative të Komisionit të Integritetit Evropian

Ngritja e një grupi pune për amendimin e ligjit "Për statusin e deputetit"

1.1.4 GJENDJA CIVILE

1. Objektivi politik

Modernizimi i Gjendjes Civile mbështetur në Dokumentin Strategjik të miratuar për këtë fushe, konsiderohet si një nga objektivat prioritarë afatshkurter për qeverinë Shqiptare. Modernizimi i Gjendjes Civile do të ketë një impakt të drejtëpërdrejtë në zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme (lokale dhe parlamentare), në përputhje të plotë me standartet europiane e ndërkombetare.

Puna e Qeverisë shqiptare për periudhën në vazhdim do të fokusohet kryesisht në shpërndarjen dhe administrimin e listave të zgjedhësve, përditësimin e tyre, në prodhimin dhe shpërndarjen e dokumentit të identitetit të shtetasve shqiptarë, me synim prodhimin e dokumentit të identitetit sipas standarteve europiane. Kjo e fundit do të bëjë të mundur uljen në maksimum të mundësive të falsifikimit të akteve që kanë të bëjnë me identifikimin e shtetasit dhe do të shërbejë si një garanci më shumë për detyrimet që rrjedhin në kuadër të procesit të Stabilizimit - Asociimit.

Gjithashtu, një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet ndërtimit dhe administrimit të sistemit të adresave me qëllim rritjen e nivelit të shërbimeve ndaj qytetarëve në përputhje me standartet ndërkombetare.

Qeveria Shqiptare është e bindur që modernizimi i Shërbimit të Gjendjes Civile është një proces kompleks e shumëdimensional që kërkon një ndërhyrje të kualifikuar dhe të koordinuar në të gjitha aspektet e veprimtarisë së tij për të siguruar një proces të sigurtë dhe të suksesshëm.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Dokumenti me i rëndësishëm në këtë fushe konsiderohet "Strategjia Kombëtare për Modernizimin e Gjendjes Civile", miratuar me VKM nr. 716, datë 30.10.2003. Përveç saj ekzistojnë një legjislacion i tere që operon në këtë fushe, ku me kryesori mund të përmendet:

Ligji nr. 8950 dt. 10.10.2002 "Për gjendjen civile" i ndryshuar

Ligji nr. 8951 dt. 10.10.2002 "Për numrin e identitetit të shtetasve",

Ligji nr. 8952 dt. 10.10.2003 "Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë"

Ligji nr. 9062 dt. 08.05.2003 "Kodi i Familjes",

Ligji nr. 9270 dt. 29.07.2004 "Për sistemin e Adresave"

Ligji nr. 9087 dt. 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.2 Kuadri institucional

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e gjendjes civile vizave janë përgjegjëse këto institucione:

1) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme. Kjo drejtori ka në varesi 2 drejtorite e mëposhtme:

Drejtorita e Regjistrat Kombëtar, e cila kryen këto funksione:
nëgritjen dhe administrimin e regjistrat kombëtar që do të jetë dokumenti unik shtetëror, ku do të pasqyrohen në mënyrë dixhitale përberësit e gjendjes civile për çdo shtetas;
transferimin e kërkuar (nga shtetasit) të dokumentacionit të gjendjes civile,
transferimin e dokumentave të gjendjes civile kërkuar nga shtetasit për shqeputjen direkte nga trangu familjar,
adresimi shifror zgjedhor për çdo shtetas në regjistrin e perkohshëm
Drejtorita e Metodikes dhe Kontrollit, e cila harton projektaktet në zbatim të paketës ligjore për shërbimin e gjendjes civile.

2) Zyrtat e Gjendjes Civile në degen e Qarkut, Bashki dhe Komuna. Në mbështetje të ligjit nr. 9296, dt. 21.10.2004, "Për procesin e verifikimit, identifikimit dhe regjistrimit të shtetasve", Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile bashkëpunon me këto zyra duke mbledhur prej tyre informacionin që përpunohet në një qendër operatore.

3) Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Juridike, Ndërkombëtare dhe Konsullore, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, nëpërmjet realizimit të shërbimit të gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore.

2.3 Asistenca teknike

Asistenca teknike e ofruar apo që do të sigurohet në të ardhmen në fushën e modernizimit të Gjendjes Civile fokusohet në:

Projekti me Statistic Norway për informatizimin e shërbimit të gjendjes civile në zyrtat Pilot Shkoder dhe Durrës, financuar nga Statistic Norway (54,560 euro) dhe Kontributi Lokal (26,030 euro) me një shumë prej 80,590 euro

Mbështetje për modernizimin e sistemit të regjistrat civil, financuar nga CARDS 2003 me një shumë prej 1 mil euro

Projekti "Prodhimi dhe shpërndarja e dokumentit të identitetit shtetasve shqiptarë", financuar nga Buxheti i Shtetit me një shumë prej 1,543,547,295 lek

Projekti I Modernizimit të shërbimit të gjendjes civile, financuar nga Buxheti i Shtetit me një shumë prej 393600000 lek

Projekti "Nëgritja dhe funksionimi I sistemit të adresave në Shqipëri", financuar nga Buxheti i Shtetit me një shumë prej 602,700,000 lek

Mbështetje për modernizimin e sistemit të regjistrat civil, financuar nga CARDS 2004 me një shumë prej 2.5 mil euro

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si më poshtë:
Përshtatja e shërbimit të gjendjes civile me standartet europiane dhe modernizimi e informatizimi i Shërbimit të Gjendjes Civile

Rritja e kapaciteteve të Zyres së Gjendjes Civile dhe kriimi i dispozitave për regjistrimin e të gjitha ngjarjeve demografike, si dhe duhet të krijohet një regjister i popullsisë

Për të rritur saktësinë e listave të votuesve, kërkohen përpjekje të vazhdueshme dhe urgjente për përmirësimin e regjistrave civilë. Prioritet duhet të jetë hartimi i një sistemi adresash për ndërtesat dhe pronat e tjera të paluajtshme. Gjithashtu duhet të jetë prioritet korrigjimi i gabimeve në shkrimin e emrave, të dhënave të cunquara, të ashtuquajturat "regjistrimet 999" dhe regjistrimet e shumëhershme brenda kufijve të njësive administrative.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Miratimi i VKM për Projektin "Për Prodhimin dhe Shpërndarjen e Dokumentit të Identitetit të Shtetasve Shqiptarë" dhenien e Fondit të Ministrisë së Brendshme

Urdhër i Kryeministrit për nëgritjen e grupit të punës që do të drejtojë dhe administrojë

projektin e Dokumentit te identitetit

Ndryshimi i VKM nr. 320 dt. 21.05.2004 "Per caktimin e elementeve te sigurise dhe miratimin e formes se dokumentit te identitetit te shtetasve shqiptare

Miratimi i VKM "Per Vendosjen e afateve per pajisje me DI te shtetasve dhe masat shtrenghuese per aplikimin e shtetasve per pajisje me DI".

Ndryshimi VKM nr.579 dt. 27.08.2004 "Per dizajnin e dokumentit te identitetit

Ndryshimi I Ligjit nr. 9087 dt. 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor I Republikes se Shqiperise"

Miratimi i Urdherit te Ministrit te Brendshem "Per kriteret e pranimit ne detyre te nepunesve te zyrave te gjendjes civile"

Miratimi i VKM per miratimin e Projektit "Per Modernizimin e sherbimit te gjendjes civile " dhenien e Fondit te Ministrise se Brendshme dhe Miratimin e Komitetit Drejtues te Projektit

Miratimi i VKM per miratimin e Projektit "Per ngritjen dhe funksionimin e sistemit te adresave " dhenien e Fondit te Ministrise se Brendshme dhe Miratimin e Komitetit Drejtues te Projektit

Miratimi i VKM "Per miratimin e Materialit te tabelave, permasat e tyre dhe formati i shkrimit ne kuader te implementimit te sistemit te adresave"

Rishikimi i VKM nr. 63 dt 23.01.2003 "Per Numrin e Punonjesve, strukturen dhe organiken e sherbimit te gjendjes civile ne Njesite e Qeverisje Vendore"

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Rishikimi i VKM nr. 63 dt 23.01.2003 "Per Numrin e Punonjesve, strukturen dhe organiken e sherbimit te gjendjes civile ne Njesite e Qeverisje Vendore";

Ngritja dhe funksionimi i Grupit te Punes per menaxhimin e Projektit "Per Prodhimin dhe Shperndarjen e Dokumentit te Identitetit te Shtetasve Shqiptare" ;

Hartimi i specifikimeve teknike per Karten e Identitetit nga Eksperti I Huaj;

Percaktimi i dizajnit te dokumentit te identitetit;

Ushtrimi i masave shtrenghuese nga institucionet e ngarkuara me VKM per detyrimin e shtetasve per pajisje me dokument identiteti brenda afateve ligjore;

Fillimi i procedurave te aplikimeve per Dokument Identiteti, prodhimi i tij dhe shperndarja e dokumentit te identitetit te shtetasve;

Shperndarja e listave te zgjedhesve per cdo njesi vendore;

Fillimi i procedurave per perditimin e listave te zgjedhesve, plotesimi i adreses shifrore per rastet "999", per Regjistrin e Perkohshem dhe Dublinet;

Fillimi i procedurave per hartimin e listave paraprake te zgjedhesve;

Hartimi i listave perfundimtare te zgjedhesve;

Fillimi procesit te modernizimit te sherbimit te gjendjes civile dhe ngritjes se Regjistrit Kombetar te Shtetasve;

Fillimi i procedura te testimit te punonjesve te cilet do te pranohen ne sherbimin e gjendjes civile;

Fillimi i aplikimit te sistemit te adresave sipas kerkesave te ligjit;

Ndryshimi i numrit te punonjesve te sherbimit te gjendjes civile ne varesi te numrit te popullsise qe i sherben secili punonjes;

Prodhimi i tabelave dhe vendosja e tyre ne Sheshe, Ruge Ndertesa etj.

Nje pjese e aktiviteteteve zbatuese te percaktuara per periudhen afatshkurter, do ta shtrijne afatin e realizimit te plote ne periudhen afatmesme.

Tabela: Shtimi i kapaciteteve institucionale të Strukturave se Gjendjes Civile

Investime	Projekti	000/leke	
		2006	2007
	Per Grupin e Punes per administrimin e projektit te kartes se Identitetit	2,184	
	Per zbatimin e projektit te shperndarjes se kartes se Identitetit	54,552	
Forcim	Per zbatimin e projektit te modernizimit te Gjendjes CIVile	74,095	

Strukture	Per aplikimin e Sistemit te Adresave	108,240
	Per prodhimin e tabelave – per t’u shtuar 120 veta	76,875
Investime		1,499,105
Investime IT		416,644
Konsulence		4,000
Trajnime		6,291

1.1.5 SISTEMI GJYQËSOR

1. Objektivi politik

Qeveria Shqiptare do të angazhohet fuqishëm në zbatimin në gjerësi dhe thellësi të reformave në sistemin e drejtësisë, të sugjeruara e të mbështetura nga partnerët ndërkombëtare, në bashkëpunim me institucionet e tjera kushtetuese që përfshihen në çështjet e reformave dhe performancës së sistemit të drejtësisë si dhe në përputhje me angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (Neni 1, 2, 13, 78 dhe 122 i MSA-së). Reformat në drejtësi do të synojnë të rikthejnë besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor dhe në ndershmërinë dhe paanësinë e vendimit gjyqësor.

Reformat që do të ndërmerren nga qeveria Shqiptare do të fokusohen në garantimin e pavarësisë reale të sistemit të drejtësisë nëpërmjet fuqizimit të institucioneve të vetëkontrollit dhe administrimit të gjyqësorit; forcimit të përgjegjshmërisë dhe ndershmërisë së vendimit gjyqësor nëpërmjet rritjes së transparencës dhe aksesit, publikimit të plotë të vendimeve gjyqësore, përmirësimit të sistemit të vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe të përgjegjshmërisë së tyre para ligjit bazuar në kritere objektive.

Gjithashtu, një vëmendje e veçantë do t’i kushtohet përmirësimit të kushteve dhe mjeteve të gjyqësorit, rritjes së profesionalizmit të gjyqtarëve, transparencës dhe objektivitetit në emërimet dhe karierrën e gjyqtarëve.

Qeveria Shqiptare është e bindur që realizimi i këtyre objektivave do ta forcojë më tej funksionimin dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe kjo do të bëjë të mundur arritjen dhe realizimin e standarteve të kërkuara.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Veprimtaria në fushën e funksionimit të sistemit gjyqësor mbështetet në legjislacionin e mëposhtëm :

Ligji nr. 8136, datë 31.07.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 8363, datë 01.07.1998 “Për krijimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor ;

Ligji nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me ligjet nr. 8546, datë 05.11.1999, nr. 8656, datë 31.07.2000 dhe nr. 9111, datë 24.07.2003;

Ligji nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”;

Ligj nr. 9110, datë 24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimet e rënda”;

Ligj nr. 9399, datë 12.05.2005 "Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare";

Dekret nr. 3993, datë 29.10.2003 “Për caktimin e kompetencave tokësore, të qëndrës së ushtrimit të veprimtarisë dhe numrit të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit për krime të rënda”;

Dekret nr. 1143, datë 03.07.1995 “Për caktimin e kufijve tokësorë të veprimtarisë së gjykatës ushtarake”;

Dekret nr. 1501, datë 29.05.1996 “Për krijimin e seksioneve për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, tregëtare e familjare pranë gjykatave të rretheve”;

Dekret nr. 1984, datë 07.01.1998 “Për krijimin e gjykatave të apelit dhe caktimin e kufijve tokësore të veprimtarisë së tyre”;

Dekret nr. 2110, datë 29.05.1998 “Për krijimin e rretheve gjyqësore, caktimin e kompetencave tokësore dhe të qëndrës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre”

2.2 Kuadri institucional

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e funksionimit të sistemit gjyqësor janë përgjegjëse këto institucione:

1) Gjykatat-organizimi i te cilave mbështetet në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Gjykatat që krijoi ky ligj janë: gjykatat e rretheve gjyqësore¹; gjykatat e krimeve të rënda²; gjykatat ushtarake³; gjykatat e apelit⁴; gjykatat e apelit të krimeve të rënda⁵ dhe gjykatat ushtarake të apelit⁶.

Pavarësia e gjykatave buron nga parimi i ndarjes së pushteteve. Duke u nisur nga ky parim, ligji ka parashikuar një sistem garancish që synojnë mbrojtjen e gjyqtarit, me këto karakteristika:

palëvizshmëria nga detyra, koha e qëndrimit në detyrë e gjyqtarëve nuk mund të kufizohet⁷; emërimi i gjyqtarëve nga Presidenti i Republikës me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë⁸;

pavarësia në administrimin e buxhetit të gjykatave, nëpërmjet Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor. Për më tepër, paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarëve nuk mund të ulen;

procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve vihen në lëvizje nga Ministri i Drejtësisë, por vetëm KLD mund të marrë masa disiplinore apo t’i shkarkojë ata. Gjatë procedimit disiplinor, gjyqtarët kanë të drejtë të mbrohen, personalisht ose nëpërmjet mbrojtësit, dhe kanë të drejtë të ankimojnë vendimin e KLD-së në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë;

imuniteti nga procesi penal (neni 137 i Kushtetutës), që do të thotë se gjyqtari mund të ndiqet penalisht vetëm mbas miratimit të KLD-së, si dhe të Kuvendit, për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë;

imuniteti nga procesi civil (neni 37 i Ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”), që do të thotë se gjyqtarët nuk mund të paditen civilisht për fakte që lidhen me kryerjen e funksioneve të tyre;

e drejta për të kërkuar mbrojtje për vete ose familjen, për shkak të kërcënimeve apo çështjeve delikate në shqyrtim (neni 38 i ligjit të sipërpërmendur).

Politikat në lidhje me gjykatat dhe gjyqtarët përfshijnë:

riorganizmin territorial të gjykatave të rretheve gjyqësore, duke patur si synim kryesor një rishpërndarje të hartës së gjykatave, në proporcion me disa tregues, siç janë: hapësira gjeografike, numri i popullsisë, volumi i çështjeve të gjykatave, si dhe ngarkesa për gjyqtar, në funksion të modelimit të një sistemi sa më eficient;

rishikimin e kuadrit ligjor përkatës, në lidhje me kriteret e emërimit të gjyqtarëve, ngritjen e tyre në karrierë, procedimin disiplinor, etj.

2) Këshilli i Lartë i Drejtësisë-i cili është autoriteti shtetëror i ngarkuar me propozimin dhe emërimin e gjyqtarëve të dy niveleve të para, si dhe shkarkimin, transferimin dhe procedimet disiplinore ndaj tyre. Ky Këshill kryesohet nga Presidenti i Republikës dhe anëtarë të tjerë të tij janë kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë, 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi dhe 9 anëtarë (gjyqtarë) të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare. Anëtarët e zgjedhur kanë mandat 5-vjeçar.

Kushtetuta i dedikon një kapitull të veçantë KLD-së, duke e veçuar atë nga legjislativi, ekzekutivi dhe vetë gjyqësori.

Tradicionalisht, KLD është parë si organ me kompetenca kryesisht disiplinore. Në të

¹ Aktualisht, 29 gjykata të rretheve gjyqësore.

² Një gjykatë e krimeve të rënda, me seli në Tiranë, e cila ka kompetencë tokësore në të gjithë territorin e vendit.

⁴ 6 të tilla.

⁵ 1 gjykatë apeli e krimeve të rënda, me seli në Tiranë.

⁶ Një gjykatë e tillë, me seli në Tiranë, e cila ka kompetencë tokësore në të gjithë territorin e vendit.

⁷ Neni 138 i Kushtetutës.

⁸ Nga ky rregull bëjnë përjashtim gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilët emërohen për një mandat 9-vjeçar.

⁹ Përsëri bëjnë përjashtim gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilët emërohen nga Presidenti i Republikës, me pëlqim të Kuvendit

vërtetë KLD ushtron edhe disa kompetenca thuajse-rregullatore. Në ushtrimin e kompetencave të saj KLD-ja:

- i jep mendim Presidentit të Republikës për përcaktimin e kompetencës territoriale të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe apeleve;

- i jep mendim Presidentit të Republikës për caktimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve; miraton dhe ndjek Sistemin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale dhe Morale të Gjyqtarëve. Aktualisht, është duke u hartuar një sistem i ri vlerësimi, që pritet të jetë eficient dhe në shërbim të sistemit të karrierës gjyqësore;

- kujdeset për kualifikimin profesional të gjyqtarëve.

3) Presidenti i Republikës është kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe autoriteti që emëron gjyqtarët e shkallës së parë dhe apelit, me cilësinë si President i Republikës dhe jo si kryetar i KLD- së. Gjithashtu, ai emëron dhe shkarkon prokurorët e të gjithë niveleve, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm.

Presidenti i Republikës ushtron edhe disa kompetenca rregullatore në fushën e organizimit të sistemit gjyqësor si: përcaktimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve, të gjykatave, qëndrën e tyre të veprimtarisë dhe kompetencën territoriale.

4) Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor është një ent publik i pavarur, që administron buxhetin e sistemit gjyqësor. Zyra drejtohet nga një bord, i përbërë nga 8 gjyqtarë nga të tre nivelet dhe një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë. Bordi emëron drejtorin e zyrës.

5) Konferenca Gjyqësore Kombëtare përmendet në Kushtetutë, si një organizëm i cili zgjedh 9 anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë si dhe funksionon në bazë të Ligjit organik dhe të një statuti.

6) Shkolla e Magjistratures, është një institucion me pavarësi institucionale, akademike dhe administrative, e krijuar me ligj. Shkolla e Magjistraturës është e vendosur në Tiranë dhe drejtohet nga Bordi i Drejtimit, i cili është i përbërë nga kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, drejtori i Shkollës së Magjistraturës, dy gjyqtarë, dy prokurorë, dy përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, dekani i Fakultetit të Drejtësisë, një përgjegjës stazhi dhe dy studentë të Shkollës. Drejtori i Shkollës emërohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Detyrat kryesore të Shkollës së Magjistraturës janë formimi profesional fillestar i kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë brenda një programi 3-vjeçar si dhe formimi profesional i vazhduar për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë. Ligji njeh detyrimin e emërimit si gjyqtarë dhe prokurorë të të gjithë kandidatëve për magjistratë që përfundojnë me sukses shkollën. Emërimi duhet të bëhet duke respektuar parimin e meritokracisë (rezultatet e arritura në Shkollë). Shkolla zhvillon gjithashtu edhe Programin e Formimit të Vazhduar për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, përfundimi me sukses i të cilit lidhet direkt me kualifikimin dhe karrierën e tyre. Procesi i trajnimit lehtësohet nga pikat e kontaktit në gjykata dhe prokurori.

Në mbështetje të Memorandumit të bashkëpunimit të nënshkruar me Ministrinë e Drejtësisë në 4 Nëntor 2003 dhe programit të perbashket me BE dhe KE, Shkolla po angazhohet në fushën e trajnimit të administratës gjyqësore.

7) Ministria e Drejtësisë në përputhje me ligjin, mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me organet e pushtetit gjyqësor dhe me prokurorinë, duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të prokurorisë, si dhe:

- Ndjek dhe përgjigjet për realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë;

- Harton projektet e akteve ligjore e nënligjore në fushën e drejtësisë;

- Kujdeset për funksionimin dhe organizimin e pushtetit gjyqësor;

- Drejton dhe kontrollon administratën gjyqësore;

- Kryen inspektime dhe bën procedimin disiplinor të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit sipas ligjit;

- Drejton sistemin e ekzekutimit të vendimeve civile dhe të titujve ekzekutive;

- Drejton veprimtarinë e Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

- Drejton shërbimin e unifikuar statistikor në fushën e Drejtësisë;

- Mban regjistrin e gjëndjes gjyqësore dhe lëshon certifikatat në bazë të atij regjistrimi.

- Realizon shërbimet juridiko-administrativ që sipas ligjit janë në kompetencë të Ministrit të Drejtësisë.

Kujdeset dhe bashkërendon veprimtaritë për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshme të të miturve në fushën e drejtësisë, si dhe për edukimin ligjor dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit nga të miturit.

Kujdeset dhe mbështet veprimtaritë për përgatitjen profesionale, aftësimin dhe specializimin e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, noterëve dhe juristëve të administratës publike.

Në marrëdhëniet me prokurorinë, Ministria e Drejtësisë ushtron kontroll sipas ligjit mbi organin e prokurorisë me qëllim kontrollin e respektimit të parimeve të drejtësisë dhe barazisë. Po ashtu, brenda datës 31 mars të çdo viti, Ministri i Drejtësisë në emër të Këshillit të Ministrave, i paraqet rekomandimet përkatëse Prokurorit të Përgjithshëm për luftën kundër kriminalitetit.

Sipas Kushtetutës, Ministri i Drejtësisë është përfaqësuesi i vetëm i Këshillit të Ministrave, anëtar i KLD-së. Po ashtu, Ministri i Drejtësisë ka të drejtë të fillojë inspektime ndaj gjyqtarëve, në rast ankimi ose mbi bazë tematike apo territoriale. Këto inspektime zhvillohen me iniciativën e tij ose në zbatim të detyrave të caktuara nga KLD.

8) Prokuroria funksionon pranë sistemit gjyqësor (pranë çdo gjykate), por nuk është pjesë e tij. Kushtetuta parashikon se Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqim të Kuvendit; ai është i pavarur dhe kompetent për ndjekjen e çështjeve penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria është organ i centralizuar dhe hierarkik; prokurorët u nënshtrohen urdhërave të prokurorëve të niveleve më të larta.

9) Komisioni i Reformës Ligjore, i krijuar me Urdhërin e Kryeministrit nr. 90, datë 16.04.2004 "Për ngritjen dhe funksionimin e grupit të punës me eksperte për reformën në fushën e Drejtësisë", si organ me pavarësi juridike-profesionale nën drejtimin dhe bashkërendimin institucional e administrativ të Ministrit të Drejtësisë. Komisioni për Reformën Ligjore është i përbërë nga një berthamë profesionistësh të fushës dhe ka për qëllim hartimin e programeve dhe strategjive afatmesme e afatgjata të reformës në fushën e drejtësisë dhe legjislacionit, si dhe vlerësimin e projektakteve të rëndësishme normative.

2.3 Asistenca teknike

Asistenca teknike që po zbatohet në këtë fushë fokusohet në:

Misioni EURALIUS financuar nga programi CARDS 2002 me një shumë prej 4,5 milionë Euro;

Përmirësimi i infrastrukturës së Gjykatës së Apelit Vlorë dhe Korçë, financuar nga programi CARDS 2003 me një shumë prej 2.3 milionë Euro;

Trajnime dhe pajisje për sistemin gjyqësor, financuar nga programi CARDS 2003 me një shumë prej 1.5 milionë Euro;

Ndertimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda, , financuar nga programi CARDS 2003 me një shume prej 5 milionë Euro;

Ndërtimi i Institutit të të miturve, financuar nga programi CARDS 2004 me një shumë prej 1.5 milionë Euro;

Krijimi i Gjykatës Tregtare, financuar nga programi CARDS 2004 me një shume prej 1 milionë Euro;

Mbështetje Prokurorisë dhe Gjykatës së Krimeve të Rënda, financuar nga programi CARDS 2004 me një shumë prej 2.4 milionë Euro;

Mbështetje për Këshillin e Lartë të Drejtësisë financuar nga programi CARDS 2004 me një shumë prej 0.6 milionë Euro;

Mbështetje për Qendrën e Publikimeve Zyrtare financuar nga programi CARDS 2004 me një shumë prej 0.9 milionë Euro;

Përmirësimi i infrastrukturës në Gjykatat e Sarandës dhe Dibrës, financuar nga programi CARDS 2002-2004-2005 me një shumë prej 1.3 milionë Euro.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si më poshtë:

Të rritet transparenca e proceseve penale dhe civile të drejtësisë;

Të forcohet statusi, pavarësia dhe mbrojtja kushtetuese për gjyqtarët;

Të vendosen rregulla objektive dhe transparente në caktimin e çështjeve që u ngarkohen gjyqtarëve;

Të vendoset një sistem transparent meritash për vlerësimin e prokurorëve;

Të përmirësohet bashkërendimi ndërmjet prokurorisë dhe policisë;

3.1.1 Iniciativat ligjore afat shkurtër

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore.

Projektligj “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;

Ndryshime në dekretin nr. 2110, datë 29.05.1998 “Për krijimin e rretheve gjyqësore, caktimin e kompetencave tokësore dhe të qëndrës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre”;

Ndryshime në dekretin nr. 706, datë 7.12.1993 “Për caktimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve”;

Ndryshime në ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”;

Hartimi i Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë” ;

Ndryshime në Ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë ;

Ndryshime në Ligjin nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

Projektligj “Për administratën gjyqësore”;

Miratimi i manualit të procesit legjislativ dhe teknikës legjislative;

Hartimi i paketës ligjore për dënimet alternative, drejtësinë për të miturit dhe azhurnimi;

Hartimi dhe miratimi i projektaktit “Për etikën e prokurorit”;

Hartimi dhe miratimi nga Prokurori i Përgjithshëm i Rregullores “Për caktimin e sistemit të vlerësimit të punës së prokurorëve”;

Përcaktimi i rregullave për zbatimin e Sistemit të Administrimit të Çështjeve (PP);

Hartimi i paketës ligjore për funksionimin dhe rregullimin e gjykatave administrative.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese nga Ministria e Drejtësisë:

Hartimi dhe zbatimi i programeve vjetore të inspektimeve në prokurori;

Hartimi dhe zbatimi i programeve vjetore të inspektimeve të veprimtarisë së administratës gjyqësore;

Hartimi dhe zbatimi i programeve vjetore të inspektimeve të përbashkëta të Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Departamentit të Inspektimeve në Ministrinë e Drejtësisë;

Programimi vjetor i kontrolleve në gjykata, lidhur me realizimin e marrëdhënieve me publikun, aksesin e qytetarëve në gjykatë dhe në vendimet gjyqësore;

Publikimi i raporteve të kontrollit në gjykata dhe prokurori;

Trajnimi i inspektorëve në lidhje me metoda të reja kontrolli, si edhe në lidhje me sisteme të vendeve të ndryshme të BE- së;

Kontrolli i zbatimit të sistemit të administrimit të çështjeve në të gjitha fazat e procesit penal.

Nga Shkolla e Magjistraturës:

Hartimi dhe zhvillimi i sesioneve trajnuese në fusha të ndryshme të së drejtës si e drejta civile, e drejta procedurale civile, e drejta penale, e drejta procedurale penale, e drejta kushtetuese, e drejta evropiane dhe të drejtat e njeriut, e drejta ndërkombëtare private, bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar në fushën penale dhe civile, prezantimi i *acquis communautaire*, prokurimi publik, e drejta e falimentit, pronësia intelektuale, barazia gjinore, mbrojtja e të dhënave personale etj;

Marrja dhe rehabilitimi i ambienteve të reja (klasa, salla leksionesh dhe seminaresh, zyra të administratës;

Rritja e stafit administrativ dhe shkencor me: dy bashkëpunëtorë shkencorë dhe dy punonjës të stafit administrativ;

Trajnime për gjyqtarët për seksionet e posaçme të gjykatës që do të trajtojnë çështjet e të miturve;

Përgatitja e pyetësorëve për identifikimin e nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve për kurse të gjuhëve të huaja;

Trajnimi i administratës gjyqësore nëpërmjet programit të bashkëpunimit midis Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

3.2 Prioritet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008 – 2009 janë si më poshtë:

Të sigurohet ndjekja penale për krimet e rënda, veçanërisht për krimin e organizuar, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë mekanizmave të bashkëpunimit ndërkufitar;

Të sigurohet trajnim i vazhdueshëm dhe i përshtatshëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve, në çështje si të drejtat e njeriut, etika, çështje tregtare dhe ato të lidhura me MSA-në;

Të sigurohet qëndrueshmëri financiare për Shkollën së Magjistraturës;

Rishikimi i rolit dhe kualifikimet e administratës gjyqësore përfshirja e tyre në mënyrë progresive në shërbimin civil.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Rishikimi tërësor i Kodit Penal

Vlen të theksohet që aktivitetet zbatuese të përcaktuara për periudhën afatshkurtër konsiderohen si angazhime që do të adresojnë në tërësi jo vetëm prioritetet afatshkurtra, por dhe ato afatmesme, duke pasur parasysh që afatet e realizimit të plotë të një pjese të tyre shtrihen përtej afateve të periudhës afatshkurtër.

1.1.6 LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

1. Objektivi politik

Prioritet absolut i Qeverisë Shqiptare do të jetë lufta për çmontimin dhe shembjen e strukturave të sistemit të korrupsionit, duke u bazuar në kombinimin e dy drejtimeve themelore, atë të parandalimit dhe atë të ndëshkimit të korrupsionit, mbështetur në moton *"Qeverisje me Duar të Pastra"*.

Reformat institucionale dhe ato të tregut do të kenë si komponent të përherëshëm të tyre mjetet dhe metodat parandaluese që ngushtojnë hapësirat për korrupsion të tilla si transparenca, kontrolli i brendshëm dhe i jashtëm, aksesit në vendimmarrje dhe roli monitorues i shoqërisë civile, komuniteteve vendore dhe të medias.

Ndërkaq, vetë këto reforma, duke ridimensionuar rolin e shtetit në ekonomi, duke ulur shkallën e burokracisë dhe të barrierave administrative, si dhe duke rritur rolin e sektorit privat dhe të atij terciar në ofrimin e të mirave publike, do të jenë faktorë mjaft të fuqishëm në uljen e mundësive për korrupsion të zyrtarëve.

Veprimi ndëshkues ndaj rasteve korruptive do të jetë një tjetër objektiv primar. Për këtë qëllim do të ndërmerren të gjitha hapat e nevojshme institucionale dhe ligjore për hetimin dhe ndëshkimin administrativ apo penal, për cilindo zyrtar që përfshihet në korrupsion.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Kuadri ligjor bazë në fushën e luftës kundër korrupsionit fokusohet në:

Ligjin nr. 8635, datë 07.06.2000 "Mbi ratifikimin e Konventës Evropiane Civile për Korrupsionin"

Ligjin nr.8778, datë 26.04.2001"Për ratifikimin e Konventës Europiane Penale për Korrupsionin"

Ligjin nr. 9245, datë 24.06.2004 "Mbi ratifikimin e Protokollit Shtesë të Konventës Penale për Korrupsionin"

Ligji nr 9492,date 13.03.2006 "Per ratifikimin e Konventes se Kombeve te Bashkuara Kunder Korrupsionit"

Ligji nr` 9508, date 03.04.2006 "Per bashkepunimin e publikut ne luften kunder korrupsionit"

Ligji nr 9475 date 09.02.2006 per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr 9367 , date 07.04.2005 "Per parandalimin e konfliktit te interesave ne ushtrimin e Funksioneve publike".

Ligji nr 9049, date 10.04.2003" Per deklarimin dhe kontrollin e pasurive te detyrimeve financiare te te zgjedhurve dhe te disa nepunesve publike" i ndryshuar.

Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 137, datë 18.03.2005, "Për miratimin e Planit të Veprimeve, për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, 2005"

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.794, datë 19.12.2005 "Për krijimin e task Forcës Anti-korrupsion"

Vendim i Keshillit te Ministrave nr 94, date 15.02.2006 " Per miratimin e rregullores per

funksi­onet dhe procedurat e kontrollit te brendshem administrativ dhe antikorrupsionit te Keshillit te Ministrave.

Urdhër Nr. 172, datë 02.11.2005 “Për marrjen e masave të shpejta në zbatim të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”

Urdhër i Kryeministrit Nr. 135, datë 12.06.2006, “Për ngritjen e Grupit Ndërmësror të Punës, për thjeshtezimin e dokumentacionit shoqerues për shërbimet e ofruara nga administrata qendrore”.

Urdhër i Kryeministrit “Per Krijimin e Task-Force per drejtimin dhe monitorimin e reformes rregullatore ne funksion te permiresimit te klimes se Biznesit” Nentor 2005

2.2 Kuadri institucional

Strukturat që janë të ngarkuara me luftën kundër korrupsionit janë:

Task Forca Anti Korrupsion, e krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 794, datë 19.12.2005. Kjo strukturë kryesohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga anëtarë të Këshillit të Ministrave dhe përfaqësues të institucioneve të tjera të varësisë. Task Forca Antikorrupsion ka këto funksione:

Analizon problemet e korrupsionit dhe të etikës së qeverisjes;

Përcakton përparësitë strategjike, synimet, objektivat dhe masat konkrete për të luftuar dhe parandaluar korrupsionin;

Propozon krijimin e grupeve të punës me ekspertë, sipas përparësive, propozon detyrat e tyre për zhvillimin e veprimtarive sektoriale, si dhe monitoron punën e tyre;

Miraton projektin e planit të veprimit antikorrupsion dhe të mirëqeverisjes dhe ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave;

Përcakton fushat parësore për kontrollin e brendshëm, administrativ dhe financiar dhe, sipas rastit, mund të përcaktojë detyra konkrete kontrolli;

Siguron bashkëpunimin ndërinsti­tuconal për luftën kundër korrupsionit dhe zbatimin e programeve të mirëqeverisjes;

Siguron bashkëpunimin me komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile;

Garanton transparencë në luftën kundër korrupsionit.

Departamenti i Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit, në Kryeministri, që është i ngarkuar, ndërmjet të tjerash, për monitorimin e zbatimit të planit të veprimeve, sipas fushës së veprimtarisë së të institucioneve, propozimin e ndryshimeve ne sistemet dhe mekanizmat anti korrupsion në strukturat e ndryshme të administratës publike etj.

2.3 Asistenca teknike

Gjatë viteve të fundit, strukturat e specializuara antikorrupsion kanë pasur mbështetjen teknike dhe financiare të Këshillit të Evropës, nëpërmjet projektit PACO (Programi kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar në Evropën Juglindore), projekt ky, që është financuar nga Agjencia Suedeze Ndërkombëtare për Zhvillimin (SIDA).

Aktualisht , në kuadër të programit CARDS 2004, është duke u zbatuar projekti “Mbështetje për reformën në administratën publike”, me një shumë prej 2 mil Euro, ku një nga komponentët e rëndësishëm të këtij projekti ka për qëllim thjeshtimin e shërbimeve publike të ofruara nga institucionet e administratës qendrore.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si më poshtë:

Të miratohet legjislacioni i nevojshëm për të harmonizuar kuadrin ligjor shqiptar me konventat europiane mbi korrupsionin (në çështje civile dhe penale) të ratifikuara nga Shqipëria, si edhe me konventat përkatëse të OKB-së.

Të përmirësohet legjislacioni ekzistues.

Të përmirësohet legjislacioni ekzistues mbi mitmarrjen dhe të zbatohet duke u bazuar në bashkërendimin ndër-ministral.

Të sigurohet shtrëngimi i ligjit mbi deklarimin e pasurisë.

Të forcohen kapacitetet institucionale për hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit.

Të angazhohet njësi e specializuar në prokurorinë e Tiranës (që merret me krimet financiare) edhe për çështjet e korrupsionit.

Të ulet numri i zyrtarëve që gëzojnë imunitet dhe të jepet imunitet vetëm atëherë kur është domosdoshmërisht e nevojshme.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Miratimi i Projektligjit “ Për përgjegjësinë penale të personave juridike”, iniciativë e cila është pjesërisht në përputhje me Konventën Europiane Penale për Korrupsionin”

Miratimi i Projekt-ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 7895 dt 27/1/1995 "Kodi Penal i RSH -së" i ndryshuar në kuadër të nenit 257 për fshehjen dhe deklarimin e remë të pasurisë së personave të zgjedhur ose nëpunësve publike;

Miratimi i ndryshimeve në ligjin nr.8749, datë 01.03.2001 " Për shërbimin e Kontrollit të Brendshëm;

Miratimi i Projekt-ligjit “Mbi prokurimet publike”

Miratimi i akteve nënligjore, në ndryshim të ligjit "Për shërbimin e Kontrollit të Brendshëm".

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Nga ana e Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës do te realizohet:

Raportimi i skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore me qëllim ndërgjegjësimin e strukturave të administratës qendrore dhe vendore për zbatimin e parimeve bazë të ndihmës shtetërore.

Vlerësimi ekonomik dhe legjislativ i skemave të ndihmave shtetërore në përputhje me dispozitat e ligjit dhe përgatitja e rekomandimeve përkatëse.

Nga ana e Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Ministria se Financave) do te realizohet:

Kryerja e Analizës së Riskut;

Menaxhimi korrekt i kuotave të MTL –së përmes shtrirjes së sistemit ASYCUDA ++ neëgjithë vendin;

Unifikimi i procedurave për zbatimin korrekt të ligjit për konfliktin e interesave dhe standarteve të duhura për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, zgjidhjen dhe penalizimin e rasteve të konfliktit të interesave;

Menaxhimi i vlerës doganore dhe çmimeve të referencës dhe implementimi uniform i tyre, në gjithë territorin doganor. Shtrirja e modulit VALU-NET.

Nga ana e Drejtorise se Përgjithshme e Tatimeve (Ministria se Financave) do te realizohet:

Dokumentimi dhe përmirësimi i proçedurave të kontrollit të brendshëm dhe investigimit të brendshëm;

Diagnostikimi, dokumentimi dhe përmirësimi i proçedurave të kontrollit dhe investigimit të Tatim-paguesve;

Zgjerimi i sistemit të kompjuterizuar tatimor (SIT) në rrethet Gjirokastrë, Sarandë, Pogradec;

Dokumentimi dhe përmirësimi i proçedurave të punës së Policisë Tatimore;

Aplikimi i sistemit të inteligjencës dhe përdorimi efikas i tij me të dhënat e rrjetit të zgjeruar kompjuterik;

Azhornimi i manualeve proçeduriale të regjistrimit, masave shtrënguese dhe akcizës;

Zbatimi i programit të zgjedhjes së kompjuterizuar të tatim-paguesve për kontroll.

Agjencia e Prokurimit Publik do te realizoje aktivitetet e meposhtme:

Forcimi i kapaciteteve administrative të APP-së;

Ngritja dhe funksionimi i Ombusmanit te Prokurimeve për të shqyrtuar procedurat e ankimit;

Përmirësimi i sistemit të informimit dhe transparencës përmes konsolidimit të Websit-it lidhur me procedurat e prokurimit.

Ministria e Brendshme do te realizoje gjate kesaj periudhe:

Vendosjen e numrit të telefonit për publikun, me qëllim denoncimin e korrupsionit në forcat e Policisë së Shtetit;

Realizimin i trajnimeve me qëllim forcimin e kapaciteteve të strukturës të Policisë Gjyqësore të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm.

Ministria e Drejtësisë do te kryeje:

Hartimin dhe zbatimin i programeve vjetore të inspektimeve neëgjykata;

Hartimin dhe zbatimin i programeve vjetore të inspektimeve në prokurori;

Hartimin dhe zbatimin i programeve vjetore të inspektimeve të veprimtarisë së administratës

gjyqësore;

Hartimin dhe zbatimin e programeve vjetore të inspektimeve të përbashkëta të Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Departamentit të Inspektimeve në Ministrinë e Drejtësisë;

Programimin vjetor të kontrolleve në gjykata, lidhur me realizimin e marrëdhënieve me publikun, aksesin e qytetarëve në gjykatë dhe në vendimet gjyqësore;

Trajnimin e inspektorëve në lidhje me metoda të reja kontrolli, si edhe në lidhje me sisteme të vendeve të ndryshme të BE-së;

Kontrollin e zbatimit të sistemit të administrimit të çështjeve në të gjitha fazat e procedimit penal;

Fuqizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe inspektoriatit të tij, si dhe fuqizimi i bashkëpunimit mes inspektoriateve të Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit do të reagojë

Krijimin e Inspektoriatit të nevojshëm për kontrollin e Infrastrukturës të Cilësisë së materialeve të ndërtimit

Kualifikimin për punonjësit e Inspektoriatit për kontrollin e Infrastrukturës të Cilësisë së materialeve të ndërtimit

Ngritjen e Forcës së Sigurisë në Portin e Shëngjinit në kuadër të “Memorandumit të mirekuptimit për kontrollin shtetëror Portual” (Memorandumi I Parisit)

3.2 Prioritet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008 – 2009 janë si më poshtë:

Të zbatohen Konventat Europiane për Korrupsionin në çështje penale dhe civile, të ratifikuara nga Shqipëria, si dhe Konventat përkatëse të OKB-së.

Te arrihen rezultate të dukshme në luftën kundër korrupsionit, në të gjitha nivelet dhe fushat, nëpërmjet zbatimit të legjislacionit përkatës.

3.2.1 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës

Përgatitja e raportit vjetor për ndihmat Shtetërore bazuar në metodologjinë e Komisionit Evropian.

Krijimi i Qendres Kombëtare të Bisnesit, me qëllim zbatimin e praktikës “one stop shop” për regjistrimin e bizneseve si dhe shërbimin si data base për të gjithë bizneset.

Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve)

Adoptimi i procedurave për regjistrimin unik të tatim-paguesve të biznesit të vogël dhe hartimi i një rregulloreje për apelimet tatimore;

Administrimi i kompjuterizuar i tatim-paguesve të biznesit të vogël;

Përfshirja e akcizës dhe taksave nacionale në SIT;

Krijimi i Rrjetit të Komunikimit Kombëtar.

Tabela: Shtese e kapaciteteve institucionale të Strukturave
përgjegjëse për Luftës kundër korrupsionit

investime	Njësia matjes	2006	2007
Rritje personeli tek:			
a) Dogana	person		+
	a	10	
b) Agjensia e prokurimit publik			
	person		+
	a	2	
Trajnime	000/le	5	
	ke	300	
Konsulencë	000/le	4	1
	ke	300	250
Investime IT	000/le	1	

1.2 TE DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE

1.2.1 RESPEKTIMI I TE DREJTAVE TE NJERIUT

1.2.1.1 PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË BURGJEVE

1. Objektivi politik

Në kuadër të garantimit të të drejtave bazë dhe themelore të individit, respektivisht për të drejtat dhe liritë që i njihen të dënuarve, qeveria shqiptare konsideron angazhim parësor krijimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues duke siguruar që të gjitha organet e zbatimit të ligjit të sigurojnë një trajtim njerëzor në paraburgim dhe shndërrimin e dënimit penal në një mundësi riedukimi.

Duke patur parasysh që kuadri ligjor për sistemin e burgjeve është gjithmonë e më tepër duke u përafruar me standartet ndërkombëtare në fushën penitenciare një objektiv tjetër i rëndësishëm mbetet zbatimi i të gjitha rekomandimeve, rregulloreve dhe akteve të tjera ndërkombëtare për këtë fushë, si për sistemin e burgimit ashtu edhe për atë të paraburgimit si dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.

Fleksibiliteti i të gjithave akteve të mësipërme shton perspektivat për të përmirësuar zbatimin e tyre praktik në sistemin e burgjeve ashtu si edhe në Evropë ku këto rregulla janë shndërruar në një simbol dhe stimuj për përmirësimin e standarteve të përgjithshme dhe regjimeve humanitare e përparimtare të trajtimit. Në këtë mënyrë garantohet që dënimi me heqje lirie do të zbatohet në mënyrë të paanëshme duke mos patur diskriminim për arsye feje, race, ngjyre, seksi, mendimi politik, ekonomik, etj.

Gjithashtu një vend të veçantë dhe prioritet për qeverinë shqiptare është zgjidhja e problemit të mbipopullimit të burgjeve duke zbatuar me rigorozitet edhe rekomandimet e Këshillit të Evropës. Në këtë mënyrë janë siguruar kushtet e domosdoshme për zbatimin e projekteve të ndryshme të mbështetura financiarisht nga CARDS për ndërtimin e burgjeve të reja dhe rikonstrukcionin e atyre ekzistues.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Kuadri ligjor bazë në këtë fushë fokusohet në:

Ligji nr. 8688, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë";

Ligji nr. 8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale";

Ligji nr. 8137, datë 31/07/1996 "Për ratifikimin e Konventës Evropiane "Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore";

Ligji nr. 8328, datë 16. 04. 1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim" i ndryshuar;

Ligji nr.8321, datë 02.04.1998 "Për Policinë e Burgjeve";

Ligji nr 9375, datë 21.04.2005 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8321 datë 02.04.1998 "Për Policinë e Burgjeve;

Ligji nr 9397, datë 12.05.2005 "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në sistemin e burgjeve".

2.2 Kuadri institucional

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, për respektimin e të drejtave të njeriut respektivisht për sistemin e burgjeve, institucionet përgjegjëse janë:

1) Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Mbështetur në ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar me ligjin nr. 9112, datë 24.07.2003, DPB është një institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë i cili ndjek e realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit, të ekzekutimit të vendimeve penale, të vuajtjes së dënimit, etj.

2) Drejtoria e Rendit dhe Sigurisë Publike në Ministrinë e Brendshme, në lidhje me respektimin e të drejtave të paraburgosurve që qëndrojnë në komisaritet e policisë.

3) Prokuroria e Përgjithshme, për rastet e kallëzimeve për keqtrajttime të burgosurve nga personeli i Policisë së Burgjeve ose nga forcat e policisë në kushtet e paraburgimit.

2.3 Asistenca teknike

Asistenca teknike që po zbatohet në këtë fushë fokusohet në:
Misioni EURALIUS financuar nga programi CARDS 2002 me një shumë prej 4,5 milionë Euro;

Ngritja e Burgut të Korçës (faza e parë) financuar nga CARDS 2002 , me një shumë prej 2.5 milionë Euro;

Ngritja e Burgut të Korçës (faza e dytë) financuar nga CARDS 2004 , me një shumë prej 2.5 milionë Euro;

Asistencë nga CARDS 2004 për trajnime për stafin e burgjeve , me një shumë prej 0.5 Milionë Euro;

Ngritja e Institutit të të miturve me asistence nga CARDS 2004 me një shumë prej 1.5 milionë Euro;

Asistence nga CARDS 2002 -2004-2005, për paraburgimin në Vlorë me një shumë prej 4.4 milionë Euro.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si më poshtë:

Të respektohen konventat ndërkombëtare për ngritjen dhe drejtimin e institucioneve penitenciare;

Të zbatohet master plani 2004 me qëllim përmirësimin e kushteve për të ndaluarit dhe të burgosurit në pritje të gjykimit;

Të zbatohet me rigorozitet Kodi i Etikës për sistemin e burgjeve.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore.

Miratimi i projekt-rregullores "Për funksionimin e Komisionit Mbikqyrës të ekzekutimit të vendimeve penale";

Miratimi i "Disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve";

Hartimi dhe miratimi i Rregulloreve të reja për qendrat e veçanta të sistemit të paraburgimit që do të ngrihen në të gjithë vendin;

Miratimi i VKM "Mbi nxitjen dhe shpërblimin e punës së të dënuarve dhe paraburgosurve";

Miratimi i projekt-ligjit "Mbi disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale";

Miratimi i projekt-ligjit "Mbi disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim";

Miratimi i projekt-ligjit "Mbi disa ndryshime e shtesa në ligjin "Për Policinë e Burgjeve";

Miratimi i projekt-ligjit "Mbi disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 8678, datë "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë";

Miratimi i projekt-ligjit "Për Shërbimin e Provës (për zbatimin dhe ndjekjen e dënimeve alternative)

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Trajnimi i stafeve të edukimit që merren me trajtimin e të miturve në ambjentet e vuajtjes së dënimit dhe ato të paraburgimit;

Trajnim i gjithanshëm i gjithë stafit të burgjeve në çështjet e të drejtave të njeriut dhe nxitja për respektimin e të drejtave përsa i përket trajtimit të të burgosurve;

Shpërndarja e të dënuarve nëpër institucionet pranë qendrave të tyre të banimit;

Botimi i një përmbledhjeje lidhur me të drejtat dhe detyrat e të dënuarve dhe të paraburgosurve në ambjentet e vuajtjes së dënimit dhe paraburgimit;

Studimi i mundësive strukturore të sistemit penitenciar për aplikimin e dënimeve alternative;

Përshtatja e ambjenteve për funksionimin e Institutit të Riedukimit për të miturit, ndërhyrja e nevojshme ndërtimore dhe pajisja e ndërtesës;

Trajnimi afatshkurtër e afatmesëm i personelit të Institutit;

Fuqizimi i Qendrës së trajnimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për t'u transformuar në akademi të sistemit të burgjeve;

Ndërhyrje në infrastrukturën e burgjeve Burrel, Lezhë, Lushnjë, Peqin, 313, 302 dhe Vlorë;

Përfundimi i burgut Fushë-Krujë;

Ndërtimi i paraburgimit të ri Durrës;
Hartimi i projektit të paraburgimit të ri Elbasan;
Ndërtimi i paraburgimit të ri Vlorë;
Përfundimi më 2007 i burgut Korçë;
Përfundimi i infrastrukturës së nevojshme logjistike për vënien në punë të burgut Fushë-Krujë;
Modernizimi i sistemit statistikor në burgje.

3.2 Prioritet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008 – 2009 janë si më poshtë:

Të trajtohen në përputhje me standardet ndërkombëtare të paraburgosurit dhe të burgosurit në pritje të gjykimit.

Të respektohen konventat ndërkombëtare mbi dinjitetin dhe sigurinë vetjake në qendrat e paraburgimit, burgjet dhe institucionet e shëndetit mendor.

Iniciativat ligjore dhe aktivitetet zbatuese të përcaktuara për periudhën afatshkurtër konsiderohen si angazhime që do të adresojnë në tërësi jo vetëm prioritetet afatshkurtra por dhe ato afatmesme.

1.2.1.2 PËRMIRËSIMI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT PËRMBARIMOR

1.Objektivi politik

Në kuadër të reformimit të sistemit gjyqësor, qeveria Shqiptare do të angazhohet për realizmin e të gjitha iniciativave të nevojshme për pëmbushjen e angazhimeve dhe detyrimeve në lidhje me përmirësimin e funksionimit të sistemit përmbarrimor. Reformat në këtë fushë do të synojnë në forcimin e kapaciteve të këtij sistemi, në zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, materializimin e një të drejte të fituar në një proces gjyqësor.

Gjithashtu, një vëmendje të veçantë do t'i kushtohet zbatimit me rigorozitet dhe në çdo rast të vendimeve gjyqësore, në radhë të parë nga vetë institucionet shtetërore, rristurimit dhe forcimit të kapaciteteve të përmbarrimit dhe hapjen e mundësive për përmbarruesin privat në këtë fushë, përmirësimin të kushteve dhe mjeteve të përmbarrimit gjyqësor, rritjes së profesionalizmit të përmbarruesve, si dhe transparencës dhe objektivitetit në emërimet dhe karrierën e përmbarruesve.

Të gjitha këto masa do të synojnë rritjen e efikasitetit të këtij shërbimi dhe përqasjes me standardet dhe praktikat evropiane.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Kuadri ligjor bazë në këtë fushë fokusohet në:

Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e RSH”, Kapitulli “Për të drejtat e njeriut”;

Ligji nr. 8036, datë 22.11.1995 “Për ndihmën e ndërsjelltë gjyqësore në fushat civile, tregtare”;

Ligji nr. 7760, datë 14. 10.1999 “ Për ratifikimin e Marrëveshjes mbi ndihmën gjyqësore në zbatimin e çështjeve civile e penale”;

Ligji nr.9443 datë.16.11.2005 per ratifikimin e Konventes e Hages 19 Tetor 1996 “ Mbi juridiksionin ligjin e zbatueshëm, njohjen, ekzekutimin e bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijës”;

Ligji nr. 8137, datë 31/07/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore”;

Ligji nr 8624, datë 15/06/2000 “Për ratifikimin e Konventës së Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”;

Ligji nr. 8688, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”;

Ligji nr. 8730, datë 18.01.2001 “ Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor”;

Ligji nr.8812 , datë 17. 05 .2001.”Kodi i Procedurës Civile i R.SH”, i ndryshuar;

Ligji nr.7850,datë 29. 07.1994.”Kodi Civil i R.Sh”;

Ligji nr 9062, datë 08.05.2003 “Kodi i Familjes”, i ndryshuar;

Ligji nr. 8435, datë 28.12.1998 “ Për sistemin e taksave në R. Sh”;

Ligji nr. 8894, datë 14.05.2002 “ Për Agjensinë e Trajtimit të Kredive”.

2.2 Kuadri institucional

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, për fushën e përmirësimin të sistemit përmbarrimor janë përgjegjëse :

1) Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor-varet nga Ministri i Drejtësisë. Shërbimi i Përmbartimit është i centralizuar me shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe i ushtron funksionet nëpërmjet përmbartuesve gjyqësorë, të cilët janë personat e ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë në përputhje me dispozitat e Kodit të Proedurës Civile.

Në nivelin qëndror të saj Drejtori i Përgjithshëm përgjigjet për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e Shërbimit Përmbartimor, zbatimin e akteve ligjore e nënligjore si dhe praktikave në fushën e veprimtarisë procedurale të ekzekutimit; përgatit dhe nxjerr urdhra, udhëzime të brendshme dhe metodika për trajtimin e çështjeve në ekzekutim; organizon dhe ndjek edukimin profesional dhe trajnimin e përmbartuesve gjyqësorë; ndjek zbatimin e etikës profesionale gjatë veprimtarisë përmbartimore si dhe përfaqëson Shërbimin e Përmbartimit Gjyqësor në marrëdhënie me të tretët.

Në nivelin vendor të organizimit zyrtar përmbartimore pranë çdo rrethi gjyqësor janë persona juridikë dhe përbëhen nga : kryetari i zyrës, përmbartuesit gjyqësorë, personeli administrative dhe teknik. Çdo zyre përmbartimore pranë çdo rrethi gjyqësor merr masat e nevojshme procedurale për ekzekutimin efektiv të titujve të ekzekutimit.

Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme dhe e Zyrave Përmbartimore, organikat si dhe rregullat e hollësishme për funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor përcaktohen nga Ministri i Drejtësisë me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm. Për realizimin e detyrave Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor ka buxhetin e vet si pjesë e veçantë brenda buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë. Çdo veprim përmbartimor kryhet kundrejt pagimit të taksave sipas ligjit për sistemin e taksave dhe tarifave përkatëse, të cilat përcaktohen me akt normativ të Ministrit të Drejtësisë.

2) Ministria e Drejtësisë- nëpërmjet Drejtorisë së Drejtësisë për të Miturit dhe Shërbimeve Juridiko-Administrative ushtron këto kompetenca:

Përgatit, ndjek dhe bashkërendon realizimin e politikave, të programeve dhe veprimtarive që lidhen me fushën e drejtësisë për të miturit, edukimin ligjor, luftën dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit dhe kriminalitetit tek të miturit;

Kujdeset dhe bashkërendon punën me institucionet e ngarkuara me detyra ligjore për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshme të të miturve në fushën e drejtësisë, veçanërisht lidhur me birësimet dhe kujdestarinë e tyre;

Kujdeset për zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit që ngarkon Ministria e Drejtësisë dhe në tërësi organet e drejtësisë, me përmbushjen e shërbimeve të ndryshme juridiko-administrative.

Gjithashtu institucione të ngarkuara me detyra ligjore për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të të miturve në fushën e drejtësisë, janë:

3) Ministria e Financave-në rastet e pamundësisë paguese të detyrimeve që institucionet buxhetore kanë ndaj personave fizikë apo juridikë, përcakton një buxhet (zë) më vete për këto institucione lidhur me këto detyrime që duhet të ekzekutohen nga përmbartimi gjyqësor. Në rastet e fillimit të procedurës për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv, urdhërohet Drejtoria e Tatim-Taksave, që është në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme, për dhënien e informacionit, brenda afatit ligjor, nëse pala debitore ushtron apo jo aktivitet tregtar, për të bërë të mundur sekuestrimin e këtij aktiviteti nga strukturat e shërbimit përmbartimor.

4) Ministria e Brendshme-kur për ekzekutimin e detyrueshem është e nevojshme që të çelet banesa ose ndërtesë tjetër e debitorit për të kërkuar sendet e tij që ndodhen në to, në rast nevojë, përmbartuesi i kërkon ndihmë policisë së rendit.

5) Prokuroria- në rastet e pengimit të ekzekutimit të Titullit Ekzekutiv nga ana e palës debitore, përmbartuesi gjyqësor bën kallëzim penal pranë organit të akuzës (Prokurori) duke vënë në dispozicion të Prokurorisë të gjitha materialet e nevojshme për fillimin e procedimit penal prej saj.

6) Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme- kur kërkohet ekzekutimi i një detyrimi nga pala debitore, përmbartuesi gjyqësor me kalimin e afatit të lajmërimit për ekzekutim vullnetar fillon ekzekutimin e detyrueshëm duke vënë sekuestro mbi sendet e paluajtshme në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

7) Bankat e Nivelit të Dytë-kur kërkohet ekzekutimi i një detyrimi në të holla, përmbartuesi gjyqësor me kalimin e afatit të lajmërimit për ekzekutim vullnetar fillon ekzekutimin e detyrueshëm duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

2.3 Asistenca teknike

Asistenca financiare e ofruar në këtë fushë është nga Misioni EURALIUS për kryerjen e trajnimeve të ndryshme me një vlerë prej 15.000 Euro.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si me poshtë:

Të arrihet një rritje e vazhdueshme në nivelin e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore.

Miratimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Proçedures Civile” iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Rregulloren e Këshillit, datë 22 Dhjetor 2000 “Mbi juridiksionin, njohjen dhe zbatimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare” dhe Konventën e Brukselit “Mbi juridiksionin dhe zbatimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare”;

Miratimi i projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8730, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor;

Miratimi i projektligjit “ Mbi proçedurat e zhvillimit të ankandit”;

Miratimi i projekt-urdhërit “Mbi caktimin dhe aplikimin e tarifave të shkallëzuara të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor”;

Miratimi i projekt-urdhërit “Për ndarjen e të ardhurave, kriteret, proçedurat e administrimit dhe shpërndarjen e tyre”;

Miratimi i një Akt-marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Ndërtimore.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Realizimi i trajnimeve me të gjithë përmbaruesit gjyqësore në rrethe si dhe të Inspektorëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit në lidhje me shtesat dhe ndryshimet e propozuara në Kodin e Proçedurës Civile;

Realizimi i trajnimeve mbi zbatimin e rregullave të Kodit Etik të Përmbaruesit gjyqësor;

Realizimi i trajnimeve i gjithë përmbaruesve gjyqësore në rrethe si dhe të Inspektorëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit në lidhje me proçedurat e zhvillimit të ankandit;

Realizimi i trajnimeve në lidhje me ekzekutimin e gjobave penale;

Realizimi i trajnimeve në lidhje me trajtimin e situatave konfliktuale në rastet e ekzekutimit të vendimeve me objekt “Takim fëmije”;

Futja e një sistemi të ri kontrolli, i cili do të sjellë një vlerësim të ri në ecurinë dhe efektivitetin në ekzekutim të zyrave përmbarimore lokale;

Ristrukturimi i ambjenteve të punës në funksion të detyrës në rrethet problematike;

Ngritja dhe instalimi i një intraneti përmes të cilit të gjitha zyrat e shërbimit përmbarimor të mund të komunikojnë përmes kompjuterit, për sigurimin e gjithë dokumentacionit të nevojshëm;

Përmirësimi i kapaciteteve infrastrukturore të zyrave të shërbimit përmbarimor;

Sigurimi i automjeteve për çdo zyrë përmbarimore, e domosdoshme në proçesin e ekzekutimit;

Sigurimi i pajisjeve të nevojshme elektronike për zyrat e shërbimit përmbarimor.

3.2 Prioritet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008 – 2009 janë si më poshtë:

Të reduktohen në masë mosrealizimet dhe të sigurohet ekzekutimi në kohë i vendimeve gjyqësore

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore.

Miratimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr 9062, datë 08.05.2003.” Kodin i Familjes”, i ndryshuar, iniciativë e cila është pjesërisht në përputhje me Rregulloren e Këshillit, datë 29 Maj 2000 “Mbi juridiksionin, njohjen dhe zbatimin e vendimeve në çështjet matrimoniale dhe në çështjet e përgjegjësisë prindërore për fëmijët e të dy bashkëshortëve” dhe Konventën e Hagës 19 Tetor 1996 “ Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, ekzekutimin e bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijës”

Të gjitha masat e parashikuara synojnë që të adresojnë në mënyrë të plotë të gjitha prioritetet e përcaktuara për këtë fushë.

Tabela: Shtesa e kapaciteteve për Shërbimin përmbartimor

<i>investime</i>	<i>Nj esia matjes</i>	<i>Gj endja aktuale</i>	<i>20 06</i>	<i>20 07</i>	<i>20</i>
Shtim personeli	Në punës	9	+		
Investime	00		2	43,	43,
e	0/leke		173	010	
Përkthim	00		60		
e	0/leke				

1.2.2 MINORITETET

1. Objektiv politik

Ndërmarrja e reformave tërësore institucionale dhe ligjore do të synojnë një garantim dhe realizim në nivele gjithnjë e më të larta të të drejtave dhe lirive themelore të individit e në veçanti të të drejtave të minoriteteve.

Në përputhje me instrumentat ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së minoriteteve dhe detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian, qeveria Shqiptare do të angazhohet për të zbatuar dhe arritur standartet më të larta të respektimit dhe realizimit të të drejtave të të gjitha minoriteteve që jetojnë në Shqipëri. Të gjitha hapat dhe nismat që do të ndërmerren do të synojnë zbatimin dhe përputhshmërinë e plotë me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, të ratifikuara nga Shqipëria.

Me prioritet do të konsiderohet zbatimi i plotë i Strategjisë Kombëtare për Romët, duke synuar përmirësimin e kushteve të jetesës, arsimimit dhe punësimit të këtij minoriteti, nëpërmjet programeve të ndihmës ekonomike, shërbimeve publike e private të përkujdesit shoqëror.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Trajtimi i minoriteteve ka marrë një dimension të ri, i cili shprehet qartë në anëtarësimin e Shqipërisë në konventat ndërkombëtare, si OSBE, Këshilli i Evropës etj, si dhe në ratifikimin apo aderimin në pothuaj të gjitha konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe në mënyrë të veçantë, në ratifikimin pa asnjë rezervë të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës “Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare” 1995.

Në kuadër të Organizatës të Kombeve të Bashkuara, Shqipëria ka ratifikuar pothuaj të gjitha konventat kryesore të kësaj organizate lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Disa nga këto dokumente janë:

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948, (*aderuar më 1955*);

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial, 1969, (*aderuar më 1994*);

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, 1966, (*aderuar më 1991*);

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore 1976, (*aderuar më 1991*);

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, 1980, (*aderuar më 1996*);

Konventa mbi të drejtat e fëmijëve 1989, (*aderuar më 1992*);

Konventa kundër diskriminimit në arsim, 1960, (*aderuar më 1963*).

Në kuadër të Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin Evropian, janë nënshkruar të gjitha dokumentat e saj, si:

Aktin Final të Konferencës së Helsinkit, 1975;

Deklaratën e Kopenhagenit, 1990;

Kartën e Parisit për një Evropë të re, 1990;

Dokumentin e Konferencës së Moskës, 1991.

Në kuadër të Këshillit të Europës, janë nënshkruar dhe ratifikuar një numër të konsiderueshëm dokumentesh të rëndësishme të adoptuara nga ky organizëm ndërkombëtar, ndër të cilat duhen përmendur:

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, 1951, (*ratifikuar me Ligjin 8137, datë 31.07.1996*) dhe Protokollat 1, 2, 4, 6, 7, 11 të kësaj Konvente;

Konventa Kuadër “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare” 1995 (*ratifikuar me Ligjin 8496, datë 3.06.1999, pa asnjë rezervë*);

Konventa Europiane për Televizionin Ndërkufitar 1999 (*ratifikuar me Ligjin Nr.8525, datë 9.9.1999*);

“Marrëveshja e Pjesëshme e Zgjeruar e Qendrës Evropiane të Gjuhëve Moderne” në Grac të Austrisë (*ratifikuar me Ligjin Nr.8706, datë 01.12.2000*), etj.

Përveç sa me sipër, ekziston edhe legjislacioni i mëposhtëm i cili merr në mbrojtje dhe adreson çështjet e minoriteteve, ku mund të përmenden kryesisht:

Ligji nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në të cilin theksohet se në marrëdhëniet me personat privatë, administrata publike udhëhiqet nga parimi i barazisë në kuptimin që askush nuk duhet të privilegjohej apo diskriminohet për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore;

Ligji nr.7952, datë 21.6.1995 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar”. Sipas këtij ligji, personat që u përkasin pakicave kombëtare u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën amare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre brenda kuadrit të planeve dhe programeve mësimore;

Ligji nr.8410, datë 30.9.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë” i cili garanton akses të plotë të pakicave në gjuhën e tyre amtare, si në median e shkruar, ashtu edhe në atë elektronike;

Ligji nr.8145, datë 11.9.1996 “Për të Drejtën e Tubimeve” garanton te drejtën për tubime publike për të gjithë shtetasit, pa asnjë dallim për shkak të seksit, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit, etnisë, gjendjes ekonomike e financiare, arsimore e sociale, të bindjeve politike, përkatësisë prindërore ose të çdo lloji rrethane tjetër vetjake.

Ligji nr.8580, datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike”, garanton të drejtën e tyre kushtetuese, me qëllim pjesëmarrjen e pakicave në jetën publike.

Ligji Nr. 9087, datë 19.06.2003, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Me qëllim që të mos preket uniteti i zonave të banuara si nga shqiptarët, ashtu edhe nga pjesëtarët e pakicave kombëtare, në Kodin Zgjedhor të RSH, parashikohet që zonat të jenë kompakte dhe të mos ndahen në pjesë që janë të shpëputura nga njëra tjetra si dhe përcaktohen kriteret e ndarjes së zonave zgjedhore;

Ligji nr. 8239, datë 3.9.1997 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7756, datë 11.10.1993 “Për Shtypin”. Me qëllim ruajtjen dhe forcimin e identitetit kulturor të pakicave kombëtare dhe në mënyrë që ato të jenë në kontakt të vazhdueshëm me zhvillimet politike, shoqërore, ekonomike e kulturore brenda dhe jashtë vendit, pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë pa asnjë pengesë të krijojnë median e tyre të shkruar në gjuhën amtare.

Ligji nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”. Eliminimi i çdo lloji forme paragjykimi apo diskriminimi ndaj pakicave dhe mbrojtja e pjesëtarëve të pakicave që jetojnë në Shqipëri apo denoncimi i akteve diskriminuese ndaj tyre (një sërë dispozitash që dënojnë “shkeljen e barazisë së shtetasve”, “nxitjen e urrejtjes dhe e grindjeve raciale, nacionale ose fetare, “krimin e genocidit” etj;

Ligji nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon përdorimin e gjuhës amtare për personat që nuk dinë shqip gjatë gjithë fazave të gjyqimit dhe marrjen dijeni për provat dhe për gjithë zhvillimin e gjyqimit me anë të përkthyesit;

VKM nr.396, datë 22.8.1994 “Për Arsimin 8-Vjeçar në Gjuhën Amtare të Personave të Pakicave”. Ky vendim ka si qëllim të konkretizojë në sferën arsimore politikën shtetërore për të krijuar kushtet e duhura për shprehjen, ruajtjen e zhvillimin e identitetit kulturor e gjuhësor të personave që iu përkasin pakicave si dhe nevojën e integritetit të tyre në shoqërinë shqiptare;

VKM nr. 502, datë 5.8.1996 “Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 22.08.1994 “Për Arsimin 8-Vjeçar në Gjuhën Amtare të Personave të Pakicave”, synon në funksionimin e njësisë të shkollimit në gjuhën amtare pranë shkollave të tërëvjeçare mbi bazën e kërkesave duke respektuar, kriteret përkatëse.

2.2 Kuadri institucional

Në hartimin dhe zbatimin e politikave për minoritetet, Shqipëria mbështetet në detyrimet që dalin nga Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare të Këshillit të Evropës. Strukturat që janë të angazhuara me mbrojtjen e minoriteteve janë:

1) Komiteti Shtetëror i Minoriteteve, i krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.127, datë 11.03.2004. Komiteti bashkëpunon me organet e qeverisjes qëndrore dhe vendore, me organizata e shoqatat që kryejnë veprimtari për ushtrimin e të drejtave dhe lirive të minoriteteve, për përmirësimin e standarteve në respektimin e të drejtave të minoriteteve në Shqipëri.

Komiteti propozon masa konkrete për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe arsimor të pakicave. Komiteti ka në përbërjen e tij përfaqësues të minoriteteve kombëtare dhe etno-gjuhësore në Shqipëri.

2) Sektori i Monitorimit të Zbatimit të Strategjisë për Minoritetin Rom pranë Shërbimit Social Shtetëror në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, i cili ka për detyrë;

monitorimin e zbatimit të objektivave dhe masave prioritare të përcaktuara në këtë strategji, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, Ministrinë e Financave dhe donatorë të ndryshëm për sigurimin e fondeve të nevojshme për realizimin e objektivave të kësaj strategjie;

vendosjen e bashkëpunimit me shoqatat e minoritetit rom dhe OJF-të e ndryshme që veprojnë në fushën e minoriteteve për zbatimin e strategjisë.

3) Drejtoria e Arsimit Fillor në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, e cila mbulon edhe problemet e arsimimit të pakicave.

4) INSTAT, cili është një Institucion Qendror i specializuar, për hartimin e kriterëve metodologjike sipas rekomandimeve ndërkombëtare, në muajin shkurt 2004, në Buletin e tij 3 – muajor (dhjetor 2003), ka publikuar rezultatet e vlerësimeve në nivel kombëtar mbi pakicat në Shqipëri.

Këto vlerësime janë bazuar në të dhënat e anketës LSMS¹⁰ (Living Standard Measurement Survey), e cila u realizua gjatë vitit 2002 nga INSTAT, si pjesë e programit të Qeverisë për Strategjinë Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social, e asistuar nga Banka Botërore, si dhe të regjistrimeve të popullsisë dhe banesave të viteve të viteve 1945, 1950, 1960, 1969, 1979, 1989 dhe 2001.

INSTAT në procesin e përpunimit të të dhënave mbi pakicat është konsultuar edhe me burime të tjera informacioni si vëzhgime, studime të ndryshme, të dhëna administrative dhe vlerësime retrospektive mbi pakicat në Shqipëri. Në bazë të këtyre vlerësimeve, përqindja e pakicave kombëtare në popullsinë prezente gjithsej të Shqipërisë prej 3.069.275 për vitin 2001 vlerësohet në 1.4%.

2.3 Asistenca e teknike

Asistenca teknike e huaj në këtë fushë fokusohet në disa projekte të vogla që do të financohen nga OSBE-ja, Këshilli i Europës dhe disa nga Agjencitë e OKB, në lidhje me zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Minoritetin Rom.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2009 janë si më poshtë:

Të përmirësohet kuadri ligjor për minoritetet në mënyrë që të përmbushë kërkesat e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, dhe të sigurohet zbatimi i saj në të gjithë Shqipërinë;

Të zbatohet Strategjia kombëtare për romët, si pjesë e strategjisë së qeverisë për të luftuar varfërinë dhe përjashtimin shoqëror. Të sigurohen të dhëna të sakta për përqindjet e minoriteteve në Shqipëri.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore.

Parashikimi si figurë krimi të veçantë në Kodin Penal i Krimeve për motive racore apo për motive të tjera diskriminuese, si dhe konsiderimi si rrethanë rënduese në Kodin Penal i motivit diskriminues si motiv për kryerjen e krimit, iniciativë e cila do të jetë plotësisht në përputhje me Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare;

Amendimi i ligjit nr.8410, datë 30.09.1998 “Për radiotelevizionin publik dhe privat në

¹⁰ Megjithatë fokusi i anketës (LSMS) ishte grumbullimi i informacionit mbi nivelin e jetesës dhe varfërisë të familjeve dhe individëve, në grupin e pyetjeve identifikuese u përfshi dhe ajo mbi kombësinë.

Republikën e Shqipërisë” ligjit nr.7756, datë 11.10.1993 dhe ligjit nr.8239, datë 03.09.1997 “Për shtypin”, duke parashikuar dispozita pozitive për të lehtësuar aksesin në media për minoritetet, iniciative e cila do të jetë plotësisht në përputhje me Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare;

Amendimi i Kodit Zgjedhor, duke parashikuar përdorimin e gjuhës së minoriteteve gjatë fushatave elektorale në zonat ku ato banojnë;

Miratimi i një rregulloreje lidhur me të drejtën e përdorimit të gjuhës amtare të minoriteteve në emërtimet tradicionale lokale dhe treguesve të tjerë topografikë në zonat ku ata banojnë;

Miratimi i Projektvendimit "Per krijimin e fondit të posaçëm për mbështetjen financiare të projekteve të zhvillimit të identitetit kombëtar dhe kulturor të pakicave kombëtare", iniciativë e cila do të jetë plotësisht në përputhje me Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare;

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Realizimi i tryezave të përbashkëta në 12 qarqet e vendit në lidhje me zbatimin e Strategjisë;

Funksionimi i Grupit ndërmintor për organizimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të Strategjisë Kombëtare për Romët;

Botimi dhe shpërndarja e Strategjisë në të gjitha qarqet e vendit;

Forcimi i kapaciteteve të Sektorit të Monitorimit të zbatimit të Strategjisë për Romët;

Realizimi i projektit për nxjerrjen e indikatorve të monitorimit të strategjisë si dhe realizimi i trajnimeve të ndryshme të sektorit dhe grupit ndërmintor përgjegjës për implementimin e Strategjisë me një program soft ëear për hedhjen e të dhënave për të monitoruar progresin e realizimit të strategjisë;

Përmirësimi i kushteve të jetesës sipas prioritetëve të Komunitetit Rom;

Komiteti Shtetëror i Minoriteteve

Organizimi i Konferencës Kombëtare për pjesëmarrjen e minoriteteve në jetën publike;

Organizimi i një tavoline të rumbullakët mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Romët;

Organizimi i Takimit Folklorik dhe Ditëve të Kulturës së Minoriteteve;

Takim Ndërkombëtar me institucionet homologe të rajonit për minoritetet në lidhje me " Praktikat e zbatimit të normave ndërkombëtare në fushën e minoriteteve".

3.2.1 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese.

Komiteti Shtetëror i Minoriteteve

Organizimi i Konferencës Kombëtare për arsimimin në gjuhën e minoriteteve;

Organizimi i Takimit Folklorik dhe Ditëve të Kulturës së Minoriteteve;

Takim Ndërkombëtar me institucionet homologe të vendeve të rajonit për minoritetet në lidhje me " Legjislacioni për minoritetet në Rajonin e Ballkanit";

Organizimi i Konferencës Kombëtare për ruajtjen dhe kultivimin e kulturës së minoriteteve;

Takim Ndërkombëtar me institucionet homologe të rajonit për minoritetet "Politikat rajonale pozitive për Minoritetet";

Organizimi i Konferencës Kombëtare për nxitjen e pjesëmarrjes në median elektronike dhe të shkruar të minoriteteve;

Takim Ndërkombëtar me institucionet homologe të rajonit për minoritetet " Minoritetet dhe integrimi euro-atlantik".

Tabela: Shtimi i kapaciteteve institucionale të Strukturave përgjegjëse për fushën e Respektimit të të Drejtave të Minoriteteve.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

INVESTIME	NJËSIA MATJES	GJENDJA AKTUALE	2006
Shtesë personeli	Nëpunës	3	2
Investime	000/le		300
infrastruktura/pajisje	kë		

Investime IT			000/le		1000	
			kë			
<i>Komiteti Shtetëror i Minoriteteve</i>						
INVESTIME	NJËSIA E	2006	2007	2008	2009	2010
	MATJES					
Trajnime	000/lekë	900	20000	20800	5800	5800

1.3 TREGU I PASURIVE TE PALUAJTSHME

1.3.1 REFORMA E TOKËS BUJQËSORE, TREGU, ADMINISTRIMI I QËNDRUESHEM DHE MBROJTJA E TOKES

1. Objektivi politik

Zhvillimi i Strategjisë për tokën bujqësore, përdorimin, tregun, administrimin dhe mbrojtjen e saj, përbëjnë objektivin afatshkurtër dhe afatmesëm të qeverisë në funksion të konsolidimit të pronësisë mbi tokën bujqësore. Reforma e tokës bujqësore, administrimi i qëndrueshëm i tokës dhe mbrojtja e tokës përbëjnë tre shtyllat kryesore për realizimin e këtij objektiivi.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Reforma e tokës dhe konsolidimi i pronësisë mbi tokën bujqësore, rregullohet nga aktet e mëposhtme ligjore dhe nënligjore:

Ligji nr. 7501 datë 19.07.1991, “Për tokën” dhe në zbatim të tij nga VKM nr. 230, datë 22.07.1991 dhe VKM nr 255, datë 2.08.1991;

Ligji nr. 8312 datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara” dhe në zbatim të tij VKM nr. 531, datë 21.08.1998, i ndryshuar;

Ligji nr. 8053 datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore” dhe në zbatim të tij Udhëzimi i Ministrisë të Bujqësisë nr. 106, datë 23.02.1996.

Tregu i tokës rregullohet nga këto akte ligjore dhe nënligjore:

Ligji nr. 7843 datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe në zbatim të tij VKM nr. 432, datë 18.04.1995;

Ligji nr. 8318 datë 1.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, dhe në zbatim të tij VKM nr. 830, datë 28.12.1998 dhe VKM nr. 831, datë 28.12.1998;

Ligji nr. 8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”.

Administrimi i qëndrueshëm i tokës, rregullohet nga:

Ligji Nr. 8752, datë 26.03.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit të tokës” dhe në zbatim të tij VKM nr. 532, datë 31.10.2002.

Mbrojtja e tokës rregullohet nga:

Ligji nr. 9244, datë 17.06.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” dhe në zbatim të tij VKM nr. 80, datë 28.01.2005 dhe VKM nr. 59, datë 28.01.2005, i cili ka në objekt harmonizimin e së drejtës së pronësisë mbi tokën me detyrimin për mbrojtjen e saj dhe të funksioneve natyrore që ajo përmbush.

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e reformës së tokës, tregut, administrimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së tokës është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

1)Sektori i Menaxhimit të Tokave në Drejtorinë e Menaxhimit të Tokave dhe Ujërave (DMTU) në Ministrinë e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBMUK);

2)Strukturat e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (SAMT) që janë në varësi të administrative të qarqeve dhe në varësi teknike të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

3) Zyrat e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ZMMT) në komuna (bashki);

4) Komisionet e tre niveleve që realizojnë reformën e tokës.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Evropian, prioritet afatshkurtër dhe afatmesëm për nënfushën e reformës së tokës bujqësore, tregut, administrimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së tokës është:

Zhvillimi i Strategjisë për tokën, përdorimin, tregun, administrimin dhe mbrojtjen e saj.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për realizimin e prioritetit për këtë fushë në periudhën afatshkurtër, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit:

Ndryshimi i Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", i cili synon përfundimin e ndarjes së tokës (reformën) në gjysmën e parë të vitit 2008;

Ndryshime në Ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", që synojnë të konsolidojnë titujt e pronësisë në disa zona të veçanta të vendit;

Ndryshime në Ligjin Nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara";

Miratimi i Udhëzimit të Ministrit "Për ndryshimin e kategorisë së tokës bujqësore dhe burimeve".

3.1.2. Aktivitet zbatues afatshkurtra

Për realizimin e prioritetit për këtë fushë, në periudhën afatshkurtër, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e Inspektoriatit Shtetëror të Mbrojtjes së Tokës gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006, si një strukturë qendrore pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Ngritja e Inspektorateve të Mbrojtjes së Tokës pranë qarqeve gjatë vitit 2007, ku do të punësohen 40 punonjës;

3.1.3 Iniciativat ligjore afatmesme

Për realizimin e prioritetit për këtë fushë, në periudhën afatmesme, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit:

Ndryshim në Ligjin nr. 8752, datë 26.03.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit të tokës";

Ndryshim në VKM-në nr. 532, datë 31.10.2002 "Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve të SAMT dhe ZMMT";

Hartimi dhe miratimi i VKM-së "Për mënyrat e krijimit dhe përdorimit të dokumentacionit LIS".

3.1.4 Aktivitet zbatues afatmesme

Për realizimin e prioritetit për këtë fushë, në periudhën afatmesme, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Krijimi i bazës së të dhënave të informacionit të Sistemit të Informacionit mbi tokën (LIS) gjatë vitit 2008, e cila do të mundësojë administrimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore. Përditësimi i LIS-it do të vazhdojë të kryhet në vazhdimësi;

Krijimi i bazës së të dhënave të informacionit të Inspektoriatit Shtetëror të Mbrojtjes së Tokës si dhe Inspektorateve të Mbrojtjes së Tokës në qarqe me synim marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e tokës;

Trajnimi i strukturave të Inspektorateve të Mbrojtjes së Tokës;

Trajnimi stafit për përdorimin e LIS-it.

Tabela: Shtesë e kapaciteve institucionale të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrotjes së Konsumatori

INVESTIME	NJËSIA E MATJES	GJENDJA AKTUALE	2006	2007	2008	2009	2010
Shtesë personeli për ngritjen e njësive të reja	nëpunës	0	+4				
Shtesë personeli për krijimin e Inspektoriatit Shtetëror të Mbrotjes së Tokës	nëpunës	0		+40			
	000/lekë						
Trajnimi i stafit					2000	2000	2000
Trajnimi i stafit të IMT-ve në qarqe	000/lekë					2000	2000

1.3.2 REGJISTRIMI FILLESTAR

1. Objektivi politik

Qeveria shqiptare është e angazhuar të përshpjetojë ritmet e procesit të regjistrimit fillestar të pasurisë së paluajtshme, në zonat rurale dhe urbane, në një kohë sa më të shpejtë.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Regjistrimi fillestar i pasurisë së paluajtshme rregullohet nga aktet e mëposhtme bazë ligjore:

Ligji Nr. 7843, datë 13.07.1994, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme";

VKM Nr.432, datë 14.8.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit";

VKM Nr.492, datë 5.08.1996 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.352, datë 3.05.1995, "Për miratimin e certifikatave të pronësisë së pasurive të paluajtshme";

VKM Nr.556, datë 23.10.2000 "Për dorëzimin e dokumentacionit të pronësisë në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme";

VKM Nr. 411, datë 29.8.2002 "Për kalimin e disa mjediseve në administrimin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, Korçë, Durrës;

VKM Nr.292, datë 24.04.2003 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 549 datë 26.8.1996 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e tarifave të shërbimit të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme" i ndryshuar;

VKM 3 datës 21.03.2006 "Për mbylljen e Njesisë së Menaxhimit të Projektit për Sistemin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe transferimin e funksioneve të saj Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme".

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

1) Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, është institucioni kryesor përgjegjes për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Zyra është nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë. ZQRPP bashkepunon ngushte me organet e pushtetit lokal (bashki dhe komuna) dhe me institucionet e tjera qendrore në vecanti me ministritë, prefekturat dhe Komitetin Shtetëror të Kthimit të Kompensimit të Pronave. Gjithashtu kjo zyre bashkepunon ngushte dhe me sektorin privat (ndertuesit, dhoma e Avokatise, e Noterise, bankat etj). Mekanizmi i bashkëpunimit konsiston në

lidhjen e marrëveshjeve ndërmjet ZQRPP dhe këtyre institucioneve;

2) Zyrrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në qarqe.

2.3. Asistenca teknike

Lidhur me konsolidimin e pronesise (perfundimin e reformes dhe te regjistrimit fillestar te pasurive te paluajtshme) dhe krijimin e sistemit te informacionit eshte zbatuar projekti i regjistrimit te pasurive te paluajtshme, i cili deri ne vitin 2004 eshte financuar nga programet PHARE, USAID dhe buxheti i Shtetit.

ZQRPP do te vazhdoje regjistrimin fillestar te zonave urbane dhe turistike si dhe automatizimin e proceseve te punes ne sistemin e regjistrimit, perditësimin e te dhenave hartografike duke financuar nga CARDS 2005 me fond prej 3.2 mln EURO. Fondi i programit CARDS 2005 perfshin dhe trajnimin e nepunesve te sistemit te regjistrimit si dhe fushatat publicitare qe synojne zbatimin efektiv te regjistrimit fillestar.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Evropian, prioritetet për nënfushën e regjistrimit fillestar është:

Regjistrimi fillestar i pasurisë së paluajtshme.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këtë prioritet afatshkurtër, për realizimin e tij do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga ZQRPP:

Ndryshimi i ligjit Nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”;

Ndryshime në VKM Nr. 292, datë 24.04.2003 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 549 datë 26.8.1996 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e tarifave të shërbimit të Zyrrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme" i ndryshuar;

Miratimi i Urdhërit të Kryeministrit "Për ndryshimin e pagave të ZRPP".

3.1.2. Aktivitet zbatues afatshkurtra

Për realizimin e këtij prioriteti afatshkurtër, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Perfundimi i regjistrimit fillestar ne 13 zona kadastrale;

Permireshimi i kapaciteteve administrative per regjistrimin fillestar nepermjet trajnimeve ;

Zbatimi i strategjise se IT nepermjet dixhitalizimit te Hartave Treguese të Regjistrimit si dhe krijimi i standarteve;

Pergatitja Planit te Biznesit;

Zhvillimi i trajnimit ;

Rinovim, zgjerim dhe zyra te reja;

Dixhitalizimi i HTR. Krijimi i standarteve, prodhimi i HTR te reja

3.1.3 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për realizimin e prioritetit të kësaj nënfushë, në periudhën afatmesme 2008-2010, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Përfundimi i regjistrimit fillestar ne 80 zona kadastrale me fondet e Bankës Botërore;

Zhvillimi i trajnimit ;

Rinovim, zgjerim dhe zyra te reja

1.3.3 Kthimi dhe Kompensimi i Pronave

1. Objektivi politik

Një nga objektivat kryesore të qeverisë është përsheptimi i procesit të kthimit dhe kompensimit të pronës. Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, për periudhën afatshkurtër 2006-2007, përveç kthimit të pronave dhe përgjigjes së mjaft ankesave të subjekteve të shpronësuar, do të vazhdojë realizimin e Hartës së Vlerës së Pronës (HVP) në Rrethin e Kavajës, HVP-në e Qarkut të Tiranës dhe HVP-në e Republikës. Rëndësia e realizimit të HVP-së, qëndron në faktin se kjo hartë në vetvete përfaqëson hapin vendimtar dhe përfundimtar për mundësinë e zgjidhjes së problematikës rreth pronësisë. Kjo hartë do të lehtësojë mjaft qeverinë shqiptare për të krijuar idenë e fondeve që do të nevojitet për kompensimin e subjekteve të shpronësuar, do të shërbejë si pikë referimi për vlerën e tokës në raste kontratash, si dhe do të krijojë një ide për tregun e tokës në Shqipëri.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Proçesi i kthimit dhe kompesimit të pronës rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore dhe nënligjore:

Ligji nr. 9235, datë 27.09.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave" përbën bazën ligjore në këtë proçes.

Vendimi i Kuvendit nr.183, datë 28.04.2005 "Metodika e Vlerësimit të pronës së paluajtshme". Ky dokument është një domosdoshmëri për llogaritjen e vlerës së pasurisë së paluajtshme që në bazë të ligjit nuk kthehet, por kompensohet.

Vendim i Kuvendit nr.330, datë 13.05.2005 "Për sigurimin e të dhënave për Pronat Publike e Private".

Udhëzim nr.1, datë 15.03.2005 "Mbi dokumentacionin e nevojshëm" mbi bazën e të cilit kryhet njohja e pronësisë.

2.2 Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e kthimit dhe kompesimit të pronës është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompesimit të Pronave (KSHKKP), i cili ka për detyrë drejtimin e proçesit të kthimit dhe kompesimit të pronave në Shqipëri dhe është nën varësinë e Kuvendit. Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompesimit të Pronës është përgjegjës për: (i) rregullimin e drejtë, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 41 të Kushtetutës, të çështjeve të së drejtës së pronësisë që kanë lindur nga shpronësimet, shtetëzimet ose konfiskimet; (ii) kthimin dhe, aty ku kthimi i pronës sipas këtij ligji është i pamundur, kompensimin e saj; si dhe (iii) proçedurat për realizimin e kthimit dhe kompesimit të pronave, si dhe organet administrative të ngarkuara për realizimin e tyre.

12 Komisionet Vendore, të cilat janë nën varësinë e KSHKKP.

2.3 Asistenca e teknike

Për proçesin e kthimit dhe kompesimit të pronës, Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompesimit të Pronës është asistuar nga ekspertë të Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin Europian (OSBE) në hartimin e "Metodikës për vlerësimin e pronës".

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Evropian 2005, prioritet afatshkurtër (2006-2007) për kthimin dhe kompesimin e pronës është:

Zbatimi i legjislacionit ekzistues për kthimin dhe kompensimin e pronave.

3.1.1. Aktivitet zbatues afatshkurtra

Për të përshpejtuar proçesin e kthimit dhe kompesimit të pronave, në periudhën afatshkurtër do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompesimit të Pronave:

Përfundimi i hartës së vlerës së tokës;

Vazhdimi i proçesit të kompesimit të pronave në zonat rurale dhe urbane;

Forcimi i mirëfunksionimit të komisioneve lokale të kthimit/kompensimit të pronave të ngritura tashmë nëpër rrethe.

1.3.4 LEGALIZIMI I PASURISË SË PALUAJTSHME

1. Objektivi politik

Objektivi i Qeverisë për legalizimit është zbatimi i politikave shtetërore, për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Veprimtaria e kontrollit të legalizimit të pasurive të paluajtshme rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore:

Ligji Nr. 9482, datë 03.04.2006, i cili shfuqizon ligjin nr.9304, datë 28.10.2004 dhe ligjin Nr. 9209, datë 23.3.2004. Për vetë karakterin individual që ka legjislacioni i pronës në çdo shtet anëtar të Bashkimit Evropian, ky ligj "nuk ka" përputhshmëri me *acquis*;

VKM Nr.289, datë 17.05.2006, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale në Republikën e Shqipërisë (ALUIZNI)".

2.2. Kuadri Institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e legalizimit të pasurisë së paluajtshme është nën përgjegjësinë e institucionit të mëposhtëm:

Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale në Republikën e Shqipërisë (ALUIZNI) është institucion qendror në varësi të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. ALUIZNI është krijuar me VKM Nr.289, datë 17.05.2006 dhe është përgjegjës për:

zbatimin teknik të procesit të legalizimit, përfshi procesin e kompensimit të pronave private; regjistrimin fillestar të ndërtimeve pa leje; evidentimin dhe përgatitjen e dokumentacionit për regjistrimin e truallit dhe të ndërtimit pa leje.

Pritet miratimi i akteve të tjera nënligjore, të cilat do të përcaktojnë strukturën dhe organikën e ALUIZNI-it.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Europian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Europian, prioritet afatshkurtër dhe afatmesëm për fushën e legalizimeve është:

Respektimi i masave në lidhje me klasifikimin e tokës

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këtë prioritet, në periudhën afatshkurtër 2006-2007, për realizimin e tij, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit:

Hartimi dhe miratimi i VKM -së "Për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin e zbatueshëm për të kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo";

Hartimi dhe miratimi i VKM -së "Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të të dhënave për ndërtimet pa leje dhe ngritjen e bazës së të dhënave";

Hartimi dhe miratimi i VKM -së "Për kriteret procedurat dhe miratimin e lejes së legalizimit";

Hartimi dhe miratimi i VKM -së "Për mënyrat dhe procedurat e shpërblimit të pronarëve të truallit";

Hartimi dhe miratimi i VKM -së "Për pezullimin e procedurave të legalizimit dhe miratimin e strategjisë për eliminimin e ndotjes në zonat apo vendbanimet informale";

Hartimi dhe miratimi i VKM -së "Për legalizimin e ndërtimeve pa leje në territore brenda zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit";

Hartimi dhe miratimi i Udhëzimit të Ministrit të MPPT&T "Për mënyrën e plotësimit të të dhënave për ndërtimet pa leje dhe ruajtjen e tyre";

Hartimi dhe miratimi i Udhëzimit të Ministrit të MPPT&T "Për miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të argumentimit dhe pasqyrimin të gjëndjes faktike të zonave / vendbanimeve/bllok banimeve dhe ndërtimit informal të veçuar";

Hartimi dhe miratimi i VKM -së "Për përcaktimin e zyra në njësitë e qeverisjes vendore";

Hartimi i Urdhërit të Kryeministrit "Për përcaktimin e organikës dhe strukturës së ALUIZNI-it";

Hartimi dhe miratimi i Rregullores " Për funksionimin e brendshëm të ALUIZNI-it";

Hartimi dhe miratimi i VKM -së "Për mënyrat, dhe procedurat alternative të shlyerjes së detyrimit në rastet e paafetësisë së pagesës nga deklaruesi";

Hartimi dhe miratimi i VKM -së "Për përcaktimin e koeficientit të raportit të shfrytëzimit të objekteve";

Hartimi dhe miratimi i VKM -së "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për bashkëveprimin e punës për identifikimin e subjekteve Komitetit Kombëtar të Kthimit të Pronave dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, njërive të qeverisjes vendore";

Hartimi dhe miratimi i VKM -së "Për prioritetet dhe administrimin e territorit të miratuar, zonë apo vendbanim informal".

3.1.2. Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e prioritetit, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese afatshkurtra:

Riorganizimi i Agjensisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave e Ndërtimeve

Informale (ALUIZNI);

Ngritja e njësisë së legalizimit pranë njësive të qeverisjes vendore;

Realizmi fotografimit ajror për të gjithë territorin;

Përgatitja dhe instalimi i programit "data base" për përpunimin e të dhënave të ndërtimeve pa leje;

Përgatitja e hartografisë sipas fotografimit ajror;

Hartimi i studimeve urbanistike.

1.4 BASHKEPUNIMI RAJONAL DHE NDERKOMBETAR

1.4.1 MARREVESHJET E TREGTISE SE LIRE

1. Objektivi politik

Politikat tregtare që Shqipëria po zbaton në mënyrë bilaterale tashmë janë ngritur në një nivel rajonal duke vënë si objektiv përpara vendeve negocimin dhe nënshkrimin brenda Dhjetorit 2006 të marrëveshjes Unike të tregtisë së Lirë të quajtur CEFTA e Amenduar dhe Zgjeruar. Ky objektiv është përshkruar në vendimin politik që kanë marrë Kryeministrat e 7 vendeve të Rajonit, Shqipërisë, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, Moldavisë, Rumanisë dhe Uninoinit Serbi dhe Mali i Zi, si dhe UNMIK dhe Kosovë, në Deklaratën e përbashkët të nënshkruar me 6 prill 2006 në Bukuresht, për fillimin e negociatave dhe konkludimin brenda vitit të kësaj marrëveshjeje Unike, e cila do të krijojë një zonë rajonale të tregtisë së lirë.

Kjo marrëveshje Rajonale do të përmbajë politkat tregtare për produktet industriale, produktet bujqësore, rregullat e origjinës, barrierat tarifore dhe jotarifore. Gjithashtu kjo Marrëveshje do të bazohet në tekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore (CEFTA), por do të karakterizohet nga dispozita moderne, bashkëkohore dhe të kompletuara, do të përcaktojë një shkallë më të lartë liberalizimi të tregtisë, si dhe do të jetë e hapur dhe gjithëpërfshirëse për të gjitha palët në Rajon.

Një objektiv tjetër i qeverisë është negociimi dhe nënshkrimi brenda 5 vjetëve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me BE, i Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Turqinë, i cili është një vend që aktualisht aplikon bashkim doganor me Bashkimin Europian. Këto negociata do të fokusohen në liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë bilaterale ndërmjet të dy vendeve, duke eliminuar barrierat tarifore dhe jo tarifore ndërmjet tyre në përuthje me parimet dhe kriteret e Nenit XXIV të GATT/OBT-së "Aplikimi Territorial – Trafiku Kufitar – Bashkimet Doganore dhe Zonat e Tregtisë së Lirë" si dhe dhënien e avantazheve reciproke në drejtim të trajtimit preferencial dhe trajtimit kombëtar në tregtinë e shërbimeve në përuthje me parimet dhe kriteret e Nenit V të GATS/OBT-së "Integrimi Ekonomik".

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit për Lehtësimin dhe Liberalizimin e Tregtisë, nënshkruar në Bruksel më 27 Qershor 2001, Shqipëria ka nënshkruar dhe ka ratifikuar 8 Marrëveshje të Tregtisë së Lirë rajonale, me Maqedoninë, Kroacinë, Unionin Serbi-Mali i Zi, Bullgarinë, Bosnje-Hercegovinën, Rumaninë, Moldavinë dhe Kosovën. Këto marrëveshje janë ratifikuar me ligjet e mëposhtme:

Ligj Nr.8892, datë 14.05.2002, "Për ratifikimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase", hyrë në fuqi 14.06.2002.

Ligj Nr.8973, datë 21.11.2002, "Për ratifikimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kroacisë", hyrë në fuqi 04.01.2003.

Ligj Nr. 9050, datë 17.04.2003, "Për ratifikimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë", hyrë në fuqi 09.04.2003.

Ligj Nr.9077, datë 09.06.2003, "Për ratifikimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë", hyrë në fuqi 15.07.2003.

Ligj Nr.9101, datë 10.07.2003, "Për ratifikimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bosnjë - Hercegovinës", hyrë në fuqi 14.08.2003.

Ligj Nr.9122, datë 29.07.2003, "Për ratifikimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administrës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), në emer të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës", hyrë në fuqi

29.08.2003.

Ligji Nr.9195, datë 26.02.2004, "Për ratifikimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Unionit Serbi-Mal i Zi", hyrë në fuqi 07.04.2004.

Ligji Nr.9196, datë 26.02.2004, "Për ratifikimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Moldavisë", hyrë në fuqi 07.04.2004.

2.2 Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për zbatimin e Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë me vendet e Rajonit, është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Drejtoria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtar/Spektori i Organizatës Botërore të Tregtisë dhe Integrimit Europian, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë, i cili ka rolin e kryesimit dhe koordinimit të grupit negociator në negociatat për Marrëveshjen e Vetme Rajonale të Tregtisë së lirë dhe Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë me Turqinë, që përbëhet nga përfaqësues të ministrive të linjës dhe institucionet e tjera qendrore në bashkërendim me strategjitë e zhvillimit të sektoreve të tjerë, bujqësi dhe industri.

Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve, në bashkëpunim me të cilat do të përgatitet projektvendimi për miratimin në parim nga Këshilli i Ministrave të projektligjeve për ratifikimin e Marrëveshjes Unike të Tregtisë së Lirë dhe Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Turqinë, për t'i hapur rrugën ratifikimit në Kuvendin e Shqipërisë.

Gjithë ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Europian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Europian, dhe nga angazhimet që derivojnë nga zbatimi i MSA-së, prioritetet afatshkurtra për fushën e bashkëpunimit rajonal janë:

Neni 12 i MSA-së, paragrafi 3: "Shqipëria do të rishikojë Marrëveshjet dypalëshe ekzistuese me të gjitha vendet përkatëse, ose do të konkludojë marrëveshje të reja, në mënyrë që të sigurojë që ato përputhen me parimet e Memorandumit të Mirëkuptimit mbi Lehtësimin dhe Liberalizimin e Tregtisë nënshkruar në Bruksel në 27 qershor 2001."

Neni 15 i MSA-së: "Bashkëpunimi me vendet candidate për aderim në BE" pika 2. Shqipëria do të nisë negociatat me Turqinë me synimin për të konkluduar, në bazë të avantazheve të përbashkëta, një marrëveshje që vendos një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet të dy palëve në përputhje me Nenin XXIV të GATT, si dhe për të liberalizuar të drejtën e vendosjes dhe ofrimit të shërbimeve ndërmjet tyre në një nivel të barazvlefshëm me këtë marrëveshje në përputhje me Nenin V të GATS. Këto negociata duhet të fillojnë sa më shpejt të jetë e mundur, me synimin për të konkluduar marrëveshjen e sipërpërmendur para fundit të periudhave tranzitore referuar në Nenin 16(1).

Të zbatohen të gjitha marrëveshjet rajonale të tregtisë së lirë.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritete afatshkurtra, për realizimin e tyre, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës:

Projektligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së vetme Rajonale CEFTA e Amenduar/Zgjeruar. Ky ligj do të përbëjë bazën ligjore për zhvillimin dhe intensifikimin e tregtisë ndërmjet vendeve të rajonit, duke u bazuar në një marrëveshje të vetme, rregulla unike të tregtisë së lirë si për produktet industriale ashtu dhe për ato bujqësore, duke sjellë implementimin e parimeve të reja të rregullave të origjinës.

Projektligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Turqisë". Ky ligj do të përcaktojë rregullat e rregjimit preferencial tregtar ndërmjet Shqipërisë dhe Turqisë në përputhje me nenin XXIV të GATT/OBT-së, për krijimin e një zone të tregtisë së lirë ndërmjet dy vendeve brenda një periudhe tranzitore, që do të përcaktohet gjatë negociatave. Teksti i marrëveshjes do të përmbajë edhe anekset për produktet sensitive industriale të të dyja palëve, anekset e koncensionëve për produktet bujqësore, protokollin e rregullave të origjinës, etj

3.1.2. Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e prioritetëve afatshkurtra, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Analiza e të dhënave të import/eksportit të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, (ii) organizimi i Komiteteve të Përbashkëta me palët nënshkruese të MTL-ve

Zhvillimi i negociatave për konkludimin e MTL-së Shqipëri - Turqi. Objekt inegociatave do të jenë: teksti i MTL-së, listat e produkteve sensitive industriale dhe periudha tranzitore e liberalizimit të tyre, koncensionet e produkteve bujqësore si dhe rregullat e origjinës.

Parafimi i MTL-së Rajonale;

Analiza e të dhënave të import/eksportit të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, (ii) organizimi i Komiteteve të Përbashkëta me palët nënshkruese të MTL-ve .

3.2. Prioritetet afatmesme

Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim Asociimit, prioritetet afatmesme janë:

Negocimi dhe nënshkrimi brenda 5 vjetëve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me BE -në i Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Turqinë

3.2.1. Aktivitet zbatues afatmesme

Meqenëse nënshkrimi i MTL-së me Turqinë do të realizohet në vitin 2007-2008, në përputhje me këtë prioritet afatmesëm, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës:

Monitorimi i implementimit të MTL-së Rajonale nëpërmjet: (i) analizës së të dhënave të import/eksportit të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, (ii) organizimit të Komiteteve të Përbashkëta me palët nënshkruese të MTL (iii) organizimi i seminareve për ndërgjegjësimin e biznesit (iv) konsultime me biznesin për sqarimin e problemeve që mund të dalin gjatë implementimit. (çdo vit)

Monitorimi i implementimit të MTL-së Shqipëri - Turqi nëpërmjet: (i) analizës së të dhënave të import/eksportit, të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, (ii) organizimit të Komitetit të Përbashkët Shqipëri - Turqi (iii) organizimi i seminareve për ndërgjegjësimin e biznesit (iv) konsultime me biznesin për sqarimin e problemeve që mund të dalin gjatë implementimit. (çdo vit)

1.4.2 Zbatimi angazhimeve të ndërmarra në OBT

1. Objektivi politik

Në kuadër të zbatimit të angazhimeve të ndërmarra me antëtarësimin në OBT, objekti kryesor i qeverisë është sigurimi i nje pozicioni korrekt të Shqipërisë në marrëdhëniet me OBT-në, zbatimin rigoroz të parimeve, rregullave dhe angazhimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në këto organizate, duke evituar çdo shtyrje të përbushjes së tyre. Në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë synimi i qeverisë do të jetë mbajtja e pozicionit korrekt të Shqipërisë me qëllim përputhjen me angazhimet e ndërmarra në kuadër të OBT-së, pozicion ky i rregulluar me hartimin e skedulit të rishikuar të miratuar me konsensus nga vendet Anëtare të OBT-së, pa bërë asnjë derogim të mëtejshëm, ndërsa në periudhë afatgjatë do të garantohet respektimi i angazhimeve të ndërmarra nga Shqipëria në kuadër të marrëdhënieve me BE-në.

Në fushën e shërbimeve, Shqipëria do të sigurojë që angazhimet e marra në kuadër të GATS të jenë sa më shumë në përputhje me ato të BE-së. Për këtë qëllim, do të vazhdojë bashkëpunimi tashmë i nisur nga struktura e OBT-se në METE, dhe koordinimi i ngushtë me Komisionin Europian, dhe veçanërisht persë i takon negociatave në kuadër të Axhendës së Dohas për Zhvillim, për të siguruar qarkullimin e lirë të mallrave, njerëzve, shërbimeve dhe kapitalit.

2. Situata aktuale

Kuadri ligjor

Zbatimi i angazhimeve të OBT-së në kuadrin ligjor tregtar e ekonomik të Shqipërisë rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore:

Ligji Nr. 8648, datë 28.07.2000 “Per ratifikimin e Protokollit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Marrakeshit, që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë”.

Ligji Nr. 8649, datë 28.07.2000 “Mbi rezultatet e negociatave tregtare shumëpalëshe të

Raundit te Uruguajt”.

Urdhri i Kryeministrit Nr. 38, date 09.02.2000 “Per sigurimin e perputhshmerise se legjislacionit shqiptar me marreveshjet e Organizates Boterore te Tregtise, gjate dhe pas anetaresimit te Shqiperise ne kete Organizate”, ne baze te se cilit, ministrite dhe institucionet e tjera qendrore jane te detyruara te paraqesin per mendim ne SOBT te gjitha aktet normative qe prekin fushat e ekonomise dhe tregtise se mallrave.

Urdhri i Kryeministrit Nr. 129, date 18.09.1999 “Per krijimin e Grupit Nderministror te punes, per masat sanitare dhe fitosanitare, si dhe per krijimin e Grupit Nderministror te punes, per barrierat teknike ne tregti” i cili percakton krijimin e dy grupeve nderministrore te punes te cilet percaktojne kuadrin ligjor dhe rregullator me efekt ne tregti qe duhet te notifikohet prane Sekretariatit te OBT-se ne Gjeneve nepermjet Drejtorise se Pergjithshme te Standarteve. Shqiperia ka njoftuar Sekretariatin e OBT-së në Gjeneve për Urdhërin e mësipërm.

VKM Nr. 382, date 23.07.2002 “Per shkembimin e te dhenave ne fushen e standarteve dhe te rregullave teknike”. Ne baze te ketij vendimi, cdo akt normativ ligjor/nenligjor qe lidhet me barrierat teknike ne tregti dhe masat sanitare dhe fitosanitare qe propozohen nga grupet respektive nderministrore te punes, perpara shqyrtimit ne Keshillin e Ministrave, duhet te dergohet ne Drejtorine e Pergjithshme të Standarteve, e cila ben depozitim e tij ne Sekretariatin e OBT-se Gjeneve, per marrjen e mendimeve te vendeve anetare qe preken nga ky akt. Ne perputhje me Marreveshjen “Per Barrierat Teknike ne Tregti” (TBT) dhe Marreveshjen per marast Sanitare dhe Fitosanitare te OBT-se ne DPS eshte krijuar Qendra e Informacioni per Standartet. Qendra e Informimit dhe e Shitjes ne DPS eshte pika e informacionit per TBT dhe SPS ne Shqiperi.

2.2 Kuadri Institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në për angazhimet e marra në OBT, është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

1) Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes nepermjet Drejtorise e Bashkepunimit Ekonomik dhe Tregtar/Sektori i Organizatës Botërore të Tregtisë dhe Integrimit European, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, i cili ka rolin e monitorimit te te gjithë kuadrin ligjor me natyre tregtare, finaciare dhe ekonomike. **Monitorimi** i ketij kuadri ligjor konsiston nese iniciativa ligjore perkatese e ndermarre nga Institucionet e Linjes eshte ose jo ne perputhje me te gjitha angazhimet qe Shqiperia ka marre ne kete Organizate dhe perkatesisht ne fushen e tregtise ne mallra, ne ate te tregtise ne sherbime, si edhe ne ate te pronesise intelektuale. Ne kete kuader jo vetem monitorimi, por edhe **notifikimi** i ketyre akteve ligjore dhe nënligjore prane OBT-se per te tri fushat perben nje prerogative per kete Sektor. **Koordinimi** ka të bëjë me mbajtjen e korrespondences se rregullt me te gjithë aktoret kryesore te ekonomise (institucionet e linjes), si edhe kontaktet e vazhdueshme me Misionin tone ne Gjeneve per bashkerendimin e politikave sektoriale me ato tregtare ne perputhje me marreveshjet e OBT-se dhe angazhimet specifike te Shqiperise ne kete Organizate. Gjithashtu nje rendesi te vecante do te kete edhe **pjesemarrja ne negociatat shumepaleshe** qe organizohen nje here ne 2 vjet ne kuader te raundeve te reja, ku do te merret pjese aktivisht dhe do te mbrohen interesat e vendit, si edhe duke bere pjese ne koalicione te ndryshme, por kjo e fundit eshte ne varesi te negociatave.

2) Gjithë ministrinë e linjës.

2.3 Asistenca teknike

Në procesin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra në OBT, Ministria e Ekonomisë është mbështetur me asistencë teknike nga programi CARDS 2002, me projektin “Trade Regulation”, në vlerë rreth 2 milion Euro, ku nje komponent i kesaj asistence eshte “Kursi i Politikve Tregtare”, asistence jo vetm per Strukturen e OBT-se dhe Integrimit Ekonomik por edhe te gjitha drejtorive ne METE qe trajtojne aspkete te politikave tregtare si dhe disa ministrive te linjes apo drejtorive qendrore.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme

Bazuar në rekomandimet e Komisionit European të dhëna në Dokumentin “Shqipëria : Progres Raporti 2005” së Nëntor 2005 dhe Dokumentin e Partneritetit European, prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme për fushën e zbatimit të angazhimeve të OBT-së, janë:

Të rregullohet pozicioni i Shqipërisë me qëllim përputhjen me angazhimet e ndërmarra në kuadër të OBT-së;

*Duhet të sigurohet zbatimi i skedulit të rishikuar, pa bërë asnjë derogim të mëtejshme;
Të garantohet respektimi i angazhimeve të ndërmarra nga Shqipëria në kuadër të marrëdhënieve me BE-në.*

3.1.1. Aktivitete zbatuese

Në përputhje me këto prioritete, për realizimin e tyre, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës:

Monitorimi i angazhimeve që Shqipëria ka marre në kuadrin e Organizates Botërore të Tregtisë, gjithashtu edhe nepermjet koordinimit të punës me të gjitha institucionet e linjes;

Notifikimi i akteve ligjore dhe nenligjore në OBT;

Pjesëmarrje në negociatat shumëpaleshe në kuadër të raundeve të reja

1.4.3 Anti-DumpingU

1.4.3 Anti-DumpingU

1. Objektivi politik

Objektivi kryesor në fushën anti-dumping lidhet me sigurimin e bazës së nevojshme ligjore dhe administrative në Shqipëri, me synim aplikimin e masave anti -dumping në mbrojtje të industrive vendase. Për periudhën afatshkurtër synohet të bëhet miratimi i paketës ligjore mbi anti-dumpingun me dy projektligje të rëndësishme mbi masat mbrojtëse në importe dhe për masat anti-dumping dhe kundërbalancuese, të përshtatshme dhe njëkohësisht të harmonizuara me ato europiane në këtë fushë. Në periudhën afatmesme, objektivi kryesor është krijimi i Komisionit të Vlerësimit të Masave në Importe.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Veprimtaria e ushtrimit të masave antidumping rregullohet nëpërmjet:

Ligji Nr. 8466, datë 24.03.1999 “Për antidumping”, i cili ka si qëllim të mbrojtë prodhimin vendas në rastet kur dëmtohet dhe pengohet nga praktika të pandershme të tregtisë ndërkombëtare nëpërmjet dumping.

2.2 Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e anti-dumping është nën përgjegjësinë e këtij institucioni:

1)Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, konkretisht Sektori Antidumping, në Drejtorinë e Mbikqyrjes së Tregut pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, i cili ka një staf prej 4 punonjësish: 1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë. Misioni i këtij sektori është mbrojtja e industrisë vendase në rastet kur dëmtohet, kërcënohet për dëmtim dhe pengohet nga praktika të pandershme të tregtisë ndërkombëtare nëpërmjet importeve të dumpuara ose të subvencionuara dhe nga importimi i një produkti në sasi të mëdha dhe në kushte të tilla që shkakton efektet e lartpërmendura në industrinë vendase.

2.3 Asistenca e Huaj

Mbështetja financiare për antidumping për Ministrinë e Financave është dhënë nga GTZ-ja, nëpërmjet projektit për fushën e tregtisë së pandershme ndërkombetare “Hartimi i legjislacionit dhe forcimi i kapaciteteve institucionale”, me vlerë rreth 10,000 Euro. Ka përfunduar faza e parë e projektit, e cila konsistonte në përgatitjen e kuadrit ligjor dhe në vitin 2006 fillon faza e dytë, e cila konsiston në realizimin e aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve institucionale.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Në zbatim të angazhimeve të marra në kuadër të Marrëveshjes së Ndërmjetme, neni 24 - "Dumping dhe subvencionet" dhe neni 25- "Masat mbrojtëse në importe", prioritetet afatshkurtra për fushën e antidumping janë:

Shqipëria ndërmerr veprime në mbrojtje të tregtisë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 24 dhe nenit 25.

Zbatimi i nenit IV – “Marrëveshja për Anti dumping” i GATT 1994;

Zbatimi i nenit IV – “marrëveshja për Subvencionet dhe Masat Kundërbalancuese” i GATT 1994.

3.1. 1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritete afatshkurtra për periudhën 2006-2007, për realizimin e tyre, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe

Energjitikës:

Miratimi i paketës ligjore “Për parandalimin dhe Tregtinë e Pandershme Ndërkombëtare dhe Antidumpingun”, e cila përmban:

Projekt - ligjin “Për masat Antidumping dhe Kundërbalancuese” në përputhje me Rregulloren e BE-së Nr. 384/96, Rregullorja e BE-së Nr. 2026/97, dhe me Marrëveshjen e Përgjithshme për Tarifatat dhe Tregtinë 1994 (neni IV, neni XIV);

Projekt - ligjin “Për masat mbrojtëse në importe”, Rregulloren e BE-së Nr. 3285/94 dhe Marrëveshjen e Përgjithshme për Tarifatat dhe Tregtinë 1994 (neni XIX).

3.1.2. Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e prioriteteve afatshkurtra, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Përgatitja e booklet-eve me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e të gjitha kategorive të interesuara. Ky aktivitet synon të informojë, shkurtimisht, mbi praktikën e tregtisë së pandershme ndërkombëtare dhe të sensibilizojë kategoritë ndaj këtyre praktikave.

Organizimi i seminarit kombëtar mbi masat mbrojtëse, masat antidumping dhe kundërbalancuese me qëllim ndërgjegjësimin e komunitetit të biznesit. Ndërgjegjësimi i komunitetit të biznesit si kategoria e prekur direkt, për ekzistencën e strukturave shtetërore përgjegjëse për aplikimin e këtyre instrumentave rregullatore, si dhe kuadrin ligjor ekzistues dhe iniciativat ligjore për fushën.

Promovimi i ligjeve “Për Masat Mbrojtëse në Importe” dhe “Për Masat Antidumping dhe Kundërbalancuese”. Prezantimi i kuadrit të ri ligjor në të gjitha kategoritë e interesuara, impakti i zbatimit të këtij legjislacioni në ekonominë shqiptare.

3.2 Prioritetet afatmesme

Në zbatim të angazhimeve të marra në kuadër të Marrëveshjes së Ndërmjetme, prioritetet afatmesme (2008-2010) për fushën e antidumping janë:

Shqipëria ndërmerr veprime në mbrojtje të tregtisë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 24 dhe nenit 25.

Zbatimi i nenit IV – “Marrëveshja për Anti dumping” i GATT 1994;

Zbatimi i nenit IV – “marrëveshja për Subvencionet dhe Masat Kundërbalancuese” i GATT 1994.

3.2.1. Iniciativat ligjore afatmesme

Në përputhje me këto prioritetet afatmesme, 2008-2009, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Miratimi i akteve nënligjore në kuadër të plotësimit të paketës anti-dumping si:

VKM për krijimin e Komisionit për Vlerësimin e Masave në Importe; (2008)

VKM për miratimin e rregullores së funksionimit të Komisionit; njoftimit publik për fillimin e hetimit; njoftimit publik për përfundimin e hetimit;

Rregullore për aplikimin dhe procedurat e masave mbrojtëse.

3.2.2. Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për realizimin e prioriteteve afatmesme, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Krijimi i Komisionit për Vlerësimin e Masave në Importe.

1.4.4 POLITIKA E JASHTME DHE SIGURIA E PËRBASHKËT

1. Politika e Jashtme

Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe të bashkëpunimit me vendet e rajonit, e veçanërisht me ato të Ballkanit Perëndimor, vazhdojnë të jenë *një nga prioritetet e politikës të jashtme të Shqipërisë*, duke qenë njëkohësisht edhe një nga kërkesat kryesore të Marrëveshjes së Stabilizimit-Asociimit me BE (nenet 1, 11-15 të MSA-se).

Shqipëria i përmbahet orientimeve të Bashkimit Evropian për një rajon të stabilizuar dhe të sigurtë ku vendin e konflikteve ndëretnike e fetare ta zërrë bashkëpunimi dy dhe shumëpalësh mes të gjitha vendeve të rajonit duke qenë të ndërgjegjshëm se *bashkëpunimi rajonal është parakusht për integrimin evropian dhe euro-atlantik* të këtyre vendeve.

Filozofia e Qeverisë Shqiptare në zhvillimin e marrëdhënieve me fqinjët bazohet në *tri parime themelore: transparencë, tolerancë dhe dialog*. Nga kjo pikëpamje është intensifikuar dialogu politik në nivel të lartë me të gjitha vendet e rajonit si edhe është zgjeruar baza juridike e bashkëpunimit institucional dypalësh në mjaft fusha me interes të ndërsjelltë.

Jo vetëm në planin dypalësh, por edhe në atë shumëpalësh Shqipëria është mjaft

aktive. Republika e Shqipërisë është anëtare e SEECP-së, të NEQ-it, Adriatik 3, nisma Adriatiko-Joniane etj dhe këtë vit ka kryesinë e dy prej tyre (NEQ, Adriatiko-Joniane). Shprehje e interesit të Shqipërisë për një politikë aktive rajonale ishte dhe takimi i Ministrave të vendeve të Europës Juglindore në Tiranë më datë 28 Prill 2006, ku u diskutuan probleme të bashkëpunimit ekonomik dhe të integritetit euro-atlantik.

Siç dihet në kuadër të krijimit të një zone të tregtisë së lirë në rajon, Shqipëria ka nënshkruar *marrëveshje të tregtisë së lirë*, një pjesë e mirë e të cilave janë në zbatim, me të gjitha vendet e rajonit dhe përveç kësaj qeveria Shqiptare dëshiron, që sikurse për mallrat, të lehtësohen deri në zhdukje graduale pengesat për *një lëvizje të lirë dhe të sigurtë të qytetarëve* të vendeve në hapësirën ballkanike.

Shqipëria i është bashkuar Deklaratës së Bukureshtit me 06 prill 2006 për zgjerimin e zonës së tregtisë së lirë (CEFTA) me të gjitha vendet e rajonit. Marrëveshja përkatëse pritet të nënshkruhet brenda vitit dhe do të zëvendësojë rrjetin e marrëveshjeve dypalëshe të tregtisë së lirë mes vendeve të rajonit të Europës Juglindore, duke i dhënë impuls të ri zhvillimit ekonomik dhe shkëmbimeve tregtare si edhe përsheptimit të integritetit të mëtejshëm të Ballkanit Perëndimor në strukturat ekonomike të BE-së.

Qëndrimi i Shqipërisë ndaj çështjes së Kosovës

Qeveria shqiptare ndjek me vëmendje dhe është e ndjeshme ndaj zhvillimeve dhe proceseve politike në Kosovë dhe është e bindur se lidhshipia kosovare po tregon urtësi, unitet dhe konsensus në menaxhimin e situatës në këto momente të rëndësishme historike që po kalon Kosova. Qeveria shqiptare përshëndet zhvillimin e raundeve të bisedimeve dypalëshe në Vjenë, duke inkurajuar palët pjesëmarrëse, të vazhdojnë në mënyrë konstruktive dialogun mes tyre. Ajo që kërkohet aktualisht nga të gjitha palët është përqasja realiste. Qeveria Shqiptare i kërkon autoriteteve të Beogradit që të nxisë serbët e Kosovës për t'u përfshirë në institucionet e saj. Shqipëria vlerëson faktin që Kosova po avancohet në përmbushjen e standarteve, për krijimin e një Kosove demokratike, të lirë dhe multietnike, si edhe burim stabiliteti në rajon.

Qëndrimi i qeverisë Shqiptare për Kosovën është i qartë. Mbështeten përpjekjet e Komunitetit Ndërkombëtar, Këshillit të Sigurimit, Grupit të Kontaktit dhe misionin e të dërguarit special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, për gjetjen e një zgjidhjeje, që mbi të gjitha merr parasysh vullnetin e popullit të Kosovës. Mbështeten gjithashtu parimet bazë, mbi të cilat mbështetet kjo zgjidhje: *jo kthim në situatën para vitit 1999, jo ndarje dhe as bashkim me një vend apo pjesë të një vendi tjetër.*

Shqipëria është për respektimin e kufinjve ndërkombëtarë përfshirë ata të Kosovës, sipas kushtetutës së vitit 1974.

Një Kosovë e pavarur dhe demokratike, e orientuar drejt integritetit euro-atlantik do të jetë një faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon.

Marrëdhëniet me vendet e rajonit

Marrëdhëniet me Maqedoninë kanë njohur një progres gjithnjë në rritje në sajë të një dialogu politik të vazhdueshëm në nivelet më të larta me autoritetet maqedone si edhe të qëndrimeve konstruktive të qeverisë Shqiptare ndaj disa zhvillimeve të caktuara të ndodhura në këtë vend. Duke mbajtur të njëjtin qëndrim me atë të komunitetit ndërkombëtar, Shqipëria ka përkrahur vazhdimisht zbatimin e plotë të Marrëveshjes së Ohrit, si një proces kyç jo vetëm për stabilitetin e Maqedonisë, por edhe për anëtarësimin e saj në Bashkimin Evropian.

Gjatë shkëmbimit të vizitave politike të nivelit më të lartë midis dy vendeve, të zhvilluara në mënyrë intensive kohët e fundit, është rikonfirmuar vullneti i përbashkët politik për thellimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit dypalësh në të gjitha fushat si edhe të bashkëpunimit në kuadër të projekteve të përbashkëta ndërkufitare dhe rajonale në interes të mirëqënies së popujve të dy vendeve dhe zhvillimit ekonomik e social të këtyre zonave.

Marrëdhëniet me shtetin e ri të pavarur të **Malit të Zi** marrin një rëndësi të veçantë në kuadrin e marrëdhënieve me vendet fqinje edhe për faktin se aty jeton një popullsi e konsiderueshme shqiptare, e cila është aktive në jetën politike të atij vendi dhe shërben si urë lidhëse midis dy popujve. Shqipëria ka përshëndetur verdiktin e popullit malazes për pavarësi me referendumin e datës 21 maj dhe ka qenë ndër vendet e para që bërë njohjen zyrtare të Malit të Zi, shtet të pavarur dhe sovran. Pritet që së

shpejti të fillojnë procedurat për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike dhe hapjen e ambasadave në Tiranë dhe Podgoricë.

Rëndësi i kushtohet veçanërisht marrëdhënieve me **Kroacinë** në të gjitha fushat duke dashur të përfitohet edhe nga përvoja kroate në kalimin e shpejtë të fazave të procesit të stabilizim-asociimit dhe pranimit si vend kandidat për në Bashkimin Evropian. Kohët e fundit ka pasur një shkëmbim të shpeshtë vizitash politike të nivelit të lartë si në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe ashtu edhe në kuadër të partneritetit të Kartës së Adriatikut.

Një kujdes i veçantë për zhvillimin normal të marrëdhënieve me **Republikën e Serbisë**, pa paragjykim, në të gjitha fushat me interes të ndërsjelltë. Në dialogun politik me autoritetet e Beogradit është bërë kujdes që trajtimi i çështjes së Kosovës të mos bëhet pengesë në zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe pavarësisht qëndrimeve të ndryshme që të dy vendet kanë lidhur me statusin e Kosovës. Qeveria Shqiptare mbështetet në filozofinë e nevojës së domosdoshme të dialogut si akti më civil që të jep mundësinë të parashtrorsh hapur qëndrimet qofshin ato edhe të kundërta.

Marrëdhëniet me **Bosnjë – Hercegovinën** vijojnë në mënyrë konstante dhe dialogu politik zhvillohet në nivelet më të larta, veçanërisht në kuadër të takimeve të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare. Shqipëria, me trupat e saj ushtarake në Bosnjë, jep kontributin e saj modest për stabilitetin e këtij vendi.

Shumë efikas dhe intensive është bashkëpunimi tripalësh në nivel politik dhe ushtarak Shqipëri-Maqedoni-Kroaci në kuadër të Kartës **Adriatik 3 – SHBA** për përshpejtimin e integritetit të këtyre vendeve në NATO si edhe **takimet periodike jozyrtare** të ministrave të jashtëm **të 5 vendeve të Ballkanit Perëndimor** me ministrat e jashtëm të vendeve anëtare të BE, të cilat mbajnë kryesinë e radhës së BE.

Marrëdhëniet dhe shkëmbimet politike me **Italinë** gjatë viteve të fundit marrëdhëniet kanë njohur rritje jo vetëm sasiore, por edhe cilësore. Në vizitat dypalëshe është konfirmuar vazhdimisht partneriteti startegjik mes dy vendeve, duke u fokusuar jo vetëm në marrëdhëniet dypalëshe por edhe në iniciativa me karakter global dhe rajonal, duke realizuar kështu mbështetjen pa rezerva të qeverisë dhe parlamentit italian në integrimin e Shqipërisë në BE dhe NATO. Në këtë kuadër edhe vizitat periodike të antarëve të qeverive dhe të personaliteve të dy vendeve demonstron, se bashkëpunimi ndërmjet vendeve është intensiv, shumëdimensional dhe shumëplanësh dhe realizohet jo vetëm në nivel qëndror por dhe në atë lokal. Duke përfituar nga programet rajonale të fqinjësisë të BE, si dhe nga autonomia që rajonet italiane gëzojnë nga ligji i decentralizimit, është nxitur një dimension i ri dhe efikas në bashkëpunimin në nivel lokal duke bërë të mundur nënshkrimin e disa Protokolleve Bashkëpunimi mes Qarqeve Shqiptare dhe Rajoneve Italiane. Me Italinë tashmë janë hedhur bazat për një partneritet ekonomik të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Italia është donatori kryesor i Shqipërisë me rreth 600 milion euro. Italia mbetet partneri kryesor tregtar i vendit tonë, duke zënë 40% të volumit tregtar (mbi 1.1miliard euro). Përsa i përket nivelit të investimeve, gjithashtu ajo zë vendin e parë. Rreth 500 firma italiane apo të përziera zhvillojnë aktivitetin e tyre dhe rreth 1500 të tjera bashkëpunojnë me vendin tonë. Bashkëpunimi me Italinë është i shtrirë në të gjitha fushat: në financë, energjetikë, industrinë nxjerrëse dhe përpunuese të mineraleve, transporteve, infrastrukturë, ujësjellësa, kanalizime, bujqësi etj.

Marrëdhëniet me **Greqinë** kanë njohur progresivisht zhvillime pozitive dhe niveli aktual i tyre është shumë i mirë. Me Greqinë është zhvilluar një bashkëpunim i ngushtë në kuadrin dypalësh, rajonal, evropian dhe ndërkombëtar për ruajtjen dhe forcimin e stabilitetit, paqes e progresit në Europën Juglindore. Shqipëria e angazhuar në procesin e integritetit në BE dhe NATO, mbështetet tek Greqia fqinje si anëtare e këtyre dy organizmave. Partneriteti i arritur në nivelin aktual të marrëdhënieve shqiptaro-greke është një realitet që vlerësohet nga qeveritë e të dy vendeve dhe nga faktori ndërkombëtar. Ky afrim dypalësh ka efektet e veta pozitive në nivelin e bashkëpunimit rajonal dhe në mënyrë të veçantë në proceset integruese të vendit ku mirëkuptimi dhe mbështetja greke nuk ka munguar.

Marrëdhëniet me **Turqinë**, të konsideruara tepër miqësore dhe të shkëlqyera nga autoritetet më të larta të të dy shteteve dhe qeverive zhvillohen dhe konsolidohen nëpërmjet shkëmbimit të rregullt të vizitave zyrtare dypalëshe midis kryetarëve të shteteve dhe qeverive si edhe ministrave homologë të të dy vendeve. Veçanërisht intensive janë marrëdhëniet e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, ku Turqia është një nga donatorët kryesorë për forcat shqiptare të armatosura. Turqia gjithashtu mbështet pa rezerva anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Me Turqinë ekziston dhe zhvillohet një bashkëpunim

i frytshëm institucional në të gjitha fushat përfshirë ato të rendit publik, të shërbimeve inteligjente, të drejtësisë, të shëndetësisë, të arsimit, shkencave, kulturës, transporteve, turizmit, etj.

Marrëdhëniet politike me **Rumaninë** janë tradicionalisht të mira dhe vitet e fundit kanë përjetuar zhvillime të rëndësishme konkrete shoqëruar me shkëmbime të nivelit të lartë. Shqipëria është e interesuar të bashkëpunojë me Rumaninë për shkëmbim përvoja përvoja përvoja si i përket strategjisë dhe logjistikës rumune në negociatat me BE dhe NATO si dhe për mbështetjen dhe lobingun e pales rumune, tashmë si vend anëtar i NATO-s.

Bashkëpunimi mes dy vendeve ka qënë intensiv dhe në kuadër të nismave rajonale dhe organizatave ndërkombëtare.

Marrëdhëniet politike me **Bullgarinë** ndërmjet dy vendeve tradicionalisht të mira janë zhvilluar së fundi nëpërmjet intensifikimit të dialogut politik, vizitave të nivelit të lartë. Në marrëdhëniet dypalëshe vend të rëndësishëm ka dhe bashkëpunimi në fushën e transporteve dhe komunikacionit, bujqësisë, energjisë elektrike, të arsimit dhe kulturës. Shqipëria është e interesuar për realizimin e projekteve të përbashkëta si të naftës-jellësit Burgas-Vlore, Koridorit VIII, linjës hekurudhore dhe ndërtimit të linjës së tensionit të lartë 400 kV ndërmjet Shqipërisë, Bullgarisë dhe Maqedonisë. Bashkëpunimi me Bullgarinë në kuadër të proceseve integruese, për shkëmbim përvoja në negociatat me BE dhe NATO si dhe për mbështetjen e lobingun e palës bullgare, tashmë si vend anëtar i NATO-s mbetet një nga prioritetet e bashkëpunimit dypalësh. Bashkëpunimi mes dy vendeve ka qënë intensiv dhe në kuadër të nismave rajonale dhe organizatave ndërkombëtare.

2. Siguria e Përbashkët

Asociimi i qëndrimeve të Shqipërisë me ato të BE -së, si pasojë e drejtpërdrejtë e Samitit të Selanikut, forcuan renditjen e prioriteteve për çështjet e politikës së jashtme dhe të sigurisë, duke i sjellë ato më pranë sferës politike të BE-së. Kontributin e saj në politikën e jashtme për çështjen e paqes dhe të sigurisë Shqipëria e jep përmes pjesëmarrjes aktive në organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe rajonale.

Pjesëmarrja në organizatat ndërkombëtare

Organizata e Kombeve të Bashkuara

Shqipëria zbaton të gjitha detyrimet që rrjedhin nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit si dhe nga Konventat ndërkombëtare të miratuara në kuadrin e Kombeve të Bashkuara. Shqipëria mban lidhje dhe bashkëpunon me organizata dhe agjensite e specializuara të Kombeve të Bashkuara. Duke respektuar Kartën e OKB-së si dhe Rezolutat e miratuara nga Këshilli i Sigurimit dhe Asambleja e Përgjithshme, Shqipëria ka kontribuar fuqimisht në zgjidhjen paqesore të krizës në Ballkan gjatë viteve 90' e në vazhdim. Politika e saj e jashtme ka inkurajuar krijimin e një klime favorizuese të fqinjësisë së mirë duke nxitur zhvillimet politike paqësore, mjedisin e sigurisë rajonale dhe zhvillimet ekonomike e sociale.

Shqipëria kontribuon në aksionet e Kombeve të Bashkuara në zonat e pasigurta ndërkombëtare. Ajo merr pjesë në operacionet paqëruajtëse ndërkombëtare në Bosnje-Hercegovinë dhe Gjeorgji. Shqipëria është kontribuese aktive në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar dhe merr pjesë me trupa në Afganistan dhe Irak.

Shqipëria zbaton me rigorozitet sistemin e sanksioneve të vendosura nga Kombet e Bashkuara.

Në vitin 2004, Shqipëria u bë për herë të parë anëtare e Këshillit Ekonomik e Social të OKB për periudhën 2005-2007. Duke u bërë anëtare e ECOSOC Shqipëria synon të kontribuojë drejtpërsëdrejti në zhvillimet ndërkombëtare globale dhe rajonale që lidhen me zhvillimin ekonomik e social dhe mbrojtjen e respektimin e të drejtave të njeriut.

Këshilli i Evropës

Shqipëria është anëtare e Këshillit të Evropës, që prej 13 korrikut të vitit 1995. Shqipëria ka ratifikuar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke njohur në të njëjtën kohë juridiksionin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Shqipëria ka ratifikuar dhe nënshkruar 51 konventa ndërkombëtare që përqendrohen në fushat e ruajtjes së paqes, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në qershor 2003 u nënshkrua në Strasburg, Memorandumi i Mirëkuptimit midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe KE-së.

OSBE

Bashkëpunimi i Shqipërisë me Praninë e OSBE-së në Shqipëri synon në rritjen e efikasitetit të aktivitetit të Pranisë dhe fokusimin e asistencës së saj në funksion të thellimit të proceseve demokratike dhe forcimit të institucioneve në Shqipëri. Zbatimi i efektshëm i mandatit të Pranisë, duke iu përshtatur zhvillimeve dhe progresit të arritur në vend me projekte sa më konkrete, rezultative dhe praktike, në mënyrë të veçantë, përfundimi i paketës së plotë zgjedhore dhe i asaj të drejtësisë, përbën një asistencë të vyer dhe një vlerë të shtuar të Pranisë së OSBE në Shqipëri.

Kontrolli i armëve

Për sa i përket anëtarësimit në traktatet dhe konventat ndërkombëtare mbi mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë dhe konvencionale, Shqipëria ka aderuar në një sërë aktesh ndërkombëtare, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e paqes dhe sigurisë së përbashkët.

Kontributi i Shqipërisë në luftën kundër terrorizmit

Kontributi reflektohet në rradhitjen dhe pjesëmarrjen aktive të Shqipërisë në rradhët e vendeve të aleancës kundër terrorizmit, me pjesëmarrjen me trupa ushtarake në disa vende përkrah atyre të SHBA-së dhe vendeve të tjera aleate në këtë fushë si dhe në aderimin në një sërë konventash kundër akteve të terrorizmit, të OKB-së dhe të Këshillit të Europës.

Politika Europiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDP)

Shqipëria ndjek zhvillimin e ESDP-së në kuadrin e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (CFSP) dhe po përgatitet për pjesëmarrjen graduale në ESDP, duke marrë përsipër të gjitha detyrimet e pjesëmarrjes në të dhe duke kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të saj.

Për sa i përket aspektit ushtarak, Shqipëria është duke kryer një reformë të thellë të sistemit të saj të mbrojtjes, e cila konsiston në konsolidimin e strukturës së re organizative të Forcave të Armatosura, reformën legislative, si dhe zbatimin e Tabelave të Organizimit dhe Pajisjeve, të cilat shenojnë një hap përpara drejt afrimit me strukturat ushtarake të vendeve të NATO-s. Gjatë kësaj periudhe është shtuar pjesëmarrja me trupa në operacionet paqeruajtëse, si tregues i angazhimit të Shqipërisë për rritjen e sigurisë dhe stabilitetit rajonal e global.

Gjatë vitit 2005, nga 23 fusha bashkëpunimi me NATO-n, Forcat e Armatosura (FA) kanë marrë pjesë në 19 prej tyre, që përfshijnë rreth 100 aktivitete në kuadrin e Planit Individual të Partneritetit (IPP), nga të cilat 7 stërvitje të përbashkëta. FA vazhdojnë të marrin pjesë në operacionin ALTHEA të BE-së në Bosnjë-Hercegovinë. Ato gjithashtu, janë të pranishme në Afganistan në kuadrin e misionit ISAF.

Pjesëmarrja e Forcave të Armatosura në Partneritetin për Paqe me NATO-n përbën drejtimin themelor të rritjes së operacionalitetit me Aleancën dhe përgatitjes për anëtarësim në NATO. Zbatimi i programeve të partneritetit si: IPP dhe PARP përbëjnë një orientim të rëndësishëm në transformimin e Forcave të Armatosura sipas standardeve të NATO-s.

1.4.5 ÇMINIMI

1. Objektivit politik

Qeveria Shqiptare, në përputhje dhe me detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në Konventat Ndërkombëtare në këtë fushë, ka hartuar Programin e Veprimit ndaj Minave, me qëllim pastrimin e të gjitha zonave të identifikuara si të ndotura me mina dhe municione të paplasura.

Një ndër objektivat parësore të këtij programi është krijimi i kapaciteteve kombëtare për pastrimin e zonave të minuara. Synimi kryesor në këtë drejtim është pastrimi i zonave të minuara dhe më pas dorëzimi i tyre, si zona të sigurta, komuniteteve.

Qeveria Shqiptare do të vazhdojë edhe në të ardhmen me zbatimin e programeve konkrete në këtë fushë duke bashkëpunuar ngushtësisht me partnerët ndërkombëtarë, të cilët kanë asistuar për operacionet e çminimit.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Ligjet parësore në fushën çminimit janë:

Ligji nr.8547, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e konventës “Për ndalimin e përdorimit, të magazinimit, të prodhimit dhe të transferimit të minave kundër personit (mkp) dhe për shkatërrimin e tyre”;

Ligji nr.8928, datë 25.07.2002 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për

ndalimin dhe kufizimin e përdorimit të armëve, të quajtura konvencionale, të cilat mund të shkaktojnë dëmtime të mëdha me pasoja pa dallim”, Gjenevë, 10 Tetor 1980 dhe në protokollet shtesë të saj”;

Ligji nr....., datë..... “Për ratifikimin e Konventës së Otavës”;

Ligji nr....., datë..... “Për ratifikimin e Konventës mbi Armët Konvencionale (KAK) dhe Protokollit II”;

VKM nr.269, datë 25.5.2000, “Për ndalimin e përdorimit, magazinimit, prodhimit e të transferimit të minave kundër personit dhe shkatërrimit të tyre”;

VKM nr.617, datë 04.12.2002 “Për heqjen nga inventari të municioneve të paqëndrueshme, të vjetra , të rrezikshme”.

2.2 Kuadri institucional

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e çminimit janë përgjegjëse këto institucione:

1) Komiteti i Veprimit ndaj Minave, i krijuar në Tetor 1999, i cili ka për detyrë hartimin e politikave për çminimin si dhe përgjegjësinë për përdorimin e fondeve dhe të asistencës. Ky komitet drejtohet nga zv./Ministri i Mbrojtjes dhe ka në përbërje të tij përfaqësues nga disa ministri.

2) Zyra Ekzekutive e Veprimit ndaj Minave (AMAE), nën drejtimin e Komitetit të Veprimit ndaj Minave, e cila ka për detyrë koordinimin e monitorimin e aktiviteteve dhe veprimeve si: çminimi, asistenca ndaj të dëmtuarve nga minat dhe ndërgjegjësimi i popullsisë për rrezikun e minave.

Gjithashtu në kuadër të Programit të Veprimit ndaj Minave, Qeveria Shqiptare bashkëpunon me këta Partnerë të huaj: UNDP, Shërbimi i Kombeve të Bashkuara për Veprimin ndaj Minave (UNMAS), Komisioni Evropian, Ndihma e Kishës Daneze (Danish Church Aid), Fondit Ndërkombëtar i Besimit (Sloveni), Qendra Ndërkombëtare Gjenevës për Çminimin Humanitar, Departamenti i Shtetit të SHBA -s dhe Qendrat e Rajonit Jug-Lindor për Veprimin ndaj Minave.

2.3 Asistenca teknike

Që nga viti 2000 e deri tani, kompani të ndryshme çminimi si RONCO, HELP, Fondacioni Zviceran për Çminimin dhe Ndihma e Kishës Daneze kanë punuar në operacionet e çminimit në Shqipëri. Aktualisht po kryen operacione pastrimi nën monitorimin e AMAE -s, organizata Danish Church Aid e financuar nga Gjermania dhe Departamenti i Shtetit Amerikan nëpërmjet Fondit Ndërkombëtar të Besimit në Slloveni dhe Danimarkë. Kjo organizatë ka filluar një projekt përurvejime teknik dhe pastrim të zonave të minuara, të financuar nga Bashkimi Evropian në kuadrin e programit CARDS.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritet i përcaktuar për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 është:

Përfundimi i procesit të çminimit.

3.1.1 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e ëtëij prioriteti do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Asgjësim industrial i municioneve nga uzinat

Asgjësim municionesh me plasje nga AEM

Aktivitetet zbatuese të përcaktuara për periudhën afatshkurtër, do ta shtrijnë afatin e realizimit të plotë edhe në periudhën afatmesme.

2. KRITERI EKONOMIK

2. KRITERI EKONOMIK

Stabiliteti makroekonomik

Mbi zhvillimet kryesore ekonomike gjatë vitit 2005

Rritja reale e PBB-së, gjatë vitit 2005 vlerësohet me rreth 5.5 %. PBB-ja, në terma nominale vlerësohet në rreth 836.9 miliardë lekë, ose 6.7 miliardë Euro, me një rritje prej rreth 7.9 %. PBB për frymë, vlerësohet në rreth 2149 Euro, me një rritje prej rreth 10.6 %, krahasuar me një vit më parë.

Sektorët prodhues të ekonomisë edhe për vitin 2005 vazhduan të kenë peshë më të vogël në stukturën e PBB-së, që do të thotë se ekonomia jonë vazhdon të mbështetet kryesisht në sektorin e shërbimeve.

Norma mesatare e inflacionit për vitin 2005 arriti në 2.4 %. Impaktin më të madh në të, e ka dhënë norma vjetore e inflacionit në muajt janar, qershor, shtator, tetor dhe nëntor për shkak të rritjes së çmimit të naftës dhe nënprodukteve të saj, reduktimit të furnizimit me energji, rritjes së nivelit të qerasë etj. Norma vjetore e inflacionit është arritur të mbahet brenda objektivit të Bankës së

Shqipërisë në 2 - 4 %. Politika fiskale e aplikuar gjatë muajve të fundit ka dhënë një kontribut pozitiv në drejtim të kontrollit të inflacionit dhe krijimit të një situatë atraktive për zhvillimin e biznesit.

Norma e Papunësisë së regjistruar gjatë vitit 2005 arriti në 14.3 % krahasuar me 14.4 % të një viti më parë.

Gjatë vitit 2005 **monedha vendase** rezultoi me një mbiçmim të lehtë kundrejt monedhës europiane, Euros dhe kundrejt dollarit amerikan. Kursi mesatar i këmbimit të lekut me Euro-n gjatë vitit 2005 ishte 124.19 lekë/euro, ndërsa kundrejt dollarit amerikan 99.86 leke/US\$. Vlerësimi i monedhës shqiptare Lekut, kundrejt Euros dhe US\$, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Ndërsa përsa i përket faktorëve të brendshëm në ecurinë e monedhës vendase gjatë kësaj periudhe mund të përmendim: flukset hyrëse të valutës së huaj (kryesisht Euro, gjatë festave të fundvitit), uljen e prodhimeve bujqësore vendase si dhe politikën e ndjekur nga banka për ndryshimin e interesave të depozitave në valutë të huaj.

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për vitin 2005, rezultoi me një tepricë prej rreth 124.8 milion eurosh. Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë për vitin 2005, mund të përmbledhen në:

Thellim të deficitit tregtar dhe deficitit korent;

Rritje të konsiderueshme të dërgesave nga emigrantët;

Rënie e flukseve hyrëse në formën e investimeve të huaja direkte krahasuar me një vit më parë;

Rritje e rezervës valutoare në rreth 1.2 miliardë euro, mjaftueshëm për të përballuar rreth 4.6 muaj importe mallrash dhe shërbimesh, etj.

Bilanci tregtar rezultoi me një deficit prej 1.5 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej rreth 15.7 %, krahasuar me një vit më parë. Eksporti vlerësohet të ketë ngadalësuar ritmet e rritjes së tij, duke u rritur vetëm me 9 % nga 23 % që u rrit një vit më parë. Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet rezultoi 25 %, nga rreth 27 % një vit më parë. Importet janë rritur me rreth 16 %. Pozitiv është fakti që rritja vjetore në importe është shkaktuar nga rritja e importeve në makineri, pajisje e në mjete transporti, gjë që flet për rritjen e nivelit të investimeve në vend. Dërgesat nga emigrantët, për vitin 2005 arritën në rreth 939 milionë euro ose rreth 21 % më shumë se një vit më parë. Kontributi i dërgesave të emigrantëve në zbutjen e deficitit tregtar llogaritet në rreth 64 %. Investimet e huaja direkte arritën në rreth 212.6 milion euro, duke pësuar një ulje në krahasim me vitin e kaluar, periudhë ku me shumë se 60 % e fluksit të investimeve të huaja direkte ka hyrë në formën e privatizimit.

Të ardhurat e buxhetit të përgjithshëm në fund të vitit 2005, arritën në 204.2 miliarde leke, duke qenë rreth 10.7% më të larta se një vit më parë. Ato arritën në rreth 24.4 % të PBB, nga 23.78 % që ishin në 2004. Shpenzimet e buxhetit të përgjithshëm arritën në 232.3 miliardë lekë, duke qenë rreth 4.5 % më të larta se vitin e kaluar. Këto shpenzime arritën në rreth 27.76 % të PBB, nga 28.67 % që ishin një vit më parë. Në këtë mosrealizim peshën më të madhe e kanë investimet me financime të huaja, të cilat nuk janë realizuar si rezultat i kapacitetit të ulët të absorbimit të këtyre financimeve.

Deficiti i përgjithshëm në fund të 2005, në raport me PBB arriti në 3.37 % krahasuar me 4.91 % të një viti më parë. Financimi i tij nga burime të brendshme rezultoi në rreth 2.78 % e PBB-së, krahasuar me 3.98 % në 2004.

Ekonomia shqiptare hyri në vitin 2005 si pjesë e një procesi të vazhdueshëm konsolidimi makroekonomik. Përgjithësisht, ky proces është materializuar në një rritje ekonomike rreth nivelit 6 %, me një inflacion nën kontroll rreth nivelit 3 %, me një deficit buxhetor në tkurrje dhe me përmirësim të vazhdueshëm të kushteve monetare. Ekonomia e vendit vlerësohet të jetë rritur me 5.5 për qind në terma realë gjatë vitit 2005, duke u shoqëruar me inflacion të ulët, brenda objektivit të synuar nga Banka e Shqipërisë.

Shenjat e rritjes ekonomike manifestohen nga një sërë treguesish, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Ndër ta duhen veçuar rritja me 13.8 % e shitjeve reale të ekonomisë, rritja e kënaqshme e të ardhurave nga TVSH-ja dhe e të ardhurave nga tatimi mbi fitimin dhe rritja e numrit të të punësuarve në ekonomi. Kjo rritje është reflektuar edhe në mendimin e bizneseve dhe konsumatorëve. Nga ana tjetër, zhvillimet e sektorit financiar dhe, në veçanti, zgjerimi i dukshëm i kredisë për ekonominë ilustron rritjen e investimeve dhe rritjen e konsumit në ekonomi.

Bilanci kursime–investime vlerësohet të ketë regjistruar një ecuri pak më të ndryshme

nga ajo e vitit të kaluar. Për herë të parë kursimet publike, ndonëse në nivel shumë modest vetëm 0.1 për qind e PBB-së, kanë regjistruar një nivel pozitiv, ndërkohë që kursimet private janë tkurrur me rreth 2.6 pikë përqindjeje. Ngushtimi i dallimit midis nivelit të normave të interesit në lekë me atë në valutë, ambienti global dhe ai kombëtar me norma relativisht të ulëta kthimi për një periudhë relativisht të gjatë, rritja e kredisë konsumatore për individët si dhe shkaqe të tjera të pamundura për t'u identifikuar me nivelin aktual të informacionit statistikor, kanë ndikuar në një sjellje të individëve më agresive drejt konsumit.

Në kushtet kur ecuria e investimeve ka qenë shumë e ngjashme me atë të vitit 2004, rënia e kursimeve private ka çuar në një thellim të deficitit korrent¹¹, i cili nga niveli 3.8 për qind i PBB-së në vitin 2004, vlerësohet të ketë arritur në 5.5 për qind të PBB-së në vitin 2005. Sektori i jashtëm i ekonomisë, gjatë vitit 2005, paraqitet me një bilanc të thelluar negativ në llogarinë korrente, shkaktuar nga zgjerimi i mëtejshëm i deficitit tregtar. Flukset hyrëse të kapitalit kanë qenë përgjithësisht të mjaftueshme për kompensimin e deficitit korrent, duke mundur një bilanc të përgjithshëm pozitiv.

Tabela: Disa tregues të ekonomisë për vitin 2005

Rritja reale e PBB-së (në %) ¹²	5.5
PBB (me çmime korrente, në milionë lekë ¹³)	836800
PBB (me çmime korrente, në milionë usd)	8379
PBB (në usd për frymë) ¹⁴	2550
Numri i të punësuarve (në mijë)	931
Përqindja e papunësisë	14.2
Përqindja e inflacionit (v/v)	2.0
Deficiti i buxhetit (me grantet, në % të PBB-së)	-3.8
Borxhi publik (në % të PBB-së)	54.9
Borxhi i jashtëm (në % të PBB-së) ¹⁵	16.8
Llogaria korrente (pa transfertat zyrtare, në % të PBB-së)	-7.0
Kursi mesatar i këmbimit, lek/usd	99.8
Kursi mesatar i këmbimit, lek/euro	124.2

Burimi: INSTAT, Ministria e Financave, vlerësime të FMN-së dhe Banka e Shqipërisë.

Deficiti buxhetor u zvogëluar me 27 % gjatë vitit 2005, çka përbën uljen më të madhe të tetë viteve të fundit. Gjithashtu, normat më të ulëta të interesit kanë ndihmuar në zbutjen e barrës së shlyerjes së borxhit të brendshëm.

Deficiti vazhdoi ritmet në ulje si përqindje e PBB-së, duke arritur nivelin 3.2 %. Për sa i përket shpërndarjes së deficitit në këtë periudhë, vërehet se tremujori i tretë pati nivelin më të lartë të deficitit me 9.5 miliardë lekë.

Çmimet e konsumit kanë qenë relativisht të qëndrueshme gjatë vitit 2005, duke shënuar një tjetër vit pozitiv në drejtim të përmbytjes së objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë, arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve¹⁶. Inflacioni vjetor shënoi vlerën 2.0 % në fund të vitit, ndërsa inflacioni vjetor mesatar rezultoi 2.4 %. Të dy këta tregues të kostos së jetesës janë ulur në krahasim me vitin e kaluar, duke u luhatur rreth kufirit të poshtëm të objektivit. Inflacioni vjetor qëndroi brenda intervalit 2 – 4 %, gjatë pjesës më të madhe të vitit.

Mjedisi makroekonomik dhe çmimet e konsumit

Rritja e moderuar e çmimeve të konsumit gjatë vitit 2005 u favorizua nga koordinimi i frytshëm i politikave monetare dhe fiskale. Këto politika ndihmuan në kontrollin e kërkesës së brendshme, duke krijuar një ambient makroekonomik të favorshëm. Politika monetare ka qenë e

¹¹ Në rastin e bilancit kursim investime, për të llogaritur kursimet e huaja është përdorur deficiti korrent plus transfertat zyrtare.

¹² Të dhënat për PBB-në dhe rritjen reale të saj janë vlerësime të Ministrisë së Financave, të FMN-së dhe të dhëna të Bankës së Shqipërisë.

¹³ Tabela është ndërtuar duke u bazuar në PBB-në nominale të rishikuar.

¹⁴ PBB nominale, e konvertuar me kursin mesatar të periudhës.

¹⁵ Borxhi qeveritar duke përfshirë borxhin e garantuar nga qeveria.

¹⁶ Ligji nr. 8269, datë 27.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

suksesshme në krijimin e kushteve të përshtatshme monetare për kontrollin e normës së inflacionit. Zbatimi i kujdesshëm i politikës fiskale, duke respektuar parametrat e planifikuar të treguesve fiskalë nuk ka përcjellë presioneve të tepërta inflacioniste dhe ka kontribuar në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Gjithashtu, zhvillimet në mjedisin e jashtëm ekonomik, të karakterizuara nga mbiçmimi i kursit të këmbimit të lekut ndaj euros dhe nga norma të qëndrueshme inflacioni në vendet partnere, nuk kanë ushtruar presione inflacioniste.

Politika fiskale

Viti 2005 u karakterizua nga një politikë fiskale e kujdesshme. Treguesit fiskalë¹⁷ u realizuan brenda niveleve të parashikuara në buxhetin e miratuar. Deficiti buxhetor në fund të këtij viti vlerësohet të jetë 3.9 % ndaj PBB-së, rreth 1.2 pikë përqindjeje më i ulët se ai i vitit të kaluar. Kërkesa e qeverisë për huamarrje të brendshme vlerësohet të jetë 2.8 % ndaj PBB-së.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka pasur përgjithësisht një kah neutral gjatë vitit 2005. Ulja me 0.25 pikë përqindjeje e normës bazë të interesit, në fund të tremujorit të parë, është pasuar nga një periudhë me presione inflacioniste të qëndrueshme në pjesën e mbetur të vitit. Norma bazë e interesit, pas tremujorit të parë, është ruajtur e pandryshuar në 5 %.

Monedha vendase ndoqi tendencën mbiçmuese të trashëguar nga viti i kaluar edhe gjatë vitit 2005, por me ritme më të zbutura mbiçmimi. Leku u mbiçmua mesatarisht me 2.6 dhe 2.7 % ndaj dollarit amerikan dhe euros. Një vit më parë ky mbiçmim ishte respektivisht 15.7 % dhe 7.2 %.

Në përgjithësi, viti 2005 u karakterizua nga norma të ulta rritjeje të çmimeve të prodhimit. Pas një tremujori të parë me rritje dyshifrore, ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të prodhimit shënoi norma të ulta rritjeje gjatë periudhës prill–shtator 2005. Në fund të nëntëmujorit të parë të vitit, çmimet e prodhimit janë 2.3 % më të larta sesa niveli i tyre për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rënia në nivelin e përgjithshëm të çmimeve në hallkën e parë të tregtimit, u udhëhoq nga ecuria e çmimeve thuajse në të gjithë sektorët.

Kursimet dhe Investimet

Disbalanca e kursimeve dhe investimeve të brendshme u rrit në 5.5 % të PBB-së gjatë vitit 2005, kundrejt nivelit 3.8 % të shënuar në vitin 2004¹⁸. Ky fakt është manifestuar edhe në zgjerimin e deficitit të llogarisë korente. Zgjerimi i kësaj difference reflektoi ecurinë e kundërt të kursimeve dhe të investimeve. Kështu, raporti i investimeve ndaj PBB-së u rrit me 0.4 pikë përqindjeje gjatë vitit 2005, ndërkohë që raporti i kursimeve ndaj PBB-së shënoi një rënie prej 1.4 pikësh përqindjeje. Normat e ulëta të interesit kanë ulur stimulimin për kursim, duke nxitur në të njëjtën kohë rritjen e investimeve.

Bilanci i pagesave

Sektori i jashtëm i ekonomisë, gjatë vitit 2005, paraqitet me një bilanc të thelluar negativ në llogarinë korente, shkaktuar nga një deficit i lartë tregtar. Flukset hyrëse të kapitalit kanë qenë përgjithësisht të mjaftueshme për kompensimin e deficitit korent, duke mundur një bilanc të përgjithshëm pozitiv.

Treguesi relativ i deficitit korent (përgjashtuar transfertat zyrtare) ndaj PBB-së, ka arritur në 7.7 % në vitin 2005 nga 5.7 % vlerësuar për vitin 2004. Thellimi i deficitit korent është shkaktuar nga përkeqësimi i bilancit tregtar – përgjatë një periudhe me vlerësim të vazhdueshëm të Lekut (gjatë dy viteve të fundit kursi real efektiv i këmbimit - llogaritur bazuar në indeksin e çmimeve të konsumit - është vlerësuar mesatarisht me 5 %).

Eksporti ka ngadalësuar ritmet e rritjes. Rritja vjetore në eksporte gjatë këtij viti u vlerësua rreth 9 %, përkundërt 23 % në vitin e kaluar. Përveç humbjes në aftësitë konkurruese (zhvillimet në kursin e këmbimit), ngadalësimi në eksporte mendohet të jetë pasojë edhe e rritjes së konkurrencës në sektorin e tekstileve, me hapjen e tregjeve evropiane drejt së Kinës dhe Indisë. Duhet përmendur se tekstilet dhe këpucët kanë përfaqësuar mesatarisht 64 % të eksporteve tona, për periudhën 2000-2004. Shkalla e përfaqësimit të tyre në totalin e eksporteve, këtë vit, ra në 58 nga 61 % në vitin 2004.

Në të njëjtën kohë, çmimet e larta të naftës në tregjet ndërkombëtare si dhe rritja e aktivitetit kreditues kanë çuar në rritje të importeve me rreth 16 %.

Si rezultat i rritjes më të shpejtë të importeve krahasimisht me atë të eksporteve, mbulimi i importeve nga eksportet ka rënë në nivelin 26 % nga 28 % në vitin e kaluar.

¹⁷ Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore u realizuan respektivisht në masën 97 për qind dhe 92 për qind ndaj planit vjetor, gjatë vitit 2005.

¹⁸ Diferenca midis kursimeve të brendshme me investimet. Sipas identiteteve bazë makroekonomike, kjo diferencë reflekton ecurinë e deficitit të llogarisë korente.

Deficiti tregtar (mallra dhe shërbime) vlerësohet të ketë arritur në 24 % të PBB-së ose 4 pikë përqindjeje më shumë, krahasuar me një vit më parë.

Llogaria korente

Vëllimi i transaksioneve korente është rritur me 21 % krahasuar me vitin 2004 duke shënuar një nivel prej 6.2 miliardë eurosh. Më se 93 % e shpenzimeve korente kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh prej jorezidentëve. Rreth 43 % e të ardhurave korente kanë ardhur në formën e transfertave korente, ndërkohë që eksporti i shërbimeve dhe ai i mallrave kanë siguruar përkatësisht 32 % dhe 18 % të të ardhurave.

Deficiti korent, kundrejt një viti më parë, është rritur me rreth 168 milionë euro, duke shënuar 454 milionë euro. Rritja e deficitit tregtar në mallra dhe në shërbime u balancua pjesërisht nga rritja e të ardhurave neto në llogaritë e transfertave dhe të të ardhurave. Deficiti tregtar ka përbërë një tipar të përhershëm të zhvillimeve të tregtisë së jashtme, duke diktuar nivelet e larta të deficitit të llogarisë korente. Treguesi relativ i importeve ndaj PBB-së, vlerësohet në rreth 30 %. Në rreth 58 % të totalit importi gjatë këtij viti, prezantohet në importe mallrash kapitalë dhe në importe mallrash të ndërmjetëm, ndërkohë që kërkesa e brendshme për mallra konsumi ka mbetur e lartë.

Të ardhurat dhe transfertat korente

Bilanci pozitiv i të ardhurave në fund të vitit 2005, vlerësohet rreth 144 milionë duke qenë 4 milionë më i lartë ndaj vitit 2004. Të ardhurat nga puna, përfaqësojnë rreth 70 % të bilancit pozitiv të të ardhurave. Fluksi neto i të ardhurave të kësaj kategorie ka rënë me rreth 3 % kundrejt një viti më parë, ndërkohë, të ardhurat neto në formën e interesit nga investimet kanë pësuar rritje (rreth 19 % ose 7 milionë euro). Shqipëria gjatë vitit 2005 ka paguar 22 milionë euro për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm ose 19 % më shumë se në vitin e kaluar.

Llogaria kapitale dhe financiare

Lëvizjet e kapitalit, gjatë vitit 2005, rezultuan në një fluks neto prej rreth 423 milionë eurosh, duke mundësuar financimin e deficitit korent me 93 %. Transfertat kapitale shënojnë 99 milionë euro ose 7 milionë më pak krahasuar me fundin e vitit 2004, ndërkohë që, llogaria financiare u mbyll me një bilanc pozitiv prej 323 milionë eurosh.

Detyrimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur me rreth 346 milionë euro dhe vlerësohen të jenë 22 % më pak se një vit më parë. Kjo rritje i dedikohet flukseve hyrëse të investimeve të huaja direkte si dhe të borxhit të jashtëm.

Fluksi i investimeve të huaja direkte gjatë vitit 2005 arriti vlerën 213 milionë euro kundrejt 278 milionë euro realizuar në vitin e kaluar. Duhet përmendur që në vitin 2004, kanë qenë flukset hyrëse të kapitalit në formën e privatizimit një faktor që ka përcaktuar madhësinë dhe karakterin e investimeve të huaja në vend.

Pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur në 22 milionë euro. Peshën më të madhe në këtë rritje e mban rritja e mjeteve të tjera valutore në formën e huave afatmesme dhe afatshkurtra, dhënë nga njësitë rezidente jashtë.

2) Analiza ekonomike për vitin 2006

Ekonomia shqipëtare edhe gjatë kësaj periudhe të parë të vitit 2006, vazhdon të karakterizohet nga një qëndrueshmëri e përgjithshme makroekonomike, e shprehur kryesisht në:

- mbajtjen e inflacionit nën kontroll;

- një sufiçit të konsiderueshëm buxhetor, rezultat ky i realizimit të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit të shtetit mbi nivelin e parashikuar dhe i shpenzimeve buxhetore nën këtë nivel;

- qëndrueshmëri të monedhës kombëtare;

- performancë të mirë të treguesve të tregtisë së jashtme krahasimisht me një vit më parë;

- kreditim në rritje për ekonominë, duke u bërë në këtë mënyrë burim kryesor për zgjerimin e ofertës së parasë.

Inflacioni vjetor, gjatë kësaj periudhe të vitit 2006, ka qëndruar afër kufirit të poshtëm të objektivit të Bankës së Shqipërisë. Inflacioni vjetor në muajin Prill arriti në 2.4 %, duke shënuar një rritje me 1.1 pikë përqindjeje, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Norma mesatare vjetore e inflacionit në muajin Prill 2006, ishte 2.25 %, ndërsa inflacioni mujor shënoi vlerën 0.6 %, me një rritje me 0.9 %, krahasuar me muajin Prill'05. Inflacioni i ulët gjatë kësaj periudhe është përcaktuar nga presioni i ulët i ushtruar mbi çmimet e konsumit nga kërkesa agregate dhe nga mospërcjellja e presioneve të tepërta inflacioniste nga ana e faktorëve të ofertës. Përmirësimi i furnizimit të tregut vendas me energji elektrike ka shkaktuar impulse lehtësuese në drejtim të rritjes së

kostos së jetesës në vend. Sjellja e kursit të këmbimit të lekut kundrejt valutave të huaja ka dhënë një impakt pozitiv në mbajtjen nën kontroll të normës së inflacionit, nëpërmjet reduktimit të presioneve inflacioniste të jashtme. Mostransmetimi i impaktit negativ të rritjes së çmimit të naftës në çmimet e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara në tregun europian ka zvogëluar mundësinë e inflacionit të importuar për shkak të zhvillimeve të ndryshme në tregjet, nga të cilat vendi ynë importon pjesën më të madhe të volumit të importeve.

Politika fiskale e aplikuar gjatë muajve të fundit ka dhënë një kontribut pozitiv në drejtim të kontrollit të inflacionit dhe krijimit të një situatë atraktive për zhvillimin e biznesit. Të ardhurat buxhetore për tremujorin e parë '06 arritën në rreth 53 miliardë lekë ose 16.7 % më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Nga ana e shpenzimeve vihet re tendenca rënëse (në terma mesatare) e tyre gjatë muajve të fundit, në ndryshim nga sjellja e tyre për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Niveli akumulativ i shpenzimeve buxhetore totale gjatë tremujorit të parë 2006, rezultoi në rreth 42.7 miliardë lekë, nga rreth 46.8 miliardë lekë në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Gjithashtu impakti i **politikës monetare** të zbatuar gjatë muajve të parë të vitit '06 mbi normën e inflacionit ka qenë pozitiv. Qëndrueshmëria e kushteve monetare dhe krijimi i një ambienti ekonomik (për aq sa varet nga politika monetare) të favorshëm, nga ana e politikës monetare, me qëllim mbajtjen e inflacionit brenda targetit të përcaktuar, manifestohet nga ngadalësimi i ekspansionit monetar në muajin janar dhe shkurt'06, ndërsa raportet e agregateve monetare dhe norma reale e interesit real, kanë patur përmirësime. Rritja vjetore e parasë jashtë bankave dhe ofertës totale të parasë shënuan përkatësisht nivelet 13.1 % dhe 11.6 %, në muajin shkurt'06.

Kursi i këmbimit të lekut kundrejt të dy monedhave kryesore paraqitet i qëndrueshëm, jashtë periudhës janar-prill 2006. Kursi mesatar i këmbimit të lekut ndaj euros arriti në 122.97 lekë/Euro nga 126.49 lekë /euro që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërkohë që kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan gjatë periudhës së katërmujorit të parë 2006 ishte 101.73 lekë/dollarë nga rreth 96.82 lekë/dollarë që ishte një vit më parë.

Vëllimi i përgjithshëm tregtar për periudhën janar-shkurt 2006 arriti në 52.1 miliard lekë, duke shënuar një rritje me rreth 19.6 % kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar, rrjedhojë kjo e rritjes si në eksporte ashtu edhe në importe. Por ndërsa eksportet janë rritur me rreth 15.8 %, importet kanë shënuar një rritje prej rreth 20.6 %, krahasuar me dy mujorin 2005. Për rrjedhojë deficitin tregtar ka pësuar një rritje prej rreth 22.6 %. Duhet theksuar se ekonomia jonë është e orientuar dhe do të orientohet edhe për një periudhë relativisht të gjatë, drejt importeve. Këtë e tregon edhe fakti që volumi i importeve është rreth 3.6 here më i lartë se ai i eksporteve.

Mbi 48 % e vëllimit të transaksioneve në tregtinë e jashtme është realizuar me vendet e BE-së. Importet nga këto vende arritën në rreth 62.3 % kundrejt importeve totale, ndërsa eksportet rreth 94 % të totalit të tyre. Shtetet partnere kryesore brenda vendeve të BE-së, mbeten Italia dhe Greqia, eksportet dhe importet me të cilat përfaqësojnë, përkatësisht rreth 88.2 % dhe rreth 42.3 % të volumit të përgjithshëm.

3) Parashikimet makroekonomike për një periudhë afatmesme, 2007-2009.

Zbatimi i politikave makroekonomike të qeverisë, për periudhën afatmesme, 2007-2009 synon në:

- ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, nëpërmjet konsolidimit të mëtejshëm fiskal, reduktimit të vazhdueshëm të borxhit të brendshëm dhe përmirësimit në balancet korente dhe primare;

- kthim në ritmet relativisht të larta të rritjes ekonomike, duke siguruar një nivel rritjeje 6-8 % në vit;

- mbajtje e një norme mesatare vjetore të inflacionit brenda intervalit 2-4 %,

- forcim të potencialeve të rritjes përmes vazhdimin të reformave, që do të nxisin investimet publike dhe private;

- rënie të borxhit publik në përqindje të PBB-së, përmes përmirësimeve në administrimin e të ardhurave dhe menaxhimin më të mirë të tij;

- politikë monetare të kujdesshme, që siguron një stabilitet afatgjatë;

- pozicion të qëndrueshëm të bilancit të përgjithshëm të pagesave, të shprehur në rritjen e rezervave valutores dhe në reduktim të deficitit të llogarisë korente.

Këto objektiva do të arrihen nëpërmjet zbatimit të një politike që mbështet rritjen dhe zgjerimin e sektorit privat të ekonomisë; mbështetjen e tij me kredi nga sektori bankar; vazhdimin e privatizimeve të ndërmarrjeve të rëndësishme shtetërore; rritjen e kapacitetit të mbledhjes së taksave,

ndjekjen e një politikë financiare që do të respektojë një deficit të ulët vjetor, rritjen e investimeve publike, dhe rritjen e efikasitetit të shpenzimeve në teresi, duke i destinuar tek ato sektorë që mbështesin rritjen e ekonomisë, dhe që kanë impakt të drejtpërdrejtë për një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë të ekonomisë së vendit, e që janë infrastruktura, shëndetësia dhe arsimi.

PBB-ja, në terma nominale në fund të vitit 2009 është parashikuar të arrijë në 1176.6 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 30.8 % kundrejt vitit 2006. PBB-ja për frymë në fund të vitit 2009, parashikohet të arrijë në rreth 3447 dollarë amerikane, me një rritje prej rreth 8.7 % krahasuar me një vit më parë.

Rritja ekonomike do të mbështetet nga sektorët kryesorë prodhues si ndërtimi, transporti e industria e për rrjedhojë edhe struktura e produktit të brendshëm bruto është parashikuar të përmirësohet në drejtim të rritjes së kontributit të sektorëve prodhues të ekonomisë, dhe rënies së kontributit të sektorëve të shërbimeve si dhe të sektorit të bujqësisë. Kontributi i sektorit të bujqësisë në fund të vitit 2009 në produktin e brendshëm bruto është parashikuar të arrijë në rreth 20.7 %.

Inflacioni është parashikuar të mbahet në nivelin 3 përqind me një shmangie në plus, minus, 1 përqind.

Eksportet janë parashikuar që në vitin 2009 të arrijnë në rreth 10 % të PBB-së nga 7.8 % që kanë arritur në vitin 2005, ndërkohë që bilanci tregtar parashikohet të arrijë në rreth 21.3 % të PBB-së.

Bilanci i llogarisë korente parashikohet të përfaqësojë rreth 6.9 përqind të PBB-së nga rreth 8.1 % që pritet të jetë në vitin 2006.

Politikat Monetare

1. Objektivi politik i fushës

Objektivi madhor i qeverisë në fushën e stabilitetit makroekonomik është ruajtja e stabilitetit makroekonomik në periudhë afatshkurtër dhe aftësimi si dhe vazhdimi i politikës së kujdesshme monetare dhe asaj të kursit të këmbimit konsiderohet si një përparësi afatmesme. Synimi është që Shqipëria të realizojë suksesshëm vendosjen e një regjimi asociimi me Komunitetin dhe vendet anëtare, ku një ndër prioritetet është edhe siguri i stabilitetit ekonomik.

2. Situata aktuale

2.1. Kuadri ligjor

Veprimtaria e kontrollit të politikës monetare në Republikën e Shqipërisë rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore dhe nënligjorë:

Ligji nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, qëllimi i të cilit është të arrijë dhe të ruajë stabilitetin e çmimeve, të nxisë dhe mbështetë zhvillimin e regjimit dhe të sistemit të këmbimeve valutore, tregun e brendshëm financiar, sistemin e pagesave, si dhe të ndihmojë në përmirësimin e kushteve monetare e kredituese, në mbështetje të stabilitetit dhe të zhvillimeve ekonomike të vendit.

Ligji nr. 8365 datë 02.07.1998 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, i cili vendos parimet kryesore të ushtrimit të veprimtarisë bankare në Republikën e Shqipërisë, të krijimit, organizimit dhe të mbikqyrjes së bankave, si dhe rregullon kujdestarinë dhe likuidimin e tyre.

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e politikave monetare është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

Banka e Shqipërisë, në mbështetje të nenit 3 të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” nr.8269 datë 23.12.1997, nxit dhe mbështet zhvillimin e regjimit dhe të sistemit të pagesave valutore, tregun e brendshëm financiar, sistemin e pagesave dhe ndihmon në përmirësimin e kushteve monetare dhe kredituese në mbështetje të stabilitetit dhe të zhvillimeve ekonomike të vendit.

Ministria e Financave, ku struktura përgjegjëse është Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Fiskale. Kjo Drejtori e përgjithshme përbëhet nga dy drejtori: “Drejtori Makroekonomike dhe Drejtoria e Politikave fiskale”. Drejtoria e Makroekonomisë ka në përbërje të saj dy sektorë me 7 punonjës (përfshirë edhe drejtorin e drejtorisë). Kjo Drejtori është përgjegjëse për

analizat dhe parashikimet makroekonomike, në përputhje me programet e zhvillimit ekonomik të vendit. Drejtoria e politikave fiskale ka në përbërje të saj dy sektorë dhe 7 punonjës (përfshirë edhe drejtorin e drejtorisë). Kjo drejtori është përgjegjëse për analizat fiskale, parashikimet e të ardhurave dhe hartimin e politikave fiskale.

2.3. Asistenca teknike

Banka e Shqipërisë synon të përfitojë nga përvoja e një banke qendrore anëtare të SEBQ-së nëpërmjet një projekti të binjakëzimit të lehtë (*Twinning Light*), i cili do të ndihmonte Bankën e Shqipërisë në realizimin e aktiviteteve zbatuese të përmendura më sipër, duke pasur një ndikim konkret dhe të drejtëpërdrejtë në përmbushjen e detyrimeve të ndërmarra në kuadër të MSA-së.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në rekomandimet e Komisionit European të dhëna në Dokumentin e Partneritetit European, si dhe në zbatim të angazhimeve të marra në Nenin 1 të MSA-së mbi stabilitetin makroekonomik, prioritet afatshkurtër për fushën e stabilitetit makroekonomik – politikat monetare-është:

Ruajtja e stabilitetit makroekonomik

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritate afatshkurtra, për realizimin e tyre, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Banka e Shqipërisë:

Projektligji "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8365, date 02.07.1998 "Per bankat ne Republiken e Shqiperise", i cili synon të përmirësojë ligjin ne fuqi duke pasqyruar detyrimet që rrjedhin nga dokumenti BAZEL II i Bankës për Rregullime Ndërkombëtare si dhe duke harmonizuar këtë ligj me direktivat e BE-së në fushën e shërbimeve bankare (2000/12/EC; Direktiva 91/308/EEC; 83/349/EEC). Ndryshimet në ligjin ekzistues do të konsistojnë në: përcaktimin e veprimtarive të lejueshme për bankat; saktësimin e kërkesave për reputacionin e aksionerëve dhe administratorëve të bankës; evidentimin më të plotë të origjinës së kapitalit të përdorur për krijimin e një banke; trajtimin e mbikëqyrjes së konsoliduar të bankave; dhe përfshirjen e Agjensisë së Sigurimit të Depozitave në procesin e likuidimit të bankës.

3.1.2. Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e prioritetëve afatshkurtra, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Rishikimin e kuadrit ekzistues rregullator në funksion të zbatimit të ligjit të amenduar "Për bankat në Republikën e Shqipërisë";

Kryerjen e skanimit të kuadrit ekzistues rregullator në fushën e statistikave, me qëllim evidentimin e mospërputhjeve të statistikave monetare dhe financiare si dhe atyre të bilancit të pagesave me standardet e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ);

Përmirësimin e mëtejshëm të komunikimit të jashtëm të Bankës së Shqipërisë me qëllim ndërgjegjësimin dhe rritjen e besimit të publikut të gjerë në sistemin bankar shqiptar, gjë që do të ndikojë edhe në përmirësimin e efektivitetit të politikës monetare, duke kontribuar në përmbushjen e objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë.

Prioritetet afatmesme

Bazuar në rekomandimet e Komisionit European të dhëna në Dokumentin e Partneritetit European, si dhe në zbatim të angazhimeve të marra në Nenin 1 të MSA-së mbi stabilitetin makroekonomik, prioritetet afatmesme për fushën e stabilitetit makroekonomik – politikat monetare-janë:

Vazhdimi i zbatimit të një politike monetare të kujdesshme dhe të kursit të këmbimit;

Ruajtja e stabilitetit makroekonomik.

3.2.1. Iniciativat ligjore afatmesme

Në përputhje me këto prioritate afatmesme, do të ndërmerret iniciativa e mëposhtme ligjore nga Banka e Shqipërisë:

Projektligji "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr.8269 date 23.12.1997 "Per Banken e Shqiperise", i cili do të ketë harmonizim "të plotë" me *acquis* në këtë fushë e më konkretisht me nenet 67, 104, 105/1, 107 dhe 109 të Traktatit të BE-së dhe nenet 14 dhe 28 të Statutit të Bankës Qendrore Evropiane. Ndryshimi i këtij ligji do të synojë të ndalojë financimin direkt të sektorit publik nga banka qendrore; të ndalojë overdraftin ose çdo lloj tjetër kreditimi ndaj institucioneve publike si dhe blerjen direkte të ndonjë instrumenti të borxhit publik nga ana e Bankës së Shqipërisë; të forcojë pavarësinë

institucionale të bankës qendrore në Shqipëri.

3. AFTESIA PER TE PERBALLUAR DETYRIMET E ANETARESISE NE BE

3.1 LEVIZJA E LIRE E MALLRAVE

3.1.1 FUSHA HORIZONTALE

3.1.1.1 STANDARDIZIMI DHE ÇERTIFIKIMI

1. Objektivi politik

Politikat qeveritare sektoriale do të synojnë thellimin e hapjes ekonomike nëpërmjet liberalizimit të ekonomisë duke respektuar angazhimet e ndërmarra në kuadrin e OBT-së, të marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e rajonit dhe të detyrimeve të Marrëveshjes së Ndërmjetme ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Europian. Për këtë qëllim, për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga neni 75 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, do të ndërmerren reforma institucionale e ligjore si dhe do të ngrihen dhe fuqizohen institucione të specializuara, që garantojnë lëvizjen e lirë të mallrave dhe që mbështesin eksportet shqiptare. Në zbatim të këtij programi Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, do të punojë për të arritur një progres të mëtjshëm në adoptimin e Standardeve Europiane, rritjen e vetëdijes së operatorëve ekonomikë në lidhje me konceptet e standartizimit dhe çertifikimit, sigurimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e detyrimeve të MSA-së; përmirësimin e funksionimit të organeve përgjegjëse për standartizimin, duke marrë parasysh praktikat komunitare, si dhe anëtarësimin me të drejta të plota në Organizatat Evropiane të Standardeve.

2. Situata e aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Aktet normative bazë për funksionimin e Drejtorisë së përgjithshme të Standartizimit janë:

Ligji Nr. 8464, datë 11.3.1999 “Për Standardizimin”, i cili është në përputhje me praktikat e vendeve anëtare të BE-së, duke përcaktuar ekzistencën e një organi të vetëm kombëtar për standardet dhe duke i deklaruar ato vullnetare.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.242, datë 28.05.1999 “Për miratimin e kodit të përgatitjes, adoptimit dhe zbatimit të standardeve”, i cili adopton Kodin e Praktikës së Mirë për Hartimin, Adoptimin dhe Miratimin e Standardeve.

VKM Nr 371, dt. 04.08.1999 “Për kriteret dhe kompetencat në fushën e standardizimit, çertifikimit dhe akreditimit”, i cili përcakton praktikën e punës për hartimin e standardeve dhe kryerjen e procedurave të çertifikimit të detyruar dhe vullnetar.

VKM Nr. 382, dt. 23.07.20002 “Për shkëmbimin e të dhënave në fushën e standardeve dhe të rregullave teknike”, i cili është i përafëruar me Direktivën 98/34/EC (amenduar nga Direktiva 98/48 EC).

Urdhëri i Kryeministrit Nr.36, dt. 06.05.1999 “Për disa masa për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në OBT” ngarkon DPS - ën për të qenë anëtar të grupit ndërmintor për Barrierat Teknike në Tregti (TBT).

Urdhëri i Kryeministrit Nr. 129, dt. 18.09.1999 “Për krijimin e grupeve ndërmintore të punës për masat sanitare dhe fitosanitare dhe për barrierat teknike në tregti”, i cili përcakton DPS -ën si pikë referimi për OBT-n dhe krijon Qendrën e Informacionit për Standardet.

2.2 Kuadri institucional

Bazuar në legjislacionin në fuqi Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është institucioni kombëtar për hartimin dhe miratimin e standardeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit ndihmon në reduktimin e barrierave teknike në tregti; ndërgjegjësimi i biznesit për rolin që ka përdorimi i standardeve Evropiane; promovimin e cilësisë së prodhimeve e shërbimeve; përafrimin e praktikave të infrastrukturës sonë të cilësisë me atë të organeve homologe në BE; përmbushjen e detyrimeve si Pikë Referimi e OBT –s.

DPS -ja për të realizuar prioritetet e saj, duhet të ketë një bashkëpunim shumë më të ngushtë me ministrinë e linjës. DPS - ja ka një numër të madh bashkëpunëtorësh nga ministrinë dhe institucionet publike, universitetet, institucionet kërkimore shkencore, prodhuesit dhe tregtuesit si dhe konsumatorët, të cilët marrin pjesë në:

Komitetet Teknike (KT) për hartimin, adoptimin dhe miratimin e standardeve;

Komitetin e Politikave të Konsumatorit për fushën e Standardeve, ku sillet zëri i konsumatorëve në procesin e hartimit, miratimit dhe adoptimit të standardeve;

Grupin e Eksperteve për Standardet, që jep mendime për rishikimin e KT-ës dhe planit të punës për hartimin e standardeve të reja dhe adaptimin e atyre EN ekzistuese;

DPS-ja ka marrëveshje bashkëpunimi me disa nga organizmat homologe të standardizimit në vendet e tjera, si: DIN- Gjermani, UNI- Itali, ELOT- Greqi, BDS- Bullgari, ARSO- Rumani, TSE- Turqi, HZN –Kroaci, ASK – Kosovë.

DPS-ja është anëtar vëzhgues në ISO (Organizata Ndërkombëtare e Standardeve) dhe anëtar i asociuar në CEN (Komiteti Evropian i Standardeve), anëtar i asociuar në IEC (Komisioni Elektroteknik Ndërkombëtar) dhe në CENELEC (Komiteti Evropian i Standardeve në fushën e Elektroteknikës).

2.3 Asistenca teknike

DPS-ja është asistuar nga Programi Phare me dy projekte PRAQ 92 dhe PRAQ III. Nga ana e programit CARDS është asistuar fillimisht me CARDS kombëtar 2001 dhe aktualisht me CARDS kombëtar 2003. Gjithashtu është e përfshirë në CARDS Rajonal 2002. Me ndihmën e tyre DPS-ja ka forcuar kapacitetet administrative, ka filluar zbatimin e praktikave të punës, të ngjashme me ato të organeve homologe Evropiane, ka hartuar aktet ligjore e nënligjore të standardizimit; ka filluar adoptimin e standardeve Evropiane; ka ngritur infrastrukturën e saj të teknologjisë informative; zotëron standardet evropiane në CD ROM, deri në Gusht të 2004, për një shërbim më të mirë ndaj biznesit.

3. Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:
Të marren masat për të rritur ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë në lidhje me konceptet e standardeve dhe certifikimit dhe rëndësisë së tyre në tregtinë ndërkombëtare.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Adoptimi i 80% të standardeve Europiane (EN) të CEN&CENELEC –it, si standarde Shqiptare, sipas këtij kalendari: 2006 - 60%; 2007 - 70%; në përputhje me Standardet Europiane në fuqi

Adoptimi i 100% të standardeve Europiane të harmonizuara të CEN&CENELEC –it, si standarde Shqiptare me Standardet Europiane në fuqi në zbatim të Direktivave të përafrimit të ri

Amendim i Ligjit 8464, dt.11.03.1999 mbi ndarjen e funksioneve të certifikimit nga ato të standardizimit.

Amendimi i VKM -së nr.382, dt.23.07.2002, i cili do të përputhet plotësisht me direktivën 98/34/EC e amenduar me 98/48/EC Korrik 1998

Ndryshim i VKM -së 371, dt.04.08.1999 "Për kriteret dhe kompetencat në fushën e standardizimit, certifikimit dhe akreditimit"

Amendimi i VKM –së nr.242, dt 28.05.1999 në përputhje me Kodin e Praktikës së Mirë për hartimin, adoptimin, miratimin dhe zbatimin e standardeve Aneks I TBT/OBT

Rishikimi i plotë i paketës ligjore të DPS -ës

3.1.2 Aktivitete zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitete e mëposhtme zbatuese:

Seminare në qytetet kryesore të vendit, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të biznesit vendas për rëndësinë që ka përdorimi i standardeve EN

Përgatitje materialesh promovuese, përkthime broshurash, guidash e artikujsh të ndryshëm për standardet dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit

Seminare promovimi (4 për operatorët ekonomikë vendas dhe 1 për atë pjesë të administratës, që merret me direktivat dhe rregullat teknike

Plotësimi i 9 kushteve për t'u bërë anëtarë me të drejta të plota në CEN&CENELEC

Konferencë për Ditën Botërore të Standardeve

3.2 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë vijon:

Sigurimi i kapaciteteve administrative për të zbatuar MSA -në.

Progres i mëtejshëm në adoptimin e standardeve Europiane dhe rritje e përpjekjeve për t'u

bërë anëtar me të drejta të plota në CEN & CENELEC.

Të sigurohet përmirësimi i funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit si Organ Kombëtar Standardesh, duke patur parasysh praktikat me të mira europiane.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore

Adoptimi 80% i standardeve Europiane (EN) të CEN&CENELEC –it, si standarde Shqiptare, sipas këtij kalendari: 2008 - 80%; në përputhje me Standardet Europiane në fuqi

Adoptimi 100% i standardeve Europiane të harmonizuara të CEN&CENELEC –it, si standarde Shqiptare në përputhje me Standardet Europiane në fuqi, në zbatim të Direktivave të Përafrimit Teknik

Vazhdim i adoptimit të standardeve EN si standarde Shqiptare (S SH) në përputhje me Standardet Europiane në fuqi, në zbatim të Direktivave të Përafrimit Teknik.

3.2.2 Aktivitete zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Përgatitje materialesh promovuese

Përkthime e publikime të broshurave e guidave të BE-së, të përzgjedhura për standardet dhe vlerësimin e konformitetit, si dhe ri-publikime të fletëpalosjeve dhe të broshurave/guidave të sipërpërmendura

Materiale promovimi në formë dhuratash

Plotësimi i 9 kushteve për t'u bërë anëtare me të drejta të plota në CEN&CENELEC

IT dhe Internet connection i rrjetit të DPS-s

Anëtarësim me të drejta të plota në CEN&CENELEC

Tabela: Shtese e kapaciteteve institucionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit

INVESTIME	NJëSIA E MATJES	2006	2007	2008	2009
2.IT	000/lekë		X	1250	
3.Infrastrukturë	000/lekë		2782		8750
3.Konsulencë (e huaj)	000/lekë	2750	337		3 600
4.Trajnime mijë lekë)	000/lekë		4500	6725	4 500

3.1.1.2 AKREDITIMI

1. Objektivi politik

Programi i Qeverisë Shqiptare për vitet 2005-2009 i ka cilësuar eksportet si matës të zhvillimit të ekonomisë shqiptare. Politikat qeveritare sektoriale do të synojnë thellimin e hapjes ekonomike nëpërmjet liberalizimit të ekonomisë, duke respektuar angazhimet e ndërmarra në kuadrin e OBT-së, të marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e rajonit dhe të detyrimeve të Marrëveshjes së Ndërmjetme ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit European. Për këtë qëllim, për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga neni 75 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, do të ndërmerren reforma institucionale e ligjore si dhe do të ngrihen dhe fuqizohen institucione të specializuara, që garantojnë lëvizjen e lirë të mallrave dhe që mbështesin eksportet shqiptare. Në zbatim të këtij programi, Drejtoria e Akreditimit në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, do të arrijë marrëveshjet e njohjes reciproke të fletë-analizave dhe certifikatave të cilësisë, të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituar dhe organizmave të akreditimit të vendeve të tjera.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Kuadri ligjor në fushën e akreditimit përbëhet nga:

Ligji Nr. 9024 datë 06.03.2003 “Për akreditimin e laboratorëve testues dhe kalibrues, organizmave certifikues dhe inspektues në Republikën e Shqipërisë”, i cili është shqyrtuar nga ekspertët e Organizatës Europiane të Akreditimit dhe përputhet me praktikat europiane të akreditimit.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 854 datë 19.12.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Akreditimit”.

Urdhri i Kryeministrit nr. 162 dt.8.12.2003 “Per miratimin e struktures dhe organogrames të

Drejtore të Akreditimit

VKM Nr. 77 dt.12.2.2004 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Drejtore të Akreditimit

2.2 Kuadri institucional

Bazuar në legjislacionin në fuqi Drejtoria e Akreditimit ka si mision të ofrojë akreditimin e laboratorëve testues, kalibruer, organizmave certifikues, inspektues; mbikqyrjen e organizmave të akredituar; ndërprerjen dhe tërheqjen e akreditimit; përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në organizmat ndërkombëtare për akreditimin. Gjithashtu kjo strukturë duhet të sigurojë lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve për industrinë shqiptare nëpërmjet njohjes së organizmave të vlerësimit të konformitetit të akredituar nga Drejtoria e Akreditimit.

Kjo Drejtore bashkëpunon me disa institucione të tjera si Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë për ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomike mbi rolin, rëndësinë e procedurave të akreditimit. Gjithashtu, bashkëpunon me ministrinë dhe institucionet në varësi të tyre për hartimin e legjislacionit në përputhje me parimet e akreditimit.

2.3 Asistenca teknike dhe financiare

Drejtoria e Akreditimit ka përfituar dhe përfiton nga projektet:

CARDS 2001 "Mbështetje për standardizimin në Shqipëri" me shumë 2 000 000 Euro

CARDS 2003 "Mbështetje për standardizimin, certifikimin dhe akreditimin në Shqipëri" me shumë 1.500 000 Euro

CARDS Rajonal 2002 "Infrastruktura e Cilësisë" me shumë 1.600 000 Euro.

3. Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Të sigurohet që Drejtoria e Akreditimit të ketë një infrastrukturë të përshtatshme dhe personel të trajnuar, dhe të adoptojë një plan pune të bazuar për anëtarësimin e ardhshëm në Organizatën Europiane të Akreditimit.

Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Amendim i ligjit nr. 9024 datë 06.03.2003, i cili do të harmonizohet plotësisht me standardin ISO 17011

Amendim I VKM nr. 854, datë 19.12.2003, i cili do të harmonizohet plotësisht me standardin ISO 17011

Amendim i Urdhërit nr. 162 datë 08.12.2003, i cili do të harmonizohet plotësisht me standardin ISO 17011

Amendim i VKM -së nr.77 datë 12.02.2004

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Përfundim i infrastrukturës fizike dhe ngritja e qendrës trajnuese pranë Drejtorisë së Akreditimit

Përgatitja e procedurave dhe kryerja e kontrolleve të brendshme

Trajnimi i stafit të Drejtorisë së Akreditimit

Promovimi i Drejtorisë dhe shërbimeve të saj

Hartim i politikës së Drejtorisë së Akreditimit për anëtarësim në Organizatën Europiane të Akreditimit

Përmirësimi i skemave të akreditimit në përputhje me kërkesat e standardeve dhe ndjekja e procedurave të akreditimit

Ngritja e një sistemi për rekrutimin e vlerësuesve

Zbatimi i sistemit të cilësisë së Drejtorisë së Akreditimit

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të Drejtorisë së Akreditimit në përputhje me standardet dhe udhëzuesit e Organizatës Europiane të Akreditimit

Vetvlerësimi i situatës në lidhje me plotësimin e kushteve teknike sipas listës së ISO -së 17011

Konsulenca me ekspertë të Organizatës Europiane të Akreditimit për zgjidhjen e moskonformiteteve të gjetura

Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë vijon:

Të sigurohet një funksionim i përmirësuar, duke patur në konsideratë praktikën më të mira të Komunitetit Europian, të trupave përgjegjëse për standardizimin, akreditimin dhe çertifikimin si dhe të trupave përgjegjëse për metrologjinë dhe kalibrimin.

Të sigurohet anëtarësimi i Shqipërisë në Organizatën Europiane të Akreditimit.

Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore

Ndryshime të detyruara nga ndryshimet në kërkesat e standardeve ose të kushtëzuara nga kërkesa të tjera të organizmave europiane e ndërkombëtare

3.3.2 Aktivitete zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Përmirësimi i skemave të akreditimit në përputhje me kërkesat e standardeve

Trajnimi i stafit të Drejtorisë së Akreditimit

Kryerja e kontrolleve të brendshme dhe rishikimi i procedurave të akreditimit

Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm në kuadër të anëtarësimit në Organizatën Europiane të Akreditimit

Akreditime të përbashkëta me organizma anëtare të Organizatës Europiane të Akreditimit

Zgjerimi i skemave të akreditimit për trupat çertifikues të menaxhimit të ambientit dhe sigurimit në punë

Anëtarësimi në Organizatën Europiane të Akreditimit

Aplikimi për nënshkrimin e marrëveshjeve shumëpalëshe për akreditimin

Tabela: Shtesë e kapaciteteve institucionale të Drejtorisë së Akreditimit

IME	INVEST	N	2	2009
	JËSIA E	006	007	008
	MATJES			
1.Shtim personash	p ersona		X	X
2.IT	0 00/lekë	1 000		
3.Infrastruktura	0 00/lekë		800	800
3.Konsulencë (e huaj)	0 00/lekë	40	3 80	3 600 000
4.Trajnime (mijë lekë)	0 00/lekë	4 600	4 160	4 700 300

3.1.1.3 METROLOGJIA LIGJORE DHE PARA-PAKETIMET

1. Objektivi politik

Politikat qeveritare sektoriale do të synojnë thellimin e hapjes ekonomike nëpërmjet liberalizimit të ekonomisë, duke respektuar angazhimet e ndërmarra në kuadrin e OBT-së, të Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë me vendet e rajonit dhe të detyrimeve të Marrëveshjes së Ndërmjetme ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Europian. Për këtë qëllim, për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga neni 75 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, do të ndërmerren reforma institucionale e ligjore si dhe do të ngrihen dhe fuqizohen institucione të specializuara që garantojnë levizjen e lirë të mallrave dhe që mbështesin eksportet shqiptare. Në zbatim të këtij programi, Drejtoria e Metrologjisë dhe e Kalibrimit në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës do të marrë masat e nevojshme për siguruar gradualisht përputhshmërinë me rregullat teknike të Komunitetit dhe procedurave europiane të metrologjisë. Për këtë qëllim, Qeveria shqiptare do të

miratojë Strategjinë Kombëtare për Metrologjinë, si dhe përgatitjen e një ligji të ri për metrologjinë, nëpërmjet të cilit DPMK mund të krijojë dhe zhvillojë një sistem të rregulluar të metrologjisë, me përdorim optimal të burimeve për të plotësuar nevojat kombëtare.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Kuadri ligjor në fushën e metrologjisë përbëhet nga:

Ligji Nr. 8996 date 30.01.2003 “Për njësitë ligjore të matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse”

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 431 date 26.06.2003 “Për njësitë ligjore të matjes”;

Vendim i Këshillit të Ministrave no. 216 datë 10.04.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit” DPMK);

Urdhër i Kryeministrit No. 157 datë 05.10.2004 “Per miratimin e strukturës dhe skemën organizative të DPMK”;

Urdhëresa e Ministrisë së Financave “Tarifat e lejimit, regjistrimit, tarifat e verifikimit dhe kalibrimit të mjeteve matëse dhe rregullat e aplikimit të tyre”;

Urdhër i DPMK no. 29 datë 13.03.2003 “Per karakteristikat metrologjike të mjeteve matëse”

Urdhëresa e DPMK no.179 datë 18.09.2003 “Për përcaktimin e afateve të detyrueshme të verifikimit periodik të mjeteve matëse”;

Urdhëresë e DPMK No. 110 date 02.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Metrologjisë”;

Rregullore e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e DPMK” miratuar nga Ministria e Ekonomisë, Dhjetor 2004.

2.2 Kuadri institucional zbatues

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës është i vetmi institucion që përgjigjet për metrologjinë, pjesë e infrastrukturës së cilësisë së bashku me standartizimin, akreditimin,urvejimin e tregut dhe vlerësimin e konformitetit. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe e Kalibrimit ka misionin të ngrejë dhe të menaxhojë sistemin kombëtar të metrologjisë në Republikën e Shqipërisë në përputhje me sistemin global dhe rajonal të metrologjisë; të mbrojë qytetaret nëpërmjet organizimit të kontrollit të mjeteve matëse në fushat e transaksioneve zyrtare dhe tregtare, mbrojtjes së shëndetit, mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë; dhe t’u ofrojë shërbime kalibrimi prodhuesve dhe përdoruesve të instrumenteve matëse për të qenë konkurrues në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.

DPMK ka 100 punonjës, nga të cilët, 32 janë punonjës në drejtorinë qendrore dhe 68 në qarqe. DPMK, në kryerjen e funksioneve të saj, bashkëpunon me ministrinë e linjës si Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit; Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës; Ministrinë e Shëndetit Publik, Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe Ministrinë e Brendshme.

DPMK bashkëpunon me institucionet përkatëse të infrastrukturës së cilësisë, Këshillin e Metrologjisë, Komiteteve Teknike të Standartizimit, Bordin e Akreditimit si dhe Komitetin Bashkërendues për Mbrojtjen e Konsumatorit. Me Universitetin Politeknik, Korporatën Elektroenergjetike, Institutin e Fizikës Bërthamore dhe Institutin e Hidrometeorologjisë bashkëpunimi realizohet në bazë të aktmarrëveshjeve të përbashkëta, pasi këto institucione disponojnë laboratorët dhe stafin e specializuar për fushat e matjeve elektrike, të rrezatimit jonizues dhe lagështisë.

2.3 Asistenca teknike

Metrologjia mbështetet nga projektet si më poshtë vijon:

Projekti CARDS 2003 “Metrologjia në Shqipëri”, për periudhën 2004 - 2007 me shumë 1 300 000 Euro me objektiv rritjen e cilësisë së produkteve shqiptare për eksport.

Projekti dypalësh Shqipëri – Gjermani “Stimulimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet krijimit dhe harmonizimit të infrastrukturës së metrologjisë me atë të BE-së” për periudhën 2006 -2010, me shumë 1.3 milion Euro.

Programi Rajonal CARDS 2002 “Infrastruktura e Cilësisë” për periudhën 2004-2006 me shumë 1.6 milion Euro.

Projekti i Bankës Botërore për mbështetjen e metrologjisë në Shqipëri për periudhën 2006-2011 me shumë prej 5 milion Euro.

Projekti kombëtar CARDS 2006 "Infrastruktura e Cilësisë" me shumë 2 milion Euro.

3. Adresimi i prioriteteve

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së.

Të shenohet progres ne transpozimin e direktivave të Përqasjes së Re, si dhe të direktivave të Përqasjes së Vjetër.

Të sigurohet funksionimi i strukturave përgjegjëse për metrologjinë dhe kalibrimin, bazuar në praktikat më të mira të Bashkimit Europian.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projekt-ligj i ri për metrologjinë, i cili do të përputhet plotësisht me Direktivën 71/316/EEC dhe Dokumentin D1 të OIML-së

Projekt VKM "Për instrumentet jo-automatike të peshimit", i cili do të përputhet plotësisht me Direktivën 90/384 EC,

Projekt-Urdhër për strukturën dhe skemën organizative të DPMK

Rishikimi i VKM nr. 341 date 26.06.2003 "Për njesite ligjore të matjes", i cili do të përputhet plotësisht me Direktivën 80/181 EEC "Njesite ligjore të matjes"

Projekt-Urdhër i Ministrit "Për organizimin dhe funksionimin e DPMK"

Projekt VKM "Për kontrollin e produkteve të paketuara dhe shisheve ene matese " i cili do të përputhet plotësisht me Direktivat: 75/106/EEC; 75/107/EEC; 76/211/EEC; 80/232/EEC; Projekt VKM "Për etalonet kombëtare të matjeve", i cili do të përputhet plotësisht me CIMP MRA, Dokumentin D8 i OIML

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Finalizimi i strategjise afatgjatë të zhvillimit të sistemit kombëtar të metrologjisë

Sigurimi i terrenit për ndertimin e Qendres Kombëtare të Metrologjisë

Përmirësimi (rikonstruksioni) i laboratoreve ekzistuese në DPMK;

Ngritja e nivelit të etaloneve kombëtare për fushat e matjeve të masës, elektrikut, temperaturës, presionit dhe volumit

Përmirësimi i strukturës dhe skemës organizative të DPMK-se, ngritja e strukturës së supervizionit metrologjik, trajnimi i stafit teknik

Trajnim i stafit teknik të laboratoreve të DPMK për fushat masë dhe volum

Kurs trainimi mbi çështjet e sigurimit të cilësise në laboratorët e etaloneve kombëtare të matjes dhe laboratorët e metrologjisë ligjore

Perkthimi dhe botimi në gjuhën Shqipe i Fjalorit Nderkombëtar të Termave Baze të Metrologjisë

Krijimi i kushteve ambientale dhe ngritja e laboratoreve në qendrën rajonale Fier.

Aktivitet ndërgjegjësues me palet e interesuara për Direktivën e Përqasjes së Re Per Instrumentat Mates" dhe menaxhimin e cilësise në Metrologjinë ligjore

Aktivitet ndërgjegjësues për palet e interesuara (prodhues, importues të mallrave të paketuara) për kontrollin e produkteve të parapaktuara.

Hartimi i projektit të ndertimit të Qendres Kombëtare të Metrologjisë dhe sigurimi i supervizionit të ndertimit

Përmirësimi dhe fuqizimi i infrastruktures së degeve të kontrollit të mjeteve matese (tri dege): studim, trajnim stafi teknik, blerje pajisjesh

Aktivitet rajonal për promovimin e metrologjisë dhe bashkepunimin në nivel rajonal

Trainim i stafit teknik për fushat e matjeve të presionit, temperaturës, matjeve elektrike dhe gjatesise, testim i lojrave të fatit

Përmirësimi i rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të DPMK-se

Përmirësimi i urdherit të Drejtorit të Përgjithshëm të DPMK "Për organizimin dhe funksionimin e Keshillit të Metrologjisë" dhe funksionimi i Këshillit të Metrologjisë

Përgatitja e Urdhërësës së DPMK lidhur me mënyrën e kryerjes së supervizionit metrologjik

Fillimi i ndërtimit të qendres së re kombëtare metrologjike

Promovimi i ditës ndërkombëtare të Metrologjisë

3.2. Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:

Te sigurohen kapacitetet administrative për permbushjen e kërkesave të MSA-se.

Te shenohet progres në transpozimin e direktivave të Perqasjes së Re, si dhe të direktivave të Perqasjes së Vjetër.

Te sigurohet funksionimi i strukturave përgjegjëse për metrologjinë dhe kalibrimin, bazuar në praktikën me të mira të KE-së.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projekt-urdher i Ministrit të METE "Për manometrat e matjes së presionit të gomave të automjeteve", i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 86/217 EEC

Projekt urdher i Ministrit të METE "Për alkoolmetrat, alkoolhigrometrat dhe tabelat e alkolit", i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivat 76/765/EEC; 76/766/EEC

Projekt Urdher i Ministrit të METE "Masat standarde të drithit", i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 71/347/EEC

Projekt VKM "Për instrumentat mates" që do të përafrohet plotësisht me Direktivën 2004/22 EC

Projekt VKM "Për instrumentet mates objekt i kontrollit ligjor metrologjik" që do të përafrohet plotësisht me Direktivën 71/316/EEC, amendamentet 72/427/EEC; 83/575/EEC; 87/354/EEC; 87/355/EEC; 88/665/EEC,

Projekt urdher i Ministrit "Për gramaret nga 1 mg deri në 50 kg të saktësisë mbi mesatare që do të përafrohet plotësisht me direktivën 74/148 EEC

Projekt urdher i Ministrit "Për gramaret nga 5 deri në 50 kg në formë katerkendore dhe gramaret nga 1 deri në 10 kg të formës cilindrike, të saktësisë mesatare" që do të përafrohet plotësisht me Direktivën 71/317 EEC

Projekt urdher i Ministrit të METE "Për miratimin e tipit dhe verifikimin e instrumenteve matese të kontrolluar ligjorisht"

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Përmirësimi dhe fuqizimi i infrastrukturës së degeve të kontrollit të mjeteve matese (tre dege): studim, trajnim stafi teknik, blerje pajisjesh

Sigurimi i konsulencës metrologjike për hartimin e specifikimeve teknike për etalonet kombëtare të matjeve që do të vendosen në qendrën e re kombëtare metrologjike

Përmirësimi dhe fuqizimi i infrastrukturës së degeve të kontrollit të mjeteve matese (tri dege): studim, trajnim stafi teknik, blerje pajisjesh

Pjesëmarrje në aktivitetet teknike Grupeve të Punës të WELMEC me statusin vëzhgues, si dhe në Komitetet teknike të EUROMET

Blerja e etaloneve kombëtare të matjeve për laboratorët e qendrës kombëtare të metrologjisë

Pergatitja e dokumentacionit për sistemin e cilësisë në laboratorët e ruajtjes së etaloneve kombëtare të matjeve me qëllim akreditimin e tyre

Pjesëmarrje në aktivitete ndërkrahasuese të etaloneve kombëtare

Pergatitja për anëtarësim në EUROMET, deklarimi i CMC-ve (aftësi matese dhe kalibrues sipas CIPM MRA-se)

Aktivitet promovues për metrologjinë në nivel kombëtar

Promovimi i ditës ndërkombëtare të Metrologjisë

3.1.1.4 VLERESIMI I KONFORMITETIT

1. Objektiv i Politik

Sigurimi në mënyrë graduale i përputhshmërisë me rregullat teknike të konformitetit dhe procedurat europiane të vlerësimit, është një nga detyrimet kryesore të vendit tonë, i cili përcaktohet në nenin 75 të MSA-se. Duke u bazuar në këtë nen, Qeveria shqiptare duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar gradualisht përputhshmërinë me rregullat teknike të Komunitetit brenda një periudhe pesë vjeçare. Për këtë qëllim, palët do të fillojnë në një fazë të hershme nxitjen e përdorimit të rregulloreve teknike të Komunitetit, standardeve europiane dhe procedurave të vlerësimit të përputhshmërisë, dhënien e asistencës për të nxitur zhvillimin e infrastrukturës së cilësisë dhe nxitjen e

pjesëmarrjes së Shqipërisë në veprimtarinë e organizatave që kanë të bëjnë me standardet, vlerësimin e përputhshmërisë, metrologjinë dhe funksione të ngjashme (p.sh. CEN, CENELEC, ETSI, EA, WELMEC, EUROMET etj).

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Ligji Nr. 9097, dt. 3.7.2003 "Per Vlersimin e Konformitetit" perfaqeson ligjin kuader persa i perket procedurave dhe rregullave te vleresimit te konformitetit.

Nje akt nenligjor eshte miratuar ne zbatim te tij:

VKM Nr. 723, date. 5.11.2004 "Per procedurat dhe rregullat baze te funksionimit te organizimit te autorizuar per kryerjen e vlersimit te konformitetit".

2.2 Kuadri institucional ekzistues

Drejtoria e Mbikqyrjes se Tregut, Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit dhe Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise dhe Kalibrimit ne Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes jane Drejtorite kryesore ne zbatimin e ligjit per vleresimin e konformitetit.

Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes per vlerësimin e konformitetit duhet te kete bashkepunim shume me te ngushte me ministritë e linjes zbatuese te ketij ligji si Ministria Shendetesise, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Mjedisit, Ministria e Brendshme, Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2.3 Asistenca teknike dhe financiare

Në këtë fushë nuk ka patur asistencë teknike dhe financiare.

3. Adresimi i prioriteteve

Prioritetet afatshkurtera

Prioritetet e percaktuara per Qeverine shqiptare per periudhen afatshkurtër jane si me poshte:

Te sigurohen kapacitetet administrative per permbushjen e kerkesave te MSA-se ne fushen e levizjes se lire te mallrave.

Te shenohet progres ne transpozimin e direktivave te perafimit te ri e te vjeter.

Iniciativat ligjore afatshkurtera

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Amendim i Ligjit Nr. 9097, dt. 3.7.2003 "Per Vlersimin e Konformitetit" i cili do të për afrohet plotësisht me vendimin e Këshillit 93/465 EEC

Projekt Vendim per miratimin e listes te produkteve qe do ti nenshtrohen vlersimit te konformitetit

Prioritetet afatmesme

Prioritetet e percaktuara per Qeverine shqiptare per periudhen afatmesme jane si meposhte:

Te sigurohen kapacitetet administrative per permbushjen e kerkesave te MSA-se ne fushen e levizjes se lire te mallrave.

Te shenohet progres ne transpozimin e direktivave te perafimit te ri e te vjeter.

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Per adresimin e prioriteteve afatmesme do te ndermerren aktivitetet e meposhteme zbatuese:

Ngritja e nje strukture implementuese

Fuqizimi i kapaciteteve te Sektorin e Standardeve dhe Sigurimit Teknik

Fushate ndergjegjesuese per konsumatorin , dhe operatorët ekonomik.

Tabela

FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË DREJTORISË SË MBIKQYRJES Së TREGUT

Inves

†

C

time	jësia e matjes	jendja aktuale	008
1.Shtim personash	personash	λ	
2.IT	(mijë lekë)	λ	50
3. Infrastruktura	(mijë lekë)		00
4.Trajnime (mijë lekë)	(mijë lekë)	λ	460

3.1.2 DIREKTIVAT E PËRAFRIMIT TEKNIK

1. Objektivi politik i fushes

Sigurimi në mënyrë graduale i përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me standardet dhe rregullat teknike mbi sigurinë e produkteve shqiptare dhe procedurat europiane të vlerësimit të konformitetit, është një nga detyrimet kryesore të vendit tone, i cili përcaktohet në nenin 75 të MSA-së. Duke u bazuar në nenin e lartpërmendur, Qeveria shqiptare duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar gradualisht përputhshmërinë me rregullat teknike të Komunitetit . Për këtë qëllim, Qeveria shqiptare do të fillojë në një fazë të hershme nxitjen e përdorimit të rregulloreve teknike të Komunitetit, standardeve europiane dhe procedurave të vlerësimit të përputhshmërisë, dhënien e asistencës për të nxitur zhvillimin e infrastrukturës së cilësisë dhe nxitjen e pjesëmarrjes së Shqipërisë në veprimtarinë e organizatave që kanë të bëjnë me standardet, vlerësimin e përputhshmërisë, akreditimin, metrologjinë dhe funksione të ngjashme.

Në kuadër të objektivave të parashikuara në Dokumentin e Partneritetit Evropian 2006, Qeveria shqiptare është angazhuar të rrisë sigurimin e kapaciteteve administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave dhe të arrijë një progres të dukshëm në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri, global dhe të vjetër.

3.1.2.1 DIREKTIVAT E PËRAFRIMIT TË RI

3.1.2.1.1 PAJISJET ELEKTRIKE

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e pajisjeve elektrike rregullohet nga aktet ligjore të mëposhtme:

Ligji nr. 9097, dt. 3.7.2003 " Për Vlerësimin e Konformitetit";

Ligji nr.8734 dt.1.2.2001 " Për garantimin e sigurisë së njerëzve, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale nga rreziku elektrik" i harmonizuar plotësisht me Direktivën 73/23/EEC, amenduar nga 93/68/EEC " Për pajisjet me voltazh të ulët".

Aktet nenligjore të miratuara në këto fusha janë:

-VKM nr. 723, dt. 5.11.2004 "Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit;

VKM nr. 494 dt.14.8.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e inspektoriatit të pajisjeve dhe

instalimeve elektrike".

1.2 Kuadri institucional

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës është institucioni përgjegjës për pajisjet elektrike. Aktualisht, pas riorganizimit të ministrive (bashkimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës), tashmë në këtë fushë operon Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standarteve dhe Sigurimit Teknik dhe Inspektoriati i Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike (IPIE) nën Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore.

1. Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut me Sektorin e Standarteve dhe Sigurimit Teknik përgjigjet për adoptimin e akteve nënligjore për projektimin, përdorimin, shfrytëzimin dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike.

2. Në kuadrin e Drejtorisë së Mbikqyrjes së Tregut funksionon edhe Inspektoriati i Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike i cili është institucion përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të rregullave, që garantojnë sigurinë e punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike në veprimtarinë e personave juridik e fizik.

IPIE është organizuar dhe funksionon në bazë të VKM nr. 494 dt. 14.8.2001 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoriatit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike".

IPIE përbëhet nga kryeinspektori dhe inspektorët në qendër, që përbëjnë nivelin qendror të organizimit dhe inspektorët e zonave brenda juridiksionit të një qarku, të cilët përbëjnë nivelin vendor të organizimit.

Aktualisht veprojnë 14 inspektorë zone të vendosur në këto prefektura ; Tiranë, Bashkia e Tiranës, Durrës, Shkodër, Dibër, Korçë, Elbasan, Fier, Vlorë, Lezhë, Berat, Kukës dhe Gjirokastër.

IPIE është përgjegjës për :

miratimin e projekteve elektrike me fuqi të instaluar mbi 20 kV;

inspektimin e subjekteve që kryejnë veprimtari me pajisje dhe instalime elektrike;

heqjen nga tregu të pajisjeve dhe instalimeve elektrike të pasigurta.

3. Prioritetet

3.3 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e levizjes së lirë të mallrave;

-Të shenohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri.

Iniciativat ligjore afatshkurtra

METE ka parashikuar të ndërmarrë për periudhën afatshkurtër iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM lidhur me "Pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit" I cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 73/23/EEC, amenduar nga Direktiva 93/68 EEC.

3.4 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

-Të shenohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ndryshime në VKM "Lidhur me pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit" I cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 73/23/EEC, amenduar nga Direktiva 93/68 EEC.

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e një strukture implementuese;

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standardeve dhe Sigurimit Teknik;

Fushatë ndërgjegjësuere për konsumatorin dhe operatorët ekonomik.

3.1.2.1.2 ENËT NËN PRESION

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e pajisjeve nën presion rregullohet nga aktet ligjore të mëposhtme:

Ligji nr. 9097, dt. 3.7.2003 " Për Vlerësimin e Konformitetit";

Ligji nr.8739 dt.12.12.2001 "Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve Nën Presion" harmonizuar plotësisht me Direktivën 97/23/EC, "Për përafrimin e ligjeve të Shteteve anëtare lidhur me pajisjet nën presion", Direktivën 87/404/EEC "Për përafrimin e ligjeve të Shteteve anëtare lidhur me enët e thjeshta Nën Presion" , amenduar nga Direktiva 90/488/EEC, dhe 93/68/EEC.

Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 8739, datë 12.12.2001 janë :

VKM nr. 723, dt. 5.11.2004 "Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit";

VKM nr. 497, dt. 14.8.2001. " Për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoriatit të Enëve Nën Presion";

Rregullore : E miratuar nga MIE "Për Enet e Thjeshta nën Presion" në përputhje me direktivën 87/404/EEC "Për përafrimin e ligjeve të Shteteve anëtare lidhur me enet e thjeshta Nën Presion" , amenduar nga Direktiva 90/488/EEC dhe 93/68/EEC;

Rregullore e miratuar nga MIE " Mbi Projektimin, Prodhimin dhe Vlerësimin e Konformitetit të Pajisjeve Nën Presion" përputhur me Direktivën 97/23/EC "Për përafrimin e ligjeve të Shteteve anëtare lidhur me pajisjet nën presion".

2.2 Kuadri institucional

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës është institucioni përgjegjës për pajisjet nën presion. Aktualisht, pas riorganizimit të ministrive (bashkimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës), tashmë në këtë fushë operon Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standarteve dhe Sigurimit Teknik dhe Inspektoriatin e Pajisjeve nën presion, nën Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore.

1. Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut me Sektorin e Standarteve dhe Sigurimit Teknik përgjigjet për adoptimin e akteve nënligjore për projektimin, përdorimin, shfrytëzimin dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike.

2. Në kuadrin e Drejtorisë së Mbikqyrjes së Tregut funksionon edhe Inspektoriatin e Pajisjeve nën presion i cili është përgjegjës për mbikqyrjen e tregut. IPNP zhvillon veprimtarinë e tij në bazë të VKM nr. 497, dt. 14.8.2001 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoriatit të Pajisjeve nën Presion".

IPNP është përgjegjës për :

-kontrollin e plotësimin të kërkesave të sigurisë të pajisjeve nën presion;

-miratimin e projektit të vendosjes së kaladajave dhe të enëve nën presion stacionare;

-inspektimin e subjekteve që kryejnë veprimtari me pajisje nën presion;

-heqjen nga tregu të pajisjeve të pasigurta.

IPNP përbëhet nga Kryeinspektori, inspektorët e qendrës dhe 10 inspektorë të zonave, të vendosur në këto prefektura : Tiranë, Durrës, Shkodër, Dibër, Korçë, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Bashkia Ballsh.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

-Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

METE ka parashikuar të ndërmerret për periudhën afatshkurtër iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM "Per pajisjet nën presion" i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 97/23/EEC "Për Pajisjet Nën Presion";

VKM " Per enët e thjeshta nën presion " i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 87/404EEC, 90/488/EE dhe 93/68/EEC "Për Enët e Thjeshta Nën Presion";

3.2 Prioritetet afatmesme

*Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:
Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;*

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ndryshime ne VKM "Per pajisjet nën presion" i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 97/23/EEC "Për pajisjet nën presion";

Ndryshime ne VKM " Për enët e thjeshta nën presion " i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 87/404/EEC, 90/488/EE dhe 93/68/EEC "Për enët e thjeshta nën presion";

VKM "Për pajisjet e transportueshme nën presion i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 1999/36 EEC "Për Pajisjet e Transportueshme Nën Presion".

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e një strukture implementuese;

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standardeve dhe Sigurimit Teknik;

Fushatë ndërgjegjësuere për konsumatorin dhe operatorët ekonomik..

3.1.2.1.3 LODRAT

Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e lodrave rregullohet nga akti ligjor i mëposhtëm:

Ligji nr. 9097, dt. 3.7.2003 " Për Vlerësimin e Konformitetit " i cili është në përputhje me Direktivën 88/378/EEC "Për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtarë mbi sigurinë e lodrave", amenduar me Direktivën 93/68/EEC.

Akti nënligjor i miratuar është :

VKM nr. 723 dt. 5.11.2004 "Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit".

2.2 Kuadri institucional

Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standarteve dhe Sigurimit Teknik në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës operon tashmë në fushën e lodrave. Kjo drejtori përgjigjet për adoptimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

3. Prioritetet

Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM "Per rregullat teknike dhe procedurat e vlersimit te konformitetit per Lodrat" i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 88/378/EEC "Për Lodrat", amenduar me Direktivën 93/68/EEC.

Prioritetet afatgjata

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatgjatë janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit te ri.

Iniciativat ligjore afatgjata

Për adresimin e prioritetëve afatgjata do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ndryshime ne VKM "Për rregullat teknike dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit për Lodrat", i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 88/378/EEC "Për Lodrat", amenduar me Direktivën 93/68/EEC.

3.3.2 Aktivitetet zbatuese afatgjata

Për adresimin e prioritetëve afatgjata do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e nje strukture implementuese;

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standarteve dhe Sigurimit Teknik;
Fushatë ndërgjegjësuese për konsumatorin dhe operatorët ekonomikë.

3.1.2.1.4 MATERIALET E NDËRTIMIT

Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Sektori i Ndërtimit mbështetet në disa akte ligjore që janë në fuqi.

Ligji "Për Produktet e Ndërtimit" nr. 9290, datë 07.10.2004, i cili është harmonizuar pjesërisht me Direktivën 89/106/EEC "Për Përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anetare lidhur me Produktet e Ndërtimit", përcakton kërkesat themelore që duhet të plotësojnë këto produkte dhe procedurat që duhen ndjekur për kontrollin e vlerësimit të konformitetit të produkteve që dalin në përdorim;

Ligji për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit nr.8402, dt.10.09.1998, ka për qëllim kryesor Disiplinimin e Projektimit, të Zbatimit dhe Kontrollit të Mbikqyrjes dhe Kolaudimit të Punimeve i shoqëruar edhe me Udhëzimet përkatëse të cilat plotësojnë më mirë qëllimin kryesor të ligjit;

Ligji "Për Vlerësimin e Konformitetit" nr. 9097, datë 03.07.2003, dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.323, datë 08.07.1999 "Për përgatitjen, përshtatjen dhe zbatimin e rregullave teknike dhe procedurat për vlerësimin e konformitetit me rregullat teknike dhe standardet".

VKM Nr. 68, dt. 15.02.2001 "Për miratimin e Standarteve dhe të Kushteve Teknike të Projektimit dhe Zbatimit të Punimeve të Ndërtimit"

Udhëzimi nr. 3, dt. 15.02.2001 "Për Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit";

Udhëzimi nr. 2, dt. 13.05.2005 "Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit.

2.2 Kuadri institucional

Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit, si institucion përgjegjës ka Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Ndërtimit dhe 12 degët e saj në Prefektura, e cila realizon kryesisht kontrollin nga pikëpamja urbanistike e ndërtimeve dhe nuk ka mjetet e nevojshme për realizimin e plotë të kontrollit të produkteve të ndërtimit.

2.3 Asistenca e huaj

Nëpërmjet programit të asistencës teknike Gjermane GTZ, është financuar projekti 'Për Këshillim' në kornizën ligjore për përmirësimin e normave, rregullave dhe kushteve teknike të projektimit dhe ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtesisë në ndërtesa, si dhe financim për përkthimin e standardeve europiane për agregatet e betonit.

Në projektin INTERREG III-A, Italia- Albania, është në proces financimi i programit "Teknikat Europiane" për sektorin e punëve publike (800000 euro).

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

MPPTT ka parashikuar të ndër marrë për periudhën afatshkurtër iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ndryshime në VKM nr. 68, datë 15.02.2001 "Për miratimin e Standarteve dhe të Kushteve Teknike të Projektimit dhe Zbatimit të Punimeve të Ndërtimit" me qëllim përafrimin e plotë me Direktivën 89/106/EEC;

Ndryshime në Ligjin nr. 9290, dt. 07.10.2004 "Për Produktet e Ndërtimit" me qëllim përafrimin e plotë me Direktivën 89/106/EEC.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Identifikimi i institucioneve të cilat duhet të plotësojnë kushte të nevojshme për krijimin e infrastrukturës së cilësisë;

Krijimi i Inspektoriatit të nevojshëm për Kontrollin e Rregullave Teknike dhe Standarteve.

Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ndryshime të detyruara nga ndryshime në kërkesat e standardeve ose të kushtëzuara nga kërkesa të reja të organizmave Europiane dhe ndërkombetare.

3.1.2.1.5 PËRPUTHSHMËRIA ELEKTROMAGNETIKE

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e përputhshmërisë elektromagnetike rregullohet nga akti ligjor i mëposhtëm:

Ligji nr. 9097, dt. 3.7.2003 " Për Vlerësimin e Konformitetit" i cili është në përputhje me Direktivën 89/336/EEC/EEC "Për përputhshmërinë elektromagnetike".

VKM nr. 723 dt. 5.11.2004 "Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit.

2.2 Kuadri institucional

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës është institucioni përgjegjës në lidhje me përputhshmërinë elektronagnetike. Aktualisht, pas riorganizimit të ministrive (bashkimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës), tashmë në këtë fushë operon Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standarteve dhe Sigurimit Teknik dhe Inspektoriati i Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike nën Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore.

1. Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut me Sektorin e Standarteve dhe Sigurimit Teknik përgjigjet për adoptimin e akteve nënligjore për projektimin, përdorimin, shfrytëzimin dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike.

2. Në kuadrin e Drejtorisë së Mbikqyrjes së Tregut funksionon edhe Inspektoriati i Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike i cili është institucion përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të rregullave, që garantojnë sigurinë e punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike në veprimtarinë e personave juridik e fizik.

IPIE është organizuar dhe funksionon në bazë të VKM nr. 494, dt. 14.8.2001 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoriatit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike".

IPIE përbëhet nga kryeinspektori dhe inspektorët në qendër, që përbëjnë nivelin qendror të organizimit dhe inspektorët e zonave brenda juridiksionit të një qarku, të cilët përbëjnë nivelin vendor të organizimit.

Aktualisht veprojnë 14 inspektorë zonë të vendosur në këto prefektura ; Tiranë, Bashkia e Tiranës, Durrës, Shkodër, Dibër, Korçë, Elbasan, Fier, Vlorë, Lezhë, Berat, Kukës dhe Gjirokastrë.

IPIE është përgjegjës për :

- miratimin e projekteve elektrike me fuqi të instaluar mbi 20 kë;
- inspektimin e subjekteve që kryejnë veprimtari me paisje dhe instalime elektrike;
- heqjen nga tregu të pajisjeve dhe instalimeve elektrike të pasigurta.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM "Për Përputhshmërinë Elektromagnetike" i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivat 89/336/EEC, 92/31/EC, 93/68/EEC, 2004/108 EC për përputhshmërinë elektromagnetike.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e një strukture implementuese;

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standarteve dhe Sigurimit Teknik;

Fushatë ndërgjegjësuere për konsumatorin dhe operatorët ekonomik.

3.1.2.1.6 MAKINERITË

Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e makinerive rregullohet nga akti ligjor i mëposhtëm:

Ligji nr. 9097, dt. 3.7.2003 " Për Vlerësimin e Konformitetit " i cili është në përputhje me Direktivën 98/37/EC "Për Makineritë", amenduar nga 98/79/EC.

Rregullorja mbi makineritë aprovuar nga MIE në vitin 2003, adoptimi i Direktivës 89/392/EEC, amenduar nga Direktiva 91/368/EEC, 93/44/EEC dhe 93/68/EEC.

2.2 Kuadri institucional

Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standarteve dhe Sigurimit Teknik në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës operon tashmë në fushën e makinerive. Kjo drejtori përgjigjet për adoptimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përfrimit të ri e të vjetër.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM "Per Makinerite" i cili do te perafrohet pjeserisht me Direktiven 98/37/EC "Per Makinerite", amenduar nga 98/79/EC

Ndryshime ne VKM "Per Makinerite" i cili do te perafrohet plotesisht me Direktiven 98/37/EC "Per Makinerite", amenduar nga 98/79/EC

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e një strukture implementuese;

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standarteve dhe Sigurimit Teknik;

Fushatë ndërgjegjësuere për konsumatorin dhe operatorët ekonomikë.

3.1.2.1.7 PAJISJET E MBROJTJES PERSONALE

2. Situata aktuale

Kuadri ligjor

Fusha e pajisjeve mbrojtëse vetjake rregullohet nga akti ligjor i mëposhtëm:

Ligji nr. 9097, dt. 3.7.2003 " Për Vlerësimin e Konformitetit " i cili është pjesërisht i përputhur me Direktivën 89/686/EEC "Mbi përshtatjen e direktivës europiane mbi kërkesat teknike dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit për pajisjet mbrojtëse vetjake (PMV)".

2.2 Kuadri institucional

Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standarteve dhe Sigurimit Teknik në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës operon tashmë në fushën e pajisjeve mbrojtëse vetjake. Kjo drejtori përgjigjet për adoptimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përfrimit të ri e të vjetër.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM "Mbi kërkesat teknike dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit për pajisjet mbrojtëse vetjake (PMV)" i cili do të përfaqësohet pjesërisht me Direktivën 89/686/EEC "Mbi sigurinë për pajisjet mbrojtëse vetjake";

Ndryshime ne VKM "Mbi kërkesat teknike dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit për pajisjet mbrojtëse vetjake (PMV)", i cili do të përfaqësohet plotësisht me Direktivën 89/686/EEC "Mbi sigurinë për pajisjet mbrojtëse vetjake".

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:
Ngritja e një strukture implementuese;
Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standarteve dhe Sigurimit Teknik;
Fushatë ndërgjegjësuere për konsumatorin dhe operatorët ekonomikë.

3.1.2.1.8 PAJISJET ME GAZ

2.Situata aktuale

Kuadri ligjor

Fusha e pajisjeve me gaz rregullohet nga akti ligjor i mëposhtëm:

Ligji nr. 9097, dt. 3.7.2003 " Për Vlerësimin e Konformitetit" i cili është pjesërisht i përputhur me Direktivën 90/396/EEC, amenduar 93/68/EEC "Mbi pajisjet me gaz".

VKM nr. 426 dt. 26.6.2003 " Për miratimin e rregullave teknike në zbatim të Direktivave 90/396/EEC dhe 93/68/EEC" të Bashkimit Europian për futjen në treg, qarkullimin e lirë dhe vërtetimin e konformitetit të pajisjeve që punojnë me lëndë djegëse të gazta".

2.2 Kuadri institucional

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës është institucioni përgjegjës për pajisjet me gaz. Aktualisht, pas riorganizimit të ministrive (bashkimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës), tashmë në këtë fushë operon Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standarteve dhe Sigurimit Teknik dhe Inspektoriati i Pajisjeve nën presion, nën Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore.

1. Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut me Sektorin e Standarteve dhe Sigurimit Teknik përgjigjet për adoptimin e akteve nënligjore për projektimin, përdorimin, shfrytëzimin dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike;

2. Në kuadrin e Drejtorisë së Mbikqyrjes së Tregut funksionon edhe Inspektoriati i Pajisjeve nën presion i cili është përgjegjës për mbikqyrjen e tregut. IPNP zhvillon veprimtarinë e tij në bazë të VKM nr. 497, dt. 14.8.2001 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoriatit të Pajisjeve nën Presion".

IPNP është përgjegjës për :

- kontrollin e plotësimit të kërkesave të sigurisë të pajisjeve nën presion;
- miratimin e projektit të vendosjes së kaldajave dhe të enëve nën presion stacionare;
- inspektimi i subjekteve që kryejnë veprimtari me pajisje nën presion;
- heqjen nga tregu të pajisjeve të pasigurta.

IPNP përbëhet nga Kryeinspektori, inspektorët e qendrës dhe 10 inspektorë të zonave, të vendosur në këto prefektura : Tiranë, Durrës, Shkodër, Dibër, Korçë, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Bashkia Ballsh.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ndryshime në VKM nr. 426 dt. 26.6.2003 " Për miratimin e rregullave teknike në zbatim të direktivave 90/396/EEC dhe 93/68/EEC të Bashkimit Europian për futjen në treg, qarkullimin e lirë dhe vërtetimin e konformitetit të pajisjeve që punojnë me lëndë djegëse të gazta" me qëllim përafrimin e pjesshëm me Direktivën 90/396/EEC, 93/68 "Për pajisjet me gaz".

3.2Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ndryshime në VKM r. 426 dt. 26.6.2003 "Për miratimin e rregullave teknike në zbatim të direktivave 90/396/EEC dhe 93/68/EEC të Bashkimit Europian për futjen në treg, qarkullimin e lirë dhe vërtetimin e konformitetit të pajisjeve që punojnë me lëndë djegëse të gazta" me qëllim harmonizimin e plotë me Direktivën 90/396/EEC, 93/68 "Për pajisjet me gaz".

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Fuqizimi i strukturës implementuese për P/Vendimin "Për enët nën presion";

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorin e Standarteve dhe Sigurimit Teknik;

Fushat e ndërgjegjësuere për konsumatorin dhe operatorët ekonomikë.

3.1.2.1.9 Mbi kërkesat për eficientë e boilerëve të rinj që punojnë me lëndë djegëse të lëngëta dhe të gazta

Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha që trajton kërkesat për eficientë e boilerëve të rinj që punojnë me lëndë djegëse të lëngëta dhe të gazta rregullohet nga akti ligjor i mëposhtëm:

Ligji nr. 9097, dt. 3.7.2003 "Për Vlerësimin e Konformitetit" i cili është pjesërisht i përputhur me Direktivën 92/42/EEC "Kërkesat e eficientë për boileret e ri që punojnë me lëndë djegëse të gazta e të lëngëshme" amenduar me direktivën 93/68 EEC, 2004/8/EC dhe 2005/32/EC.

2.2 Kuadri institucional

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës është institucioni përgjegjës në lidhje me kërkesat për eficientë e boilerëve të rinj që punojnë me lëndë djegëse të lëngëta dhe të gazta. Aktualisht, mbas riorganizimit të ministrive (bashkimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës), tashmë në këtë fushë operon Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standarteve dhe Sigurimit Teknik dhe Inspektoriati i Pajisjeve nën presion, nën Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore.

1. Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut me Sektorin e Standarteve dhe Sigurimit Teknik përgjigjet për adoptimin e akteve nënligjore për projektimin, përdorimin, shfrytëzimin dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike;

2. Në kuadrin e Drejtorisë së Mbikqyrjes së Tregut funksionon edhe Inspektoriati i Pajisjeve nën presion i cili është përgjegjës për mbikqyrjen e tregut. IPNP zhvillon veprimtarinë e tij në bazë të VKM nr. 497, dt. 14.8.2001 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoriatit të Pajisjeve nën Presion".

IPNP është përgjegjës për :

-kontrollin e plotësimit të kërkesave të sigurisë të pajisjeve nën presion;

-miratimin e projektit të vendosjes së kaldajave dhe të enëve nën presion stacionare;

-inspektimin e subjekteve që kryejnë veprimtari me pajisje nën presion;

-heqjen nga tregu të pajisjeve të pasigurta.

IPNP përbëhet nga Kryeinspektori, inspektorët e qendrës dhe 10 inspektorë të zonave, të vendosur në këto prefektura : Tiranë, Durrës, Shkodër, Dibër, Korçë, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Bashkia Ballsh.

3.Prioritetet

3.1Prioritetet afatmesme

*Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:
Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;*

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përfrimit të ri e të vjetër.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM "Mbi kërkesat për eficientë e boilerëve të rinj që punojnë me lëndë djegëse të lëngëta dhe gazta" i cili do të përfaqësohet pjesërisht me Direktivën 92/42/EEC, amenduar me direktivën 93/68 EEC, 2004/8/EC, 2005/32/EC.

Prioritetet afatgjata

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatgjatë janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e

lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri.

Iniciativat ligjore afatgjata

Për adresimin e prioritetëve afatgjata do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ndryshime në VKM "Mbi kërkesat për eficensën e boilerëve të rinj që punojnë me lëndë djegëse të lëngëta dhe gazta" i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 92/42/EEC, amenduar me direktivën 93/68 EEC, 2004/8/EC, 2005/32/EC.

3.3.2 Aktivitetet zbatuese afatgjata

Për adresimin e prioritetëve afatgjata do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Fuqizimi I strukturës implementuese për zbatimin e vendimit;

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standarteve dhe Sigurimit Teknik;

Fushatë ndërgjegjësuese për konsumatorin dhe operatorët ekonomikë.

3.1.2.1.10 LËNDËT PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL

Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e eksplozivëve për përdorim civil rregullohet nga aktet ligjore të mëposhtme:

Ligji nr. 9126 dt. 29.07.2003 "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton procedurat, rregullat dhe përgjegjësitë e administratës shtetërore për prodhimin, përdorimin, kontrollin dhe mënyrën e tregimit të lëndëve plasëse për përdorim civil. Ky ligj është përafuar plotësisht me Direktivën 93/15/EEC "Për harmonizimin e dispozitave mbi hedhjen në treg dhe kontrollin e eksplozivëve për përdorim civil".

VKM nr. 597 dt. 10.09.2004 "Për procedurën për dhënien e lejes së importimit, eksportimit dhe prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil";

VKM nr. 853 dt. 17.12.2002 "Për procedurën për dhënien e lejes së importimit, eksportimit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike fishekzjarre për përdorim festiv";

Urdhëri i Ministrit të Mbrojtjes "Për miratimin e rregullores për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të dhënies së lejeve të importit të eksportit dhe prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil". Ky urdhër përcakton përbërjen e komisionit. Gjithashtu në këtë rregullore parashikohen të gjitha procedurat administrative të ushtrimit të kompetencave nga ky komision. Ministria e Mbrojtjes është organi kompetent për dhënien e lejeve të importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve plasëse si dhe të vjeljes së tarifave. Për këtë qëllim është ngritur Komisioni i Dhënies së Lejeve, një strukturë me 5 punonjës nga drejtori të ndryshme.

Urdhëri i përbashkët i MM dhe MF "Për tarifat financiare për dhënien e lejeve të import-eksportit dhe prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil". Ky urdhër përcakton tarifat të detajuara financiare për lejet e importit, eksportit apo prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil. Institucion përgjegjës për zbatimin e kësaj mase është gjithashtu Ministria e Mbrojtjes.

2.2 Kuadri institucional

- Ministria e Mbrojtjes është institucioni përgjegjës për lejimin e prodhimit, importimit dhe eksportimit të lëndëve plasëse për përdorim civil në Republikën e Shqipërisë. Për dhënien e këtyre lejeve MM ka krijuar Komisionin e Dhënies së Lejeve e cila është një strukturë ad-hoc e përbërë nga 5 punonjës të drejtorive të ndryshme. Në shërbim të këtij Komisioni funksionon një Sekretari Teknike, rolin e luan Sektori i Armë-Kontrollit në Drejtorinë e Politikave Mbrojtëse dhe Integruese ;

- Ministria e Brendshme është institucioni përgjegjës për transferimin, magazinimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse për përdorim civil.

- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është institucioni përgjegjës për përdorimin e lëndëve plasëse për përdorim civil.

Vetitë e lëndëve plasëse për përdorim civil testohen vetëm nga persona juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e kësaj veprimtarie, të pajisur me certifikatën e laboratorit të akredituar. Ata janë të detyruar t'i demonstrojnë Ministrisë së Mbrojtjes pajtimin me praktikën e laboratorit të akredituar.

3.1.2.1.11 Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të përdorshme në atmosfera potencialisht shpërthyes

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha që trajton Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të përdorshme në atmosfera potencialisht

shpërthyes rregullohet nga akti ligjor i mëposhtëm:

Ligji nr. 9097, dt. 3.7.2003 " Për Vlerësimin e Konformitetit " i cili është pjesërisht i përputhur me Direktivën 94/9/EC "Për Pajisjet dhe Sistemet Mbrojtëse të Përdorshme në Atmosfera Potencialisht Shpërthyes".

Rregullore: Për pajisjet elektrike që instalohen apo përdoren në mjedise minerare potencialisht eksplozive mbështetur në direktivën 76/117/EEC;

Rregullore : "Për pajisjet elektrike për përdorim në atmosfera potencialisht shpërthyes që kërkojnë tipe të caktuara mbrojtje mbështetur në direktivën 79/196/EEC;

Rregullore : "Për pajisjet elektrike që përdoren në atmosfera potencialisht eksplozive në minierat e ndjeshme ndaj gazit shpërthyes" mbështetur në direktivën 82/130/EEC.

2.2 Kuadri institucional

Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standarteve dhe Sigurimit Teknik në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës operon tashmë në fushën e pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse të përdorshme në atmosfera potencialisht shpërthyes. Kjo drejtori përgjigjet për adoptimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

3. Prioritetet

3.2 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafërimit të ri e të vjetër.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM " Për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të përdorshme në atmosfera potencialisht shpërthyes" i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 94/9/EC

Ndryshime në VKM " Për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të përdorshme në atmosfera potencialisht shpërthyes" i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 94/9/EC

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e një strukture implementuese;

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standarteve dhe Sigurimit Teknik;

Fushatë ndërgjegjëse për konsumatorin dhe operatorët ekonomikë.

3.1.2.1.12 ASHENSORËT

Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e ashensorëve rregullohet nga legjislacioni i mëposhtëm:

Ligji nr. 9097, dt. 3.7.2003 " Për Vlerësimin e Konformitetit " i cili është pjesërisht i përputhur me Direktivën 95/16/EEC "Për Ashensorët".

VKM nr. 723, datë 05.11.2004 "Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmave të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit".

2.2 Kuadri institucional

Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standarteve dhe Sigurimit Teknik në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës operon tashmë në fushën e Ashensorëve. Kjo drejtori përgjigjet për adoptimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafërimit të ri.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM " Për Ashensorët " i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 95/16/EEC "Për Ashensorët".

3.2 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ndryshime në VKM " Për Ashensorët " i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 95/16/EEC "Për Ashensorët".

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e një strukture implementuese;

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standarteve dhe Sigurimit Teknik;

Fushat ndërgjegjësuere për konsumatorin dhe operatorët ekonomik.

3.1.2.1.13 PAJISJET MJEKËSORE

2.Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e pajisjeve mjekësore rregullohet nga legjislacioni i mëposhtëm:

Ligji nr. 9097, datë 3.7.2003 " Për vlerësimin e konformitetit " i cili është bazuar në Traktatin që themelon Komunitetin Evropian, Titulli I "Lëvizja e Lirë e Mallrave", nenet 23-31, neni 100.

VKM nr. 723, datë 05.11.2004 "Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmave të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit".

2.2 Kuadri institucional

Ministria e Shëndetësisë është institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë në lidhje me pajisjet mjekësore. Ajo funksionon në bazë të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave".

Aktualisht në Ministrinë e Shëndetësisë funksionojnë këto organe përgjegjëse për kontrollin e pajisjeve mjekësore:

Drejtoria Spitalore dhe Sektori i Stomatologjisë- liçenson importimin e pajisjeve mjekësore;

Komisioni i Liçensimit-liçenson aktivitetet për importimin dhe tregtimin me shumicë të pajisjeve mjekësore;

Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet-kontrollon burimet e radiacionit jonizues;

Njësia për Standardizim dhe Menaxhim e Pajisjeve Mjekësore në Ministrinë e Shëndetësisë

2.3 Asistenca teknike

Sistemi shëndetësor shqiptar është mbështetur nga programe me financim të huaj nëpërmjet projekteve të ndryshme, komponentet kryesore të të cilave kanë qenë rehabilitimi i infrastrukturave, pajisje mjekësore dhe jo mjekësore, zhvillim kapacitetesh, etj.

Projekti që është aktualisht në zbatim lidhet me "Forcimin e sistemit të menaxhimit dhe mirëmbajtjes në shërbimin shëndetësor shqiptar" financuar nga SIDA (Swedish International Development Cooperation Agency) me një shumë prej 3.3 milionë Euro.

3. Prioritetet

3.1Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ligj "Për pajisjet mjekësore", përafrohet plotësisht me Direktivën 90/385/EEC, Direktivën 93/42/EC dhe Direktivën 98/79/EC.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Përgatitja e termave të referencës për Njësinë e Menaxhimit të Standardeve ;

Hartimi i një plani veprimi për parashikimin e aktivitetëve dhe masave në kuadrin e ligjit;

Hartimi i një strategjie për pajisjet mjekësore.

3.2 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM “Për zbatimin e ligjit për pajisjet mjekësore” i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 90/385/EEC, Direktivën 93/42/EC dhe Direktivën 98/79/EC .

3.1.2.1.14 BARNAT PËR PËRDORIM NJERËZOR

2.Situata aktuale

Kuadri ligjor

Fusha e barnave rregullohet nga legjislati i mëposhtëm:

Ligji nr. 9323, datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" pjesërisht i përafrohet me Direktivën 2001/83/EC dhe "Kodin Komunitar në lidhje me produktet mjekësore me përdorim njerëzor".

VKM nr.52, datë 27.10.2005 "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Çmimeve të Barnave" plotësisht e përafrohet me Direktivën 89/105/EC, datë 21.12. 1988 "Mbi transparencën e masave që rregullojnë çmimet e barnave për përdorim njerëzor dhe përfshirja e tyre në sistemin kombëtar të sigurimeve shëndetësore" ;

VKM nr. 325, datë 14.6.1993 "Për regjimin e eksport-importit dhe prodhimin e barnave";

Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Ministrisë të Financave nr. 180, datë 13.8.1993 "Për bashkëpunim në regjimin e import – eksportit të barnave";

Urdhër i Ministrisë të Shëndetësisë nr.104, datë 5.3.2004 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 180, datë 13.8.1993 "Për bashkëpunimin në regjimin e import-eksportit të barnave dhe zhdoganimin e tyre";

Urdhër i Ministrisë të Shëndetësisë nr. 214, datë. 22.4.2004

Rregullore nr. prot. 399, datë 20.1.1998 "Për fabrikimin e barnave";

Rregullore e shërbimit farmaceutik nr. prot. 296, datë 26.1.1998.

2.2 Kuadri Institucional

Drejtoria Farmaceutike në Ministrinë e Shëndetësisë është institucioni përgjegjës për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e farmaceutikës.

Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave është institucion i specializuar për analizën, regjistrimin, kontrollin e barnave dhe inspektimin farmaceutik. Kontrolli i saj shtrihet mbi veprimtaritë, mjediset, pajisjet e fabrikimit; tregtimin me shumicë e pakicë, kushtet e ruajtjes së barnave dhe barnat e importuara. QKKB përbëhet nga Sektori i Regjistrimit, Sektori i Inspektimit, Sektori i Analizave, Sektori i Informacionit, Sektori i Farmakovigjilencës dhe Sektori i Administratës.

3. Prioritetet

3.1Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtëra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projekt VKM “Për importimin e barnave të paregjistruara dhe të barnave të dhuruara”, i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 2001/83/EC dhe Rregullore 141/2000/EC;

Projekt VKM “Për liçencimin e veprimtarive private në fushën e prodhimit dhe shërbimit farmaceutik”, i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 2001/83/EC dhe Direktivën 85/432/EEC;

Projekt VKM “Për strukturën dhe organizimin e kontrollit të barnave”, i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 2001/83/EC;

Projekt VKM "Për etiketimin e barnave" cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 2001/83/EC;

Projekt VKM "Për prodhimin dhe shpërndarjen e barnave" cili do të përafrohet plotësisht me

Direktivën 2001/83/EC dhe Direktivën 2003/94/ EC;

Projekturdhër i MSH "Për klasifikimin e barnave", i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 2001/83/EC;

Projekt rregullore e MSH "Për reklamen e barnave" e cila do të përafrohet plotësisht me Direktivën 2001/83/EC;

Projekt VKM "Për organizimin e Komiteteve të Etikës", i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 2001/20/EC;

Projekt rregullore "Për praktiken e mire klinike", e cila do të përafrohet plotësisht me Direktivën 2001/83/EC dhe Direktivën 2001/20/EC.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Përcaktimi i procedurave dhe formularëve për importimin e barnave të paregjistruara e të dhuruara;

Përcaktimi i procedurave të verifikimit të prodhimit e shërbimit farmaceutik;

Riorganizimi i strukturës së kontrollit të barnave;

Ripërcaktimi i funksioneve të kontrollit të barnave (sipas niveleve);

Njohja e fabrikuesve me rregullat e etiketimit të barnave & përcaktimi i kohës së zbatimit të rregullave;

Njohja e fabrikuesve me VKM dhe rregullat e praktikës së mirë të fabrikimit dhe vendosja e afteve për zbatimin e tyre;

Njoftimi i gjithë të interesuarve për klasifikimin e miratuar;

Njoftimi i të interesuarve për rregullat e reklamës dhe miratimi i formularëve të aplikimit për reklamë;

Organizimi i komiteteve të etikës mjekësore;

Rritja e kapaciteteve administrative nëpërmjet trajnimit të anëtarëve për njohjen e legjislacionit dhe praktikës së mirë klinike.

3.1.2.1.15 MATERIALET DHE TEKNOLOGJITË ME PËRDORIM TË DYFISHTË

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e materialeve dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë rregullohet nga aktet nënligjore të mëposhtme:

VKM nr.366, datë 5.10.1991 "Për krijimin e ndërmarrjes së import-eksportit në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes"

Urdhër nr.5, datë 8.1.2002 i Ministrit të Mbrojtjes "Për funksionimin e ndërmarrjes së import-eksportit të ushtrisë "MEICO" dhe marrëdhëniet e saj me drejtoritë dhe me komandat e Ministrisë së Mbrojtjes"

2.2 Kuadri institucional

Ministria e Mbrojtjes është duke përgatitur projektligjin "Për import-eksportin e materialeve ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë" i cili do të përcaktojë kushtet, afatet dhe procedurat për rregullimin e veprimtarisë së import-eksportit të këtyre mallrave dhe kontrollin shtetëror mbi këtë veprimtari.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafërimit të ri

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Ministria e Mbrojtjes ka parashikur të ndërmarrë iniciativën e mëposhtme ligjore për periudhën afatshkurtër

Projektligji "Për eksport-importin e materialeve ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë" i cili do të përafrohet plotësisht Rregulloren (EC)1334/2000

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Ministria e Mbrojtjes ka parashikur të ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme zbatuese për periudhën afatshkurtër :

Ngritja e nje Komiteti ndërmintor për kontrollin e import-eksportit të mallrave me përdorim të dyfishtë

3.1.2.1.16 PAJISJET FUNDORË TË RADIO-TELEKOMUNIKACIONIT

2 Situata Aktuale

2.1 Kuadri Ligjor

Fusha e pajisjeve fundore të Radio Telekomunikacionit rregullohet nga legjislacioni i mëposhtëm:

Ligji nr. 8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë" i cili është përafëruar pjesërisht me Direktivat mbi liberalizimin : 90/388/ECC, 88/301/ECC, 94/46/EC, 95/51/EC, 96/2/EC, 96/19/EC, Direktivat mbi rrjetin e hapur : 90/387/EEC, 97/51/EC, Direktivat mbi rregullimin e interkonjeksionit : 96/19/EC, 97/33/EC, Direktivat mbi liçensimin : 97/13/EC, 97/710/EC, Direktivat mbi numeracionin : 98/61/EC/, 91/396/EEC, 92/264/ECC dhe Direktivat mbi ruajtjen e fshehtësisë : 97/66/EC

VKM nr. 288, datë 18.6.1999 "Për miratimin e dokumentit të politikave të zhvillimit të sektorit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë"

2.2 Kuadri Institucional

Drejtoria e Përgjithshme e Postë Telekomunikacionit në Ministrinë e Punëve Publike, të Transportit dhe Telekomunikacionit është përgjegjëse për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e telekomunikacioneve, ndërsa Enti Rregullator i Telekomunikacionit mbikqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për telekomunikacionet dhe politika e zhvillimit të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafërimit të ri

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

MPPTT ka parashikur të ndërmarrë iniciativat e mëposhtme ligjore për periudhën afatshkurtër:

Amendimi i ligjit nr. 8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë" me qëllim përafërimit të plotë me Direktivën 1999/5/EC, të datës 9 Mars 1999 "Për pajisjet e radiove dhe për pajisjet fundore të telekomunikacionit dhe për njohjen e përbashkët të konformitetit të tyre"

Hartimi dhe miratimi i dokumentit të ri të politikës së zhvillimit të telekomunikacionit në Republikën e Shqipërisë i cili do të përafërjë plotësisht Direktivën 1999/5/EC, të datës 9 Mars 1999 "Për pajisjet e radiove dhe për pajisjet fundore të telekomunikacionit dhe për njohjen e përbashkët të konformitetit të tyre".

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

MPPTT ka parashikur të ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme zbatuese për periudhën afatshkurtër :

- Përforsimi i kapaciteteve të DPPT-së me synim kualifikimin e mëtejshëm të personelit në lidhje me këtë fushë.

3.1.2.1.17 MJETET DETARE DHE MJETET LUNDRUESE ARGËTUESE

Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e mjeteve lundruese argëtuese dhe pajisjeve detare është një fushë e re që aktualisht nuk rregullohet nga ndonjë akt ligjor apo nënligjor. Por studimi i parashikuar ka si qëllim plotësimin e kuadrit ligjor dhe përafërimit të këtij të fundit me legjislacionin evropian të identifikuar.

2.2 Kuadri institucional

Drejtoria e Politikave të Transportit Detar është njësia më e lartë e administratës detare, portuale dhe ujore e përfshirë në strukturën organizative të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe që varet nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Kjo Drejtori është përgjegjëse për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e transportit detar dhe misioni i saj përfshin të gjitha çështjet administrative, juridike,

ekonomike, financiare, teknike, sociale etj. në këtë fushë brenda kuadrit ligjor të kompetencave të kësaj Ministrie.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përfrimit të ri.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

MPPTT ka parashikur të ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme zbatuese për periudhën afatshkurtër:

Studim me qëllim identifikimin më të hollësishëm të legjislacionit evropian në këtë fushë dhe përfrimin e legjislacionit vendas me këtë të fundit.

3.1.2.1.18 SISTEMI HEKURUDHOR I SHPEJTËSISË SË LARTË

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e sistemit hekurudhor të shpejtësisë së lartë rregullohet nga aktet ligjore të mëposhtme:

Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë, aprovuar me ligjin nr. 9317, datë 18 Nentor 2004, i cili është bazuar në Traktatin "Për krijimin e Bashkimit Evropian", Titulli XII, Neni 129, në Memorandumin e Mirëkuptimit të Europës Jug-Lindore, nënshkruar më 11 qershor 2004 dhe është përfruar pjesërisht me Direktivën 91/440/EEC, e 29 shtatorit 1991.

2.2 Kuadri institucional ekzistues

Në zbatim të legjislacionit në fuqi Sektori i Politikave të Transportit Hekurudhor, pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit është njësi rregullatore e përgjithshme e aktivitetit tërësor të transportit hekurudhor. Drejtimet kryesore të punës të Sektorit janë:

Të hartojë dhe të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme politikat e zhvillimit të transportit hekurudhor në përputhje me zhvillimin aktual të ekonomisë kombëtare dhe të nevojave të popullatës për transportin e mallrave e të udhëtarëve, si për transportin e brendshëm ashtu dhe për transportin ndërkombëtar hekurudhor;

Të hartojë dhe të përmirësojë në vijimësi një legjislacionin sa më bashkëkohor e në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian, me synim nxitjen dhe menaxhimin optimal të transportit hekurudhor në përputhje me politikat sektoriale të hartuara;

Të ndjekë hartimin e studimeve të fizibilitetit dhe master-planeve për zhvillimin e transportit hekurudhor në tërësi dhe sipas zonave e Korridoreve të veçanta të transportit;

Të mbështesë, të inkurajojë dhe të favorizojë zhvillimin e trafikut tranzit duke i dhënë përparësi zhvillimit të transporteve multimodale në korridoret Lindje-Perëndim, Veri-Jug si dhe ato në drejtim të Kosovës;

Të marrë masat për mënjanimet e një konkurrence të pandershme;

Të përcaktojë politikat e përmirësimit të infrastrukturave ekzistuese të transportit hekurudhor dhe të zgjerimit e zhvillimit të infrastrukturave të reja;

Të monitorojë zbatimin e politikave dhe të bashkëpunojë me organet e pushtetit lokal për probleme specifike;

Të shqyrtojë dhe të ndjekë në tërësi problemet teknike të transportit hekurudhor që lidhen me gjëndjen aktuale të inventarit të mjeteve lëvizëse, të sistemeve të komunikimit e të sinjalizimit si dhe të ndjekë në vazhdimësi politikat e miratuara për ecurinë në këtë fushë.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si mëposhtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përfrimit të ri e të vjetër.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtëra

MPPTT ka parashikuar të realizojë brenda një periudhe afatshkurtër iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM' Per nderveprimin e sistemit hekurudhor me shpejtesi te larte' me qellim përafrimin e pjesshem me Direktivën 96/48/EC

VKM 'Per nderveprimin e sistemit hekurudhor me shpejtesi te larte' me qellim përafrimin e pjesshem me Direktivën 2004/50/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e 29 prillit 2004 .

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

MPPTT ka parashikur të ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme zbatuese për periudhën afatshkurtër:

Studim me qëllim identifikimin më të hollësishëm të legjislacionit evropian në këtë fushë dhe përafrimin e legjislacionit vendas me këtë të fundit.

3.1.2.1.19 PAKETIMI DHE PAKETIMI I MBETJEVE

2.Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e paketimit dhe e mbeturinave të paketimit rregullohet nga akti ligjor i mëposhtëm:

Ligji nr. 9097, datë 3.7.2003 " Për vlerësimin e konformitetit " i cili është pjesërisht i përputhur me Direktivën 94/62/EEC "Për paketimin dhe mbeturinat e paketimit".

2.2 Kuadri Institucional

Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standardeve dhe Sigurimit Teknik në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, operon tashmë në fushën e paketimit dhe të mbeturinave të paketimit. Kjo Drejtori përgjigjet për adoptimin e akteve ligjore dhe nënligjore dhe në këtë fushë ajo bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Mjedisit.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si mëposhtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

3.1.1Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM "Për rregullat teknike dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit për paketimin dhe mbeturinat e paketimit" i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 94/62/EC, 2005/20EC "Për paketimin dhe mbeturinat e paketimit".

3.2 Prioritetet afatgjata

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatgjate janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri

3.2.1 Iniciativat ligjore afatgjata

METE ka parashikuar të ndërmarrë, për periudhën afatgjatë, iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ndryshime ne VKM 'Për rregullat teknike dhe procedurat e vlerësimit te konformitetit për paketimin dhe mbeturinat e paketimit" i cili do te përafrohet plotësisht me Direktivën 94/62/EC, 2005/20 EC për paketimin dhe mbeturinat e paketimit

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatgjata

METE ka parashikuar të ndërmarrë, për periudhën afatgjatë, aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e një strukture implementuese;

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standardeve dhe Sigurimit Teknik;

Fushatë ndërgjegjësuere për konsumatorin dhe operatorët ekonomikë.

3.1.2.1.20 INSTALIMET KABLLORE PËR TRANSPORT PERSONASH

Situata aktuale

Kuadri ligjor

Fusha e instalimeve kabllike për transport njerëzish rregullohet nga akti ligjor i mëposhtëm:

Ligji nr. 9097, datë 3.7.2003 " Për vlerësimin e konformitetit " i cili është pjesërisht i përputhur me Direktivën 2000/9/EEC "Për instalimet kabllike për transport njerezish".

2.2 Kuadri institucional

Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standardeve dhe Sigurimit Teknik ne Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës operon tashme në fushën e instalimeve kabllike për transport njerëzish. Kjo Drejtori përgjigjet për adoptimin e akteve ligjore dhe nënligjore dhe në këtë fushë ajo bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si mëposhtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM “Për instalimet kabllike për transport njerëzish” i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 2000/9/EC për instalimet kabllike për transport njerezish.

3.2 Prioritetet afatgjata

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatgjatë janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatgjata

METE ka parashikuar të ndërmarrë, për periudhën afatgjatë, iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ndryshime ne VKM “Për instalimet kabllike për transport njerëzish ” i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 2000/9/EC për instalimet kabllike për transport njerezish.

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatgjata

METE ka parashikuar të ndërmarrë, për periudhën afatgjatë, aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e një strukture implementuese;

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standardeve dhe Sigurimit Teknik;

Fushatë ndërgjegjësuere për konsumatorin dhe operatorët ekonomikë.

3.1.2.1.21 EFIÇENSA ENERGIJTIKE E PAJISJEVE FRIGORIFERIKE, NDRIÇIMIT FLUORESHENT DHE ETIKETIMI I PAJISJEVE ELEKTROSHTËPIAKE

Situata aktuale

Kuadri ligjor

Fusha e efencës e energjise se paisjeve frigoriferike, ndricimit floreshent dhe etiketimi i paisjeve elektroshtepiake, rregullohen nga aktet ligjore te meposhtme :

Ligji 9097, date 3.7.2003 “Per Vlersimin e Konformitetit” i cili eshte pjeserisht i perputhur me Direktiven 96/57/EEC “Per Eficencen e Energjitike te Paisjeve Frigoriferike”, amenduar me 86/594/EEC; pjeserisht i perputhur me direktiven 2000/55/EC, “Kerkesat per Eficence per Ndricimin Floreshent”; pjeserisht I perputhur me direktiven 92/75/EC Per” Etiketimin e Paisjeve Elektroshtepiake”.

2.2 Kuadri Institucional

Drejtoria e Mbikqyrjes se Tregut (DMT) me Sektorin e Standardeve dhe Sigurimit Teknik ne Ministrine e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes operon tashme ne fushen e efencences energjetike te paisjeve frigoriferike ndricimit floreshent dhe etiketimit te paisjeve elektroshtepiake.

Kjo Drejtori pergjigjet per adoptimin e akteve ligjore e nenligjore.

3 Prioritetet

3.1 Prioritetet afatmesme

Prioritet e percaktuara per Qeverine shqiptare per periudhen afatmesme jane si me poshte:

Te sigurohen kapacitetet administrative per permbushjen e kerkesave MSA-se ne fushen e levizjes se lire te mallrave

Te shenohet progres ne transpozimin e direktivave te perafimit te ri e te vjeter.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Per adresimin e prioriteteve afatmesme do te ndermerren iniciativat e meposhtme ligjore:

-VKM "Per paisjet frigorifetike" i cili do te perafrohet pjeserisht me Direktiven 96/57/EEC "Per Eficencen e Energjitike te Paisjeve Frigoriferike", amenduar me 86/594/EEC.

-VKM "Per eficencen e energjise per ndricimin floreshent" i cili do te perafrohet pjeserisht me Direktiven 2000/55/EC "Eficenca e energjise per ndricimin floreshent",

-VKM "Per etiketimin e paisjeve elektroshtepiake" I cili do te perafrohet pjeserisht me Direktiven 92/75/EC

-Ndryshime ne VKM "Per paisjet frigoriferike" i cili do te perafrohet plotesisht me Direktiven 96/57/EEC "Per Eficencen e Energjitike te Paisjeve Frigoriferike", amenduar me 86/594/EEC.

-Ndryshime ne VKM "Per eficencen e energjise per ndricimin floreshent" I cili do te perafrohet pjeserisht me Direktiven 2000/55/EC "eficenca e energjise per ndricimin floreshent",

-Ndryshime ne VKM "Per etiketimin e paisjeve elektroshtepiake" I cili do te perafrohet pjeserisht me Direktiven 92/75/EC

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Per adresimin e prioriteteve afatmesme do te ndermerren aktivitetet e meposhtme zbatuese;

Ngritja e nje structure implementuese;

Fuqizimi I kapaciteteve te Sektorit te Standardeve dhe Sigurimit Teknik

Fushate ndergjegjuesore per konsumatorin dhe operatoret ekonomik

INSTRUMENTET E PESHIMIT JO-AUTOMATIK (NAWI)

DIREKTIVAT PER INSTRUMENTET MATES (MID)

2.Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e instrumenteve te peshimit jo-automatike rregullohet nga legjislacioni i mëposhtëm:

Ligji nr. 9097, dt. 3.7.2003 " Për Vlerësimin e Konformitetit " i cili është pjesërisht i përputhur me Direktivën 95/16/EEC

Ligji nr 8996 date 30.01.2003 "Përnjesite e matjes dhe kontrollin e mjeteve matese metrologjine".

VKM nr. 723, datë 05.11.2004 "Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmave të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit".

2.2 Kuadri institucional

Drejtoria e Pergjitheshme e Metrologjise dhe Kalibrimit (DPMK), ne varesi te Ministrit te Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes operon tashme në fushën e instrumenteve te peshimit jo-automatike dhe te instrumenteve mates. DPMK përgjigjet për adoptimin e akteve nënligjore per vlerësimin e konformitetit të instrumenteve mates si dhe te instrumenteve te peshimiti jo-automatik te peshimit si dhe per survejimin ne treg te tyre.

2.3 Asistenca teknike

Konsulenca e huaj per pergatitjen e VKM "Kerkesat teknike dhe proecdurat e vleresimit te konformitetit te instrumenteve te peshimiti jo-automatike" mundesohet nga Zyra Ceke per Standartet, metrologjine dhe Testimin (COSMT) ne kauder te proejktit bilateral "Asistence per administraten shtetore Shqiptare per Harmonizimin Teknik". Asistenca teknike per blerjen e etaloneve refernce per fushen e matjeve te mases sigurohet nga Projekti CARDS 2003 "Metrologjia ne Shqiperi".

Asistenca teknike per adaptiomin e Direktives per Instrumentet Mates, per disa nga kategorie qe mbulon kjo direktive do te sigurohet nga Projekti bilateral me Institutin Gjerman te Metrolgojise (PTB) Promovim i Infrastruktures se metrologjise ne Shqiperi". Kjo asistence do te konsistoje ne pergatitje te aktit ligjor, te fuqizimit te infrastruktures dhe te aktivitetve ndergjegjesuese per operatoret ekonomike.

3 Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM " Për kërkesat teknike dhe procedurat e vleresimit të konformitetit të instrumenteve të peshimit jo-automatik", i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 90/384/EEC "Për Instrumentet jo-automatike të peshimit (NAWI).

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Per adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Permiresimi dhe fuqizimi i infrastruktures së degeve të kontrollit të mjeteve matëse (tri dege): studim, trajnim stafi teknik, blerje pajisjesh

Përmirësimi i struktures dhe skemes organizative të DPMK-se, ngritja e struktures së supervizionit metrologjik, trajnimi i stafit teknik

Pjesmarrje në aktivitetet teknike Grupeve të Punes të WELMEC me statusin vëzhgues, si dhe në Komitetet teknike të EUROMET

Përgatitja e Urdhërësës së DPMK lidhur me mënyrën e kryerjes së supervizionit metrologjik

Aktivitet ndërgjegjësues me palet e interesuara për Direktivën e Perqasjes së Re Instrumenteve jo-automatike të Peshimit.

Ngritja e nivelit të etaloneve kombëtare për fushën e matjeve të masës

3.2 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM " Për Instrumentet matëse", i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 2004/22 "Direktivat për Instrumentet matëse" .

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Fushatë ndërgjegjësuere për konsumatorin dhe operatorët ekonomik.

Permiresimi dhe fuqizimi i infrastruktures së degeve të kontrollit të mjeteve matëse (tre dege): studim, trajnim stafi teknik, blerje pajisjesh

Pjesmarrje në aktivitetet teknike Grupeve të Punes të WELMEC me statusin vëzhgues, si dhe në Komitetet teknike të EUROMET

Aktivitet promovues për metrologjinë në nivel kombëtar

Ndërtimi i qendres së re kombëtare metrologjike

Ngritja e nivelit të etaloneve kombëtare për fushat e matjeve të masës, elektrikut, temperaturës, presionit dhe volumit si dhe fushat e tjera prioritare.

3.1.2.2 DIREKTIVAT E PËRAFRIMIT TË VJETËR

3.1.2.2.1 MALLRAT USHQIMORE

Shih informacionin tek Siguria ushqimore , Politika Bujqësore

3.1.2.2.2 MJETET MOTORIKE

Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e mjeteve motorike rregullohet nga akti ligjor i mëposhtëm:

Ligji nr. 8378, datë 22.7.1998 « Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar dhe i përafëruar pjesërisht me Direktivat 91/439/EEC, 96/53/EC, 96/96/EC ;

Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar;

Marrëveshja Evropiane për Transportin Nderkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR) dhe protokollin e nënshkrimit, miratuar me ligjin 9272, datë 16.09.2004;

Marrëveshja Evropiane në lidhje me adoptimin e kushteve uniforme për inspektimet teknike periodike të mjeteve motorike dhe njohja reciproke e inspektimeve të tilla e 13 Nëntorit 1997,

ratifikuar me ligjin nr. 9273, datë 16.09.2004.

Rregullorja në zbatim të Kodit Rrugor VKM nr. 153, datë 4.7.2000, i ndryshuar;

Urdheresa e KM nr. 1, datë. 21.08.1998 " Për rregullat e klasifikimit, emërimit dhe transportit rrugor të mallrave të rrezikshme";

Udhëzimi i MPPTT nr. 3551, datë 23.07.2003 "Mbi procedurat e pranimit dhe regjistrimit të mjeteve rrugore";

Udhëzimi i MPPTT nr. 4447, datë 23.09.2003 " Mbi qarkullimin e mjeteve jashtë norme";

Udhëzimi i MPPTT nr. 3413, datë 16.07.2003 "Për kontrollin teknik të mjeteve rrugore";

Udhëzimi i MPPTT nr. 5167, datë 26.12.2002 " Mbi organizimin e qarkullimit dhe sinjalizimit rrugor";

Udhëzimi i MPPTT nr. 994, datë 12.03.2003 " Për organizimin dhe funksionimin e autoshkollave";

Udhëzimi i MPPTT "Për Transportin Rrugor të Mallrave të Rrezikshme";

Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë të MPPTT dhe Ministrisë të Mjedisit nr. 6527, datë 24.12.2004 "Mbi vlerat e lejuara të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre";

Urdhëri i Kryeministrit nr. 44, datë 24.3.2006 " Për zbatimin e objektivave për përmirësimin e sigurisë rrugore";

2.2 Kuadri institucional

Institucioni përgjegjës për këtë fushë është Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe më konkretisht Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore.

Misioni dhe detyrat funksionale të Drejtorisë burojnë nga legjislacioni bazë në fushën e sigurisë së transportit rrugor dhe ndotjes së ambjentit nga mjetet. Kjo Drejtori harton politika të zhvillimit sektorial të konkretizuara në programin e objektivave vjetore, afatshkurtra dhe afatmesme.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurter janë si mëposhtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafërimit të ri e të vjetër.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

MPPTT ka parashikuar të ndërmarrë, për periudhën afatshkurter, iniciativat e mëposhtme ligjore:

Studim me qëllim identifikimin më të hollësishëm të legjislacionit evropian në këtë fushë dhe përafërimit të legjislacionit vendas me këtë të fundit;

Përfundim i kapaciteteve të DQSR me synim kualifikimin e mëtejshëm të personelit në lidhje me këtë fushë.

3.1.2.2.3 QELQI

Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e qelqit rregullohet nga akti ligjor i mëposhtëm :

Ligji nr. 9097, datë. 3.7.2003 " Për vlerësimin e konformitetit" i cili është pjesërisht i përafëruar me Direktivën 69/493/EEC "Lidhur me xhamin e kristaltë "

Ligji nr. 8739, datë 12.12.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve nën presion ».

Aktet nënligjore të miratuara janë :

VKM nr. 497, datë 14.8.2001 " Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të enëve nën presion".

Rregullore "Për enët e thjeshta nën presion", date 24.12.2002

Rregullore " Mbi Projektimin, Prodhimin dhe Vlerësimin e Konformitetit të Paisjeve Në Presion ", date 24.12.2002

2.2 Kuadri institucional

Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standardeve dhe Sigurimit Teknik në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës operon tashmë në fushën e qelqit. Kjo rejtore përgjigjet për adoptimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si mëposhte:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përfrimit të ri e të vjetër.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM 'Për xhamin e kristalte' i cili do të jetë pjesërisht i përfruar me Direktivën 69/493/EEC "Lidhur me xhamin e kristalte" ;

Ndryshime ne VKM "Për xhamin e kristalte" i cili do të jetë plotësisht i përfruar me Direktivën 69/493/EEC "Lidhur me xhamin e kristalte "

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e një strukture implementuese;

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standardeve dhe Sigurimit Teknik;

Fushatë ndërgjegjëse për konsumatorin dhe operatorët ekonomikë.

3.1.2.2.4 TEKSTILET

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e tekstileve rregullohet nga akti ligjor i mëposhtëm:

Ligji nr. 9097, datë. 3.7.2003 " Për vlerësimin e konformitetit " i cili është pjesërisht i përputhur me Direktivën 96/74/EEC mbi emërtimin e fijeve tekstile dhe termave të etiketimit, Direktivën 97/73/EEC mbi analizën sasiore të përzierjeve dyshe", Direktivën 73/44/EEC mbi analizën sasiore të përzierjeve të fijeve treshe".

2.2 Kuadri institucional

Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standardeve dhe Sigurimit Teknik në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës operon tashmë në fushën e tekstileve. Kjo rejtori përgjigjet për adoptimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si mëposhtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përfrimit të ri e të vjetër.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM "Për emërtimin e fijeve tekstile dhe termave te etiketimit" i cili do te jete pjesërisht i përfruar me Direktivën 96/74/EC, 97/37 EC

VKM " Mbi analizen sasiore te përzierjeve dyshe" i cili do te jete pjesërisht i përfruar me Direktivën Nr. 96/73/EEC

VKM "Mbi analizen sasiore te përzierjeve te fijeve treshe" i cili do te jete pjesërisht i përfruar me Direktivën Nr.73/44/EEC

Ndryshime ne VKM "Për emërtimin e fijeve tekstile dhe termave te etiketimit" i cili do te jete plotesisht i përfruar me Direktivën 96/74/EC, 97/37 EC

Ndryshime VKM "Mbi analizen sasiore te përzierjeve dyshe" i cili do te jete plotesisht i përfruar me Direktivën Nr. 96/73/EEC

Ndryshime VKM "Mbi analizen sasiore te përzierjeve te fijeve treshe" i cili do te jete plotesisht i përfruar me Direktivën Nr.73/44/EEC

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do te ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e një strukture implementuese;

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standardeve dhe Sigurimit Teknik;
Fushatë ndërgjegjësuere për konsumatorin , dhe operatorët ekonomikë.

3.1.2.2.5 KËPUCET

Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e këpuceve rregullohet nga akti ligjor i mëposhtëm:

Ligji nr. 9097, datë 3.7.2003 " Për vlerësimin e konformitetit " i cili është pjesërisht i përputhur me Direktivën 94/11/EEC "Për etiketimin e materialeve që përdoren në pjesët kryesore të këpucëve"

2.2 Kuadri institucional

Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standardeve dhe Sigurimit Teknik në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës operon tashmë në fushën e këpucëve. Kjo Drejtori përgjigjet për adoptimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

Prioritetet

3.1 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si mëposhte:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM 'Mbi etiketimin e materialeve të përbersave kryesor të kepuceve' i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 94/11/EC

Ndryshime në VKM "Mbi etiketimin e materialeve të përbersave kryesor të kepuceve" i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 94/11/EC

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e një strukture implementuese;

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standardeve dhe Sigurimit Teknik;

Fushatë ndërgjegjësuere për konsumatorin dhe operatorët ekonomikë.

3.1.2.2.6 DRURI

Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e drurit rregullohet nga akti ligjor i mëposhtëm:

Ligji nr. 9097, datë 3.7.2003 " Për vlerësimin e konformitetit " i cili është pjesërisht i përputhur me Direktivën 68/89/EEC " Mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me klasifikimin e drurit të papërpunuar".

2.2 Kuadri Institucional

Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standardeve dhe Sigurimit Teknik në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës operon tashmë në fushën e drurit. Kjo Drejtori përgjigjet për adoptimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

3. Prioritetet

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

METE ka ndërmarrë për periudhën afatshkurtër iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM 'Për klasifikimin e drurit të papërpunuar' i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 68/89/EEC " Mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me klasifikimin e drurit të papërpunuar".

3.2 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si mëposhtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ndryshime në VKM ' Për klasifikimin e drurit të papërpunuar' i cili do të përafrohet plotësisht

me Direktivën 68/89/EEC" Mbi përfrimin e ligjeve te shteteve anetare ne lidhje me klasifikimin e drurit te papëpunuar".

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do te ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e një strukture implementuese;

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standardeve dhe Sigurimit Teknik;

Fushatë ndërgjegjësuere për konsumatorin dhe operatorët ekonomikë.

3.1.2.2.7 KIMIKATET

2. Situata Aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e kimikateve rregullohet nga aktet ligjore të mëposhtme:

Ligji nr.9108, dt.17.07.2003 "Per substancat dhe preparatet kimike", mbështetur ne Konventen e Baselit " Per kalimin nderkufitar te mbetjeve te rrezikshme dhe asgjesimin e tyre" dhe Konventen e Stokholmit per Ndotsit Organike te Qendrueshem (POP-s)

Ligji nr.9263, datë 29.07.2004 "Për ratifikimin e Konventës "Ndotsit Organik te Qendrueshem (POPs)" (Konventa e Stockholmit)

Ligji nr.8934, dt.5.09.2002 "Per mbrojtjen e mjedisit"

VKM nr. 824, datë 11.12.2003 "Për klasifikimin, paketimin, etiketimin dhe ruajtjen e sigurtë të substancave dhe preparateve të rrezikshme" në përputhje me direktivën 1999/45/EC dhe 76/769/EEC.

VKM nr.26, datë 31.01.1994 "Për mbetjet e rrezikshme dhe mbeturinat".

VKM nr.447, datë 19.09.1994 "Për ndalimin e përdorimit të asbestit si material termoizolues në të gjitha llojet e ndërtimit".

VKM nr.447, datë16.09.1999 "Për shkatërrimin e mbetjeve toksike të magazinuara në depot e ushtrisë".

2.2 Kuadri institucional

Fusha e kimikateve, mbulohet në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave nga *Drejtoria e Politikave te Parandalimit të Ndotjes* e cila ka edhe kompetencen e hartimin te legjislacionit ne kete fushë.

Gjithashtu, *Instituti i Mjedisit* në varësi të MMP&AU eshte caktuar si Qender Kombetare Reference e Agjencise Europiane te Mjedisit per kimikatet.

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Enegjitikës, është përgjegjëse për regjistrimin e kimikateve që ekzistojnë në tregun shqiptar si dhe për menaxhimin i industrisë dhe kimikateve, kurse *Ministria e BujqesiseUshqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit* është përgjegjese për regjistrimin e pesticideve.

2.3 Asistenca teknike dhe financiare

Titulli i projektit është Përgatitja e Planit Kombëtar në zbatim të Konventës së Stocholmit "Ndotsit Organik te Qendrueshem (POPs)"; Instucioni drejtues: MMP&AU; Kohëzgjatja e projektit: 2005-2006; Donatori: UNDP/GEF; Buxheti: 378,400 USD; Objektivi: Për të forcuar aftësitë e Shqipërisë për të plotësuar detyrimet e saj nën Konventën e Stockholmit, përfshire përgatitjen e Planit Kombëtar të Zbatimit të POP-seve. Ky Plan do të përcaktojë burimet e POP-seve dhe rrugët për menxhimin e vendeve të ndotura prej tyre. Statusi: Projekti sapo ka filluar.

Titulli i projektit: Plan Kombëtar i nxjerrjes nga përdorimi i substancave ozon-holluese; Instucioni drejtues: MMP&AU; Kohëzgjatja e projektit: 2003-2009; Donatori: UNEP/UNIDO; Buxheti: 672,125 USD; Objektivi: Qëllimi kryesor i projektit është forcimi i kuadrit ligjor dhe institucional për realizimin e Planit Kombëtar për nxjerrjen jashte përdorimit të substancave ozon-holluese, duke zbatuar një sistem të liçencave sipas sasive.

3. Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurter janë si mëposhtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përfrimit të ri e të vjetër.

3.3.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Ministria e Mjedisit ka parashikuar për periudhën afatmesme realizimin e aktiviteteve të mëposhtme zbatuese:

Zbatimi i projektit të UNDP/GEF "Pergatitja e Planit Kombëtar në zbatim të konventës së Stokholmit për Ndotesit Organik të Qendrueshëm (POPs)

Krijimi i zyres së regjistrimit të kimikateve

Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si mëposhtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

Iniciativat ligjore afatmesme

MMP&AU ka parashikuar për periudhën afatmesme realizimin e iniciativës së mëposhtme ligjore:

Projekt akt "Për kufizimet në hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave dhe preparateve të rrezikshme" i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivat 76/769/EEC, 79/663/EEC, 82/806/EEC, 82/828/EEC, 83/264/EEC, 85/467/EEC, 85/610/EEC, 89/678/EEC, 89/677/EEC, 91/173/EEC, 91/338/EEC, 91/339/EEC, 94/27/EC, 94/48/EC, 94/60/EC, 97/16/EC, 97/56/EC, 1999/43/EC, 2001/41/EC, 2003/11/EC, 2003/34/EC, 2003/36/EC, 2003/53/EC.

3.3.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Ministria e Mjedisit ka parashikuar për periudhën afatmesme realizimin e aktiviteteve të mëposhtme zbatuese:

Funksionimi i zyres së regjistrimit të kimikateve

Trajnime të autoriteteve doganore

Funksionimi i zyres së regjistrimit të kimikateve

Trajnime të ARM-ve, inspektoreve të punës

Forcimi i kapaciteteve në DPPN/MMPAU

Prioritetet afatgjata

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatgjatë janë si mëposhtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

Iniciativat ligjore afatgjata

MMP&AU ka parashikuar për periudhën afatgjatë realizimin e iniciativës së mëposhtme ligjore:

Projekt akt 'Klasifikimi dhe paketimi i substancave të rrezikshme' i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivat 1999/45/EC, 2001/60/EC, 91/155/EEC, 93/112/EC

Projekt akt 'Për mbrojtjen nga asbesti' i cili përafrohet pjesërisht me Direktivën 87/217/EEC amenduar nga Direktiva 91/692

Projekt akt 'Transportimi i mallrave të rrezikshme' i cili përafrohet me Direktivat 94/55/EC, 2000/61/EC, 2003/28/EC, 2001/505/EC

Projekt akt 'Importi dhe eksporti i kimikateve të rrezikshme' i cili do të përafrohet pjesërisht me Rregulloret 304/2003, 1213/2003, 775/2004

Projekt akt 'Substancat aktive dhe NOQ-et' i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivat 79/117/EEC, 83/131/EEC, 85/298/EEC, 86/214/EEC, 86/355/EEC, 89/365/EEC, 90/335/EEC, 90/533/EEC, 91/188/EEC dhe me Rregulloren 850/2004

Projekt akt 'Për prodhimin dhe përdorimin e detergjenteve' i cili përafrohet pjesërisht me Direktivat 73/404/EEC e amenduar dhe Rregulloren (EC) No 648/2004

3.3.2 Aktivitetet zbatuese afatgjata

Ministria e Mjedisit ka parashikuar për periudhën afatgjatë realizimin e aktiviteteve të mëposhtme zbatuese:

Funksionimi i zyres së regjistrimit të kimikateve

Forcimi i kapaciteteve në DPPN/MMPAU

Funksionimi i zyres së regjistrimit të kimikateve

Forcim kapacitetesh ne DPPN/MMPAU
Funksionimi i zyres se rregjistrimit te kimikateve
Forcim kapacitetesh ne DPPN/MMPAU
3.1.2.2.8 DETERGJENTET

Situata Aktuale

2.1 Kuadri Ligjor

Fusha e detergjentëve rregullohet nga akti ligjor i mëposhtëm:

Ligji nr. 9097, datë 3.7.2003 " Për vlerësimin e konformitetit" i cili është përafshuar pjesërisht me Direktivat 73/404/EEC, 73/405 EEC, 82/242/EEC, 82/243/EEC "Për Detergjentët"

2.2 Kuadri Institucional

Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Standardeve dhe Sigurimit Teknik në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës operon tashmë në fushën e detergjentëve. Kjo Drejtori përgjigjet për adoptimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si mëposhtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafritit të ri e të vjetër.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM 'Për Detergjentet' i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivat 73/404/EEC, 73/405 EEC, 82/242/EEC, 82/243/EEC "Për Detergjentet"

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e një strukture implementuese;

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standardeve dhe Sigurimit Teknik;

Fushatë ndërgjegjësuese për konsumatorin dhe operatorët ekonomikë.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatgjata

METE ka parashikuar të ndermarre për periudhën afatgjatë iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ndryshime ne VKM 'Për detergjentet' i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivat 73/404/EEC, 73/405 EEC, 82/242/EEC, 82/243/EEC "Për Detergjentet"

3.1.2.2.9 PLEHRAT KIMIKE

Situata Aktuale

2.1 Kuadri Ligjor

Fusha e plehrave kimike rregullohet nga akti ligjor i mëposhtëm:

Ligji nr.8531, datë 23.09.1999 "Për shërbimin e kontrollit të plehrave kimike" pjesërisht i përafshuar me Direktivat 97/63/EC" amenduar nga direktivat 76/116/EEC, 89/284/EEC dhe 89/530/EEC në lidhje me përafritimin e ligjeve të Vendeve Antare mbi plehrat kimike.

VKM, nr. 234 datë 11.05.2000 "Për kriteret dhe rregullat e marrjes së mostrave dhe vlerësimit të plehrave kimike".

VKM nr. 253 datë 18.05.2000 "Për organizimin e shërbimit të kontrollit të plehrave kimike".

VKM nr. 233 datë 11.05.2000 "Për mbështetjen e shërbimit të kontrollit të plehrave kimike nga organet e ruajtjes së rendit".

Rregullore "Për funksionimin e shërbimit të kontrollit të plehrave kimike dhe për kushtet e ruajtjes dhe magazinimit të plehrave kimike.

2.2 Kuadri Institucional

Shërbimi i Kontrollit të Plehrave Kimike (SHKPK), i cili është në varësi të Institutit të Studimit të Tokave (në MBU) dhe është organizuar dhe funksionon në përputhje me VKM nr. 253, datë 18.05.2000.

SHKPK kryen kontrole për vlerësimin e cilësisë së plehrave kimike, përpara hedhjes së tyre në treg dhe gjatë tregtimit, për të garantuar mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe mjedisit si dhe interesat ekonomike të fermerëve.

Në bazë të VKM të mësipërme, SHKPK financohet pjesërisht nga buxheti i shtetit dhe ky

financim mbulon vetëm pagën e Administratorit. Pjesa tjetër e strukturës organizative financohet nga të ardhurat që krijohen nga veprimtaria e SHKPK.

Laboratori Analitik, në varësi të Institutit të tokave është përgjegjës për analizimin e mostrave të marra prej inspektoreve. Ky laborator kryen analiza për tokat, ujërat dhe plehrat kimike. MBU planifikon ndarjen e Laboratorit të Pleherave Kimike nga Laboratori Analitik dhe vendosjen e tij në varësi të SHKPK.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si mëposhtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafritit të ri e të vjetër.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Instituti i Studimit të Tokave parashikon të ndërmarrë për periudhën afatshkurtër iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM "Për standartet, etiketimin dhe paketimin e plehrave kimike, mbrojtjen e konsumatorit, barrierat teknike" i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivat 97/63/EEC, 89/284/EEC, 89/530/EEC, Rregulloren (EC) 2003/2003;

VKM "Mbi vendosjen e rregullave për regjistrimin e plehrave kimike të prodhuara dhe importuara në RSH" i cili do të përafrohet pjesërisht me Vendimin 2003/1/EC dhe Rregulloren (EC) 2003/2003;

VKM "Për rishikimin e masave ndëshkimore për kundravajtësit administrativë" i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 97/63/EC dhe Rregulloren (EC) 2003/2003.

3.2 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si mëposhtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafritit të ri e të vjetër.

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e një strukture implementuese;

Fuqizimi i kapaciteteve të Sektorit të Standardeve dhe Sigurimit Teknik

3.1.2.2.10 PRODUKTET KOZMETIKE

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Fusha e produkteve kozmetike është një fushë e re e cila nuk ka ende një kuadër ligjor ekzistues. Por parashikimet ligjore të bëra nga Ministria e Shëndetësisë kanë si qëllim plotësimin e kuadrit ligjor dhe përafritin e këtij të fundit me legjislacionin evropian të identifikuar.

2.2 Kuadri institucional

Ministria e Shëndetësisë është institucioni përgjegjës për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e produkteve kozmetike si dhe për përafritin e këtyre akteve me legjislacionin evropian.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si mëposhtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafritit të ri e të vjetër.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projektligj "Për produktet kozmetike" i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 76/768/EEC;

Projekt VKM "Për listën e lëndëve të ndaluara për prodhimin e produkteve kozmetike" i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 76/768/EEC

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:
Ngritja e strukturave për kontrollin e produkteve kozmetike

3.2 Prioritetet afatgjata

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatgjatë janë si mëposhtë:

Të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përfrimit të ri e të vjetër.

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatgjata

Ministria e Shëndetësisë ka parashikuar për periudhën afatgjatë aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e strukturave për kontrollin e produkteve kozmetike

3.1.2.2.11 PRODUKTET VETERINARE DHE MJEKËSORE

Shih Politikën Bujqësore

3.1.3 MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE MBIKQYRJA E TREGUT

Objektivat e Politikës

Përafrimi në mënyre graduale i legjislacionit shqiptar në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve me atë europian, brenda një periudhe pesëvjeçare, përbën një nga detyrimet e parashikuara në nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Ky detyrim i përgjithshëm i parashikuar në nenin 70 të MSA-së parashikohet edhe në Nenin 76 të saj, i cili përcakton, për fushën e mbrojtjes së konsumatorit, detyrimet e mëposhtme:

Përafrimin e standardeve për mbrojtjen e konsumatorit në Shqipëri me standardet Komunitare.

Politikë për mbrojtjen aktive të konsumatorëve, në përputhje me legjislacionin komunitar;

Harmonizimin e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorit në Shqipëri me atë ekzistues në Komunitet;

Mbrojtje ligjore efektive për konsumatorët për përmirësimin e cilësisë së mallrave dhe mbajtjes së standardeve të duhura të sigurisë;

Monitorimin e rregullave nga autoritetet kompetente dhe siguri i aksesit në drejtësi në rast mosmarrëveshje

Situata Aktuale

Kuadri Ligjor

Fusha e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbrojtjes së Tregut rregullohet me aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

Ligji Nr. 9135, dt. 11.09.2003 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve,” i cili synon sigurimin e një mbrojtje efektive të konsumatorëve, nëpërmjet përcaktimit të të drejtave të konsumatorëve, marrëdhënieve ndërmjet konsumatorëve dhe prodhuesve, shitësve, furnizuesve, ofruesve të shërbimeve si dhe organeve të kontrollit të tregut dhe të standardizimit. Qëllimi kryesor i tij është mbrojtja e shëndetit, mjedisit, sigurisë së jetës dhe e të drejtave të tjera të konsumatorit të sanksionuara në këtë ligj.

Ky ligj është pjesërisht i përafruar me:

Direktivën 1999/44/EEC,

Direktivën 1998/6/EEC,

Direktivën 97/55/EC,

Direktivën 1997/7/EEC,

Direktivën 92/59/EEC,

Direktivën 94/47/EC,

Direktivën 93/13/EEC,

Direktivën 85/577/EEC,

Direktivën 84/450/EEC,

Direktivën 2001/95/EC dhe

Direktivën 2000/31/EC

Në zbatim të ligjit të mësipërm, ka dalë Urdhëri i Kryeministrit Nr.50, datë 05.04.2006 “Për miratimin e përbërjes së Këshillit Bashkërendues për Mbrojtjen e Konsumatorëve”. Këshilli Bashkërendues përbëhet nga 17 anëtarë, përfaqësues të institucioneve shtetërore, shoqatave të konsumatorëve dhe organizimeve të biznesit, dhe ka për objekt të punës së tij, shqyrtimin e politikave sektoriale, akteve ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikqyrjen e tregut.

Kuadri Institucional

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës është institucioni përgjegjës për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikqyrjen e Tregut në Shqipëri.

Aktualisht, mbas riorganizimit të ministrive (bashkimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës) si dhe organizimit të brendshëm të vetë ministrisë, tashmë në këtë fushë operon Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut (DMT) me Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorëve nën Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore. Gjithashtu operon dhe Sektori i Politikave të Konsumatorëve në Drejtorinë e Politikave të Tregut, drejtori e cila është nën Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave.

Struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikqyrjen e tregut në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës ka si mision krijimin e kushteve për funksionimin e sistemit institucional në drejtim të mbrojtjes së jetës, shëndetit, interesave ekonomike si dhe të drejtave të tjera të konsumatorëve të përcaktura në legjislacionin e kësaj fushe, nëpërmjet drejtimit, organizimit, bashkërendimit të veprimtarive për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikqyrjen e tregut.

Struktura e Mbrojtjes së Konsumatorëve, mbështetur në Ligjin Nr.9135, dt.11.09.2003 *“Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”* dhe për të siguruar zbatimin e tij, i nevojitet bashkëpunim i vazhdueshëm me institucionet qendrore dhe strukturat publike të kontrollit të tregut, të cilat përveç zbatimit të ligjeve të tyre specifike, janë të parashikuara dhe nga ligji i mësipërm për zbatimin e dispozitave të tij:

Ministritë e linjës, drejtoritë përkatëse, si: Ministria e Shëndetësisë (Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Parësor, Drejtoria Farmaceutike), Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve (Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve, Drejtoria Veterinare);

Drejtoritë e Përgjithshme si: Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, etj.

Strukturat publike të kontrollit të tregut si: Inspektorati i Ushqimit, Inspektorati Veterinar, Inspektorati i Pajisjeve Elektrike, Inspektorati i Enëve nën Presion, etj;

Entet rregullatore si: ERT, ERE;

Avokati i Popullit.

2.3 Asistenca Teknike

Projekti i Qeverisë Gjermane “Mbështetja e iniciativave për mbrojtjen e konsumatorëve”, i zbatuar nëpërmjet Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Teknik (GTZ). Ky projekt pati një kohëzgjatje Shtator 2003 - Gusht 2005.

Qëllimi i projektit ishte mbështetja për implementimin e të drejtave dhe interesave të konsumatorëve, me objektiva specifike: fuqizimi i kompetencave të strukturës shtetërore të mbrojtjes së konsumatorëve; fuqizimi i ndërgjegjësimit publik mbi mbrojtjen e konsumatorit dhe të drejtat e tij; fuqizimi i koordinimit dhe kooperimit ndërmjet strukturave qeveritare dhe joqeveritare.

Projekti “Mbikëqyrja e Tregut në Shqipëri” i Programit CARDS 2003. Zbatimi i projektit ka nisur në Gusht 2004 dhe parashikohet të përfundojë në Gusht 2006. Vlera e projektit është 1 milion euro.

Qëllimi kryesor i projektit është mbrojtja e konsumatorëve dhe promovimi dhe liberalizimi i tregtisë. Objektivat specifike të tij janë selektimi dhe implementimi i një sistemi të mbikqyrjes së tregut të përshtatshëm dhe në përputhje me kërkesat e BE -së, forcimi i menaxhimit dhe i kapaciteteve institucionale të strukturës së mbrojtjes së konsumatorëve; ngritja e kapaciteteve të institucioneve të tjera shtetërore për mbikqyrjen e tregut dhe për sistemin e shkëmbimit të informacioneve; rritja e ndërgjegjësimit publik mbi mbrojtjen e konsumatorëve dhe përfitimet e sistemit të mbikqyrjes së tregut.

Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra

Në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbikëqyrjes së Tregut , prioritetet afatshkurtra janë:

Formulimi i strategjisë për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut

Forcimi i strukture përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut

Përafrimi i legjislacionit vendas me atë të BE-së në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit (Neni 70 dhe 76 i MSA).

Iniciativa Ligjore

Në përputhje me prioritetet afatshkurtra, gjatë vitit 2006-2007, do të ndërmerren këto iniciativa ligjore:

Ligj për mbikëqyrjen e tregut/inspektoratet. Ky projektligj do të sigurojë bazën ligjore të funksionimit të Sistemit të Mbikëqyrjes së Tregut dhe të ngritjes së një Inspektorati të Përgjithshëm për mbikëqyrjen e mallrave jo-ushqimore në treg.

Projekt VKM "Për mënyrën e bashkërendimit të veprimtarive të strukturave publike të kontrollit të tregut". Ky projektvendim do të jetë akt nënligjor i projektligjit të sipërpërmendur. Paketa ligjore do të hartohet me asistencën teknike të Programit CARDS 2003, Projekti "Mbikëqyrja e Tregut në Shqipëri. Ky vendim përafrohet plotësisht me Direktivën 2001/95/EC 'Mbi sigurinë e përgjithshme të produkteve'

Hartimi i "Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikqyrjen e Tregut", së bashku me modelin e Sistemit të Mbikqyrjes së Tregut. Strategjia përcakton qëllimin dhe drejtimit e politikës së mbrojtjes së konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut gjatë një periudhe trevjeçare. Për hartimin e kësaj Strategjie institucionet përgjegjëse janë mbështetur në Rezolutën e Këshillit, 2 Dhjetor 2002 për Strategjinë e Politikës së Konsumatorit në Komunitet

Ndryshime në Ligjin nr. 9135, dt. 11.09.2003 "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve". Ndryshimet e ligjit do të synojnë harmonizimin e plotë të tij me legjislacionin europian nëpërmjet adoptimit të direktivave europiane: 90/314/EEC- Mbi paketat e udhëtimit, 87/102/EEC- Mbi kreditë e konsumatorëve dhe 98/7/EC- Mbi kreditë e konsumatorëve.

Aktivite Zbatuese

Për të bërë të mundur plotësimin e detyrimeve ligjore dhe përmbushjen e prioritetëve afatshkurtra janë ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Zbatimi i procedurave për përzgjedhjen e modelit të Sistemit të mbikëqyrjes së Tregut .

Udhëzues për strukturat e kontrollit të tregut dhe biznesin në lidhje me vlerësimin e rrezikshmërisë për mallrat në treg dhe ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese. Ky udhëzues dhe ai i pikes 1 do të hartohen me asistencën e Programit CARDS dhe do t'i shërbejnë rritjes së sigurisë së produkteve në treg dhe përmirësimit të praktikave të punës të strukturave publike të kontrollit në treg.

Forcimi i kapaciteteve institucionale

Studim në lidhje me vlerësimin institucional dhe përcaktimin e kostove respektive, për strukturat të kontrollit të tregut, në përputhje me adoptimin progresiv të direktivave europiane të fushës .

Promovimi i Strategjisë së Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe modelit të Sistemit të Mbikqyrjes së Tregut. Promovimi do të përfshijë përgatitjen e botimit, fletëpalosjes, mbajtjen e seminarit ndërgjegjësues etj.

Përcaktimi i masave për zbatimin e Strategjisë dhe modelin e mbikëqyrjes së tregut

Bashkërendimi i veprimtarisë në lidhje me kontrollin e sigurisë së mallrave dhe shërbimeve në kuadër të SMT

Zhvillimi i kapaciteteve administrative të strukturave të MK, në drejtim të mbledhjes e trajtimit të informacionit të SMT si dhe trajtimit të ankesave të konsumatorëve.

Prioritetet afatmesme

Në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbikqyrjes së Tregut , prioritetet afatmesme janë:

Sigurimi i kapaciteteve administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave;

Vendosja dhe zhvillimi sistemit të mbikqyrjes së tregut në përputhje me acquis në lidhje me lëvizjen e lirë të mallrave.

Iniciativa Ligjore

Në përputhje me prioritetet afatmesme do të ndërmerren këto iniciativa ligjore:

Harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit vendas me atë të BE -së në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve (Direktivat 98/27/EC "Mbi vendimet gjyqësore në mbrojtjen e interesave të konsumatorëve"; 2002/65/EC; mbi marketingun në distancë të shërbimeve financiare konsumatore dhe 98/257/EC europiane mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësorit)

Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikqyrjen e Tregut për periudhën 2010-2014 duke u mbështetur në Politikat komunitare për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikqyrjen e tregut

Aktivite Zbatuese

Për të bërë të mundur plotësimin e detyrimeve ligjore dhe përmbushjen e prioriteteve afatmesme janë ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Studim në lidhje me vlerësimin institucional dhe përcaktimin e kostove respektive, për strukturat e kontrollit të tregut, në përputhje me adoptimin progresiv të direktivave europiane të fushës.

Studim në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë në RAPEX (Sistemi i Shkëmbimit të Informacionit në lidhje me mallrat e rrezikshme)

Tabela: Shtesë e kapaciteteve institucionale të METE për Mbrojtjen e Konsumatorit

INVESTIME	NJESIA E M A TJ ES	GJENDJA AKT UAL E	2006	2007	2008	2009
Shtim person ash	persona	5		1		
Konsulencë (e huaj)	(mijë le kë)	130,000 CARDS	600	5200	6000	8000
Trajnime	(mijë le kë)	CARDS	2500	600		

3.1.4 LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE KULTURORE

1. Objektivi politik

Në zbatim të nenit 42 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (neni 29 i Marrëveshjes së Ndërmjetme) nuk do të pengohet ndalimi apo kufizimi i importeve, eksporteve ose mallrave tranzit të justifikuar në bazë të mbrojtjes së thesareve kombëtare me vlerë artistike, historike ose arkeologjike, ose në mbrojtjen e pronësive intelektuale. Ndalime ose kufizime të tilla nuk do të lënë vend për diskriminim arbitrar ose kufizim të maskuar në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Europian.

Mbrojtja e pasurisë kombëtare me vlerë artistike, historike dhe arkeologjike do të sigurohet nga një regjim kufizimesh në importe, eksporte apo në tranzit. Mbrojtja e pronës kulturore do të ruhet nëpërmjet një kuadri legjislativ i cili do të përputhet me legjislacionin komunitar mbi pronën kulturore. Kjo do të gjejë zbatim për kthimin e mallrave kulturore të lëvizuara në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti dhe eksporti i mallrave kulturore sipas legjislacionit europian.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Kuadri ligjor ekzistues në fushën e lëvizjes së mallrave kulturore përbëhet nga :

ligji. 9048, dt.07/04/03 "Për Trashëgiminë Kulturore

ligj 9886, dt 04/05/05 "Për muzetë"

ligj 8096 21/03/96 "Për kinematografinë"

ligj 8576 dt. 3/02/00 "Për Bibliotekat"

ligj nr. 8578, dt.10/02/00 "Për Teatrin"

Konventa e UNESCO-s 1970 «Mbi mjetet e ndalimit dhe parandalimit të importit dhe eksportit të transferimit të paligjshëm të pronësive së pasurisë kulturore»

Konventa "Për ruajtjen e Trashëgimisë materiale dhe shpirtërore" 2003

Udhëzim nr. 2, dt 18.3.2004 "për procedurat e lëvizjes së objekteve të trashëgimisë kulturore, të luajtshme, me vlera të veçanta, kombëtare dhe unike, për ruajtjen, restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

2.2 Kuadri institucional ekzistues

Institucioni përgjegjës për fushën e lëvizjes së mallrave kulturore është Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ku për zbatimin e kuadrit ligjor ekzistues janë ngarkuar këto struktura :

Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore (DTK) e cila është struktura përgjegjëse për mbrojtjen , ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. DTK është strukturë politikëbërëse dhe për zbatimin e politikave të saj janë përgjegjëse institucionet e saj të varësisë si më poshtë vijon

Galeria Kombëtare e Arteve

Instituti i Monumenteve të Kulturës

Instituti i Arkeologjisë

Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore

2.3 Asistencë teknike dhe financiare

Për këtë fushë nuk ka patur asistencë teknike dhe financiare.

3. Adresimi i prioriteteve

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritet i përcaktuar për Qeverinë Shqiptare për periudhën afatshkurtër është:

Mbrojtja e thesareve kombëtare me vlerë artistike, historike ose arkeologjike

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurter

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projektligj "Për disa ndryshime në ligjin për trashëgiminë", i cili do të përafrohet pjesërisht me direktivën 93/7/EEC; direktivën 96/100 EC; Rregulloren 3911/92; Rregulloren 752/93

Projekt ligj "Për disa ndryshime në ligjin për muzetë", i cili do të përafrohet pjesërisht me direktivën 93/7/EEC; Direktivën 96/100 EC; Rregulloren 3911/92; Rregulloren 752/93

Projekt ligj "për disa ndryshime në ligjin për kinematografinë", i cili do të përfarohet pjesërisht me direktivën 93/7/EEC; direktivën 96/100 EC; Rregulloren 3911/92; Rregulloren 752/93

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Përcaktimi i hapësirave dhe specifikimeve të detajuara për lëvizjen e objekteve kulturore në kuptimin e ligjit të trashëgimisë

3.2 Prioritete afatmesme

Prioritet i përcaktuar për Qeverinë Shqiptare për periudhën afatmesme është:

Mbrojtja e thesareve kombëtare me vlerë artistike, historike ose arkeologjike

3.2.1 Iniciativa ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projekt - ligj "Për disa ndryshime në ligjin për bibliotekat", i cili do të përafrohet pjesërisht me direktivën 93/7/EEC; Direktivën 96/100 EC; Rregulloren 3911/92; Rregulloren 752/93

Projekt - ligj "Për disa ndryshime në ligjin për teatrin", i cili do të përafrohet pjesërisht me direktivën 93/7/EEC; Direktivën 96/100 EC; Rregulloren 3911/92; Rregulloren 752/93

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Përcaktimi i hapësirave dhe specifikimeve të detajuara për lëvizjen e objekteve kulturore në kuptimin e ligjit të trashëgimisë.

3.2 LIRIA E VENDOSJES DHE LIRIA PER TE OFRUAR SHERBIME

3.2.1 LIRIA E VENDOSJES DHE LIRIA PER TE OFRUAR SHERBIME (PROCEDURAT E REGJISTRIMIT DHE TE LICENSIMIT)

1. Objektivi politik

Qeveria shqiptare, në zbatim të angazhimeve të marra në OBT për të siguruar trajtim të barabartë mes shoqërive shqiptare dhe atyre të huaja dhe në përputhje me detyrimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (neni 49-56), duhet të lehtësojë fillimin e veprimtarive ekonomike në territorin

shqiptar nga shoqëri dhe shtetas komunitarë. Për këtë qëllim, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, qeveria do të garantojë trajtim të njëjtë si ndaj shoqërive komunitare, ashtu edhe shoqërive vendase ose të një vendit të tretë, pavarësisht cilësisë. Gjithashtu, pas vendosjes në Shqipëri të filialeve dhe degëve të shoqërive komunitare, këto të fundit do të kenë trajtim jo më pak të favorshëm se ai që do t'u akordohet degëve dhe filialeve shqiptare.

Pesë vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, ky regjim do të zbatohet dhe për shtetasit

komunitarë, të cilët mund të fillojnë veprimtari ekonomike si persona të vetë-punësuar.

Në nenin 57 të MSA-së, Qeveria shqiptare është angazhuar të marrë masat e nevojshme për të lejuar progresivisht ofrimin e shërbimeve nga shoqëritë ose shtetasit e Komunitetit ose Shqipërisë, të vendosur në një territor të ndryshëm nga marrësi i shërbimit.

Për zbatimin efektiv të këtyre neneve, Qeveria shqiptare do të reformojë procedurat për regjistrimin e biznesit dhe licensimin e tij.

Për regjistrimin e biznesit synohet përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe efikasitetit gjatë ofrimit të këtij shërbimi, si dhe reduktimi i praktikave korruptive gjatë regjistrimit të biznesit. Kjo do të arrihet nëpërmjet krijimit të një modeli tërësisht të ri, nëpërmjet të cilit do të realizohet regjistrimi i biznesit me një herë të vetme. Në një periudhë 3-vjeçare do të bëhet funksionale Qendra Kombëtare e Biznesit, e cila do të shërbejë si 'one-stop-shop' për regjistrimin e biznesit. I gjithë aktiviteti për këtë fushë do të ndiqet nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe do të monitorohet në vijim në kuadër të mekanizmave përkates të reformës rregullatore. Këto masa do të çojnë në reduktimin e ditëve të regjistrimit nga 47 ditë në 1 ditë, reduktimin e akteve korruptive gjatë regjistrimit dhe ofrimit të shërbimit on-line.

Për sistemin e licensimit synohet thjeshtësimi dhe harmonizimi i procedurave të licensimit në të gjithë sektorët, duke përdorur në mënyrë të harmonizuar parimet e qeverisjes së mirë dhe të eksperiencave të tilla si thjeshtësimi administrativ, parimi i autodeklarimit dhe autoçertifikimit, etj.. Qeveria shqiptare do të synojë ofrimin e shërbimit për biznesin sipas eksperiencave të 'One-Stop-Shop' duke vlerësuar eksperiencat e OECD-së për licensimin.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Legjislacioni bazë për lirinë e vendosjes dhe ofrimin e shërbimeve përbëhet nga:

Ligji nr. 7632, date 04.11.1992, "Dispozita të Pjesës së Parë të Kodit Tregtar"

Ligji nr. 7638, date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare"

Ligji nr. 7667, date 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Procedurat e ndjekura nga Shoqëritë Tregtare"

2.2 Kuadri institucional

Qeveria shqiptare, me Urdhërin e Kryeministrit nr. 170, date 31.10.2005, ka krijuar Task Forcën për drejtimin dhe monitorimin e Reformës Rregullatore, e cila drejtohet nga Kryeministri. Në kuadër të kësaj reforme janë krijuar edhe grupet teknike të drejtuara nga zëvendësministrat sipas fushave të mbulimit. Këto grupe teknike, nën drejtimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, kanë hartuar Planin e Veprimit të Reformës Rregullatore. Regjistrimi dhe licensimi trajtohen nga Grupi i Regjistrimit dhe Licensimit drejtuar nga Zëvendësministri i Drejtësisë dhe Zëvendësministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Reforma Rregullatore koordinohet nga Drejtoria e Politikave të Tregut pranë Ministrinë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2.3. Asistenca teknike dhe financiare

Asistenca në këtë drejtim është e fokusuar në përmirësimin e sistemit të regjistrimit të biznesit me objektiv ofrimin e tij në një ditë, në një ndalim të vetem dhe *online* që do të mundësohet me projektin e Llogarisë së Sfidës së Mijëvjeçarit me shumë prej 2.500 000 USD.

Projekti 'BERIS' i Bankës Botërore me shumë 11 000 000 USD do të japë mbështetjen për të gjithë Reformën Rregullatore.

3. Adresimi i prioritetëve

Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Të ndryshohet legjislacioni në fuqi mbi të drejtën e vendosjes për të siguruar trajtim plotësisht të barabartë mes shoqërive të huaja dhe vendase, një dallim të qartë mes ofrimit të shërbimeve të

përkohshme apo të përhershme dhe përputhshmëri me kërkesat e MSA-së.

Të sigurohet parimi i proporcionalitetit në ofrimin e shërbimeve ndërkufitare.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Iniciativat ligjore do të ndërmerren pas studimit të bërë në kuadër të Reformës Rregullatore për përmirësimin e klimës së biznesit.

3.1.2 Aktivitete zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Shtimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të Drejtorisë së Politikave të Tregut për zbatimin e Reformës Rregullatore

Informatizimi tërësor i regjistrit tregtar,

Rishikimi tërësor i sistemit të licensimit për reduktimin e pengesave administrative ekzistuese,

Rishikimi i detajuar i kuadrit ligjor për çdo sektor duke percaktuar statusin aktual në lidhje me përputhshmërinë e tij me "Acquis communautaire", si dhe percaktimin e masave për harmonizimin e tyre.

Tabela

FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË DREJTORISË SE POLITIKAVE TE TREGUT NE MINISTRINE E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES.

Investime	Njësia e matjes	Gjendja aktuale	VITI
			2006
1.Shtim personash	persona	5 persona	5 persona

3.2.2 NJOHJA RECIPROKE E DIPLOMAVE

1. Objektivi politik

Fusha e njohjes së diplomave është një fushë tepër e rëndësishme për realizimin e lëvizjes së lirë të personave në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, detyrimet e së cilës përcaktohen në nenin 54 të saj.

Qeveria shqiptare do të punojë që procedurat dhe kriteret e njohjes së kualifikimeve të huaja të jenë transparente, koherente, të besueshme dhe do të rishikojë në mënyrë periodike këto procedura për të rritur transparencën, duke marrë parasysh edhe zhvillimet në fushën e arsimit. Ky është parimi kryesor i zbatimit të politikave transparente të njohjes në Bashkimin Evropian, i cili gjen shprehje edhe në nenin 54, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Në Ministria e Arsimit dhe e Shkencës do të bëhet njohja e diplomave unike Bachelor dhe Master të cilat janë të përfshira në një diplomë universitare. Këto diploma master që do të njihen nga MASH janë fituar sipas procesit të Bolonjës në sistemin me cikle studimi (3+2 apo 3+1) që është konceptuar si një proces i vetëm për këdo që dëshiron të ndjekë këto studime dhe që zbatohet në pjesën më të madhe të vendeve evropiane. Po kështu parashikohet që në periudhat e ardhme të vendoset edhe njohja e diplomave të përbashkëta. Për të pasur një transparencë sa më të madhe në procesin e njohjes së diplomave po punohet për futjen e Suplementit të diplomës dhe përsosjen e sistemit ECTS.

2. Situata aktuale

2.1. Kuadri ligjor ekzistues

Në fushën e njohjes së diplomave ekziston një kuadër i plotë ligjor, i cili reflekton rregullat e legjisllacionit parësor dhe dytësor evropian dhe përbëhet nga:

Konventa e Lisbonës për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Evropë, nënshkruar më datë 04.11.1999 .

Ligji Nr. 8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

VKM nr. 523, datë 01.08.2003 "Për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave dhe certifikatave të fituara në shkollat e larta të huaja

Udhëzim Nr. 8, datë 29.04.2005 "Për procedurat e njohjes dhe ekuivalentimit të diplomave

dhe certifikatave të fituara në shkollat e larta të huaja”.

Urdher Nr. 107, date 9.05.2005 " Per miratim Rregullore".

Kuadri institucional ekzistues

Në Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, pranë Drejtorisë së Arsimit të Lartë dhe Njohjes së Diplomave, funksionon njësia e njohjes së diplomave. Kjo njësi ka për detyrë kryrjen e procedurës së plotë të njohjes së diplomave.

Drejtoria e Arsimit të Lartë verifikon vërtetësinë e dokumentacionit për mbarimin e shkollës së lartë, i mbështetur në aktet ligjore e nën ligjore në fuqi dhe lëshon dokumentin e njohjes së diplomës.

Komisioni ad hoc i përbërë nga specialistë të shkollave të larta, mbas shqyrtimit të dokumentacionit shtetëror dhe shkollor, vendosi për njohjen e plotë ose të pjesëshme të diplomës, e cila konfirmon mbarimin e studimeve të larta të aplikantit.

Asistenca teknike dhe financiare

Në këtë fushë nuk ka pasur asistencë teknike dhe financiare. Për një periudhë tre vjeçare 2007-2009 parashikohet që një projekt i Bankës Botërore të asistojë arsimin e lartë në vendin tonë e në këtë kuadër kjo mund të shtrihet edhe në fushën e njohjes së diplomave.

3. Adresimi i prioriteteve

3.1 Prioritetet afatshkurtra (2006 – 2007)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Do të intensifikohet reformimi universitar ne perputhje me parimet dhe objektivat e procesit te Bolonjes ne drejtim te struktures se studimeve (3+2 vite), ngritjes se sistemit te vleresimit te cilesise permes akreditimit, adoptimit te sistemit te krediteve, unifikimit te procedurave te njohjes se diplomave sipas normave te Bashkimit European.

Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM per reduktimin e procedurave te njohjes se diplomave te fituara ne shkollat e larta te huaja i cili do të përafrohet pjesërisht me direktivën 2005/36 EC

Udhezim per zbatimin e Planit Kombëtar të veprimit lidhur me permiresimin e procedurave per njohjen e kualifikimeve, të fituara jashtë shtetit i cili do të përafrohet pjesërisht me direktivën 2005/36 EC

Udhezim per futjen e ECTS dhe Supplementit të Diplomës i cili do të përafrohet pjesërisht me direktivën 2005/36 EC

Regullore lidhur me permiresimin e procedurave per njohjen e kualifikimeve, të fituara jashtë shtetit i cili do të përafrohet pjesërisht me direktivën 2005/36 EC

VKM per përmirësimin e titujve të diplomave, sipas përvojës së universiteteve europiane i cili do të përafrohet pjesërisht me direktivën 2005/36 EC

Udhezim lidhur me permiresimin e procedurave per njohjen e kualifikimeve, të fituara jashtë shtetit i cili do të përafrohet pjesërisht me direktivën 2005/36 EC

Udhezim per përmirësimin e sistemit ECTS i cili do të përafrohet pjesërisht me direktivën 2005/36 EC

Udhezim per implementimin masiv Supplementit të Diplomës i cili do të përafrohet pjesërisht me direktivën 2005/36 EC

Aktivite zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Krijimi i grupit te punes per reduktimin e procedurave te njohjes se diplomave

Zbatimi i procedures se re per njohjen se diplomave

Implementimi i Planit Kombetare per procedurat e njohjes se diplomave

Seminare per permiresimin e sistemit ECTS dhe Shtojces se diplomave

Përmirësimi i titujve të diplomave, sipas përvojës së universiteteve europiane

Zbatimi i procedures se re per njohjen se diplomave

Seminare per diskutimin e titujve te diplomave

Implementimi masiv Supplementit të Diplomës

Prioritetet afatmesme

Prioritete e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë

vijon:

Do të intensifikohet reformimi universitar në përputhje me parimet dhe objektivat e procesit të Bolonjes në drejtim të struktureve të studimeve (3+2 vite), ngritjes së sistemit të vlerësimit të cilësive përmes akreditimit, adoptimit të sistemit të krediteve, unifikimit të procedurave të njohjes së diplomave sipas normave të Bashkimit Europian.

Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM për njohjen e diplomave të përbashkëta, i cili do të përafrohet pjesërisht me direktivën 2005/36/EC

VKM për reduktimin e procedurave të njohjes së diplomave të fituara në shkollat e larta të huaja i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 2005/36/EC

VKM për përmirësimin e titujve të diplomave, sipas përvojës së universiteteve europiane i cili do të përfarohet plotësisht me direktivën 2005/36/EC

VKM për procedura të njohjes së diplomave sipas standarteve të BE i cili do të përafrohet plotësisht me direktivën 2005/36/EC

3.2.2. Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Përmirësimi i sistemit ECTS

Implementimi i Suplementit të Diplomës

Përmirëimi i titujve të diplomave

Zbatimi i procedurave të njohjes së diplomave sipas standardeve të BE

3.2.3 NJOHJA RECIPROKE E KUALIFIKIMEVE PËR PROFESIONET E LIRA

1. Objektivi Politik

Në kuadër të zbatimit të Nenit 54 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit Qeveria Shqiptare angazhohet të marrë hapa të nevojshëm për njohjen reciproke të kualifikimeve, për të lehtësuar aktivitetet profesionale të shtetasve shqiptarë dhe shtetasve komunitarë në Shqipëri si dhe Përafrimin e Legjislacionit vendas me acquis mbi ushtrimin e disa profesioneve të lira.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Baza ligjore që përcakton veprimtaritë e mjekut, farmacistit, mamive infermierëve dhe dentistëve që licensohen së bashku me kriteret e licensimit është:

VKM 238/2003 “Për licensimin e veprimtarisë private në fushën e shëndetësisë”

Ligji 8615/2000 “Për Urdhërin e Mjekut në Republikën e Shqipërisë”

Ligji Nr 9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhërin e Farmacistëve në RSH”

Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë 108/2002 “Për dhënien e licensës për ushtrim të profesionit në fushën e shëndetësisë në profesion të lirë privat”

Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë 309/2003 “Për transferimin e aktivitetit privat në fushën e shëndetësisë”

Urdhëri 346/2004 “Mbi kriteret e licensimit të subjekteve private në profesionin e mjekut, farmacistit, stomatologut”, si dhe një sërë udhëzimesh e rregulloresh.

Baza ligjore që përcakton veprimtaritë e arkitektit që licensohen së bashku me kriteret e licensimit është:

VKM 613/1993, “Për ushtrimin e veprimtarive në ndërtim dhe projektim të shoqërive”

Rregullore “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale për punët dhe shërbimet publike”

Baza ligjore që përcakton veprimtaritë e avokatit dhe noterit që licensohen së bashku me kriteret e licensimit është :

Kushtetuta e RSH-së. Neni 49 i Kushtetutës sanksionon të drejtën e fitimit të mjeteve të jetesës me punë të ligjshme, të zgjedhur ose pranuar vetë. Çdo person është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional.

Ligji nr. 7829, datë 01.06.1994, “Për Noterinë” ndryshuar me ligjin nr.7820, datë 19.04.1995; ndryshuar me ligjin nr. 8790, datë 10.05.2001; ndryshuar me ligjin nr. 9216, datë 01.04.2004, i cili rregullon veprimtarinë e profesionit të noterit. Ky ligj përcakton kushtet dhe kriteret për t’u bërë noter;

të drejtat dhe detyrimet e noterit; mënyrën e redaktimit të akteve noteriale, pavlefshmërinë e akteve dhe të veprimeve noteriale; organizimin dhe përfaqësimin profesional të noterëve.

Ligji nr. 9109, datë 17.07.2003, “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, i cili është hartuar nën asistencën e Këshillit të Europës. Ky ligj rregullon veprimtarinë e avokatit; përcakton kriteret dhe kushtet për të ushtruar profesionin e avokatit, të drejtat dhe detyrat e tyre; përcakton organet drejtuese; kompetencat dhe juridiksionin e tyre, ka sjellë harmonizim të pjesshëm me Direktivën 77/249/CEE.

Kuadri institucional ekzistues

Ministria e Shëndetësisë licenson subjektet private, vendas apo të huaj, që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e shëndetësisë. Organi përgjegjës për pranimin e kërkesave të subjekteve dhe për prëgatitjen e materialeve për Komisionin e Posaçëm të dhënies së Liçensave, është Sektori i Licensimit, në Drejtorinë Juridike, të Marrëdhënieve me Jashtë dhe të Licensimeve. Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licensave është organ vendimmarrës. Ky komision mblidhet një herë në muaj dhe është i përbërë nga Kryetar i Komisionit ZV. Ministri i Shëndetësisë dhe ka si anëtarë Drejtorët e të gjitha Drejtorive të Ministrisë së Shëndetësisë, një jurist, një anëtar të Urdhërit të Mjekut, Drejtori i ISKSH -së, anëtar nga Ministria e Mjedisit, Drejtori i QKKB -së.

Urdhëri i Mjekëve të Shqipërisë është ent publik, i cili përfaqëson interesat e përbashkët të profesioneve mjekësore dhe rregullon marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikut. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e mjekut ose të stomatologut në Republikën e Shqipërisë pa qenë anëtar i Urdhërit të Mjekëve. Misioni i Urdhërit të Mjekëve është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesioneve mjekësore dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga kequshtrimi i mjekësisë. Urdhëri i Mjekëve jep dhe heq të drejtën individuale për ushtrimin e profesionit të mjekut dhe stomatologut.

Urdëri i Framacistëve është ent publik, i cili përbëhet nga individët, që ushtrojnë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë dhe përfaqëson interesat e tyre profesionale në nivel partneriteti institucional. Asnjë individ nuk mund ta ushtrojë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhërit të Farmacistëve. Për këtë qëllim jep dhe heq të drejtën vetjake për ushtrimin e këtij profesioni. Urdhëri i Farmacistëve ka për mision ruajtjen dhe garantimin e nivelit të lartë të formimit dhe edukimit shkencor e profesional të farmacistëve, ushtrimin e profesionit, sipas kërkesave shkencore, normave të etikës mjekësore e të Kodit të Deontologjisë Farmaceutike Shqiptare dhe mbrojtjen e pacientëve e të konsumatorëve nga kequshtrimet profesionale dhe shkeljet e normave të detyrueshme.

Profesioni i arkitektit

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, është institucion i autorizuar për dhënien e liçensave lidhur me punët dhe shërbimet publike. Njohja e kualifikimit profesional të arkitektit bëhet me anë të lëshimit të liçensës personale, për ushtrimin e aktivitetit me objekt ndërtimin. Miratimi i liçensave bëhet nga Komisioni i Posaçëm që ngrihet brenda MRTT –së për këtë qëllim dhe që përbëhen nga specialistë të fushës. Sektori i Liçensimit në MRTT pranon kërkesat dhe dokumentacionin e nevojshëm për t’ja përcjellë më pas Komisionit të posaçëm të Liçensimit.

Profesioni i avokatit dhe noterit

Ministria e Drejtësisë nëpërmjet Drejtorisë së Profesioneve të Lira kujdeset dhe mbështet sipas ligjit ushtrimin, organizimin dhe funksionimin e profesionit, të avokatit, noterit, ndërmjetësit, arbitrit dhe profesioneve të tjera të lira të lidhura me sistemin e drejtësisë, kujdeset dhe mbështet funksionimin e veprimtarisë dhe të shërbimeve të ekspertimit ligjor.

Dhoma Kombëtare e Noterisë- Ministria e Drejtësisë bashkërisht me Dhomën Kombëtare të Noterisë cakton numrin minimal të noterëve për një rreth gjyqësor në bazë të numrit të popullsisë dhe të vëllimit të punës së veprimtarisë noteriale. Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, veç e veç mbajnë regjistra për noterët dhe asistentët, si dhe administrojnë dokumentacionin që lidhet me marrjen dhe heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit, transferimet e tyre, përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe ecurinë disiplinore të noterëve dhe asistentëve.

Dhoma Kombëtare e Avokatisë - Dhoma Kombëtare e Avokatisë është një person juridik i pavarur nga shteti në ushtrimin e veprimtarisë së saj. Ajo përgjigjet për rregullimin dhe kontrollin e ushtrimit të avokatit në Republikën e Shqipërisë. Rregullat e organizimit dhe funksionimit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë parashikohen në statutin e saj.

Dhoma Kombëtare e Avokatisë, dhomat e avokatisë për juridiksionin e tyre, si dhe Ministria e Drejtësisë, mbajnë regjistrin e asistentëve, si dhe administrojnë dokumentacionin përkatës për ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

2.3. Asistenca teknike dhe financiare

Në këto fusha nuk ka patur asistencë teknike dhe financiare.

3. Adresimi i prioritetëve

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Lehtësimi i aktiviteteve profesionale të shtetasve shqiptare dhe atyre të Komunitetit në Shqipëri dhe vendet respektive të Komunitetit.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projekt ligji “Për infermieristikën”, i cili ka për qëllim jo vetëm përmirësimin e shërbimit infermior në të gjithë strukturat shëndetësore, por dhe të vënies së rregullave për njohjen e kualifikimit profesional të infermierëve sipas normave komunitare. Do të sjellë harmonizim të pjesshëm me Direktivën 2005/36 EC.

Ndryshime në ligjin nr.9109, dt.17.07.2003 “Për Profesionin e Avokatit në RSH” si dhe Projektakti “për heqjen e pengesave në qarkullimin e lirë të personave dhe të shërbimeve të shtetasve të Komunitetit Europian në Shqipëri dhe anasjelltas”, të cilët do sjellin një harmonizim të pjesshëm me Direktivën 77/249/EEC dhe Direktivën 98/5/EC.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Studimi dhe identifikimi i normave komunitare për njohjen e kualifikimeve profesionale, për të sjellë në periudhat e mëvonëshme harmonizimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së.

3.2. Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:

Përafrimi i legjislacionit vendas me acquis mbi ushtrimin e disa profesioneve të lira.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore

Hartimi i Projektligjit “Për profesionet e lira në fushën e shëndetësisë” për të sjellë një harmonizim të plotë me Direktivën 2005/36 EC.

Ndryshim legjislacioni për lejet profesionale në fushat publike, në përputhje të plotë me Direktivën 2005/36 EC.

Projektakti “për heqjen e pengesave në qarkullimin e lirë të personave dhe të shërbimeve të shtetasve të Komunitetit Europian në Shqipëri dhe anasjelltas” si dhe Projektakti nënligjor mbi njohjen reciproke të kualifikimeve të profesioneve të lira si avokat, noter, eksper ligjor, në përputhje të plotë me Direktivën /249/EEC dhe direktivën 98/5/EC

Ngritja e Urdhërit të Infermierit, që do të jetë një ent publik, i cili do të përbëhet nga individët, që ushtrojnë profesionin e infermierit në Republikën e Shqipërisë dhe do të përfaqësojnë interesat e tyre profesionale në nivel partneriteti institucional.

3.2.4 SHERBIMET POSTARE

Objektivi politik

Bazuar në nenet 50, 57, 70, 71, 72 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, në Strategjinë Kombëtare të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për Shqipërinë dhe dokumentin mbi Politikën e zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, Qeveria Shqiptare angazhohet për një liberalizim gradual të tregut të shërbimeve postare me qëllim ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë dhe tarifa të përballueshme nga konsumatorët.

Objektivi është që në Republikën e Shqipërisë, të gjitha shërbimet postare të hapen për tu ofruar nga sektori privat dhe kjo hapje do të bëhet në përputhje me legjislacionin europian. Liberalizimi gradual i tregut si dhe krijimi i strukturave rregullatore të pavarura do të jenë faktore të rëndësishëm për nxitjen e konkurrencës së ndershme në tregun postar. Nepermjet aplikimit të procedurave të thjeshtuara për licencim do të rritet interesi i sektorit privat për të konkuruar jo vetëm në tregun postar të jashtëm por edhe në atë të brendshëm.

Harmonizimi i standardeve kombëtare me ato të Bashkimit Evropian do të arrihet nepermjet ngritjes së një infrastrukture dhe logjistike mbështetëse për shërbimet postare të cilat do të

inkurajojnë ofrimin e shërbimeve postare me çilesi të lartë. Investimet në infrastrukture si dhe menaxhimi i rrjetit postar i orientuar drejt biznesit janë thelbësore në arritjen e standardeve të larta të shërbimit. Futja e shërbimeve të reja postare do të bëhet si nga operatori publik postar ashtu dhe nga ofruesit privat të shërbimeve postare dhe do të mbështeten nga teknikat dhe teknologjitë e reja në përdorim.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Kuadri ligjor në fushën e shërbimeve postare përbëhet nga:

Ligji Nr.8530 datë 23.09.1999 "Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë" ndryshuar nga Ligji Nr.9223, datë 29.04.2004 i cili është në përputhje me Direktivën 2002/39/EC

Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr. 539, dt. 01.08.2003 "Politikat e zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë"

Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr.788, dt. 26.12.2004 "Për përcaktimin e tarifës dhe të peshës së shërbimeve të rezervuara për operatorin publik postar" i cili përputhet pjesërisht me Direktivën 2002/39/EC

Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr. 405, dt. 27.07.2000 "Për kushtet e nxjerrjes Pulles Postare Shqiptare".

Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr. 27, datë 20.01.2001 "Për vendosjen e kutive postare në ndërtesa banimi dhe institucione".

Kuadri institucional ekzistues

Për zbatimin e objektivave të përcaktuara me lart institucioni përgjegjës, është Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit i propozon Keshillit të Ministrave strategjinë e zhvillimit të postave si dhe veprimet e nevojshme për përmbushjen e objektivave të politikës së zhvillimit të postave. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Transportit dhe Poste Telekomunikacioneve, harton projektaktet ligjore e nënligjore për zhvillimin e sektorit të postave, harton plane zhvillimi të postave, mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore nga të gjithë operatorët publikë dhe privatë, ndjek zbatimin e detyrimeve për sektorin e postave, gjithashtu aktualisht kryen dhe funksionet e struktura rregullatore, procedurat e licencimit në bazë të përcaktimeve të këtij ligji, kontrollon çilesinë e shërbimeve të kryera nga operatorët, në bazë të normave dhe standardeve si dhe konkurrencën në treg.

Për realizimin e detyrave të mësipërme aktualisht Drejtoria e Politikave të Post-telekomunikacionit, është e pandare në sektore (të pakten) e cila drejtohet nga një drejtor dhe ka në përberje të saj 2 specialiste:

3. Adresimi i prioritetëve

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritet i përcaktuar për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër është:

Liberalizim gradual të tregut të shërbimeve postare me qëllim ofrimin e shërbimeve me çilesi të lartë dhe tarifa të përballueshme nga konsumatorët.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Amendimi I Ligjit "Për shërbimet Postare" i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 2002/39/EC

VKM "Përcaktimi i peshës dhe tarifës për zonën e rezervuar për operatorin publik postar" i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivën 2002/39/EC

Ratifikimi i Dokumentit të Kongresit të 23-të të Unionit Postar Universal (UPU)

VKM "Përcaktimi i tarifave të shërbimit universal" i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 2002/39/EC

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Fuqizimi i sektorit postar në Drejtorinë e Politikave të Transportit dhe Poste Telekomunikacioneve.

Tabela e mëposhtme tregon investimet që do të kryhen për fuqizimin e kapaciteteve administrative të Drejtorisë së Politikave të Transportit dhe Poste Telekomunikacionit

3.2 Prioritetet afatmesme

Prioritet i përcaktuar për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër është:

Liberalizim gradual te tregut te sherbimeve postare me qellim ofrimin e sherbimeve me cilesi te larte dhe tarifa te perballueshme nga konsumatorët.

Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

VKM "Sherbimi universal dhe harmonizimi i sherbimeve te rezervuara" i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 2002/39/EC

VKM "Kushtet e qeverisjes te ofrimit te sherbimeve jo te rezervuara dhe aksesin ne rrjet, licensat dhe autorizimet, procedurat dhe kushtet respektive i cili do të përafrohet plotësisht me direktivën 2002/39/EC

VKM "Liberalizimi i plote i sektorit Postar" i cili do të përafrohet plotësisht me direktivën 2002/39/EC

VKM: "Ratifikimi i dokumentit te Kongresit te 24 te UPU", Nairobi 2008

Aktivitet zbatues afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e Njesise Rregullatore te Postave

Tabela

FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË DREJTORISË SË POLITIKAVE TË TRANSPORTIT DHE POSTË-TELEKOMUNIKACIONIT

time	Inves	Ë	C	VITET
	jësia e matjes	jendja aktuale	006	007
1.Shtim personash	ersona	2		
Infrastrukture	(mijë lekë)			69
2.IT	(mijë lekë)	2	X	15
4.Trajnime (mijë lekë)	(mijë lekë)	2		230

3.2.5 SHËRBIMET FINANCIARE,

3.2.5.1 Banka

1. Objektivi Politik

Qeveria shqiptare në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, do të ndërmarrë nisma ligjore dhe institucionale për një fuqizim të shpejtë dhe të qëndrueshëm të sektorit bankar e financiar. Banka e Shqipërisë do të zhvillojë politikat e saj në përputhje me rekomandimet e Bashkimit Europian, me qëllim përmbushjen e angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

MSA -ja në nenin 70 parashikon detyrimin për Përafrimin e Legjislacionit në këtë fushë gjatë fazës së parë tranzitore. Në nenin 50 të saj, Shqipëria është angazhuar që me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, t'u ofrojë shoqërive komunitare si dhe degëve dhe filialeve të tyre një trajtim jo më pak

të favorshëm se ai që u njihet kompanive, degëve apo filialeve vendase. Gjithashtu, në nenin 57 të Marrëveshjes, Shqipëria angazhohet të lejojë progresivisht ofrimin e shërbimeve nga shoqëritë komunitare, pa qenë nevoja për t'u vendosur.

Vendimi i Këshillit për Parimet, Kushtet dhe Përparësitë të përmbajtura në Partneritetin Europian me Shqipërinë, i datës 30 janar 2006, përcakton si përparësi afatshkurtër në fushën e shërbimeve financiare forcimin e kuadrit ligjor dhe mbikëqyrës në sektorin bankar.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Legjislacioni bazë për rregullimin e proceseve të krijimit, liçencimit dhe mbikëqyrjes së bankave përbëhet nga:

Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë"

Ligji nr. 8365, datë 02.07.1998, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"

Banka e Shqipërisë, në përputhje me misionin e saj si autoritet mbikëqyrës, nxjerr akte nënligjore: vendime, rregullore, udhëzime dhe urdhëra, të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha bankat e subjektet e tjera të liçencuara prej saj. Si udhëzues kryesor për hartimin e këtyre akteve shërbejnë "Parimet bazë për një mbikëqyrje efektive" të Komitetit të Bazelit, si dhe udhëzimet e këtij komiteti për mbikëqyrjen bankare.

Banka e Shqipërisë është autoriteti mbikëqyrës i institucioneve të kreditit. Ajo ka të drejtën ekskluzive të japë miratimin për fillimin e aktivitetit bankar nëpërmjet dhënies së licencës, si dhe të mbikëqyrë aktivitetin e çdo subjekti, i cili ka marrë licencë për ushtrimin e veprimtarisë bankare në Republikën e Shqipërisë.

Struktura kryesore e Bankës së Shqipërisë, e përfshirë në ushtrimin e funksioneve të mësipërme, është Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e hyrjes së bankave të reja (licencimin); rregullimin e bankave të nivelit të dytë dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të respektimit të rregullave; mbikëqyrjen e ecurisë financiare të bankave, trajtimin e bankave me probleme si dhe ruajtjen e likuiditetit, aftësisë pagueuse dhe funksionimit normal të sistemit bankar. Në përmbushjen e objektivave të Bankës së Shqipërisë të përcaktuara në ligj, si institucioni mbështetës kryesor për realizimin e objektivave të saj, është Ministria e Financave.

Banka e Shqipërisë ka memorandume bashkëpunimi në fushën e mbikëqyrjes bankare me Bankën e Greqisë, Autoritetin e Bankave dhe Pagesave të Kosovës, Bankën Qendrore të Bullgarisë, atë të Maqedonisë si dhe me Autoritetin Mbikëqyrës dhe Rregullimit Bankar të Turqisë. Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi edhe me Autoritetin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe me Komisionin e Letrave me Vlerë.

2.3. Asistenca teknike dhe financiare

Në fushën e mbikëqyrjes bankare Banka e Shqipërisë është asistuar nga Banka Botërore në hartimin e dokumentit "Plani i Zhvillimit të Mbikëqyrjes". Plani i Zhvillimit të Mbikëqyrjes ka qenë pjesë e programit FSAC, kredi prej 15 milionë USD. Po ashtu, Bankën e Shqipërisë e ka asistuar dhe do ta asistojë edhe FMN –ja, me asistencë teknike si dhe FSVC -ja (Financial Services Voluntary Corps), me asistencë afat shkurtër për probleme të ndryshme. Banka e Shqipërisë synon të përfitojë nga përvoja e një banke qendrore anëtare të SEBQ-së në fushën e mbikëqyrjes bankare nëpërmjet një projekti të binjakëzimit të lehtë (Twinning Light), i cili do të ndihmonte Bankën e Shqipërisë në realizimin e aktiviteteve zbatuese, duke pasur një ndikim konkret dhe të drejtpërdrejtë në përmbushjen e detyrimeve të mara në kuadër të MSA-së

3. Adresimi i prioriteteve

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet për Bankën e Shqipërisë do të jetë:

Forcimi i kuadrit ligjor dhe mbikëqyrës në sektorin bankar.

Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore

Amendimi i ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 77/780/EEC dhe Direktivën 83/349/EEC për përcaktimin e përkufizimit të degës dhe filialit të bankave; do të reflektojë parimet e Bazelit në lidhje me "pjesëmarrjen ndikuese" dhe kontrollin e bankës, do të përafrohet plotësisht me Direktiven 2000/12/EC mbi parashikimin që kapitali rregullator i bankës nuk duhet të bjerë nën nivelin e kapitalit fillestar minimal në kohën e liçencimit, do të përafrohet plotësisht me nenin 8 të Direktivës

91/308/EEC mbi revokimin e licencës së një banke si dhe me parimet e Bazelit mbi parandalimin e pastrimit të parave, si dhe do të shfuqizojë kërkesën lidhur me detyrimin e administratorëve të degës së bankës së huaj, për të qenë rezidentë në Republikën e Shqipërisë.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Rishikimi i kuadrit ekzistues rregullator në funksion të zbatimit të ligjit të amenduar "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Tabela

FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Investi me	N jësia matjes	G jendja aktuale	VITET			
			2006	2007	2008	2009
3.Kons ulencë (e huaj)	(mijë leke)	X	X	1 4281,85		
4.Traj nime (mijë leke)	(mijë leke)	X	X	1 500		X

3.2.5.2 SIGURIMET

1. Objektivi Politik

Qeveria shqiptare do të ndërmarrë nisma ligjore dhe institucionale për garantimin e konkurrencës së lirë dhe të funksionimit transparent e të ndershëm të tregut të sigurimeve. Do të mbështetet fuqizimi i autoritetit rregullator të këtij tregu dhe do të luftohet korrupsioni dhe lidhja e kontratave mes institucioneve shtetërore dhe operatorëve të këtij tregu, të infektuara nga konfliktet e interesave. Synim i Qeverisë Shqiptare është dhe krijimi brenda vitit 2006 i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, ku Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Inspektorati i Pensioneve dhe Komisioni i Letrave me Vlerë do të integrohen në një të vetëm.

Neni 70 i MSA-së parashikon detyrimin për Përafrimin e Legjislacionit në këtë fushë gjatë fazës së parë tranzitore. Në nenin 50 të saj, Shqipëria është angazhuar që, me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, t'u ofrojë shoqërive komunitare si dhe degëve dhe filialeve të tyre një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u njohet kompanive, degëve apo filialeve shqiptare. Gjithashtu, në nenin 57 të Marrëveshjes, Shqipëria angazhohet të lejojë progresivisht ofrimin e shërbimeve nga shoqëritë komunitare, pa qenë nevoja për t'u vendosur.

Vendimi i Këshillit për Parimet, Kushtet dhe Përparësitë të përmbajtura në Partneritetin European me Shqipërinë i 30 Janarit 2006, përcakton si përparësi afatshkurtër në fushën e shërbimeve financiare forcimin e kuadrit ligjor dhe mbikëqyrës në sektorin e sigurimeve.

2 Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Veprimtaria e sigurimit, risigurimit, ndërmjetësimit në sigurime e risigurime si dhe mbikëqyrja mbi këtë veprimtari rregullohet me dy ligje:

Ligji Nr. 9267 datë 29.07.2004 'Mbi vëprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime',

Ligji Nr. 9268 datë 29.07.2004 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve".

Legjislacioni në fuqi është pjesërisht i përafruar me këto akte komunitare:

Direktiva 73/239/EEC – Direktiva e Parë e Këshillit – "Për të ushtruar aktivitetin e sigurimit të

jo-jetës”,

Direktiva 88/357/EEC – Direktiva e Dytë e Këshillit

Direktiva 92/49/EEC – Direktiva e Tretë e Këshillit,

Direktiva e Këshillit 2002/83/EC “Për sigurimin e Jetës”

Direktiva e Këshillit 2002/92/EC “Mbi ndërmjetësimin në sigurime”.

Akte nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërpërmenduar janë:

VKM nr.191 datë 25.03.2005 “Për miratimin e metodikës “Mbi mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë pague për sigurimin e jetës dhe Jo-Jetës, si dhe elementët që e përbejnë atë”

VKM nr.192 datë 25.03.2005 “Për kriteret dhe procedurat e licensimit të agjenteve në sigurime si dhe rregullat për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre”

VKM nr.268 datë 28.04.2005 “Mbi përcaktimin e kufijve maksimale të lejueshëm për aktivet dhe investimet e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike”

Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve është institucioni i vetëm ligjor që liçenson, kontrollon dhe mbikëqyr operatorët në tregun e sigurimit, me qëllim mbrojtjen e interesave të të siguruarve në Republikën e Shqipërisë.

Veprimtaria e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, konsiston në Mbikëqyrjen financiare dhe ligjore të operatorëve të tregut të sigurimeve, për të garantuar funksionimin e tregut të sigurimeve në parametra të qëndrueshme financiare; konkurrencë të ndershme midis operatorëve në treg; cilësinë e shërbimit të ofruar nga ana e operatorëve në tregun e sigurimeve; dhe qëndrueshmërinë e ofruesit të shërbimit në zbatim të përgjegjësi që rrjedhin nga kontraktimi me konsumatorët.

Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me,

Bankën e Shqipërisë dhe Komisionin e Letrave me Vlerë, lidhur me shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave, mbikëqyrjen e përbashkët të tregut, luftën kundër pastrimit të parave

Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në kuadrin e mbikëqyrjes së tregut të sigurimit të detyrueshëm,

Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Transportit Rrugor, në kuadrin e mbikëqyrjes së tregut të sigurimit të detyrueshëm dhe shkëmbimin e informacionit.

Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe ndërkombëtare. Memorandumi i Mirëkuptimit me BPK-në(Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës), ka për qëllim shkëmbimin e eksperiencave të mbikëqyrjes, për mbarëvajtjen e tregut të sigurimeve. Autoriteti ka filluar negociatat për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Autoritetin e Italisë, Greqisë dhe Maqedonisë.

2.3. Asistenca teknike dhe financiare

Fusha e sigurimeve është mbështetur nga Projekti FSAP (Program i Vlerësimit të Sektorit Financiar), i Bankës Botërore dhe FMN që nga Nëntori 2004, për vlerësimin e sektorit financiar (sigurimeve) në Republikën e Shqipërisë.

Në kuadrin e Kredisë së Bankës Botërore është dhënë asistencë gjatë vitit 2004-2005 në rishikimin e akteve ligjore dhe nënligjore ekzistuese, projektimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të ligjit, përgatitjen e startegjive për rregullimin e tregut të sigurimeve dhe AMS -së, dhe trajnimin e stafit.

3. Adresimi i prioritetëve

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet i përcaktuar për Qeverinë Shqiptare për periudhën afat-shkurtër do të jetë:

Plotësimi dhe rregullimi i kuadrit normativ të fushës së sigurimeve dhe përafrimi i tij me të drejtën Komunitare

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Amendimi i ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Mbi veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërjetësimin në sigurime dhe risigurime”, që ka të bëjë me vendosjen e degës së shoqërisë së huaj në territorin shqiptar”.

P/VKM "Për kriteret e liçencimit të vlerësuesve të dëmeve"

P/VKM "Mbi rregullat e vlerësimit të aktiveve në mbulim të prigjoneve teknike dhe matematike", i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 73/239/EEC, Direktivën 88/357/EEC, Direktivën 92/49/EEC, dhe Direktivën 2002/82/EC

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese: Përgatitja e raporteve vlerësuese për zbatimin e kuadrit ligjor nga operatorët e sigurimeve. Trajnimi dhe liçencimi i agjenteve të sigurimeve, në bashkëpunim me shoqëritë e sigurimit. Krijimi i shoqërive të vlerësuesve të dëmeve .

3.2. Prioritetet afatmesme

Prioritetet i përcaktuar për Qeverinë Shqiptare për periudhën afat-mesme do të jetë:

Plotësimi dhe rregullimi i kuadrit normativ të fushës së sigurimeve dhe përafrimi i tij me të drejtën Komunitare

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

P/Ligj “Mbi kontratat e sigurimeve”

P/ligj “për disa ndryshime në ligjin 9267 datë 29.07.2004”, i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 73/239/EEC, Direktivën 88/357/EEC, Direktivën 92/49/EEC , Direktivën 2002/82/EC

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për periudhën afatmesme nuk janë parashikuar aktivitete zbatuese.

FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE

Duke qenë se brenda vitit 2006 do të krijohet Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, ku Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Inspektorati i Pensioneve dhe Komisioni i Letrave me Vlerë do të integrohen në një të vetëm, aktualisht nuk mund të jepen shifra në lidhje me forcimin e kapaciteteve të këtij institucioni.

3.3 LËVIZJA E LIRË E KAPITALEVE

1. Objektivi politik i fushës

Në nenet 60-62 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Shqipëria ka marrë përsipër detyrimin për të liberalizuar lëvizjen e kapitalit dhe të pagesave rrjedhëse në marrëdhëniet me Komunitetin Europian.

Shqipëria është e angazhuar të nënshkruajë Nenin VIII të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar. Shqipëria vazhdon të zbatojë kufizimet që ky nen kërkon të hiqen, për shkak të tepricave debitore në kuadrin e marrëveshjeve inoperative dypalëshe të pagesave, të cilat bëjnë pjesë në borxhin e jashtëm ende të pariskeduluar.

Në memorandumet e fundit për politikën ekonomiko-financiare të qeverisë, në kuadrin e nënshkrimit të marrëveshjeve të PRGF (*Poverty Reduction and Growth Facility*), Qeveria Shqiptare është angazhuar rregullisht për miratimin hap pas hapi të marrëveshjeve të riskedulimit për shumat tashmë të rikoniluara si dhe për rregullimin e borxhit privat.

Për sa i përket liberalizimit të llogarisë kapitale, ky proces konsiderohet praktikisht i realizuar dhe pse ekzistojnë ende disa kufizime në lidhje me lëvizjen e kapitaleve jashtë vendit për rezidentët.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Kuadri ligjor ekzistues për fushën e Lëvizjes së Lirë të Kapitalit është:

Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë";

Ligji nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë";

Ligji nr. 8610 datë 17.05.2000 "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave" i ndryshuar.

Për përmbushjen e rolit të saj në sistemin e pagesave, Banka e Shqipërisë ka miratuar aktet nënligjore të mëposhtme:

Rregullore "Për procedurat e sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)", e cila përcakton rregullat dhe procedurat për funksionimin e Sistemit të Kryqëzimit të Pagesave me Vlerë të Vogël (AECH);

Vendimi nr. 54 "Për disa ndryshime në "Rregullat dhe procedurat e sistemit shqiptar të pagesave ndër-bankare AIPS", i cili sjell ndryshime në tabelat e orareve dhe e seancave të punës në sistemin AIPS.

Rregulla dhe procedura për Sistemin Shqiptar të Pagesave Ndër-bankare AIPS. Sistemi AIPS është sistemi i shlyerjes bruto në kohë reale për pagesat ndër-bankare në Lek;

Rregullore "Për pagesat elektronike në Shqipëri" e cila synon modernizimin e sistemit të pagesave, formulon parimet kryesore të instrumenteve elektronike të pagesave që emetohen në Republikën e Shqipërisë;

Rregullore "Për organizimin e kleringut në Bankën e Shqipërisë" e cila synon kryerjen e kleringut të pagesave mbi një bazë ligjore, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit të instrumenteve të pagesës, të përshtatshme në kohë dhe procedura të njëjta për të gjitha bankat anëtare të tij;

Rregullore "Për sistemin dhe instrumentet e pagesave", e cila synon funksionimin normal të sistemit të pagesave në Republikën e Shqipërisë.

Regjimi i lëvizjeve të kapitalit në Shqipëri rregullohet nga Rregullorja "Për Veprimtarinë Valutore", e cila vendos rregullat lidhur me veprimet në llogaritë kapitale dhe në llogaritë rrjedhëse midis rezidentëve dhe jorezidentëve nga brenda-jashtë vendit dhe nga jashtë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Kuadri institucional

Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës për zbatimin e detyrimeve të MSA-së në lidhje me lëvizjen e lirë të kapitalit dhe të pagesave rrjedhëse si dhe mbi sistemin e pagesave. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë ka bashkëpunuar me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrinë e Drejtësisë, Komisionin e Letrave me Vlerë, Komisionin e Mbikqyrjes së Sigurimeve, në lidhje me përgatitjen e matricës rreth liberalizimit të llogarisë kapitale.

Marrëdhëniet midis Bankës së Shqipërisë dhe vendeve të rajonit janë të përqendruara në fushën e mbikqyrjes bankare dhe në liberalizimin e pagesave korrente në përputhje me Nenin VIII të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Akti kryesor ligjor që rregullon lëvizjen e kapitalit dhe pagesat rrjedhëse është ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", në bazë të së cilit Banka e Shqipërisë nxit dhe mbështet mirëfunksionimin e sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri. Në bazë të nenit 21 të këtij ligji, Banka e Shqipërisë mbikëqyr sistemin e pagesave në Republikën e Shqipërisë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet subjekteve apo njësive ndërbankare të krijuara nga ajo për këtë qëllim.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2006-2007 janë si më poshtë:

Të përmirësohet monitorimi i kujdesshëm i sektorit financiar;

Të merren masa të mëtejshme për të ulur përdorimin e kartëmonedhave (cash) në ekonomi.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projektligj "Për regjimin e këmbimeve valutore". Banka e Shqipërisë, për të evidentuar në mënyrë të përgjithshme të gjitha lëvizjet e kapitalit si në hyrje edhe në dalje, do të hartojë projektligjin "Për regjimin e këmbimeve valutore në Shqipëri". Ky ligj do të adoptojë direktivën 88/361/EEC "për zbatimin e Nenit 67 të Traktatit të BE; direktivën 97/05/EC "Mbi transfertat ndërkufitare të kredive" si dhe direktivën 91/308/EC "Për parandalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar me qëllim pastrimin e parave";

Rregulla dhe procedura për Sistemin Shqiptar të Pagesave Ndërbankare AIPS. Duke qenë se Vendimi "Rregulla dhe Procedura të Sistemit Shqiptar të Pagesave Ndërbankare – AIPS" nuk ka pasqyrim të drejtpërdrejtë në direktivën 98/26/EC, ku diskutohen: finaliteti dhe ligjshmëria e urdhrave të transfertave përkundrejt shpalljes së falimentimit, fuqia prapavepruese e procedurave të falimentimit si dhe izolimi (mbrojtja) e të drejtave të mbajtësit të kolateralit nga ndikimet e falimentimit të ofruesit, brenda vitit 2006, do të realizohet amendimi i këtij vendimi duke adoptuar plotësisht direktivën e mësipërme;

Rregullore "Për debitimin direkt";

Rregullore "Për procedurat e sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)";

Rregullore "Për pagesat elektronike";

Rregullore "Për zhvillimin e kleringut".

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Krijimi i strukturave të përshtatshme brenda Sektorit të Pagesave, për organizimin dhe ndarjen e punës operacionale nga ajo mbikëqyrëse dhe rregullative: Krijimi i zyrës së politikave dhe mbikëqyrjes së sistemit të pagesave;

Njohja me direktivat e BE-se dhe evidentimi i çështjeve për tu pasqyruar në rregulloret ekzistuese mbi sistemin e pagesave

Njohja me rregulloret e institucioneve homologe;

Organizimi i takimeve me komitetin kombëtar të pagesave për çështjen e përafrimit të legjislacionit të pagesave;

Asistencë për përgatitjen e rregullores për debitimin direkt;

Ngritja e grupit të punës brendainstitucional për hartimin e projektligjit "Për regjimin e këmbimeve valutore".

Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2008-2009 janë si më poshtë:

Sigurimi i progresit në liberalizimin e plotë të lëvizjes së kapitalit, në përputhje me afatin e vendosur gjatë anëtarësimit në OBT (2010).

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projektligj "Për Sistemin e Pagesave";

Projektligj "Për rekordet elektronike".

Tabela 1

FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË STRUKTURAVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

ktivit	je	0
eti	nd	0
	ja	6
	ak	
	tu	
	ale	

rajni		8
me		8
		0
		+
		3
		2
		0
		=

htim
pers
onas
h

3.4 LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE

1. Objektivi Politik

Legjislacioni tregtar është një nga fushat prioritare në kuadër të procesit të integritimit, që Qeveria Shqiptare, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në nenet Neni 70 (3), Neni 6, 49, 50 (1), dhe 51 (1) të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, është angazhuar për përafrimin e legjislacionit mbi shoqëritë tregtare me *acquis communautaire*.

Një nga çështjet kryesore që duhet të gjejë rregullim në legjislacionin aktual të shoqërive tregtare, për të shmangur problemet që janë hasur në praktikën e zbatimit të ligjit lidhur me konfuzionin që krijohet shpesh herë midis termave “degë” dhe “filiali”, është përkufizimi më i qartë i këtyre koncepteve.

Aspekte të tjera të rëndësishme të trajtuara në nenin 50 të MSA -së, konsistojnë në lehtësimin e fillimit të veprimtarive në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga kompani dhe shtetas komunitarë duke garantuar trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar kompanive të saj, ose kompanive të një vendi të tretë, si dhe filialeve dhe degëve të tyre.

Në nenin 51 të MSA -së, parashikohet se, secila Palë mund të rregullojë vendosjen dhe veprimtarinë e kompanive dhe shtetasve në territorin e saj, përsa kohë që këto rregullore nuk krijojnë diskriminim për kompanitë dhe shtetasit e Palës tjetër krahasuar me shtetasit dhe kompanitë e saj.

2 Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Tri ligjet bazë në fushën tregtare, aktualisht në zbatim, janë:

Ligji nr. 7632, datë 04.11.1992 “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit tregtar” Ky ligj është pjesërisht i përafruar me direktivën e parë 68/151/EEC dhe direktivën e dytë 77/91/EEC amenduar me direktivën 92/101/EEC

Ligji nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, është ligji bazë që përcakton 4 forma shoqërie tregtare. Ligji është pjesërisht i përafruar me: direktivën e parë 68/151/EEC dhe direktivën e dytë 77/91/EEC amenduar, direktivën 92/101/EEC e tretë 78/855/EEC e amenduar, direktivën e gjashtë 83/349/EEC e amenduar, direktivën e katërt 78/660/EEC, e amenduar dhe të shtatë 83/349/EEC, e amenduar, dhe me direktivën e dymbëdhjetë 89/667/EEC,

Ligji nr. 7667, datë 28.01.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare” .Ky ligj është pjesërisht i përafruar me direktivën e parë 68/151/EEC, direktivën e dytë 77/91/EEC, direktivën e tretë 78/855/EEC dhe direktivën e gjashtë 83/349/EEC.

Aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, që ndërthuren me tre ligjet bazë tregtare, janë si në

vijim:

Kodi Civil i miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, i ndryshuar.

Kodi i Procedurës Civile i miratuar me ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, i ndryshuar.

Kodi Penal i miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar, parashikon veprat penale si rezultat i shpërdorimit të kompetencave nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës apo administratorët e shoqërive tregtare, përpilimin e dokumentacionit të rremë apo të falsifikuar, emetimin e parregullt të aksioneve, e të tjera.

Ligji nr. 7661, datë 19.01.1993 “Për kontabilitetin” - Përmbajtja e këtij ligji reflekton pjesërisht direktivën e katërt 78/660/EEC, dhe të shtatë 83/349/EEC.

Ligji nr 9009, datë 13.02.2003 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” .

Në zbatim të këtij ligji janë nxjerrë aktet nënligjore në vijim si dhe dy udhëzime të Ministrit të Financave:

VKM nr. 388, datë 12.06.2003 “Për ngritjen e Komisionit Shtetëror për kualifikimin e auditeve të brendshëm në sektorin publik” dhe VKM nr. 389, datë 12.06.2003 “Për përcaktimin e vjetërsisë në punë, për marrjen e titullit të përkohshëm “Audit i brendshëm në sektorin publik”.

VKM nr. 833, datë 11.12.2003 “Për funksionimin e Komitetit të Auditimit të brendshëm”.

VKM nr. 345, datë 01.06.2004 “Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm, të kodit etik për auditët e brendshëm dhe të kartës së auditimit të brendshëm politik”;

Ligji nr. 8901, datë 23.05.2002 “Për falimentimin” ;

Ligji nr. 8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguruese”.

Kuadri institucional ekzistues

Ministria e Drejtësisë: Reforma e legjislacionit tregtar ndiqet nga Sektori i së drejtës civile-tregtare, i krijuar gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2004 në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit.

Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës - Drejtoria e Nxitjes së Biznesit në dhe Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve (Alb Invest)

Këshilli Konsultativ i Biznesit - krijuar me Urdhërin e Kryeministrit nr.22, datë 23.01.2003.

Ministria e Financave - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për çështje që lidhen vetëm me fushën specifike që mbulon MF.

Gjykatat - Pranë gjykatës së shkallës së parë, Tiranë funksionon një seksion tregtar me 8 gjyqtarë si dhe zyra e regjistrit tregtar.

Zyra e Regjistrit Tregtar - Regjistri tregtar mbahet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit të Tiranës për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, bashkëpunojnë me administratën shtetërore duke kontribuar me mendime ose propozime për çështje që lidhen me mbarëvajtjen e tregtisë e të industrisë.

Organet e Prokurorisë - Prokuroria ushtron ndjekjen penale për kundravajtjet apo veprat penale për veprimet e kryera nga shoqëritë tregtare.

2.3. Asistenca teknike dhe financiare

Për shkak të rëndësisë që mbart legjislacioni civil dhe ai tregtar, nëpërmjet programit CARDS 2004, do të realizohet brenda vitit 2006 përmirësimi i legjislacionit organik dhe procedural me synimin e hartimit në radhë të parë, dhe funksionimit të përshtatshëm të strukturave të gjykatave për trajtimin e çështjeve civile e tregtare dhe administrative në përputhje me praktikën më të mira të BE-së.

Zbatimi i plotë i legjislacionit të ri tregtar dhe sistemit përkatës të gjykimeve administrative dhe tregtare do të realizohet nëpërmjet ngritjes së infrastrukturës së nevojshme fizike dhe institucionale dhe investimeve në drejtim të rritjes së kapaciteteve të këtij sistemi.

Rezultatet e pritshme parashikohen të jenë:

Përmirësimi i sistemit gjyqësor në çështjet civile e tregtare sipas standardeve të BE-së;

Në të ardhmen krijimi i gjykatave të posaçme tregtare;

Harmonizimi i legjislacionit vendas me praktikën më të mira të BE-së në çështjet sektoriale;

Mbajtja e seminareve, trajnimeve, vizitave studimore dhe aktiviteteve, binjakëzimi me gjykata tregtare dhe institucione të BE-së.

3. Adresimi i prioritetëve

3.1. Prioritetet afatshkurtra (2006 – 2007)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006-2007 janë si më poshtë:

Të zbatohet plani i veprimit për heqjen e barrierave administrative për investimet dhe të

sigurohet zbatimi i duhur, i hapur dhe jodiskriminues i legjislacionit, rregullave dhe procedurave që kanë të bëjnë me biznesin.

Të bëhet më pak i kushtueshëm, më i thjeshtë dhe më i mundur regjistrimi i shoqërive në të gjithë vendin.

Të miratohen ligje të përmirësuara në lidhje me tregtinë.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projektligj "Për disa dyshime në Ligjin nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare", për reduktimin e afatit të regjistrimit të shoqërive tregtare në gjykatë.

Projektvendim "Për informatizimin e regjistrit tregtar"

Projektligj "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare"

Ligji nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Studim për identifikimin e ndërhyrjeve të mëtejshme në legjislacionin tregtar.

3.5 TË DREJTAT E PRONËSISË INTELLEKTUALE DHE INDUSTRIALE

3.5.1 PRONESIA INTELLEKTUALE

Objektivi Politik

Qëllimi kryesor i politikave të mbrojtjes të drejtës së autorit në Republikën e Shqipërisë është garantimi i mbrojtjes të drejtave të autorit nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të Zyrës Shqiptare për të drejta të autorit si institucioni kryesor i mbrojtjes së këtyre të drejtave. Ky qëllim synohet të arrihet nëpërmjet:

Hartimit të akteve nënligjore dhe rregullatore për funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit;

Vendosjes së marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore dhe me operatorët e tjerë privatë që ndikojnë dhe janë të përfshirë direkt dhe indirekt në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të autorit në Shqipëri.

Forcimit dhe zgjerimi i kapaciteteve administrative (zyrat rajonale shqiptare për të drejtën e autorit), forcimi i bashkëpunimit me institucionet e përfshira në këtë proces për rritjen e efikasitetit të luftës kundër piraterisë.

Situata Aktuale

Kuadri Ligjor

Fusha e mbrojtjes së të drejtave të autorit rregullohet me aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

Ligji nr. 9380 dt.: 23,04,2005 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të". Projektligji ka përafëruar pjesërisht direktivat e Bashkimit Europian për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të si vijon:

Direktiva 92/100/KE. Mbi të drejtën e qerasë dhe huasë dhe mbi disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale;

Direktiva 93/98/KE. Mbi harmonizimin e afatit të mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe disa të drejtave fqinje;

Direktiva 91/250/KE. Mbi mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike;

Direktiva 2001/29/KE. Mbi harmonizimin e disa aspekteve të së drejtës së autorit dhe të drejtave fqinj në shoqërinë e informacionit;

Direktiva 96/9/KE. Mbi mbrojtjen e bazës së të dhënave;

Direktiva 93/83/KEE. Mbi koordinimin e disa rregullimeve rreth të drejtës së autorit dhe të drejtave fqinj lidhur me të drejtën e autorit të zbatuar për trasmetimin satelitor dhe ritrasmetimin me kabëll;

Direktiva 2001/84/KE. Mbi të drejtën e Rishitjes.

Ligji nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë" me ndryshimet përkatëse.

VKM nr. 120, dt. 27,01,1997 "Për shpërblimin e autoreve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor".

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 309, dt. 13.6.2000 “Për Tarifat e Përdoruesve të Pronësisë Artistike” ku përcaktohet se, te gjithë kategoritë e ndryshme te përdoruesve te të drejtave te autorit dhe te drejtave te përafërta me to, janë te detyruar te lidhin kontrate me shoqëritë e administrimit kolektiv te këtyre te drejtave dhe te paguajnë tarifat përkatëse te përcaktuara ne vendim.

Ligji nr. 8449, date 27.01.1999 "Për Kodit Doganor ne Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimi i Këshillit te Ministrave nr. 205, date 13.04.1999 "Për dispozitat zbatuese te Kodit Doganor te Republikës se Shqipërisë", i cili siguron një sistem masash kufitare për ndalimin e mallrave pirate dhe te falsifikuara qe cenojnë dhe shkelin te drejtat e pronësisë intelektuale.

Kodi Civil (Nenet 608,609,617) si dhe Kodi Penal (Nenet 147,148,149).

Shqipëria ka aderuar në këto konventa ndërkombëtare:

Ne Konventën e Bernës, "Për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike", nënshkruar në Bernë më 09.09.1886, plotësuar me aktin e Parisit me 24.07.1971 dhe ndryshuar me 02.10.1979. (Aderimi me dekret te Presidentit te Republikës nr. 487 date 09.03.1993).

Ne Konventën e Romës, "Për mbrojtjen e artistëve interpretues dhe ekzekutues, të prodhuesve të fonogrameve dhe të organizmave të radiodifuzionit", nënshkruar në Romë me 26 tetor 1961. (Aderimi me ligjin nr. 8579, date 16.02.2000 te Kuvendit të Shqipërisë)

Ne Konventën e Gjenevës, "Për mbrojtjen e prodhuesve të fonogrameve kundër riprodhimit të paautorizuar të tyre" nënshkruar në Gjenevë me 29 tetor 1971. (Aderimi me ligjin nr. 8585, date 15.03.2000, të Kuvendit të Shqipërisë).

Ne Konventën Universale “Për te Drejtën e Autorit” dhe Dy Protokollet Shtese te Saj, nënshkruar ne Paris, me 24 korrik 1971. (Aderimi me ligjin nr. 9129, date 08.09.2003, të Kuvendit të Shqipërisë)

Traktatet Ndërkombëtare:

Traktatin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WPO) , "Për mbrojtjen e artistëve interpretues dhe ekzekutues dhe prodhuesve të fonogrameve", ligji 8740, date 15.02.2001.

Traktatin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) "Për te drejtën e autorit", ligji 8838, date 22.11.2001.

Traktati “Mbi lidhjen e Marrëveshjeve ndërkombëtare” ligji nr. 8371 dt. 9.07.1998.

Kuadri Institucional

Zbatimi i Legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e te të drejtave te autorit, ushtrohet nëpërmjet këtyre institucioneve:

Ministria e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve është institucion qëndror që bën politikat në fushën e të drejtave të autorit. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar në 28 maj 2005 ligjin e ri “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera lidhur me të”.

Institucione te tjera me te cilat bashkepunon MTKRS jane :

Ministria e Drejtësisë,

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve,

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave,

Ministria e Financave,

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës,

Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës,

Këshillin Kombëtar të radios dhe Televizionit,

Gjykatat dhe

Prokuroritë.

Asistenca Teknike

Asistenca e huaj për hartimin e projektvendimit të ngritjes dhe funksionimit të zyrës shqiptare Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera lidhur me të” u mundësua nga USAID. Ky program e asistoi grupin shqiptar te punës me një eksperte të huaj të të Drejtës Ndërkombëtare dhe të Drejtës së Autorit.

Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra

Forcimi i kapaciteteve administrative për mbrojtjen e pronësisë intelektuale përfshirë ngritjen e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit.

Miratimi i legjislacionit dhe forcimi i kapacitetit administrativ në fushën e të Drejtave të Autorit.

Iniciativa Ligjore
VKM "Për statusin objektin e veprimtarisë dhe funksionimin e zyrës shqiptare për te drejtat e autorit"

VKM "Për miratimin e tarifave të shërbimeve që do të kryejë zyra shqiptare për te drejtat e autorit".

Aktivitetet Zbatuese

Ngritja e Zyrës Shtetërore për te Drejtat e Autorit;

Rekrutimi i stafit të Z. SH. D. A;

Pajisja e zyrës me logjistiken përkatëse të nevojshme për funksionimin eficient të saj në përputhje me standardet evropiane për një institucion të tillë;

Fushata sensibilizuese mediatike;

Botimi i publikimeve të ndryshme ;

Zhvillimi i seminareve dhe workshopeve.

Prioritetet afatmesme

Të zbatohen plotësisht konventat e ratifikuara ndërkombëtare, për të drejtën e pronësisë intelektuale, tregtare dhe industriale.

Të zbatohet në mënyrë të përshtatshme e drejta e pronësisë intelektuale dhe të shënohen arritje më të mira në fushën kundër piraterisë dhe falsifikimeve.

Të ngrihen zyra rajonale për të drejtën e autorit.

Iniciativa Ligjore

Hartimi i Urdhrave për krijimin e 6 Zyra-ve rajonale.

Aktivitetet Zbatuese

Krijimi i web page-it të Z.SH.D.A

Lidhja në rrjet të Z.SH.D.A me institucionet homologe të komunitetit

Forcimi i kapaciteteve në gjyqësor që lidhen me të drejtën e pronësisë intelektuale

Tabela: Shtese e kapaciteteve institucionale të MKRTS për Pronësinë Intelektuale

<i>INVESTIME</i>	<i>NJES</i>	<i>GJE</i>	<i>2</i>	<i>2</i>	<i>2008</i>
<i>IA</i>	<i>E</i>	<i>NDJA</i>	<i>006</i>	<i>007</i>	
<i>MATJES</i>		<i>AKTUALE</i>			
Konsulencë e huaj + Perktim e <i>acquis</i>	(mijë lekë)			1 8120	4000
Trajnime (mijë lekë)	(mijë lekë)		7 000	0	4500

3.5.2 PRONËSIA INDUSTRIALE

Zhvillimi i politikës

Objektivat kryesorë në fushën e pronësisë industriale, të cilët janë përcaktuar si objektivat prioritarë për institucionet shqiptare, në kuadrin e angazhimeve të marra për MSA-në dhe Programin e Qeverisë Shqiptare për periudhën 2005-2009, janë:

Sigurimi i një niveli të ngjashëm mbrojtjeje të të drejtave të pronësisë industriale, me atë të vendeve të Bashkimit Evropian brenda një periudhe katër vjeçare nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (Marrëveshja e Ndërmjetme - neni 40, MSA – neni 73);

Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit të biznesit për çështje të pronësisë industriale;

Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve zbatuese të legjislacionit të fushës, përfshirë sistemin gjyqësor.

Realizimi i objektivave të përcaktuara si prioritarë, është i lidhur ngushtë me realizimin e objektivave të tjera strategjike, të cilat konsistojnë në:

harmonizimin e legjislacionit kombëtar aktual në fushën e pronësisë industriale, me Direktivat e Komisionit Evropian në këtë fushë, përputhjen e plotë të këtij legjislacioni me marrëveshjen e TRPS-it, si dhe përputhjen e rregulloreve kombëtare me marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat

Shqipëria është anëtare;

anëtarësimin në traktate, konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare, në të cilat kanë aderuar vendet anëtare të BE-së (Marrëveshja e Strasburgut për klasifikimin ndërkombëtar të patentave, Marrëveshja e Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të dizenjosh industriale, Konventa Europiane e Patentave, Konventa për Ligjin e Patentave (WIPO);

forcimin e rolit të Drejtorisë së Patentave dhe Markave dhe ngritjen e një infrastrukture të përshtatshme administrative, brenda këtij institucioni, si organizmi kryesor në sistemin e mbrojtjes së pronësisë industriale;

ngritjen në një nivel më të lartë të implementimit të legjislacionit të fushës së pronësisë industriale në Shqipëri;

zhvillimin e burimeve njerëzore të specializuara në fushën e pronësisë industriale;

arritjen e një bashkëpunimi transparent ndërmjet institucioneve dhe organizatave të përfshira në sigurimin e mbrojtjes së pronësisë industriale;

rritjen e ndërgjegjësimit të publiku të gjerë dhe rretheve të interesuara në këtë fushë, si dhe trajnimin e tyre lidhur me rëndësinë e të drejtës së pronësisë industriale.

Situata Aktuale

Kuadri Ligjor

Fusha e Pronësisë Industriale rregullohet me aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

Kushtetuta e RSH-së, neni 58/1;

Kodi Civil i RSH-së aprovuar me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, në nenet 628-640;

Kodi Penal i RSH-së, në nenet 148, 149 dhe 288;

Kodi i Procedurës Civile i RSH-së, i aprovuar me ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996, në nenet 348, 334-336, 208-212, 527-608;

Kodi Doganor i RSH-së neni 82/4, si dhe Udhëzimi i KM -së nr. 205, datë 13.09.1999 “Për zbatimin e kodit doganor”, Titulli IX, nenet 118-127.

Funksionimi i Drejtorisë së Patentave dhe Markave rregullohet me aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

Ligjin 7819, datë 27.04.1994 “Për pronësinë industriale”, i cili siguron mbrojtjen e objekteve të pronësisë industriale, pikërisht për shpikjet dhe modelet e përdorimit, dizenjot industriale, markat tregtare e të shërbimit si dhe emërtimet e origjinës.

Ligjin 8477, datë 22.04.1999 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 7819”

Ligjin 8488, datë 13.05.1999 “Për mbrojtjen e topografive të qarqeve të integruara”

VKM 313, datë 13.06.2000 “Për funksionimin e Drejtorisë së Patentave dhe Markave”

Urdhërin e Kryeministrit datë 22.10.2001 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së patentave dhe markave”

Urdhrin e KKSHT -së nr. 5, datë 5.12.1994 “ Rregulla për emërtimet e origjinës”;

Urdhrin e KKSHT -së nr. 3, datë 4.10.1994 “Rregulla për markat”

Konventat, Marrëveshjet dhe aktet ndërkombëtare në të cilat ka aderuar Republika e Shqipërisë.

Shqipëria është anëtare e disa marrëveshjeve dhe konventave në fushën e pronësisë industriale:

Konventës së WIPO-s (organizata ndërkombëtare e pronësisë intelektuale) – 30.06.1992

Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale – 4.10.1995

Marrëveshjes së Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave – 4.10.1995

Protokollit të Marrëveshjes së Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave – 30.07.2003

Traktatit të bashkëpunimit në fushën e patentave – 4.10.1995

Marrëveshjes së Nice-s për klasifikimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve për efekt të regjistrimit të markave – 19.09.2003

Marrëveshjes së Budapestit për njohjen ndërkombëtare të depozitimit të mikroorganizmave për qëllime të procedurave të patentave – 19.09.2003.

Kuadri Institucional

Zbatimi i Legjislacionit në fuqi për garantimin e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale, ushtrohet nëpërmjet këtyre institucioneve:

Drejtoria e Patentave dhe Markave është institucioni i vetëm, nëpërmjet të cilit shteti shqiptar

jep të drejtën e pronësisë mbi shpikjet dhe modelet e përdorimit (patentat), markat tregtare e të shërbimit, dizenjet industriale dhe treguesit gjeografik apo emërtimet e origjinës, duke iu garantuar pronarëve të tyre këtë të drejtë, nëpërmjet regjistrimit.

Misioni i Drejtorisë është sigurimi i një sistemi efektiv të mbrojtjes së pronësisë industriale, sistem, i cili do të inkurajojë progresin teknologjik nëpërmjet transferimit të teknologjisë duke bërë të mundur zhvillimin e industrive lokale dhe nxitjen e Institucioneve të Kërkimit dhe Zhvillimit për krijimin e një mjedisi inovativ.

Ky mision realizohet nëpërmjet mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale, patentave për shpikje dhe modele përdorimi, markave tregtare, dizenjove industriale dhe treguesve gjeografike si dhe përhapjen e informacionit në lidhje me këto aktivitete.

Autoritetet Doganore si pjesë e sistemit të mbrojtjes së pronësisë industriale, janë të detyruara që me kërkesë të personit të interesuar, të verifikojnë dhe të kontrollojnë mallrat e falsifikuara dhe ato pirate.

Policia Tatimore është pjesë e sistemit të shkëmbimit të informacionit të nevojshëm, në rast të konstatimit të shkeljeve të të drejtave të pronësisë industriale.

Prokuroria është organi i procedimit penal pranë të cilit depozitohen kërkesat për rastet e falsifikimit ose piratimit të objekteve të pronësisë industriale, nga subjektet private kundër njeri tjetrit, bazuar në dispozitat e Kodit Penal. Duhet theksuar se, padia penale, si kërkesë e personit të dëmtuar nga piratimi apo falsifikimi, rezulton e papërdorur.

Policia e Krimit Ekonomik është një hallke tjetër e sistemit të mbrojtjes së pronësisë industriale. Ajo heton mbi bazën e denoncimeve të marra nga subjektet, pronarë të të drejtave të pronësisë industriale.

Sistemi Gjyqësor ka të bëjë kryesisht me Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka juridiksionin e përcaktuar nga Kodi i Procedurës Civile dhe ligji “Për pronësinë industriale”, për të vepruar si instancë e parë e specializuar për gjykimin e konflikteve që burojnë nga shkella e të drejtave të pronësisë industriale. Pranë kësaj gjykate është seksioni i gjykimin të çështjeve tregtare ku përfshihet edhe gjykimi i çështjeve të mësipërme. Krahas kësaj gjykate, në shkallën e dytë dhe të tretë, janë Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë, pranë të cilave ankimohen vendimet gjyqësore.

Asistenca Teknike

Drejtoria e Patentave dhe Markave është asistuar në punën e saj nga ekspertiza institucionale e WIPO-s, e Zyrës Europiane të Patentave dhe GTZ -ja, për përgatitjen e bazës së re ligjore në fushën e pronësisë industriale.

Në kuadrin e Programit CARDS Drejtoria është asistuar në përgatitjen e udhëzuesve për markat tregtare, si akte mbështetëse për zbatimin e ligjit.

Në përgatitjen e dokumentit të protokolleve të bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Patentave e Markave dhe përkatësisht Gjykatës, Prokurorisë e Doganës, Drejtoria është asistuar nga USAID – Programi i Ligjeve.

Në kuadrin e Programit CARDS janë përcaktuar aktivitetet trajnuese me punonjës të doganave, gjyqtarë e prokurorë, me punonjës të policisë tatimore.

Me asistencë të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) është bërë i mundur krijimi i bazës së të dhënave për të gjitha objektet e pronësisë industriale dhe instalimi i programit për regjistrimin dhe administrimin e objekteve të pronësisë industriale.

Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra

Në fushën e pronësisë industriale, Prioritet Afatshkurtër është sigurimi i një niveli të ngjashëm mbrojtjeje të të drejtave të pronësisë industriale me atë të vendeve të komunitetit, brenda një periudhe 4 vjeçare nga hyrja në fuqi e MSA-se

Iniciativa Ligjore

Në përputhje me prioritetin afatshkurtër, gjatë vitit 2006-2007, do të ndërmerren këto iniciativa ligjore:

Aprovimi i projekt ligjit “Për Pronësinë Industriale” në Qeveri dhe Parlament; ligji do të jetë në përputhje me Direktivën 98/44/EC “Për mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike”, Direktivën 89/104/EEC për përafrimin e ligjeve të vendeve anëtare lidhur me markat tregtare dhe Direktivën 98/71/EC për mbrojtjen ligjore të dizenjove industriale, Direktiven 2004/48/EC për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, rregulloren e Keshillit 40/94 mbi Markat e Komunitetit, rregulloren

6/2002 per Dizenjon e Komunitetit, propozimin per nje rregullore te Keshillit mbi Patentat e Komunitetit, rregulloren 1768/92 lidhur me krijimin certifikates per mbrojtje suplementare te produkteve mjeksore, rregulloren 816/2006 per licencat e detyrueshme te patentave lidhur me prodhimin e produkteve farmaceutike per eksport, ne vendet me probleme te shendetit publik.

Hartimi dhe aprovimi i akteve nenligjore (VKM, rregullore dhe udhezime) te domosdoshme per implementimin e ligjit;

Aderimi ne:

Marrveshjen e Strasburgut per klasifikimin nderkombetar te patentave;

Marrveshjen e Hagës per regjistrimin nderkombetar te dizenjos industriale;

Konventën Europiane te Patentave (EPC);

Konventën per Ligjin e Patentave (PLT-WIPO);

Nenshkrimi i protokolleve te bashkepunimit me:

Drejtorinë e Pergjithshme te Doganave;

Policinë e krimit ekonomik;

Gjykatën e Tiranës dhe Prokurorinë;

Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë

Aktivitete Zbatuese

Masat me karakter institucional, te cilat konsistojne ne rritjen e kapaciteteve njerëzore:

ne numër, duke e shtuar numrin me 13 specialistë, dhe

specializimin e burimeve njerëzore te perfshira ne procesin e dhënies se te drejtave te pronësisë industriale nepermjet programeve te trajnimit te specialistëve, te perfaqësuesve te autorizuar si dhe te personave te çdo kategorie tjetër te perfshirë ne procesin e mbrojtjes se pronësisë industriale.

Sistemimi i stafit ne ambiente te pershtatshme per realizimin e detyrave te ngarkuara me ligj dhe te objektivave te percaktuara ne kuadrin e MSA-së;

Hartimi dhe zbatimi i kalendarit vjetor per trajnimin e gjyqtarëve, prokurorëve ne bashkepunim me shkollën e Magjistraturës, te doganierëve, policisë tatimore e te krimit ekonomik ne bashkepunim me Ministrinë e Financave dhe atë te Brendshme, si dhe per trajnimin e agjentëve ligjore ne bashkepunim me Dhomën Kombëtare te Avokatisë.

Tabela: Shtese e kapaciteteve institucionale te DPM -së

<i>Instrumentet</i>	<i>N</i>	<i>G</i>	<i>G</i>	<i>2</i>					
	<i>jësia</i>	<i>e</i>	<i>jendja</i>	<i>jendja</i>	<i>e</i>	<i>006</i>	<i>007</i>	<i>008</i>	<i>009</i>
	<i>matjes</i>		<i>aktuale</i>	<i>pritshme</i>					
1. Shtim personash	pe		1	1				4	
	rsona		3	3		750	90		
2. IT+ zyra	/0							1	
	00 lekë					000	30.000		
3. Konsulencë (e	/0								
huaj)	00 lekë								
4. Trajnime (mijë	/0								
leke)	00 lekë					00			

3.6 KONKURRENCA DHE NDIHMA SHTETËRORE

3.6.1 KONKURRENCA

Objektivi politik

Fusha e konkurrencës është një fushë kyçe per realizimin e zonës së tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian. Per te vendosur një konkurrencë te lirë dhe te ndershme ne tregun shqiptar, Shteti shqiptar është i angazhuar te zbatojë detyrimet e percaktuara ne nenet 27, 38 dhe 39 te Marrveshjes së Ndërmjetme dhe ne nenet 40, 70, 71 dhe 72 te MSA - së. Per te arritur këtë objektivi, dukuritë që mund te ndikojne ne tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë si marrveshjet ndërmjet ndërmarrjeve, vendimet e marra dhe praktika te cilat kanë si objektivi ose pasojë

parandalimin dhe kufizimin e konkurrencës, apo abuzimi me pozitën dominuese nga 1 ose shumë ndërmarrje në territorin shqiptar do të eliminohen. Ndërmarrjet shtetërore do t'i nënshtrohen gjithashtu zbatimit të rregullave të konkurrencës. Qeveria shqiptare angazhohet të rregullojë progresivisht mono-polet shtetërore me karakter tregtar, me qëllim që të zhdukë çdo diskriminim në fushën e furnizimit dhe të tregtimit të mallrave. Në zbatim të këtyre rregullave Shteti shqiptar angazhohet të sigurojë një transparencë të madhe në shkëmbimin e informacioneve.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Kuadri ligjor për fushën e konkurrencës i cili mbështetet në nenet 81, 82 dhe 86 të Traktatit të Komunitetit Evropian përbëhet nga :

Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i cili është në përputhje të plotë me nenet 81, 82, dhe 86 të Traktatit të Komunitetit Evropian, Rregulloren nr. 2790/1999, Njoftimin e Komisionit nr. 2001/C3/02, nr. 97/C 372/03, Rregulloren nr.2790/1999, Rregulloren nr.4064/89, nr.1/2003 nr.447/98 .

Në zbatim të ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës" janë miratuar rregulloret e mëposhtme:

Rregullorja "Për Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës"

Rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës"

Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve", e cila është mbështetur në rregulloren 4064/89 .

Rregullorja "Për gjrobat dhe lehtësimin prej tyre", e cila është në përputhje me njoftimin 2003/C 10/13.

2.1 Kuadri institucional ekzistues

Autoriteti i Konkurrencës, si një institucion publik i pavarur, është ngritur në zbatim të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës". Autoriteti përbëhet nga Komisioni i Konkurrencës, si organi vendimmarrës dhe Sekretariati, si organi ekzekutiv i tij. Komisioni prej pesë anëtarësh është emëruar në bazë të vendimit Nr.123, datë 26.2.2004 nga Kuvendi i Shqipërisë, për një periudhë pesëvjeçare dhe vepron si një strukturë e përhershme.

Misioni i Autoritetit të Konkurrencës është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, nëpërmjet zbatimit të legjislacionit të konkurrencës, i cili përcakton rregullat e sjelljes jo vetëm të ndërmarrjeve, por edhe të shtetit në mbrojtjen juridike të konkurrencës, konkretisht në nxitjen e politikave të konkurrencës përmes liberalizimit, përmirësimit të praktikave të prokurimit, nxitjes së privatizimeve në rrugë konkurruese, si dhe forcimit të shtetit ligjor.

Autoriteti i Konkurrencës në bazë të ligjit bashkëpunon me Administratën qendrore dhe vendore, Entet rregullatore dhe Gjykatat.

2.3.Asistenca teknike dhe financiare

Politika e Konkurrencës në Shqipëri mbështetet nga projektet e mëposhtme:

Programi CARDS 2002 "Mbështetje për konkurrencën dhe ndihmën shtetërore" me një shumë prej 1,5 milion Euro.

3. Adresimi i prioriteteve

Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet afat-shkurtra për Autoritetin e Konkurrencës janë si më poshtë:

Të përmirësohet legjislacioni ekzistues mbi konkurrencën me qëllim forcimin e kontrollit mbi të;

Të forcohen kapacitetet e institucionit dhe konkretisht rritja e buxhetit dhe stafit të Autoritetit të Konkurrencës.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afat-shkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Vendim për miratimin e Strategjisë kombëtare të Konkurrencës

Rregullorja "Për zbatimin e rregullave të konkurrencës sipas neneve 81 dhe 82 të Traktatit të Komunitetit Evropian, e cila do të përafrohet plotësisht me rregulloren nr. 1/2003.

Rregullorja "Për procedurat në lidhje me nenet 81 dhe 82 të Traktatit të Komunitetit Evropian e cila do të përafrohet plotësisht me rregulloren nr. 773/2004.

Rregullorja "Për zbatimin e kontrollit të përqëndrimeve ndërmjet ndërmarrjeve e cila do të përafrohet plotësisht me rregulloren nr. 802/2004

Rregullorja "Për kontrollin e përqëndrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" e cila do të përafrohet plotësisht me rregulloren nr. 139/2004.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Forcimi i kapaciteteve institucionale të Autoritetit të Konkurrencës

Përgatitja dhe botimi i komentarit mbi mbrojtjen e konkurrencës

Organizimi i Konferencës Ndërkombëtare "Për politikën e Konkurrencës dhe ndihmës shtetërore në Bashkimin Europian"

Organizimi i seminareve mbi të drejtën e konkurrencës

Përgatitja dhe botimi i fjalorit terminologjik të konkurrencës

Tabela e mëposhtme tregon investimet që do të kryhen për fuqizimin e kapaciteteve administrative të Autoritetit të Konkurrencës.

Prioritetet afatmesme

Prioritetet afat-mesme për Autoritetin e Konkurrencës janë si më poshtë:

Zbatimi i legjislacionit mbi Konkurrencën

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Udhëzim "Për rregullat e përbashkëta në tregun e brendshëm të gazit natyror" e cila do të përafrohet plotësisht me Direktivën nr. 2003/55 CE

Udhëzim "Për mbajtjen e një niveli minimal stoku të naftës bruto ose nënprodhimeve të saj", e cila do të përafrohet plotësisht me direktivën nr.98/93 CE

Rregullore "Për kategoritë e marrëveshjeve vertikale të cilat i përkasin praktikave në lidhje me mjetet motorrike", e cila do të përafrohet plotësisht me rregulloren 1400/2002

Rregullore "Për kompetencat e personit të ngarkuar me kontrollin ligjor të dokumentave kontabël"

Rregullore "Për detyrimet e publikimeve të disa formave të shoqërive", e cila do të përafrohet plotësisht me direktivën nr. 2001/58 CE

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Forcimi i kapaciteteve institucionale të Autoritetit të Konkurrencës nëpërmjet trajnimeve për politikën e konkurrencës

Tabela

FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS

I estime	T jësia e matjes	C jendja aktuale	VITET		
			006	007	008
1 ntim sonash	F ersona	2 0	15		

3.6.2 NDIHMA SHETETËRORE

1. Objektivi Politik

Fusha e ndihmës shtetërore është një nga fushat prioritare në kuadër të procesit të integritimit,

detyrimet e së cilës përcaktohen në nenet 70 dhe 71 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe në nenin 38 të Marrëveshjes së Ndërmjetme. Këto nene parashikojnë domosdoshmërinë e përafrimit të legjislacionit vendas me “*acquis communautaire*”, si dhe ngritjen e strukturës së pavarur nga ana funksionale, e ngarkuar me kontrollin e skemave financiare të ndihmës shtetërore dhe ndihmave individuale që zbatohen në Shqipëri, me kompetencat e mjaftueshme ligjore mbi kthimin e ndihmave shtetërore të paligjshme. Qeveria shqiptare është e angazhuar në zbatimin e parimit të transparencës për të gjitha masat e ndërmarra nga organet e administratës qendrore dhe vendore, si dhe institucionet e tjera që veprojnë në emër të shtetit, të cilat lidhen me përdorimin e burimeve shtetërore. Për këtë do të përgatitet një inventar gjithëpërfshirës i skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore dhe vlerësimi i tyre sipas standardeve evropiane, si dhe do të përgatiten raportet vjetore për ndihmat shtetërore në Shqipëri, të cilat duhet t’i paraqiten Komisionit Evropian. Bazuar në llogaritjen e treguesve të GDP-së sipas nivelit të NUTS-II, do të përgatitet edhe harta rajonale që do të bëjë klasifikimin e zonave dhe rajoneve të vendit dhe, mbi bazën e treguesve të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, do të përcaktohen vlerat e intensitetit maksimal të lejuar për kategori të veçanta të ndihmës shtetërore në këto rajone.

2. Situata aktuale

2.1. Kuadri ligjor ekzistues

Kuadri ligjor për ndihmën shtetërore reflekton rregullat e legjislacionit parësor dhe dytësor evropian dhe përbëhet nga:

Ligji Nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën Shtetërore” i cili është në përputhje me nenet 87, 88 të Traktatit mbi Komunitetin Evropian dhe i harmonizuar plotësisht me Rregulloret Nr. 69/2001, 70/2001, 2204/2002, 68/2001, 659/1999.

Tre akte nënligjore janë miratuar në zbatim të tij, të cilat janë:

VKM nr. 815 datë 28.12.2005, “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale” e harmonizuar plotësisht me Udhëzimet e Komunitetit Nr. C 74/1998 “Mbi ndihmën kombëtare rajonale”.

VKM nr. 816 datë 28.12.2005, “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim” e harmonizuar plotësisht me Udhëzimet e Komuniteti Nr. C 244/02 2004 “Për ndihmën shtetërore për shpëtimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve në vështirësi”.

VKM nr. 817 datë 28.12.2005, “Për procedurat dhe formën e njoftimit” e harmonizuar plotësisht me Rregulloret e Procedurave Nr. 659/1999, 794/2004 të Komisionit Evropian.

Kuadri institucional ekzistues

Bazuar në legjislacionin në fuqi janë krijuar dhe funksionojnë dy strukturat e kontrollit të ndihmës shtetërore: Drejtoria e Ndihmës Shtetërore (1) në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Komisioni i Ndihmës Shtetërore (2):

Drejtoria e Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është struktura e ngarkuar me detyrat tekniko - administrative për kontrollin e ndihmave shtetërore në Shqipëri. Misioni i drejtorisë është zbatimi i legjislacionit në fushën e ndihmës shtetërore, nëpërmjet analizës, vlerësimit dhe kontrollit të skemave të ndihmës shtetërore dhe të ndihmave individuale, për të siguruar vendosjen e disiplinës së ndihmës shtetërore në vend, transparencën në përdorimin e fondeve publike, si dhe balancimin e politikave për realizimin e objektivave horizontale, sektoriale e rajonale.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore është organi vendim-marrës, i cili ka kompetencë të autorizojë planet për dhënien e ndihmës shtetërore, apo të urdhërojë kthimin e ndihmave të paligjshme. Në bazë të dispozitave të ligjit, Komisioni është një organ kolegjal i përbërë nga pesë anëtarë, i cili gëzon pavarësi në ushtrimin e funksioneve të tij.

Puna paraprake për zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore, veçanërisht në lidhje me transparencën në përdorimin e fondeve publike dhe përgatitjen e inventarit të skemave të ndihmës shtetërore, ka kërkuar bashkëpunimin e institucioneve dhe strukturave të tjera administrative në nivel qendror dhe lokal.

Me hyrjen në fuqi të ligjit, bashkëpunimi me institucionet e administratës qendrore dhe vendore është bërë më i domosdoshëm, për shkak të detyrimeve ligjore që kanë këto institucione, si dhënës të drejtpërdrejtë të ndihmave shtetërore.

2.3. Asistenca teknike dhe financiare

Fusha e ndihmës shtetërore mbështetet nga disa projekte të tilla si:

projekti CARDS 2002 “Mbështetje për konkurrencën dhe ndihmën shtetërore” me një shumë

prej 500 000 Euro.

projekti CARDS 2005 për asistencë afatshkurtër për zgjidhjen e rasteve konkrete të ndihmës shtetërore, si dhe për trajnimin e strukturave të kontrollit dhe dhënësve të ndihmës shtetërore me shumë prej 200.000 Euro.

projekti BERIS i Bankës Botërore për fuqizimin e kapaciteteve institucionale të strukturave të kontrollit të ndihmës shtetërore me shumë prej 260 000 Euro.

3. Adresimi i prioriteteve

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatshkurtër janë si më poshtë:

Të miratohet legjislacioni zbatues për ndihmën shtetërore;

Të ngrihet dhe të funksionojë një autoritet funksionalisht i pavarur për ndihmën shtetërore;

Të sigurohet progres në përfundimin e një inventari të detajuar për ndihmën shtetërore

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Udhëzimi mbi paraqitjen e ankesave për ndihmat e paligjshme, dhe vlerësimin e ndihmave të paligjshme, i cili do të përafrohet plotësisht me Komunikatën e Komisionit Evropian OJC 110, 150, 116.

VKM mbi inventarin e skemave të ndihmës shtetërore.

Udhëzim për bllokun e përjashtimeve, i cili do të përafrohet plotësisht me rregulloret 68/2001, 363/2004, 70/2001, 364/2004, 2204/2002

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Fuqizimi i kapaciteteve administrative të strukturave të ndihmës shtetërore

Vënia në funksionim e Sistemit të menaxhimit të të dhënave, si dhe përgatitja e një faqeje të veçantë në internet

Përgatitja e një inventari gjithëpërfshirës të skemave të ndihmës shtetërore

Ndërgjegjësimi i komunitetit të biznesit, nëpërmjet organizimit të veprimtarive për evidentimin e rëndësisë së zbatimit të skemave të ndihmës shtetërore dhe ndikimet e tyre në zhvillimin e rajoneve, sektorëve ekonomikë dhe konkurrencës në treg.

3.2 Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:

Të zbatohet legjislacioni mbi ndihmën shtetërore

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Udhëzim për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve publike, i cili do të përputhet plotësisht me Komunikatën OJC 297

Udhëzim për metodologjinë e analizës së kostove standarde të ndihmës shtetërore dhe modelet e deklarimit të informacionit për kualifikimin e SME-ve, i cili do të përafrohet plotësisht me Komunikatat OJC 281, OJC 118

VKM për përgatitjen e raportit vjetor për ndihmën shtetërore

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Fuqizimi i kapaciteteve administrative të strukturave të ndihmës shtetërore

Përcaktimi i zonave dhe intensiteteve përkatëse të ndihmës shtetërore për përgatitjen e hartës rajonale të ndihmës shtetërore

Ndërgjegjësimi publik për konceptin e ndihmës shtetërore

Prioritetet afatgjata

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatgjatë janë si më poshtë:

Të zbatohet legjislacioni mbi ndihmën shtetërore

Në vitet 2009-2012 do të punohet për plotësime të mundshme të këtij kuadri ligjor, në varësi të ndryshimeve apo reformave që mund të ndërmarret Komisioni Evropian në fushën e ndihmës shtetërore.

Tabela
FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË DREJTORISË SË NDIHMËS
SHTETËRORE

Inves	Ë	C	VITET		
	jësia e matjes	jendja aktuale	006	007	008
1.Sht ersonash	Ë ersona	Ë			
2.IT	(mijë lekë)	Ë	X		500
3.Ko encë (e)	(mijë lekë)	Ë	050	500	875
4.Tra e (mijë)	(mijë lekë)	Ë	250	500	625

3.7 PROKURIMI PUBLIK

1. Zhvillimi i politikës për prokurimin publik

Qëllimi kryesor i politikave të prokurimit publik në Republikën e Shqipërisë është garantimi dhe respektimi i procedurave të prokurimit publik, duke siguruar hapjen e kontratave publike mbi bazat e mos-diskriminimit, sipas skedulit të angazhimeve të OBT-së.

Objektivat kryesor të politikave të prokurimit publik në Republikën e Shqipërisë janë:

Përafrimi i kuadrit ligjor me *acquis communautaire*

Garantimi adekuat i procedurave të ankimimit, Ngritja e Komisionit të Ankimimit

2. Situata Aktuale

2.1 Kuadri Ligjor

Fusha e Prokurimit Publik rregullohet me aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

Ligji nr. 7971, date 26.07.1995 “Për Prokurimin Publik”, ndryshuar me ligjet nr. 8039, date 23.11.1995, nr. 8074, date 22.2.1996, nr. 8112, date 28.3.1996, nr. 8767, date 5.4.2001, nr. 9064, date 8.05.2003, nr. 9872 date 14.04.2005, nr 9450 date 15.12.2005.

Ky ligj, i cili reflekton pjesërisht parimet e sanksionuara në direktivat 93/36/EEC, 89/665/EEC, 92/50/EEC, nuk rregullon prokurimet në sektorin utilitar (ujë, energji, transport, telekomunikacion dhe shërbim postar). Për secilën nga sektorët e mbuluar nga Direktiva 92/13/EEC parashikohen procedura të veçanta të prokurimit në përputhje me Udhëzimin nr. 1 date 1.01.1996 “Për Prokurimin Publik”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 335, date 23.06.2000 “Për rregullat e prokurimit publik” përditësuar me VKM 228, date 24.5.2002, VKM 337, date 01.6.2004, VKM 337, date 01.06.2004 VKM nr 36 date 18.01.2006, VKM nr 127 date 02.03.2006);

Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 1 date 01.01.1996 “Për prokurimin publik” ndryshuar me UKM nr. 1, date 24.5.2002, UKM nr. 3 date 10.07.2003, UKM nr. 4, date 16.06.2005, UKM nr. 1, date 18.01.2006 dhe UKM nr. 2, date 27.01.2006.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 675, date 20.12.2002 (ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 146, date 07.03.2003 dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 546, date

01.08.2003) “Për përdorimin e fondeve buxhetore për mallra, ndërtim dhe shërbime”.

Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr. 3 date 10.07.2003 “Për miratimin e Dokumentit Standard të Tenderit si dhe Manualin e Përdoruesit”.

Kuadri Institucional

Zbatimi i Legjislacionit në fuqi për prokurimin publik ushtrohet nëpërmjet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Agjencia e Prokurimit Publik (APP) është organi qendror për mbikëqyrjen dhe koordinimin e sistemit të prokurimit publik në Shqipëri. Mbi këtë bazë, APP-ja është organi kompetent për kontrollin e procedurave të tenderimit të zhvilluara nga ente të ndryshme prokuruese, të ministrive apo institucioneve të tjera. Krahas ekzistencës si organ kontrolli, kjo Agjenci nxit dhe ndihmon në kualifikimin e punonjësve të organeve qendrore e lokale, që merren me prokurimin publik si dhe jep udhëzime dhe, sipas kërkesës, këshilla e ndihme enteve prokuruese që ndërmarrin një procedure prokurimi.

Institucioni i Agjencisë së Prokurimit Publik është organ qendror, person juridik, publik, buxhetor në varësi të Këshillit të Ministrave. Në të njëjtën kohë, në institucionet respektive veprojnë entet prokuruese, komisioni i vlerësimit të ofertave dhe njësi e prokurimit përgjegjëse për prokurimin me fonde publike që i vihen në dispozicion.

Në funksion të misionit të saj, Agjencia e Prokurimit Publik:

nxjerr Buletinën e Prokurimit Publik [do pesë ditë që publikon të gjitha njoftimet për zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe fituesve të shpallur në këto procedura

bën inspektimin e dokumentacionit përkatës për procedurat e prokurimit dhe ushtron kontroll pranë enteve prokuruese.

shqyrton ankesat e kandidateve në procedurat e prokurimit.

Asistenca Teknike

Në fushën e Prokurimit Publik janë në zbatim këto projekte:

Projekti “Mbështetje për Prokurimin Publik” me një vlerë prej 3 milion eurosh, në kuadër të programit CARDS 2002. Agjencia e Prokurimit Publik ka përfituar vetëm nga komponenti asistence teknike 2.5 milion Euro për “Përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* në fushën e prokurimit publik”, i cili ka filluar nga zbatimi në shtator të vitit 2004 dhe përfshinë asistence teknike dhe ligjore. Deri tani është realizuar:

vlerësimi i situatës ligjore dhe institucionale

ka përfunduar hartimi i projektligjit të ri “Për Prokurimin Publik”

trajnimi i stafit të APP-së në të tre sektorët

Projekti “Në fushën e ligjit dhe akteve nënligjore të prokurimit publik” me vlerë 255.000 USD, në kuadër të asistencës nga Banka Botërore, ka pasur si objektin ndryshimet në ligjin dhe aktet nënligjore të prokurimit publik. Ky projekt ka dhënë një ndihmë të konsiderueshme kryesisht në fushën e trajnimeve të administratës publike.

APP tashmë ka tenderuar dhe kontraktuar me USAID për Projektin “Sfidat e Mijëvjeçarit” për një vlerë me 5 mln USD.

3. Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra

Në fushën e Prokurimit Publik, prioritetet afatshkurtra janë:

Hapja e kontratave publike mbi bazat e mos-diskriminimit, në kuadër të OBT

Kompanitë Komunitare të vendosura në Shqipëri duhet të gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes në procedurat e tenderimit njësoj me kompanitë vendase nga momenti i hyrjes në fuqi të marrëveshjes

Garantimi dhe respektimi i ligjit dhe akteve nënligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik

*Përafrimi i kuadrit ligjor me *acquis communautaire**

Forcimi i Agjencisë së Prokurimit Publik dhe enteve prokuruese në ministrinë e linjës

Mënjanimi i shmangies nga parimi i tenderit të hapur

Garantimi adekuat i procedurave të ☐nimit

Sigurimi i zbatimit rigoroz i procedurave të tenderimit

Sigurimi i hetimit dhe ndjekja penale për shkeljet që kanë lidhje me prokurimin

Iniciativa Ligjore

Miratimi Ligjit Kuadër “Për Prokurimin Publik”, në përputhje me Direktivën 2004/18/EC,

89/665/EEC, Direktivën 2004/17/EC, 92/13/EEC.

Projekt-ligji i hartuar tashme synon harmonizimin e pjesshëm, por në një shkallë të lartë në këto direktiva.

Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit brenda vitit 2007.

Aktivitetet Zbatuese

Forcimi i kapaciteteve administrative të APP dhe njohja e studimi i ligjit të ri

Përmirësimi i sistemit të informimit përmes konsolidimit të ëb-site lidhur me procedurat e prokurimit.

Ngritja e komisionit shtetëror për të shqyrtuar procedurat e ankimit.

Prioritetet afatmesme

Të sigurohet harmonizimi i kuadrit ligjor shqiptar me acquis e BE-së.

Të bëhen plotësisht funksionale strukturat e prokurimit publik, me anë të zbatimit të rreptë të procedurave për prokurimin publik, në përputhje me ligjin dhe me kërkesat e MSA-së.

Akses i Kompanive shqiptare në procedurat e tenderimit në Komunitet, në baze të ligjeve të këtij te fundit.

Kompanitë Komunitare jo të vendosura në Shqipëri duhet të gëzojnë akses në procedurat e tenderimit në baze të legjislacionit shqiptar, jo më vonë se [4 vjet] pas hyrjes në fuqi të MSA-se.

Iniciativa Ligjore

Amendimi i Ligjit "Për Prokurimin Publik" dhe akteve nënligjore duke harmonizuar plotësisht legjislacionin shqiptar me atë të Bashkimit Europian në fushën e prokurimit publik.

Tabela: Shtesa e kapaciteteve institucionale të APP

INVE	NJES	GJE	2006	2007	2008
STIME	IA	NDJA			
	MATJES	AKTUALE			
Shtesa	Nepu	25	+ 2		
personeli	nes				

3.8 BUJQËSIA

3.8.1 SIGURIA USHQIMORE

Zhvillimi i politikës për sigurinë ushqimore

Qëllimi kryesor i politikave të sigurisë ushqimore në Republikën e Shqipërisë është ngritja dhe forcimi i sistemit të sigurisë së ushqimit dhe sistemeve të kontrollit që kanë lidhje me të, me fokus mbrojtjen e konsumatorit.

Ky qëllim synohet të arrihet nëpërmjet:

Përafrimit të legjislacionit vendas me atë të BE-së në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit (neni 71 i MSA - së).

Përmirësimit të sigurisë së ushqimeve dhe kushteve fitosanitare dhe veterinarë, në përputhje me standardet Komunitare.

Përgatitjes së një strategjie kombëtare për përmirësimin e përpunimit të ushqimit, në mënyrë që të plotësojnë standardet e BE-së.

Situata Aktuale

Kuadri Ligjor

Fusha e Sigurisë Ushqimore rregullohet me aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

Ligji Nr. 7941, dt. 31.05.1995 "Për ushqimin", i cili zbatohet për materialet e para, produktet ushqimore, materialet ndihmëse dhe aditivët dhe përmban dispozita mbi përpunimin, paketimin, marketimin, inspektimin dhe kontrollin.

VKM Nr.604, dt. 17.11.2000 "Për etiketimin e produkteve ushqimore" i cili është mbështetur pjesërisht në Direktivën 79/112 EEC datë 18 Dhjetor 1978 "Përafrimi i ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me etiketimin, paraqitjen dhe reklamimin e produkteve ushqimore për shitje tek konsumatori".

VKM Nr.609, dt. 17.11.2000 "Për industrializimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale" mbështetur pjesërisht në Direktivën 80/777/EEC, "Për përafrimin e legjislacionit të Shteteve Anëtare në lidhje me shfrytëzimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale".

Urdhër i përbashkët i Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministrit të Shëndetësisë Nr.698

datë 16.12.2003 “Mbi përdorimin e disa ëmbëlsuesve ushqimor në produktet ushqimore” mbështetur pjesërisht në Direktivat 89/107/KEE “Për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare mbi aditivët e lejuara për t’u përdorur në ushqimet njerëzore” dhe 94/35/EC “Mbi ëmbëlsuesit që përdoren në ushqime”.

Urdhër i përbashkët i Ministrisë të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministrisë të Shëndetësisë Nr.698 datë 16.12.2003 “Mbi përdorimin e disa ngjyresve ushqimor në produktet ushqimore” i mbështetur pjesërisht në Direktivën 94/36/EC “Mbi ngjyresit që mund të përdoren në ushqime”.

Urdhër i Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr. 209 datë 27.03.2006 “Mbi përdorimin e aromatizuesve në produktet ushqimore” i mbështetur pjesërisht në Direktivën 2002/113/ KE, “Mbi përdorimin e aromatizuesve në produktet ushqimore”

Urdhër i Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr. 210 datë 27.04.2006 mbi miratimin e rregullores “Mbi përdorimin e aditiveve ushqimore të tjerë nga ngjyresit dhe ëmbëlsuesit” i mbështetur pjesërisht në Direktivën 2001/5/KE, Direktivës 2003/52/KE, Rregullores (KE) 1882/2003 dhe Direktivës 2003/114/KE.

Urdhër i Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr.302 datë 29.07.2005 “Mbi higjenën e produkteve ushqimore”, i mbështetur pjesërisht në 93/43/KE “Mbi higjenën ushqimore”.

Kuadri Institucional

Zbatimi i Legjislacionit në fuqi për sigurinë ushqimore, ushtrohet nëpërmjet këtyre institucioneve:

Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me Drejtorinë e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (DSUMK) është përgjegjëse për hartimin e politikave të kontrollit të sigurisë dhe cilësisë së produkteve ushqimore. DSUMK - ja zhvillon aktivitetin e saj në zbatim të ligjit nr. 7941 datë 31.05.1995 “Për Ushqimin” dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. DSUMK - ja i ushtron funksionet e saj nëpërmjet Inspektoriatit të Sigurisë Ushqimore pranë Drejtorive Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit.

Inspektoriat i Sigurisë Ushqimore është përgjegjës për kontrollin e sigurisë dhe cilësisë së produkteve ushqimore të importuara, të prodhuara dhe të tregtuara në vend si dhe të lëndëve të para të përdorura në industrinë ushqimore. Inspektorët e Sigurisë Ushqimore janë të vendosur pranë çdo pike të kalimit kufitar dhe pikave doganore. Inspektoriat i Sigurisë Ushqimore ushtron kontroll mbi:

materialet e para (me përjashtim të atyre që janë nën përgjegjësinë e veterinarisë), aditivët, materialet ndihmëse dhe produktet përfundimtare për treguesit cilësorë të deklaruar dhe të miratuar;

falsifikimin e ushqimit;

godinat, proceset dhe pajisjet e përdorura për prodhimin, pra teknologjia;

paketimin dhe etiketimin;

kushtet teknologjike të trajtimit, magazinimit dhe transportit;

sistemet e kontrollit të cilësisë të aplikuara nga prodhuesit,

dokumentacionin teknik dhe teknologjik.

Inspektorët ushqimore mund të vendosin për:

bllokimin e produkteve ushqimore që nuk plotësojnë kërkesat e ligjit;

asgjësimin e mallrave ushqimore, të cilat pas kontrollit laboratorik rezultojnë se nuk janë në përputhje me standardet ose që u ka kaluar afati i përdorimit;

mbylljen e aktivitetit prodhues dhe vendosjen e gjobave për shkeljet e konstatuara.

Struktura administrative e garantimit të sigurisë ushqimore plotësohet edhe nga laboratorët e kontrollit të sigurisë ushqimore, ku përfshihet Instituti i Kërkimeve Veterinare (IKV) dhe Instituti i Kërkimeve të Ushqimit (IKU) dhe njëmbëdhjetë laboratore rajonale.

IKV dhe IKU janë Qendra Reference në kontrollin e sigurisë dhe cilësisë së ushqimeve dhe kryejnë analiza të një spektri të gjerë që mbulojnë fushën e sigurisë dhe cilësisë ushqimore.

Në nivel rajonal funksionojnë njëmbëdhjetë laboratore, katër nga të cilat, Durrës, Vlorë, Shkodër dhe Gjirokastrë, janë të pajisura me teknologjinë e nevojshme për të kryer analizat për përcaktimin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore si dhe të lëndëve të para të përdorura në industrinë ushqimore. Laboratorët janë pajisur nga projekte të Bankës Botërore, Qeverisë Italiane dhe PHARE-BE.

Departamenti Analitik në IKU dhe Laboratori Rajonal i Kontrollit Ushqimor në Durrës janë çertifikuar nga kompania italiane CERMET për ISO 9001.

MBUMK – ja është duke vlerësuar mundësitë e racionalizimit të laboratorëve, futjen e metodave të reja, infrastrukturës, pajisjeve, stafit dhe llojit të analizave që kryhen.

Asistenca Teknike

Në fushën e Sigurisë ushqimore janë në zbatim këto projekte:

Projekti “Për sigurimin e pajisjeve laboratorike për laboratorët e kontrollit ushqimor” i mbështetur nga Qeveria Italiane (2003-5 - €2 m), jep mbështetje për sigurinë ushqimore, duke përfshirë mbështetjen për institutin e veterinarisë, për testimin e mbetjeve kimike dhe për trajnimin e stafit laboratorik të testimit të ushqimit.

Projekti i sigurisë dhe kontrollit ushqimor (CARDS MIP € 2 m) është propozuar të përfshihet në programin CARDS 2005-6 për të adresuar boshllëqet në sistemin shqiptar të standardeve ushqimore, sigurinë dhe higjenën. Ky projekt do të mbështesë:

asistencë në Përafrimin e Legjislacionit Shqiptar të sigurisë ushqimore me *acquis communautaire*,

asistencë në ngritjen e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Ushqimore, financime për forcimin e laboratoreve për testimin e ushqimit.

Në vitin 2006 fillon projekti CARDS 2005 “për ngritjen e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (A.K.U)” i cili është planifikuar të përfundojë në vitin 2008.

Autoritetit Kombëtar i Ushqimit do të funksionojë si një agjenci autonome dhe do të jetë përgjegjës për të gjitha çështjet e sigurisë ushqimore dhe higjenës, për harmonizimin e legjislacionit me standardet europiane, si dhe për dhënien e informacionit ndaj publikut. AKU –ja do të përmbledhë në vetvete kompetenca të MBUMK- së dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Gjithashtu, projekti për akreditimin e laboratorëve, 2006-2008, do të shërbej po për qëllimin e funksionimit të AKU-së.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2006 do të hartohet drafti i ligjit të ri për ushqimin në përputhje me Rregulloren 178/2002/KEE “Për parimet e përgjithshme dhe kriteret legjislacionit ushqimor”.

Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra

Në fushën e sigurisë ushqimore, Prioritetet Afatshkurtra janë:

Forcimi i sistemit të sigurisë së ushqimit dhe sistemeve të kontrollit që kanë lidhje me të;

Përafrimi i legjislacionit vendas me atë të BE-së në fushën e Mbrotjes së Konsumatorit (Neni 71 i MSA -së).

Iniciativa Ligjore

Në përputhje me prioritetet afatshkurtra, gjatë vitit 2006-2007, do të ndërmerren këto iniciativa ligjore:

Ligji i ri “Mbi Ushqimin” i cili synon të përafrojë pjesërisht Rregulloren 178/2002/EC,

Rregullorja “Mbi etiketimin e produkteve ushqimore” e cila synon të përafroje pjesërisht Direktivat 89/396/EEC; 90/496/EEC; 94/54/EC dhe 2000/13/EEC,

Rregullorja “Mbi inspektimin zyrtar të produkteve ushqimore” e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 89/396/EEC,

Urdhëri i Ministrit “Mbi aromatizuesit ushqimorë të autorizuar”, i cili synon të përafrojë pjesërisht Direktivat dhe Rregulloret 2232/96/EC; 1999/217/EC; 2002/113/EC; 1565/2000/EC dhe 622/2002/EEC;

Rregullorja “Mbi substancat aromatizuese kimike të përcaktuara”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivat 88/388/EEC dhe 91/71/EEC,

Rregullorja “Mbi verifikimin e kriterit të pastërtisë për aditive të caktuara të autorizuar”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivat 95/31/EC; 95/45/EC; 97/77/EC; 98/66/EC; 98/86/EC; 1999/75/EC; 2001/30/EC; 2001/50/EC; 2001/52/EC; 2003/95/EC; 2004/45/EC dhe 2004/47/EC,

Rregullorja “Mbi përcaktimin e kriterit të pastërtisë së emulsifikatorëve, stabilizuesve, mpiksësve dhe agentëve xhelatinoze”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivat 78/663/EEC; 82/504/EEC; 90/612/EEC dhe 92/4/EEC,

Rregullorja “Mbi kontaminuesit në ushqime”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Rregulloren 315/93/EEC,

Rregullorja “Mbi nivelet maksimale për kontaminues të caktuar”, e cila synon të përafrojë

pjesërisht Rregulloren 466/2001/EEC,

Rregullorja “Mbi skemën e përgjithshme të materialeve në kontakt me ushqimin”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 89/109/EEC.

Rregullorja “Mbi materialet e monomer klorur vinilit në kontakt me ushqimin”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivat 78/142/EEC; 80/766/EEC dhe 81/432/EEC;

Rregullorja “Mbi materialet plastike në kontakt me ushqimin”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivat 90/128/EEC; 96/3/EURATOM dhe 2002/72/KE.

Aktivitete Zbatuese

Për të bërë të mundur plotësimin e detyrimeve ligjore dhe përmbushjen e prioriteteve afatshkurtra, gjatë vitit 2006-2007, do të ngrihen dhe forcohen kapacitetet administrative të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (mbështetur nga projekti CARDS 2005 “për ngritjen e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (A.K.U)”, i cili është planifikuar të përfundojë në vitin 2008)

Prioritetet afatmesme

Në përputhje me rekomandimet e Partneritetit Europian dhe detyrimet që rrjedhin nga Neni 76 i MSA -së, Prioritetet Afatmesme janë:

Të arrihen përmirësime thelbësore për sa i takon sigurisë së ushqimeve dhe kushteve fito-sanitare dhe veterinare, në përputhje me standardet e KE-së. Të përgatitet një plan për përmirësimin e përpunimit të ushqimit, në mënyrë që të plotësojnë standardet e BE-së;

Përafrimi i standardeve të mbrojtjes së konsumatorit në Shqipëri me ato Komunitare, në mënyrë që të sigurohet një funksionim normal i tregut. Kjo mbrojtje do të varet nga zhvillimet e infrastrukturës administrative në mënyrë që të sigurohet mbikëqyrja e zbatimit të ligjit.

Iniciativa Ligjore

Në përputhje me prioritetet afatshkurtra, gjatë vitit 2008-2010, do të ndërmerren këto iniciativa ligjore:

Rregullorja “Mbi testimin e migrimin të përbërësve të materialeve plastike në kontakt me ushqimin”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivat 82/711/EEC; 85/572/EEC; 93/8/EC dhe 97/48/EC,

Rregullorja “Mbi çlirimin e substancave N-nitrosamina dhe N-nitrosatable nga elastomeret ose përbërësve plastikë”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivat 93/11/EC dhe 89/109/EEC.

Rregullorja “Mbi artikujt qeramikë në kontakt me ushqimet”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 85/500/EEC,

Rregullorja “Mbi materialet e përbëra nga filmat celulozë të rigjeneruar në kontakt me ushqimin”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 93/10/EC,

Rregullorja “Mbi materialet që përmbajnë derivate të caktuara epoksi dhe që janë në kontakt me ushqimin”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 2002/816/EC.

Rregullorja “Mbi masat shtesë në lidhje me kontrollin e produkteve ushqimore”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 93/99/EC,

Rregullorja “Mbi metodat e marrjes së mostrave dhe analizave për monitorimin e produkteve ushqimore të përcaktuara për konsum njerëzor”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivat 85/591/EEC; 87/524/EEC; 98/53/EC 2001/22/EC 2002/26/EC dhe 2002/69/EC.

Rregullorja “Mbi aromatizuesit tymues”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Rregulloren 2065/2003/EC,

Rregullorja “Mbi krijimin e Aneksit 1 të listimit të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, për të cilat janë zbatuar nivelet maksimale të mbetjeve të pesticideve”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Rregulloren 178/2006/EC.

Rregullorja “Mbi inventarizimin e burimit të materialeve dhe substancave të përdorura në përgatitjen e aromatizuesve”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 88/389/EEC.

Rregullorja “Mbi ushqimet me ngrirje të shpejtë”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 2002/16/EC,

Rregullorja “Mbi ushqimet dhe produktet bujqësore të rritura në mënyrë organike”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Rregulloret 2092/91/EEC dhe 392/2004/EC,

Rregullorja “Mbi përdorimin e përmbajtjeve të mikro-organizmave gjenetikisht të modifikuar”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivat 90/219/EEC dhe 98/81/EC,

Rregullorja “Mbi ushqimet e reja dhe ingredientet e ushqimeve të reja (OMGJ)”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 2001/18/EC dhe Rregulloren 1830/2003/EC,

Rregullorja “Mbi gjurmimin dhe etiketimin e OMGJ-ve”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 2001/18/EC dhe Rregulloren 1830/2003/EC,

Rregullorja “Mbi ushqimet e përcaktuara për përdorim me vlerë ushqimore të përcaktuar”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivat 89/398/EEC; 96/84/EC dhe 2001/15/EC.

Rregullorja “Mbi ushqimet me bazë cereale të përpunuara dhe ushqimet për fëmijë, të vegjël dhe të rritur”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 96/5/EC,

Rregullorja “Mbi ushqimet e përdorura në dieta kufizuese të energjisë për uljen e peshës”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 96/8/EC.

Rregullorja “Mbi formulat e ushqimeve për fëmijë të vegjël”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 91/321/EEC,

Rregullorja “Mbi ushqimet dietike për qëllime mjeksore të caktuara”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 1999/21/EC.

Rregullorja “Mbi ushqimet shitesë”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 2002/46/EC,

Rregullorja “Mbi yndyrnat dhe vajrat e ngrënshme: niveli i acidit erucic”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 76/621/EC.

Rregullorja “Mbi kakaon dhe çokollatën”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 2000/36/EC,

Rregullorja “Mbi sheqerin”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 2001/111/EC.

Rregullorja “Mbi lëngjet e frutave dhe produkteve të ngjashme”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivat 93/77/EEC dhe 93/45/EC,

Rregullorja “Mbi reçelin e frutave, xhelet, marmalatat dhe puren e gështenjave”, e cila synon të përafrojë pjesërisht Direktivat 79/639/EEC; 80/1276/EEC dhe 88/593/EEC.

Aktivitetet Zbatuese

Për të bërë të mundur plotësimin e detyrimeve ligjore dhe përmbushjen e prioriteteve afatmesme, gjatë vitit 2008-2010, do të vazhdojë forcimi i kapaciteteve administrative të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

Tabela: Shtesë e kapaciteteve institucionale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

INVESTIME	N	G	2006	2007	2008	2009
<i>jesia matese</i>	<i>jendja aktuale</i>					
Asistencë teknike, Mbështetje në procesin e Përafrimit të Legjislacionit, IT	/		1	1	1	
000 lekë		30000	30000	30000		
Akreditimi i laboratoreve	/		2	2	1	
000 lekë		00000	00000	3600	3600	
Paisje laboratorit	/		1	-	-	
000 lekë		7000				
Trajnim i stafit të laboratorëve	/		-	3	3	
000 lekë			000	000	000	
Trajnim i inspektorëve	/		-	1	1	
000 lekë			2000	200	200	
Trajnim dhe asistencë teknike për stafin e Drejtorisë së Sigurisë Ushqimore	/		-	3	3	
000 lekë			200	200	200	
Prezantimi i ligjit të ri "Për Ushqimin" për grupet e interesit	/		-	1	-	
000 lekë			000			

3.8.2 AGROPËRPUNIMI DHE MARKETINGU

Objekti Politik

Qëllimi i Qeverisë Shqiptare për fushën e Agroperpunimit dhe Tregtimit është forcimi i sistemeve të sigurisë ushqimore dhe sistemeve të lidhura me të. Ky qëllim synohet të realizohet nëpërmjet:

Përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis communautaire* (MSA)

Përgatitjes së një programi që do të zhvillojë industrinë përpunuese në mënyrë që të përmbushë standardet e Bashkimit Europian,

Rritjes së konkurrencës midis fermerëve dhe midis prodhuesve blegtorale lokale, si dhe Përmirësimit të sistemit të tregtimit për produktet bujqësore të përpunuara.

Situata Aktuale

Kuadri Ligjor

Kuadri ligjor që rregullon sektorin e verërave dhe pijeve alkoolike përfshin aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

Ligji nr. 8443, datë 21.01.1999 “Për Vreshtarinë Vëren dhe Produktet e tjera që Rrjedhin nga Rrushi” i cili përafrohet pjesërisht me Rregulloren 1493/99, 2676/90, 1623/2000 1622/2000;

VKM nr. 505, datë 21.09.2000 “Për miratimin e rregullores për vreshtarinë vëren dhe produktet e tjera që rrjedhin nga rrushi”;

Urdhri i Ministrit nr. 2, datë 06.01.2003 “Mbi përkufizimin emërtimin dhe paraqitjen e pijeve alkoolike”

Kuadri i mësipërm normativ përcakton kryesisht llojet e verërave, karakteristikat e tyre, nënproduktet e verës, praktikat enologjike të lejuara, përkufizimin se cilat janë produktet e falsifikuara dhe jo të përshtatshme për konsum, rregulla të përgjithshme për përcaktimin e origjinës së verërave dhe emërtimet e tyre.

Kuadri ligjor që rregullon sektorin e vajit të ullirit përfshin aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

Ligji nr. 8944, i vitit 2002, “Mbi Prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit”, përcakton kriteret teknike të lejueshme për prodhimin dhe emërtimin e Vajit të Ullirit të cilat janë në përputhje me standardet Komunitare për këtë produkt.

VKM Nr. 475, datë 12.07.2003, “Për karakteristikat e Vajrave të Ullirit”, Objekt i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kriterëve të cilësisë, natyrshmërisë, treguesve fiziko-kimike dhe shijore të vajrave të ullirit të përkufizuar në nenin 2 të Ligjit nr. 8944 datë 19.09.2002 “Për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajrave të ullirit”.

Udhëzimi “Për përcaktimin e karakteristikave organo-shqisore të “vajrave të virgjëra të ullirit”. Ky udhëzim mbështetet në parimin që në vlerësimin cilësor të vajrave të virgjëra të ullirit, përcaktimi i treguesve shijore të tyre ka rëndësi të veçantë si për të gjitha produktet ushqimore.

Kuadri ligjor që rregullon sektorin e Prodhimeve të qumështit dhe bulmetit përfshin aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

Ligji nr. 9441 datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe produkteve me bazë qumështi”, i cili adopton pjesërisht:

Vendimin e Këshillit 92/608/EEC,

Vendimin e Komisionit 91/180/EC që formulon disa metoda të analizimit të cilësisë së qumështit të papërpunuar dhe qumështit të trajtuar në temperaturë (heat-treated) dhe dispozitat kryesore të

Direktivës 92/46/EC që formulon rregullat shëndetësore për prodhimin dhe nxjerrjen në treg të qumështit të papërpunuar, qumështit të trajtuar në temperaturë (heat-treated) dhe produkteve me bazë qumështi.

Aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fushën e Agroperpunimit dhe Tregtimit janë:

Ligji nr. 7941 datë 31.05.1995 “Për ushqimin” i cili zbatohet për lenden e parë, produktet ushqimore, materialet ndihmëse dhe aditivët dhe përmban dispozita mbi përpunimin, paketimin, tregtimin, inspektimin dhe kontrollin.

Kuadri Institucional

Sektori i Agroperpunimit në Drejtorinë e Politikave të Prodhimit në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrotjtjes së Konsumatorit është përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e politikave në fushën e përpunimit të produkteve bujqësore.

Ky sektor ne bashkëpunim me Drejtorinë e Statistikave ne MBU&MK, bën vlerësimin e ecurisë se treguesve makro te këtij sektori.

Asistenca Teknike

Projekti i Shërbimeve Bujqësore (IDA) i Bankës Botërore (9.6 milionë dollarë planifikuar për 8 vjet, 1999-2007) ka si qellim:

Përmirësimin e aksesit te fermerëve te vegjël per perdorim nga ana e tyre te farerave cilesore (\$ 1.34 m) duke perfshire permiresimin e struktures rregullatore te farave ne perputhje me standardet nderkombetare,

Përmirësimin e aksesit te fermereve te vegjel ndaj teknologjive te duhura dhe rritjen e shumellojshmerise se prodhimit (\$ 1.0 m) duke perfshire masat per shpejtimin e transferimit te teknologjise dhe praktikat e permiresuara te biznesit ne komunitetet rurale.

Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra

Ne fushën e Agroperpunimit dhe Tregtimit prioriteti afatshkurtër është Zbatimi i Protokollit 3 te MSA-se/ Marrëveshjes se Ndërmjetme, “Mbi verën dhe pijet e tjera alkoolike”

Iniciativa Ligjore

MBU&MK ka parashikuar te ndermarre iniciativat e meposhtme ligjore:

Ndryshime ne ligjin ekzistues nr. 8443 dt. 21.01.1999 “Për vreshtarinë vëren dhe produktet e tjera qe rrjedhin nga rrushi” (lidhur me praktikat enologjike) me qellim përafrimin e pjesshëm me Rregulloret 1493/99, 2676/90, 1623/2000, 1622/2000

VKM “Për ngritjen dhe funksionimin e këshillit te eksperteve te qumështit” që do te harmonizohet pjesërisht me Direktivën 46/92.

Ligji i ri "Për Ushqimin" i cili do te përafrohet pjesërisht me Rregulloren 178/2002/EC.

Ndryshime ne VKM nr. 505 dt. 21.09.2000 “Për miratimin e rregullores për vreshtarinë verën dhe produktet e tjera qe rrjedhin nga rrushi”, (lidhur me praktikat enologjike) me qellim përafrimin e pjesshëm me Rregulloret 1493/99, 2676/90, 1623/2000, 1622/2000

Rregullore “Për emërtimin dhe mbrojtjen e origjinës se produkteve bujqësore dhe ushqimore”, e cila do te përafrohet pjesërisht me Rregulloret 2081/92 2082/92

Rregullore “Për ngritjen e kadastrës se vreshtarisë dhe verërave”, e cila do te përafrohet pjesërisht me Rregulloret 1493/99, 2392/86, 649/1987

Rregullore "Për funksionimin e Komitetit Rregullator te përcaktimit te origjinës se verërave" e cila do te përafrohet pjesërisht me Rregulloren 2081/92.

Rregullore "Per hartimin dhe mbajtjen e regjistrit kombetar te grumbulluesit dhe perpunuesve te qumeshtit" e cila do te perafrohet plotesisht me Direktiven 46/92 e amenduar.

VKM “Kerkesat mikrobike per qumeshtin e konsumit dhe te produkteve me baze qumeshti” I cili do te perafrohet plotesisht me Rregulloren 46/92 e amenduar.

VKM “Mbi normat e grumbullimit te qumeshtit te paperpunuar” i cili do te perafrohet plotesisht me Direktiven 92/46 e amenduar.

Aktivitete Zbatuese

Për te beret e mundur plotësimin e detyrimeve ligjore afatshkurtra MBU&MK ka parashikuar te ndërmarre aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Studim mbi identifikimin e plote dhe prioritizimin e acquis communautaire qe do te adoptohet ne periudhën afatshkurtër ne sektorin e agroperpunimit.

Ngritja e nje organi keshillimor me eksperte teknike per zgjidhjen e problemeve teknike te qumështit dhe nënprodukteve te tij.

Krijimi zyrës per mbajtjen e kadastrës se vreshtarise dhe verave.

Ngritja e komitetit rregullator te përcaktimit te origjines se vererave:

ngritja e grupit te punës me eksperte te fushës;

ngritja e një komiteti për regjistrimin e aplikanteve për produktet e reja dhe kontrollimin për ato te regjistruara.

Per emertimin dhe mbrojtjen e origjines se produkteve bujqesore dhe ushqimore (Ngritja e grupit te punes me eksperte te fushes, Ngritja e nje komiteti per regjistrimin e aplikanteve per treguesit dhe origjinen e produkteve te reja dhe kontroll per ato te regjistruara, Trajnim i grupit te punës dhe

komitetit)

Ngritja e grupit të punës për hartimin e draftit VKM “Kerkesat mikrobike për qumështin e konsumit dhe të produkteve me baze qumështi”:

Percaktimi i kerkesave mikrobike për qumështin e konsumit dhe produktet me baze qumështi;

Trajnimi i inspektorëve ushqimorë, sanitare e veterinarë për zbatimin e ligjit.

Ngritja e grupit të punës për hartimin e draftit të VKM “Mbi normat e grumbullimit të qumështit të paperpunuar”,

Percaktimi i kufijve të normave të grumbullimit të qumështit,

Trajnimi i inspektorëve ushqimorë, sanitare e veterinarë për zbatimin e ligjit;

Organizimi i vizitave studimore në vende të BE-së mbi mënyrën e funksionimit të skemës;

Evidentimi i grumbulluesve, standardisuesve dhe përpunuesve të qumështit;

Evidentimi i linjave teknologjive të përdorura dhe formave të përdorura për mbajtjen e regjistrit.

Ngritja e grupit të punës për hartimin e draftit të VKM “Mbi kerkesat teknike mbi qumështin e paperpunuar që përdoret për qumështin e trajtuar termikisht dhe prodhimin e produkteve me baze qumështi”:

Percaktimi i kerkesave që duhet të plotësojë qumështi i grumbulluar që do të përdoret për prodhimin e qumështit të trajtuar termikisht ose të produkteve me baze qumështi;

Trajnimi i inspektorëve ushqimorë, sanitare e veterinarë për zbatimin e ligjit.

Prioritetet afatmesme

Në përputhje me rekomandimet e Partneritetit Europian Prioritetet Afatmesëm është menduar përgatitja e një plani për përmirësimin e përpunimit të ushqimit nëpër ndërmarrje, në mënyrë që ato të plotësojnë standardet e BE-së.

Iniciativa Ligjore

Në përputhje me prioritetin afatmesëm do të ndërmerren këto iniciativa ligjore:

VKM “Mbi kerkesat teknike që duhen përmbushur për prodhimin e qumështit të trajtuar termikisht dhe prodhimin e produkteve me baze qumështi”, i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivën 46/92 e amenduar;

Rregullore “Sistemi i autokontrollit të prodhuesit të produkteve me baze qumështi” që do të përafrohet plotësisht me Direktivën 46/92 e amenduar;

VKM “Përberja dhe treguesit cilësorë të qumështit dhe produktet me baze qumështi që do të përafrohet plotësisht me Direktivën 46/92 1992 L 0046 – 12/12/03;

Rregullore “Për ngritjen e një organizmi të pavarur të certifikimit të produkteve agroushqimorë” që do të përafrohet pjesërisht me Rregulloren 2082/92.

Aktivitete Zbatuese

Për përmbushjen e prioritetit afatmesëm MBUMK ka parashikuar realizimin e aktiviteteve zbatuese:

Ngritja e grupit të punës për hartimin e draftit të VKM “ Mbi përbërjen dhe treguesit cilësorë të qumështit dhe produkteve me baze qumështi;

Mbështetje për një organizmi të pavarur të certifikimit të produkteve agroushqimorë.

Tabela: Shtesë e kapaciteteve institucionale të MBUMK për fushën e Agropërpunimit

INVESTIME	NJESI	20	200	2	2009
	A E MATJES	06	7	008	
Konsulencë	(000/lekë)	43		1	3500
Trajnime	(000/lekë)	50		000	
		500	0	780	5000

3.8.3 BLEGTORIA

Objektivi Politik

Qëllimi kryesor për fushën e Blegtorisë është ndërtimi i hallkave të reja për zbatimin e programeve racore, rritja e prodhimit të ushqimeve të përgatitura për blegtorinë dhe forcimi i kontrollit

te cilësisë së tyre, zhvillimi i fermave të specializuara dhe qendrave industriale të prodhimit blegtoral dhe ruajtja e resurseve gjenetike autoktone në blegtori.

Situata Aktuale

Kuadri Ligjor

Fusha e Blegtorisë rregullohet me aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

Ligji nr. 9426. date. 6.10.2005 “Për Mbarëshkrimin e Blegtorisë”, është Ligji kuadër që përcakton strukturën institucionale për mbarëshkrimin e kafshëve në Shqipëri. Ky ligj adopton pjesërisht Direktivat:

91/174/EEC,

88/661/EEC ,

98/58/EC,

90/427EEC,

94/28/EC,

77/504/EEC.

Ligji Nr. 8702, date 1.12.2000,” Mbi identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe fermave blegtorale”, i cili adapton pjesërisht direktivën 92/102, dhe rregulloren 820/97. Ky ligj plotëson kuadrin e nevojshëm normativ në funksion të programeve racore dhe të mbarëshkrimit të blegtorisë.

VKM Nr. 143. date. 11.3.2004, “Për anëtarësimin e MBUMK në Komisionin Ndërkombëtar për regjistrimin e kafshëve (ICAR).

Ligji Nr. 8411. dt. 1.10. 1998 “ Mbi Ushqimin e Blegtorisë”, është akti baze që rregullon sektorin e ushqimit të kafshëve në Shqipëri dhe ka adaptuar pjesërisht Direktivën 91/51/EEC.

Rregullorja Nr. 1, date. 10.03.2000, “Për ushqimin e kafshëve”, e amenduar me Rregullore Nr. 12, date. 12.11.2002, e cila adopton pjesërisht direktivat 70/524/EEC dhe 93/74/EEC;

Rregullorja Nr. 4, date. 10.03.2000, "Për marrjen dhe konservimin e mostrës për kontrollin zyrtar të ushqimit të kafshëve", e cila adopton pjesërisht direktivën 70/373/EEC.

Rregullorja Nr. 5, date. 10.03.2000. "Për përcaktimin e nivelit maksimal të lejuar për substancat e dëmshme, mbetjet e pesticideve dhe substancave të tjera shtese në ushqimin për blegtorinë", e cila adopton pjesërisht direktivat 92/508/EEC; 91/51/EEC; 70/524/EEC dhe 82/471/EEC,

Rregullore Nr. 6, date. 10.03.2000 “Për tregtimin e ushqimit të përzier blegtoral”, e cila adopton pjesërisht direktivat 79/63/EEC; 91/516/EEC; 80/511/EEC; 82/475/EEC dhe 86/174/EEC.

Urdhëri i Ministrit Nr. 614, date 12.12.2002, “Për kryerjen e analizave të ushqimit blegtoral”, e cila adopton pjesërisht direktivën 82/471/EEC.

Urdhëri i Ministrit Nr. 373, date 23.08.2002, “Për të parandaluar importin e miellit, mishit, kockave dhe gjakut për ushqimin e kafshëve”.

Kuadri Institucional

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit është institucioni përgjegjës për ushtrimin e veprimtarive në fushën e blegtorisë.

Zbatimi praktik dhe shkencor i shërbimit blegtoral sigurohet nga:

1. Sektori i Prodhimit Blegtoral i cili është kompetent për:
hartimin e programeve për zbatimin e politikave të zhvillimit të blegtorisë,
për mbarëshkrimin e mirë të kafshëve;
për vlerësimin e progresit gjenetik,
për përcaktimin e rentabilitetit të racave,
për përcaktimin e prioriteteve për strategjinë e punës racore,
për identifikimin e resurseve gjenetike autoktone e të kultivuara dhe propozimin e masave mbrojtëse për to,
për ndjekjen e aktiviteteve lidhur me Librin e Racës dhe Librat Anagrafike për çdo specie dhe regjistrimin e racave të reja dhe transferimin e teknologjive në të gjitha organizmat publikë e private të autorizuar nga MBUMK.

2. Inspektoriati i Kontrollit ligjor të Zooteknisë, i cili përbehet nga:

Sektoret e Prodhimit bimor dhe blegtoral në Qarqe ku ushtrojnë aktivitetin e tyre 14 inspektore zooteknike, 2 prej të cilëve janë përgjegjës për punën racore në 2 qendra të miratuara.

Sherbimi zooteknik privat qe funksionon ne fushen e riprodhimit te kafsheve, ku ushtrojne aktivitetin 523 teknike inseminatore te kualifikuar nga IKZ (sherbimi publik) dhe Sherbimi privat (programi i te cilit miratohet nga MBUMK)

Sherbimi Zooteknik Privat, qe operojne ne ferma dhe impjante blegtorale dhe Organizata te mbareshtimit te kafsheve, perfshin 31 zooteknike.

Instituti i Kerkimeve Zooteknike (IKZ), eshte strukture e kerkimit shkencor ne Blegtori. Ajo kryen kerkimin shkencor dhe transferimin e teknologjive ne fushen e prodhimit blegtoral ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

3. Instituti i Kerkimeve Zooteknike është qendër reference për kontrollin e:

Ushqimeve te kafshëve. Ky kontroll kryhet nga laborator i vetem ne Republiken e Shqiperise i cili eshte i paisur me teknologji bashkekohore.

Materialit shumezues, vezëve dhe transferim embrioneve, (ende nuk kryen këto kontrolle per arsye se nuk eshte plotesuar kuadri ligjor, mungon struktura perkatese dhe mundësia financiare)

Instituti i Kerkimeve Zooteknike zbaton programet e kerkimit dhe te transferimit te teknologjise nepermjet departamenteve te saj dhe nepermjet:

Stacionit te Përmirësimit te GJEDHIT (demave), ne Tirane

Stacionit te Bagëtive te imta ne Korçe.

4. Sherbimi keshillimor perfshin rreth 30 zooteknike te cilet operojne ne Pushtetin Vendor nepermjet keshillimit.

5. Këshilli i Blegtorisë (K.B.), është organ qe miratohet nga ministri për një periudhe 4 vjeçare me te drejte rizgjedhjeje ne zbatim te nenit 73 te ligjit Nr. 9426. date 6.10.2005 “Per Mbareshtimin e Blegtorise”. Detyrat per funksionin e Keshillit te Blegtorise jane te percaktuara ne nenin 74 te ketij ligji.

Sektori i Prodhimit Blegtoral ne Drejtorine e Politikave te Prodhimit ne MBUMK, bashkepunon me perfaqesues te strukturave analoge ne shtetet anetare si France, Itali, Hollande, Angli, Danimarkë te cilat fokusohen ne shkembim informacioni dhe eksperiences.

Ne kuader te bashkepunimit rajonal ky sektor bashkepunon me shtete fqinj si Maqedoni, Slloveni, Bullgari dhe Kroaci me te cilet bashkepunimi fokusohet ne shkembim informacionit, eksperiences dhe teknologjise.

Ky sektor bashkepunon edhe me Organizaten Boterore te Ushqimit (FAO), per shkembim informacioni ku mund te permendet hartimi i status raportit mbi resurset gjenetike shtazore ne Shqiperi (identifikimi i populacioneve te kafsheve ne rrezik apo qe rrezikojne te zhduken), me Shoqaten Nderkombetare te Prodhimit te Kafsheve (EAAP), me Shoqaten Nderkombetare te Kontrollit te Prodhimitarise (ICAR) dhe me Shoqata dhe organizata te tjera, ku mund te permendim INRA (France), ANAF (Itali) etj.

Asistenca Teknike

Ne fushen e Blegtorise nuk ka projekte ne zbatim.

Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra

Ne fushën e Blegtorisë, prioritetet Afatshkurtra janë:

konsolidimi i arritjeve dhe ndërtimi i hallkave te reja për zbatimin e programeve racore

rritja e prodhimit te ushqimeve te përgatitura për blegtorinë dhe forcimi i kontrollit te cilësisë se tyre

zhvillimi i fermave te specializuara dhe qendrave industriale te prodhimit blegtoral dhe ruajtja e resurseve gjenetike autoktone ne blegtori.

Iniciativa Ligjore

Ne përputhje me prioritetet afatshkurtra do te ndërmerren këto iniciativa ligjore:

Rregullore "Për riprodhimin e kafsheve te fermes, prodhimi e tregtimi i materjaleve racore", e cila synon menaxhimin dhe monitorimin e materialeve racore te prodhuara, mbrojtjen e racave te kultivuara dhe atyre autoktone, e cila do te perafrohet pjeserisht me Direktivat 96/510/EEC, 96/509/EC, 77/504/EEC 89/361/EEC, 77/504/EEC, 90/425/EEC.

Vendim i Keshillit te Ministrave “ Per miratimin e Strategjise se prodhimit te mishit”, e cila synon shtimin e prodhimit te mishit ne nje kohe te shkurter dhe ritjen e cilesise se tij e cila do te perafroje plotesisht Rregulloret 1208/81/EEC, 1186/90/EEC, 2137/92/EEC.

Rregullore "Çertifikimi i kafsheve me vlera racore per treg", e cila synon nxitjen dhe inkurajimin e prodhimit dhe çertifikimin e kafsheve me vlera racore per permbushjen e kërkesave te tregut e cila do te perafrohet plotesisht me Direktiven 96/80/EC.

Rregullore mbi Standardet minimum te mbarështimit te kafshëve shtëpiake (Standardet minimum te mbarështimit te GJEDHIT) kushtet tekniko - teknologjike për objektet e strehimit dhe pajisjet, si dhe pajisjet dhe menaxhimi i jashtëqitjeve, standardet etologjike e ekologjike, planifikimi i hapësirës) e cila do te perafrohet plotesisht me Direktivat 91/628/EEC, 90/425/EEC, 90/425/ 91/496 78/923/EEC,91/629/EEC.

VKM "Per programin e mbareshtimit te bagetive te imta" i cili synon mbareshtimin e racave te pastra te te imtave dhe sigurine e diversitetit gjenetik, kultivimin e racave autoktone prej mishit dhe qumeshtit te te cilave prodhohen produkte tipike shqiptare i cili do te perafrohet pjesërisht me Direktivën 89/361/ECC

Rregullore "Per organizatat e Mbareshtimit te Kafsheve" e cila synon trajtimin ligjor te aktivitetit te organizatave te mbareshtimit te blegtorise, bazuar ne ligjin "Per Mbareshtimin e Blegtorise"dhe ne Ligjin nr. 8788 dt.7.05.2001. "Per Organizatat jo Fitim- Prurese" e cila do te perafrohet pjesërisht me Dir. 84/247/EEC, Dir. 84/419/EEC, Dir. 90/254/EEC.

Aktivite Zbatuese

Per te bere te mundur plotesimin e detyrimeve ligjore dhe permbushjen e prioriteteve afatshkurtra do te ndërmerren këto aktivitete zbatuese:

Ngritja e grupit te punës për hartimin e rregullores per riprodhimin e kafsheve te fermes, prodhimi dhe tregtimi i materialeve racore;

Ngritja e Grupit te punes prej 8 personash ne lidhje me hartimin e rregullores mbi Certifikimin e kafshëve me vlera racore për treg;

Përgatitja administrative ne lidhje me hartimin rregullores mbi Certifikimin e kafshëve me vlera racore për treg;

Ndërgjegjësimi i fermerëve që merren me prodhimin e mishit për treg, publikime;

Ngritja e grupit te punës me urdhër te Ministrisë te Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit ne lidhje me rregulloren për Standardet minimum te mbarështimit te kafshëve shtëpiake (gjedhit);

Përgatitja administrative ne lidhje me hartimin e rregullores për standardet minimum te mbarështimit te kafshëve shtëpiake;

Ngritja e grupit te punës prej 6 specialistesh për hartimin e programit te mbarështimit te bagëtive te imta";

Studimi i fizibilitetit "Për Hartimin e Programit te mbarështimit te bagëtive te imta";

Ngrija e grupit te punës për rregulloren e organizatave te mbarështimit te kafshëve

3.2 Prioritetet afatmesme

Ne përputhje me detyrimin qe rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, Prioriteti Afatmesëm është Përafrimi i legjislacionit vendas me atë te BE-se ne fushën e Blegtorisë.

Iniciativa Ligjore

Ne përputhje me prioritetet afatmesme do te ndërmerren këto iniciativa ligjore:

Rregullore "Per standartet minimum te mbareshtimit te kafsheve shtepiake (shpendeve, derrave, dhe te imtave)", synon rritjen e sigurise se ketyre prodhimeve dhe plotesimit te kërkesave te tregut per produkte cilesore dhe te sigurta, (kushtet tekniko- teknologjike per objektet e strehimit dhe pajisjet, per pajisjet dhe menaxhimin e jashteqitjeve, standartet etologjike e ekologjike, planifikim i hapsires). Kjo Rregullore do te perafrohet pjesërisht me Direktivat 91/628/EEC,91/630/EEC, 89/66/EEC;

Rregullore "Mbi kërkesat per tu regjistruar dhe mbajtur librin Gjenealogjik per racat e pastra dhe dokumentacionin zooteknik", eshte sistemimi i informacionit baze qe lidhet me kafshet qe permbushin kërkesat e programeve racore per mbrojtjen e burimeve gjenetike - shtazore, sigurimi i diversitetit dhe permiresim gjenetik i blegtorise, ruatja e numrit te kerkuar te kafsheve per mbareshtim si dhe e materialeve te tjera racore, rritja e niveleve te tyre te prodhimitarise. Kjo Rregullore do te perafrohet pjesërisht me Direktivat. 96/80/EEC,96/463/EEC, 84/419/EEC;

Rregullore "Per inspektimin e te ushqyerit te kafsheve" e cila synon vendosjen e principeve qe drejtojnë organizimin e inspektimit zyrtar ne fushen e ushqimit te kafsheve, si dhe vendosjen e kërkesave minimum per inspektimin e ekonomive bujqesore qe mbajne kafshe per qellime bujqesore.

Kjo Rregullore do te perafrohet pjeserisht me Direktiven 2000/50/EC;

Rregullore “ Per tregtimin e ushqimeve te thjeshta” me qellim adaptimin e direktivave te BE; Ndryshime ne rregulloren nr. 1 dt, 10.03.2000, e ndryshuar.”Per ushqimet e kafsheve”, me qellim perafrimin e pjesshem me Direktivat 82/47EEC, 93/74 EEC,83/228 EEC 93/113EEC;

Ndryshime ne rregulloren nr. 4 dt, 10..03.2000 “Per marrjen dhe konservimin e kampionit per kontrollin zyrtar te ushqimit te blegtorise” me qellim harmonizimin e pjesshem te kerkesave qe rrjedhin nga BE;

Ndryshime ne rregulloren nr. 5, dt. 10.03.2000 “Per percaktimin e nivelit maksimal te lejuar per lendet e demshme, mbetjet pesticide dhe lende te tjera shtese ne ushqimet e blegtorise” me qellim perafrimin e pjesshem me Direktiven 97/153/EEC;

Ndryshime ne rregulloren nr 6, dt. 10.03.2000,” Per tregtimin e ushqimeve te perziera te blegtorise” me qellim perafrimin e pjesshem me Direktivat 79/63/EEC 91/516/EEC 80/511/EEC 82/475/EEC 86/174/EEC;

VKM, “Mbi kriteret e ruajtjes se racave ne zhdukje ose ne rrezik zhdukje dhe mbrojtjes se rezervave gjenetike te kafsheve te fermes”

3.2.2 Aktivitete Zbatuese

Për te bere te mundur plotësimin e detyrimeve ligjore dhe përmbushjen e prioriteteve afatmesme do te ndërmerren këto aktivitete zbatuese:

Ngritja e grupit te punes per hartimin e rregullores "Mbi kerkesat per tu regjistruar dhe mbajtur librin gjenealogjik per racat e pestra dhe dokumentacionin zooteknik"

Pergatitja administrative ne lidhje me hartimin e rregullores "Mbi kerkesat per tu regjistruar dhe mbajtur librin gjenealogjik per racat e pestra dhe dokumentacionin zooteknik"

Ngritja e grupit te punes prej 6 personash per pergatijen e rregullores "Per inspektimin e ushqimit te kafsheve"

Ngritja e grupit te punes per hartimin e rregullores "Per tregtimin e ushqimeve te thjeshta"

Ballafaqim me eksperte te fushes se biznesit, nga organizatat e fermerve,etj rreth projekt rregullores "Per tregtimin e ushqimeve te thjeshta"

Ngritje e grupit te punes per hartimin e VKM "Mbi kriteret e ruajtjes se racave ne zhdukje ose ne rrezik zhdukje dhe mbrojtjes se rezervave gjenetike te kafsheve te fermes

Studimi i fizibilitetit ne lidhje me hartimin e VKM "Mbi kriteret e ruajtjes se racave ne zhdukje ose ne rrezik zhdukje dhe mbrojtjes se rezervave gjenetike te kafsheve te fermes"

Tabela: Shtesë e kapaciteteve institucionale te MBUMK për Blegtorinë

ME	INVESTI	NJ		GJ		20	2	20	20
		ESIA	E	ENDJA	06	007	08	09	
		MATJES		AKTUALE					
cë	Konsulen	(00		200	90	1	27	12	
		0/ lekë)	0	0	3300	00	100		
	Trajnime	(00		22	4	60			
		0/ lekë)		0	00	0			

3.8.4 SHËRBIMET VETERINARE

Objektivi politik i fushës

Qëllimi kryesor për fushën e Veterinarisë është rritja e sigurisë ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit, duke ruajtur të pastër situatën e sëmundjeve në kafshë në territorin e vendit.

Ky qëllim synohet të realizohet nëpërmjet objektivave:

Plotësimi i kuadrit ligjor në kontrollin e sëmundjeve në kafshë dhe në kontrollin e produkteve me origjinë shtazore;

Garantimi i kontrollit të plotë të sëmundjeve zoonotike në kafshë dhe siguri i një situate të pastër nga sëmundjet infektive në kafshë;

Ngritja e pikave kufitare të inspektimit veterinar të afta për të ushtruar kontrollin e import eksporteve të kafshëve të gjalla dhe produkte me origjinë prej tyre;

Monitorim i plotë i qendrave të prodhimit të molusqeve dhe mbetjeve në kafshë në të gjithë vendin, për të garantuar produkte të sigurt sipas standardeve Komunitare.

Situata Aktuale

Kuadri ligjor

Fusha e Veterinarisë rregullohet nga aktet ligjore dhe nënligjore:

Ligji Nr. 9308, dt. 4.11.2004 “Për shërbimin dhe inspektoratin veterinar”, i cili rregullon organizimin, funksionimin dhe financimin e shërbimit dhe inspektimit veterinar si dhe të drejtat dhe detyrat e administratës veterinarë. Ky ligj është hartuar duke u bazuar në ligjin slloven “Për veterinarinë”;

Rregullore “Për mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë nga hyrja nga dogana e sëmundjeve ngjitëse të kafshëve dhe produkteve me origjinë shtazore”;

Rregullore Nr. 4, dt. 30.12.1999 “Për regjistrimin e ilaçeve veterinarë”, e cila përaftron pjesërisht direktivën 91/412 EEC;

Rregullore Nr. 5, dt. 30.12.1999 “Për ndërtimin dhe funksionimin e farmaceutikave veterinarë” e cila përaftron pjesërisht direktivën 91/412 EEC;

Rregullore Nr. 6, dt. 30.12.1999 “Për prodhimin e medikamenteve veterinarë” e cila përaftron pjesërisht direktivën 91/412 EEC;

Rregullore Nr. 2759, dt. 12.08.1999 “Për kontrollin e Brucelozës tek bagëtia” e cila përaftron pjesërisht direktivën 77/391 EEC;

Rregullore Nr. 2759/1, dt. 12.8.1999 “Për kontrollin e TBC-se tek bagëtia” e cila përaftron pjesërisht direktivën 77/391 EEC;

Rregullore Nr. 2759/2, dt. 12.8.1999 “Për kontrollin e Plasjes”;

Rregullorja Nr. 1 date 4.12.2003 “Për Gjurmimin dhe Luftimin e Sëmundjes Lopa e Çmendur”, e cila përaftron pjesërisht Rregulloren Nr. 999/2001/EC;

Rregullorja “Për Luftimin dhe Gjurmimin e Sëmundjes Afta Epizootike”, e cila përaftron pjesërisht Direktivën 85/511/EEC;

Rregullorja “Për Luftimin dhe Gjurmimin e Sëmundjes Murtaja Klasike e Derrave”, e cila përaftron pjesërisht Direktivat 80/217, 80/1095 EEC.

Manuali i BIP (Pikat e Inspektimit Kufitar) me Rregulloret:

Rregullorja Nr. 11, datë 3.7.2000, “Për rregullat lidhur me kontrollin veterinar të kafshëve të gjalla të importuara nga vendet e treta”, e cila përaftron pjesërisht Direktivën 97/794 EC;

Rregullorja Nr. 10 date 3.7.2000 “Për listën e postave të inspektimit kufitar të miratuar për kontrollet veterinarë mbi produktet dhe kafshët nga vendet e treta”, e cila përaftron pjesërisht Direktivën 97/778 EEC;

Rregullorja Nr. 9 date 3.7.2000 “Për importimet e gjedhit, dhenve, dhive, derrave, mishit të freskët ose produkteve të mishit nga vendet e treta”, e cila përaftron pjesërisht Direktivën 92/462/EC;

Rregullorja Nr. 6 date 3.7.2000 “Për kontrollin veterinar të zbatueshëm në shkëmbimet tregtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të treta për kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore”, e cila përaftron pjesërisht Direktivën 90/425/EEC;

Rregullorja Nr. 5 date 3.7.2000 “Për organizimin e kontrolleve veterinarë të produkteve që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë nga vendet me të cilat ka marrëdhënie tregtare”, e cila përaftron pjesërisht Direktivën 90/675/EEC;

Rregullorja Nr. 4 date 3.7.2000 “Për organizimin e kontrolleve veterinarë të kafshëve të gjalla që hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga vende me të cilat ka marrëdhënie tregtare”, e cila përaftron pjesërisht Direktivën 91/496/EEC;

Rregullore Nr. 3. date 3.7.2000 “Për modelin e çertifikatës veterinarë”, e cila përaftron pjesërisht Direktivën 93/14/EEC.

Rregullore mbi luftimin, gjurmimin dhe eliminimin e sëmundjeve infektive dhe parazitare në kafshë e shpendë si dhe për kontrollin sanitar veterinar të ushqimeve me origjinë shtazore:

Rregullore Nr. 4 datë 11.6.2004 “Për kontrollin e sëmundjes së Pseudopestit”, e cila përaftron pjesërisht Direktivën 92/66EEC;

Rregullore Nr. 1 datë 25.5.2004 “Për kontrollin e sëmundjes salmoneloze në shpendë”, e cila përaftron pjesërisht Direktivën 92/117 EEC;

Rregullore Nr. 1 datë 17.3.2000 “Mbi masat për monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet shtazore”, e cila përaftron pjesërisht Direktivën Nr. 96/23/EEC;

Rregullore Nr. 2 datë 11.6.2004 “Mbi kushtet sanitare-veterinare të tregtimit dhe importimit të fekalëve të shpendëve dhe puplave”;

Rregullore Nr. 1 “Mbi detyrat veterinarë të inspektoratit që varen nga MBU-ja, në lidhje me kontrollin e molusqeve bivalvë të gjalla”;

Rregullore Nr. 2 “Mbi rregullat veterinarë sanitare që administrojnë prodhimet dhe nxjerrjen në treg të molusqeve bivalvë të gjallë”. e cila përaftron pjesërisht Direktivën 91/492 EEC;

Rregullore Nr. 3 “Mbi tregtimin dhe kushtet e tregut për kafshët dhe prodhimet e akuakultures” e cila përaftron pjesërisht Direktivën 91/493 EEC;

Rregullore Nr. 4 “Akte të posaçme normative në lidhje me vlerat maksimale dhe afrimet e analizave të disa bio-toksinave detare në molusqet bivalvë, echinoderms, tunicates dhe marine gastropods”;

Rregullore Nr. 5 “Mbi ngritjen e kontrolleve të posaçme shëndetësore për mbledhjen dhe përpunimin e disa molusqeve bivalvë me një nivel helmi butaku amnesic (Amnesic Shellfish Poison-ASP) duke tejkaluar kufirin e vendosur nga Rregullorja Nr. 2;

Rregullore Nr. 6, dt. 09.09.2003 “Mbi kërkesat për cilësinë ujore të molusqeve” e cila përaftron pjesërisht Direktivën 79/923 EEC;

Rregullore Nr. 1, dt. 17.03.2000 “Mbi masat që duhen marrë për monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve tek kafshët dhe produktet e bulmetit”;

Rregullore Nr. 3 datë 25.5.2005 “Mbi kushtet sanitare-veterinare të eksportimit të pulave dhe vezëve për inkubim në vendet e BE-së e cila përaftron pjesërisht Direktivën 90/539 EEC.

Kuadri Institucional

Institucionet që garantojnë zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e veterinarisë janë:

Drejtoria e Shëndetit të Kafshëve dhe Mbrojtjes së Bimëve (DSHUMB) në MBUMK, e përbërë nga 18 nëpunës është autoriteti përgjegjës për rregullimin e përgjithshëm të çështjeve veterinarë lidhur me shëndetin e kafshëve. Drejtoria është e përbërë nga:

Spektori i mbrojtjes së shëndetit të kafshëve (1 përgjegjës, 5 specialistë veterinarë,) i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e Inspektoratit të Shëndetit të Kafshëve në Qarqe për diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve parazitare dhe infektuese në zonat publike dhe rurale (vëzhgimin, lajmërimin, parandalimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve ngjitëse të kafshëve),

Zyra e Identifikimit dhe Regjistrimit (3 specialistë), përgjegjëse për Identifikimin dhe Regjistrimin e kafshëve;

Laboratori i Kontrollit Veterinar Shtetëror (1 përgjegjës, 5 specialistë), i cili është përgjegjës për kontrollin e barnave dhe bio-produkteve veterinarë.

2. Inspektorati Veterinar, është një rrjet kontrolli i përbërë nga:

243 Inspektorë Veterinarë në Drejtoritë e Bujqësisë dhe Ushqimit në Qarqe, Rrethe dhe Komuna;

500 Inspektorë Veterinarë në rrjetin e shërbimit veterinar privat nuk kanë të drejta çertifikuese.

Ky rrjet kontrolli, garanton zbatimin e Ligjit Nr. 9308, dt. 4.11.2004 “Për shërbimin dhe inspektoratin veterinar” dhe është përgjegjës për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe kontrollin e ushqimeve me origjinë shtazore. Ai kryen kontroll në qarqet, bashkitë dhe komunat me qëllim:

parandalimin e sëmundjeve;

garantimin e kushteve sanitare-veterinarë në tregjet e kafshëve;

kontrollin e ushqimit të kafshëve.

3 Instituti i Kërkimeve Veterinarë (IKV) varet nga Drejtoria e Shërbimeve Veterinarë dhe është përgjegjës për hartimin e strategjive të gjurmimit dhe luftimit të sëmundjeve infektive, parazitare në kafshët e tokës, të ujit dhe në shpendë. Ky Institut ka në varësi të tij 12 Laboratorë Rajonale, të cilët janë përgjegjës për gjurmimin, analizimin dhe diagnostikimin e sëmundjeve infektive, parazitare në kafshët e tokës, të ujit dhe në shpendë.

Instituti kryen diagnozat veterinarë dhe testimin e profilaksisë së shëndetit të kafshëve në përputhje me programin kombëtar. Ai kryen programe testuese për kontrollin e sëmundjeve Epizootike, ilaçeve veterinarë dhe diagnozat e sëmundjeve të përgjithshme. Ai është përgjegjës gjithashtu për kryerjen e testeve të produkteve ushqimore me origjinë shtazore në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik. Instituti i Kërkimeve Veterinarë bashkëpunon me FAO, EHO, OIE dhe

laboratorë të tjerë reference për konfirmimin e sëmundjeve të ndryshme infektuese.

Asistenca e Huaj

Programi i monitorimit dhe mbikëqyrjes për sëmundjet infektive 2005-2007 (Organizata Botërore e Shëndetësisë- 500 000 euro).

DSHKMB ne MBUMK drejton një sërë programesh vjetore mbikëqyrëse të sëmundjeve për të kontrolluar listën e përcaktuar nga OIE. Testimi është ndërmarrë në përputhje me kërkesat e BE-së.

Shërbimet e integruara të menaxhimit të kufijve (CARDS 2003 - € 0.6 m)

Ky projekt asiston në rritjen e inspektimit të pikave kufitare për kontrollin veterinar dhe fitosanitar. Asistenca do të përfshijë pajisjet dhe trajnimin për shërbimet e inspektimit kufitar, rritjen e sistemit kompjuterik për të bërë të mundur regjistrimin dhe komunikimin me laboratorët dhe zyrat e administrimit në Tiranë.

Monitorimi i shëndetit të kafshët e imta (CARDS 2003 - € 2.2 m)

Ky projekt shtrihet nga viti 2004-2007 për të ndihmuar Shqipërinë në adoptimin e standardeve veterinarë të BE-së për kafshët e imta (kryesisht dele dhe dhi). Objektivi i përgjithshëm i projektit është zhvillimi i tregut të eksportit për kafshët e imta nëpërmjet ngritjes së një sistemi më të mirë ndjekjeje për ndodhjen e sëmundjes dhe monitorimi i lëvizjeve të kafshëve. Kjo do të përfshijë gjithashtu mbështetjen për përmirësimin e legjislacionit në këtë fushë.

Projekti i përforsimit institucional për shërbimet veterinarë (CARDS 2006)

Është propozuar përfshirja në MIP 2006 CARDS, një projekt për forcimin e shërbimeve veterinarë. Kjo është konsideruar si një pjesë e lehtësimit të tregut në lidhje me mishin dhe produktet e mishit. Projekti do të zhvillojë një kapacitet institucional për të drejtuar kuadrin ligjor shqiptar me *acquis* në fushat e shëndetit të kafshëve dhe shëndetin publik veterinar. Forcimi i kapacitetit të autoriteteve kompetente për të kryer një inspektim efektiv në kufi, në përputhje me kriteret Komunitare, mbikëqyrja, notifikimi, parandalimi, kontrolli dhe çrrënjësja e sëmundjeve të kafshëve, infektuese apo ngjitëse, aktivitete në lidhje me mishin dhe higjienën e produkteve të kafshëve, (duke përfshirë aplikimin e standardeve të sigurisë së ushqimit në ndërmarrjet e përpunimit), çertifikimi i shëndetit dhe aktiviteteve specifike në lidhje me mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve, kontrollin e mbetjeve, aspektet veterinarë të ushqimit të kafshëve, medikamentet veterinarë, ilaçet dhe produktet biologjike.

Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra

Përafrimi i legjislacionit kombëtar për veterinarinë me acquis communautaire.

Proçesi i përafrimit të legjislacionit do të fokusohet:

legjislacionin bazë të kontrollit të sëmundjeve me karakter përhapës e dëmtues;

legjislacionin mbi vendosjen e sistemit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale;

legjislacionin mbi aquakulturën dhe molusqet bivalve si një nga prioritetet e eksporteve shqiptare;

legjislacionin mbi prodhimin, importimin dhe tregtimin e barnave dhe bio-produkteve veterinarë;

legjislacionin bazë të lëvizjes së kafshëve (import-transit-eksport);

legjislacionin mbi vendosjen e sistemit të informacionit epizootik.

Ruajtja e situatës epidemiologjike të vendit nëpërmjet realizimit të:

hartimit dhe zbatimit të programeve kombëtare të kontrollit deri në çrrënjësje të sëmundjeve zoonotike problematike për vendin;

forcimit të karantinës shtetërore nëpërmjet menaxhimit të importeve të kafshëve të gjalla;

programeve të emergjencës veterinarë për parandalimin e hyrjes apo izolimin dhe çrrënjësjes e menjëhershëm në rast të shfaqjes së sëmundjeve endemike;

realizimit të programeve të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla;

realizimit të monitorimit të ujërave të brendshme dhe molusqeve bivalve;

fuqizimit të inspektimeve veterinarë duke rritur shkallën e kualifikimit profesional të stafit veterinar në fushën e ruajtjes së shëndetit të kafshëve;

fuqizimit të rrjetit laboratorik veterinar me synim akreditimin e Institutit të Kërkimeve Veterinarë dhe përsosjen e laboratorëve veterinarë rajonalë në fushën e diagnozës veterinarë dhe të monitorimit të situatës epizootike të vendit.

Prioritetet afatmesme

Identifikimi i kafshëve dhe regjistrimi i fermave blegtorale duke:

plotësuar dhe fuqizuar strukturat veterinare në fushën e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale;

realizuar identifikimin e gjedhit brenda vitit 2008 duke përfunduar vendosjen e sistemit të identifikimit të gjedhit brenda vitit 2009;

realizuar identifikimin e të imtave brenda vitit 2008 dhe zgjerimit të shpejtë të tij në vitin 2009;

vendosur një sistem database për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave në të 12 Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit paralelisht me identifikimin e kafshëve;

vendosjen dhe përsosjen e sistemit kompjuterik të informacionit epidemiologjik.

Fuqizimi i Pikave të Inspektimit Veterinar Kufitar:

pajisja e të 14 pikave të inspektimit veterinar kufitar me mjetet e nevojshme të inspektimit veterinar si dhe me mjetet e nevojshme të informacionit;

trajnimi mbi procedurat e kontrollit veterinar kufitar të kafshëve të gjalla si dhe të çdo lloj ngarkese përshkruar në legjislacionin veterinar;

plotësimi me mjetet e infrastrukturës dhe të logjistikës në 12 rajonet (sektorët veterinare) si dhe të pikave veterinare të inspektimit kufitar në vartësi të tyre.

Tabela: Shtesë e kapaciteteve institucionale të MBUMK për Veterinarinë

INVESTIME	AKTIVITETE	NJËSIA E MATJES	GJENDJA AKTUALE	2006	2007	2008	2009	2010
Burimet Njerëzore	Identifikim i gjedhit në rrethet ku është aplikuar vendosja e këtij sistemi	persona	6	12				
Përkthim legjislacioni	Përkthimi i acquis që synohet të përafrohet në shqip	/000 lekë		848.9	258.7	343.2	321.1	321.1
Konsulencë	Përafrimi i Legjislacionit vendas me acquis communaux	/000 lekë		3000	3000	3000	3000	
Investime + Trajnime	Vaksinimi, Gjurmimi i sëmundjeve Eliminimi i kafshëve të infektuara Monitorim i molusqeve Programe kombëtare të monitorimit dhe vendosja e sistemit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave	/000 lekë	349323	388484.9	372128.7	234213.2	231991.1	234591.1

blegtorale.
Fuqizimi i
rrjetit
laboratorik
veterinar,
akreditimi i
IKV
Trajnime të
stafit veterinar

3.8.5 PRODHIMI BIMOR

Objektivi Politik

Objektivi kryesor në fushën e Prodhimit Bimor është sigurimi i një zhvillimi të qëndrueshëm të bimëve bujqësore me qëllim rritjen optimale të prodhimit për plotësimin sa më mirë të nevojave të vendit, rritjen e mundësive për eksport si dhe mbështetjen e menaxhimit në këtë zhvillim.

Situata Aktuale

Kuadri Ligjor

Fusha e Prodhimit bimor rregullohet me aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

Ligji nr. 7929, datë 11.5.1995 "Për mbrojtjen e drufrutoreve". Qëllimi është mbrojtja e drufrutoreve nga dëmtimet mekanike të qëllimshme ose jo, nga çdo subjekt fizik e juridik, vendas a i huaj.

Ligji nr. 8443, datë 21.1.1999 dhe Rregullorja "Për Vreshtarinë, Verën dhe produktet e tjera që rrjedhin nga rrushi". Këto akte përcaktojnë dhe vendosin rregullat bazë për mbarështimin e vreshtarisë, për prodhimin e rrushit, të verërave dhe produkteve të tjera që rrjedhin prej tij

Ligji nr. 8732, datë 24.1.2001 dhe VKM -të nr. 154, 155, 156 dhe 157 , datë 25.4.2002 "Për materialin mbjellës bimor " që përcaktojnë rregulla për riprodhimin, shumëzimin, përpunimin dhe tregëtimin e materialit mbjellës bimor.

Ligji nr. 8700, datë 23.11.2000 "Për anëtarësimin e laboratorit kombëtar të testimit të farave dhe fidanëve në shoqatën ndërkombëtare të testimit të farave (ISTA)".

Ligji nr.8880, datë 15. 4. 2002 "Për të drejtat e seleksionerit të bimëve". Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e të drejtave të personave që seleksojnë, zbulojnë dhe zhvillojnë varietete të reja bimore. Ky ligj është përafëruar pjesërisht me Rregulloren Nr. 2100/94.

Ligji nr. 9199, datë 26.2.2004 dhe VKM -të nr. 388, datë 31.5.2005 e nr. 145, datë 8.3. 2006 që kanë për qëllim nxitjen e prodhimit organik në vend, përcaktimin e kushteve të prodhimit, përpunimit, transportit, certifikimit dhe kontrollit të produkteve bujqësore dhe atyre ushqimore, me prejardhje bimore dhe shtazore, që prodhohen, përpunohen ose / dhe importohen e tregëtohen si produkte Bio. Ky ligj është përafëruar pjesërisht me Rregulloren Nr. 2092/91.

Ligji nr. 9395, datë 12.5.2005 " Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare "Për mbrojtjen e varieteteve të reja të bimëve".

Rregullore e Nr. 2, datë 20.11. 1995 "Për mbrojtjen e drufrutoreve". Në këtë rregullore përcaktohen detyrat , të drejtat e organeve shtetërore për mbrojtjen e drufrutoreve si dhe detyrimet që kanë gjithë subjektet juridike e fizike vendas apo të huaj për problemin e mësipërm.

VKM nr. 505 datë 21.9. 2000 "Për miratimin e rregullores së ligjit nr. 8443, datë 21.1.1999 Për Vreshtarinë, Verën dhe produktet e tjera që rrjedhin nga rrushi". Objekt i kësaj rregulloreje janë mbarështimi i vreshtave dhe prodhimi i tyre, përcaktimi, përpunimi dhe tregëtimi i produkteve të rrushit dhe pijeve aoolike të rrjedhura prej tij si dhe përkufizimi dhe përdorimi i alkooleve të rrushit

VKM nr. 157, datë 25.4.2002 "Për kriteret dhe rregullat e përpunimit, ambalazhimit, ruajtjes, etiketimit dhe përmbajtjes së etiketës për materialin mbjellës, bimor ".

Udhëzim nr.106, datë 2.12. 2002 "Për tarifën e shërbimeve që kryhen për materialin mbjellës, bimor".

Udhëzim nr.107, datë 2.12. 2002 "Për krijimin, shumëzimin, përpunimin, tregëtimin, kontrollin, vlerësimin e farave dhe fidanëve dhe ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik, bimor".

VKM nr. 141, datë 7.3.2003 "Për përcaktimin e pagesës vjetore për mbajtjen e së drejtës së

seleksionerit të bimëve".

Rregullore e MBU nr. 1, datë 30.10.2003 "Për të drejtat e seleksionerit të bimëve".

Kuadri Institucional

1. **Drejtoria e Politikave të Prodhimit me Sektorin e Prodhimit Bimor** ne Ministrine e Bujqesise Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit është struktura përgjegjëse për zhvillimin e prodhimit bimor.

2. **Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve** është krijuar me Vendim te Këshillit te Ministrave Nr. 447, datë 03.09.1993, dhe ka në përbërje:

Laboratorin Qëndror te Testimit të Farave, i cili kontrollon dhe çertifikon treguesit cilësore të materialit mbjellës të importuar dhe të prodhuar në Shqipëri, me qëllim lejimin e tregtimit të tij. Laboratori Qendror i Testimit të Materialit Mbjellës është duke ndjekur procedurat e akreditimit në ISTA-s.

Banken Gjenetike, e cila identifikon, grumbullon dhe ruan burimet gjenetike me vlerë shkencore

Sektorin e Testimit të Varieteteve, i cili provon në kushtet agroklmatike të vendit, të gjitha materialet mbjellëse që kërkohet të tregëtohen në Shqipëri konform skemave dhe standarteve të OECD.

Inspektoriatin e Kontrollit Shtetëror te Farave dhe Fidanëve, i cili kontrollon procedurat e prodhimit, standartizimit dhe tregtimit te farave dhe fidaneve per te garantuar fermeret mbi materialin mbjelles bimor.

Kuadri normativ qe rregullon funksionimin e Institucioneve qe mbulojne kete fushe eshte:

VKM nr. 154, datë 25.4.2002 "Për të drejtat dhe detyrat e Inspektoriatit të Kontrollit Shtetëror të Farërave dhe të fidanëve".

VKM nr. 155, datë 25.4.2002 "Për funksionimin, të drejtat dhe detyrat e Entit Shtetëror të Farërave dhe të Fidanëve".

VKM nr.388, datë 31.5.2005 " Për përbërjen, funksionimin, të drejtat dhe detyrat e komisionit shtetëror të prodhimit organik"

VKM nr 145, datë 8.3.2006 'Për disa ndryshime në VKM nr 388, datë 31.5.2005 " Për përbërjen, funksionimin, të drejtat dhe detyrat e komisionit shtetëror të prodhimit organik"

Asistenca Teknike

Projekti i Sherbimeve Bujqesore (IDA) i Bankes Boterore (9.6 milione dollare planifikuar per 8 vjet, 1999-2007) ka si qellim permiresimin e aksesit te fermereve te vegjel per perdorim nga ana e tyre te farerave cilesore (\$ 1.34 m) duke perfshire permiresimin e struktures rregullatore te farave dhe institucionet ne perputhje me standardet nderkombetare, promovimin e regjistrimit vullnetar te farerave dhe zhvillimin e nje procesi te liberalizuar te çertifikimit te farerave. Permiresimi i aksesit te fermereve te vegjel ndaj teknologjive te duhura dhe rritjen e shumellojshmerise se prodhimit (\$ 1.0 m) duke perfshire masat per shpejtimin e transferimit te teknologjise dhe praktikave te permiresuara te biznesit ne komunitetet rurale, eshte nje tjetër qellim i ketij projekti.

Projekti CARDS 'Ngritja e Kadastrës së Vreshtarisë dhe Verës' qe ka si qellim rritjen e cilësisë se verërave dhe emërtimin e origjinës se tyre (500.000 euro).

Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra

Ne fushen e Prodhimit Bimor, prioritetet Afatshkurtra është përmirësimi i legjislacionin për Vreshtarinë dhe Verën me synim harmonizimin me legjislacionin Komunitar.

Iniciativa Ligjore

Ne përputhje me prioritetin afatshkurtër do te ndërmerren këto iniciativa ligjore:

Udhëzim "Mbi organizimin dhe mbajtjen e Kadastrës Vreshtarisë dhe Verës" i cili do te përafrohet pjesërisht me Rregulloren 2392 / 86/EEC;

Përmirësimi i Ligjit "për Vreshtarinë dhe Verën" i cili do te përafrohet pjesërisht me Rregulloret 1493/99/EC, 2676/90/EEC, 1623/2000/EC dhe 1622/2000/EC;

Përmirësimi i Rregullores në zbatim te ligjit "për Vreshtarinë e Verën" e cila do te përafrohet pjesërisht me Rregulloret 1493/99/EC, 2676/90/EEC, 1623/2000/EC dhe 1622/2000/EC;

Rregullore "Mbi kriteret dhe rregullat e detajuara për krijimin e Regjistrit te Vreshtave e të Verës", për miratim me VKM e cila do te përafrohet plotësisht me Rregulloret 1493/99/EC, 2676/90EEC, 1623/2000/EC, 1622/2000/EC dhe 649/87/EC;

Ligj “për materialin mbjellës bimor”;

VKM “për tregtimin e farave të drithërave dhe bimëve foragjereve” i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivat 66/401, 66/402/EEC;

VKM “për tregtimin e materialeve të shumëzimit të bimëve drufrutore” i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivat 68/193/EEC, 92/34/EC dhe 93/48/EC.

Aktivitete Zbatuese

Për te bere te mundur plotësimin e detyrimeve ligjore dhe përmbushjen e prioriteteve afatshkurtra janë ndërmarre këto aktivitete zbatuese:

Studim për rajonet dhe mikrorajonet potenciale të zhvillimit të vreshtarisë dhe Verës.

Studim për evidentimin dhe prezantimin e gjendjes së germoplazmës lokale të hardhisë.

Projekt për ngritjen e një Zyre Rajonale pilot për mbajtjen e Kadastrës së Vreshtarisë dhe Verës.

Ngritja e funksionimi i grupit te punes per hartimin e Rregullores per Regjistrin e vreshtave e te veres

Ngritja dhe funksionimi i zyrove për mbajtjen e Kadastrës së vreshtarise dhe veres

Ngritja dhe funksionimi i grupit të punës për përgatitjen e draftit të gjithë paketës ligjore për materialin mbjellës bimor.

Prioritetet afatmesme

Ne përputhje me rekomandimet e Partneritetit European Prioritetet Afatmesme janë:

Zhvillimi i strategjisë për përdorimin e tokës, për tregun e tokës, zhvillimin rural, diversifikimin e aktiviteteve fermerë dhe rritjen e konkureshmërisë në bujqësi.

Të merren masa për të siguruar një kontroll efikas të prodhimit bimor në vend.

Iniciativa Ligjore

Ne përputhje me prioritetet afatmesme do te ndërmerren këto iniciativa ligjore:

VKM “për materialet e shumëzimit të perimeve, qe janë të ndryshme nga farat” i cili do te përafrohet plotësisht me Direktivat 92/33/EC, 93/61/EC;

Udhëzim “për rregullat e kontrollit për materialet e shumëzimit për perimet, të ndryshme nga farat dhe për materialet e shumëzimit të bimëve drufrutore” i cili do te perafrohet plotësisht me Direktivat 93/62/EC, 93/64/ EC;

Udhëzim “për plotësimin e listës së varieteteve të materialeve të shumëzimit të bimëve drufrutore” i cili do te perafrohet plotësisht me Direktivat 93/79/ EC;

VKM "Për strukturën, funksionimin, kriteret e pranimit, te vleresimit te dokumentacionit te nevojshem dhe te detyrave te organizmave certifikues vendase per produktet BIO" i cili do te perafrohet plotësisht me Rregulloret 2092/91/EC, 207/93/EC, 1788/2001/EC, 529/95/EC dhe direktiven 94/92/EC;

Përmirësimi i ligjit nr. 8880, datë 15.4.2002 "Për të drejtat e seleksionerit të bimëve" dhe Aktet nenligjore qe rrjedhin nga ligji me qellim perafrimin e plote me Rregulloren 2100/94/EC;

Ligj “për Vreshtarinë dhe Verën” i cili do te perafrohet plotësisht me Rregulloret 1493/99/EC, 2676/90/EEC, 1623/2000/EC dhe 1622/2000/EC;

Aktet nënligjore të nevojshme që rrjedhin nga Ligji i ri “për Vreshtarinë dhe Verën” te cilet do te perafrohen plotësisht me Rregulloret 1493/99/EC, 2676/90/EEC, 1623/2000/EC dhe 1622/2000/EC

Aktivitete Zbatuese

Për te bere te mundur plotësimin e detyrimeve ligjore dhe përmbushjen e prioriteteve afatmesme janë ndërmarre këto aktivitete zbatuese:

Ngritja dhe funksionimi i trupës së inspektimit dhe Certifikimit për farërat;

Ngritja dhe funksionimi i trupës së inspektimit dhe Certifikimit për materialin mbjellës të drufrutoreve;

Ngritja dhe funksionimi i grupit të punës për përgatitjen e draftit të VKM " Për strukturën, funksionimin, kriteret e pranimit, të vlerësimit të dokumentacionit të nevojshëm dhe të detyrave të organizmave certifikues vendase për produktet BIO".

Ngritja dhe funksionimi i grupit të punës për përmirësim të ligjit nr. 8880, datë 15.4.2002 "Për të drejtat e seleksionerit të bimëve".

Ngritja dhe funksionimi i grupit të punës për përgatitjen e projekt ligjit të ri për vreshtarinë dhe verën dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Ngritja e strukturës për mbrojtjen e varieteteve.

Tabela: Shtese e kapaciteteve institucionale te MBUMK për fushën e Prodhimit Bimor

<i>INV</i> <i>ESTIME</i>	<i>NJ</i> <i>ESIA</i> <i>MATJES</i>	<i>E</i> <i>JENDJ</i> <i>A</i> <i>AKTU</i> <i>ALE</i>	<i>€</i> <i>006</i>	<i>2</i> <i>007</i>	<i>2</i> <i>008</i>	<i>2</i> <i>9</i>	<i>200</i>
Buri	sona	per	3		2	6	4
met		2		1			
Njerëzore							
Përk	/00				5	2	130
thim dhe	0 lekë			89	07		
veprimtari							
përgatitore							
për							
legjislacioni							
n							
Kon	/00		7		3	3	120
sulencë	0 lekë	5300		000	000	0	
Inve	/00				5	3	
stime dhe IT	0 lekë			400	300		
Traj	/00		C		2	7	300
nime	0 lekë	ARDS		000	500	0	

3.8.6 MBROJTJA E BIMEVE

Objektivi Politik

Qëllimi i Qeverisë Shqiptare në fushën e Mbrojtjes së Bimëve është mbrojtja e konsumatorit, duke ruajtur te pastër situatën e fitosanitare. Ky qëllim synohet të realizohet nëpërmjet:

Bashkëpunimit të palëve për të përafëruar standardet e mbrojtjes së konsumatorit në Shqipëri me ato Europiane;

Sigurimit të mbrojtjes efektive të konsumatorit në mënyrë që të sigurohet një funksion normal i tregut;

Zhvillimet e infrastrukturës administrative në mënyrë që të sigurohet mbikëqyrja e tregut dhe zbatimi i ligjit në këtë fushë.

Situata Aktuale

Kuadri Ligjor

Fusha e mbrojtjes së Shëndetit të Bimëve rregullohet nga aktet ligjore dhe nënligjore:

Ligji Nr. 9362, datë 24.03.2005 “Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve”;

Ligji përcakton kërkesat në lidhje me kontrollin fitosanitar në vend, mbikëqyrjen kombëtare dhe inspektimet e importit. Ai vendos parimet e kontrollit fitosanitar të aplikueshme ndaj prodhuesve, importuesve dhe eksportuesve të bimëve dhe produkteve të bimëve si dhe aplikimin e masave fitosanitare kur zbulohet kontaminimi nga organizmat e dëmshëm.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 72, datë 06.02.2003 “Rregullat e Inspektimit Karantinor Fitosanitar”, i cili ka përafëruar plotësisht Direktivën 2000/29/EC “Për masat mbrojtëse për parandalimin e hyrjes në Komunitet të parazitëve të bimeve dhe produkteve bimorë”, dhe anekseve respektive.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 72, datë 06.02.2003 “Rregullat e Inspektimit Karantinor Fitosanitar”, adopton plotësisht Aneksin I dhe V të Direktivës së Këshillit 2000/29/EC. Ky vendim ka adoptuar kërkesat e kësaj Direktive në lidhje me inspektimin fitosanitar të bimeve dhe produkteve të bimeve.

Fusha e prodhimit, tregtimit dhe përdorimit të Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve rregullohet

nga aktet ligjore dhe nënligjore:

Produktet e Mbrojtjes se Bimeve (PMB) rregullohen nga:

Ligji Nr. 9362, date 24.03.2005 “Për Shërbimin e Mbrojtjes se Bimëve”;

Vendimi i Këshillit te Ministrave Nr. 72, Date 15.02.2001, “Për miratimin e Rregullores për Produktet e Mbrojtjes se Bimëve”.

Vendimi i Këshillit te Ministrave Nr. 72, Date 15.02.2001, “Për miratimin e Rregullores për Produktet e Mbrojtjes se Bimëve”, adopton pjesërisht:

Direktivën e Këshillit 91/414/EEC (për futjen ne treg te produkteve te mbrojtjes se bimëve) dhe,

Direktivën 79/117 (për ndalimin e futjes ne treg te produkteve për mbrojtjen e bimëve qe përmbajnë lende te caktuara aktive).

Ne zbatim te këtij kuadri normativ, vetëm produktet e mbrojtjes se bimëve te regjistruara mund te prodhohen, importohen, tregtohen, magazinohen dhe përdoren ne Shqipëri. Ky vendim rregullon te gjitha procedurat për:

Importin, tregtimin, ruajtjen, transportimin dhe përdorimin e produkteve objekt te mbrojtjes se bimëve;

Regjistrimin e produkteve te mbrojtjes se bimëve, kërkesat për te dhënat, mbrojtja dhe konfidencialiteti i te dhënave, si dhe kriteret për regjistrimin e produkteve te mbrojtjes se bimëve si dhe tërheqjen e tyre nga tregu;

Klasifikimi, etiketimi, dhe paketimi i produkteve te mbrojtjes se bimëve te tregtuara ne Shqipëri;

Kuadri Institucional

Institucionet qe garantojnë zbatimin e kuadrit ligjor ne fushën e mbrojtjes se bimëve janë:

Drejtoria e Shëndetit te Kafshëve dhe Mbrojtjes se Bimëve (DSHKMB) ne MBUMK është autoriteti kompetent qendror përgjegjës për rregullimin e çështjeve fitosanitare dhe hartimin e politikave ne fushën e mbrojtjes se bimëve.

Ne përbërje te kësaj drejtorie është dhe **Spektori i Mbrojtjes se Bimëve**, qe përbehet nga përgjegjësi i sektorit dhe 2 specialiste agronome.

Inspektorati i mbrojtjes se bimëve ne Drejtoritë Rajonale te Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit i përbëre nga 65 inspektore, nga te cilët: 12 Kryeinspektorë, 24 inspektore te rretheve dhe 29 inspektore te karantinës ne pikat e kalimit kufitar.

Ne laboratorët e mbrojtjes se bimëve te DRBU & MK punojnë dhe 12 agronome.

Instituti i Mbrojtjes se Bimëve (IMB), i cili është autoritet kombëtar kërkimore ne fushën e mbrojtjes se bimëve.

IMB kryen monitorimin e organizmave karantinore, përcakton statusin e tyre si dhe masat për parandalimin e futjes dhe përhapjes se tyre ne territorin e Shqipërisë. Për zbatimin e këtyre detyrave, Instituti mbështetet ne Laboratorët e diagnostikimit te pajisur me mjetet e nevojshme diagnostikuese.

Asistenca Teknike

Përmirësimi i Inspektimit fitosanitar ne pikat kufitare. (BIP-s ne kuadër te CARDS 2003 - € 0.6 m) 2005-2006:

Ky projekt asiston ne krijimin e një sistemi te integruar fitosanitar brenda Shqipërisë për te përfshire trajnimin e inspektoreve ne vlerësimin e rrezikut te organizmave karantinore ne përputhje me EU Vademecum, Përafrimin e legjislacionit vendas me *acquis* për shëndetin e bimëve dhe produktet e mbrojtjes te bimëve si dhe për te siguruar programet e testimit te laboratorëve dhe programet e monitorimit dhe mbikëqyrjes ne përputhje me standardet dhe praktiket e BE-se.

Prioritetet

Hartimi i kuadri normativ i nevojshëm për te rregulluar Nivelet Maksimale te Mbetjeve (MRL), duke garantuar ngritjen e laboratorëve te cilët do te kontrollojnë dhe përcaktojnë nivelin e mbetjeve te produkteve te mbrojtjes se bimëve (PMB-ve) ne produktet bujqësore, me qellim zbatimin e tij.

Forcimi i kapaciteteve te Institutit te Mbrojtjes se Bimëve me qellim kryerjen e analizave cilësore te PMB-ve, për përcaktimin e lendes vepruese dhe te përmbajtjes se saj ne produkt, si dhe te mbetjeve te PMB-ve ne bime, produkte bimore.

Prioritetet afatshkurtra

Iniciativa Ligjore
 Rishqyrtimi i ligjit Nr. 9362, date 24.3.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”.
 Legjislacioni që ka të bëjë me shëndetin e bimëve, karantinën bimore;
 Legjislacioni që ka të bëjë me kufizimin e përhapjes së parazitëve të veçantë;
 Aktivitete Zbatuese
 Ngritja dhe funksionimi i strukturave të mbrojtjes së bimëve që nga MBU & MK deri në nivel qarku. Rrethi dhe në pikat e kalimit kufitar;
 Kualifikimi i stafit të mbrojtjes së bimëve për të ju përgjigjur kërkesave të kohës;
 Prioritetet afatmesme
 Iniciativa Ligjore
 Legjislacioni për PMB-të, që nga regjistrimi i tyre, kontrolli nga importimi deri tek përdoruesi i fundit (fermeri), për mbetjet e PMB-ve në bime, produkte bimore;
 Legjislacioni për zonat e mbrojtura si dhe ai për lëvizjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera;
 Aktivitete Zbatuese
 Ngritja dhe funksionimi i infrastrukturës së mbrojtjes së bimëve, që nga pajisjet laboratorike në IMB, veçanërisht laboratorit i analizave cilësore të PMB-ve dhe mbetjeve të tyre në bime dhe produkte bimore; forcimi i kontrollit fitosanitar në pikat e kalimit kufitar; etj.

Tabela: Shtesa e kapaciteteve institucionale të MBUMK për fushën Fitosanitare

INVEST	NJESIA	GJE				
IMET	E MATJES	NDJA	006	007	008	009
		AKTUALE				
Burimet	persona	68				
Njerëzore						
Përkthim	/000 lekë					
dhe veprimtari			13	398	12	79.5
përgatitore për						
legjislacionin						
Konsulen	/000 lekë					
cë			3400	000	000	
Investim	/000 lekë					
e			4500	9000	3000	
			0			
Trajnime	/000 lekë					
			9000	000	0000	

3.8.7 ZHVILLIMI RURAL DHE STRUKTURAT BUJQËSORE

Objektivi politik

Qëllimi kryesor i politikave të zhvillimit rural në Republikën e Shqipërisë është nxitja e zhvillimit të integruar e të qëndrueshëm rural dhe diversifikimi (zhvillimi i aktiviteteve ekonomike jo bujqësore).

Ky qëllim synohet të arrihet nëpërmjet:

Bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së duke u fokusuar në zona prioritare lidhur me *Acquis Communautaire* në fushën e bujqësisë. Bashkëpunimi duhet veçanërisht të synojë modernizimin dhe rristurimin e bujqësisë shqiptare dhe të sektorit të agro-industriës duke u mbështetur në përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me atë të praktikave, rregullave dhe standardeve Komunitare. (neni 95 i MSA-së)

Forcimit të kooperimit për një zhvillim rajonal dhe lokal, me objektiv kryesor, kontribuimin në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazisë rajonale. Vëmendje e veçantë do t'i jepet kooperimit ndër-kufitar, trans-kombëtar dhe kooperimit ndër-rajonal.

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit në bashkëpunim me Bankën Botërore ka hartuar një draft për Strategjinë e Zhvillimit Rural të vendit. Me Strategjinë e Zhvillimit Rural, do të synohet që

politikat sociale, ekonomike e mjedisore të implementimit të saj të kenë karakter zonal, rajonal e global.

2.Situata Aktuale

2.1Kuari Ligjor

Nuk ka një kuader ligjor te vecante per zhvillimin rural ne Shqiperi. Nje rendesi te vecante per Shqiperine ne periudhen afatmesme, ka legjislacioni i BE-se i aplikuar per vendet hyrese ne fushen e zhvillimit rural, kryesisht Rregulloret 1268/1999 EC; 1257/1999 EC dhe 1260/1999 EC.

2.2 Kuadri Institucional

Aktualisht me ndryshimin e strukturave të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në fund të vitit 2006 është krijuar Drejtoria e Politikave Rurale e përbërë nga:

Sektori i Zhvillimit Rural

Sektori i Analizave të Politikave

Duke qenë se numri i punonjësve që janë të përfshirë në fushën e zhvillimit rural në Ministrinë e Bujqësisë është dy, lind nevoja e krijimit të një organizmi koordinues, i cili të koordinojë dhe bashkërendojë të gjitha veprimet që ndërmerren si nga Ministritë e Linjës, ashtu dhe nga donatorë, OJF që veprojnë në fushën e zhvillimit rural.

Në vitin 2004, është ngritur një Komitet Nderministror për Zhvillimin Rural i kryesuar nga zv/Kryeministri ku përfshihen Ministrat e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit; Financës; Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit; Ekonomisë; Transportit dhe Telekomunikacionit; Shëndetësisë; Arsimit; Kultures, Rinisë dhe Sporteve; Rregullimit të Territorit dhe Turizmit; Mjedisit, dhe Integrimit Europian.

Në MBUMK funksionon Sekretariati Teknik i këtij Komiteti Nderministror. Ky Sekretariat do të mbështet Grupin e Punës mbi Zhvillimin Rural, anëtarët e të cilit janë përfaqësuesit e:

11 Ministrat e përfaqësuar në Komitetin Nderministror

OJF-te e shoqërisë civile me një interes dhe kapacitet të treguar në planifikimin e ZHR

Shoqata prodhuesish dhe konsumatorësh dhe grupe të interesuara

Agjenci donatore shumë anës dhe dyanës

Projektet ekzistuese që veprojnë në zonat rurale

Asistenca Teknike

Në fushën e zhvillimit rural nuk ka projekte në zbatim.

Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra

Në fushën e zhvillimit rural, Prioritetet Afatshkurtra janë:

Rritja e Punësimit dhe Rritja e të Ardhurave nga Produktet Jobujqësore;

Krijimi i Mundësive të Barabarta në Lidhje me Shërbimet Rurale;

Përmirësimi i Infrastrukturës Rurale, si Rrugët, Tregjet Rurale, Uji i Pijshëm;

Rritja e Aksesit të Popullsisë Rurale në Burimet Financiare dhe Kreditë dhe Zgjerimi i Sektorit jo bankar (i financimit rural);

Rritja e Kapaciteteve të Komuniteteve Rurale;

Ulja e Migrimit Rural dhe Krijimi i Marrëdhënieve më të Ngushta të Komunitetit Rural.

3.1.1Iniciativa Ligjore

Në përputhje me prioritetet afatshkurtra, gjatë vitit 2006-2007, do të ndërmerren këto iniciativa ligjore:

VKM "Për mandatimin e një organizmi koordinues të politikave kombëtare të zhvillimit rural"

Ligji "Mbi mbështetjen financiare të zhvillimit rural" i cili do të përafrohet pjesërisht me Rregulloren Nr 1257/1999

VKM "Për ngritjen e Agjencisë së Pagesave" i cili do të përafrohet pjesërisht me Rregulloren Nr 1260/1999, parashtron dispozita të përgjithshme mbi Fondet Strukturore

3.1.2Aktivitete Zbatuese

Për të bërë të mundur plotësimin e detyrimeve ligjore dhe përmbushjen e prioritetëve afatshkurtra, gjatë vitit 2006-2007, do të ndërmerren këto aktivitete:

Fillimi i hartimit të studimeve pilote të zhvillimit rural;

Përcaktimi i marrëveshjeve Institucionale;
 Mbështetje për Programin e Zhvillimit Rural dhe Kapacitetin koordinues brenda MBU&MK;
 Hartimi dhe Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Rural;
 Përpilimi i termave të referencës dhe kërkesave të sakta financiare;
 Konceptimi i ngritjes së Agjencisë së Pagesave;
 Zbatimi i studimeve Pilote Rurale.
 Prioritetet afatmesme
 Në përputhje me rekomandimet e Partneritetit Europian Prioritetet Afatmesme janë:
Nxitja e dialogut rajonal;
Nxitja e stabilitetit, fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit rajonal nëpërmjet programeve
ndërkufitare për zhvillimin e zonave të caktuara;
 Iniciativa Ligjore
 Në fushën e zhvillimit rural nuk janë parashikuar iniciativa ligjore afatmesme
 Aktivitete Zbatuese
 Për përmbushjen e prioritetëve afatmesme MBU&MK ka parashikuar realizimin e aktiviteteve të mëposhtme zbatuese:
 Viti i parë i zbatimit të Planit të Zhvillimit Kombëtar Rural ;
 Mbështetje në praktika të planeve të zhvillimit rural në nivel lokal, në bashkëpunim me popullsinë rurale dhe aktore të tjerë që veprojnë në këtë fushë;
 Prezantim të fermerët dhe aktoret rural rreth politikave të përbashkëta bujqësore (CAP);
 Organizimi dhe koordinimi i trajnimeve të fermerët dhe aktoret e tjerë rural në aktivitete specifike për zbatuar aktivitetet e propozuara në planet pilote të zhvillimit rural;
 Monitorimi dhe vlerësimi i procesit të implementimit.

Tabela: Shtesa e kapaciteteve institucionale të MBUMK për Zhvillimin Rural

NTA	INSTRUME	NJES	GJE	2	2	2009
	IA	E	NDJA	007	008	
	MATJES		AKTUALE			
Shtimi i	Perso	2		4		
nepunesve	na					
IT	(mijë			8		
	lekë)			32		
Konsulencë	(mijë	2210		1	6	6000
(e huaj)	lekë)			0000	000	
Trajnime	(mijë			9	5	5616
(mijë lekë)	lekë)			360	616	

3.8.8 PYJET DHE KULLOTAT

Objektivi Politik

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* në fushën e mjedisit, lidhet direkt me standartet mjedisore dhe detyrën jetësore për të luftuar degradimin e mjedisit me qëllim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Ky objektivi, është shkrirë në dokumentet strategjike sektoriale si Plani i Veprimit në Mjedis, Strategjia dhe Plani i Veprimit të Biodiversitetit dhe Strategjia e Zhvillimit të Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave.

2.Situata aktuale

Kuadri ligjor

Legjislacioni për pyjet përfshin:

Tre akte ligjore bazë të cilët rregullojnë mbrojtjen dhe mbarështimin e pyjeve funksionimin e shërbimit pyjor, mbarështimin e kullotave dhe livadheve, bimëve mjekësore natyrore.

Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor shqiptar”;

Ligji nr. 7917 datë 13.4.1995 “Për kullotat e livadhet”;

Ligji nr 7722, datë 16.6.1993. ‘Për mbrojtjen e bimëve mjekësore, tanifere, eterovajore natyrore;

VKM, nr. 247 datë 23.4.2004, me të cilën është miratuar "Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe reformës institucionale në Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave në Republikën e Shqipërisë;

VKM, nr 290 datë 30.4.2004 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të mbrojtjes nga zjarret në pyje dhe kullota.

Kuadri institucional

Drejtoria e Politikave të Pyjeve dhe Kullotave, është organizmi administrativ dhe teknik i ngarkuar për qeverisjen e fondit pyjor e kullosor kombëtar, përfshirë në strukturën organizative të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Qeverisja e fondit pyjor kombëtar mbështetet në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm e shumëfunksional të pyjeve e kullotave. Në përputhje me Strategjinë e zhvillimit afatgjatë të vendit, përgatit draftin për Strategjinë e zhvillimit të sektorit të pyjeve e kullotave. Drejtoria e Politikave të Pyjeve dhe Kullotave, për administrimin dhe qeverisjen e fondit pyjor kombëtar, të kullotave, mjedisit natyror, të florës dhe të faunës së egër, bimëve mjekësore e të burimeve të tjera pyjore e jopyjore dhe të infrastrukturës rrugore, ushtron detyra të karakterit projektues menaxhues e kontrollues, në përputhje me organizimin e strukturave vartese. Kjo Drejtori funksionon e organizuar në tre sektorë:

Sektori i Trajtimit të Burimeve Pyjore;

Sektori i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave;

Sektori i Pyjeve Komunale.

2.3. Asistenca teknike dhe financiare

Sektori i pyjeve dhe kullotave, që nga viti 1995 është mbështetur me asistencë teknike në kuadrin e dy projekteve kryesore:

"Projekti shqiptar i pyjeve" i financuar nga Banka Botërore, me një afat zbatimi deri në vitin 2004;

"Projekti i pylltarisë private" financuar nga USAID i zbatuar deri në vitin 2000.

3. Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Përgatitje e ligjit të ri të kullotave e livadheve;

Rishikimi i ligjit të bimëve mjekësore eterevojore e tanifere;

Projekt VKM "Për tarifat në pyje dhe shitjen e produkteve pyjore";

Projekt VKM. "Kriteret e transferimit të pyjeve dhe kullotave në përdorim të qeverisjes vendore";

Amendim i ligjit "Për mbrojtjen dhe zhvillimin e bimëve mjekësore natyrore";

Projekt VKM. "Për tarifat e kullotjes";

Projekt VKM. "Për tarifat e shpërblimit të dëmeve në fondin kullosor";

Projekt VKM "Për krijimin e Këshillit të politikave pyjore";

Projekt VKM "Për rregullat e trajtimit të pyjeve, vjeljes, marketingut të produkteve pyjore";

Projekt VKM "Për organizimin e Shërbimit Pyjor në nivel rajoni"

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Takime zonale me drejtues dhe shefa seksionesh të DSHP, për udhëzime në zbatim të VKM-së "Për tarifat e produkteve pyjore dhe shitjen e lëndës drusore";

Seminare rajonale, në zbatim të ligjit të ri dhe akteve nënligjore "Për kullotat dhe livadhet";

Tryeza të rumbullakëta me pushtetin vendor në komuna e fshatra, zyrat e regjistrimit të pasurive, për pyjet dhe kullotat komunale;

Organizimi i takimeve rajonale për njohje me ligjin e ri të bimëve, propozime për përcaktimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit, me personelin pyjor, subjektet grumbulluese, shoqatat e pyjeve komunale, OJF-të mjedisore, etj.

Prioritetet afatmesme

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projekt VKM "Për hartimin e zbatimit të Programit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave,

Programet e zhvillimit në nivel rajoni";
Projekt VKM "Për krijimi i shërbimit të ekstensionit agropyjor".

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Seminare rajonale "Për rregullat e trajtimit të pyjeve, vjeljes, marketingut të produkteve pyjore";

Seminare kualifikuese e tryeza të rrubullakëta, për zbatimin e Programit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave;

Seminare e takime për funksionimin e shërbimit të ekstensionit agropyjor në nivel komune e rajoni.

VITI	Vlera në 000 lekë		
	Për mbështetje ligjore (tab 6)	Për veprimtari zbatuese (tab.7)	Totali (000 lekë)
2006	2700	4100	6800
2007	5700	22660	28360
2008	2700	3850	6550
2009	3900	72500	76400
2010		7450	7450
	15 000	110 560	125 560

3.9 Peshkimi

1. Objektivi politik

Sigurimi i një zhvillimi të qëndrueshëm të sektorit të peshkimit me qëllim rritjen e prodhimit deri në kufijtë optimalë të shfrytëzimit dhe mbështetja e procesit të menaxhimit dhe bashkëmenaxhimit, nëpërmjet rehabilitimit të infrastrukturës, zhvillimit, mbështetjes, dhe liçensimit të aktivitetit të peshkimit, përbën një nga objektivat themelore të Qeverisë në fushën e peshkimit.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Strategjia e Sektorit të peshkimit është në proces përgatitje. Ajo ka përcaktuar qartë politikat parësore të zhvillimit të sektorit deri në vitin 2015.

Ligji Nr. 7908, datë 5.4.1995 "Për Peshkimin dhe Akuakulturën", i ndryshuar nga Ligji 8763 datë 2.4.2001 si dhe nga Ligji 8870 datë 21.3.2002, së bashku me Rregulloren Nr 1 datë 29.3.2005 "Për zbatimin e Ligjshmërisë në peshkim dhe Akuakulturë" adopton pjesërisht:

a. Procedurat për ekzekutimin dhe regjistrimin e inspektimeve e formuluar në Rregulloret ((EEC) Nr 3561/85, Nr 1382/87 dhe Nr 2740/1999) ((ne Nenet 34 -44 te ligjit) dhe (Rregulloren Nr 1 dt. 29.3.2005)

b. Në lidhje me shfrytëzimin e burimeve të peshkimit, dhënien e lejeve të peshkimit dhe masat teknike të peshkimit (EEC) Nr 954/87, (EEC) Nr 3440/84,

c. Kërkesat për plotësimin e ditareve të udhëtimit, deklaratat e zbarkimit, shënimet e lundrimit dhe mbledhja dhe transmetimi i statistikave në lidhje me shfrytëzimin e burimeve të peshkimit (EEC) Nr 2807/83, E EC Nr 2018/93, (EC) Nr 2597/95)

d. Në lidhje me identifikimin dhe regjistrimin e anijeve të peshkimit, rregulloren (EC) Nr 1381/87 dhe (EC) Nr 2090/98. Rregullorja nr.1 date 29.3.2005, bazohet pjesërisht ne parimet kryesore të Politikës së Përbashkët të Peshkimit dhe dispozitat e Rregullores së Këshillit (EEC) Nr. 2847/93 që krijojnë një sistem kontrolli të aplikueshëm ndaj Politikës së Përbashkët të Peshkimit dhe Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr 3670/92 që krijojnë një sistem Komunitar për peshkimin dhe akuakulturën.

Ligji 9093 datë 3.7.2003 "Për ratifikimin e Marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun"

Ligji 9401 datë 19.05.2005 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Marrëveshjen për

nxitjen e respektimit të masave ndërkombëtare të menaxhimit dhe të ruajtjes së burimeve nga anijet e peshkimit në det të hapur”

Ligji Nr.9055, datë 24.4.2003 “Për aderimin E Republikës së Shqipërisë në “Konventën mbi të drejtën e detit” të OKB-së”

VKM 135 datë 8.3.2006 ”Për Procedurat dhe çmimet e Dhënies me qira të siperfaqeve ujore për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës intensive”

Të tjera instrumenta ligjore në fuqi përfshijnë: Statutin *Tip* për menaxhimin e Organizatave të Peshkimit dhe marrëveshjet e transferimit të porteve.

Këto akte normative kanë qëllim vendosjen e rregullave të qarta për shfrytëzimin racional dhe të përgjegjshëm të resurseve biologjike ujore dhe akuakulturës, administrimin në sektorët e Peshkimit dhe akuakulturës, për të siguruar masat e ruajtjes, për të garantuar mbikqyrjen e resurseve biologjike ujore, për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, për të siguruar kërkesat e konsumatorit, për nxitjen e kërkimeve shkencore e teknologjike, si dhe transferimin e menaxhimit të strukturave të peshkimit tek Organizatat e menaxhimit të Peshkimit.

Marrëveshjet ndërkombëtare në fushat e peshkimit, si pjesë e madhe e *acquis* në këtë sektor janë adaptuar gradualisht nga Shqipëria.

Marrëdhëniet e jashtme të Shqipërisë në fushën e peshkimit janë rregulluar nga:

Marrëveshjet dypalëshe mbi rregulloret e peshkimit,

Marrëveshjet e tregtisë së lirë,

Dispozitat e konventave ndërkombëtare dhe organizatat rajonale të peshkimit të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Më e rëndësishme nga këto është Komisioni i Përgjithshëm i Mesdheut për Peshkimin (GFCM) ku Shqipëria është një pjesëmarrëse aktive.

Instrumentat e mëposhtme dhe marrëveshjet janë në veçanti të lidhura me menaxhimin e peshkimi në Shqipëri :

1982 Konventa e OKB -së për Ligjin e Detit (ratifikuar në qershor 2003)

1995 Kodi i FAO Kodi i Sjelljes për Peshkimin e Përgjegjshëm (implementuar si një kod vullnetar në 1997)

1993 FAO Marrëveshja e Zbatimit (pranuar në Maj 2005)

Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (GFCM) (ratifikuar në korrik 2003)

Komisioni ndërkombëtar për ruajtjen e Tonit të Atlantikut (ICCAT) (status vëzhgimi)

1957 Komisioni Këshillmor Europian i Peshkimit të Ujërave të Brendshme (EIFAC)

2. 2 Kuadri institucional ekzistues

Bazuar në legjislacionin në fuqi institucioni përgjegjës për menaxhimin dhe mbikqyrjen e resurseve peshkore është, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, konkretisht, Drejtoria e Politikave të Peshkimit, e cila përbëhet nga katër specialistë si dhe Inspektorët lokalë. Inspektoriat i peshkimit ka zyra në vende të ndryshme, ku shihet e nevojshme, me qëllim që të sigurojë zbatimin e këtij ligji e të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij

Bashkëpunimi me institucionet e tjera

Drejtoria e Politikave të Peshkimit si pjesë e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave bashkëpunon me Drejtoritë përkatëse të Ministrisë dhe inspektoriatin e mjedisit.

Drejtoria e Politikave të Peshkimit bashkëpunon me:

Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, nga e cila siguron mbështetjen për kontrollet dhe penalizimet e shkeljeve ligjore, që rezultojnë gjatë kontroll/inspektimit e inspektoriatit.

Me Ministrinë e Mbrojtjes, me të cilën, në kuadër të ligjit “Për Rojën Bregdetare” dhe Manualin e Rojës Bregdetare, siguron operacione të veçanta për kontrollin e hapësirës detare në bashkëpunim me strukturën e Inspektoriatit. Marrëveshjet specifike të bashkëpunimit të hartuara me Rojën Bregdetare specifikojnë modalitetet e këtij bashkëpunimi.

2.3 Asistenca teknike dhe financiare

Banka Botërore (IDA) Projekti Pilot i Zhvillimit të Peshkimit

Objektivat kryesore të projektit janë:

1. përmirësimi i infrastrukturës portuale dhe menaxhimit të porteve dhe qendrave të Peshkimit përmes rehabilitimit të tyre dhe krijimit të organizatave mbi bazë komuniteti (Organizata të Menaxhimit të Peshkimit- OMP) ;

2. krijimi i një kuadri efektiv institucional për bashkëmenaxhimin e burimeve detare duke angazhuar OMP-të dhe duke rritur mundësitë e sektorit publik;

3. arritja e kapacitetit të mëparshme të vendit në akuakulturë dhe shfrytëzimi i mundësive për zhvillimin e mëtejshëm të akuakulturës, veçanërisht për llojet me vlera të larta.

Për të arritur këto objektiva në projekt propozohen këto ndërhyrje kryesore :

rehabilitim i infrastrukturës portuale në Sarandë, Vlorë dhe Shëngjin dhe ngritjen e qendrave të peshkimit në Shkodër, Pogradec dhe Prespë

mbështetja e organizimit me bazë komuniteti të OMP-ve dhe bashkëmenaxhim i strukturave dhe resurseve;

programe të asistencës teknike për OMP-të, DPP dhe IKP ;

programe mbështetjeje në ripopullimin e ujërave të ëmbla;

programe demonstruese të veprimtarive të reja të akuakulturës.

FAO- ADRIAMED

Asistencë teknike për Menaxhimin e Peshkimit për vendet Mesdhetare, Rregjistri Detar i Peshkimit, ngritja dhe funksionimi i Sistemit të Grumbullimit të të Dhënave Statistikore në Peshkim.

COOPI (Cooperazione Italiana)

Bashkëfinancim në ndërtimin e një qendre peshkimi në Shirokë, Shkodër dhe mbështetje për OMP-në (Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit).

Porti i Peshkimit Durres

Eshtë në përgatitje dhe negocim me Bankën Islamike për Zhvillim, një kredi për ndërtimin e Portit të ri të peshkimit, si një bashkefinancim i kësaj banke dhe Qeverisë Shqiptare

Cards Program

Qendra e grumbullimit dhe dërgimit të Midhjeve Sarandë e perfunduar.

3. Adresimi i prioritetëve

3.1 Prioritetet afatshkurtera 2006-2007

Aktualisht po punohet për përfundimin e strategjisë së sektorit si dhe për ngritjen e një sistemi grumbullimi të dhënash në bazë të (CE) No 1639/2001, dalë në zbatimin e (CE) No 1543/2000 të përfshira në Rregulloren e mësipërme. Pas regjistrimit të flotës së peshkimit dhe regjistrimit elektronik të bërë në vitin 2001, për arritjen e përputhjes me BE-në mbi regjistrimin e anijeve kërkohet një punë e mëtejshme.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtera

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

përmirësimi i legjislacionit në fushën e kontrollit të zbatimit të ligjit

përmirësimi i legjislacionit në menaxhimin e resurseve peshkore

aderimi në ICCAT (International Commission for the Conservation of Atlantic Tunas)

përmirësimi i legjislacionit në grumbullimin e të dhënave në peshkim

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Zbatimi i rregulloreve për Inspektoriatin e peshkimit dhe plotësimi i numrit të inspektorëve të peshkimit

Zbatimi i rregulloreve për menaxhimin e resurseve, mënyrën e regjistrimit të anijeve të peshkimit etj.

Zbatimi i ligjit për aderimin e Shqipërisë në ICCAT

Zbatimi i rregulloreve për grumbullimin e të dhënave në peshkim

3.2. Prioritetet afatmesme (2008-2009)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2008-2009 janë si më poshtë:

Të zbatohet legjislacionin fushëm e peshkimit.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

përmirësimi i legjislacionit në fushën e kontrollit të zbatimit të ligjit

përmirësimi i legjislacionit në menaxhimin e resurseve peshkore

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioritetëve do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

ngritja e njësisë së grumbullimit të të dhënave në peshkim

Zbatimi i legjislacionit të përmirësuar në fushën e kontrollit të zbatimit të ligjit

Zbatimi i legjislacionit të përmirësuar në menaxhimin e resurseve peshkore

3.3 Prioritetet afatgjata (2009-2012)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2009-2012 janë si më poshtë:

Për periudhën 2009 - 2012 do të punohet për plotësimet e kuadrit ligjor në përputhje me Common Fisheries Policy (CFP) në Përgjithësi, në pjesën e Tregut, të Resurseve dhe të politikave strukturore

Tabela: Shtesa e kapaciteteve institucionale për Peshkimin

INVESTIME	NJESIA MATJES persona	E	GJENDJA AKTUALE	2006	2007	2008	2009
Burimet Njerëzore Përkthim dhe veprimtari përgatitore për legjislacionin	/000 lekë				20	5	
Konsulencë	/000 lekë						
Investime dhe IT	/000 lekë				5400	3300	
Trajnime	/000 lekë			17 nenpunes	20 nenpunes		

3.10 TRANSPORTI

3.10.1 INFRASTRUKTURA RRUGORE

1.Objektivi Politik

Qeveria Shqiptare ka përcaktuar si prioritet kryesor për infrastrukturën rrugore ndërtimin e rrugës Durrës–Kukës–Morinë si dhe kompletimet e Korridoreve Veri–Jug dhe Lindje–Perëndim (Korridori VIII-të). Gjithashtu, prioritet për Qeverinë Shqiptare mbetet edhe ndërtimi i degëzimeve, që lidhin korridoret me akset e tjera kombëtare, përmirësimi dhe zhvillimi i rrugëve ndërkufitare dhe turistike, si dhe përmirësimi i sistemit të administrimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore. Realizimi i prioritetëve të sipërpërmendura do të ketë si qëllim përfundimtar, zhvillimin e një infrastrukture rrugore, që e integron vendin me rajonin dhe me Europën, si kusht bazë për sigurimin e rritjes ekonomike dhe zhvillimin në tërësi të vendit, si dhe forcimi i kapaciteteve projektuese dhe zbatuese, duke synuar arritjen e standardeve të njohura ndërkombëtare dhe të BE - së.

2.Situata aktuale

2.1Kuadri ligjor ekzistues

Legjislacioni bazë, që rregullon veprimtarinë në fushën e infrastrukturës rrugore, përbëhet nga aktet e mëposhtme ligjore:

Ligji 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë"

Ligji Nr.8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar

Ligji Nr. 9511 dt.10.04.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen Europiane "Për arteriet kryesore të trafikut ndërkombëtar AGR"

Memorandumi i Mirëkuptimit i Europës Jug Lindore (11 qershor 2004)

VKM nr. 270, dt.10.05.06 " Për miratimin e Planit Kombëtar të Transportit"

VKM Nr.405, datë 08.01.1996 "Për Administrimin e Rrjetit Rrugor Kombëtar dhe Rrjetit Rural të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar

VKM Nr. 68, datë15.02.2001 "Për Miratimin e Kushteve Teknike të Projektimit dhe të zbatimit të punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar (Lidhja Nr.2, për rrugët automobilistike)

2.2. Kuadri institucional ekzistues

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e infrastrukture rrugore janë:

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, nën varësinë e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Në përputhje me programin e Qeverisë, kjo Drejtori, përveç të tjerash, përgatit strategjinë dhe politikën e zhvillimit të Rrjetit Rrugor Kombëtar (Rr.Rr.K.) bazuar në kritere inxhinierike sa më të përparura dhe në efektivitetin ekonomik të investimeve dhe ia paraqet ato për

shqyrtim Këshillit Kombëtar të Rrugëve. Gjithashtu, kjo Drejtori harton programin e investimeve të Rr.Rr.K, bën shpërndarjen dhe kontrollon realizimin e tyre.

Në punën e saj kjo Drejtori mbështetet nga Drejtoria e Politikave të Transportit Rrugor si dhe nga Drejtoria e Qarkullimit dhe e Sigurisë Rrugore, pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Planifikimit të Transportit, në Ministrinë e Punëve Publike, Taransportit dhe Telekomunikacionit.

2.3 Asistenca teknike

Në realizimin e objektivave të saj në fushën e Infrastrukturës Rrugore, Qeveria Shqiptare është mbështetur nga disa Donatorë të huaj. Ndërtimi i Segmentit Lushnje - Fier 21.5 km, (Pjesë e Korridorit Lindje - Perëndim, Korridori 8-të) është mbështetur nga Kooperacioni Italian me një vlerë rreth 2 952 000 lekë. Banka Europiane e Investimeve (BEI) mbështet me një shumë rreth 3 456 300 lekë punimet në Segmentin Tepelenë - Gjirokastrë 23 km (Pjesë e Korridorit Veri-Jug). Nga BEI pritët që edhe në vitet në vazhdim të ketë një asistencë për ndërtimin e Segmenti Fier (Levan) - Tepelenë dhe atë Fier (Levan) - Vlorë 43 km (Pjesë e Korridorit 8 - të). Kjo asistencë do të jetë në bashkëpunim me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe vlera do të jetë rreth 14 760 000 lek. Për ndërtimin e Segmentit Shkodër - Hani i Hotit 35 km (Pjesë e Korridorit Veri - Jug), edhe Qeveria Italiane do të japë asistencën e saj.

Adresimi i prioritetëve

Prioritetet afatshkurtra (2006 – 2007)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2006-2007 janë si më poshtë:

Të zbatohet Plani Kombëtar për Transportin, përfshi planifikimin dhe buxhetimin për asetet mirëmbajtëse të infrastrukturës së transportit

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Hartimi dhe miratimi i Projekt - Ligjit "Standartet Shqiptare të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve ". Projekt - ligji do të jetë në përputhje me Standardet Evropiane të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Vazhdimi i punimeve për ndërtimin e segmentit Lushnje - Fier 21.5 km, (Pjesë e Korridorit Lindje - Perëndim, Korridori i 8-të)

Vazhdimi i punimeve për ndërtimin e segmentit Tepelenë - Gjirokastrë 23 km (Pjesë e Korridorit të 8 -të)

Ndërtimi i segmentit Milot-Rrëshen 26 km, (Pjesë e rrugës Durrës-Kukës-Morinë)

Ndërtimi i segmentit Kalimash - Kukës - Morinë 30 km, (Pjesë e rrugës Durrës-Kukës-Morinë)

Ndërtimi i segmentit Shkodër - Hani i Hotit 35 km (Pjesë e Korridorit Veri - Jug)

Ndërtimi i rrugës Transballkanike Vlorë,

Ndërtimi i segmentit Fier (Levan) – Tepelenë, në varësi të prioritetit të studimit të fizibilitetit të aksit Qendror jugor dhe të financimit (Pjesë e Korridorit Veri -Jug)

Ndërtimi i rrugës turistike të bregdetit Jug-Perëndimor, Vlorë - Himarë -Sarandë.

Prioritetet afatmesme (2008-2009)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2008-2009 janë si më poshtë:

Të vazhdohet me zbatimin e Master-Planit të Shqipërisë për Transportin, përfshi përpjekjet për të përfunduar korridorin rrugor Lindje-Perëndim dhe aksin Veri-Jug.

Të përfundojë reforma e nevojshme institucionale për të përmirësuar menaxhimin e asetëve të transportit, për t'u dhënë përparësi investimeve, për hartimin e politikave dhe përfshirjen e sektorit privat.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Urdhër i Këshillit të Ministrave "Për Përgatitjen e Hartave të Azhornuara Rrugore"

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Do të vazhdojnë punimet e nisura në periudhën afatshkurtër për disa prej akteve rrugore dhe gjatë periudhës afatmesme pritët përfundimi i tyre. Kështu, do të vazhdojnë punimet për ndërtimin e:

Segmenti Kalimash - Kukës - Morinë 30 km, (Pjesë e rrugës Durrës-Kukës-Morinë)
 Segmenti Shkodër - Hani i Hotit 35 km (Pjesë e Korridorit Veri - Jug)
 Rruga Transballkanike Vlorë,
 Segmenti Fier (Levan) - Tepelenë në varësi të prioritetit të studimit të fizibilitetit të aksit
 Qendror jugor dhe të financimit (Pjesë e Korridorit Veri -Jug)
 Rruga turistike e bregdetit Jug-Perëndimor, Vlore- Himarë - Sarandë
 Gjatë periudhës afatmesme *do të fillojnë* punimet për:
 Ndërtimin e segmentit Fier (Levan) - Vlorë 43 km (Pjesë e Korridorit të 8 – të)
Tabela: Shtese e kapaciteteve ndihmëse për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (Infrastruktura Rrugore)

INVESTIME	NJESIA E MATJES	gJENDJA AKTUALE	2006	2007	2008
Rritja e numrit të punonjësve	person				
Trajnime	000 lek				
Investime (pajsje, ndërtesa)	000 lek		22 400 000 (Investimet zbatohen mbi 2 vjet)	17 600 000 (Investimet zbatohen mbi 2 vjet)	15 200 000 (Investimet zbatohen mbi 2 vjet)
IT	000 lek				
Konsulenca-Studime	000 lek			74 756	1500

3.10.2 SIGURIA RRUGORE

1.Objektivi Politik

Në funksion të angazhimeve që rrjedhin nga zbatimi i MSA-së për fushën e sigurisë rrugore, fokusi i qeverisë shqiptare është përqëndruar në: përafrimin e legjislacionit në fushën e transportit tokësor, me vëmendjen kryesore në sigurinë rrugore dhe ndotjen e mjedisit nga mjetet, vendosjen e standarteve në nxjerrjet e gazrave nga automjetet e rënda dhe nivelit të zhurmave, si dhe krijimin e një sistemi informimi mbi trafikun rrugor duke synuar rritjen e sigurisë rrugore. Politikat e qeverisë do të konsiderojnë gjithashtu, optimizimin e elementeve të dobishëm të transportit si shpejtësia dhe komoditeti i lëvizjes përkundrejt ndikimit negativ mjedisor dhe sigurisë në lëvizje.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri ligjor

Veprimat në fushën e sigurisë rrugore rregullohet nga aktet e mëposhtme ligjore:

Ligji nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

VKM nr.153, datë 07.04.2000 "Për miratimin e Rregullores së Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë";

Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar;

VKM nr. 270, datë 10.05.06 " Për miratimin e Planit Kombëtar të Transportit".

Republika e Shqipërisë është palë në disa Marrëveshje Evropiane në këtë fushë, ku ndër më të rëndësishmet përmendim:

Marrëveshja Evropiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme” (ADR) dhe Protokoli i saj, ratifikuar me Ligjin nr.9272, datë 16.09.2004.

Marrëveshja Evropiane në lidhje me “Adoptimin e kushteve uniforme për inspektimet teknike periodike të mjeteve motorike dhe njohja reciproke e inspektimeve të tilla” e 13 Nëntorit 1997, ratifikuar me Ligjin nr. 9273, datë 16.09.2004.

2.2. Kuadri Institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e sigurisë rrugore është nën përgjegjësinë e këtij institucioni:

Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore, pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit është organi kryesor përgjegjës për veprimat në këtë fushë. Ajo ka si mision hartimin e politikave të zhvillimit sektorial të konkretizuara në programin e objektivave vjetore afatshkurtra dhe afatmesme.

Për realizimin e detyrave të saj, kjo Drejtori bashkëpunon me: Komitetin Ndërmjësor të Sigurisë Rrugore, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor si dhe me Policinë Rrugore pranë Ministrisë së Brendshme, e cila ka si aktivitet të saj kontrollin ligjor të zbatimit të Kodit Rrugor.

2.3. Asistenca e Huaj

Mbështetja financiare për fushën e sigurisë rrugore është përftuar nga "Projekti i Sigurisë Rrugore" si komponent i Projektit të Bankës Botërore të quajtur "Mirëmbajtja e rrugëve".

Në bashkëpunim me asistencën e huaj të Bankës Botërore (BB-së) pritet të krijohet një sistem i raportimit të aksidenteve në përputhje me rekomandimet e Direktivës 93/704/KE.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Prioritet i përcaktuar për Qeverinë shqiptare për periudhën 2006-2007 është:

Zbatimi i programit për sigurinë rrugore dhe përmirësimi i kushteve të sigurisë rrugore, duke filluar me harmonizimin e legjislacionit shqiptar me acquis e BE-së për sa i përket peshave dhe dimensioneve, kontrolleve teknike, kontrolleve në anë të rrugës, lejeve të drejtimit dhe dokumenteve regjistruese të automjetit.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projekttakt "Për një ndryshim në VKM nr.153, datë 07.04.2000 "Per miratimin e Rregullores së Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar", i cili do të jetë pjesërisht i përputhur me Direktivën 91/439/KE;

Projektligj "Për një ndryshim në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar". Ligji i ri do të jetë pjesërisht i përputhur me Direktivën 91/439/KE;

Projekttakt "Për ndryshime në Udhëzimin e kualifikimit për drejtuesit e mjeteve dhe programin teoriko-praktik nr. 994, datë 12.3.2003", i cili do të jetë pjesërisht i përputhur me Direktivën 96/53 KE

3.1.2. Aktivitet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Studim me qëllim njohjen e legjislacionit të ri evropian në fushën e sigurisë rrugore;

Realizimi i investimeve për përmirësimin e komponentëve të sigurisë rrugore, në sinjalistike rrugore dhe përmirësim të pikave të rrezikut;

Ndjekja me prioritet e investimeve për përmirësimin e komponenteve të sigurisë rrugore në sinjalistike rrugore dhe përmirësim i pikave të rrezikut;

Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave në kuadër të programit "Për monitorimin e mjedisit";

Përmirësime të pikave të rrezikut nëpërmjet projektesh pilot;

Ndjekja e projekteve "Pilot" të krijuara me qëllim përmirësimin e pikave të rrezikut;

Krijimi i një qendre informimi të trafikut;

Përmirësimi i qendrave të kontrollit teknik të mjeteve për testimin e parametrave konstruktiv dhe ekologjik komform standarteve Evropiane.

3.2. Prioritetet Afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2008-2009 janë si më poshtë:

Të shënohen rezultate më të mira për sa i takon sigurisë rrugore dhe të merren masa shtesë për përmirësim të mëtejshëm;

Të merren masa për parandalimin e ndërtimeve pa leje përgjatë rrugëve të reja dhe të parandalohen hyrjet e pasigurta në rrugët kombëtare.

3.2.1. Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projekttvendim i KM "Për caktimin e konsulentëve të sigurisë rrugore"

në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme". Kjo VKM do të ketë përputhshmëri të pjesëshme me Direktivën 96/53 KE;

Projekttakt "Për disa ndryshime në ligjin, VKM dhe udhëzimin "Për procedurat e kontrollit të mallrave të rrezikshme", i cili do të ketë përputhshmëri të pjesshme me Direktivën 95/50 KE.

3.2.2. Aktivitet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Krijimi i një qendre informimi të trafikut;

Përmirësime të pikave të rrezikut nëpërmjet projektesh pilot;

Pjesmarrja në kuadër të programit "Për monitorimin e mjedisit" me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

Tabela: Shtesë e kapaciteteve ndihmëse për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (Siguria Rrugore dhe Ndotja e Ambjentit nga Mjetet)

INVESTIME	NJESIA E MATJES	gJENDJA AKTUALE	2006	2007
Rritja e numrit të punonjësve	person	5		
Trajnime	000 lek		100	
Investime (pajisje, ndërtesa)	000 lek		200 000	1 320 000
IT	000 lek			
Konsulenca-Studime	000 lek		10 800	

3.10.3 TRANSPORTI RRUGOR

1. Objektivi Politik

Në zbatim të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit për fushën e Transportit Rrugor, Qeveria Shqiptare ka si prioritet hartimin e politikave lidhur me lehtësimin e hyrjes në treg të transportuesve. Në mbështetje të këtij angazhimi, do të forcohet legjislacioni për shmangien e konkurrencës së pandershme, si dhe do të zbatohen me rigorozitet marrëveshjet dy dhe shumë palëshe në Transportin Rrugor.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri ligjor

Me qëllim rregullimin e veprimtarisë në këtë fushë Qeveria Shqiptare ka miratuar një sërë aktesh ligjore, disa prej të cilave kanë mundësuar aderimin e Shqipërisë në disa Konventa Ndërkombëtare për Transportin Rrugor. Kuadri ligjor bazë në këtë fushë përbëhet nga:

Ligji nr.8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" i ndryshuar, i cili është ligji bazë për hyrjen në treg, në bazë të transparencës dhe kriterëve cilësorë të njëjta. Ky Ligj është plotësisht i përafshuar me Direktivën nr. 96/26EC, amenduar nga direktiva 98/76. Dispozitat për zbatimin e këtij Ligji janë të përfshira në Udhëzimin nr.5781, datë 23.12. 2003.

Ligji Nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë"

VKM nr. 270, dt.10.05.06 " Për miratimin e Planit Kombëtar të Transportit"

Ndër Konvenat dhe Marrëveshjet Europiane, në të cilat Republika e Shqipërisë tashme është palë, përmendim:

Konventa mbi Trafikun Rrugor, e 19 Shtatorit 1949;

Konventa mbi Trafikun Rrugor, e 8 Nëntorit 1968;

Konventa mbi Shenjat dhe Sinjalet Rrugore, e 8 Nëntorit 1968

Konventa Doganore mbi Importimin e Përkohshëm të Mjeteve Rrugore Private

Konventa Doganore mbi transportin ndërkombëtar të mallrave sipas TIR, e 15 Janar 1959;

Konventa Doganore mbi transportin ndërkombëtar të mallrave sipas TIR, e 14 Nëntor 1975

Marrëveshja Evropiane e Transportit Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme, e 30 Shtatorit 1957 (ADR),

Marrëveshja Evropiane mbi Transportin Ndërkombëtar të Mallrave Ushqimore Delikate dhe Pajisjet Speciale që përdoren në të tilla Transporte (ATP), e 1 Shtatorit 1970,

Marrëveshja mbi Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Rastit të Udhëtarëve me Autobus (Marrëveshja Interbus),

Marrëveshja Europiane në lidhje me Adoptimin e kushteve uniforme për inspektimet teknike periodike të mjeteve motorike dhe njohja reciproke e inspektimeve të tilla e 13 Nëntorit 1997,

Protokolli që ndryshon nenet 1 (A) dhe 14 (1),(3)B të Marrëveshjes Europiane të Transportit Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme, e 30 shtatorit 1957 (ADR), bërë në Gjenevë më 28 tetor 1993;

Konventa, që lidhet me punën e ekuipazheve në transportin ndërkombëtar rrugor, e vitit 1970 (AETR);

Konventa mbi kontratën për transportuesit ndërkombëtar rrugor të mallrave, e 1956 -ës (CMR);

Shqipëria është gjithashtu palë në Memorandumin e Mirëkuptimit të Europës Juglindore, nënshkruar me 11 qershor 2004

2.2. Kuadri Institucional

Politika e transportit rrugor ndërkombëtar dhe të brendshëm përsa i përket mallrave dhe udhëtarëve, është nën përgjegjësinë e:

Drejtorisë së Politikave të Transportit Rrugor, e cila është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Planifikimit të Transportit, në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPT&T).

Roli i Drejtorisë së Politikave të Transportit Rrugor qëndron kryesisht në hartimin e politikave lidhur me hyrjen në treg të transportuesve, mënjanimin e konkurrencës së pandershme në këtë fushë, hartimin dhe monitorimin e marrëveshjeve bilaterale e multilaterale në transportin rrugor, propozimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

Për realizimin e objektivave të saj, kjo Drejtori bashkëpunon me Drejtorinë e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore në MPPT, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtorinë e Qarkullimit Rrugor në Ministrinë e Brendshme, Njësitë e Qeverisjes Vendore si dhe me Shoqatën e Transportuesve Shqiptarë (ANALTIR).

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Dokumenti i Partneritetit European nuk adreson prioritetet afatshkurtra për fushën e Transportit Rrugor.

3.2. Prioritetet Afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2008-2009 janë si më poshtë:

Zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit të Europës Juglindore (SEE), Rrjeti Transportues Rajonal përfshi Observatorin e Transportit (SEETO)

3.2.1. Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projekt -ligj "Për një ndryshim në Ligjin Nr.8308, datë 18.03.1998 " Për transportet rrugore", i ndryshuar". Ligji pritet të jetë pjesërisht i përputhur me Direktivën Nr.96/26/KE

VKM "Për pranimin profesional të operatorëve në transportin rrugor dhe njohjen reciproke të diplomave dhe certifikatave", e cila do të jetë pjesërisht e përputhur me Direktivën Nr.96/26/KE

Projekt -ligj "Për aderimin në Konventën "Mbi taksimin e mjeteve rrugore që merren me transportin e mallrave"

Projekt-ligj "Për aderimin në Konventën "Mbi Taksimin e mjeteve rrugore që merren me transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve"

VKM "Për miratimin e dokumentit të ri të politikave sociale për drejtuesit e mjeteve dhe rritjen e sigurisë rrugore". VKM do të jetë pjesërisht i përputhur me Rregulloren 3820/85/KE dhe Direktivën 2002/15/KE

Projekt - udhëzim "Për procedurat standarte të kontrollit", i cili do të jetë pjesërisht i përputhur me Direktivën 88/599/KE

Projekt-ligj "Për një ndryshim në ligjin 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë"(Për peshat dhe dimensionet)". Ligji i ri do të jetë pjesërisht i përputhur me Direktivën 96/53/KE.

Projekt-ligj " Për një ndryshim në ligjin 8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", i cili do të jetë pjesërisht i përputhur me Direktivën 99/62/KE

VKM "Mbi punësimin dhe kualifikimin profesional të konsulentëve të sigurisë rrugore në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme", pjesërisht e përputhur me Direktivën 96/35/KE

VKM "Mbi procedurat uniforme në kontrollin e transportit rrugor të mallrave të rrezikshme", pjesërisht e përputhur me Direktivën 95/50/KE

3.2.2. Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme

zbatuese:

Trainimi i institucioneve të kontrollit lidhur me zbatimin e legjislacionit në rrugë
 Studim me qëllim njohjen me legjislacionin komunitar në fushën e transportit rrugor
 Forcimi i kapaciteteve administrative në Drejtorinë e Politikave të Transportit Rrugor
 Trainimi i ekspertëve të Drejtorisë së Politikave të Transportit Rrugor

Tabela: Shtese e kapaciteteve zbatuese për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (Transporti Rrugor)

INVESTIME	NJESIA E MATJES	gJENDJA AKTUALE	2006
Rritja e numrit të punonjësve	person	4	3
Trajnime	000 lek		1500
Investime (pajisje, ndërtesa)	000 lek		100
IT	000 lek		240
Konsulenca-Studime	000 lek		3000

3.10.4 TRANSPORTI HEKURUDHOR

Objektivi Politik

Ristrukturimi i sistemit hekurudhor shqiptar është prioriteti i Qeverisë Shqiptare në fushën e Transportit Hekurudhor. Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor, duke synuar përputhjen e plotë të tij me atë europian, përmirësimi i menaxhimit të performancës ekonomike, reduktimi i kostove operative, ulja e subvencioneve, përmirësimi i infrastrukturës hekurudhore si dhe rinovimi i përgjithshëm i inventarit të mjeteve lëvizëse, duke i dhënë përparësi importit të trenave rajonale, janë objektivat ,që priten të realizohen deri në periudhën afatmesme, me qëllim përmbushjen e prioritetit të Qeverisë Shqiptare.

Qëllimi final është përfshirja e rrjetit tonë hekurudhor në rrjetet rajonale hekurudhore: Korridori VIII dhe Rrjeti Hekurudhor Rajonal i Përfundimit të Lartë.

1. Situata Aktuale

1.1. Kuadri Ligjor

Me qëllim rregullimin e veprimtarisë në Transportin Hekurudhor me Ligjin nr. 9317, datë 18.11. 2004, është miratuar “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”. Ky Kod ka parasysh direktivat kryesore të KE-së për zhvillimin në sektorin hekurudhor si : hapja e tregut për transportues të tjerë, përveç Hekurudhave Shqiptare Sha., liberalizimi, transparenca, mosdiskriminimi i operatorëve, ndarja e operatorëve të transportit nga administruesit e infrastrukturës, referuar direktivës 91/440/KEE dhe amendimet e tij përfshirë direktivën 2001/12/KE dhe direktiva 2001/13/KE. Ai, gjithashtu, përfshin futjen në të ardhmen të konceptit të detyrimit të shërbimit publik, siç përcaktohet në Rregulloren nr. 1191/69 e Këshillit të 26 Qershorit 1969.

Shqipëria është anëtare e Organizatës Ndërqeveritare të Transportit Ndërkombëtar Hekurudhor, që nga viti 1984 (OTIF). Në 1 Qershor 1984 Shqipëria ka ratifikuar Konventën lidhur me transportet ndërkombëtare hekurudhore e 9 Majit 1980 (COTIF).

Aktualisht Republika e Shqipërisë është anëtare në Konventat e mëposhtme :

Konventa e OKB-së (UNCE) për lehtësimin e kalimeve kufitare për mallrat e transportuara me hekurudhë.

Konventa e OKB-së (UNCE) për lehtësimin e kalimeve kufitare për udhëtarët dhe bagazhet e transportuara me hekurudhë.

Rregullat uniforme lidhur me kontratën e transportit ndërkombëtar hekurudhor të mallrave (CIM).

Rregullat uniforme lidhur me kontratën e transportit ndërkombëtar hekurudhor të udhëtarëve (CIV).

Gjithashtu, Shqipëria është palë edhe në Memorandumin e Mirëkuptimit të Europës Jug-Lindore, nënshkruar me 11 qershor 2004.

1.2. Kuadri institucional

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, Sektori i Politikave të Transportit Hekurudhor, pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, është njësi rregullatore e përgjithshme e aktivitetit tërësor të transportit hekurudhor. Drejtimit kryesor të punës të Ministrisë janë:

Të hartojë dhe të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme politikat e zhvillimit të transportit hekurudhor, në përputhje me zhvillimin aktual të ekonomisë kombëtare dhe të nevojave të popullatës për transportin e mallrave e të udhëtarëve, si për transportin e brendshëm ashtu dhe për transportin

ndërkombëtar hekurudhor;

Të hartojë dhe të përmirësojë në vijimësi një legjislacionin sa me bashkëkohor e në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian, me synim nxitjen dhe menaxhimin optimal të transportit hekurudhor në përputhje me politikat sektoriale të hartuara.

Të ndjekë hartimin e studimeve të fizibilitetit dhe master – planeve për zhvillimin e transportit hekurudhor në tërësi dhe sipas zonave e Korridoreve të veçanta të transportit.

Të mbështesë, të inkurajojë dhe të favorizojë zhvillimin e trafikut transit, duke i dhënë përparësi zhvillimit të transporteve multimodale në korridoret Lindje – Perëndim, Veri – Jug si dhe ato në drejtim të Kosovës;

Të marrë masat për mënjanimet e një konkurrence të pandershme;

Të përcaktojë politikat e përmirësimit të infrastrukturave ekzistuese të transportit hekurudhor dhe të zgjerimit e zhvillimit të infrastrukturave të reja;

Të monitorojë zbatimin e politikave dhe të bashkëpunojë me organet e pushtetit lokal për probleme specifike;

Të shqyrtojë dhe të ndjekë në tërësi problemet teknike të transportit hekurudhor, që lidhen me gjendjen aktuale të inventarit të mjeteve lëvizëse, të sistemeve të komunikimit e të sinjalizimit si dhe të ndjekë në vazhdimësi politikat e miratuara për ecurinë në këtë fushë.

Ministria e Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacionit bashkëpunon ngushtësisht me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Hekurudhat Shqiptare Sh.a. dhe Drejtorinë e Planifikimit Financiar, Statistikave dhe Integritetit në MPPT&T për hartimin e strategjive dhe hapat e privatizimit të sektorëve të ndryshëm të transportit hekurudhor, në bazë të politikës së hartuar për këtë qëllim.

Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Europian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Europian, prioritet afatshkurtër (2006-2007) për fushën e transportit hekurudhor është:

Të nisin reformat e nevojshme në sektorin hekurudhor

Iniciativat ligjore afatshkurtra

Me qëllim realizimin e këtij prioriteti, do të ndërmeren këto iniciativa ligjore për një periudhë afat shkurtër:

Miratimi i Rregullores për dhënien dhe heqjen e dëshmisë së aftësisë dhe shqyrtimi i kundravajtjeve administrative.

Miratimi i standarteve teknike të vijave hekurudhore

Miratimi i Udhëzimit mbi kushtet teknike të ndërtimit dhe të funksionimit të kalesave hekurudhore.

Miratimi i Rregullores së sinjalizimit dhe e ndërlidhjes në hekurudhë.

Miratimi i Rregullores për kontrollin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e infrastrukturës hekurudhore

Miratimi i Rregullores për shfrytëzimin teknik të hekurudhave

Miratimi i Rregullores për transportin hekurudhor të udhëtarëve dhe të bagazheve.

Miratimi i Rregullores për kriteret e liçensimit të transportuesve hekurudhorë.

Miratimi i Rregullores për dhënien e lejeve të veprimtarisë të transportuesve hekurudhorë.

Miratimi i Rregullave për mënyrën e përdorimit të vijës hekurudhore nga transportuesit hekurudhorë.

Miratimi i Rregullores për transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme

Miratimi i Rregullores mbi kushtet e pranimit teknike dhe të pranimit për shfrytëzim të mjeteve hekurudhore.

Të gjitha këto iniciativa ligjore do të jenë pjesërisht të përputhura me , Rregulloret (CEE) 1191/69, 1107/70 si dhe me Direktivën 91/440/CE, Direktivën 95/18/CE, Direktivën 96/48/CE, Direktivën 2001/12/CE, Direktivën 2001/13/CE, Direktivën 2001/14/CE, Direktivën 2001/16/CE, Direktivën 2004/49/CE , Direktivën 2004/50/CE, Direktivën 2004/51/CE.

Përveç rregulloreve të mësipërme, gjatë procesit të reformimit mund të lindë domosdoshmëria e nxjerrjes së akteve të tjera ligjore, në varësi të ecurisë së këtij procesi.

Aktivitet zbatuese

Për realizimin e prioritetit afatshkurtër në këtë fushë, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Studimi i Legjislacionit Komunitar në fushën e Transportit Hekurudhor

Hartimi i plan - veprimit për ndarjen e llogarive të sektorit të infrastrukturës nga sektori i shfrytëzimit

Studim për ndarjen e nënndarjen e Bazës Mekanike në një shoqëri anonime të veçantë

Ndarja e Bazës Mekanike në një Shoqëri anonime të veçante, jo në varësi të HSH -së.

Studim mbi ndarjen institucionale të infrastrukturës nga transportuesit hekurudhorë të udhëtareve dhe të mallrave.

Pjesëmarrja në grupet e punës për realizimin e studimeve "Për ngritjen e rrjetit hekurudhor rajonal të Performancës së Lartë"

Prioritetet Afatmesme

Bazuar në rekomandimet e Komisionit European të dhëna në Dokumentin e Partneritetit European, prioritet afatmesëm (2008-2009) për fushën e transportit hekurudhor është:

Zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit të Europës Juglindore (SEE), Rrjeti Transportues Rajonal përfshi Observatorin e Transportit (SEETO)

Iniciativat ligjore dhe Aktivitet zbatuese

Të gjitha iniciativat ligjore të ndërmarra në periudhën afatshkurtër si dhe aktivitetet zbatuese të kësaj periudhe i shërbejnë edhe përmbushjes së prioritetit afatmesëm në këtë fushë.

Tabela: Shtesë e kapaciteteve ndihmëse për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (Transporti Hekurudhor)

INVESTIME	NJESIA E	gJENDJA	2	2
MATJES	AKTUALE	006	007	
Rritja e numrit të punonjësve	person	3		
Trajnime	000 lek		1	1
		7500	0150	
Investime (paisje, ndërtesa)	000 lek			
IT	000 lek			
Konsulenca-	000 lek		2	4
Studime		2140	3610	

3.10.5 TRANSPORTI DETAR

Objektivi Politik

Më datë 10.05.2006 Qeveria Shqiptare miratoi Planin Kombëtar të Transportit, i cili përbën dokumentin themelor që do të rregullojë të gjitha nënfushat e transportit, si rrjedhojë edhe transportin detar. Objektivat e përcaktuara në këtë Plan për Transportin Detar janë:

zhvillimi dhe rehabilitimi i porteve dhe sigurimi i burimeve financiare të nevojshme për zhvillimin e sistemit të transportit në një mënyrë më të harmonizuar me qëllim që të inkurajojë zhvillimin e ekonomisë dhe të vendit, të përmbushë kërkesat për transportin Evropian në rajonet jugore të Evropës;

zbatimi i reformave ekonomike, përmes nxitjes së privatizimit të aktivitetëve që kanë mbetur publike, komercializimin e shërbimeve publike, si dhe përmes rritjes së përfitimit të kostove përmes një politike çmimesh dhe taksash;

krijimi i një sistem rregullator dhe ligjor sipas kërkesave dhe standardeve evropiane që do të garantojë operime optimale të shërbimeve të transportit në bazë të një konkurrimi të nivelit të lartë;

zhvillimi dhe kryerja e reformave institucionale.

1. Situata Aktuale

1.1. Kuadri ligjor

Konventat Ndërkombëtare

Republika e Shqipërisë si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare Tregtare (IMO) që në vitin 1993, ka ratifikuar një numër të konsiderueshëm Konventash ndër të cilat më të rëndësishmet përmendim:

Konventa e Detyrimit Civil për Ndotjet nga Nafta duke përfshirë edhe Protokollin e fundit. (cLc);

Konventa për Fondin e Kompensimit të Dëmeve të Shkaktuara nga Ndotjet e Ambientit Detar duke përfshirë Protokollin e fundit;

Konventa për Standardet e Kualifikimit, Atestimit dhe Shërbimit për Detarët (STCË);

Konventa Ndërkombëtare “Mbi Shpëtimin e Jetës në Det” (SOLAS 1974), së bashku me amendamentet që pasojnë atë deri në Dhjetor të vitit 2000;

Konventa Ndërkombëtare “Mbi Kërkim Shpëtimin në Det” (SAR 1979);

Konventa e Kombeve të Bashkuara “Mbi të Drejtën e Detit”, Montego Bay, Xhamaika;

Konventa Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara “Mbi kushtet e Regjistrimit të Anijeve”;

Legjislacioni Kombëtar

Veprimtaria në fushën e Transportit Detar rregullohet nga këto akte ligjore dhe nënligjore:

Ligji nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar Shqiptar”. Ky Kod rregullon marrëdhëniet juridike ekonomike dhe shoqërore në fushën e transportit detar. Kodi Detar Shqiptar përputhet plotësisht me *acquis communautaire* në fushën e transportit detar;

Ligji nr. 9281, datë 23.09.2004 “Për sigurinë në anije dhe porte”;

Ligji nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”;

VKM nr. 270 datë 10.05.06 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Transportit”

VKM nr. 596 datë 10.09.2004 “Për miratimin e Statusit të Autoritetit Portual Durrës dhe riorganizimin e tij”;

VKM nr. 107, datë 25.02.2005 “Për një shtesë në VKM nr. 596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statusit të Autoritetit Portual Durrës dhe riorganizimin e tij dhe një ndryshim në VKM nr. 390, datë 15.02.2002 “Për mbrojtjen e objekteve të rëndësishme të veçantë me Forcat e Policisë së Shtetit”;

VKM nr. 115, datë 25.02.2005 “Për Autoritetin Shtetëror të Sigurisë Detare”, si dhe rregulloret përkatëse në lidhje me to.

1.2. Kuadri institucional

Në zbatim të legjislacionit në fushën e transportit detar është ngritur Drejtoria e Politikave të Transportit Detar pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT). Kjo Drejtori është njësi më e lartë e administratës detare, portuale dhe ujore e përfshirë në strukturën organizative të MPPTT.

Në funksion të përmbushjes së misionit të saj, kjo Drejtori realizon këto detyra:

Përcakton Strategjinë e zhvillimit të transportit detar, ujqor dhe porteve;

Përcakton rregullat e administrimit të pronës brenda territoreve të porteve;

Përgatit legjislacionin për rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimin normal të aktiviteteve në fushën e transportit detar, ujqor dhe porteve;

Përcakton rregullat për parandalimin dhe mbrojtjen nga ndotja të mjedisit. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Integritit, përgatit marrëveshjet detare me shtetet e tjera që burojnë nga zbatimi i Konventave Ndërkombëtare Detare dhe Ligji për Detin;

Përgatit të gjithë dokumentacionin për ratifikimin, bashkimin ose pranimin e Konventave Ndërkombëtare Detare si dhe përgatit rregullat kombëtare në zbatim të tyre;

Ndjek, në procesin e zhvillimit të përgjithshëm, të gjitha problemet që dalin për detin duke i zgjidhur ato sipas kompetencave që i jep ligji;

Bashkëpunon me drejtoritë e tjera në lidhje me kryerjen e investimeve në sektorin e transportit detar, ujqor dhe porteve.

Për realizimin e detyrave që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit, kjo Drejtori bashkëpunon me institucionet e vartësisë si Autoriteti Portual Durrës, Portet Detare Sh.A, Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve, Regjistri Detar Sh.A, Ndërmarrja e Anijeve të Shërbimit Detar si dhe me institucione të tjera.

1.3. Asistenca e huaj

Për zhvillimin e Portit të Vlores, është nënshkruar Marrëveshja me Cooperazione Italiana për financimin prej 15,4 mln Euro për realizimin e fazës 1, 2 dhe pjesërisht të fazës 3.

Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit European, prioritet afatshkurter (2006-2007) për fushën e transportit detar është:

Të përmirësohen kushtet e sigurisë detare, veçanërisht shkalla e ndalimit e anijeve shqiptare sipas Memorandumit të Mirëkuptimit të Parisit.

Iniciativat ligjore

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projektligji për aderimin e Shqipërisë në “Memorandumin e Mirëkuptimit për Kontrollin Shtetëror Portual” (Memorandumi i Mirëkuptimit të Parisit)

Aktivitet zbatues

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e Kontrollit Shtetëror Portual. Ngritja e këtij organizmi vjen si detyrim për përmbushjen e angazhimeve pas aderimit të Shqipërisë në Memorandumin e Mirëkuptimit për Kontrollin Shtetëror Portual. Ky organizëm do të jetë njësi kryesore për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Memorandumi. Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve është Instiucioni përgjegjës për ngritjen e këtij organizmi.

Në vazhdim të përpjekjeve për rritjen e sigurisë në porte dhe në përgjigje të angazhimeve që rrjedhin nga aderimi i Shqipërisë në Memorandumin e Mirëkuptimit për Kontrollin Shtetëror Portual dhe në konventa të tjera ndërkombëtare, gjatë periudhës afatshkurtër do të ndërmerren edhe këto aktivitete zbatuese:

Ngritja e Forcës së Sigurisë në Portin e Sarandës;

Ngritja e Forcës së Sigurisë në Portin e Vlorës;

Ngritja e Forcës së Sigurisë në Portin e Shëngjinit

Prioritetet Afatmesme

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit European, prioritet afatmesme (2008-2009) për fushën e transportit detar është:

Të arrihen përparime të dukshme në rehabilitimin e porteve të Durrësit dhe Vlorës dhe të konsolidohen operacionet portuale në këto porte.

Iniciativat ligjore

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projektligji “Për ngritjen e e Administratës Detare shqiptare”, i cili do të jetë i përafshuar plotësisht me Direktivën 94/57/EC, 95/21/EC. Ngritja e kësaj administrate vjen si domosdoshmëri për zbatimin e angazhimeve që rrjedhin nga Konventat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë. Administrata Detare do të jetë organizmi bazë për zbatimin e këtyre angazhimeve dhe për hartimin e politikave në fushën e transportit detar.

Aktivitet zbatues

Me qëllim zbatimin e angazhimeve që rrjedhin nga miratimi i projektligjit “Për ngritjen e administratës detare shqiptare”, gjatë periudhës afatmesme do të realizohet:

Ngritja e administratës detare

Nga ana tjetër do të vazhdojë:

Ndërtimi i fazës së parë, të dytë dhe pjesërisht të tretë të Master Planit të Portit të Vlorës, me qëllim rehabilitimin e këtij Porti.

Tabela: Shtesë e kapaciteteve ndihmëse për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (Transporti Detar)

INVESTIME	NJESIA E MATJES	gjENDJA AKTUALE	2006	2007	2008	2009
Rritja e numrit të punonjësve	person	A) 8		A)+ 16		
MPPTT		B) 1		B) +10		
Porti Detar Sh.A. Sarandë		C) 3		C) +20		
Porti Detar Sh.A. Vlorë		D) 1		D) +10		
Porti Detar Sh.A. Shëngjin				E) +4		
Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve						

Trajnime	000 lek	A)24 600	A) 95 940
MPPTT			B) 123
Porti Detar Sh.A. Sarandë			C) 492
Porti Detar Sh.A. Vlorë			D) 123
Porti Detar Sh.A. Shëngjin			E) 6150
Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve			
Investime (paisje, ndërtesa)	000 lek	A) 162 360	B) 500 B) 500
MPPTT		B) 500	C) 1000 C) 1000
Porti Detar Sh.A. Sarandë		C) 1895 200	D) 500 D) 500
Porti Detar Sh.A. Vlorë		D) 500	
Porti Detar Sh.A. Shëngjin			
Kapiteneria e Përgjithshme			
IT	000 lek	A)510 600	
MPPTT			
Porti Detar Sh.A. Sarandë		E) 12 300	
Porti Detar Sh.A. Vlorë			
Porti Detar Sh.A. Shëngjin			
Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve			
Konsulenca-Studime	000 lek	A) 79 950	
MPPTT			
Porti Detar Sh.A. Sarandë			
Porti Detar Sh.A. Vlorë			
Porti Detar Sh.A. Shëngjin			
Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve			

3.10.6 TRANSPORTI AJROR

1. Objektivi politik

Krijimi gradualisht i nje hapesire unike e te lidhur qarkullimi si ne nivel kombetar, ashtu edhe ne nivel rajonal, eshte nje nga objektivat strategjike per sektorin e transportit ajror. Qeveria shqiptare synon te zbatoje me eficence projektet aeroportuale per rritjen e kapaciteteve te qarkullimit dhe te metodave me efektive te terheqjes se kapitaleve private ne keto sherbime. Nje rendesi e vecante do t'i kushtohet zbatimit me rigorozitet te detyrimeve ligjore qe rrjedhin nga qenia pale ne disa prej Konventave dhe Marreveshjeve me te rendesishme Nderkombetare ne Fushen e Transportit Detar.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria ne fushen e Transportit Ajror rregullohet nga aket e meposhtme ligjore:

Ligji Nr.7877, dt 30.11.1994, "Per Aviacionin Civil Shqiptar"

Ligji Nr.8910, dt 19.03.1998, "Per sigurine e aviacionit civil "

Ligji Nr.8374, dt 15.07.1998, "Per perdorimin e hapesires ajrore te RSH"

Ligji nr.9312 date 11.11.2004, "Per ratifikimin e Marreveshjes se Koncesionit, ndermjet Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Shoqerise Koncesionare "Tirana Airport Partners"sh.p.k., per ndertimin, venien ne pune, operimin dhe mirembajtjen e Aeroportit Nderkombetar "Nene Tereza".

Ligji nr. 9149 date 30.10.2003 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr 8130, date 19.03.1998 "Per sigurine ne aviacionin civil shqiptar", referuar Aneksit 17 "Siguria" te ICAOS, Dokumentit 8973 "Manuali i Sigurise";

VKM Nr.270, dt. 10.05.06 "Per miratimin e Planit Kombetar te Transportit"

VKM Nr.48, dt 28.01.1999, "Per krijimin e bordit te hetimeve te aksidenteve dhe incidenteve ajrore te aviacionit civil"

VKM nr.665 dt 18.12.2002, "Per miratimin e kontrates ndermjet Qeverise se Republikes se Shqiperise dhe Lockheed Martin Global inc. Per modernizimin e sherbimit te Trafikut Ajror Shqiptar"

VKM Nr.296, dt 14.05.2004 "Per krijimin e komitetit te sigurise se Aeroportit te Rinasit "

VKM Nr.3, dt.07.01.1999, "Per krijimin dhe funksionimin ne fushen e kerkim-shpetimit (SAR) te avioneve ne rast aksidentesh ajrore"

VKM Nr.224,dt.15.05.1995, "Per krijimin e Keshillit konsultativ te Aviacionit Civil",

VKM nr.91 date 20.02.2004 "Per miratimin e programit kombetar te sigurise se Aviacionit Civil"

Republika e Shqiperise ka aderuar dhe ratifikuar Aktet nderkombetare ligjore, si me poshte :

Konventa Nderkombetare e Aviacionit Civil, nenshkruar ne Chicago, 7/12/44,

Marreveshja nderkombetare sherbimeve tranzit te trafikut ajror, nenshkruar ne Chicago me 07/12/44.

Marreveshja nderkombetare e Transportit Ajror,

Protokolli ne tekstin autentik trigjuhesh i Konventes Nderkombetare te Aviacionit Civil, nenshkruar ne Buenos Aires, me 24/09/68

Artikulli 83 pers. ne Montreal, me 06/10/80,

Konventa e Mbrojtjes ndaj akteve te kryera bordin e avionit, nenshkruar ne Tokyo me 14/09/63,

Konventa per Shtypjen e Masave te Paligjshme ne Avion, nenshkruar me Hage me 16/12/70,

Konventa per Shtypjen e Akteve te Paligjshme kunder Sigurise ne Aviacionin Civil, nenshkruar me Montreal me 23/09/71,

Protokolli per shtypjen e akteve te paligjshme te dhunes ne Aeroportet Nderkombetare Civile, Konventa Shtese per Shtypjen e Akteve te Paligjshme kunder Sigurise ne Aviacionin Civil, nenshkruar me Montreal me 23/09/71, nenshkruar ne Montreal me 24/02/88,

Qeveria e Republikes se Shqiperise ka parafuar dhe miratuar ne parim "Marreveshjen Horizontale me Vendet Anetare te BE-se", e cila normon dhe vendos kritere standarte te perbashketa te se drejtes se operimit ne fushen e transportit ajror.

Gjithashtu eshte parafuar edhe Marreveshja Shumepaleshe "Mbi krijimin e nje Zone te Perbashket te Aviacionit Evropian ndermjet RSH dhe vendeve te Bashkimit Europian"

2.2. Kuadri institucional

Transporti ajror shqiptar, nga pikpamja strukture-organizative vepron si nje sistem ne krye te te cilit eshte Autoriteti me i larte i tij, Ministri i Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Transporti ajror shqiptar funksionon ne tre nivele baze:

Niveli i zhvillimit te politikave (Drejtoria e Politikave te Transportit Ajror ne MPPTT);

Niveli rregullator e teknik (Drejtoria e Pergjithshme e Aviacionit Civil);

Niveli operacional dhe i operimit (Agjensia Nacionale e Trafikut Ajror, shoqerite ajrore, operatori i aeroportit, struktura e sherbimit te kontrollit te trafikut ajror, organizmat e mirembajtjes dhe struktura te tjera).

1. Drejtoria e Politikave te Transportit Ajror

Drejtoria e Politikave te Transportit Ajror si pjese e struktures se Ministrise se Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ka keto detyra:

Udheheq procesin e hartimit te strategjive politike, ligjore dhe ekonomike te zhvillimit te Transportit Ajror ne perputhje me strategjite dhe objektivat e Qeverise;

Koordinon, mbeshtet dhe monitoron ekezekutimin e programeve te miratuara afatmesme dhe afatgjata nga organet e tjera me natyre ekzekutive ne fushen e Transportit Ajror, levizjes se lire te pasagjereve dhe mallrave;

Koordinon dhe monitoron legjislacionin ne fushen e Transportit Ajror, perputhjen me legjislacionin nderkombetar dhe objektivat Evropiane te perfshirjes ne nje zone te vetme Evropiane, liberalizimin e tregut te transportit ajror, permiresimet e sigurise dhe parrezikshmerise(security & safety)

2. Drejtoria e Pergjithshme e Aviacionit Civil (DPAC)

DPAC eshte strukture e vartesise organike e Ministrise se Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe ka per mision rregullimin e marredhenieve ndermjet shtetit dhe personave juridike dhe fizike shteterore dhe privat, ne perputhje me interesat kombetare dhe normat teknike nderkombetare te veprimtarise ne fushen e aviacionit civil.

3. Agjensia Nacionale e Trafikut Ajror

Agjensia Nacionale e Trafikut Ajror (ANTA) sh.a. eshte nje shoqeri tregtare anonime me kapital teresisht shteteror e varur nga Ministria e Puneve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacionet dhe Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes.

4. Tirana Airport Partners Sh.p.k

Shoqeria Tirana Airport Partners (TAP) sh.p.k eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e cila ka marre ne koncension operimin e Aeroportit te Rinasit. Tirana Airport Partners ka per mision kryerjen e te gjithe sherbimeve aeroportuale ne aeroport.

Koncensionimi eshte dhene per 20 (njetzet) vjet dhe eshte ratifikuar me ligj nga Parlamenti shqiptar. TAP eshte operatori i vetem aeroportual i Aeroportit « Nene Tereza » te Rinasit.

Modernizimi i Aeroportit « Nene Tereza » behet ne perputhje me Master Planin e zhvillimit

te Aeroportit miratuar nga Qeveria shqiptare.

2.3. Asistenca e Huaj

Per zhvillimin e sektorit te transportit ajror, aktualisht nuk ka asistence te huaj.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra

*Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2006-2007 janë si më poshtë:
Të bëhen ndryshime në Kodin Ajror në mënyrë që të jetë në përputhje me acquis, duke marrë parasysh Hapësirën e Përbashkët Europiane të Aviacionit (ECAA).*

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projektligji "Per miratimin e Kodit Ajror", i cili do te rregulloje veprimtarine ne fushen e Transportit Ajror. Me qellim perfshirjen ne kete Kod te standarteve europiane, ai do te jete plotesisht i perputhur me Rregulloret 2407/92/KE, 2343/90/KE , 2320/2002/KE, 2027/97/KE, 889/2002/KE, 785/2004/ KE, 549/2004KE, Rreg.550/2004KE, 551/2004KE si dhe me Direktivat 94/56/KE, , 2002/30/KE dhe me Konventen e Montrealit.

Ne zbatim te Kodit Ajror do te miratohen:

Projektvendim i Keshillit te Ministrave per percaktimin e struktures, dhe menyres se financimit te Autoritetit se Aviacionit Civil.

Projekt-Vendim i Keshillit te Ministrave per krijimin e Enti Kombetar i Hetimit te Incidenteve dhe Aksidenteve ne Aviacion, si organ i pavarur i aviacionit. Vendimi do te jete plotesisht i perputhur me Direktiven 94/56KE "Mbi hetimin e aksidenteve dhe incidenteve".

Projekt Vendim i Keshillit te Ministrave "Per organizimin e hapesires ajrore dhe rregullat e ajrit ne RSH". Vendimi do te jete plotesisht i perputhur me Direktiven 2002/30KE

Projekt Vendim i Keshillit te Ministrave "Per caktimin e subjektit per kryerjen sherbimit te kontrollit te trafikut ajror per avionet civil dhe shteteror ne kohe paqe, si dhe kushtet dhe procedurat per hartimin e rregullave te sherbimit te trafikut ajror". Ky Vendim do te miratohet ne zbatim te angazhimeve qe rrjedhin per palen shqiptare nga Marreveshja Nderkombetare e Sherbimeve Tranzit te Trafikut Ajror.

3.1.2. Aktivitet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Përgatitja e infrastruktures per hartimin e Kodit Ajror

Plotesimi i detyrimeve financiare qe rrjedhin nga antaresimet ne Organizmat Nderkombetare te Aviacionit ne te cilat ka aderuar RSH si :ICAO, ECAC, JAA. Plotesimi i ketyre detyrimeve do te vazhdoje edhe per periudhen afatmesme.

Studim te trafikut te brendshem ajror nepermjet futjes ne skemen e operimit te tre aeroporteve (Rinas, Kukes dhe Sarande)

Krijimi i Entit te Investigimit te Incidenteve dhe Aksidenteve te Aviacionit

3.2. Prioritetet Afatmesme

Iniciativat ligjore afatmesme

Dokumenti i Partneritetit European nuk adreson prioritetet afatmesme per kete fushe. Me qellim adresimin e prioritetëve afatmesme te qeverise shqiptare, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projekt Vendim i Keshillit te Ministrave "Per percaktimin e subjektit per kryerjen e Sherbimit meteorologjik per nevojat e aviacionit".

Projekt Vendim i Keshillit te Ministrave "Per procedurat e leshimit te lejeve per Fluturimet nderkombetare te avioneve"

Udhezimi i Ministrit te Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit per Mbajtjen e rregjistrimit shteteror te aerodromeve civile dhe eksperimentale.

Udhezim i Ministrit te Puneve Publike,Transportit dhe Telekomunikacionit per marrjen e lejeve ne rastet e kryerjes se transportit nderkombetar dhe/ose punimeve ajrore ne territorin e Republikes se Shqiperise, per subjektet e aviacionit te huaj.

Udhezim i Ministrit te Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit per percaktimin e kerkesave per leshimin e Autorizimit te Operatorin Ajror dhe te Çertifikates se Operimit Ajror (C.O.A)

Udhëzim i Ministrit të Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për kërkesat dhe procedurat për sigurinë në shërbimet e trafikut ajror në përputhje me standartet e ICAO-s dhe të EUROCONTROL-it

Vendim i Keshillit të Ministrave "Për procedurat e leshimit të lejeve për Fluturimet ndërkombetare të avioneve".

Vendim i Keshillit të Ministrave "Për përdorimin e fotografimit, filmimit dhe metodave të tjera nga bordi i avionit"

Tabela: Shtesë e kapaciteteve për Ministrinë Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

INVESTIME	NJESIA E MATJES	gJENDJA AKTUALE	2006	2007	2008	2009
Rritja e numrit të punonjësve	person	3				
Trajnime	000 lek		6000			
Investime (pajisje, ndërtesa)	000 lek		8851	9410	7051	7756
IT	000 lek			1000		
Konsulenca-Studime	000 lek		2000	4000		

3.11 TATIMET

1. Objektivi politik

Bazuar në nenet 85 dhe 98 të MSA-së për forcimin e reformave të mëtejshme në sistemin fiskal dhe në ristrukturimin e administratës së tatimeve, Qeveria shqiptare angazhohet të sigurojë efikasitet në mbledhjen e taksave dhe në luftën kundër evazionit fiskal. Për këtë qëllim, do të merren parasysh prioritetet që lidhen me "acquis communautaire" në fushën e tatimeve dhe luftën kundër konkurrencës së dëmshme të tatimeve. Qeveria shqiptare njeh rëndësinë e përmirësimit të transparencës dhe shkëmbimit të të dhënave me Bashkimin Evropian me qëllim që të lehtësohet vënja në zbatim e masave parandaluese për mospagimin ose evazionin fiskal.

Qellimet dhe drejtimet kryesore të punës së qeverisë do të jenë: maksimizimi i mbledhjes së të ardhurave tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesit; ofrimi i shërbimeve të një cilësie të lartë; minimizimi i kostove të mbledhjes së të ardhurave tatimore pa rrezikuar efektivitetin e mbledhjes dhe duke ofruar shërbimet e nevojshme për tatimpaguesit, sigurimi për organet shtetërore i të dhënave të sakta statistikore dhe ngritja e kapaciteteve administrative në këtë fushë.

2. Situata aktuale

Kuadri ligjor ekzistues

Legjislacioni bazë në fushën e tatimeve përbëhet nga:

Ligji Nr.8560, date 22.12.1999 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"

Ligji Nr.7928, date 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i amenduar),

Ligji Nr.8438, date 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" me efekt nga Janari 1999 (i amenduar)

Ligji Nr.8978, date 12.12.2002 "Për taksën vendore mbi biznesin e vogël";

Ligji Nr.8976, date 12.12.2002 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" (i amenduar).

Ligji Nr.8977, date 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë";

Ligji Nr.9136, date 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Ligji Nr.8982, date 12.12.2002 "Për sistemin e taksave vendore"

Kuadri institucional ekzistues

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) është institucioni tatimor qendror i vetëm në Republikën e Shqipërisë dhe ka autoritetin për të propozuar hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit tatimor. Gjithashtu, ky institucion ka autoritetin për të zbatuar dhe administruar të gjitha tatimet, taksat e tarifatat kombetare në Shqipëri. DPT përbehet nga Drejtoria Qendrore, 36 degët e tatim-taksave në rrethe dhe degen e tatimpaguesve të medhenj.

Qëllimi kryesor i DPT është të ndihmojë tatimpaguesit për të paguar detyrimet e tyre tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, dhe të sigurojë që të ardhurat nga këto detyrime të shkojnë për llogari të buxhetit të shtetit, duke i ofruar tatimpaguesve një sistem pagese eficient dhe

efektiv.

Administrata tatimore ka nje personel prej rreth 1.516 nëpunësish. Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (Drejtoria Qendrore) perbehet nga Drejtori i Pergjithshem, tre zv/drejtores, perkatesisht teknik, operacional dhe mbeshtetes dhe 13 drejtores dhe 2 Njesi.

DPT bashkepunon ngushte per shkembime informacioni dhe asistence reciproke me Doganat, me Drejtorine e Thesarit, me Drejtorite Rajonale te Transportit, me Ministrine e Rendit, bankat, Dhomen e Tregtise, shoqatat e bizneseve, etj., si dhe me administratat analoge jashte vendit. etj.

Ne fushen e politikave tatimore dhe legjislacionit tatimor bashkepunon me Ministrine e Financave, Ministrine e Integritimit Evropian dhe Ministrine e Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes.

2.3 Asistenca teknike dhe financiare

Administrata Tatimore aktualisht mbështetet nga:

CAM-A nepermjet Projektit CARDS me shume 4 000 000Euro, jep asistence per fiskalitetin ne Shqiperi

Projekt i DIFID me shume 2 383 000 Euro, mbeshtet Reforme ne Administraten Tatimore

Projekt i SIDA me shume 640 000 Euro, mbeshtet modernizimin dhe efektivitetin e administrates tatimore.

Projekt i USAID me shume 5 155 000 Dollarë, mbeshtet permiresimet e nevojshme ne Sistemin Tatimor Shqiptar duke u perqendruar ne:

Projekt i INEENT me shume 320 000 Euro jep asistencen ne fushen e trainimeve

3. Adresimi i prioriteteve

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e percaktuara per Qeverine shqiptare per periudhen afatshkurtër janë si më poshtë:

Të përafrohet më tej legjislacioni tatimor me acquis communautaire dhe të vepohet në përputhje me parimet e Kodit të Sjelljes për Tatimin e Biznesit, duke garantuar përputhshmërinë e masave të reja tatimore me këto parime.

Të përfundojë procesi i kompjuterizimit të zyrave të tatimeve.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projektligj per TVSH i cili do të përafrohet pjesësisht me Direktivën 6 e BE per TVSH

Udhezim i Ministrit te Financave per TVSH

Projektligj per Tatimin mbi te Ardthurat i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivat e BE per tatime direkte

Udhezim i Ministrit te Financave per Tatimin

mbi te Ardthurat

Projektligj per Proçedurat Tatimore

Udhezim i Ministrit te Financave per Proçedurat Tatimore

Projektligj per Akcizat per perafrimin e nivelit te tyre me vendet e BE me Direktivat dhe rregulloret e BE per akcizat

Udhezim i Ministrit te Financave Per akcizat

3.1.2 Aktivitete zbatuese afatshkurter

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Dokumentimi dhe permiresimi i proçedurave te kontrollit te brendshem dhe investigimit te brendshem, per te cilen nevojitet trajnim dhe konsulence.

Diagnostikimi, dokumentimi dhe permiresimi i proçedurave te Kontrollit dhe Investigimit te Tatimpaguesve, per te cilen duhet nje trajnim i stafit perkates.

Zgjerimi i sistemit te kompiuterizuar tatimor (SIT) ne rrethet Gjirokaster, Sarande, Pogradec, per te cilen kerkohet stafi perkates, trainimi i tij si dhe investime ne paisje.

Dokumentimi dhe permiresimi i proçedurave te punes se Policise Tatimore, per te cilen nevojitet konsulenca.

Permiresimi i kushteve akomoduese ne degen e tatimeve Tirane, per te cilen kekohet nje fond investimi.

Aplikimi i sistemit te inteligjences dhe perdorimi efikas i tij me te dhenat e rrjetit te zgjeruar kompiuterik.

Perfundimi dhe vleresimi i projektit per ngritjen e Qendres se perhereshme te trajnimit tatimor, per te cilin kerkohet nje fond investimi.

Azhornimi i manualeve procedurale te regjistrimit, masave shternguese dhe akcizes.

Zbatimi i programit te zgjedhjes se kompiuterizuar te tatimpaguesve per kontroll, nevojitet konsulence.

3.2 Prioritete afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatmesme janë si më poshtë:

Të sigurohet një përafrim i vazhdueshëm i legjislacionit tatimor shqiptar me acquis communautaire, të rriten kapacitetet administrative për luftën kundër korrupsionit dhe evazionit fiskal.

Të përmirësohet transparenca dhe shkëmbimi i informacionit me Shtetet Anëtare të BE-së në mënyrë që të lehtësohet përforcimi i masave që parandalojnë shmangien apo evazionin e taksave.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projektligj per TVSH. Paraqitja e nje tarife te reduktuar te TVSH ne kuader te përafrimit te nivelit te TVSH me ate te direktives 6 te BE.

Udhëzim i Ministrit te Financave per Tatimin mbi Vleren e Shtuar ne mbështetje te ketyre ndryshimeve.

Projektligj per TVSH. Zgjerimi i baze se tatimpagusve te TVSH nepermjet uljes se kufirit te regjistrimit per TVSH (VAT Threshold) ne reflektim te përafrimit me kufirin e direktives 6 te BE.

Udhëzim i Ministrit te Financave per Tatimin mbi Vleren e Shtuar ne lidhje me uljen e kufirit.

Projektligj per Tatimin mbi te Ardhurat mbi zgjerimi e sistemit integral te deklarimit dhe pagimit te Tatimit mbi te Ardhurat personale ne kuader te përafrimit te metejshe me direktiven e BE per tatimet direkte.

Udhëzim i Ministrit te Financave per Tatimin mbi te Ardhurat ne mbështetje te ketij ndryshimi.

Projektligj per Procedurat Tatimore ne kuader te përafrimit te metejshe me direktivat e BE.

Udhëzim i Ministrit te Financave per Procedurat Tatimore ne mbështetje te ketij ndryshimi.

Projektligj per Akcizat. Metoda e akcizimit te pijeve alkolike jo per liter pije, por per liter alkol puro, ne kuader te përafrimit te metejshe me direktivat mbi taksat indirekte te BE.

Udhëzim i Ministrit te Financave per nivelin e Akcizave ne mbështetje te ketyre ndryshimeve.

Projektligj per Tatimin mbi te Ardhurat. Zgjerimi i sistemit integral te deklarimit dhe pagimit te tatimit mbi te ardhurat personale ne kuader te përafrimit te metejshe me direktiven e BE per tatimet direkte.

Udhëzim i Ministrit te Financave per Tatimin mbi te Ardhurat ne mbështetje te ketij ndryshimi.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Adoptimi i procedurave per regjistrimin unik te tatimpaguesve te biznesit te vogel.

Hartimi i nje rregulloreje per apelimet tatimore.

Perfundimi i Manualit te Burimeve Njerezore.

Zhvillimi dhe zbatimi i nje programi kompiuterik per administrimin e kompiuterizuar te te dhenave te personelit.

Zhvillimi i trajnimeve

3.3 Prioritetet afatgjatë

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën afatgjatë janë si më poshtë:

Të sigurohet një përafrim i vazhdueshëm i legjislacionit tatimor shqiptar me acquis communautaire, të rriten kapacitetet administrative për luftën kundër korrupsionit dhe evazionit fiskal.

Të përmirësohet transparenca dhe shkëmbimi i informacionit me Shtetet Anëtare të BE-së në mënyrë që të lehtësohet përforcimi i masave që parandalojnë shmangien apo evazionin e taksave.

Iniciativat ligjore afatgjate

Për adresimin e prioriteteve afatgjatë do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Harmonizimi i tarifave te akcizes me ato te BE, (karburantet, pijet alkolike, cigaret) duke

arritur harmonizimin e plote me direktivat dhe rregulloret e Akcizave te BE, me perjashtim te dispozitave qe lidhen me anetaresimin.

Vendosja e regjimit te tranzitimit nen regjimin e pezullimit tatimor dhe krijimit te magazinave tatimore (ne vendet e BE), qe siguron harmonizim te plote me direktivat dhe rregulloret e BE per akcizat.

Aplikimi i plote i sistemit integral te deklarimit dhe pagimit te tatimit mbi te ardhurat personale ne baze te direktivave dhe rregulloreve te tatimeve direkte te BE.

3.3.2 Aktivitetet zbatuese afatgjatë

Për adresimin e prioritetëve afatgjatë do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Administrimi i kompiuterizuar i tatimpaguesve te biznesit te vogel.

Perfshirja e akcizes dhe taksave nacionale ne SIT, per te cilin kerkohet nje fond investimi.

Krijimi i Rrjetit te Komunikimit Kombetar, per te cilin kerkohet nje fond investimi.

Zgjerimi i Rrjetit te Komunikimit Kombetar, per te cilin kerkohet nje fond investimi.

3.12 DOGANAT

Objektivi Politik

Qëllimi kryesor për fushën e Doganave është rritja e standardeve te strukturave doganore, vënia e tyre ne shërbim te komunitetit, ndalimi i kontrabandës, korrupsionit, monopoleve, praktikave klienteliste dhe krijimi i një klime te favorshme konkurrence për biznesin.

Shërbimi Doganor ka hartuar strategjitë dhe plane te specifikuar, te cilat konsistojnë ne 3 objektiva kryesore:

Rritjen e ndjeshme te nivelit te vjeljes se te ardhurave si dhe rritjen e nivelit te zhdoganimit kryesisht te mallrave qe paguajnë akcize.

Përfshirjen gjithnjë e me intensive të Shërbimit Doganor ne luftën kundër trafikut te drogës, armeve, makinave te vjedhura, qenieve njerëzore etj.

Forcimin e administrimit te burimeve njerëzore, zbulimin dhe goditjen e akteve korruptive, transparencën me publikun dhe sensibilizimin e tij ne luftën kundër korrupsionit.

Situata Aktuale

Kuadri Ligjor

Fusha e Doganave rregullohet nga aktet ligjore dhe nënligjore:

1. Kodi Doganor i Republikës se Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 8449, daten 27.01.1999 (i ndryshuar), i cili adopton pjesërisht Rregulloren 2913/92/EEC.

2. Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave miratuar me Ligjin nr. 8474, date 14.4.1999 “Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave”, i cili adopton pjesërisht Rregulloren 2263/2000/EC.

3. Ligji nr. 9461, dt. 21.12.2005, “Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore”, i cili adopton plotësisht Rregulloren 2658/87/EEC.

4. Vendimi i Këshillit te Ministrave nr. 205, date 13.04.1999, “Për Dispozitat Zbatuese te Kodit Doganor” (i ndryshuar) i cili adopton pjesërisht Rregulloren 2454/1993/EEC

5. Marreveshjet e Tregetise se Lire: Aktualisht jane negociuar, miratuar dhe kane hyre ne fuqi 8 Marrveshje te Tregetise se Lire me Kosoven, Maqedonine, Kroacine, Serbine, Rumanine, Bullgarine, Bosnje Herzegovinen dhe Moldavine.

6. Marreveshjet bilaterale per asistence te ndersjellte doganore: Shqiperia ka nenshkruar 14 Marreveshje te Asistences se Ndersjellte Doganore

Aktet normative te mësipërme përcaktojnë procedurat e hyrjes dhe daljes se mallrave nga dhe për ne territorin e Shqipërisë, vjellen e detyrimeve qe duhen paguar, masat e detyrimeve, mënyrat e kontrollit dhe verifikimit, definicionet dhe procedurat mbi administrimin e origjinës, shpjegimin dhe definicionet mbi konceptin e regjimeve doganore si dhe procedurat, format, mënyrat mbi administrimin e tyre.

Kuadri Institucional

Administrata doganore mbështetet ne tre misionet thelbësore:

Misioni fiskal, qe është misioni kryesor e qe konsiston ne mbledhjen e taksave doganore te mallrave qe importohen ne Republikën e Shqipërisë;

Misioni ekonomik; përmes te cilit dogana, zbaton nivelet e ndryshme te taksave si dhe ushtron funksionet kontrolluese;

Misioni Mbrojtës; ku administrata doganore luan rolin e saj te rëndësishëm i cili fokusohet kryesisht tek:

Mbrojtja e sigurisë kombëtare dhe rendit publik .

Mbrojtja e shëndetit publik.

Mbrojtja e konsumatorëve

Mbrojtja e ambientit

Mbrojtja e pasurisë kulturore kombëtare

Ruajtja e moralit publik

Asistenca Teknike

Administrata doganore ka matur dhe vazhdon të ketë marrëdhënie në nivele optimale me Misionin e Asistencës Doganore CAM-Albania, sot CAFAO, në kuadrin e asistencës që ka konsistuar kryesisht në:

Implementimin dhe vënien në zbatim të Sistemit Informatik ASYCUDA ++ i cili u bë operativ në 10 zyra doganore,

Monitorimin e problemeve që kanë lidhje me MTL-të e në veçanti me origjinën e mallrave, trinitime dhe asistenca të vazhdueshme të stafëve operacionale,

Monitorimin e vlerësimit doganor dhe regjimeve doganore kryesisht atë të magazinave doganore, hartimin dhe përshkrimin e vendit të punës për personelin e SHDSH-se,

Luftën kundër kontrabandës, evazionit fiskal dhe veprimtarisë antikrim.

Prioritetet

Prioritetet afatshkurtra

Përafrimi i legjislacionit doganor shqiptar me EU acquis communautaire,

Forcimi i bashkëpunimit me vendet e tjera të rajonit që kanë nënshkruar MSA lidhur me krijimin e zonave të tregtisë së lirë sipas dispozitave të OBT-se, dhe dhënies së koncesioneve reciproke lidhur me lëvizjen e punëtorëve, të drejtën e krijimit të kompanive, lëvizjes së lirë të shërbimeve, pagesave korrente dhe lëvizjes së kapitalit.

Bashkëpunimi me vendet e rajonit dhe vendet kandidatë për anëtarësim.

Ndalimi i diskriminimit fiskal për produktet e BE-se, shfuqizimi dhe mos-vendosja e masave ose praktikave të reja të natyrës fiskale të brendshme që krijojnë direkt ose indirekt diskriminimin midis produkteve vendase dhe atyre të BE-se;

sigurimi i bashkëpunimit administrativ me BE për të luftuar parregullsitë dhe mashtrimin në Dogana .

Zbatimi i Dispozitave të MSA që kanë të bëjnë me shfuqizimin dhe reduktimin e tarifave doganore dhe masave me efekt të njëjte mbi importet nga BE,

vendosja e lidhjeve të ngushta të bashkëpunimit me BE me qëllim forcimin e bashkëpunimit ekonomik në përfitim të të dyja palëve

Sigurimi i zbatimit të Protokollit IV të origjinës.

Iniciativat Ligjore

Për të mundësuar plotësimin e detyrimeve të sipërcituara, administrata doganore do të ndermarre iniciativat e duhura ligjore nga të cilat listojmë:

Ligjin për ndryshimin e Kodit Doganor, Pjesa II e personelin doganor (përfshirja në statusin e nepunës të civil)

VKM për ndryshimin e VK nr. 205, dt. 13.04.1999, për ndryshimin e Dispozitave Zbatuese të KD në lidhje me përjashtimet nga detyrimet doganore

Ligjin për ndryshimin e Kodit Doganor, Pjesa VIII, shkeljet doganore

Ligjin për ndryshimin e Kodit Doganor, për harmonizimin e pothuajse të plotë të procedurave të thjeshtuara.

VKM për ndryshimin e VK nr. 205, dt. 13.04.1999, për ndryshimin e Dispozitave Zbatuese të KD për procedurat e thjeshtuara

VKM për ndryshimin e VK nr. 205, dt. 13.04.1999, për ndryshimin e Dispozitave Zbatuese të KD për përafrimin e gjithë Aneksëve të operacioneve përpunuese (anekset e origjinës)

Ligjin për ndryshimin e Kodit Doganor, për pjesën e origjinës preferenciale duke mundësuar harmonizim pothuajse të plotë me Kodin e ri Doganor Komunitar.

Aktivitetet Zbatuese

Gjithashtu, për të mundësuar arritjen e plotësimit të detyrimeve të planit të përafrimit të legjislacionit si dhe për të mundësuar plotësimin e detyrimeve të MSA-se dhe të Partneritetit Europian, Administrata Doganore do të ndermarrë edhe disa masa konkrete zbatuese. Me poshtë po rendisim

disa prej masave me te rendesishme:

Zbatimi i PKPL, si dhe thellimi i vleresimit dhe perzgjedhjes se acquis ne kuader te perafimit
Implementimi i Planit Vjetor te Trajnimeve, per te mundesuar ngritjen e aftesimit profesional
te stafit doganor

Implementimi i planit vjetor të investimeve

Prioritetet afatmesme

Rritja e vazhdueshme e kapaciteteve administrative për zbatimin e legjislacionit doganor si
dhe lufta kundër korrupsionit dhe evazionit fiskal,

Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit dhe procedurave doganore, si dhe i zbatimit te tyre ne
linje me acquis communautaire;

Miradministrimi dhe mire-menaxhimi i kapaciteteve njerëzore për zbatimin korrekt dhe
uniform te marrëveshjeve te tregtisë se lire dhe ne luftën kundër kontrabandës dhe trafikeve;

Zbatimi i plote i ASYCUDA-s ne te gjithë vendin dhe vazhdimi i procesit te kompjuterizimit;

Ndryshime te mëtejshme ne ligj për te përfshire te gjithë stafin doganor ne shërbimin civil;

Përmirësimi i transparencës si dhe shkëmbimi i informacionit me vendet anëtare te BE-se për
te lehtësuar zbatimin e masave për te parandaluar evazionin.

Iniciativa Ligjore

Unifikimi i procedurave për zbatimin korrekt te ligjit për konfliktin e interesave dhe
standardeve te duhura për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, zgjidhjen dhe penalizmin e rasteve te
konfliktit te interesave,

Shtrirja e programit ASYCUDA ++ ne gjithë vendin

Analiza e riskut

Zbatimi i kujdesshëm i Marrëveshjes se Integritimit

Menaxhimi korrekt i kuotave MTL përmes shtrirjes se sistemit ASYCUDA ++ ne gjithë
vandin

Menaxhimi i vlerës doganore dhe çmimeve te referencës. Implementimi uniform i tyre ne
gjithë territorin doganor. Shtrirja e modulit VALU-NET

Tabela e forcimi te kapaciteteve institucionale te Shërbimeve Doganore

Instr nte	jësia e matjes	C jendja aktuale	VITET		
			006	007	008
Përk dhe im tari atitore	000 lekë		3	78	7
slacionin					
Kons cë	000 lekë		1000	080	
Inve e	000 lekë	1 77049	6344		
Traj e	000 lekë		984	90	

3.13 STATISTIKAT

1. Objektiv Politik

Drejtimet kryesore të zhvillimit strategjik të statistikave zyrtare në Shqipëri janë ngritja dhe forcimi i identitetit të sistemit dhe të imazhit të statistikës zyrtare, zhvillimi i kulturës statistikore në vend dhe shtimi i përdorimit të metodave statistikore në të dhënat që vijnë prej administratës publike; edukimi dhe përhapja e kulturës statistikore dhe stimulimi i kërkesës për informacion statistikor, integrimi dhe harmonizimi i metodave të prodhimit të informacionit statistikor në funksion të kërkesave dhe rekomandimeve evropiane e ndërkombëtare si dhe sigurimi i një bashkëpunimi statistikor ndërmjet të gjitha agjensive statistikore operuese në vend.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria në fushën e statistikave zyrtare në Shqipëri rregullohet në bazë të akteve të mëposhtme ligjore dhe nënligjore:

Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për Statistikat Zyrtare”.

Ky ligj përcakton dhe vendos standarte për marrjen, organizimin dhe shpërndarjen e statistikave. Ai përcakton termat dhe konceptet e statistikave zyrtare: parimet mbi të cilat mbështetet procesi i nxjerrjes së statistikave zyrtare për të siguruar besimin e publikut dhe njëkohësisht dhe cilësinë e tyre, i cili është i përputhshëm me *acquis* për statistikë.

Memorandume bashkëpunimi mes INSTAT - it dhe Ministrisë së Financave, me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit; Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Bankën e Shqipërisë; Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Këto memorandume me mbajtësit kryesorë të të dhënave administrative, synojnë sigurimin dhe trasmetimin në vazhdimësi të të dhënave bazë nga burimet administrative në drejtim të INSTAT - it .

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacionit në fuqi në fushën e statistikave është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

Instituti i Statistikave (INSTAT) i cili ka për detyrë të prodhojë statistika transparente, të paanëshme dhe në kohë që ndihmojnë përdoruesit të gjykojnë mbi ecurinë e proceseve transformuese të zhvillimit në vend. Këtë mision INSTAT - i e ushtron në përputhje me mandatin e tij publik dhe institucional duke synuar ngritjen e organizuar të një sistemi statistikor kombëtar, duke maksimuar përdorimin e të gjitha burimeve ekzistuese të informacionit.

Agjensitë Statistike, të cilat i sigurojnë INSTAT-it të gjitha dokumentet dhe të dhënat e nevojshme, për t'i mundësuar atij përpunimin e statistikave në çdo sektor.

Këshilli e Statistikave, i cili përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë të emëruar nga Këshilli i Ministrave, miraton programin statistikor, planin strategjik pesëvjeçar dhe Plan -Veprimin njëvjeçar të INSTAT-it dhe buxhetin vjetor dhe strukturën organizative të INSTAT-it.

Me Udhër të Kryeministrit, Nr 128, datë 05.06.2006 është miratuar struktura dhe organika e re për institucionin e INSTAT. Sipas këtij Urdhri, INSTAT është i organizuar me 3 drejtori, si më poshtë:

Drejtoria e Prodhimit të Statistikave, e cila ka për mision përpunimin, analizimin dhe publikimin e një pjese të statistikave ekonomike dhe ato me karakter social dhe demografik. Kjo drejtori në strukturën e saj përfshin këta sektorë: sektori i Llogarive kombëtare; sektori i bujqësisë dhe mjedisit; sektori i çmimeve; sektori i statistikave afatshkurtra; sektori i demografisë dhe statistikave personale dhe sektori i nivelit të jetesës.

Drejtoria e Anketave dhe mbështjetjes teknologjike, e cila ka për mision krijimin e mjeteve për përpunimin, analizimin, publikimin e statistikave dhe ruajtjen e të dhënave me karakter individual. Sektori i IT është përgjegjës për përcaktimin e standarteve dhe zbatimin e tyre. Sektori i Metodologjisë siguron zgjedhjen e sample-ave dhe vlerësimin e gabimeve të vrojtimit. Sektori i Kartografisë mbështet organizimin dhe drejtimin e regjistrimeve të përgjithshme dhe vrojttimeve me zgjedhje pranë familjeve si dhe shpërndarjen e rezultateve nëpërmjet hartave tematike. Kjo drejtori përfshin këto sektorë: Sektori i anketave, regjistrave dhe metodologjisë; sektori i informacionit teknologjik; sektori i difuzionit si dhe sektori i kartografisë.

Drejtoria e Personelit dhe shërbimeve mbështetëse, e cila përfshin në strukturën e saj këto

sektorë: sektori i financës; sektori i burimeve njerëzore si dhe sektori i marrëdhënieve me jashtë dhe koordinimit rajonal.

2.3. Asistenca teknike

Në mbështetje të zhvillimit të sistemit të statistikave zyrtare në Shqipëri, INSTAT - i është asistuar nga: **Programi Kombëtar CARDS 2002**, Projekt Binjakëzimi në implementim “Mbështetje të Institutit të Statistikave të Shqipërisë për mbledhjen e të dhënave dhe adoptimin e *Acquis Communautaire*” (2004- 2006);

Asistencë Teknike nga qeveria Suedeze e cila ndihmon në fushën e Statistikave të Biznesit, Sistemit të Informacionit Statistikor të Integruar, Statistikave të Çmimeve dhe Metodologjinë e Vrojtjeve.

Programi Rajonal CARDS 2003 për Statistikat: ka si objektiv harmonizimin e sistemeve statistikore të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe përafrimi i tyre me konceptet dhe standartet e BE-së në fushën e statistikave të tregtisë së jashtme, e statistikave të punës, paritetit të fuqisë blerëse, statistikave të migracionit, harmonizimit të mbledhjes dhe prodhimit të të dhënave, forcimit të besimit në statistikën kombëtare

Gjithashtu, INSTAT -i do të asistohet nga **Programi CARDS 2005 dhe 2006** për zhvillimin e statistikave rajonale.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Europian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Europian, si dhe angazhimet që derivojnë nga MSA-ja, prioritetet afatshkurtra (2006-2007) për fushën e statistikave janë:

Zgjerimi i regjistrit të biznesit për të përfshirë të gjitha njësitë e parashikuara në Rregulloren e 31998R1165;

Zhvillimi i statistikave për llogaritë kombëtare, makroekonomike, sociale dhe ato të bujqësisë.

Përafrimi i legjislacionit shqiptar në fushën e statistikave me Acquis Communautaire në bazë të nenit 70 të MSA.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritate afatshkurtra për periudhën 2006-2007, si dhe në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *Acquis Communautaire*, në fushën e statistikave, do të ndërmerren këto iniciativa ligjore:

Miratimi i ligjit “Për Miratimin e Programit të statistikave zyrtare 2007-2011”, brenda vitit 2006. Ky ligj do të ketë një shkallë përputhshmërie me *acquis* “të pjesshme”, e fokusuar në transpozimin e *acquis* për statistikën që lidhen me tregun e brendshëm. Ky ligj do të përmbajë programin pesëvjeçar të statistikave zyrtare, mbi bazën e të cilit mblidhen të dhëna statistikore që pasqyrojnë gjendjen ekonomike, sociale, demografike dhe mjedisore për një periudhë pesëvjeçare. Përfitues direkt të tij janë institucionet shtetërore, organizatat jo-fitimprurëse organizatat ndërkombëtare dhe individët. Qëllimi ka qënë përfshirja e *Acquis Communautaire* ekzistuese në programin e statistikave zyrtare dhe nëpërmjet zbatimit të programit, zbatimi i normave evropiane në fushën e statistikave.

Aktivitet zbatues afatshkurtra

Për realizimin e prioritetëve afatshkurtra, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Kryerja e anketës vjetore mbi buxhetin e familjeve, për matjen e nivelit të jetesës dhe rinovimin e peshave të artikujve të shportës , për indeksin e çmimeve të konsumit;

Kryerja e anketës pranë ndërmarrjeve të reja;

Përmirësimi i regjistrit statistikor;

Kryerja e një vrojtimi të ri tremujor pranë ndërmarrjeve ekonomike për llogaritjen e indekseve të tjera të papërfshirë në vrojtimin ekzistues;

Përmirësimi i metodologjisë për vrojtimin tremujor;

Përgatitja e metodologjisë LFS dhe kampionit;

Përgatitja e pyetësorit mbi LFS – në, trajnimi dhe testimi;

Për realizimin e këtyre aktiviteteve INSTAT -i do të asistohet metodologjikisht nga Zyra e Statistikës së Suedisë, Instituti i Statistikës së Italisë dhe programi CARDS 2005.

3.2. Prioritetet Afatmesme

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Europian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit

Evropian, dhe detyrimet që derivojnë nga MSA-ja, prioritetet afatmesme (2008-2009) për fushën e statistikave janë:

Zhvillimi i statistikave të biznesit dhe sociale, duke përfshirë statistikën e tregut të punës dhe të bëhet progres drejt implementimit të të gjitha klasifikimeve Evropiane, duke përfshirë klasifikimin e rajoneve statistikore.

INSTAT -i duhet që brenda 5 vitesh nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, të jetë në gjendje që të dërgojë në Komisionin Evropian, PBB -në e saj për frymë të harmonizuar me nivelin e NUTS II, në bazë të nenit 38 të Marrëveshjes së Ndërmjetme.

Të sigurojë ngritjen e një sistemi statistikor efikas e të qëndrueshëm të aftë për të ofruar të dhëna objektive dhe të sakta të nevojshme për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe të reformave në Shqipëri si dhe progresin në zbatim të MSA -së.

Bashkëpunimi Statistikor duhet të bëjë të mundur që INSTAT -i të plotësojë më mirë nevojat e klientëve të tij në vend (si të administratës publike dhe të sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të respektojë parimet themelore të statistikave të nxjerra nga UN19, kushtet e ligjit Statistikor Evropian dhe zhvillimin drejt Acquis Communautaire .

Aktivitet zbatues afatmesme

Aktivitetet statistikore që do të realizohen në zbatim të prioritetëve afatmesme janë:

Regjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike bujqësore,

Anketa e forcave të punës, për përmirësimin e treguesve të punës

Anketa tremujore pranë pikave kufitare dhe ndërmarrjeve hoteliere, për treguesit e turizmit.

Gjatë periudhës afatmesme, do të bëhet zbatimi i përafrimit të legjislacionit në fushën e statistikave, do të fokusohet më kryesisht në fushën e statistikave sociale e rajonale si dhe vazhdimësinë e aktivitetëve për statistikën ekonomike. Ndër aktivitetet më kryesore zbatuese që planifikohen të ndërmerren janë:

Zbatimi i NACE Rev.2 në zbatim të Rregullores 31990R3037;

Puna në terren, përpunimi i të dhënave LFS;

Publikimi i LFS –ës;

Anketa e buxhetit të familjes HBS-së;

Përmirësimi i metodologjisë së grumbullimit të statistikave- në zbatim të Rregullores së Këshillit, nr. 31995L0064;

Përmirësimi i statistikave ujore të mallrave dhe pasagjerëve, në zbatim të Rregullores së Këshillit, nr. 31998D0385;

Publikimi i të dhënave statistikore mbi transportin ujor, në zbatim të Rregullores së Këshillit nr.32001D0423;

Zbatimi i 32001D0423 CPA të revizionuar, në zbatim të Rregullores së Këshillit, Nr. 31993R3696;

Përmirësimi i statistikave tremujore të turizmit (ATN), në zbatim të Rregullores së Këshillit, Nr. 31995L0057;

Hartimi i metodologjisë për vrojtje në pikat kufitare, në zbatim të Rregullores së Këshillit, Nr. 31999D0035;

Për zbatimin e *acquis* në këto fusha, INSTAT –i do të mbështetet me asistencë teknike të huaj e ofruar nga programi CARDS 2005.

Aktivitet zbatues afatmesme që do të ndërmerren në kuadër të përgatitjeve për raportim të PPB -së në nivelin NUTS II, janë:

Anketa pranë Ndërmarrjeve të Reja (ANR) dhe Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve, çdo vit;

Përmirësimi dhe plotësimi i regjistrit Statistikor (ASN),

Përmirësimi i treguesve të nënsektorëve S.123 dhe S.124 (ndërmjetës të tjerë financiarë, etj) Regjistrimi i Përgjithshëm i Bujqësisë Të ndërmerren analiza Input/Output me çmime korrente duke ndërtuar tabela vlerësuese supply and use dhe të implementohet më pas një metodologji për kalimin në çmime konstante;

Mbi bazën e metodologjisë të përgatitur për mënyrën e vlerësimit të gjenerimit të llogarisë së të ardhurave do të fillojë në mënyrë eksperimentale, llogaritja e PBB -së me metodën e të ardhurave,

¹⁹ United Nations

duke u nisur nga vlerësimet e pagave dhe elementeve të tjerë

Përmirësimi dhe plotësimi i regjistrit Statistikor

Kryerja e një vrojtimi statistikor mbi njësitë ekonomike bujqësore

Prioritetet afatgjata

Bazuar në angazhimet që derivojnë nga MSA-ja, prioritetet afatgjata (2009-2012) për fushën e statistikave janë:

INSTAT duhet që brenda 5 vitesh nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, të jetë në gjendje që të dërgojë në Komisionin e Komunitetit Europian, PBB -në e saj për frymë të harmonizuar me nivelin e NUTS II, në bazë të nenit 38 të Marrëveshjes së Ndërmjetme.

Përafrimi legjislationit me acquis communautarire në fushën e statistikave, në bazë të nenit 70 të MSA.

Të sigurojë ngritjen e një sistemi statistikor efikas e të qëndrueshëm i aftë për të ofruar të dhëna objektive dhe të sakta të nevojshme për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe të reformave në Shqipëri si dhe progresin në zbatim të MSA-së.

Bashkëpunimi Statistikor duhet të bëjë të mundur që INSTAT -i të plotësojë më mirë nevojat e klientëve të tij në vend (si të administratës publike dhe të sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të respektojë parimet themelore të statistikave të nxjerra nga UN20, kushtet e ligjit Statistikor Evropian dhe zhvillimin drejt Community acquis

Iniciativat ligjore afatgjata

Në përputhje me këto prioritetet afatgjata për periudhën 2009-2012, si dhe në kuadër të përafrimit të legjislationit shqiptar me *Acquis Communautaire*, në fushën e statistikave, do të ndërmerren këto iniciativa ligjore:

Miratimi i projektligjit “Për miratimin e programit të statistikave zyrtare 2012-2017 ” brenda vitit 2012. Ky projektligjligj do të synojë përafrimin e legjislationit në fushën e statistikave me *Acquis Communautaire* në fushat statistikore të pambuluara në periudhën 2006-2009, si statistikave të investimeve, të mjedisit, të tregtisë së jashtme si dhe përmirësimin në vazhdimësi të të gjitha statistikave ekonomike, sociale e të mjedisit.

Aktivitetet zbatuese afatgjata

Disa nga aktivitetet zbatuese më të rëndësishme që parashikohen për t’u kryer gjatë periudhës afatgjatë janë:

Zbatimi i Programit Statistikor Zyrtar për Statistikat Mjedisore dhe statistikave të prodhimit dhe menazhimit të Mbetjeve;

Vrojtimi i ri tremujor mbi prodhimin industrial (C,D dhe E) në zbatim të Rregullores së Këshillit, nr. 31991R3924

Hartimi dhe zbatimi i metodologjisë për vrojtimin mbi produktet industriale

Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë,

Anketa strukturore vjetore pranë njësive ekonomike bujqësore,

Për raportimin e PPB -së në nivelin NUTS II, në periudhën afatgjatë do të ndërmerren këto aktivitete zbatuese:

Kryerja e anketave pranë Ndërmarrjeve të Reja(ANR) dhe anketave strukturore pranë Ndërmarrjeve (ASN) çdo vit;

Përmirësimi dhe plotësimi i regjistrit Statistikor

Publikimi i PBB -së tremujore, sipas metodës së prodhimit

Kryerja e një vrojtimi për prodhimin e drithërave.

Kryerja e një vrojtimi për strukturën e tufave dhe numrin e krerëve , kryerja e një vrojtimi mbi;

Harmonizim i metodologjisë bujqësore

Ngritja e një Komiteti për vlerësimin e informacionit statistikor të prodhimeve bujqësore, përjashtuar drithërat

Kryerja e një vrojtimi statistikor mbi njësitë ekonomike bujqësore

3.14 PUNESIMI DHE KOHEZIONI SOCIAL

3.14.1 Dialogu social

1. Objektivi Politik

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e dialogut social është inkurajimi i dialogut social për të kontribuar në përmirësimin e qeverisjes dhe në performancën ekonomike. Harmonizimi në mënyrë progresive i legjislacionit shqiptar me atë të Komunitetit Evropian në fushën e dialogut social është një objektiv tjetër i rëndësishëm i qeverisë.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria e fushës së dialogut social, rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore :

Nenet 49-50 të Kushtetutës së RSH;

Kodi i Punës, nenet 124,138-139, 148, 159-196 dhe 200-202 ;

Konventa nr. 87 “Liria e Shoqatave dhe Mbrojtja e të Drejtës së Organizimit”;

Konventa nr.98 “E drejta e Organizimit dhe Bisedimeve Kolektive”;

Konventa nr. 154 “Bisedimi Kolektiv”;

VKM nr.730, datë 6.11.2003 "Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë Këshill”;

VKM nr.741, datë 6.11.2003 "Për procedurën e pajtimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Zyrave Shtetërore të Pajtimit”;

VKM nr.740, datë 6.11.2003 " Për mënyrën e organizimit dhe procedurën e votimit, për përcaktimin e përfaqësueshmërisë së organizatave të punëmarrësve”;

VKM nr.61, date 23.1.2003 "Për caktimin e numrit të përfaqësuesve të organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës”;

Urdhëri i Ministrit të PÇSSHB nr. 2218, date 2.12.2003 "Për ngritjen dhe vënien në lëvizje të Zyrës së Pajtimit”;

Rregullorja e Funksionimit të Këshillit Kombëtar të Punës.

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e barazisë gjinore, është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

1)Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta-Drejtoria e Marrëdhënieve të Punës;

2)Këshilli Kombëtar i Punës

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, prioritetet afatshkurtra për fushën e dialogut social janë:

Inkurajimi i dialogut social në funksion të përmirësimit të qeverisjes dhe në performancën ekonomike;

Harmonizimi në mënyrë progresive i legjislacionit shqiptar me atë të Komunitetit Evropian në fushën e dialogut social.

3.1.2. Aktivitet zbatues afatshkurtra

Për realizimin e angazhimeve afatshkurtra, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Realizimi i një studimi për njohjen e legjislacionit evropian në fushën e dialogut social. Në funksion të rekomandimeve të këtij studimi, do të procedohet me harmonizimin e kuadrit ligjor shqiptar me *acquis* në fushën e dialogut social.

3.14.2 PUNESIMI

1. Objektivi Politik

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e punesimit, për periudhën afatgjatë është realizimi i pajtueshmërisë me rregullat në fuqi në Shtetet Anëtare në fushën e lëvizjes së punonjësve, duke marrë parasysh situatën në tregun e punës në Shtetet Anëtare, në varësi të legjislacionit; krijimi i lehtësirave ekzistuese për akses në punësim për shtetasit shqiptarë të akorduara nga Shtetet Anëtare me anë të marrëveshjeve dypalëshe; bashkëpunimi për lehtësimin e reformave dhe politikave shqiptare të punësimit, në kontekstin e forcimit të reformave ekonomike dhe të integritit; përshtatja e

legjislacionit shqiptar për sa u përket kushteve të punës dhe mundësive të barabarta për gratë si dhe ngritja e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe trajnimit profesional në Shqipëri.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria e fushës së tregut të punës dhe formimit profesional rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore :

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë -Neni 59;

Ligji 7995, datë 20.09.1995 "Për nxitjen e punësimit;

Ligji 8872, datë 29.03.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH";

Ligji 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në RSH";

VKM nr 67, datë 10.01.2003 "Strategjia e Punësimit dhe Formimit Profesional";

VKM nr.69, datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë" i ndryshuar;

VKM nr. 42, datë 17.01.1998 "Për miratimin e statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit"i ndryshuar";

VKM nr. 70, datë 11.2.1999 "Për evidentimin e punëkërkuesve të papunë";

VKM 73, datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë";

VKM nr. 74 datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional";

VKM nr.632 datë 18.9.2003 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë femra"

VKM nr. 708 datë 16.10.2003 "Për mënyrën e liçensimit dhe të funksionimit të agjencive private të punësimit";

VKM nr.583, datë 10.9.2004 "Për caktimin e nivelit të së ardhurës nga papunësia";

VKM nr. 196, datë 20.03.2003 "Për standartet e zhvillimit të kurrikulave të arsimit dhe formimit profesional"

VKM nr. 675, datë 25.09.2003 "Për përcaktimin e procedurave të krijimit, organizimit dhe mbylljes së institucioneve të formimit profesional, në varësi të MPÇS";

VKM nr. 543, datë 31.10.2002 "Për akreditimin e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional (AFP)";

Udhëzim i Përbashket me Ministrinë e Financave nr. 1 datë 5.2.2001 "Për kriteret dhe procedurat e subvencionit për të nxitur punësimin";

Udhëzim i Ministrit të MPÇS dhe Ministrit të MASH, nr. 6, datë 14.03.2003 "Për regjistrimin e institucioneve të AFP-së";

Udhëzim i Ministrit të MPÇS dhe Ministrit të MASH, nr.16, datë 28.12.2002 MPÇS dhe MASH "Për organizimin dhe veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional".

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e tregut të punës dhe formimit profesional është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta- Drejtoria e Politikave të Punësimit;

Ministria e Arsimit dhe Shkencës- Drejtoria e Zhvillimit të Kurrikulit;

Shërbimi Kombëtar i Punësimit- Drejtoria e Punësimit, Drejtoria e Formimit Profesional.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në angazhimet e Partneritetit Evropian , prioritetet afatshkurtra për fushën e tregut të punës dhe formimit profesional janë:

Realizimi i pajtueshmërisë me rregullat në fuqi në Shtetet Anëtare në fushën e lëvizjes së punonjësve, duke marrë parasysh situatën në tregun e punës në Shtetet Anëtare, në varësi të legjislacionit; Krijimi i lehtësirave ekzistuese për akses në punësim për shtetasit shqiptarë të akorduara nga Shtetet Anëtare me anë të marrëveshjeve dypalëshe; Bashkepunimi për lehtësimin e reformave dhe politikave shqiptare të punësimit, në kontekstin e forcimit të reformave ekonomike dhe

të integritit;

Përshtatja e legjislacionit shqiptar për sa u përket kushteve të punës dhe mundësive të barabarta për gratë;

Ngritja e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe trajnimit profesional në Shqipëri.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritetet afatshkurtra, për realizimin e tyre, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

Hartimi dhe miratimi VKM-së "Për miratimin e Strategjisë së rishikuar të Punësimit";

Hartimi dhe miratimi i VKM – së "Për përcaktimin e procedurave të konkurrencës për mbështetjen financiare të Drejtorive Rajonale të Formimit Profesional Publik" e cila do të ketë një shkallë përputhshmërie "të pjesëshme" me *acquis* ;

Hartimi dhe miratimi i VKM – së "Për përcaktimin e rregullave të shlyerjes së detyrimit nga punëdhënësit që nuk punësojnë persona me aftësi të kufizuara dhe mënyra e përdorimit të fondit të mbledhur";

Hartimi dhe miratimi i VKM – së "Për miratimin e Strategjisë së arsimit dhe formimit profesional";

Hartimi dhe miratimi i VKM – së "Për zbatimin e programit të praktikave profesionale";

Hartimi dhe miratimi i VKM – së "Për pagesën e pjesëmarrjes së punëkërkuarve të papunë në kurset e profesioneve të ofruara nga qendrat publike të formimit profesional".

3.1.2. Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e angazhimeve afatshkurtra, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Krijimi i një sistemi të informatizuar të tregut të punës nëpërmjet krijimit të një data base në lidhje me vendet e lira të punës (Tiranë dhe Korçë);

Realizimi i studimeve periodike afatshkurtra të tregut të punës; paisja me bazën e nevojshme materiale/didaktike për mësimin teorik dhe praktik të qendrave publike të formimit profesional;

Rinovimi i mjediseve ekzistuese për mësimin teorik/praktik në qendrat publike të formimit profesional nëpërmjet rikonstruksionit të mjediseve ekzistuese;

Realizimi i një studimi për ngritjen e Qëndresë së Trainimit të Trainerëve;

Fillimi i decentralizimit të menaxhimit të sistemit të AFP-ve në drejtim të shkollave apo qendrave të AAFP;

Krijimi i Agjencisë Kombëtare të Kualifikimeve Profesionale.

3.2 Prioritetet Afatmesme

Bazuar në angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, prioritetet afatmesme për fushën e tregut të punës dhe formimit profesional janë:

Realizimi i pajtueshmërisë me rregullat në fuqi në Shtetet Anëtare në fushën e lëvizjes së punonjësve, duke marrë parasysh situatën në tregun e punës në Shtetet Anëtare, në varësi të legjislacionit;

Krijimi i lehtësirave ekzistuese për akses në punësim për shtetasit shqiptarë të akorduara nga Shtetet Anëtare me anë të marrëveshjeve dypalëshe;

Bashkëpunimi për lehtësimin e reformave dhe politikave shqiptare të punësimit, në kontekstin e forcimit të reformave ekonomike dhe të integritit;

Përshtatja e legjislacionit shqiptar për sa u përket kushteve të punës dhe mundësive të barabarta për gratë,

Përmirësimi i nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe trajnimit profesional në Shqipëri.

3.2.1. Iniciativat ligjore afatmesme

Në përputhje me këto prioritetet afatmesme, për periudhën 2008-2010, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

Hartimi dhe miratimi i projektligjit "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8872, datë 29.03.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë "

Hartimi dhe miratimi i projektligjit të ri "Për nxitjen e punësimit", në përputhje me Strategjinë Evropiane të Punësimit dhe specifikisht me Vendimin 2005/600/ EC ,në shkallë përputhshmërie të pjesëshme, me *acquis communautaire* .

Hartimi dhe miratimi i VKM-ve të programeve të nxitjes së punësimit, në përputhje me Ligjin e ri të Punësimit.

3.2.2 Aktivitet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e angazhimeve gjatë periudhës kohore 2008-2010, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Kompletimi i procesit të informatizimit të tregut të punës në gjithë sistemin e shërbimit publik të punësimit duke shfrytëzuar investimet e donatorëve të huaj dhe Qeverisë Shqiptare;

Institucionalizimi i metodologjisë së hartimit të kurrikulave të AFP;

Hartimi i kriterëve të vlerësimit dhe certifikimit në fushën e AFP;

Mbështetje e kurrikulit të AFP me "tekste integrale".

Krijimi i shërbimit për orientimin profesional dhe këshillimin për karrierë në bashkëpunim me partnerët socialë;

Institucionalizimi i bashkëpunimit midis AFP dhe biznesit lokal.

(i) 3.14.3 Mbrojtja dhe Sigurimet Shoqërore

3.14.3.1 MBROJTJA SHOQËRORE

1. Objektivi politik

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e mbrojtjes shoqërore, për periudhën afatshkurtër, është përmirësimi i sistemit të mbrojtjes sociale dhe standarteve, duke luftuar përjashtimin social dhe diskriminimin.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria e fushës së mbrojtjes shoqërore rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore :

Ligji nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”;

Ligji nr. 8098 datë 28.03.1996 “ Për statusin e te verbërit”;

Ligji nr. 7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”;

Ligji nr. 8626 datë 22.06.2000 “Për statusin e invalidit para dhe tetraplegjik”;

VKM nr. 265, datë 28.04.2005 “ Strategjia e shërbimeve sociale”;

VKM nr. 633, datë 18.09.2003 “Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom ”;

VKM nr. 8, datë 07.01.2005 “Strategjia e personave me aftësi të kufizuar”(PAK);

VKM nr. 787, datë 14.12.2005 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike";

VKM nr. 563, datë 12.8.2005 "Për caktimin e përgjegjësive të qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore";

VKM nr 564, datë 12.8.2005 "Për liçensimin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore";

VKM nr. 658, datë 17.10.2005 "Për standardet e shërbimeve shoqërore";

VKM nr. 659, datë 17.10.2005 "Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale";

VKM nr.83, datë 26.02.2001 “Për tarifatat telefonike”;

VKM nr.632, datë 21.11.2001”Përfitimet nga Enti Kombëtar të Banesave“;

Udhëzim nr. 497 datë 6.03.2006 "Për llogaritjen e të ardhurave që sigurohen nga prodhimi bujqësor dhe blegtoral".

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e mbrojtjes shoqërore, është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta- Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale ;

Ministria e Brendshme;

Ministria e Shëndetësisë;

Shërbimi Social Shtetëror

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në angazhimet e Partneritetit Evropian, prioriteti afatshkurtër për fushën e mbrojtjes shoqërore është:

Përmirësimi i sistemit të mbrojtjes sociale dhe standarteve duke luftuar përjashtimin social dhe diskriminimin

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këtë prioritet afatshkurtër, për realizimin e tij do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

Hartimi dhe miratimi VKM-së “Për kriteret dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuara”;

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore”;

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Për kriteret e vendosjes së personave në nevojë në institucionet e përkujdesit rezidencial”;

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Hartimi i Standarteve për PAK”;

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Hartimi i standarteve për shërbimet e të moshuarve”;

Hartimi dhe miratimi i VKM-së “Hartimi i standarteve të shërbimit të kujdestarisë për fëmijë”;

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Për ngritjen e Fondit Shoqëror dhe kriteret e përdorimit të tij”.

3.14.3.2 SIGURIMET SHOQËRORE

1. Objektivi politik

Fokusi kryesor i Qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore, për periudhën afatgjatë është koordinimi i sistemit të mbrojtjes shoqërore për punonjësit komunitarë të punësuar në territorin shqiptar si dhe adaptimi i sistemit të sigurimeve shoqërore me kërkesat e reja ekonomike e sociale, nëpërmjet bashkëpunimit me palët.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria e fushës së sigurimeve shoqërore rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore:

Ligji nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në RSH;

Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore";

Ligji nr.7845, datë 13.7.1994 “Për numrin e sigurimit shoqëror”;

Ligji nr.9066, datë 15.5.2003 “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë “Për mbrojtjen shoqërore”;

Ligji nr.8960, datë 24.10.2002 “Për ratifikimin e Kartës Sociale Evropiane, të rishikuar”;

Ligji nr. 9442, datë 16.11.2005 "Për ratifikimin e Konventës së ILO-s, nr.102, “Për standartet minimale të mbrojtjes shoqërore”

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e sigurimeve shoqërore, është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

1) Ministria e Financave-Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

2) Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta-Drejtoria e Politikave të Pensioneve dhe Pagave;

3) Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

4) Drejtoria e Përgjithshme e Postave

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në angazhimet që derivojnë nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit, prioritetet afatshkurtra për fushën e sigurimeve shoqërore janë:

Koordinimi i sistemit të mbrojtjes shoqërore për punonjësit komunitarë të punësuar në territorin shqiptar .

Adaptimi i sistemit të sigurimeve shoqërore me kërkesat e reja ekonomike e sociale, nëpërmjet bashkëpunimit me palët.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritete afatshkurtra, për realizimin e tyre, nga Ministria e Financave,

do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore ne RSH"

Miratimi i projektligjit "Për ratifikimin e Kodit Evropian të Sigurimeve Shoqërore"

Hartimi dhe miratimi i VKM – së, në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore"

Hartimi dhe miratimi i VKM – së " Për rritjen e përfitimeve të pensioneve"

3.1.2. Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e këtyre prioritetëve do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Diskutimi, shkëmbimi i informacionit në kuadrin e marrëveshjeve dypaleshe me Hungarinë, Rumaninë, Bullgarinë;

Organizimi i takimeve (konferenca, ëorkshop-e, seminare etj) për diskutimin me partnerët; studimi për llogaritjen e efekteve financiare që burojnë nga ndryshimet e ligjit;

Ndjekja e zbatimit të VKM-se "Për rritjen e përfitimeve"

Zbatimi i VKM-se ne zbatim te ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore"

Kryerja e procedurave për ratifikimin e Kodit Evropian të Sigurimeve Shoqërore;

Zbatimi i Marrëveshjes me Turqinë;

Vënia në përdorim të një sistemi të automatizuar të informacionit për sigurimet shoqërore.

3.2 Prioritetet afatmesme

Bazuar në angazhimet që derivojnë nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, prioritetet afatmesme për fushën e sigurimeve shoqërore janë:

Koordinimi i sistemit të mbrojtjes shoqërore për punonjësit komunitare të punësuar në territorin shqiptar;

Adaptimi i sistemit të sigurimeve shoqërore me kërkesat e reja ekonomike e sociale, nëpërmjet bashkëpunimit me palët.

3.2.1. Iniciativat ligjore afatmesme

Në përputhje me këto prioritetet afatmesme, Ministria e Financave do të ndërmarrë iniciativat e mëposhtme ligjore:

Hartimi dhe miratimi i VKM – së "Për disa çështje në zbatim të Ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore"

Hartimi dhe miratimi i VKM – së " Për rritjen e përfitimeve të pensioneve"

Hartimi dhe miratimi i VKM – së " Për rritjen e përfitimeve "

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për realizimin e këtyre angazhimeve do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Fillimi dhe vazhdimi i procedurave të diskutimit, shkëmbimit të informacionit në kuadrin e Marrëveshjeve të përbashkëta me Italinë, Greqinë si dhe ndërtimi i nje database për të dhënat;

Ndjekja e zbatimit të VKM-se "Për rritjen e përfitimeve"

Zbatimi i VKM-se ne zbatim te ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore"

Vazhdimi i procedurave për marrëveshjet dypalëshe për sigurimet shoqërore;

Kryerja e një studimi për legjislacionin shqiptar të sigurimeve shoqërore në raport me Rregulloren 1408/71/EEC për sigurimet shoqërore.

3.14.4 Shëndeti dhe Siguria në Punë

1.Objektivi Politik i fushës

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e sigurisë dhe shëndeti në punë për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme është nxitja e zbatueshmërisë së legjislacionit të punës, lidhur me sigurimin dhe mbrojtjen e integruar fizike, mendore dhe sociale të punonjesve, nepermjet përmirësimit dhe harmonizimit të legjislacionit shqiptar me atë të komunitetit evropian.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventat e ILO në fushën e sigurisë dhe higjenës, si më poshtë:

Konventa Nr. 155 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë";

Konventa Nr.170 "Për përdorimin e kimikateve në punë";

Konventa Nr. 174 Parandalimi i aksidenteve të rënda në industri";

Konventa Nr. 176 "Sigurimi dhe shëndeti në miniera"

Veprimtaria e fushës së sigurisë dhe shëndetit në punë, rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore :

Kushtetuta-neni 49;

Kodi i Punes- nenet 39-75;

Ligji nr.7986, datë 13.9.1995 “Për Inspektoriatin Shtetëror të Punës” i ndryshuar me ligjin nr.8394, datë 2.9.1998, i cili është pjesërisht i përputhur me acquis;

VKM nr 459, datë 22.7.1998 "Për substancat e rrezikshme";

VKM nr 460, datë 22.7.1998 "Për aksidentin në punë";

VKM nr.461, datë 22.7.1998 "Për regjistrin që mban punëdhënësi për aksidentin në punë dhe sëmundjet profesionale;

VKM nr 419, datë 4.8.2000 “Për objektet e rrezikshme”;

VKM nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masa të veçanta të sigurisë dhe higjenes në punë”;

VKM nr. 205, datë 9.5.2002 “Për përcaktimin e punëve të lehta për të miturit”;

VKM nr.207, datë 9.5.2002 “Për përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme”;

VKM nr. 445, datë 26.6.2003 “Për inspektimin detar”;

VKM nr 742, datë 6.11.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.692, datë 13.12.2001 “Për masa të veçanta të sigurisë dhe higjenes në punë para vënies në punë të ndërmarrjes”.

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

1)Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;

2)Drejtoria e Shërbimeve Juridike, Drejtoria e Marrëdhënieve të Punes, Sektori i Sigurisë në Punë;

3)Inspektoriati Shtetëror i Punës.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, prioritetet afatshkurtra (2006-2007) për fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, janë:

Vlerësim i legjislacionit mbi kushtet e punës, pagesën për punonjësit e komunitetit;

Përmirësimi dhe harmonizimi në mënyrë progresive i legjislacionit shqiptar në përputhje me atë të Komunitetit Evropian, për kushtet e punës si dhe mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritetet afatshkurtra, për realizimin e tyre, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

Hartimi dhe miratimi i projektligjit “Për inspektimin në punë dhe Inspektoriatin Shtetëror të Punës” i cili do të synojë përputhshmërinë pjesërisht me acquis communautaire në fushën e inspektimit në punë ;

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Organizimi dhe drejtimi i ISHP-së”;

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Për përcaktimin e substancave të rrezikshme”;

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Për përcaktimin e objekteve të rrezikshme”;

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Për procedurën e lënies së aktit të inspektimit”;

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Për bashkëpunimin me institucionet homologe”.

3.1.2. Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e angazhimeve gjatë periudhës afatshkurtër, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Do të fuqizohen kapacitetet insitucionale të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe parashikohet që në vazhdim numri i kapaciteteve ekzistuese të burimeve njerëzore të rritet, si në tabelën e mëposhtme.

Do të krijohen drejtori rajonale në 5 prefektura, si në tabelën e mëposhtme.

Do të zhvillohen trajnime për njohjen e legjislacionit evropian në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë brenda vitit 2006.

3.2 Prioritetet Afatmesme

Bazuar në angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, prioritetet afatmesme për fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, janë:

Vlerësim i legjislacionit mbi kushtet e punës, pagesën për punonjësit e komunitetit,

Përmiresimi dhe harmonizimi në mënyrë progresive i legjislacionit shqiptar në përputhje me atë të Komunitetit Evropian, për kushtet e punës si dhe mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë.

3.2.1. Iniciativat ligjore afatmesme

Në përputhje me këto prioritetet afatmesme, për periudhën 2008-2010, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

Hartimi dhe miratimi i ligjit “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

Hartimi i strategjise Kombetare “Siguria dhe shëndeti në punë”.

Tabela: Shtese e kapaciteteve institucionale te Inspektoriatit Shtetëror të Punës

INV ESTIME	N JESIA E MATJES	GJ ENDJA AKTUALE	006	007
Shtes e personeli	N epunes	15		35
Invest ime IT	0 00/leke			
Invest ime infrastruktura	0 00/leke			
Kons ulence (e huaj)	0 00/leke			
Trajni me	0 00/leke			

3.14.5 BARAZIA GJINORE

1. Objektivi Politik

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e barazisë gjinore është harmonizimi në mënyrë progresive i legjislacionit shqiptar me *acquis* në fushën e kushteve të punës, veçanërisht të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe ofrimit e garantimit të mundësive të barabarta.

Qeveria është e angazhuar që në reformat e punësimit dhe ekonomike, një prioritet i veçantë t’i jepet garantimit të kushteve të mira të punës dhe mundësive të barabarta për gratë.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria e fushës së barazisë gjinore rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore :

Kushtetuta- neni 18 dhe neni 49;

Karta e të Drejtave Themelore të Komunitetit Evropian;

Konventa "Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas" dhe Protokollit shtesë i saj (CEDAW);

Kodi Zgjedhor- Neni 3;

Kodi i Punës-Nenet 9,10,32,39,75,76,97,98,108,109,134,72,115,55,104,108;

Ligji nr. 9198, datë 1.07.2004 “Për një shoqëri gjinore të barabartë”;

Kodi Penal : Nenet 113, 114, 115;

Ligji nr 7995, datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit”;

Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimin shoqëror në RSH”;

Ligji nr.8876, datë 4.4.2002 “Për shëndetin riprodhues”;

Ligji nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” ;

Ligji nr.8528, datë 23.09.1999 “ Për mbrojtjen dhe nxitjen e të ushqyerit me gjë”;

VKM nr.145, datë 10.08.1998 “Mbi ndalimin e punës së natës për gratë shtatëzëna”

VKM nr. 632, datë 18.9.2003 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra”;

VKM nr 73, datë 11.02.1999 “Për Programin e Nxitjes së Punësimit nëpërmjet formimit në punë”;

VKM nr. 397, datë 20.5.1996, ndryshuar me VKM nr. 185, datë 3.5.2002, "Për mbrojtjen e veçantë të grave shtatëzëna dhe të amësisë"

Urdhëri nr. 394 datë 23.02.2004 i Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale "Për tarifat e Sistemit të Formimit Profesional"

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e barazisë gjinore, është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

1)Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Drejtoria e Shanseve të Barabarta;

2)Ministria e Arsimit dhe Shkencës , Drejtoria e Kurrikulave;

3)Ministria e Shëndetësisë, Sektori i Shëndetit Riprodhues;

4)Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Drejtoria e Politikave Rinore;

5)Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Politikave Rinore;

6)Ministria e Brendshme , Drejtoria e Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Sektori Antitrafikimit.

7)Ministria e Bujqësisë, Drejtoria e Politikave Rurale, Sektori i Politikave të Zhvillimit.

8)INSTAT (Qendra e Kërkimeve Sociale)

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme

Bazuar në angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme për fushën e barazisë gjinore janë:

Harmonizimi në mënyrë progresive i legjislacionit shqiptar me acquis në fushën e kushteve të punës, veçanërisht të shëndetit e sigurisë në punë dhe mundësive të barabarta;

Përshtatja e sistemit shqiptar të sigurimeve shoqërore me kërkesat e reja ekonomike dhe sociale.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritetet, për realizimin e tyre, në periudhën afatshkurtër do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e ligjit Nr. 9198, datë 1.07.2004 “Për një shoqëri gjinore të barabartë”

Hartimi dhe miratimi me VKM i “Strategjisë Kombëtare për Barazinë gjinore”

Hartimi dhe miratimi me VKM i “Strategjisë Kombëtare mbi luftën kundër dhunës në familje”

3.1.2. Aktivitet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e angazhimeve, në periudhën afatshkurtër, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Organizimi i fushatave sensibilizuese për njohjen e ligjit nr. 9198, datë 1.07.2004 "Për një shoqëri gjinore të barabartë”;

Organizimi i një konference kombëtare dhe i fushatave sensibilizuese në media për lancimin e Strategjisë për barazinë gjinore;

Realizimi i një studimi për njohjen e legjislacionit evropian në fushën e barazisë gjinore;

Organizimi i një konference kombëtare për lancimin e Strategjisë Kombëtare mbi luftën kundër dhunës në familje;

Pasurimi i Qendrës së Dokumentacionit dhe Informacionit, me literaturë bashkëkohore për barazinë gjinore;

Trajnime të ndryshme për stafin e ministrise për tematika në fushën e barazisë gjinore.

3.1.3 Aktivitet zbatuese afatmesme

Për realizimin e angazhimeve, gjatë periudhës kohore 2008-2010, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë për barazinë gjinore ;

Trajnimi i personave për vlerësimin e impaktit të Strategjise brenda vitit 2008.

3.15 ENERGJIA

3.15.1 SEKTORI I ENERGJISE

1. Objektivi politik i fushës

Hapja reale e tregut të energjisë mbetet prioriteti i Qeverisë Shqiptare në këtë fushë, prioritet ky që bëhet edhe më i detyrueshëm pas nënshkrimit të Traktatit të Komunitetit për Energjinë. Synimi kryesor do të jetë integrimi në tregun rajonal të energjisë elektrike. Hapja e këtij tregu do të nxisë tërheqjen e kapitaleve private dhe rritjen e ndjeshme të kapaciteteve prodhuese dhe furnizuese të sistemit elektroenergjetik shqiptar.

Në funksion të realizimit të këtij objekti, në periudhë afatshkurtër do të zbatohet procesi për ristrukturimin e privatizimin e KESH. Fillimisht, do të kryhet ndarja në shoqëri të vecanta e veprimtarive të KESH si prodhimi, transmetimi, shpërndarja e energjise elektrike. Gjithashtu, do të rriten kapacitetet rregullatore të Enti Rregullator i Energjisë, me qëllim që të jetë në gjendje që të luajë rolin e arbitrit të paanshëm në tregun e liberalizuar të energjisë.

Objektiv afatmesëm do të jetë harmonizimi i gjithë kuadrit ligjor me *acquis communitaire*, në mënyrë që tregu shqiptar i energjisë t'i përafrohet standarteve dhe normave europiane. Objektiv tjetër afatmesëm është mbështetja e integritetit të Shqipërisë në rrjetet e transmetimit rajonal dhe europian të energjisë së gjitha llojeve.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria e funksionimit dhe kontrollit të energjisë në Republikën e Shqipërisë rregullohet nëpërmjet këtyre akteve kryesore ligjore e nënligjore:

Ligjin nr. 9501, datë 03.04.2006 "Për ratifikimin e traktatit të Krijimit të Komunitetit të Energjisë";

Ligji Nr. 9379, datë 28.4.2005 "Për Efiçensën e Energjisë", i cili nxit përdorimin me efiçensë të të gjitha llojeve të energjisë;

Ligji Nr. 9072, datë 22.05.2003 "Mbi sektorin e energjise elektrike", i cili përcakton kushtet për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve, në përputhje me parametrat standarte, përmes funksionimit të efektshëm të tregut të energjisë dhe zhvillimit të konkurrencës në këtë sektor, duke marrë parasysh ruajtjen e interesave të konsumatorit, minimizimin e kostove të shërbimeve dhe respektimin e mjedisit. Ky ligj ka një nivel përputhshmërie "të plotë" me Direktivën 2003/53/EC;

Ligji Nr. 8937 datë 12.09.2002 "Për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa", i cili përcakton vendosjen e rregullave dhe bërjen e detyrueshme të marrjes së masave për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa

VKM Nr. 539, datë 12.08.2004 "Për aprovimin e modelit tranzitor të tregut të energjisë elektrike", i cili është i bazuar në zbatimin gradual të Direktivave 96/92/EC dhe 2003/54/EC;

Në zbatim të legjislacionit bazë, ERE ka miratuar Kodin e Shpërndarjes, të Matjes, të Transmetimit dhe Rregullat e Tregut.

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacionit në fuqi në fushën energjise është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

Drejtoria e Politikave Energjitike, që vepron nën Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave në Ministrinë Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Kjo Drejtori ka si detyrë të hartojë politikat qeveritare në sektorin e energjisë; të hartojë kuadrin e nevojshëm ligjor në përputhje me Direktivat e BE-së për të realizuar politikat në sektorin e energjisë; të zbatojë politikat e qeverisë në sektorin e energjisë; të përgatisë sektorin e energjisë për privatizim; të monitorojë procesin e privatizimit dhe të ndërhyjë për një mbarëvajtje sa më të mirë të sektorit;

Enti Rregullator për Energjinë (ERE), i cili kryen funksionet rregullatore të shtetit në sektorin e energjise elektrike. ERE funksionon si një institucion i pavarur (në varesi të Parlamentit), me qëllim sigurimin e mos-diskriminimit, konkurrencës efikase dhe funksionimit të efektshëm të tregut në sektorin e energjise elektrike. Neni 23 i ligjit nr. 9072 parashikon funksionet dhe kompetencat e ERE në përputhje me Direktivën 2003/54/EC;

Agjensia Kombetare e Energjise (AKE), i cili është nën varësi të drejtpërdrejtë nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, funksioni i së cilës është përgatitja e Strategjisë Kombëtare për Energjinë dhe monitorimi i zbatimit të kësaj strategjie;

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) është operatori i vetëm që kryen aktivitetin e tij në sektorin e energjisë elektrike, përveç Hidrocentraleve të vegjël, të privatizuara në dy vitet e fundit ²¹. Struktura e KESH-it përbëhet nga 3 divizione: (i) Divizioni i Prodhimit, me 5 dege; (ii) Divizioni i Transmetimit, me gjashtë dege në qarqet kryesore të vendit; dhe (iii) Divizioni i Shpërndarjes mbulon 4 zona shpërndarjeje (zona e BISABU-së në jug mund të trajtohet si e veçantë dhe menaxhohet me asistencën e një kompanie gjermane). Ndarja e re e KESH-it në tre divizione është hapi i parë drejt ndarjes përfundimtare në tre kompani tregëtare me funksione të pavarura. Kjo ndarje e kompanive të integruara vertikalisht, kërkohej nga Direktiva 96/92/EC, si edhe nga Memorandumet e Athinës të viteve 2002/2003.

Qendra e Eficiencës së Energjise Shqiptare – BE (QEE), është një OJF, shpenzimet mbajtese të së cilës mbështeten nga buxheti i shtetit. Kjo qendër është përfshirë në një seri projektesh pilote dhe fushata informacioni në fushën e efektshmërisë së energjisë, të cilat financohen nga donatore të ndryshëm ndërkombëtarë.

2.3. Asistenca e Huaj

Në mbështetje të zhvillimit të sektorit energjistik në Shqipëri, kryesisht për përmirësimin e infrastrukturës energjitike dhe ndarjes së KESH në kompani të vecanta (Transmetimi, Shpërndarje dhe Prodhimi), qeveria shqiptare është mbështetur me projekte në fushën e energjisë nga disa institucione të huaja të tilla si: Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Europiane e Investimeve (BEI), Banka Botërore, Qeveria Gjermane dhe ajo Spanjolle, Granti Japonëz etj. Pjesa më e madhe e këtyre projekteve pritet të përfundojë brenda vitit 2007.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Europian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Europian, si dhe angazhimet që derivojnë nga zbatimi i MSA-ja, prioritetet afatshkurtra për fushën e energjisë janë:

Rishikimi i Strategjisë Kombëtare të Energjisë, zbatimi i Planit të Veprimit të rishikuar për Zbatimin e Saj

Të fillojë vënia në zbatim e angazhimeve të ndërmarra në kuadër të Traktatit për Krijimin e Komunitetit të Energjisë

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritate afatshkurtra, për periudhën 2006-2007, si dhe në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*, në fushën energjisë, do të ndërmerren këto iniciativa ligjore nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës:

Ndryshimi i ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike". Ndryshimi i këtij ligji do të bëhet me qëllim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga nënshkrimi i Traktatit të Komunitetit për Energjinë, me synim krijimin e një tregu të hapur rajonal;

Hartimi i kuadrit ligjor për prokurimin e energjisë elektrike. Kuadri i ri ligjor do të jetë në përputhje të plotë me Direktivën 2003/54;

Hartimi dhe miratimi i VKM "Për Auditimet Energjetike". Vendimi do të jetë plotësisht i përputhur me Direktivën 94/42/EC;

Hartimi dhe miratimi i VKM "Për ngritjen e Agjencive Rajonale të Energjisë nën autoritetin e AKE-së dhe Rregullore për formatet e plotësimit të të dhënave energjetike". Agjensitë Rajonale të Energjisë do të jenë orgaanizmat kryesore për zbatimin e politikave energjitike në nivele rajonale. Këto Agjensi do të kontrollohen nga AKE.

Hartimi dhe miratimi i Projekt-aktit "Për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë". Strategjia Kombëtare e Energjisë është dokumenti bazë që rregullon veprimtarinë në fushën e Energjisë. Në funksion të përmirësimit të kuadrit ligjor shqiptar në këtë fushë dhe të nevojave të reja për hapjen e tregut dhe përmirësimin e infrastrukturës energjitike, kjo strategji do të rishikohet dhe do

21 Në Shqipëri, vetëm disa prodhues të vegjël të energjisë elektrike (rreth 35 HEC-e të vegjël të privatizuara, ose të dhëna me koncesion) kanë statusin e centralit të pavarur të energjisë elektrike.

te perpunohet edhe Plani ne zbatim te kesaj Strategjie.

Gjate kesaj periudhe do te harton dhe miratohen edhe VKM e mëposhtme, te cilet do te jene ne perputhje te plote me Direktiven 92/75/EC.

VKM " Për procedurat e certifikimit te paisjeve elektroshtepiake"

VKM "Për procedurat e certifikimit te paisjeve elektroshtepiake per rrobalareset"

VKM " Për procedurat e certifikimit te llampave te ndricimit"

VKM " Për procedurat e certifikimit te kondicionereve"

VKM " Për procedurat dhe kontrollin e fondit të efijensës së energjisë" ,

Enti Rregullator i Energjise do te rishikoje dhe miratojë:

Modelin Tranzitor te Tregut

Regullat e Tregut

Kodin e Transmetimit, Shperndarjes dhe Kodin e Matjes

3.1.2. Aktivitet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e prioriteteve afatshkurtra, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Vazhdimi i reformes tarifore

Forcimi i kapaciteteve administrative

Pjesmarria ne Grupet e Punes per Rishikimin e Strategjise

Shtim i personelit per rishikimin e Strategjise Kombetare te Energjise

Shtim i personave ne fushen e legjislacionit te energjise - Auditimet

Shtim i personave ne fushen e legjislacionit per Krijimin e Zyrave Rajonale te Energjise

Ngritja e zyrave rajonale te energjise

Shtim i personave ne fushen e per procedurat e certifikimit te paisjeve elektroshtepiake"

Trajnimi i eksperteve ne fushen e procedurave te certifikimit te paisjeve te rrobalareset

Shtim i personave ne fushen e legjislacionit te energjise per VKM e llampave te ndricimit

Shtim i personave ne fushen e procedurave të certifikimit të paisjeve elektroshtepiake - kondicionereve

3.2. Prioritetet Afatmesme

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Europian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Europian, dhe detyrimet që derivojnë nga zbatimi MSA, prioritetet afatmesme (2008-2009) për fushën e energjise janë:

Zbatimi në kohë projektet e ndryshme që synojnë përmirësimin e infrastrukturës për prodhimin e energjisë, transmetimin dhe shpërndarjen.

Vazhdimi i zbatimit te angazhimeve rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e energjisë, me objektiv ngritjen e një tregu konkurrues rajonal të energjisë.

3.2.1. Iniciativat ligjore afatmesme

Gjate periudhes afatmesme me qellim realizimin e perpaesive te Partneritetit Europian do te ndermerren keto iniciativa ligjore nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës:

Hartimi dhe miratimi i projekt-ligjit "Për Taksat e Energjisë";

Hartimi dhe miratimi i projekt-ligjit "Ligji integral".

3.2.2. Aktivitet zbatuese afatmesme

Ne zbatim te prioriteteve te Partneritetit Europian, gjate kesaj periudhe do te vazhdoje zbatimi i disa projekteve, të cilat priten të përfundojnë brenda vitit 2008. Këto projekte jane:

Vazhdimi i punimeve per realizimin e projektit per zgjatjen e linjes 220/20kV te Tiranes

Vazhdimi i punimeve per realizimin e projektit per permiresimin e rrjetit te shperndarjes per linjen e Korces dhe Kavajes

Vazhdimi i punimeve per realizimin e projektit per zgjatjen e linjes 110/20kV SS te Lushnjes dhe Uznoves;

Vazhdimi i punimeve per realizimin e projektit per permiresimin e rrjetit te shperndarjes per linjen e Lushnjes dhe Beratit;

Realizimi i projektit per rehabilitimin dhe permiresimin e rrjetit te shperndarjes dhe transmetimit per Stacionin e Vaut te Dejes dhe Shkodres;

Realizimi i projektit per rehabilitimin, kontrollin dhe monitorimin ne nenstacionin Elbasan 1 dhe Tirana 1;

Vazhdimi i punes me qellim realizimin e projektit per mbeshtetje dhe instalimin e njesise dhe pjeseve perberese per 110/20 SS dhe TL per rajonin e Duresit, Kucoves dhe Elbasanit;

Vazhdimi i punes me qellim realizimin e projektit per mbeshtetje dhe instalimin e njesise dhe pjeseve perberese per sistemin e shperndarjes per rajonin e Durresit, Kucoves dhe Elbasanit;

Vazhdimi i projektit BISABU

Vazhdimi i DRCRP- Projekti per Rehabilitimin e Kaskades se Drinit;

Realizimi i projektit per vendosjen e matesave kolektive dhe individuale;

Ndertimi 85-135 MË Vlora Combined Cycle TPP.

Ndërtimi i Linjës 400 kv Elbasan-Podgoricë

Ndërtimi i Nënstacionit 400 kv në Tiranë

Ndërtimi i Qendrës së re Dispecer në Tiranë

Gjithashtu, në mbeshtetje te akteve ligjore qe do te miratohen gjate kesaj periudhe do te ndermern keto aktivitetet:

Shtim i personave per hartimin e Ligjit per Taksat e Energjise

Forcimi i kapaciteteve per hartimin e Ligjit Integral te Energjise

Tabela: Shtese e kapaciteve për Ministrine e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes

INVESTIME	NJESIA E MATJES	gJENDJA AKTUALE	2006	2007	2008	2009
Rritja e numrit të punonjësve	person			B) +18	B) +1	
A) METE		A) 2	) +3			
B)AKE		B) 30	) +7	F		
Trajnime	000 lek		B)1813	B)2082.5	B) 490	
A) METE						
B)AKE						
Investime (paisje, ndërtesa)	000 lek	89 270 000 (Investimet do te shtrihen deri ne vitin 2008)				
KESH						
IT	000 lek	A) 4000		F		B) 367
A) METE		B)1286	)4 838			
B)AKE						
Konsulenca-Studime	000 lek		B) 1470	B) 1163	B) 735	B) 735

3.15.2 SEKTORI I HIDROKARBUREVE

1. Objektivi Politik i fushës

Objektivi kryesor i qeverisë për sektorin e hidrokarbureve është garantimi i një furnizimi të sigurt të ekonomisë me burime energjitike hidrokarbure për të siguruar një zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik e njerëzor të vendit si dhe për të siguruar integrimin e vendit në BE, nëpërmjet diversifikimit (shumëllojshmërisë, shtimit dhe zgjerimit) të burimeve furnizuese të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe rritja e prodhimit vendas të naftës bruto me rreth 10% në vit. Nje rëndesi e veçante do t'i kushtohet mbrojtjes së mjedisit dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore tokësore dhe nëntokësore. Një tjetër objektivi i qeverisë shqiptare për këtë nënfushë është edhe ristrukturimi dhe privatizimi i shoqërive në sektorin e hidrokarbureve, ku shteti është pronar.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria në fushën e sektorit të hidrokarbureve rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore:

Ligji nr. 9501, datë 03.04.2006 "Për ratifikimin e Traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë";

Ligji Nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve”, ndryshuar nga ligji nr. 9218, datë 08.04.2004, siguron një sistem të hapur të liçensimit për aktivitete në fushën e përpunimit, transportit dhe tregëtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve.

Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993 i ndryshuar me ligjin nr. 7853, datë 29.07.1994, analoge me Direktivën 94/22/EC “Për kushtet për dhënien dhe përdorimin e autorizimeve për zbulimin, eksplorimin dhe prodhimin e hidrokarbureve” përcakton kërkesat që një kompani vendase apo e huaj duhet të përmbushë, me qëllim fillimin e aktivitetit të kërkimit dhe prodhimit. Marrëveshjet për hidrokarburet (të përpiluara sipas modeleve ndërkombëtare) nënshkruhen nga Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës (ministria përgjegjëse për hidrokarburet), sipas propozimit të bërë nga grupi negociues në përbërje të AKH-së dhe më pas miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Zbatimi i ligjit mundësohet nga një paketë fiskale e posaçme e parashikuar me ligjin nr. 7811, datë 12.04.1994 “Për aprovimin e Dekretit nr. 782, datë 22.02.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (Kërkim – Prodhim)”.

2.2. Kuadri institucional

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për fushën e hidrokarbureve janë:

Sektori i Politikave Primare pranë Drejtorise së Politikave Industriale ;

Sektori i Lejeve dhe Konçesioneve ;

Sektori i Menaxhimit të Kontratave në Drejtorinë e Liçensave dhe Menaxhimit të Kontratave

Këto struktura janë pjesë e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe kanë përgjegjësi kryesore në zbatimin e legjislacionit për fushën e hidrokarbureve. Funksionet e tyre janë: (i) hartimi i politikave zhvilluese të sektorit hidrokarbur në përputhje me kërkesat në rritje të tregut për burime energjike me bazë hidrokarbur, duke synuar realizimin e një furnizimi të sigurtë dhe të qëndrueshëm të tregut me këto produkte, si dhe një mjedis të shëndetshëm; (ii) përpunimi i të dhënave për aktivitetin e subjekteve dhe institucioneve të sektorit hidrokarbur, duke përcaktuar përparësitë të shprehura në programe dhe projekte konkrete zhvilluese; (iii) ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të kontratave dhe marrëveshjeve që operojnë në sektorin hidrokarbur ; (iv) lëshimi i disa lloje liçensash, sipas fushave të veprimtarisë së operatorëve dhe produkteve në fjalë; dhe (v) koordinimi i punës me organizma të ndryshëm shkencorë për kërkim dhe zhvillim, përpunimin dhe marketingun në sektorin e hidrokarbureve.

4. Inspektoriati Shtetëror i Kontrollit të Naftes, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre;

5. Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve (AKH);

6. Qendra Kombëtare Shkencore e Hidrokarbureve (QKSHH).

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Në zbatim të objektivave të përcaktuara në programin e qeverisë, prioritet afatshkurtër në fushën e hidrokarbureve është:

Ristrukturimi dhe privatizimi i shoqërive në sektorin e hidrokarbureve, ku shteti është pronar.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këtë prioritet afatshkurtër, për realizimin e tij, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës:

Projektvendimi “Mbi standardet e karburanteve dhe lubrifikanteve”, i cili do të përafrohet “pjesërisht” me Direktivën 98/70/EC ndryshuar me Direktivën 2003/17/EC.

Ndryshim i Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve”, për të reflektuar ndryshimet strukturore të institucioneve që menaxhojnë sektorin hidrokarbur, i përafrohet pjesërisht me Direktivën 98/70/EC.

Hartimi i kuadrit rregullator ligjor dhe teknik për tregun e brendshëm të gazit. Kuadri ligjor pritet të jetë i përafrohet pjesërisht me Direktivat 98/30/EC dhe 2003/55/EC

3.1.2. Aktivitet zbatues afatshkurtra

Për realizimin e prioriteteve afatshkurtra, do të ndërmerren aktivitetet zbatues të mëposhtme:

Rivlerësimi procesit të privatizimit të shoqërive, ARMO, SERVCOM dhe shoqërive të tjera anonime;

Përcaktimi i hapave procedurialë dhe ligjorë për privatizimin e ALBPETROL Sh.A.;

Rritja e rolit rregullator të shtetit në drejtimin të cilesisë së nënprodukteve që tregëtohen dhe rezervës së sigurisë;

Përfundimi i praktikave ligjore për privatizimin e ALBPETROL SH.A;

Ndjekja e procedurave të privatizimit të shoqërive ARMO, SERVCOM dhe shoqërive të tjera anonime;

Rritja e prodhimit vendas të naftës bruto në masën 10%;

Bashkëpunimi me shoqëritë e huaja për kërkimin dhe prodhimin e HK në territorin shqiptar;

Diversifikimi i burimeve të furnizimit me naftë, gaz dhe nënprodukte.

3.2. Prioritetet afatmesme

Në zbatim të objektivave të përcaktuara në Programin e qeverisë, prioritetet afatmesme dhe afatgjata në fushën e hidrokarbureve janë:

Garantimi i një furnizimi të sigurtë të ekonomisë me burime energjitike hidrokarbure për të siguruar një zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik e njerëzor të vendit;

Mbrojtja e mjedisit dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore tokësore dhe nëntokësore.

3.2.1. Iniciativat ligjore afatmesme

Në përputhje me këto prioritetet afatmesme, për realizimin e tyre, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Amendimi i VKM nr. 808, datë 05.11.2004 “Për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre”. VKM-ja e ndryshuar do të jetë pjesërisht e përputhur me Direktivën 68/414/EEC.

3.2.2. Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për realizimin e prioritetëve afatmesme, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ndjekja e Procedurave të privatizimit të shoqërisë ALBPETROL SH.A.

Tabela: Shtesë e kapaciteteve për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës

INVESTIME	NJESIA E MATJES	gJENDJA AKTUALE	2006	2007
Rritja e numrit të punonjësve	person	3		
Trajnime	000 lek			
Investime (pajisje, ndërtesa)	000 lek			
IT	000 lek			
Konsulenca-Studime	000 lek		5000	5000

3.16 POLITIKAT INDUSTRIALE

3.16.1 POLITIKAT INDUSTRIALE

1. Objektivi Politik

Prioriteti kryesor i qeverisë shqiptare në fushën e politikave industriale është përfundimi i privatizimit të pronës publike të mbetur si dhe mbrojtja e mjedisit nga zhvillimet industriale. Nga ana tjetër në kuadër të realizimit të angazhimeve që rrjedhin nga MSA-ja, qeveria shqiptare duhet të përgatisë brenda një periudhe trevjeçare, me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Ndërmjetme, një program për ristrukturimin e industrisë së hekurit dhe çelikut me qëllim zhvillimin e kësaj industrie në kushtet e një tregu normal.

Prandaj që do të ndiqen në ristrukturimin dhe zhvillimin e industrisë prodhuese sipas degëve të saj përcaktohen nga Strategjia e Zhvillimit të Industrisë Joushqimore.

2. Situata Aktuale

Kuadri Ligjor

Veprimtaria në Sektorin e Politikave Industriale rregullohet nga një kuadër ligjor i konsoliduar, i përbërë prej këtyre akteve ligjore dhe nënligjore:

Ligji nr.7512, datë 10.08.1992 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”;

Ligji nr. 7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”;

Ligji nr. 7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore”;

Ligji nr. 7973, datë 26.07.1995 “Për konçensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”;

VKM nr. 269, datë 23.04.2004 “Për miratimin e Strategjisë së zhvillimit të industrisë jo-ushqimore”;

VKM nr. 230, datë 4.04.1998 “Për privatizimin e pjesëve të kapitalit të zotëruara nga shteti në shoqërite me kapital të përbashkët”;

VKM nr. 159, datë 13.03.2003 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet si dhe procedurat e shitjes”;

VKM nr. 195 datë 20.03.1998 “Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen”;

VKM nr. 169, datë 13.03.2003 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore që u nënshtrohen privatizimit apo transformimit të tyre në shoqëri tregtare”;

VKM nr. 194 datë 20.03.1998 “Për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar të shoqërive që do të krijohen nga shndërrimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregëtare”;

VKM nr. 195, datë 20.03.1998 “Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen”;

VKM nr. 197, datë 20.03.1998 “Për nxjerrjen jashtë përdorimi të objekteve që nuk mund të shiten”;

VKM nr. 418 datë 9.07.1998 “Për procedurat e likuidimit të ndërmarrjeve në rrugë administrative”;

VKM nr. 315, datë 24.04.2003 “Për dhënien me qera të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”;

VKM nr. 461, datë 6.10.1999 “Për monitorimin e objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive e institucioneve shtetërore të dhëna me qera ose enfiteoze, përdorimi i të ardhurave ose enfiteoza”;

VKM nr. 398, datë 13.06.2003 “Për heqjen e liçencave në industrinë prodhuese”.

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e sistemit të shëndetit publik është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

Sektori i Politikave Sekondare dhe Terciale në Drejtorinë e Politikave Industriale, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, i cili mbikqyr dhe ndjek problematikën e ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, etj, në degët Kimi, Dru-Letër, Lëkurë-Këpucë, Tekstil-Konfeksione e Gomë të sektorit publik. Ky sektor është organi përgjegjës për hartimin, zbatimin dhe përmirësimin e politikave të zhvillimit të industrisë prodhuese. Në funksion të zbatimit të Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë, ky sektor do të monitorojë konkurrueshmërinë e produkteve industriale;

Drejtoria Rregullatore dhe Drejtoria e Politikave Tregtare, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës ;

Institucione të tjera si :**Instituti i Studimeve dhe Projektmeve të Metalurgjisë, Instituti i Mekanikës, Instituti i Përpunim Drurit dhe Instituti i Industrisë së Lehtë.**

2.3. Asistenca e huaj

Mbështetja financiare për Politikën Industriale, për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës është dhënë nga Programi CARDS, konkretisht Projekti “Për asgjësimin e mbetjeve arsenikale në Uzinën e Plehrave Azotike në Fier”, me vlerë rreth 1 milionë Euro.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në angazhimet që rrjedhin nga zbatimi Marrëveshjes së Ndërmjetme, dhe në programin e qeverisë, prioritetet afatshkurtra për fushën e politikave industriale janë:

Fillimi i procesit për draftimin e "Planit për Ristrukturimin e Industrisë së Hekurit dhe Çelikut", duke i dhënë prioritet përfundimit të procesit të privatizimit të pronës publike të mbetur si dhe mbrotjen e mjedisit nga ndotjet industriale;

Arritja e mbijetesës së qëndrueshme në fund të ristrukturimit të sektorit të çelikut në kushtet e tregut normal të prodhimit e tregtimit nëpërmjet vlerësimit të gjendjes dhe programimi e implementimi i aktiviteteve për rritjen e qëndrueshme të aftësisë konkurruese dhe bërja normale e prodhimit dhe tregtisë së çelikut në kushtet e plotësimit të detyrimeve të MSA-së dhe Protokollit 1 për çelikut”

Përfundimi i privatizimit të pronës publike të mbetur

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritete afatshkurtra, për realizimin e tyre, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës:

Hartimi dhe miratimi i Urdhërit të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës "Për ngritjen e grupit të punës për përpunimin e "Planit për Ristrukturimin e Industrisë së Hekurit dhe Çelikut";

Hartimi dhe miratimi i projektligjit "Për industrinë joushqimore";

Hartimi dhe miratimi i projektvendimit "Për implemetimin e ligjit nga subjektet publike dhe private";

Hartimi dhe miratimi i projektvendimit "Për harmonizimin e detyrimeve dhe këmbimin e të dhënave ndërmjet palëve, si ministri, institucione, entet, subjekte private dhe publike.

Përputhshmëria me këto fusha me *acquis* është me statusin "jo i aplikueshëm".

3.1.2. Aktivitet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e prioriteteve afatshkurtra, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Listimi i pronës publike të mbetur;

Rigrupimi i ndërmarrjeve për t'u privatizuar në grupe ndërmarrjesh industriale në bazë prefekturash;

Likujdimi i ndërmarrjeve publike që nuk privatizohen;

Pjesëmarrja në grupet e mbrojtjes së mjedisit në MMP&AU;

Privatizimi i SH.A-ve publike;

Pjesëmarrja në Grupin e Punës për përpunimin e "Planit për Ristrukturimin e Industrisë së Hekurit dhe Çelikut";

Diagnostikimi i gjëndjes tërësore në sektorin e çelikut (në përputhje me kërkesat dhe implikimet nga Protokollit 1 i MSA-së;

Përgatitja e Termave të Referencës për konsulencën e huaj të mundshme;

Përgatitja e projektit të privatizimit të plotë;

3.2. Prioritetet afatmesme

Bazuar në angazhimet që rrjedhin nga zbatimi Marrëveshjes së Ndërmjetme dhe në Programin e Qeverisë, prioritetet afatmesme për fushën e politikave industriale janë:

Funksionimi i sektorit të hekurit dhe çelikut në kushtet e tregut normal të prodhimit e tregtimit në kuadër të plotësimit të detyrimeve të Protokollit 1 për hekurin dhe çelikut;

Përfundimi i privatizimit të pronës publike të mbetur

3.2.1. Iniciativat ligjore afatmesme

Në përputhje me këto prioritete afatmesme, për realizimin e tyre, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës:

Projektligji "Për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjeve", i cili do të jetë pjesërisht i përputhur me Direktiven 96/61/EC amenduar nga Direktiva 2003/35/EC, Direktiva 2003/87/EC si dhe me Rregulloren Nr.1882/2003.

Aktivitet zbatuese afatmesme

Për realizimin e prioriteteve afatmesme, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Privatizimi i pjesës shtetërore në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar;

Përgatitja e Planit të zbatimit dhe monitorimi periodik të progresit të ristrukturimit të sektorit të hekurit dhe çelikut;

Hartimi dhe miratimi i Udhëzuesve BAT për sektorë të industrisë metalurgjike (industria e çelikut, ferrokromit, fonderitë dhe për industri të tjera);

Fillimi i zbatimit të projektit të ristrukturimit të industrisë së hekurit dhe çelikut.

Tabela: *Shtese e kapaciteve për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës*

INVESTIME	NJESIA	E	gJENDJA	2006
	MATJES		AKTUALE	
Rritja e numrit të punonjësve	person	1		+2
Trajnime	000 lek			

Investime ndërtesa)	(paisje, 000 lek	125
IT	000 lek	246
Konsulenca-Studime	000 lek	

3.16.2 Sektori i Minierave

1. Objektivi politik i fushës

Në përputhje me programin e qeverisë, përparësitë në sektorin e minierave janë përfundimi dhe miratimi i Strategjise së Zhvillimit të Industrise Minerare; përmirësimi i kuadrit ligjor si rezultat i përvojës së përfutur, monitorimi i marrëveshjeve të konçesionit në industrinë minerare, mbyllja e minierave, privatizimi i aseteve, likuidimi si dhe realizimi i studimeve me karakter kombëtar në lidhje me zhvillimin e sektorit²².

2. Situata aktuale

Kuadri ligjor

Veprimtaria shtetërore në sektorin e minierave rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore:

Ligji nr.7796 datë 17.02.1994 “Ligji Minerar i Shqipërisë”, i amenduar. Ky ligj përcakton marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe personave juridikë me qëllim që të përftohen të drejtat minerare dhe të kryhen aktivitetet minerare.

Ligji nr.8386 datë 02.07.1998 “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar“, i amenduar. Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë detyrat, bazat, parimet e organizimit e të drejtimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) me përjashtim të Shërbimit Gjeologjik të Naftës e Gazit.

Ligji nr.7973, datë 26.07.1995 “Për konçesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbime publike dhe infrastrukture”, i amenduar. Ligji ka për qëllim krijimin e kuadrit ligjor për pjesëmarrjen e sektorit privat, vendas e të huaj, nëpërmjet konçesioneve dhe formave të tjera të partneritetit shtet-privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë.

VKM nr. 54, datë 28.01.2005 “Për përcaktimin e kriterëve për dhënien e lejeve profesionale specialisteve që kryejnë projektimin, vlerësimin, konsulencën, monitorimin dhe drejtimin teknik të veprimtarisë minerare”, e ndryshuar.

Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e minierave është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

Drejtoria e Liçensave dhe e Menaxhimit të Kontratave në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE). Përgjegjësitë e kësaj Drejtorie lidhur me sektorin minerar janë: (i) fillimi dhe menaxhimi i reformës rregullatore lidhur me procesin e liçensimit dhe lidhjes së kontratave konçesionare, në përputhje me politikat kombëtare dhe rajonale në fushën minerare; (ii) Menaxhimi dhe kontrolli i zbatimit të kontratave konçesionare si dhe lejeve minerare konform marrëveshjeve dhe projekteve të miratuara nga Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA); dhe (iii) bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave pranë METE për të siguruar një informacion të përditësuar dhe analizuar të gjithë të dhënat teknike, ekonomike dhe administrative në lidhje me aktivitetin minerar në Shqipëri;

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave/Sektori i Politikave Primare, mbulon politikat që lidhen me Industrinë Minerare. Përgjegjësia kryesore e këtij Sektori është në hartimin e platformës dhe politikave të zhvillimit për industrinë e nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve;

Instituti i Teknologjisë së Nxjerrjes dhe Përpunimit të Mineraleve i cili ka rol bashkëpunues; **Shërbimin Gjeologjik Shqiptar,** i cili ka rol bashkëpunues.

²² Për Sektorin Minerar nuk ka detyrime të veçanta në MSA dhe Partneritetin Evropin 2005, me përjashtim të detyrimeve të përgjithshme(përafrimi i legjislacionit) që rrjedhin nga Neni 70 i MSA-së.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Në zbatim të objektivave të përcaktuara në programin e qeverisë, prioritetet afatshkurtra në fushën e minierave janë:

Përfundimi dhe miratimi i Strategjisë së Zhvillimit të Industrisë Minerare;

Përmirësimi i kuadrit ligjor si rezultat i përvojës së përfituar;

Monitorimi i marrëveshjeve të konçesionit në industrinë minerare;

Mbyllja e minierave, privatizimi i aseteve, likuidimi si dhe realizimi i studimeve me karakter kombëtar në lidhje me zhvillimin e sektorit.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritate afatshkurtra, për realizimin e tyre, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës:

Amendimi i ligjit nr.7796, datë 17.02.1994 “Ligji mineralar i Shqipërisë”, me qëllim lehtësimin e procedurave të liçensimit për zhvillimin e aktivitetit mineralar, si dhe për rregullimin ligjor të procesit të monitorimit të Rezervave të Burimeve Minerare dhe veprimtarisë post-minerare”.

Miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë së zhvillimit të industrisë minerare, bazuar në politikat rajonale për menaxhimin me efektivitet të burimeve minerare ekzistuese dhe atyre që do të zbulohen për një periudhë 15 vjeçare”, me qëllim menaxhimin me efektivitet të burimeve minerare ekzistuese dhe atyre që do të zbulohen në të ardhmen dhe vlerësimin e potencialit mineralar, për të krijuar mundësinë e përcaktimit të politikave dhe programeve të veprimit mbi menaxhimin e burimeve minerare ekzistuese si dhe zhvillimin e tyre në perspektivë në përputhje me zhvillimet e reja të ekonomisë shqiptare.

3.1.2. Aktivitet zbatues afatshkurtra

Për realizimin e prioritetëve afatshkurtra, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Kontrolli i realizimit të programit të investimeve dhe prodhimit;

Studimi dhe hartimi i marrëveshjeve të reja konçesionare;

Monitorimi i marrëveshjeve të konçesionit në industrinë minerare;

Vlerësimi, menaxhimi dhe monitorimi i ujrave nëntokesore në basenet kryesore ujëmbajtës me përparësi zonat turistike, urbane etj.

Rivlerësimi i pasurive natyrore e lëndëve të para dhe vënia e tyre në efijence;

Studime komplekse në shërbim të mirëadministrimit të territorit dhe burimeve natyrore në shkallë vendi dhe lokale: gjeologjia-territori-mjedisi;

Studime komplekse në fushën e gjeomjedisit dhe monitorimi i tij;

Vlerësimi i rreziqeve gjeologjike, si dhe studime gjeologo-inxhinjerie të specializuara për vlerësimin e qëndrueshmërisë dhe zgjerimin e infrastrukturës publike;

Gjeologjia bazë (studime shkencore të thelluara me rëndësi aplikative);

Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të informacionit, banka e të dhënave, transmetimi i informacionit drejt organeve vendim-marrëse dhe shoqërisë (GIS);

Informim për shoqërinë, opinionin shkencor dhe zhvillimi i resurseve njerëzore;

Studime dhe projektme për nevoja emergjente sipas kërkesave të pushtetit qendror e lokal;

Promovimi i mineraleve të rinj për shfrytëzim;

Mbikqyrja e shfrytëzimit efektiv të pasurive minerale;

Monitorimi i fenomeneve post shfrytëzimi;

Kërkime teknologjike dhe mjedisi;

Kontrolli i mbylljeve;

Hartimi i projekteve për mbyllje të reja;

Hartimi i preventivave të ndryshme për rimbylljet

Tabela: Shtesë e kapaciteve të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës

INVESTIME	NJESIA E MATJES person	gJENDJA AKTUALE a)178 b) 88	2006)+ 172	a b
Ritja e numrit të punonjësve				
A)Shërbimi Gjeologjik Shqiptar				
B) Instituti i Teknologjisë së Nxjerrjes dhe Përpunimit të				
			2505	

Mineraleve		) + 10
Trajnime	000 lek	4600
(Instituti i Teknologjisë së Nxjerrjes dhe Përpunimit të Mineraleve)		
Investime (paisje, ndërtesa)	000 lek	
IT	000 lek	11000
(Instituti i Teknologjisë së Nxjerrjes dhe Përpunimit të Mineraleve)		
Konsulenca-Studime	000 lek	A)3500
A)METE		B)
B)Instituti i Teknologjisë së Nxjerrjes dhe Përpunimit të Mineraleve		6000

3.17 NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

1. Objektivi politik i fushës

Në fushën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, qeveria po ndërmerr politika nxitëse për zhvillimin me ritme më të larta të sipërmarrjes së lirë. Per periudhën afatshkurtër 2006-2007, fokusi kryesor i qeverisë është krijimi i një klime pozitive për zhvillimin e biznesit, me qëllim që t'i hapet rrugë rritjes dhe fuqizimit të SME-ve, tërheqjes së investimeve të huaja në Shqipëri dhe nxitjes së eksporteve shqiptare në tregun rajonal dhe global. Në periudhën afatmesme 2008-2010, qeveria shqiptare do të punojë më tej për reduktimin e informalitetit në ekonomi, krijimin e skemave dhe zbatimin e politikave që kanë për qëllim nxitjen e konkurrueshmërisë dhe të inovacionit midis SME-ve, si dhe hartimin e politikave për përgjegjësitë sociale të SME-ve me synim rritjen e produktivitetit, përmirësimin e kushteve të punës së punëtorëve, mbrojtjen e mjedisit, etj.

2. Situata Aktuale

2.1 Kuadri Ligjor

Ligji bazë që rregullon masat dhe politikat shtetërore për klasifikimin, nxitjen e krijimit dhe të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është Ligji Nr.8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme". Konstatohet se ligji ekzistues nuk është në përputhje me Rekomandimin e Komisionit të BE-së, datë 6 maj 2003 në lidhje me përkufizimin e SME-ve.

Akte të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e SME-ve janë:

Ligji Nr.9107, datë 17.07.2003, "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 8636, datë 06.07.2000 "Për zonat e lira" ndryshuar me ligjin Nr. 8725 datë 26.12.2000", sipas të cilit Enti Kombëtar i Zonave të Lira kalon në varësi të Ministrit të Ekonomisë;

Ligji Nr.7804, datë 10.03.1994, "Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë", në bazë të cilit janë krijuar Dhomat që zhvillojnë veprimtari si insitucione të së drejtës publike;

Ligji Nr.9396, datë 12.05.2005, " Për qiranë Financiare" dhe në zbatim të nenit 44 të këtij ligji Udhëzimi për qiranë financiare, undhëzim i përbashkët i MF dhe METE;

Ligji Nr.7764, datë 2.11.1993 "Për Investimet e Huaja", në bazë të të cilit jepet kuptimi i investitorit të huaj dhe investimit të huaj si dhe trajtimet e tyre si dhe të drejtat e transferimit të fondeve, të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, etj;

Ligji Nr.9497, datë 20.03.2006 "Për krijimin e Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve";

VKM Nr.57, datë 2.02.2001, "Strategjia e Zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme", e cila synon krijimin e vendeve të punës dhe shpërndarjen e të ardhurave si dhe tenton një zhvillim të ekuilibruar rajonal e sektorial në të gjithë vendin;

VKM Nr.518, datë 24.10.2002, "Për miratimin e Strategjisë së Nxitjes së Eksporteve shqiptare" dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj;

VKM Nr.34, datë 16.01.2003, "Për miratimin e Rregullores së Funksionimit të Zonës së Lirë";

VKM Nr.438, datë 02.07.2004, "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 43, datë 17.01.1998, Për organizimin e panaiereve dhe ekspozitave tregtare";

VKM Nr. 246, datë 21.04.2005, për miratimin e Planit të Veprimit "Për reduktimin e ekonomisë informale" dhe në zbatim të saj

Urdhëri i Kryeministrit Nr.180, datë 11.11.2004, "Për krijimin e grupit qendror për hartimin

dhe zbatimin e planit të veprimit për reduktimin e ekonomisë informale”;

VKM Nr.326, datë 13.05.05, për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e “Programit për zhvillimin e sektorit privat me anë të një kredie ndihmë për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe sigurimin e asistencës teknike për to”. Kjo marrëveshje u nënshkrua më datë 21.06.05;

Ligji Nr. 9527 dhe Ligji Nr. 9528 datë 11.05.2006 për ratifikimin e marrëveshjes qeveritare dhe financiare midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane “Për realizimin e programit për zhvillimin e sektorit privat, me anë të një kredie ndihmë për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe sigurimin e asistencës teknike për to”;

VKM Nr. 157 datë 15.03.2006, “Për miratimin e Planit të Veprimit të reformës rregullatore në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit” dhe në zbatim të saj Urdhëri Nr.170, datë 31.10.2005 për krijimin e Task – Forcës “Për drejtimin dhe monitorimin e reformës rregullatore në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit”, e cila drejtohet nga Kryeministri;

Urdhëri Nr.22 i Kryeministrit, datë 23.01.2003, “Për riorganizimin e Këshillit Konsultativ të Biznesit”, i cili ngarkon Ministrinë e Ekonomisë për organizimin dhe funksionimin e këtij Këshilli;

Urdhëri Nr.192 i Kryeministrit, datë 12.12.2005, “Për riorganizimin e grupit ndërmnistror të punës për kompaktin e investimeve në kuadër të paktit të stabilitetit”.

2.2 Kuadri Institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është në përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës si institucioni kryesor që ka për detyrë hartimin e politikave për përmirësimin e klimës së biznesit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

Drejtoria e Nxitjes së Biznesit në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës;

Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve (Alb Invest).

Struktura e Drejtorisë së Nxitjes së Biznesit është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Tregtare. Ajo përhet nga shtatë punonjës, dhe është ndarë në tre sektorë (Sektorin e SME-ve, Sektorin e Investimeve të Huaja Direkte dhe Sektorin e Eksporteve). Kjo drejtori është përgjegjëse për:

studimin e gjendjes dhe përpunimin e politikave të zhvillimit të biznesit për sektorin privat, për nxitjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), investimeve të huaja direkte (IHD) dhe të eksporteve;

hartimin dhe masave me karakter ligjor, institucional dhe administrativ në interes të zhvillimit të biznesit;

hartimin e programeve dhe projekteve të financimit, në bashkëpunim me institucionet publike shtetërore e private dhe donatorët, në interes të zhvillimit të sektorit privat, vecanërisht të SME-ve, investimeve dhe eksporteve;

organizimin e dialogut të vazhdueshëm me grupet e interesit të komunitetit të biznesit;

Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve (Alb Invest) është person juridik publik, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës, me seli në Tiranë dhe që ushtron veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve u krijua si rezultat i bashkimit të tre agjencive ekzistuese: Agjencia e SME-ve, Agjencia e Investimeve të Huaja dhe Agjencia e Nxitjes së Eksporteve, me ligj Nr. 9497, datë 20.03.2006. Ndërkohë është duke u përgatitur dhe kuadri i akteve nënligjore për funksionimin e Agjencisë, si statuti, struktura, etj. Struktura dhe organika përcaktohen me Urdhër të Kryeministrit me propozim të ministrit të Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës. Në përbërje të saj mendohet të jenë rreth 25 specialistë, të ndarë në 3 divizione: të zbatimit të politikave për nxitjen e SME-ve, për nxitjen e eksporteve si dhe për nxitjen e investimeve të huaja.

2.3 Asistenca e Huaj

Gjatë këtyre viteve të fundit, ndihma e huaj për mbështetjen e Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës në fushën e zhvillimit të sektorit privat ka qënë në formën e asistencës teknike dhe ndihmë financiare në formë kredie. Më konkretisht mbështetje financiare është dhënë nga:

Projekti CARDS 2002 “Nxitja dhe rregullimi i tregut” në bashkëpunim me PNUD-in, me

vlerë 2.2 milion euro;

Projekti CARDS 2002 "Nxitja e tregtisë" me vlerë 2 milion euro;

Projekti CARDS 2003 "Mbështetje për sistemin e mbikqyrjes së tregut" me vlerë 1 milion euro;

Projekti i GTZ-së, i cili ka asistuar qeverinë në hartimin e Strategjisë së nxitjes së eksporteve si dhe ka ofruar asistencë teknike për Agjencinë e Nxitjes së Eksporteve;

Projekti i PNUD-it i cili ka asistuar qeverinë në hartimin e strategjisë afatmesme të SME-ve si dhe ka ofruar asistencë teknike për Agjencinë e Nxitjes së Investimeve të Huaja;

Projekti i Bankës Botërore FIAS/ IFC që ka kontribuar në realizimin e studimit për barrierat administrative në fushën e investimeve;

Projektet e USAID-it të cilat janë përqendruar në asistencën teknike, financimin e bizneseve prodhuese dhe në vecanti për kompanitë eksportuese duke kontribuar gjithashtu në krijimin e Cluster Industrial (projekti EDEM-USAID);

Projekti i SEED/ IFC ka asistuar qeverinë në hartimin e kuadrit ligjor rregullues në fushën e biznesit, si hartimi i p/ligjit për qiranë financiare, ndërmarrjen e studimit për tregun e lizingut, faktoringut si dhe në studimin për përmirësimin e funksionit të KK të Biznesit;

Projekti i Qeverisë Italiane me vlerë 30 milionë lekë që do të detajohet nëpërmjet një programi 3 vjeçar për mbështetjen e SME-ve nëpërmjet një kredie ndihmë me vlerë 25 milionë, 2,5 milion euro do të shërbejnë për krijimin e Fondit të Garancisë dhe 2,5 milion do të shërbejnë për asistencë teknike. Projekti është planifikuar të zbatohet gjatë viteve 2006-2009;

Projekti i Qeverisë Amerikane "Llogaria e sfidës së mijëvjeçarit" me një vlerë 2.5 milion dollarë asistencë teknike për rishikimin e modelit të regjistrimit të biznesit me objektiv reduktimin e kohës së regjistrimit të biznesit dhe ofrimin e regjistrimit on line. Projekti është planifikuar të zbatohet gjatë viteve 2006-2009;

Gjithashtu, është në negociim projekti i Bankës Botërore "BERIS" me vlerë 11 milion dollarë në formën e kredisë, e cila do të përdoret për zbatimin e reformës rregullatore në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit.

3. Adresimi i Prioriteteve

3.1 Prioritetet Afatshkurtra (2006-2007)

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Europian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Europian, prioritetet afatshkurtra (2006-2007) për fushën e SME-ve janë:

Të përmirësohet qëndrueshmëria financiare e Agjencisë së Biznesit dhe të zbatohen programet kombëtare trajnuese për SME-të;

Të zbatohet Karta Europiane për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;

Të zbatohet plani i veprimit për heqjen e barrierave administrative për investimet dhe të sigurohet zbatimi i duhur, i hapur dhe jodiskriminues i legjislacionit, rregullave dhe procedurave që kanë të bëjnë me biznesin;

Të bëhet më pak i kushtueshëm, më i thjeshtë dhe më i mundur regjistrimi i shoqërive në të gjithë vendin;

Të përmirësohen procedurat për marrjen e licencave, lejeve dhe certifikatave;

Të reformohet sistemi i parapagimit të taksave që të bëhet më i favorshëm për shoqëritë e reja;

Të zbatohet plani i veprimit i rishikuar për reduktimin e ekonomisë informale;

Të hartohen procedura vlerësuese për ndikimin që kanë masat e planifikuara rregulluese mbi biznesin;

Të miratohen ligje të përmirësuara në lidhje me tregtinë;

Të sigurohet zbatimi efikas i fondit të garancisë së kredisë dhe të sigurohet një menaxhim profesional dhe i pavarur i skemës.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për realizimin e prioriteteve afatshkurtra nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Miratimi i ligjit "Për faktoringun";

Miratimi i ligjit "Për incentivat në fushën e investimeve";

Hartimi dhe miratimi i VKM-së së re "Për Reduktimin e Ekonomisë Informale";

Hartimi dhe miratimi i Urdhërit të Kryeministrit për ngritjen e grupit ndërdikasterial për

monitorimin e reduktimit të ekonomise informale;

Hartimi dhe miratimi i ligjit "Për Këshillin Konsultativ të Biznesit";

Hartimi dhe miratimi i ligjit të ri "Për dhomat e tregtisë dhe industrisë";

Hartimi dhe miratimi i planit të veprimit për nxitjen e prodhimit dhe eksportit;

Hartimi dhe miratimi i kuadrit ligjor për fondin e garancive

3.1.2. Aktivitet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Në kuadër të përmirësimeve në drejtim të financimit të sektorëve të SME-ve do të aktivizohen skemat e garantimit të kredive për SME-të si dhe do të rritet kapitali bazë i institucioneve të mikrokredive;

Ngritja e strukture se nevojshme, ku do të punësohen tre punonjës, e cila e do të zbatojë projektin "Për mbështetjen e SME-ve" që do të krijojë fondin e garantimit të kredive;

Rishikimi i kuadrit rregullator dhe praktikave administrative, duke synuar përmirësimin e kuadrit ligjor dhe administrativ për uljen e kohës dhe kostos së regjistrimit të një biznesi (nga 30 ditë do të realizohet në 10 ditë), thjeshtimin e procedurës për regjistrimin e kompanive, thjeshtimin e procedurave të licencimit si dhe për lejet e ndërtimit, taksat dhe tatimet etj. Gjithashtu do të synohet në gjetjen e një modeli të përshtatshëm për kushtet e Shqipërisë nëpërmjet krijimit të një "One-stop shop";

Do të përmirësohen dhe përditësohen informacionet për SME-të në portalin www.seebiz.net.al;

Zbatimi i programit kombëtar të trajnimit për SME-të, me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së tyre në tregun Europian;

Krijimi i Sekretariatit të Këshillit Konsultativ të Biznesit brenda vitit 2007, ku do të punësohen 3 punonjës. Qëllimi i këtij Sekretariati do të jetë monitorimi i veprimtarisë së Këshillit Konsultativ të Biznesit, mbledhja e mendimeve nga biznesi etj, duke shërbyer në këtë mënyrë për nxitjen e dialogut qeveri-biznes;

3.2. Prioritetet afatmesme

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Europian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Europian, prioritetet afatmesme (2008-2010) për fushën e SME-ve janë:

Të ruhet ritmi i strategjisë për luftën kundër ekonomisë informale me zhvillimet në këtë sektor;

Të zhvillohen më tej strukturat e specializuara për mbështetjen e biznesit dhe të studiohet fizibiliteti për një park biznes-teknologjie;

Të fillojë hartimi dhe aplikimi e një politike kërkimore të integruar dhe të merren masa të mëtejshme për nxitjen e novacioneve dhe konkurrueshmërisë mes shoqërive të vogla.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për realizimin e prioriteteve afatmesme nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Hartimi dhe miratimi i ligjit "Për SME-të", i cili do të synojë të përfshijë rekomandimet e BE-së në fushën e SME-ve.

3.2.2 Aktivitet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Krijimi i fondit për futjen e teknologjive të reja dhe për nxitjen e inovacionit të SME-ve, fonde të cilët do të ndikojnë në rritjen e konkurrueshmërisë së SME-ve;

Gjatë vitit 2008 parashikohet të rritet numri i punonjësve (2 persona) në Drejtorinë e Nxtjes së Biznesit (DNB), të cilët do të punojnë për zbatimin e planit të veprimit për rritjen e konkurrueshmërisë së SME-ve;

Ngritja e Qendres Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit. Krijimi i kësaj Qendre do të bëhet brenda vitit 2008 dhe parashikohet që 20 punonjës të punojnë në të;

Krijimi i Agjencise së Kreditimit të Eksporteve brenda vitit 2009. Në këtë Agjenci do të parashikohet të punësohen 5 punonjës;

Forcimi i kapaciteteve të DNB-së (me një punonjës), gjatë vitit 2009, në kuadër të hartimit të një plani veprimi për politikën e përfshirjes së përgjegjësive sociale në SME.

Brenda vitit 2010 në strukturën e Alb Invest do të krijohet një strukturë ku parashikohet të punësohen 5 punonjës e cila do të punojë për krijimin e inkubatorëve teknologjikë.

Forcimi i kapaciteve të Ministrisë së Energjitikës, Tregtisë dhe Energjitikës

Ndërtimi i kapaciteteve	Viti				
	2006	2007	2008	2009	
Krijimi i strukturës për zbatimin e projektit “Për mbështetjen e SME-ve” (në 000/ Lek)	3				
Krijimi i Sekretariatit të Këshillit Konsultativ të Biznesit (në 000/ Lek)		3			
		500			
Forcimi i kapaciteteve të DNB-së për zbatimin e planit të veprimit për rritjen e konkurrueshmërisë së SME-ve (në 000/ Lek)			2		
			800		
Ngritja e Qendrës Kombëtare për Regjistrimin e Biznesit (në 000/ Lek)			20		
			2000		
Krijimi i Agjencisë së Kreditimit të				5	

Eksporteve (në 000/ Lek)				500	
Forcimi i kapaciteteve të DNB-së në kuadër të përfshirjes së përgjegjësiwe sociale në SME (në 000/ Lek)				1 00	
Krijimi i një strukture përgjegjëse për ngritjen e inkubatorëve teknologjikë (në 000/ Lek)					

3.18 ARSIMI DHE SHKENCA

3.18.1 ARSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL

1. Objektivi Politik i fushës

Fokusi kryesor i Qeverisë në fushën e arsimit dhe formimit profesional, për periudhën afatgjatë është rritja e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe trajnimit profesional, sigurimi i aksesit në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit pa diskriminim si dhe përmirësimi i strukturave të arsimit dhe trajnimit, nxitjen e harmonizimit të vendeve të PSA-s nëpërmjet zhvillimit të arsimit, zhvillimit social dhe kulturës.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria e fushës së arsimit dhe formimit profesional, rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore :

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 57

Ligji 8872, datë 29.03.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH"

Ligji nr. 7952 datë 21.06.1995 "Per sistemin arsimor parauniversitar.

Strategjia e Arsimit dhe formimit profesional

Strategjia "Politika reformuese për arsimin dhe formimin profesional"

VKM nr.543, datë 01.10.2002 "Për akreditimin e Institucioneve të arsimit dhe formimit profesional"

VKM nr.196, datë 20.03.2003. "Për standardet e zhvillimit të kurrikulave të AFP-së"

VKM nr. 616, datë 04.12.2002 "Për përcaktimin e kategorive të tjera të grupeve të veçanta që përfitojnë nga ligji nr. 8872, datë 29.03.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH".

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjisllacioni në fuqi në fushën e arsimit dhe formimit profesional, është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, me Drejtorinë e Zhvillimit të Kurrikulit, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtoria Ekonomike, është institucioni qendror, i cili menaxhon sistemin arsimor në Shqipëri

2. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Drejtoria e Politikave të Punësimit

3. **Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional**, që i sugjeron Këshillit të Ministrave politika për zhvillimin e sistemit të arsimit dhe formimit profesional duke përfshirë në këtë proces partnerët social dhe të gjithë subjektet e tjerë që veprojnë në këtë fushë

4. Drejtoritë Arsimore Rajonale, Zyrat Arsimore

5. **Instituti i Kurrikulave dhe Standarteve**

6. **Qendra Arsimore e Trainimit dhe Kualifikimit**

7. **Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimeve dhe Provimeve.**

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe ato të Axhendës së Selanikut, prioritetet afatshkurtra për fushën e arsimit dhe formimit profesional janë:

Ngritja e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe arsimit dhe trajnimit profesional

Sigurimi i aksesit në të gjitha nivelet e arsimimit dhe trajnimit pa diskriminim;

Përmirësimi i strukturave të arsimit dhe trajnimit;

Nxitja e harmonizimit të vendeve të PSA-s nëpërmjet zhvillimit të arsimit, zhvillimit social dhe kulturës.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto priorite, për periudhën 2006-2007, për realizimin e tyre, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Arsimit dhe Shkences, të cilat kanë një nivel “të pjesshëm” përputhshmërie me *acquis communautaire*:

Ndryshimi i Ligjit nr. 8872, datë 29.03.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë";

Hartimi dhe miratimi VKM-së “Për modalitetet e kryerjes së praktikave profesionale në ndërmarrje nga nxënësit e AFP -së”.

Hartimi dhe miratimi i VKM – së "Për modalitetet e kryerjes së veprimtarive ekonomike nga shkollat profesionale.”

Hartimi dhe miratimi i VKM – së "Për sistemin e kualifikimit të vazhduar të mësuesve dhe instukturëve të AFP -së”.

3.1.2. Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e angazhimeve gjatë periudhës kohore 2006-2007, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Përcaktimi i modaliteteve të kryerjes së praktikave profesionale në ndërmarrje nga nxënësit e AFP -së dhe modalitetet e kryerjes së veprimtarive ekonomike nga shkollat profesionale;

Konsolidimi i sistemit të kualifikimit të vazhduar të mësuesve dhe instukturëve të AFP -së;

Krijimi i agjensisë Kombëtare të AFP -së dhe në kuadër të këtij aktiviteti do të oganziohen trajnime të ndryshme për njohjen dhe mënyrën e funksionimit të Agjensisë, si në tabelën e mëposhtme.

Kryerja e një studimi për problemet që kanë dalë si rezultat i moszbatimit të plotë të Ligjit 8872, datë 29.03.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"

3.2 Prioritetet Afatmesme

Bazuar në angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe të Axhendës së Selanikut, prioritet afatmesme për fushën e arsimit dhe formimit profesional janë::

Ngritja e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe arsimit dhe trajnimit profesional

Sigurimi i aksesit në të gjitha nivelet e arsimimit dhe trajnimit pa diskriminim;

Përmirësimi i strukturave të arsimit dhe trajnimit;

Nxitja e harmonizimit të vendeve të PSA-s nëpërmjet zhvillimit të arsimit, zhvillimit social dhe kulturës.

3.2.1. Iniciativat ligjore afatmesme

Në përputhje me këto priorite afatmesme, për periudhën 2008-2010, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës:

Hartimi dhe miratimi i VKM-së “Për përcaktimin e niveleve të arsimit dhe formimit profesional (AFP)”, i cili ka një shkallë “të pjesëshme” përputhshmërie me *acquis communautaire*.

Hartimi dhe miratimi i VKM-së “Për sistemin e orientimit dhe këshillimit profesional”, i cili

ka një shkallë “të pjesshme” përputhshmërie me *acquis communautaire*.

Hartimi dhe miratimi i VKM-së “Për sistemin e kualifikimit fillestar të mësuesve dhe instruktorëve”, i cili ka një shkallë “të plotë” përputhshmërie me *acquis communautaire*.

3.2.2 Aktivitet zbatues afatshkurtra

Për realizimin e angazhimeve gjatë periudhës kohore 2008-2010, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Realizimi i një studimi për përcaktimin e niveleve të AFP -së dhe organizimi i trajnimeve të ndryshme për krahasimin e nevojave të tregut, me mundësitë që ofrojnë shkollat;

Përmirësimi i sistemit të orientimit dhe këshillimit profesional dhe organizmi i trainimeve e shkëmbim përvoja për sistemin e orientimit dhe këshillimit profesional;

Funksionimi i sistemit të kualifikimit fillestar të mësuesve dhe instruktorëve dhe organizimi i trajnimeve për shkëmbimin e përvojave të mësuesve dhe instruktorëve.

Tabela: Ngritja e kapaciteteve të Agjensisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP)

INVESTIME	NJESIA E MATJES	GJENDJA AKTUA LE	2007
Shtese personeli	Nepunes	0	+17

3.18.2 MOSDIKRIMINIMI NË ARSIM

1. Objektivi Politik

Fokusi kryesor i Qeverisë në fushën e mosdiskriminimit në arsim, për periudhën afatgjatë, është garantimi i aksesit në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit në të gjithë vendin dhe për të gjithë njerëzit, si dhe shmagia e paraqitjes së formave të diskriminimit mbi bazën e gjinisë, ngjyrës, origjinës etnike ose fesë.

2.Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria e fushës së mosdiskriminimit në arsim rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore :

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë , neni 57 neni 59

Deklarate Universale e të Drejtave të Njeriut.

Ligji nr. 7952 dt.21.06.1995, "Për sistemin arsimor parauniversitar", ndryshuar me ligjin nr.8367, dt.30.07.1998 "Për një ndryshim në Ligji nr. 7952 dt.21.06.1995, "Për sistemin arsimor parauniversitar".

VKM nr. 8 datë 07.01.2005, "Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara".

VKM nr. 633, datë 18.09.2003 Strategjia Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom ”

VKM Nr. 707, Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Bashkimit Evropian

VKM Nr. 760, datë 19.11.2004 "Strategjia kombëtare për migracionin"

VKM Nr. 78, datë 08.02.2006 "Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike"

Urdhëri Nr. 321, datë 11.10.2004. “Për eksperimentimin e shërbimit psikologjik në sistemin arsimor parauniversitar”,

Udhëzimi nr. 34, datë 08.12.2004 "Për zbatimin e projektit "Shansi i dytë"

Udhëzimi nr. 06, datë 29.03.2006 "Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindjeje"

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjisllacioni në fuqi në fushën e mosdiskriminimit në arsim është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

1. MASH, Drejtoria e Zhvillimit të Kurrikulave

2. MPÇSSHB

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme

Bazuar në angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe ato të Axhendës së Selanikut, prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme (2006-2010) për fushën e mosdiskriminimit në arsim janë:

Garantimi i aksesit në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit në të gjithë vendin, duke u siguruar që të mos jetë diskriminues mbi bazën e gjinisë, ngjyrës, origjinës etnike ose fesë;

Nxitja e harmonizimit të vendeve të PSA-s nëpërmjet zhvillimit të arsimit, zhvillimit social dhe kulturës.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra dhe afatmesme

Në përputhje me këto prioritate për periudhën 2006-2010, për realizimin e tyre, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, të cilat do të kenë një shkallë përputhshmërie “të pjesshme “ me *acquis communautaire*:

Hartimi e miratimi i akteve nënligjore përkatëse pas rishikimit të Dispozitave Normative të Arsimit Parauniversitar;

Hartimi dhe miratimi i Urdhërit të Ministrit “Për rregullimin e punës me PEI-në (plani edukativ i individualizuar) dhe saktësimin e procedurave të pranimit dhe të vlerësimit fillestar e në proces të nxënësve me nevoja të veçantë”;

Hartimi dhe miratimi i Urdhërit të Ministrit "Për krijimin e shërbimit psikologjik në shkollë”;

Hartimi dhe miratimi i VKM-së “Për financimin e trajnimit të kujdestarëve të PAK -së të rëndë”.

3.1.2. Aktivitet zbatuese afatshkurtra dhe afatmesme

Për realizimin e angazhimeve, gjatë periudhës kohore 2006-2010, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Akordimi i bursave për fëmijët me të ardhura të pakta familjare;

Sigurimi me rampa të pjerrëta i mjediseve të 100 shkollave dhe 90 kopshteve;

Evidentimi i gjendjes së frekuentimit të kopshteve dhe shkolla nga fëmijët romë në kuadrin e zbatimit të strategjisë për komunitetin rom ;

Ngritja e ekipeve multidisiplinare për hartimin e programeve për parandalimin e hershëm të Aftësive të Kufizuara, (rehabilitim dhe riintegrim);

Kryerja e një studimi për minimizimin e rrezikut të aftësive të kufizuara, të lindura; përgatitja e buletineve dhe materialeve me karakter divulgativ;

Ofrimi i kurseve për femijet 5-6 vjeçar për nxenesit e komunitetit Rom, për mësimin e gjuhës shqipe për t’i përgatitur për klasën e parë;

Përgatitja e një paketë me udhëzime praktike, materiale didaktike dhe standarde integruese në ndihmë të shkollave;

Zgjerimi i shërbimit psikologjik në shkollë;

Fuqizimi i kapaciteteve institucionale të Institutit të të Verbërve.

3.18.3 ARSIMI PARAUNIVERSITAR

1. Objektivi politik i fushës

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e arsimit parauniversitar është rritja e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe trajnimit profesional, sigurimi i aksesit në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit pa diskriminim mbi bazën e gjinisë, ngjyrës, origjinës, etnike ose fesë; përmirësimi i strukturave të arsimit dhe trajnimit; nxitja e harmonizimit të vendeve të PSA-se nëpërmjet zhvillimit të arsimit, zhvillimit social dhe kultures.

Qeveria është e angazhuar për të realizuar autonominë shkollore, nëpërmjet refomes arsimore në bashkepunim dhe me grupet e interesit.

Zhvillimi i arsimit do të bazohet në modelin e edukimit të vazhdueshëm duke filluar që në moshën parashkollore dhe që vazhdon gjithë jetën, si dhe dhënia e perparësive shkollave të mesme profesionale në përputhje me tendencat rajonale të zhvillimit ekonomik e të tregut të punës.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria e fushës së arsimit parauniversitar rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore :

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë , neni 57 dhe neni 59.

Deklarate Universale e të Drejtave të Njeriut.

Ligji nr. 7952 datë 21.06.1995, "Për sistemin arsimor parauniversitar", ndryshuar me ligjin

nr.8367, datë 30.07.1998 "Per nje ndryshim ne Ligji nr. 7952 dt.21.06.1995, "Për sistemin arsimor parauniversitar".

VKM Nr. 538, datë 12.08.2004 "Strategjia kombetare e zhvillimit te arsimit parauniversitar",

VKM nr. 368, datë 31.05.2005 "Strategjia kombetare per femijet"

VKM nr. 632 dt.04.10.2004 " Per Politikat e decentralizimit te sistemit te arsimit parauniversitar"

VKM nr.654 datë 25.09.2003 "Per krijimin e Institutit te kurrikulave e standardeve (IKS)",

VKM nr.309 datë 12.05.2001 "Per krijimin e qendres kombetare arsimore te vleresimit dhe provimeve".

VKM Nr. 707, datë 16.10.2003 "Per riorganizimin e drejtorive arsimore te rretheve ne Drejtori Arsimore Rajonale dhe Zyra Arsimore".

VKM Nr. 78, datë 08.02.2006 "Per krijimin e matures shteterore dhe pranimet ne shkollat e larta publike"

VKM Nr. 144, datë 08.03.2006 "Per botimin, shtypjen dhe shperndarjen e teksteve shkollore te sistemit arsimor parauniversitar"

VKM nr. 248, datë 28.05.1999 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se lejes per funksionimin e institucioneve arsimore jopublike dhe te institucioneve arsimore plotesuese jopublike ku zhvillohen lende fetare ose ku mesimi zhvillohet edhe ne gjuhe te huaj".

VKM nr. 8, datë 07.01.2005 "Strategjia kombetare e personave me aftesi te kufizuara"

VKM Nr. 760, datë 19.11.2004 "Strategjia kombetare per migracionin"

VKM nr. 633, datë 18.09.2003 "Për përmirësimin e kushtëve të jetësës se minoritetit Rom"

Urdhri Nr. 321, datë 11.10.2004. "Për eksperimentimin e shërbimit psikologjik në sistemin arsimor parauniversitar",

Udhëzim nr. 23, datë 18.10.2005 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se lejes se funksionimit per institucionet arsimore private dhe institucionet arsimore plotesuese private parauniversitare"

Udhëzimi nr. 34, datë 08.12.2004 "Per zbatimin e projektit "Shansi i dyte" per arsimimin e nxenesve qe kane braktisur shkollen dhe nxenesve te ngjuar per shkak te gjakmarrjes"

Udhëzimi nr. 06, datë 29.03.2006 "Per regjistrimin ne shkolle te nxenesve rome qe nuk jane te pajisur me çertifikate lindjeje"

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e arsimit parauniversitar është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

1. Ministria e Arsimit dhe Shkences, Drejtoria e Zhvillimit te Kurrikules, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Inspektimit.

2. Instituti I Kurrikulave dhe Standardeve, Qendra Arsimore e Trajnimit dhe Kualifikimit, Qendra Kombëtare e Arsimore e Vlerësimit dhe të Provimeve, bashkitë dhe komunat, Drejtoritë Arsimore Rajonale, Zyrat Arsimore, Kopshtet.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme

Bazuar në angazhimet e Marreveshjes se Stabilizim Asociimit dhe ato te Axhendes se Selanikut, prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme (2006-2010) për fushën e arsimit parauniversitar jane:

Ngritja e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe arsimit dhe trajnimit profesional

Sigurimi i aksesit ne te gjitha nivelet e arsimimit dhe trajnimit pa diskriminim mbi bazën e gjinisë, ngjyrës, origjinës etnike ose fesë; ;

Përmirësimi i strukturave te arsimit dhe trajnimit;

Nxitja e harmonizimit te vendeve te PSA-se nepermjet zhvillimit te arsimit, zhvillimit social dhe kultures.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto priorite, për periudhën afatshkurtër 2006-2007, për realizimin e tyre, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Arsimit dhe Shkences. Këto iniciativa do të kenë një shkallë "te pjeseshme" perputhshmerie me *acquis communautaire*.

Hartimi dhe miratimi i ndryshimi i Ligjit Nr.7952, dt.29.06.1995 "Per sistemin arsimor parauniversitar" (i ndryshuar)

Hartimi dhe miratimi i VKM-se "Per strategjine e zhvillimit te arsimit parashkollor"
Hartimi dhe miratimi i udhezimeve "Per fushen e liberalizimit te botimeve shkollore"
Hartimi dhe miratimi udhezimit "Per zbatimin e kurrikules se re ne fillim te vitit shkollore 2006-2007"

Hartimi dhe miratimi i VKM – së " Per zbatimin e TIK ne rritjen e cilesise se transmetimit dhe pervetesimit te njohurive ne implementimin e metodave bashkekohore europiane ne mesim"

3.1.2. Aktivitet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e angazhimeve gjate periudhes kohore 2006-2007, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Zbatimi i politikës se re te librave;

Krijimi i komisioneve lendore per miratimin e kurrikules se re;

Studim per gjendjen e arsimit parashkollor ne zbatim te strategjise se miratuar;

Veprimtari per zbatimin e udhezimit per zbatimin e kurrikules se re ne fillim te vitit shkollore 2006-2007;

Studimi per gjendjen e TIK dhe propozime per futjen e tyre ne sistemin arsimor;

Hartimi i kurrikules se grupit pergatitor (5-6 vjeçar);

Hartimi i moduleve te trajnimit dhe kualifikimit te mesueseve te arsimit parashkollor dhe zbatimi nepermjet pilotimit;

Përmirësimi i vlerësimit te maturaes shteterore

3.1.3. Iniciativat ligjore afatmesme

Në përputhje me prioritet në fushën e arsimit parauniversitar, për periudhën afatmesme 2008-2010, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Arsimit dhe Shkences. Këto iniciativa do të kenë një shkallë "te pjeseshme" perputhshmerie me *acquis communautaire*:

Hartimi dhe miratimi i VKM-se "Per strukturen e arsimit te mesem"

Hartimi dhe miratimi i Udhezimit "Per vendosjen ne skemen e arsimit te detyruar te grupmoshes 5-6 vjeçare bazuar ne pilotim"

Hartimi dhe miratimi i Udhezimit "Per zbatimin e kurrikules se re ne fillim te vitit shkollore"

Hartimi dhe miratimi i Udhezimit "Per shtrirjen e sherbimeve te femijerise se hershme ne zonat e marginalizuara me alternativa te reja bazuar ne pilotime"

Hartimi dhe miratimi i Urdherit "Per zbatimin e strukture dhe kurrikules se re te arsimit te mesem"

Hartimi dhe miratimi i Urdherit "Per krijimin e komisioneve lendore per rishikimin e kurrikules se re"

Hartimi dhe miratimi i Urdherit "Per shtrirjen dhe vendosja e arsimit te detyruar te grupmoshes 5-6 vjeçare ne skemen e sistemit arsimor"

Hartimi dhe miratimi i udhezimit "Per shtrirjen dhe vendosja e arsimit te detyruar te grupmoshes 5-6 vjeçare ne skemen e sistemit arsimor"

3.1.4. Aktivitet zbatuese afatmesme

Për realizimin e angazhimeve, gjate periudhes kohore afatmesme 2008-2010, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Parashikimi i masave per zbatimin e udhezimit per vendosjen ne skemen e arsimit te detyruar te grupmoshes 5-6 vjeçare bazuar ne pilotim;

Veprimtari per zbatimin e udhezimit per zbatimin e kurrikules se re ne fillim te vitit shkollore 2008-2009; Zbatimi ne arsimin e detyruar te kurrikules opsionale per TIK;

Vendosja ne skemen e arsimit te detyruar te grupmoshes 5-6 vjeçare bazuar ne pilotim; Studim per rezultatet e implementimit te maturaes shteterore;

Marrja e masave per zbatimin e urdhrat per krijimin e komisioneve lendore per rishikimin e kurrikules se re;

Shtrirja dhe vendosja e arsimit te detyruar te grupmoshes 5-6 vjeçare ne skemen e sistemit arsimor

Tabela: Shtesë e kapaciteve për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

INVESTIME	NJESIA E	GJENDJA	2006	2007	2008	2009	2010
2516							

	MATJES	AKTUALE			
Shtese personeli	Nepunes	7		+3	
Investime IT	000/leke		750	5500	18000
Investime infrastrukture	000/leke			380000	190000
Konsulence (e huaj)	000/leke				
Trajnime	000/leke		2590	4480	4402
					1302

3.18.4 ARSIMI I LARTË

1. Objektivi politik

Fokusi kryesor i Qeverisë në fushën e arsimit të lartë për periudhën afatgjatë, është arritja e objektivave të Deklaratës së Bolonjës.

Në funksion të realizimit të këtij objektivi, në periudhë afatshkurtër orientimi kryesor do të jetë ndërmarrja e reformave ekonomike në fushën e arsimit të lartë, duke u përqendruar në mënyrë të veçantë në krijimin e institucioneve, menaxhimin e universiteteve dhe realizimin e autonomisë së universiteteve.

Në periudhën afatmesme aspektet kryesore në fushën e arsimit të lartë do të jenë përkundrejt zhvillimit të burimeve njerëzore, çështjet administrative, financiare, të pronësisë, si dhe në rritjen cilësore dhe masivizimin e arsimit të lartë. Ky proces do të mbështetet edhe nga iniciativa private.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria e fushës së Arsimit të Lartë rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore :

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë , neni 57

Ligji Nr. 8461, datë 25.02.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”

VKM Nr. 694, datë 21.10.1996 “Për normën mësimore e shkencore në shkollat e larta dhe në arsimin parauniversitar, pagimin e orëve suplementare, aktivizimin e pensionistëve dhe punonjësve të jashtëm në sistemin e arsimit”.

VKM. Nr. 19, datë 06.01.1997 “Për funksionimin e kurseve të Kualifikimit dhe Specializimit pranë shkollave të larta”.

VKM Nr. 786, datë 17.12.1998 “Për kualifikimin shkencor, pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve pedagogjikë dhe kërkimorë”.

VKM Nr. 303, datë 01.07.1999 “Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë”.

VKM Nr. 14, datë 19.10.1995 “Për normat mësimore të punës në shkollat e larta”.

VKM Nr. 29, datë 26.10.1998 “Për modalitetet e paraqitjes së propozimeve për hapjen e kurseve të studimit dhe njësive mësimore-shkencore në shkollat e larta”

Udhëzim Nr. 17, datë 10.08.1999 ‘Për kurset e specializimit dhe të kualifikimit pasuniversitar”.

Udhëzim Nr. 18, datë 10.08.1999 ‘Për kualifikimin shkencor pasuniversitar”

Udhëzim Nr. 22, datë 08.1999 ‘Për standardet e krijimit të seksioneve dhe të departamenteve”.

Udhëzim Nr. 36, datë 17.11.1999 ‘Për normat mësimore të punës në shkollat pasuniversitare (SHPU)”.

Udhëzimi Nr. 29, datë 08.10. 2004 “Për zgjedhjen e Qeverisë Studentore në shkollat e larta universitare

Udhëzim Nr. 18, datë 29.07.2004 “Për standardet e strukturave akademike”.

Udhëzim Nr. 2, datë 17.02.2006 "Për procedurat e pranimeve në shkollat e larta për vitin akademik 2006-2007 në sistemin me kohë të plotë"

Urdhër Nr. 63, datë 22.02.2006 "për fillimin e regjistrimeve në shkollat e larta për vitin akademik 2006-2007 në sistemin me kohë të plotë"

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e Arsimit të Lartë, është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

1. MASH, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Njohjes së Kualifikimeve

2. Agjensia e Akreditimit të Arsimit të Lartë,, qëllimi i së cilës është të mbledhë kërkesat për vlerësimin dhe akreditimin e kurrikulave dhe institucioneve, përcakton treguesit e vlerësimit, kryen

vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm, përgatit materialin për këshillin e Akreditimit. Inspektimi kryhet nga një strukturë në dy nivele: në nivelin qendror nga Drejtoria e Inspektimit dhe nga sektorët e inspektimit në 13 qarqe. Në total është një personel prej 128 specialistësh që kryen vlerësimin e jashtëm të sistemit arsimor parauniversitar publik dhe jopublik. Në nivelin universitar, Drejtoria e Arsimit të Lartë kryen edhe inspektimin e shkollave të larta

3. Universitetet

4. MPJ, Drejtoria e Bashkimit European

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra dhe aftamesme

Bazuar në angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe ato të Axhendës së Selanikut, prioritetet afatshkurtra dhe aftimesme (2006-2010) për fushën e Arsimit të Lartë janë:

Arritja e objektivave të Deklaratës së Bolonjës

Zhvillimi i burimeve njerëzore të shoqërisë civile dhe reformave ekonomike në fushën e arsimit të lartë, duke u përqëndruar në mënyrë të veçantë në krijimin e institucioneve, menaxhimin e universiteteve dhe realizimin e autonomisë së tyre, veçanërisht në aspektet administrative, financiare e pronësore,

Rritjen cilësore dhe masivizimin e arsimit të lartë, i cili do të mbështetet edhe nga iniciativa private në këtë fushë.

Nxitja e harmonizimit të vendeve të PSA-s nëpërmjet zhvillimit të arsimit, zhvillimit social dhe kulturës.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritate për periudhën 2006-2007, për realizimin e tyre, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Këto iniciativa do të kenë një nivel “të pjesshëm” perputhshmerie me *acquis communautaire*.

Hartimi dhe miratimi i Projektligjit “Për Arsimin e Lartë”

Hartimi dhe miratimi me VKM i “Strategjisë dhe Reformimit të Arsimit të Lartë Shqiptar”

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Për Reforma në arsimin e lartë për zbatimin e parimeve dhe qëllimet e “Deklaratës së Bolonjës” për të arritur standardet europiane”

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Për pranimet e studentëve në ciklin e parë të studimeve në universitete”

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Për pranimet e studentëve në ciklin e dytë "master" të studimeve në universitete”

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Për Master Planin e zhvillimit të Arsimit të Lartë”

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Për vlerësimin dhe akreditimin në arsimin e lartë”

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Për pjesëmarrjen e stafëve akademike në sipërmarrje”

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Për ciklin e tretë të studime doktorature sipas standardeve të procesit të Bolonjës”

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Për heqjen e tarifave të shkollimit për kategori të caktuara sociale”.

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Për transferimin e pikëve të krediteve (ECTS)”

Hartimi dhe miratimi i VKM – së “Për formimin e kornizës kurrikulare mbi bazën e standardeve europiane”.

3.1.2. Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e angazhimeve gjatë periudhës kohore 2006-2007, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Krijimi i grupit të punës për ndjekjen e procesit të Bolonjës si dhe krijimi i grupeve të punës për ndërtimin e kurrikulave të reja në përputhje me ciklet e studimit;

Realizmi i vlerësimit të Agjensisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë nga Agjensia Europiane e Sigurimit të Cilësisë, sipas kërkesave të Bolonjës;

Organizimi i takimeve me shkollat e larta për përmirësimin e sistemit të pranimeve në to, dhe rekrutimin e stafit të ri akademik;

Organizimi i seminareve për përsosjen e sistemit të doktoraturave dhe të kurseve të specializimit;

Organizimi i seminareve për përmirësimin në vijimësi të kurrikulës në sistemin "Bachelor".

3.1.3 Iniciativat ligjore afatmesme

Në përputhje me prioritetet për Arsimin e Lartë, për periudhën afatmesme 2008-2010, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës:

Hartimi dhe miratimi i VKM-së “për legalizimin e pronave të universiteteve dhe shkollave të larta”

Hartimi dhe miratimi i VKM-së “Për transferimin e studimeve”

Hartimi dhe miratimi i VKM-së “Për titujt akademik”.

Hartimi dhe miratimi i VKM-së “Për Reforma në arsimin e lartë për zbatimin e parimeve dhe qëllimet e “Deklaratës së Bolonjës” për të arritur standardet europiane

Hartimi dhe miratimi i VKM-së “Për Vlerësimin dhe akreditimin sipas standardeve të ENQA(Rrjeti Evropian i Sigurimit të Cilësisë)

Hartimi dhe miratimi i VKM-së “Për hyrjen në sistemin evropian të studimeve”

3.1.4 Aktivitet zbatues afatshkurtra

Për realizimin e angazhimeve gjatë periudhës kohore afatmesme 2008-2010, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Reformimi i kurrikulës mbi bazën e standardeve europiane,

Realizimi i studimeve dhe takimeve për përmirësimin e strukturave akademike dhe rritjen e kapaciteteve të shkollave të larta;

Zbatimi i Master Planit të Arsimit të Lartë;

Përmirësimi i doktoraturave dhe kurseve të specializimit;

Krijimi dhe zbatimi i standarteve evropiane në fushat e studimeve universitare dhe pasuniversitare;

Organizmi i seminareve dhe takimeve për konsolidimin e strukturave akademike dhe rritja e kapaciteteve të shkollave të larta;

Përfshirja cilësore në rrjetin evropian të arsimit të lartë;

Tabela:Shtesë e kapaciteve për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

<i>INVE</i>	<i>N</i>	<i>GJ</i>	<i>2</i>	<i>2</i>	<i>2</i>	<i>2</i>	<i>2</i>	<i>2</i>
<i>STIME</i>	<i>JESIA</i>	<i>ENDJA</i>	<i>006</i>	<i>007</i>	<i>008</i>	<i>009</i>	<i>010</i>	<i>2</i>
<i>MATJES</i>	<i>AKTUALE</i>							
Shtese	N	5		+	+	+	+	-
personeli	epunes		35	15	93	30	10	
Invest	00			3	1	8	6	1
ime IT	0/leke		0000	5000	05000	0000	00000	
Invest	00					1	7	5
ime	0/leke				700000	00000	00000	
infrastruktura								
Konsu	00							
lence (e huaj)	0/leke							
Trajni	00							
me	0/leke							

3.18.5 KËRKIMI SHKENCOR

1. Objektivi politik i fushës

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e kerkimit shkencor për periudhën afatgjatë është inkurajimi i bashkëpunimit në kerkimet civile shkencore dhe zhvillimin teknologjik (KZHT). Ky bashkëpunim mendohet të bëhet mbi bazën e përfitimit të ndërsjelltë, hyrjes në programet përkatëse, si dhe nxitjes së vendeve të përfshira në procesin e Stabilizim-Asocimit për shkëmbim përvojash në kuadër të zhvillimit të arsimit, zhvillimit social dhe kulturës.

2.Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria e fushes se arsimit dhe formimit profesional, rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore :

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë , neni 57

Ligji nr. 7893, datë 22.12.1994, "Për shkencën dhe Zhvillimin Teknologjik" , i ndryshuar me

ligjin nr. 8401, datë 09.09.1998

Ligji nr. 9182, datë 05.02.2004, "Për Akademinë e Shkencave"

Ligji Nr. 8461, datë 25.02.1999 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë"

VKM nr. 567, datë 23.10.1995, "Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të veprimtarisë Shkencore e Teknologjike"

Udhëzim nr. 5, datë 29.06.1995, "Për mënyrën e paraqitjes së raporteve shkencore (studimeve) për projektet që financohen në kuadrin e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit"

Udhëzim nr. 6, datë 19.10.1995, "Për mënyrën e raportimit mbi zbatimin e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit"

Udhëzim nr. 3, datë 10.06.1996, "Për vlerësimin e Projekteve që financohen në kuadrin e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit"

Udhëzim nr. 4, datë 24.06.1996, "Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit"

Udhëzim nr. 25, datë 01.10.1998, "Për procedurën e paraqitjes, shqyrtimit dhe miratimit të projekteve që financohen në kuadrin e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit".

Udhëzim nr. 11, datë 16.06.2005, "Për procedurën e paraqitjes, shqyrtimit dhe miratimit të projekteve që financohen në kuadrin e Programeve të Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik me vendet e tjera".

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e arsimit dhe formimit profesional, është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Kërkimit Shkencor, është institucioni qendror i cili menaxhon sistemin arsimor dhe kërkimin shkencor në Shqipëri;

2. Ministria e Shëndetësisë, Sektori i Politikave

3. Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Keshillimit dhe Shkencës.

4. Ministria e Ekonomisë Tregtise dhe Energjitikës, Drejtoria e Pegjithshme.

5. Akademia e Shkencave, Drejtoria e Projekteve.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme

Bazuar në angazhimet e Marreveshjes së Stabilizimit Asociimit dhe ato të Axhendes së Selanikut, prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme (2006-2010) për fushën e kërkimit shkencor janë:

Inkurajimi i bashkëpunimit në kërkimet civile shkencore dhe zhvillimin teknologjik (KZhT) mbi bazën e përfitimit të ndërsjellë dhe duke marrë parasysh burimet ekzistuese, hyrje të përshtatshme në programet e tyre përkatëse, në qoftë se ka nivele të përshtatshme të mbrojtjes efikase të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare (DPI);

Nxitja e harmonizimit të vendeve të PSA-së nepermjet zhvillimit të arsimit, zhvillimit social dhe kultures.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra dhe afatmesme

Në përputhje me këto prioritete, për periudhën afatshkurtër 2006-2007, për realizimin e tyre, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës:

Ndryshimi i ligjit Nr. 7893, datë 22.12.1994, "Për shkencën dhe Zhvillimin Teknologjik", i ndryshuar me ligjin Nr. 8401, datë 09.09.1998, i cili do të ketë një nivel përputhshmërie të "pjeseshme" me *acquis communautaire*.

Ndryshimi i ligjit Nr. 9182, datë 05.02.2004, "Për Akademinë e Shkencave"

Hartimi dhe miratimi i akteve të reja nënligjore për zbatimin e ndryshimeve të Ligjit nr. 7893, datë 22.12.1994, "Për shkencën dhe Zhvillimin Teknologjik", i ndryshuar me ligjin Nr. 8401, datë 09.09.1998, të cilat do të kenë një shkallë përputhshmërie "të pjeseshme" me *acquis communautaire*;

Hartimi dhe miratimi i akteve të reja nënligjore për zbatimin e ndryshimeve të ligjit Nr. 9182, datë 05.02.2004, "Për Akademinë e Shkencave".

3.1.2. Aktivitet zbatues afatshkurtra dhe afatmesme

Për realizimin e prioritetëve, gjatë periudhës kohore 2006-2010, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore –shkencore, çdo vit;

Hartimi dhe aplikimi për projektet në fushën e kërkimit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar,

çdo vit;

Organizimi i konferencave, seminareve etj, në zbatim të ligjit nr. 7893, datë 22.12.1994, "Për shkencën dhe Zhvillimin Teknologjik", çdo vit.

Tabela: Shtesë e kapaciteteve për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

INV	N	GJ
ESTIME	JESIA E	ENDJA
	MATJES	AKTUALE

006

Shtes	N	6
e personeli	epunes	

3.19 TELEKOMUNIKACIONI

1. Objektivi politik

Qeveria shqiptare e konsideron telekomunikacionin dhe teknologjinë e informacionit si faktorë thelbësorë për një zhvillim të shpejtë e modern të vendit dhe integrimin e tij në Evropë. Qeveria do të ndërmarrë reforma që hapin tregun e telekomunikacioneve dhe të teknologjisë së informacionit që sjell rritjen e investimeve private në këtë sektor, rritjen e aksesit në shërbime dhe rritjen e cilësisë së këtyre shërbimeve. Për këtë qëllim qeveria do të bëjë efektiv krijimin e një tregu konkurrues në fushën e komunikacioneve nëpërmjet iniciativave ligjore dhe institucionale, në rritjen e përgjegjshmërisë dhe efikasitetit të Entit Rregullator pa cënuar autonominë e tij, hapjen e tregut për operatorë të rinj të shërbimit celular dhe atij fiks, sigurimin e aksesit të barabartë të interkonjeksionit për të gjithë operatorët në rrjetet e operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Veprimtaria në fushën e telekomunikimit në Shqipëri rregullohet në bazë të akteve të mëposhtme ligjore dhe nënligjore:

Ligji nr.8618, datë 14.06.2000 "Për telekomunikacionin në Republikën e Shqipërisë". Ky ligj është plotësisht i përputhur me paketën ligjore të BE-së në fushën e telekomunikacioneve;

Ligji nr.8430, datë 14.12.1998 "Për ratifikimin e Kushtetutës dhe Konventës së Bashkimit Ndërkombëtar të telekomunikacioneve, ITU (Gjenevë, 1992)";

Ligji nr. 9370, datë 14.4.2005, "Për ratifikimin e instrumentave që ndryshojnë Kushtetutën dhe Konventën e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit";

VKM nr. 288, datë 18.6.1999 "Për miratimin e dokumentit të politikave të zhvillimit të sektorit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë";

VKM nr. 311, datë 5.7.1999 "Nje shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 18.6.1999 "Për miratimin e dokumentit të politikave të zhvillimit" e ndryshuar;

VKM nr. 216, datë 10.04.2003 "Strategjia Kombëtare e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit";

VKM nr. 379, datë 31.5.2001 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Radiofrekuencave", e ndryshuar.

2.2 Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacionit në fuqi në fushën e telekomunikimit, ushtrohet nëpërmjet këtyre institucioneve:

1. Drejtoria e Politikave të Postë-Telekomunikacionit në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit është përgjegjëse për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e telekomunikacioneve.

Për përmbushjen e objektivave të politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve kjo Drejtori ka si mision:

Hartimin e projektakteve ligjore e nënligjore për zhvillimin e sektorit të telekomunikacioneve; Harton plane për zhvillimin e telekomunikacioneve;

Mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore nga të gjithë operatorët publike të telekomunikacioneve;

Ndjek zbatimin e detyrimeve ligjore ndërkombëtare për sektorin e telekomunikacioneve ku Republika e Shqipërisë është palë;

Bashkërendon punën për hartimin e planit kombëtar të radiofrekuencave, për realizimin e nevojave të institucioneve shtetërore si dhe për shërbimet kombëtare të radiondërlidhjes bregdetare.

2. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve (ERT) është institucioni që mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga legjislacioni në fushën e telekomunikimit.

Në përmbushje të funksionit të tij Enti ka këto kompetenca:

Liçenson dhe mbikëqyr respektimin e kushteve të liçensave;

Rregullon interkonjeksionin e rrjeteve të telekomunikacioneve;

Kontrollon cilësinë e shërbimeve të ofruara nga operatorët në përputhje me standartet e caktuara;

Garanton konkurrencen ndërmjet operatorve të telekomunikacioneve mbështetur në parimet e transparencës, të mosdiskriminimit dhe ndershmërisë;

Harton dhe miraton planin kombëtar të numeracionit dhe siguron zbatimin e tij;

Kontrollon pajisjet e importuara të telekomunikacioneve dhe siguron përshtatjen e atyre që prodhohen në vend;

Cakton radiofrekuencat për çdo përdorues civil, me përjashtim të operatorëve radio televizivë.

2.3 Asistenca e Huaj

Për zhvillimin e sektorit të telekomunikimit, aktualisht nuk ka asistencë të huaj.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Evropian, si dhe angazhimet që derivojnë nga MSA-ja, prioritetet afatshkurtra për fushën e telekomunikimit janë:

Të sigurohet zbatimi i legjislacionit të komunikimeve elektronike dhe të bazohet në direktivat e BE-së.

Forcimi i kapaciteteve dhe rolit të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, të sigurohet pavarësia e tij dhe të krijohet një sistem i përmirësuar apelimi.

Marrja e masave për të garantuar konkurrencën në tregun e rrjeteve të komunikimit elektronik dhe shërbimeve.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritate afatshkurtra, si dhe në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*, në fushën e telekomunikimit, do të ndërmerren këto iniciativa ligjore:

VKM "Për miratimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave për operatorët celularë me fuqi të ndjeshme në treg";

Amendimi i ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë";

Miratimi i dokumentit të ri të zhvillimit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë;

Tre aktet e mësipërme do të shërbejnë për forcimin e legjislacionit kombëtar në fushën e telekomunikimit dhe do të jenë plotësisht të përputhura me:

Rregulloren (EC) nr. 2887/2000,

Direktivën 2002/21/EC,

Direktivën 2002/19/EC,

Direktivën 2002/20/EC,

Direktivën 2002/22/EC,

Direktivën 2002/77/EC,

Direktivën 2002/58/EC,

Direktivën 1999/5/EC

Vendimin nr/2002/EC.

Projektligj "Për Ratifikimin e Radio Rregulloreve të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve"

3.1.2 Aktivitet zbatues afatshkurtra

Për realizimin e prioriteteve afatshkurtra, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

- Fuqizimi i sektorit të telekomunikacionit në Drejtorinë e Politikave të Postë Telekomunikacionit;
- Fuqizimi i kapaciteteve të ERT-së;
- Përmirësimi i kuadrit rregullator për liçencimin e operatorëve të rinj të TKL në një treg plotësisht të liberalizuar;
- Hartimi i metodologjisë për kontrollin e tarifave të Operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT);
- Studim mbi përdorimin e frekuencave të përcaktuara për shërbimin wireless;
- Vënia në funksionim e qendrës së lëvizshme të monitorimit të frekuencave dhe blerja e paisjeve të saj;
- Blerja e programit të administrimit të frekuencave;
- Blerje pajisjesh dhe transferim i domain-it cc TLD;
- Ndërtimi i shtesës së godinës;
- Rekrutimi i 5 punonjësve dhe kualifikimi i tyre;
- Hartimi dhe implementimi i legjislacionit sekondar (procedura, rregullore liçencimi dhe kuadri rregullator mbështetës);
- Studimi dhe ngritja e Qendrës Kombëtare të monitorimit të spektrit të frekuencave;
- Studim për transferimin dhe implementim e projektit për administrimin e adresave kombëtare në fushën e komunikimeve përmes Protokollit IP (cc.TLD 'Country Code Top Level Domain Name'. Al');
- Hartimi metodologjive për llogaritjen e kostonë së operatorit të rrjetit fiks dhe operatorëve të telefonisë së lëvizshme për shërbimet e rrjetit me shumicë dhe pakicë.

3.2 Prioritetet afatmesme

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Evropian, dhe detyrimet e MSA-së, prioritet afatmesëm për fushën e telekomunikimit është përafrimi i plote legjislacionit vendas me acquis në fushën e komunikacioneve elektronike.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Me qëllim realizimin e prioritetit të adresuar nga Partneriteti Evropian, gjatë periudhës afatmesme do të merren këto iniciativa ligjore:

Amendimi i Planit Kombëtar të radiofrekuencave duke reflektuar aktet finale të Konferencës Botërore të Radiokomunikacionit (WRC-07)

Projektligj "Për ratifikimin e Radio Rregulloreve të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve të amenduar në Konferencën Botërore të Radiokomunikacionit (WRC-07)"

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Duke qenë se prioriteti i adresuar nga Partneriteti Evropian për fushën e telekomunikimit për periudhën afatmesme ka të bëjë me transpozim të kuadrit ligjor, gjatë kësaj periudhe nuk do të ndërmerren aktivitete zbatuese.

Tabela: Shtesë e kapaciteteve për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Entit Rregullator të Telekomunikacioneve

INVESTIME	NJESIA	E	gJENDJA	2	2	
	MATJES		AKTUALE	006	007	
Rritja e numrit të punonjësve	person		2 45	) +10	B) +2	A
A)MPPTT						B
B) ERT					) +5	
Trajnime	000 lek			B		B
A) MPPTT				) 3000	) 11000	
B)ERT						
Investime (paisje, ndërtesa)	000 lek			B) 60000	a) 3690	

A)MPPTT			b
B)ERT			) 220000
IT	000 lek	B	a)
A)MPPTT		) 13300	738
B) ERT			
Konsulenca-Studime	000 lek	B	B
A) MPPTT		) 21960	) 60000
B) ERT			

3.20 TURIZMI

Objektivi politik i fushës

Zhvillimi i turizmit duke qenë i lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, është një fushë prioritare për Qeverinë Shqiptare. Angazhimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, Neni 94, për Qeverinë Shqiptare, kanë të bëjnë me bashkëpunimin me BE-në, me qëllim përmirësimin e rrjedhjes së informacionit mbi turizmin (nëpërmjet rrjeteve ndërkombëtare, bazave të të dhënave), dhe transferimin e ekspertizës (nëpërmjet trajnimeve, shkëmbimeve, seminareve), duke u mbështetur në pjesën e duhur të *acquis communautaire* që lidhet me këtë sektor.

Qeveria Shqiptare ka hartuar dokumentin “Strategjia për Zhvillimin e Turizmit 2002-2012”, ku përcaktohen orientimet strategjike të zhvillimit të turizmit. Kjo strategji nevojitet të zhvillohet më tej për t’u plotësuar me vlerësimin e impaktit mjedisor dhe me planin afatgjatë të veprimit.

2 Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Në fushën e turizmit ekziston vetëm një ligj specifik:

Ligji nr. 7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, i cili jep bazën ligjore për zhvillimin dhe stimulimin e investimeve turistike.

Aktet nënligjorë të cilët rregullojnë veprimtarinë e regjistrimit, standardizimit dhe licencimit të agjencive turistike dhe njësive akomoduese janë:

VKM nr 88 datë 01.03.1993 “Për miratimin e zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit”;

VKM nr.518 datë 12.08.1996 “Për kategorizimin, klasifikimin dhe regjistrimin e njësive akomoduese”, ndryshuar me VKM nr.279 datë 8.05.2003, VKM nr.685 datë 25.09.2003 dhe me VKM nr.218 datë 04.04.1998;

VKM nr. 356 datë 25.03.1996 “Për rregullimin e kohës së punës dhe pushimit në hotelet; restorantet dhe ndërmarrjet që plotësojnë nevojat e turizmit”;

VKM nr. 240 datë 06.06.2002 “Për mënyrën e ndarjes së të ardhurave që vijnë nga marrëveshjet e qirasë së personave të stimuluar në fushën turistike”;

VKM nr. 242 datë 03.07.2003 “Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të turizmit në Shqipëri deri në vitin 2012”;

VKM nr. 802 datë 19.12.2005 “Për përbërjen, funksionet, detyrat, përgjegjësitë dhe organizimin e brendshëm të Këshillit të Zhvillimit të Turizmit”.

2.2 Kuadri institucional

Ministria e Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve është institucioni përgjegjës për fushën e turizmit. Objektivat dhe veprimtaritë kryesore të kësaj ministrie janë realizimi i një kuadri të plotë ligjor për fushat përbërëse të zhvillimit dhe veprimit të industrisë turistike dhe përafrimit të tij me standardet e BE-së. Ky objektivi është në funksion të arritjes së një zhvillimi të qëndrueshëm në turizëm, duke përfshirë aspekte të ndryshme të tij si: investimet, planifikimi, klasifikimi, regjistrimi, standardizimi, licencimi, paketat turistike (të udhëtimeve, pushimeve, tureve), regjistrimi në NJAT, sistemi i certifikimit për turizmin e qëndrueshëm, përkufizimi i llojeve të strukturave turistike, mbledhja dhe përpunimi i informacionit, incentivat, format e turizmit, etj.

Strukturat në varësi të MTKRS, të cilat kanë si objekt të punës së tyre turizmin, janë:

Drejtoria e Zhvillimit të Turizmit, e cila ka për detyrë stimulimin dhe nxitjen e investimeve në turizëm;

Drejtoria e Shërbimeve në Turizëm, e cila është përgjegjëse për licencimin e njësive akomoduese, agjencive turistike dhe mjeteve të transportit për qëllime turistike;

Enti i Turizmit, i cili është i ngarkuar me promocionin dhe monitorimin e investimeve.

Zyrat rajonale për Turizmin funksionojnë pranë qarqeve dhe kanë për detyrë raportimin e të

dhënave për turizmin.

MTKRS bashkëpunon me Shoqatën e Agjencive Turistike dhe Shoqatën Hoteliere, për çështje të ndryshme të turizmit.

2.3. Asistenca e Huaj

Në fushën e turizmit, Qeveria shqiptare ka përfituar asistencë për hartimin e:

Ligjit nr. 7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, hartuar me asistencë të Bankës Europiane për Zhvillim dhe Rindërtim (viti 1993);

Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit 2002-2012, hartuar me asistencë të Agjencisë Gjermane për Zhvillim (GTZ);

Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Zhvillimin e Turizmit Kulturor dhe Natyror, hartuar në bashkëpunim me UNDP (2005).

Aktualisht MTKRS do të përfitojë asistencë dhe financim për rishikimin dhe hartimin e kuadrit ligjor për turizmin, nga Organizata Botërore e Turizmit nëpërmjet Organizatës Holandeze për Zhvillim, SNV (50 000 euro).

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2006-2009 janë si më poshtë:

Përmirësimi dhe hartimi i kuadrit ligjor në turizëm në përputhje me standardet e BE-së;

Përcaktimi i planit të veprimit strategjik afatgjatë;

Përmirësimi i sistemit të planifikimit të zonave turistike;

Rivlerësimi i zonave të degraduara bregdetare me prioritet zhvillimin e turizmit;

Zhvillimi i infrastrukturor.

3.1.1 Iniciativat ligjore

Për adresimin e prioritetëve do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Hartimi i një ligji të ri për turizmin, i cili do të përafrojë direktivat: 90/314/EEC, mbi paketën e udhëtimeve, paketën e pushimeve dhe paketën e tureve; 95/57/EC, mbi mbledhjen e informacionit statistikor në fushën e turizmit; si dhe Vendimin 99/35/EC, mbi procedurat për implementimin e direktivës 95/57EC, mbi mbledhjen e të dhënave statistikore në fushën e Turizmit;

Hartimi i VKM-ve, në zbatim të ligjit të ri për turizmin.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese

Për adresimin e prioritetëve do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e sistemit të informacionit dhe grumbullimit e përpunimit të të dhënave, sipas standardeve ndërkombëtare;

Analizë e legjislacionit ekzistues;

Përgatitja e përmbledhjes së legjislacionit veprues në fushën e turizmit.

Tabela 1

FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË STRUKTURAVE QË VEPROJNË NË FUSHËN E TURIZMIT

AKTIVITETI	2006	2007	2008
Ngritje/forcim struktur e (shtim persona sh)			
Trajnime			

3.21 POLITIKAT AUDIO-VIZUALE

1. Objektivi Politik

Fusha e politikave audiovizuale ka një rëndësi të veçantë në procesin e integritetit të vendit tonë në BE, për shkak të detyrimeve të rëndësishme që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Neni 102 i MSA-së, “Bashkëpunimi në fushën Audiovizive” përcakton disa drejtime për bashkëpunimin në këtë fushë, siç janë: realizimi i programeve për trajnimin e gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të cilët punojnë në fushën e mediave; dhënia e ndihmës teknike mediave private dhe publike, me qëllim forcimin e pavarësisë dhe profesionalizmit të tyre; si dhe rritja e bashkëpunimit të tyre me mediat europiane. Një tjetër aspekt shumë i rëndësishëm i Nenit 102 të MSA-së, është detyrimi për harmonizimin e legjislacionit audiovizual me *Acquis*, si dhe përafrimin me politikën e BE-së, në lidhje me rregullimin e përmbajtjes së transmetimeve ndërkufitare. Gjithashtu, kërkohet që një kujdes i veçantë duhet t’i kushtohet respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, në transmetimin e programeve nga operatorë të ndryshëm, tokësor, satelitorë, dhe kabllorë.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Kuadri ligjor për fushën e Politikave Audiovizuale përbëhet nga ligji aktual “Per Radion dhe Televizionin në RSH”, i cili ka përmbushur dhe zgjidhur nevojat me të domosdoshme për rregullimin e veprimtarisë radiotelevizive dhe gjithashtu asaj programore. Amendimet e herëpashershme të këtij ligji i kanë dhënë kompetenca me të gjera KKRT-se, kryesisht për garantimin e konkurrencës së ndershme në kuadrin e sigurimit të programeve në mënyrë të ligjshme dhe minimizimit të piraterisë

Ligji Nr. 8410, datë 30.9.1998 “Per Radion dhe Televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin Nr. 8794, datë 10.5.2001; Ligjin nr. 8655, datë 31.7.2000; dhe me Ligjin nr. 9531, datë 11.05.2006

Ligji Nr. 8435 datë 28.12.1998 “Per sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohen: Taksa për përdorimin e aparateve radiotelevizive, dhe Taksa vjetore për licencimin e transmetimeve radiotelevizive

2.2 Kuadri institucional ekzistues

Organi rregullator për transmetimet radio e televizive është **Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit**, i themeluar në vitin 1999, mbështetur në ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998 “Per radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”. Ligji garanton pavarësinë e organit rregullator. KKRT në fund të çdo viti i paraqet Kuvendit të Shqipërisë, Raportin Vjetor të Veprimtarisë.

Pranë **KKRT-se**, vepron **Këshilli i Ankesave për Radion dhe Televizionin**, i cili është një organizëm këshillimor. Këshilli i Ankesave caktohet nga KKRT-se, dhe përbehet nga kryetari dhe 2 anëtarë, specialiste të fushës së medias, të cilët emërohen për një periudhë 3-vjeçare. Objekti i punës së Këshillit të Ankesave është sensibilizimi i opinionit publik për të ndërgjegjësuar entet radiotelevizive publike dhe private, që të zbatojnë normat morale dhe etike në programet e tyre.

Pranë Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit vepron administrata e tij, e cila realizon gjithë veprimtarinë e nevojshme administrative në shërbim të Këshillit.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera

KKRT bashkëpunon me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për çështjet lidhur me të Drejtat e Autorit. KKRT ka si qëllim të ndjeke kontratat që lidhin televizionet me shoqëritë distributore, por nuk ka kompetenca të ndërhyjë në rast shkeljeje.

KKRT bashkëpunon gjithashtu dhe me Policinë Tatimore, e cila zbaton vendimet e KKRT -se.

KKRT, nëpërmjet bashkëpunimit me ERT (Entin Rregullator të Telekomunikacioneve) dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, janë të angazhuar për vendosjen e rregullave për importin e pajisjeve për transmetime audiovizuale.

Rëndësi të veçantë ka dhe bashkëpunimi i KKRT -se me institucionet homologe të vendeve fqinje për koordinimin e frekuencave, në zbatim të detyrimeve që lindin nga aderimi në organizmat ndërkombëtare si ITU (International Telecommunication Union).

2.3. Asistenca teknike dhe financiare

Aktualisht nuk ka asnjë projekt ekzistues për asistence teknike dhe financiare.

3. Adresimi i prioriteteve

3.1. Prioritetet afatshkurtra (2006 – 2007)

Prioritetet e përcaktuara për periudhën 2006-2007 janë si më poshtë:

Të shtrëngohet legjislacioni i komunikimeve elektronike dhe të bazohet në direktivat e BE-së.

Të merren masa për të garantuar konkurrencën në tregun e rrjeteve të komunikimit elektronik dhe shërbimeve.

Të fillojë procesi i harmonizimit me Konventën Europiane të Televizionit Ndërkufitar dhe me direktivën e Televizionit pa Kufi.

Të përforcohen kapacitetet administrative të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit dhe të finalizohet Plani Kombëtar për Radion dhe Televizionin.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Amendimi i ligjit 8410 dt 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat ne Republikën e Shqipërisë”

Per sigurimin e pavaresise dhe efektivitetit te plote veprues te KKRT -se;

Per krijimin e operatoreve rajonale;

Per sigurimin e transparencës për pronësinë mbi mediat dhe;

Për shmangien e monopoleve.

Këto amendime do të mbështeten tek Rekomandimi i Këshillit të Europës. (2000) 23 “Mbi pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregullatore për sektoret e transmetimit”si dhe tek direktivat: 2002/19/EC (Access Directive); 2002/20/EC (Authorisation Directive); 2002/21/EC (Framework Directive); 2002/22/EC (Universal Service Directive), të 7 Marsit 2002.

Përmirësimi i projekt ligjit “Për eksperimentimin e transmetimeve numerike ne Republikën e Shqipërisë”

Hartimi i Dokumentit të Politikës së Zhvillimit të Transmetimeve Radio e Televizive ne Republikën e Shqipërisë

Ratifikimi i Marrëveshjes RRC-06 “Për planifikimin e transmetimeve tokësore numerike ne pjese te Rajoneve 1 dhe 3 ne brezat frekuencore 174-230 MHz dhe 470-862 MHz”.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Përmirësimi i skemës organizative të KKRT -se

Studim mbi pronësinë mbi mediat dhe masat për parandalimin e monopoleve

Miratimi i Kodit të Sjelljes së Anëtareve dhe Administratës

Përgatitja e rregullores së licencimit të operatoreve të rrjetit e programeve numerike.

Përgatitja e dokumentacionit dhe procedurave të organizimit të garës.

Hartimi i Dokumentit të Politikës së Zhvillimit të Transmetimeve Radio e Televizive ne Republikën e Shqipërisë,

Përgatitja e raportit dhe konkluzioneve mbi zhvillimin e RRC-06 dhe Planit të Frekuencave bashkëngjitur.

Finalizimi i Planit të transmetimeve analoge e numerike të Shqipërisë.

Përgatitja e Planit të veprimit për zbatimin e Planit të Frekuencave të miratuar në RRC-06

Përgatitja e Planit të Caktimeve numerike shqiptare

Organizim i punës për njohjen e propagandimin e Planit dhe masave për zbatimin

3.2. Prioritetet afatmesme (2008-2009)

Prioritetet e përcaktuara për periudhën 2008-2009 janë si më poshtë:

Të ndahen frekuencat televizive në mënyrë të drejtë dhe jodiskriminuese dhe në përputhje me Planin Kombëtar; transmetuesit të përmbushin plotësisht kriteret.

Të përmirësohet paanshmëria e kompanisë së televizionit shtetëror.

Të transpozohet dhe më tej dhe të zbatohet kuadri –BE-së për komunikacionet elektronike.

Të vazhdohet me procesin e harmonizimit me Konventën Europiane të Televizionit Ndërkufitar dhe direktivën e Televizionit pa Kufi.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Amendimi i ligjit 8410 dt 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat ne

Republikën e Shqipërisë”:

Për të siguruar një shpërndarje të drejte e jo diskriminuese të frekuencave RTV në përputhje me Planin Kombëtar;

Për të garantuar një konkurrencë të ndershme për operatorët radio televizivë;

Për të garantuar shërbimin universal;

Për zhdukjen e plote të fenomenit të piraterisë dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale;

Për mbrojtjen e minoriteteve dhe dinjitetit njerëzor dhe frenimin e urrejtjes e dhunës, në veçanti ato me origjinë raciale e fetare;

Për sigurimin e paanshmërisë së informacionit dhe mbrojtjes së konsumatorit

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Revizionimi i Rregulloreve të licencimit, bazuar në Dokumentin e Politikës së Zhvillimit të Transmetimeve Radio e Televizive, Marrëveshjen RRC-06 dhe Planin e Frekuencave;

Përfundimi i transformimit të RTSH -se në një operator publik të transmetimeve RTV

Ristrukturimi i skemës organizative të RTSH

Përcaktimi i skemës së financimit të RTSH –se për sigurimin e pavarësisë ekonomike

Përcaktimi i rolit të RTSH –se në erën numerike

Përgatitja e Kodit të Sjelljes për Këshillin Drejtues të RTSH -se

Prioritetet afatgjata (2009-2012)

Prioritetet e përcaktuara për periudhën 2009-2012 janë si më poshtë:

Hartimi i ligjit të plote “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj do të jetë plotësisht i përafëruar me Konventën për Televizionin Ndërkufitar, direktivën «Televizioni pa Kufi» dhe direktivat 2002/19/EC (Access Directive); 2002/20/EC (Authorisation Directive); 2002/21/EC (Framework Directive); 2002/22/EC (Universal Service Directive), të 7 Marsit 2002.

Forcimi i kapaciteteve administrative dhe rritja e zbatueshmërisë së ligjit.

Tabela 1

**FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË KËSHILLIT KOMBËTAR
TË RADIOS DHE TELEVISIONIT**

INVESTIME	NJESIA E MATJES	GJENDJA AKTUALE	2006	2007	2008
Trajnime			4 sesione / 15 nëpunës 10 000 (mijë lekë)	6 sesione / për 15 nëpunës 7 000 (mijë lekë)	8 sesione 13 000 (mijë lekë)

3.22 MJEDISI

3.22.1 LEGJISLACIONI HORIZONTAL

Objektivi politik

Më qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm në vend, në fushën e legjislacionit horizontal, synohet në krijimin e një baze ligjore për ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi bashkëkohor të vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përsosjen e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, rregullimin, lehtësimin dhe përsosjen e procedurave të pajisjes me leje mjedisore, me qëllim sigurimin e integritetit të komponentit mjedisor në të gjitha hallkat dhe nivelet vendimarrëse të shtetit, sigurimin e pjesëmarrjes së publikut në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe vendimmarrje.

2. Situata aktuale

Kuadri ligjor

Në fushën e legjislacionit horizontal, është punuar në drejtim të krijimit të një baze ligjore për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe ngritjen e zhvillimin e një sistemi bashkëkohor të tij, bazuar në detyrimet e përcaktuara në Direktivat përkatëse të BE-së dhe Konventat ndërkombëtare. Kuadri ligjor ekzisues në lidhje me vlerësimin strategjik mjedisor dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis, përbëhet nga një set ligjesh dhe aktesh nënligjore:

Ligji nr. 8934, datë 5.09.2002, “Për Mbrojtjen e Mjedisit”;

Ligji nr. 8990, datë 23.01.2003, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, përafruar pjesërisht me Direktivën 85/337/EEC dhe me Direktivën 79/11/EEC;

VKM nr. 249, datë 24.04.2003, “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementëve të lejes mjedisore”;

VKM nr. 805, datë 4.12.2003, “Për miratimin e listës së veprimtarive, që ndikojnë në mjedis, për të cilat kërkohet leje mjedisore”;

VKM nr. 103, datë 31.03.2002, “Për monitorimin e Mjedisit në Republikën e Shqipërisë”;

Rregullore nr. 1, datë 17.08.2004, “Për pjesëmarrjen e publikut në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis”, si kërkesë e Konventës së Aarhusit mbi të drejtën e publikut për informim mjedisor.

Në lidhje me dokumentat ndërkombëtarë, janë ratifikuar:

Konventa e ESPOO-s “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar”;

Protokollit të vlerësimit strategjik mjedisor i Konventës së ESPOO-s;

Konventa e AARHUS “Mbi të drejtën e publikut për informim mjedisor, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe aksesin në drejtësi”;

Amendamentet I dhe II të Konventës së ESPOO-s “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar”;

Protokolli i Regjistrave të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve të Konventës së AARHUS.

Gjithashtu, në zbatim të detyrimeve të Konventës së AARHUS, është miratuar Strategjia e zbatimit të kësaj Konvente.

Kuadri institucional

Nënfusha e legjislacionit horizontal, në MMPAU, trajtohet **nga Drejtoria e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Lejeve**, e cila koordinon veprimet për zbatueshmërinë korrekte të këtij legjislacioni, koordinon punën me drejtoritë e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për procedurën e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të pajisjes me deklaratë, leje mjedisore, ndjek zbatimin e ligjeve e të akteve nënligjore, që kanë të bëjnë me vlerësimin strategjik mjedisor dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis. Bashkëpunon me strukturat qendrore e lokale vendimmarrëse, Ministrinë e Linjës dhe institucionet shtetërore për të siguruar integrimin e mjedisit në planet, programet e strategjitë sektoriale.

Ndër detyrat kryesore të kësaj drejtorie përmendim:

përgatit deklaratat mjedisore për strategjitë e planet e veprimit për energjitikën, minierat, industrinë, transportin, bujqësinë, pyjet, për administrimin e burimeve natyrore dhe të pasurive minerale dhe për administrimin e mbeturinave;

harton database për plane, programe, strategji, projekte e veprimtari me ndikim në mjedis, si dhe;

harton database për subjektet e licencuar, nxit pjesëmarrjen e publikut dhe OJF-vë mjedisore në vendimmarrje nëpërmjet një procesi të hapur për të gjitha palët e interesuara.

Asistenca e Huaj

Aspekte të rëndësishme që lidhen me fushën e legjislacionit horizontal, janë pjesë e projekteve të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Për t’u përmendur janë:

Projekti “Environmental Legislation and Planning”, CARDS 2002, me vlere 2.5 mil euro;

Projekti i binjakëzimit me SIDA.

Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2006-2007 janë si më poshtë:

*Të forcohen kapacitetet administrative dhe bashkërendimi në nivel kombëtar dhe vendor;
Të zbatohet legjislacioni për vlerësimin e ndikimit të mjedisit;
Të miratohet një strategji për harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit për mjedisin me
acquis të BE-së dhe të zbatohet siç duhet legjislacioni ekzistues, veçanërisht për sa i përket
ekzekutimit.*

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projektvendimi "Për metodologjinë kombëtare të vlerësimit strategjik mjedisor dhe të vlerësimit të ndikimit në mjedis", në përputhje të plotë me Direktivën e VNM, VSM, Protokollin i VSM, Konventa e ESPOO-së, Konventa e Aarhusit;

Projektligji "Për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkufitare", në përputhje të plotë me Direktivën e VNM, VSM, Protokollin i VSM, Konventa e ESPOO-së, Konventa e Aarhusit.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

ndërgjegjësimi i aktorëve;

krijimi dhe forcimi i strukturave përkatëse në nivelet qendrore dhe lokale;

ngritja e grupeve sipas specifikës;

bashkëpunimi, koordinimi;

ngritja e një autoriteti përgjegjës për planifikimin e integruar të planeve dhe programeve dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis;

informimi, në kuadër të zbatueshmërisë së Konventës së Aarhus, përfshirja në proces e publikut deri në vendimarrje;

rritja e bashkëpunimit dhe efektivitetit me palët e interesuara;

zbatimi i metodologjisë kombëtare "Për vlerësimin strategjik mjedisor dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis",

forcimi i kapaciteteve për zbatueshmërinë e saj, rritja e cilësisë;

identifikimi i çështjeve më të rëndësishme,

zbatueshmëria në mënyrën e duhur të projekteve me ndikim në mjedis nëpërmjet zbatimit të metodologjisë.

Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2008-2009 janë si më poshtë:

Të forcohet monitorimi i mjedisit dhe ndotësit të ndëshkohen me sanksione të rrepta;

Të vazhdohet me zbatimin e angazhimeve rajonale dhe ndërkombëtare për mjedisin.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projektudhëzim "Për formatin e dokumentacionit për komunikimet me palën shkaktare të ndikimeve ndërkufitare", në përputhje të plotë me Konventën e ESPOO-s;

Projektudhëzim "Për listën tip të shpenzimeve për procedurat ndërkufitare dhe kriteret metodike për përlllogaritjen e shpenzimeve të tyre", në përputhje të plotë me Konventën e ESPOO-s.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

zbatimi i rregullave dhe procedurave për projektet dhe veprimtaritë me ndikim ndërkufitar ku Shqipëria është palë shkaktare, sigurimi i respektimit të mjedisit dhe shëndetit të vendeve fqinje nga projekte me ndikim të mundshëm ndërkufitar ku Shqipëria është palë shkaktare;

përgatitja e formatit të dokumentacionit për komunikimet me palën shkaktare të ndikimeve ndërkufitare", duke përgatitur dokumentacionin tip të përshtatshëm në rastet e procedurave ndërkufitare;

zbatimi i udhëzimit "Për listën tip të shpenzimeve për procedurat ndërkufitare dhe kriteret metodike për përlllogaritjen e shpenzimeve të tyre", duke identifikuar kostot e përafërta dhe duke përcaktuar shpenzimet e mundshme të domosdoshme në procedurat ndërkufitare;

zbatimi i udhëzimit "Për përgatitjen e planeve dhe programeve të veprimit për aksidentet industriale me ndikime të largëta ndërkufitare", nëpërmjet përcaktimit të programeve dhe planeve të veprimit, krahas strukturave përkatëse, për identifikimin, koordinimin dhe bashkëpunimin për përballimin e situatave emergjente në rastet e aksidenteve industriale. Në këtë kuadër do të forcohen strukturat për përballimin e këtyre situatave për të siguruar mbrojtjen e shëndetit dhe mjediseve

ndërkufitare;

ngritja e një autoriteti përgjegjës për planifikimin e integruar të planeve dhe programeve si dhe procedurat e vlerësimit e ndikimit në mjedis. Me qëllim zbatueshmerinë e ligjit "Për vlerësimin strategjik mjedisor", do të forcohen kapacitetet qendrore e lokale për të mundësuar integrimin e mjedisit që në fazat fillestare të përgatitjes së programeve, planeve e strategjive sektoriale kombëtare, rajonale e lokale.

AKTIVITETI	2006	2007	2008
Forcim strukture (shtim personash)	2	2	2
Trajnime			

3.22.2 CILESIA E AJRIT

Objektivi Politik

Qeveria shqiptare synon disiplinimin e aktiviteteve ekonomike që shkaktojnë ndotjen e ajrit në zonat urbane. Synimi i saj është përgjysmimi i nivelit të ndotjes së ajrit në zonat e mëdha urbane të vendit. Për këtë arsye do të adoptohen plotësisht standartet mjedisore të shkarkimit në ajër, duke i përafëruar me standartet europiane, sipas një programi ambicioz. Disiplina urbane dhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbra do të sjellin një përmirësim cilesor të ajrit në qytetet e vendit, e për pasoje edhe të treguesve të shëndetit të popullsisë urbane. Krahas forcimit të disiplinës, do të adoptohen incentive për një sjellje miqësore me mjedisin të aktiviteteve ekonomike e njerezore dhe që, njëkohësisht, respektojnë principet e tregut të lirë. Gjithashtu, për këtë qëllim, do të adoptohen lehtësira fiskale për uljen e ndotjeve nga bizneset dhe konsumi, për investime në teknologji të pastra, për konservimin e energjisë, për përdorimin racional të burimeve natyrore dhe për nxitjen e investimeve mjedisore.

2.Situata aktuale

Kuadri ligjor ekzistues

Legjislacioni për cilësinë e ajrit, përfshin:

Ligjin nr.8897, dt.16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", i cili është bazuar në Direktivën 96/62/EC: On the air quality (framework directive).

VKM -ne nr.435, dt.12.09.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër, bazuar në Direktivën 96/62/EC: On the air quality (framework directive).

VKM -ne nr.248, dt.24.04.2003 "Për miratimin e normave të perkoheshme të shkarkimeve në ajër", që bazohet në Konventën e UNECE on Long Range Transboundary Air Pollution (CLTRAP) (Gjeneve 1979) dhe protokollin e saj:

Udhëzim i Perbashket i Ministrisë të Mjedisit dhe Ministrisë të Transportit dhe Telekomunikacionit Nr. 6527, datë 24.12.2004 " Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotëse të ajrit në mjedis, nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe menyrat e kontrollit të tyre";

VKM –ne nr.803, dt.04.12.2003 "Për normat e cilësisë së ajrit";

Ligji nr. 8977 datë 12.12.2002 "Për sistemin e Taksave në Republikën e Shqipërisë miratoi ecotaksën për karburantet.

Ligji nr. 9425 datë 06.10.2005 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e vitit 1979 "për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe".

Ligji nr. 9480 datë 16.2.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kopenhagenit të Protokollit të Montrealit "Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit"

Ligji nr. 9485 datë 6.3.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Montrealit të protokollit të Montrealit "Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit"

Ligji nr. 9486, datë 6.3.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Pekimit të protokollit të Montrealit "Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit"

Ligji nr. 9484 datë 6.3.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Londrës të protokollit të Montrealit "Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit"

Kuadri institucional ekzistues

Institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e cilësisë së ajrit janë MMPAU, MSH, METE,

MPPTT. Ne Drejtorine e Politikave te Parandalimit te Ndotjeve ne MMPAU ka vetem 1 specialist teknik per ajrin dhe 1 jurist, qe sipas rastit, pervec fushave te tjera mund te angazhohet edhe ne hartimin e legjislacionit ne kete fushë.

2.3. Asistenca teknike dhe financiare

MMPAU drejton cdo vit procesin e monitorimit te cilesise se ajrit nga institucionet monitoruese vendase. Fondi vjetor per kete qellim eshte 5,000,000 leke.

Gjithashtu, MMPAU po zbaton nje projekt (2.5 MEURO) te financuar nga CARDS 2004 "Forcimi i monitorimit te mjedisit ne Shqiperi" (STEMA), i cili fokuson kryesisht problemet e ajrit, ne menyre te vecante shkarkimet ne ajer. Ky projekt, vec te tjerash synon te realizoje te gjitha procedurat per akreditimin ne nivel kombetar te laboratorit/departamentit te monitorimit te ajrit si dhe te siguroje paisje bashkekohore monitorimi, trajnime te stafeve monitoruese, etj.

Adresimi i prioriteteve

Prioritetet afatshkurtra (2006 – 2007)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2006-2007 janë si më poshtë:

Të merren masa në vatrat problematike që ndotin mjedisin si landfilli i inerteve në Sharrë dhe zona Patos-Marinëz e nxjerrjes së naftës

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Hartimi i projekt-vendimit "Per standartet e karburanteve".

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Vazhdim i monitorimit te cilesise se ajrit nga institucionet vendase;

Organizim i konsultave me eksperte te huaj dhe grupet e punes me aktoret perkates per hartimin e akteve te planifikuara.

Zbatim i projektit CARDS 2004 "Forcimi i rrjetit te monitorimit te mjedisit ne Shqiperi (STEMA).

Shtese me 1 specialsit ajri ne DPPN/MMPAU

Forcim i kapaciteteve perkatese ne DPPN per ajrin.

Prioritetet afatmesme (2008-2009)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2008-2009 janë si më poshtë:

te reduktohet ndotja e ajrit ne zonat urbane;

te reduktohet ndotja nga Rafineria e Naftes ne Ballsh;

te forcohet monitorimi i mjedisit dhe

te perafrohet progresivisht Acquis.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Amendimi i Ligjit nr.8897, dt.16.05.2002 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja".

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Monitorimi i cilesise se ajrit nga institucionet vendase

Organizim i konsultave me eksperte te huaj

Zbatimi i projektit CARDS 2004 "Forcimi i rrjetit te monitorimit te mjedisit ne Shqiperi (STEMA).

Forcimi i kapaciteteve ne DPPN/MMPAU.

Zbatimi i fazes se dyte te projektit STEMA (nqse eshte miratuar nga IPA).

Prioritetet afatgjata (2010-2012)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2010-2012 janë si më poshtë:

3.3.1 Iniciativat ligjore afatgjata

Projektiligj per aderimin ne "Protocol for the long-term financing of the co-operative programme for monitoring and evaluation of the long-range transmission of air pollutants in Europe (EMEP) (Geneva 1984)

Projektiligj per aderimin ne "Protocol concerning the control of emissions of Nitrogen Oxides

or their transboundary fluxes (Sofia 1988)"

Projektligj per aderimin ne "Protocol concerning the further reduction of SO2 emissions (Oslo 1994)"

Projektligj per aderimin ne "Protocol on heavy metals (Aarhus 1998)"

Projekttakt "Per ngritjen e nje sistemi informacioni per mbrojtjen e mjedisit"

Projekttakt per identifikimin e burimeve te reja potenciale te ndotjes se ajrit

Projekttakt per ngritjen dhe funksionimin e sistemeve te njoftimit te smogut

Projekttakt per kriteret e import-eksport-transportit te karburanteve

3.3.2 Aktivitetet zbatuese afatgjata

Monitorimi i cilesise se ajrit nga institucionet vendase

Organizim i konsultave me eksperte te huaj

Zbatimi i projektit CARDS 2004 "Forcimi i rrjetit te monitorimit te mjedisit ne Shqiperi (STEMA).

Forcimi i kapaciteteve ne DPPN/MMPAU.

Zbatimi i fazes se dyte te projektit STEMA (nqse eshte miratuar nga IPA).

Tabela 1 Forcimi i kapaciteteve institucionale te strukturave te parandalimit te ndotjes

AKTIVITETI	2007	2008	2009
Forcim strukture (shtim personash)	1	0	0
Trajnime	0	0	0

3.22.3 MENAXHIMI I MBETJEVE

Objektivi Politik

Objektivi kryesor i Qeverise Shqiptare, ne perputhje edhe me angazhimin e marre ne kuader te Marreveshjes se Stabilizim Asociimit, eshte zhvillimi dhe forcimi i bashkepunimit per te luftuar degradimin mjedisor, me synim promovimin e qendrushmerise ne mjedis.

2. Situata aktuale

Kuadri ligjor ekzistues

Ne fushen e mbetjeve, kuadri ligjor perbehet nga keto akte ligjore:

Ligji Nr.8934, date 05.09.2002. "Per Mbrojtjen e Mjedisit", neni 20, administrimi i mbetjeve synon parandalimin dhe kufizimin e ndikimeve te tyre te demshme ne shendetin e njeriut dhe ne mjedis; riciklimin, riperdorimin ose rigjenerimin e mbetjeve ne procese te tjera.

Ligji Nr. 9010, date 11.02.2003 "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta", synon mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit nga ndotja dhe demtimi prej mbeturinave te ngurta, nepermjet administrimit mjedisor te tyre ne çdo faze, duke perfshire ketu krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, perpunimin dhe asgjesimin, te cilat çojne ne pakesimin e mbetjeve dhe zvogelimin e ndikimeve te tyre te rrezikshme e te demshme. Ai eshte pjeserisht i perafuar me Convention on transboundary movements of hazardous waste and their disposal (Basel 1989), Directive 75/442/EEC: On waste (EU framework directive), Directive 91/689/EEC: On hazardous waste, Directive 94/67/EEC: On the incineration of waste, Directive 99/31/EEC: The landfill.

Ligji Nr 8094, date 21.03.1996 "Per largimin publik te mbeturinave". Ministria e Rregullimit te Territorit dhe Turizmit eshte pergjegjese per zbatimin e ketij ligji. Ky ligj synon mbrojtjen e mjedisit urban nga ndotja e mbeturinave, si dhe largimin publik te tyre ne brendesi te teritoreve bashkiake e te komunave. Ai synon gjithashtu disiplinimin e pastrimit te qytetit nga mbeturinat duke filluar nga dorezimi, mbledhja, fshirja, grumbullimi dhe transporti.

Ligji nr. 7973, date 26.07.1995 "Per Konçensionet dhe Pjesemarrjen e Sektorit Privat ne Sherbimet Publike dhe Infrastrukture". Nje nder pikat e fushes se zbatimit te ketij ligji eshte edhe administrimi i mbetjeve te ngurta dhe te demshme. Dhenia me konçension per ndertimin e impianteve per perpunimin e mbetjeve te ngurta urbane eshte nje nga format me te aplikueshme per momentin, pasi ndertimi i tyre kerkon nje financim te paperballueshem nga buxheti i shtetit apo ai i pushtetit vendor.

Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr.103, datë 31.03.2002 “Per Monitorimin e Mjedisit në Republikën e Shqipërisë”. Në piken C-3/a,b dhe C-5/d ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për monitorimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe atyre inerte si dhe hartimin e Raportit Vjetor për sasinë vjetore të mbetjeve në rang bashkie, qarku dhe Republike.

Ligji nr.8405, datë 17.09.1998 “Per Urbanistikën” me amendimet perkatese. Ky ligj percakton procedurat e miratimit të vendit ku do të ngrihet impianti i perpunimit të mbetjeve urbane, në vartësi të madhësisë së sheshit. Percaktimi i këtij sheshi, për perpunimin e mbetjeve urbane, duhet të bëhet në nivelin e studimit rajonal, të masterplaneve, të planit të përgjithshëm rregullues dhe studimeve urbanistike pjesore.

Ligji “Per organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor”, i cili obligon bashkitë dhe komunat për t’u përfshirë në menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal (2000);

Ligji nr. 8094 dt. 21 03 1996 “Per sistemin e taksimit të largimit publik të mbeturinave”

VKM nr. 803, datë 04.12.2003 “Per miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve me qëllim përdorimi, perpunimi dhe riciklimi”

Rregullore Nr 4 datë 15.10.2003 “Per kerkimin dhe miratimin e lejeve të eksportimit dhe tranzitimit të mbetjeve”

VKM “Per miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve”.

“Ligji Nr.9537, datë 18.5.2006 Per administrimin e mbetjeve të rrezikshme”

Ligji nr. 8977 datë 12.12.2002 “Per sistemin e Taksave në republikën e Shqipërisë” i cili miratoi ekotaksën për ambalazhet plastike të lengjeve.

Kuadri institucional ekzistues

Sipas ligjit Nr. 9010, datë 11.02.2003 “Per administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, menaxhimi i mbetjeve të ngurta është detyrë e institucioneve MMPAU, MPPTT, MSH, METE, MBUMK.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave, e cila në Drejtorinë e Politikave të Parandalimit të Ndotjeve ka vetëm 1 ekspert që mbulon çështjet e mbetjeve në teresi dhe mbetjet e rrezikshme dhe në Sektorin e Legjislacionit ka vetëm 1 jurist, që sipas rastit, përveç fushave të tjera angazhohet edhe me problemet e mbetjeve dhe mbetjet e rrezikshme.

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, që ka sektorin (prej 3 vetash) e Mbetjeve Urbane (për mbetjet urbane dhe mbetjet e ndertimit (inerte).

Ministria e Shëndetësisë për mbetjet spitalore;

Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës për mbetjet industriale dhe mbetjet e vëllimshme nga industria;

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për mbetjet e bujqësisë dhe të rritjes së kafshëve;

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për mbetjet e automjeteve në fund të jetës dhe ato që rezultojnë nga zëvendësimi i materialeve apo pjesëve të konsumuara. Ligji i ri i vitit 2000 “Mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor” detyron bashkitë të angazhohen në menaxhimin e mbetjeve urbane (grumbullim, transportim, trajtim dhe asgjësim) në nivel lokal. Gjithashtu, ligji “Per taksat vendore” i jep bashkive të drejtën të vendosin taksa vendore për pastrimin e qytetit, që paguhen nga sektori familjar dhe agjentët socio-ekonomike.

2.3. Asistenca teknike dhe financiare

Aktualisht, në fushën e menaxhimit të mbetjeve, MMAPU po zbaton dy projektet e mëposhtme:

Titulli i projektit: Studim fizibiliteti dhe projektimi për një landfill të mbetjeve të rrezikshme. Kohezgjatja e projektit: 2004-2006; Donori: CARDS 2002; Buxheti: 600,000EURO; Objektivi: Një projektim i plotë dhe të gjithë dokumentet perkatese për ndertimin e një landfili të sigurtë për mbetjet e rrezikshme. Projekti menaxhohet nga Delegacioni i Komisionit Europian në Tiranë. Statusi: Në proces

Titulli i projektit: Projekti i menaxhimit të mbetjeve të ngurta në rajonin e Korçës. Institucioni drejtues: MM; Kohezgjatja e pritshme e projektit: 2005-2006; Donori: SIDA; Buxheti: 15,000,000 Korona Suedeze; Objektivi: Organizimi, mirefunksionimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i mbetjeve të ngurta. Projekti do të zhvillohet në tre nivele: qendror, rajonal dhe lokal. Ky projekt është vazhdim dhe plotëson projektin e KFW–së që po zbatohet në rajonin e Korçës. Statusi: në pritje për të filluar pasi të firmoset marrëveshja nga të dy palët.

Nderkohe, është siguruar mbështetje financiare për këto projekte:

Titulli i projektit: Ndërtimi i një landfilli të sigurtë për mbetjet e rrezikshme. Institucioni drejtues: MM; Kohezgjatja e pritshme e projektit: 2007-2008; Donori: CARDS 2004; Buxheti: 3,500,000 EURO; Objektivi: Ndërtimi i landfillit të sigurtë për mbetjet e rrezikshme. Statusi: zbatimi do të fillojë pas përfundimit me sukses të projektit “Studim fizibiliteti dhe projektimi për një landfill të mbetjeve të rrezikshme” të financuar nga CARDS 2002.

Gjithashtu, është miratuar nga CARDS 2006 (3 MEUR) edhe transferimi i mbetjeve të rrezikshme që gjenden në zonat e nevojta mjedisore, në landfillin e ri të mbetjeve të rrezikshme që do ndërtohet sipas projektit të mesipër.

Adresimi i prioritetëve

Dokumenti i Partneritetit European për Shqipërinë (2004) dhe këto rekomandime:

Për periudhën afatshkurter Edhe për periudhën afatmesme: Midis fushave të tjera të Acquis, në kushtet e Shqipërisë, mënyhëmi i mbetjeve përben një prioritet të lartë.

Duke qenë se problemet e administrimit të mbetjeve janë një prioritet, në periudhën 5 vjeçare janë parashikuar të hartohen një sërë aktesh ligjore, të cilat do t’u adresohen një sërë direktivave të rendesishme në fushën e mbetjeve. Akte të tjera do të hartohen edhe në periudhën afatmesme e afatgjatë.

Prioritetet afatshkurtra (2006 – 2007)

Rehabilitimi i zonave të nevojta në Durrës dhe Vlorë

Marrja e masave në vatrat problematike që ndotin mjedisin, si landfilli i mbetjeve urbane në Sharrë dhe zona Patos-Marinëz e nxjerrjes së naftës.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Në zbatim të ligjit Nr. 9010, datë 11.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, do të hartohet dhe miratohet nga Ministri i MMPAU dhe i MPPTT rregullorja për mënyhimin e mbetjeve të ndërtimit.

Do të hartohen dhe miratohen një sërë rregulloresh, formularesh dhe regjistrash për implementimin e Ligjit Nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”.

Do të hartohet dhe miratohet Projektligji “Për amendimin e ligjit 9010 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, një Projektakt “Për miratimin e rregullave, procedurave dhe afateve për hartimin e Planeve Lokale të Administrimit të Mbetjeve të Ngurta”,

Projektakti “Për miratimin e rregullave, procedurave dhe afateve për hartimin e Planeve Rajonale të Administrimit të Mbetjeve të Ngurta” si dhe

Projektakti “Për listën e mbetjeve që do lejohen për import, për qëllim përdorimi përpunimi dhe riciklimi”.

Projektakti “Për miratimin e rregullave, procedurave, dhe afateve për hartimin e Planit Kombëtar të Administrimit të Mbetjeve të Ngurta”.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Do të organizohet një Konferencë për riciklimin e mbetjeve, një sërë aktiviteteve ndërgjegjëse në bashkëpunim me OJF-te mjedisore, do të botohet një gazete lokale për mënyhimin e mbetjeve urbane në Korce.

Në bashkëpunim me projektin e Sidas, do të organizohen trajnime të specialistëve lokale për mbetjet.

Do të përfundojë zbatimi i projektit të CARDS 2002 “Studim fizibiliteti dhe projektimi inxhinjerik për një landfill të mbetjeve të rrezikshme”.

Nderkohe, për të përballuar në kohë e me cilësi detyrat ambicioze në fushën e mënyhimit të mbetjeve dhe të mbetjeve të rrezikshme është planifikuar një shtesë prej 2 specialistesh për mbetjet në Drejtorinë e Politikave të Parandalimit të Ndotjeve.

3.2. Prioritetet afatmesme (2008-2009)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2008-2009 janë si më poshtë: rehabilitimi i zonave të nevojta dhe përafrimin progresivisht të Acquis për mjedisin vazhdimi i përpjekjeve për adresimin e vatrave toksike.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:
 Do të hartohet nje Projektakt "Per landfillimin e mbetjeve dhe incinerimin",
 Projektakti "Per komposimin e mbetjeve",
 Projektligji "Per Ndotesit organike te qendrueshem" si dhe
 Projektligji "Per miratimin e planit kombetar te administrimit te mbetjeve".
 Aktivitetet zbatuese afatmesme
 Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:
 Do të organizohen trajnime te specialisteve lokale per plotesimin e regjistrimit te mbetjeve;
 do të realizohen aktivitetet per ndergjegjesimin e publikut ne lidhje me nevojën e menaxhimit
 te qendrueshme te mbetjeve te ngurta, trajnime te specialisteve lokale e rajonale per hartimin e planeve
 locale e rajonale, trajnime te specialisteve te doganave per importet e mbetjeve te riciklueshme,
 publikime te ndryshme, etj.
 Prioritetet afatgjata (2010-2012)
 Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2009-2012 janë si më poshtë:
 Do të hartohet Projektakti "Per ambalazhimin dhe mbetjet e amballazheve",
 Projektakti "Per landfillet e automjeteve ne fund te jetes",
 Projektakti "Per mbetjet nga industria te dioksidit te titaniumit", si dhe
 Projektakti "Per raportimin, pyetesoret, certifikatat e asgjesimit, grumbullimin e statistikave
 per mbetjet".
 Aktivitetet zbatuese afatgjata
 Për adresimin e prioriteteve afatgjata do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:
 Do të vazhdoje puna per forcimin e kapaciteteve ne fushen e menaxhimit te mbetjeve per
 Drejtorine e Politikave te Parandalimit te Ndotjeve dhe
 zbatimi i akteve te miratuara ne vazhdimesi.

Tabela 1 Forcimi i kapaciteteve te institucionale te Strukturave te parandalimit te Ndotjes

AKTIVITETI	2007	2008	2009
Forcim strukture (shtim personash)			
Trajnime			
3.21.4 UJI			
3.21.4.1 ADMINISTRIMI I BURIMEVE UJORE			
1. Objektivi Politik			
Administrimi i burimeve ujore është një nga fushat prioritare në kuadër të procesit të integritetit. Perafrimi i legjislacionit vendas me ate komunitar ne kete fushe eshte edhe nje nga sfidat kryesore te qeverise shqiptare, ne kuader te zbatimit edhe te prioriteteve te Partneritetit European.			
2 Situata aktuale			
2.1 Kuadri ligjor ekzistues			
Kuadri ligjor për Administrimin e burimeve ujore përbëhet nga:			
Ligji nr 8934, dt 5.9.2002 "Per mbrojtjen e mjedisit"			
Ligji nr.9115, dt.24.7.2003,"Per trajtimin mjedisor te ujerave te ndotura;			
Ligji nr 8093, dt.21.3.1996 "Per rezervat ujore"			
Ligj nr 9103, dt 10.7.2003,"Per mbrojtjen e liqeneve nderkufitare"			
Ligj nr. 8905, dt 6.6.2002 "Per mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe demtimi"			
Ligj nr. 8875, dt. 4.4.2002 "Per rojen BregdetareShqiptare"			
Aktet nënligjore qe janë miratuar në zbatim të tij janë:			
VKM Nr. 177, dt. 31.03.2005 " Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritesë"			
VKM Nr. 103, dt. 31.03.2002 " Per monitorimin e mjedisit ne RSH"			
VKM Nr. 775, dt. 28.10.1996 " Per krijimin e Keshillit Kombetar te Ujit"			

VKM Nr. 240, dt. 10.04.1998 " Per krijimin e Sekretariatit te KKKU"
VKM Nr. 635, dt. 21.11.2001 " Per krijimin e Komisionit Qeveritar per problemet ujore me vendet fqinje";

VKM Nr. 63. dt. 26.01.2001 " Per procedurat e kerkimit, te shqyrtimit dhe dhenies se autorizimeve, te lejeve dhe koncensionave pe perdorimin e rezervave ujore";

VKM.Nr. 313, dt. 21.05.2004 " Per miratimin e tarifave te perdorimit te ujit";

VKM. Nr. 362. dt.11.06.2004 " Per shperblimin e anetareve te KBU dhe Keshillave konsultative teknike prane autoriteteve;

VENDIME TE Keshillit Kombetar te Ujerrave

VKKU. Nr.1. dt 23.09.1994 " Per proceduren per miratimin e lejeve pershfrytezimin e ujerave per konfeksionim";

VKKU. Nr.2. dt.23 .09.1994 "Per miratimin e lejes per shfrytetzimin pjesor te burimit "Ujet e ftohte Tepelene".

VKKU. Nr.1. dt. 20.02.1997 "Per miratimin e ndertimit te hidrocentralit te Kalivacit, ne gryken e kalivacit, mbi lumin Vjose";

VKKU. Nr. 1. dt. 04.06.1998 "Per miratimin e lejeve per perdorimin e disa burimeve per ndertim ujesjellesash per ujin e pijshem"

VKKU. Nr. 4. dt. 04.06.1998 " Per krijimin e grupit te punes se kontrollit te veprimtarise per shfrytezimin e zhavorreve dhe rerrave si materiale inerte"

VKKU. Nr. 2. dt. 04.06.1998 " Per miratimin e autorizimeve te disa shpimeve per ujera nentokesore, per furnizimin me uje te ujesjellesave publike"

VKKU. Nr. 5. dt.16.04.2004 " Per ndarjen e territorit te Republikes ne basene ujembledhese dhe per krijimin e Agjensive te ujit per keto basene"

Kuadri institucional ekzistues

Problematika e administrimit te ujerave dhe ruajtjes se cilesise se tyre, mbulohet nga *Drejtoria e Politikave te Mbrojtjes se Natyres* dhe Sektori i Ujerrave, ne MMPAU. Sektori i ujerave ka 3 persona, 1 shfekt sektori dhe 2 specialist si dhe nga Drejtoria e Politikave te Parandalimit te Ndotijes, ku per ujerat ka 1 specialiste, si dhe Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese (Sektori i Legjislacionit) qe angazhon sipas rastit 1 – 2 specialiste ne hartimin e akteve ligjore dhe nenligjore.

Sektori i Ujerrave perfshin AUB qe veprojne ne 6 basene ne te cilat eshte ndare territori i RSH, qe zbatojne dhe kontrollojne legjislacionin per ujerat.

Bashkepuniimi me institucionet e tjera

Bashkepuniimi fokusohet ne rritjen e kapaciteteve administrative, bashkerendimin e programeve te kontrollit dhe inpektimit midis institucioneve qe mbulojne kete fushe. Masat organizative te zbatuara deri tani ne fushen e cilesise se ujit te pijshem, jane te lidhura me riorganizimin e ndermarjeve te ujesjelles kanalizimeve.

Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit mbulon problemet e ujesjelles kanalizimeve;

Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit mbulon problemet e perdorimit te ujit per ujitje;

Ministria e Shendetesise mbulon problemet e ujit te pijshem dhe sanitetit te ujit.

2.3. Asistenca teknike dhe financiare

Fusha e menaxhimit te ujerave eshte mbështetur nga disa projekte të tilla si:

Programi Phare:

Titulli i projektit: rehabilitimi i kanalizimeve Vlore, Vlefte 9,731,492 E; objektivi: rehabilitimi i rrjetit te kanalizimeve Vlore, ndertimi i stacionit te pompimeve;

Titulli i projektit: Permiresimi i rrjetit te ujesjellesit Vlore, Vlera 2,104,832 E, Objektivi permiresimi i rrjetit shperndares

Titulli i projektit : Permiresimi ne furnizimin me uje te qytetit dhe largimi i ujerave te zeza, Ujesjelles kanalizimie Sarande, vlera 4,252,608 E;

Titulli i projektit : Rehabilitimi i Ujesjellesit te Fierit, vlera 4,279,884E;

Titulli i projektit : rehabilitimi i kanalizimeve Lezhe, vlera 1,543,930E

Titulli i projektit : rehabilitimi i Ujesjellesit Gjirrokaster, vlera 5,491,834E;

Titulli i projektit: Forcimi institucional i bashkive Gjirrokaster dhe Vlore,, vlera 645,690E;

Titulli i projektit: Eliminimi i mbetjeve te arsenikut te lengeshem ne azotikun e fierit, vlere 1,000,000E

Banka Botërore

Titulli i projektit: Rehabilitimi i furnizimit me uje per Durresin, Lezhen, Fierin dhe Saranden, vlere 10,000,000\$ kredi,

Titulli i projektit: Permireshimi i furnizimit me uje per nje popullsi prej 24.200 banoresh ne 17 fshatra ne zonen rurale, Durres

Titulli i projektit: Projekt bashkiak i furnizimit me uje dhe kanalizimeve, vlere 15,000.000\$ kredi, objektivi: Operimin e 4 ndermarjeve te ujesjelles kanalizimeve nepermjet nje operatori privat me kontrate menaxhimi.

Titulli i projektit: Menaxhimi i integruar i ujerave te ekosistemit . Grant 4,87 milion USD, kredi. Objektivi te zvogeloje ngarkesen e ndotjes se prodhuar ne tre qytete Durres, Lezhe/Shengjin dhe Sarande nepermjet ndertimit te baseneve artificiale te trajtimit te ujrave te zeza.

Titulli i projektit Menaxhimi i tokes urbane, vlere : 10,573,529 USD, i perfunduar, objektivi: Shtrirja e infrastrukturave baze ne zonat periferike dhe te degraduara te tiranes se madhe ose te qyteteve te tjera si dhe forcimin e institucioneve pergjegjese ne nivel lokal dhe kombetar.

Titulli i projektit Pergatitja e kodit te zonimit dhe planit rregullues urban per bashkine e Tiranes, Vlere: 1,466 milion \$, Objektivi: asistence financiare dhe teknike per pergatitjen e planit te ri rregullues te Tiranes dhe Kodit te Zonimit.

Banka Gjermane per Rindertim

Titulli i projektit Projekt i menaxhimit te ujit, kanalizimeve Pogradec, vlere: 17,050,000E kredi+grant. Objektivi:Rehabilitimi i rrjetit te kanalizimeve dhe ndertimi i impiantit te trajtimit te ujrave te zeza.

Titulli i projektit Ujesjelles kanalizime Kruje faze II, vlere: 2,556,459 E grant.

Titulli i projektit Rezervuari i Manskurise, vlere: 3,579,042E (kredi +grant). Objektivi: ndertimi i nje rezervuari ne zonen e Manskurise i cili do ti sherbeje ujesjellesit te Kavajes dhe fshatrave perreth.

Titulli i projektit Kanalizimet Kavaje, vlere: 6,646,794 E kredi.

Titulli i projektit Furnizim me uje dhe shkarkimi i ujrave te zeza ne Lushnje, vlere: 4,971,626 E (Kredi + grant),

Titulli i projektit Projekti ujesjelles kanalizime Korce, vlere: 64,500,000EU, ne fazen e miratimit.

Kooperacioni Italian

Titulli i projektit Asistence teknike dhe financiare per ndermarrjen e zgjeruar te ujesjelles kanalizimeve, vlere: 10,484,075E Objektivi: Riprteritje e sistemit te furnizimit me uje te pijshem te Tiranes.

Titulli i projektit Mbeshtetje institucionale per PIU-tirane. Vlere: 600.000EU

Titulli i projektit Projekti i sherbimeve esenciale dhe urbanizimit paresor per dy zona ne Tirane dhe ne Vlore, lagjet Kombinat dhe 24 Maji.

Titulli i projektit Projekti periferia urbane e Tiranes, komponenti infrastrukturor. Vlere: 3.000.000E, pritet aprovimi final.Objektivi: Rimekembja e sherbimeve esenciale dhe urbanizimit paresor per lagjen e Laprakes.

Banka Islamike per Zhvillim

Titulli i projektit Furnizimi me uje i zonave rurale Bajze, Klos. Vlere: 6.339.787USD. Objektivi: Rehabilitimi i ujesjellesave,ndertimi i depove te ujit.

Titulli i projektit Ujsjelles Kanalizimet e Fushe Krujes – Peshkopi. Vlere: 6.531.329USD kredi.

Qeveria Austriake

Titulli i projektit: Furnizim me uje i qytetit te Shkodres, faza konsoliduese. Vlere : 2.619.000^E grant

Titulli i projektit : Furnizim me uje per fshatin Kastrat

Titulli i projektit : Furnizim me uje i 4 fshatrave ne rrethin e Shkodres. Vlere 300 000E grant.

Qeveria Norvogeje

Titulli i projektit : Ujesjelles kanalizime Burrel. Vlere: 3.500 000E grant.

Qeveria e Dukatit te Madh te Luksenburgut

Titulli i projektit: Rehabilitimi i rrjetit të ujesjelles kanalizimesh në Maqellare, Diber. Vlera : 4.365.000 E grant.

3. Adresimi i prioriteteve

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2006-2007 janë si më poshtë:
Perafrimi i legjislacionit vendas me atë komunitar

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Miratimi i vendimeve të Keshillit Kombëtar të Ujërave

Rishikimi i ligjit “Për rezervat ujrore”, i cili do të përafrohet me direktivën baze 2000/60/EEC

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Analizimi i një kuadri ligjor vendas për fushën e cilesisë së ujit dhe përgatitja e një vleresimi mbi adaptimin e Direktivave:

2000/60/EEC; Direktiva baze;

91/676/EEC “Për vendosjen e një liste prioritesh në fushën e politikave të ujërave.

Fuqizimi i kapaciteteve administrative

Tabela e mëposhtme tregon me një detaje investimet që do të kryhen për fuqizimin e kapaciteteve administrative

3.2. Prioritetet afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2008-2009 konsistojnë në:

Zbatimi i legjislacionit në fushën e menaxhimit të ujërave

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Projekt ligj “Për krijimin e rrjetit për veprimin në politikën e ujit” i cili do të harmonizojë Direktivën 2000/60/EEC me qëllim vendosjen e bashkëpunimit me nivelin lokal dhe përfshirjen e publikut.

Miratimi i vendimeve të Keshillit Kombëtar të Ujërave;

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Forcimi i kapaciteteve administrative të AUB si dhe mbështetja me logjistike, krijimi i rrjetit të pikave të monitorimit të basenave ujore dhe informatizimi i informacionit.

Miratimi i vendimeve të Keshillit Kombëtar të Ujërave;

3.2 Prioritetet afatgjata

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2009-2012 janë si më poshtë:

Zbatimi i legjislacionit vendas në harmoni me atë komunitar.

Në vitet 2009-2012 do të punohet për plotësime të mundshme të këtij kuadri ligjor, në varësi të ndryshimeve apo reformave që mund të ndërmarrë Komisioni Evropian në fushën menaxhimit të ujërave.

Tabela 1

FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË UJËRAVE

AKTIVITETI	2006	2007	2008
Ngritje/forcim strukture, kapacitetesh (shtim personash)	- ---- - -	-----1--- 600 leke/ vit-	-----8--- 3840 lek e/v it-
Trajnime		4 persona, 1000	

	leke	
Buxheti (mije leke	1600	3840
	leke/ vit	lek e/v it

3.22.4.2 CILESIA E UJIT TE PIJSHEM

Objektivi Politik

Shqipëria, në kuadër të zbatimit të angazhimeve të ndërmarra në dokumentin e Partneritetit, synon të zhvillojë dhe zbatojë strategjinë kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Higjienës, si dhe strategjinë rurale të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Do të zhvillohet dhe të nisat zbatimi i një strategjie për harmonizimin progresiv me acquis në fushën e furnizimit me ujë dhe higjienës, që do të përafrojë standartet e cilësisë së ujrave në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Legjislacioni mjedisor për ujërat, përfshin:

Ligjin 7643, 1992 "Për Inspektoriatin Sanitar Shtetëror"

VKM -në Nr 145, datë 26.02.1998 " Për miratimin e rregullores higjeno-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm"

VKM –në Nr 609, datë 17.11.2000 "Për industrializimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale"

Udhëzimin nga MSH, Nr 203, datë 06.06.1995 "Për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm të puseve"

Rregulloren Nr 4, datë 10.05.1989 "Për kërkesat higjeno-sanitare të pishinave"

Kuadri institucional ekzistues

Institucion mbështetës i Ministrisë së Shëndetësisë për arritjen e detyrimit të më sipërm lidhur me sanitetin e ujit të pijshëm është Instituti i Shëndetit Publik, i cili varet drejtpërdrejtë nga Ministria e Shëndetësisë

Inspektoriatin Sanitar Shtetëror, i cili monitoron, kontrollon zbatimin e rregullave higjeno-sanitare për projektimin, ndërtimin, rikonstruksionin dhe shfrytëzimin e veprave të furnizimit me ujë të pijshëm, të përcaktuara në rregulloren higjeno-sanitare për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm në bazë të VKM –së Nr. 145 datë 26.02.1998 .

Përparësitë Afatshkurtra 2006-2007

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Amendim i rregullores Nr 4, datë 10.05.1989 "Për kërkesat higjeno-sanitare të pishinave", që do të sjellë një harmonizim të pjesshëm me Direktivën EC 76/768 (për pishinat)

Amendim i VKM -së Nr 145, datë 26.02.1998 "Për miratimin e rregullores higjeno-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm" harmonizim të pjesshëm me Direktivat EC 80/778, dhe EC 98/83, 1998

aktivitetet zbatuese bazë

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Zbatimi i masave që rrjedhin nga rregullorja e rishikuar, dhe

Përmirësimi i cilësisë nëpërmjet uljes së vlerave maksimale të lejueshme të disa treguesve toksikë

AKTIVITETI	2006	2008	2009
------------	------	------	------

Forcim strukture (shtim personash)	0	0	1
Trajnime	300 (300.000 l)	0	1.200.000ALL

3.22.4.3 PARANDALIMI I NDOTJES SË UJIT DHE MANAXHIMI I UJIT TE PIJSHEM

1.Objektivi Politik

Shqiperia ne kuader te zbatimit te angazhimeve te ndermarra ne MSA, synon te perafroje standartet e cilesise se ujerave ne periudhen afat-shkurter dhe afat-mesme. Ndaj eshte nje objektiv themelor,qe me perparesi te displinohen aktivitetet ekonomike, qe shkaktojne ndotjen ne ujrat bregdetare e liqenore dhe qe kompromentojne potencialet turistike.

2.Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Legjislacioni mjedisor per ujerat, perfshin:

Ligjin nr.8905, date 06.06.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe demtimet”

Ligjin nr.9103, date 10.07.2003 “Per mbrojtjen e liqeneve nderkufitare”

VKM -n “Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese”

VKM nr. 177 date 31.3.2005 “Per shkarkimet”

2.2.Kuadri institucional ekzistues

Institucionet pergjegjese per menaxhimin dhe cilesine e ujit jane MPPTT, MMPAU, MBUMK, MSH

Ne MMPAU, ne Drejtorine e Parandalimit te Ndotjes ka vetem 1 specialist teknik per cilesine e ujit dhe 1 jurist, i drejtorise juridike, qe sipas rastit, pervec fushave te tjera, angazhohet edhe ne hartimin e legjislacionit ne kete fushe. Eshte e qarte, qe kjo nenfushe e *Acquis* eshte e pamundur te mbulohet nga stafi ekzistues, prandaj eshte planifikuar shtimi i 1 specialisti te ri ne Drejtorine e Poltikave te Parandalimit te Ndotjeve..

2.3 Asistenca teknike

Ne fushen e mbrojtjes nga ndotja industriale eshte siguruar asistenca e programit CARDS 2002 (0.9 MEUR), ne kuader te te cilit ,po zbatohet projekti i meposhtem si dhe nje vazhdim i tij me mbeshtetjen e CARDS 2005 (1 MEUR):

Titulli i projektit: Ngritja e impiantit te trajtimit te mbetjeve ujore ne Rafinerine e Naftes ne Ballsh. Instucion i drejtues: MM; Kohezgjatja e pritshme e projektit: 2005-2006; Donori: CARDS 2002; Buxheti: 900,000 EUR; Objektivi: Rehabilitimi i Rafinerise se Naftes ne Ballsh, per ta bere ate te punoje me kapacitet te plote ne perputhje me standartet e Bashkimit European. Projekti do te menaxhohet nga delegacioni i KE ne Tirane.

Adresimi i prioriteteve

Prioritetet afatshkurtra (2006-2007)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006-2007 janë si më poshtë: reduktimi i ndotjes nga Rafineria e Naftes ne Ballsh

Reduktimi i ndotjes se ujerave ne pergjithesi

forcimin i monitorimit te mjedisit,

Zbatimi i Strategjise Kombetare te Furnizimit me Uje dhe Sanitetin

Zbatimi i Strategjise Rurale te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve dhe

perafrimin progresivisht te Acquis.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Aktivitetet ne kuader te binjakezimit me SIDA/SEPA per monitorimin e ujit
monitorimi i ujrave nga institucionet vendase
shtim stafi i DPPN per ujin

Shpejtimi I procesit te decentralizimit te ndermarrjeve ujesjelles-kanalizime ne organet e pushtetit lokal.

Hartimi I nje metodike per llogaritjen e mbeshtetjes me subvencione te ujesjelles-kanalizimeve, duke stimuluar performancen e ndermarrjeve

Identifikimi I gjendjes se furnizimit me uji te zonave rurale dhe hartimi I nje database kombetare

Fillimi I pregatitjes se nje politike te drejte investimesh ne zonat rurale mbeshtetur ne database kombetar

Shtirja e monitorimit te indikatorëve te performances ne te gjithë ndermarrjet e vendit

Shtirja e monitorimit te ndermarrjeve ne te gjitha ndermarrjet ujesjelles-kanalizime ne Shqiperi

Inventarizimi I sistemeve te ujesjelles-kanalizimeve ne zonat rurale dhe pregatitja e nje database

Pregatitja e nje metodike per llogaritjen e subvencioneve per sistemet uejsjelles-kanalizime

Hartimi I nje plani masash per shpejtimin e procesit te transferimit te aseteve ne organet lokale

Perfundimi I procesit te decentralizimit te ndermarrjeve Ujesjelles-Kanalizime ne Organet lokale dhe zgjidhja e te gjithë problemeve te mbetura nga procesi I transferimit te aseteve

Fillimi I pregatitjes se sektorit ujesjelles-kanalizime per pjesmarrjen e sektorit privat sidomos atij shqiptar ne periudhen fillestare

Pregatitja e nje plani te ndergjegjesimit publik dhe komunikimi ne lidhje me ceshtjen e ujit te pijshem dhe sanitetit ne Shqiperi

Hartimi I nje pakete ligjore per fillimin e pjesmarrjes se sektorit privat ne sektorin e ujesjelles-kanalizimeve

Aplikimi I rezultateve te monitorimit te ndermarrjeve per te vleresuar performancen e ndermarrjeve dhe aplikimit te skemes se subvencioneve

Pregatitja e nje masterpalni kombetar te investimeve per rehabilitimin e sistemeve ekzistuese dhe shtrirjes se sherbimit ne zonat e varfera dhe te pambuluara

Rehabilitimi i plote i rrjeteve te ujesjelles-kanalizimeve dhe shtrirjet e sherbimit ne drejtim te zonave te varfra

Prioritetet afatmesme (2008-2009)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008-2009 janë si më poshtë:

Të zvogëlohet ndotja që shkakton rafineria e Ballshit, përfshi edhe shkarkimet në lumin e Gjanicës dhe të merren masa kundër ndotjes së ujit në përgjithësi.

Të forcohet monitorimi i mjedisit dhe ndotësit të ndëshkohen me sanksione të rrepta.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

draft amendim i ligjeve ekzistuese lidhur me menaxhimin e resurseve ujore dhe parandalimin e ndotjes se ujrave

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

monitorimi i cilesise se ujrave siperfaqesore (lumenj e liqene, dhe ujera banjatore) dhe nentokesore.

Vazhdim i bashkepunimit ne kuader te Marreveshjes se Binjakezimit me Agjencine e Mbrojtjes se Mjedisit te Suedise (SEPA) me mbeshtetjen e SIDA-s.

Prioritetet afatgjata (2010-2012)

3.2.1 Iniciativat ligjore afatgjata

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2010-2012 janë si më poshtë:

hartimi i nje akti te ri per shkarkimet ne ujera.

Aktivitetet zbatuese afatgjata

monitorimi i cilesise se ujerave sipërfaqesore (lumenj e liqene, dhe ujera banjatore) dhe nentokesore

Tabela 1 Forcimi i kapaciteteve institucionale te strukturave te parandalimit te ndotjes

AKTIVITETI	2007	2008	2009
Forcim struktur e (shtim personas h)	1	0	0
Trajnime	6.000.000ALL	6.000.000ALL	6.000.000ALL

3.22.5 MBROJTJA E NATYRËS

1. Objektivi Politik

Mbrojtja e Natyrës është një prej nënfushave prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e mjedisit. Përafrimi i legjislacionit shqiptar me acquis në fushën e mjedisit, lidhet direkt me standartet mjedisore dhe detyrën jetësore për të luftuar degradimin e mjedisit me qëllim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Ky objektivi, është shkruar në dokumentet strategjike sektoriale si: Plani Kombëtar i Veprimit në Mjedis, Strategjia dhe Plani i Veprimit të Biodiversitetit dhe Strategjia e Zhvillimit të Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave

2. Situata aktuale

2.1. Kuadri ligjor ekzistues

Kuadri ligjor për mbrojtjen e natyrës mbështetet në tri ligje bazë Ligji nr. 8934, datë 05.09.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", Ligji nr. 7875, datë 23.11.1994 "Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë" ndryshuar me ligjin nr. 9219, datë 08.04.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 7875, i cili është pjesërisht i përafuar me direktivën e Këshillit 79/409/EEC, Ligji nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", të cilat reflektojnë nenet 174-176, të titullit xix për Mjedisin, të traktatit për krijimin e Komunitetit Evropian

Legjislacioni mjedisor në fushën e mbrojtjes së natyrës përfshin:

- VKM nr. 451, dt. 16.09. 1993 "Për administrimin e shpellave"
- VKM nr.413, dt.22.8.1994 "Për shpalljen e Lagunës së Karavastasë dhe Parkut të Divjakës si ekosistem natyror veçanërisht i mbrojtur për t'u përfshirë në listën e konventës së Ramsarit".
- VKM nr.365, dt. 10.07.1995 "Për një ndryshim në VKM nr.451, dt.16.09.1993 "Për administrimin e shpellave"
- VKM nr. 80, dt.18.2.1999 "Për shpalljen Park Kombëtar të Prespës dhe "Peizazh i Mbrojtur tokësor/ujor" të Liqenit të Pogradecit".
- Ligji nr.8906, dt.06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura" mbështetur në kategorizimin dhe kriteret e IUCN-së për zonat e mbrojtura.
- VKM nr.364, dt.18.07.2002 "Për miratimin e planit "Administrimi i Zonës bregdetare".
- VKM nr.648, dt.13.12.2002 "Për ndalimin e përkohshëm të prerjes së lëndëve drusore me përjshim të asaj që përdoret për dru zjarri".
- VKM nr.676, dt.20.12.2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur e monumenteve të natyrës shqiptare".
- VKM nr.531, dt.31.10.2002 "Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit dhe të territorit përreth tij zonë natyrore veçanërisht e mbrojtur dhe përfshirjen e tij në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë"
- VKM nr.267, dt.24.4.2003 "Për procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike".

- VKM nr.266, dt. 24.4.2003 “Për administratat e zonave të mbrojtura”
- VKM nr.804, dt.4.12.2003 “Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare, që vihen në mbrojtje”, mbështetur në nenin 5 të “Convention on the conservation for the protection European wildlife and natural habitats Bern, 1979”.
- VKM nr.807, dt.4.12.2003 “Për rregullat e dhënies në përdorim të shpellave”
- VKM nr.680 dt. 22.10.2004 “Për shpalljen e sistemit ligatinor Vjosë-Nartë, pejsazh ujor-tokësor i mbrojtur”
- VKM nr.682 dt. 02.11.2005 “Per shpalljen e lumit Buna dhe te territoreve ligatinore perreth tij ”Peisazh ujor/tokesor i mbrojtur””
- VKM nr.683 dt. 02.11.2005 “Per shpalljen e kompleksit ligatinor te liqenit te Shkodres e te zones se lumit Buna, zone vecanerisht e mbrojtur dhe perfshirjen e tij ne listen e ligatinave me rendesi nderkombetare, vecanerisht si habitate te shpendeve te ujit”
- VKM nr. 684, dt 02.11.2005 “Për shpalljen e zonës shqiptare të Liqenit të Shkodrës Rezervat Natyror i Menaxhuar ”
- VKM nr. 693, dt. 10.11.2005 “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit Park Kombëtar”
- Janë ratifikuar/aderuar/nënshkruar marrëveshjet shumëpalëshe të mëposhtme:
- Konventa për Diversitetin Biologjik, Rio 1992. Ratifikuar me 5.04.1994.
- Konventa për Mbrojtjen dhe përdorimin e drejtimeve ujore ndërkufitare dhe liqenet ndërkufitare, Helsinki 1992. Ratifikuar në 05.03.1994.
- Konventa për ligatinat e rëndësisë ndërkombëtare veçanërisht për habitatet e shpendëve ujorë, Ramsar 1971. Ratifikuar në 29.03.1996.
- Konventa për ruajtjen e habitateve naturale dhe jetën e egër në Europë, Bërn 1979. Ratifikuar në 2.03.1998.
- Konventa për ruajtjen e specieve migruese të kafshëve të egra, Bonn 1997. Nënshkruar në Nëntor 2000 si dhe marrëveshjet e saj ACCOBAMS dhe EUROBATS
- Konventa për Luftën Kundër Shkretëtirëzimit. Ratifikuar në 2000.
- Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara (CITES). Aderuar me Ligjin nr. 9021, datë 6.03.2003
- Protokolli i Kartagjenës për Biosigurinë i Konventës për Diversitetin Biologjik, 2000. Aderuar me ligjin Nr. 9279, datë 23.09.2004 “ Për aderimin e RSH -ës në Protokollin e Kartagjenës për Biosigurinë të Konventës “ Për larminë biologjike””.

2.2. Kuadri institucional ekzistues

Në funksion të zbatimit të legjislacionit aktualisht ekzistojnë institucionet e mëposhtme:

Drejtoria e Politikave të Mbrojtjes së Natyrës në MMPAU, e cila mbulon çështjet e lidhura me mbrojtjen e natyrës dhe zonave të mbrojtura. Ajo ka në përbërje 9 specialistë (përfshirë Drejtorin dhe tre shefa Sektorësh) dhe tre sektorë të angazhuar me problemet e mbrojtjes së natyrës. Në ndihmë të funksionimit të kësaj Drejtorie, është dhe **Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (Sektori i Legjislacionit)** që angazhon sipas rastit 1-2 specialistë në hartimin e legjislacionit në këtë fushë. Kjo drejtori harton legjislacionin dhe dokumentat strategjike që lidhen me këtë fushë. **Drejtoria e Politikave të Pyjeve dhe Kullotave** dhe strukturat e saj nëpër rrethe hartojnë, zbatojnë dhe kontrollojnë legjislacionin për pyjet dhe kullotat.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave në fushën e mbrojtjes së natyrës bashkëpunon me:

Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, duke siguruar vendim-marrjen për përdorimin e territorit.

Ministrinë e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, e cila harton dhe zbaton politikat për zhvillimin e turizmit.

Ministrinë e Brendshme, me qëllim menaxhimin e burimeve natyrore lokale.

2.3. Asistenca teknike dhe financiare

Fusha e mbrojtjes së Natyrës mbështetet nga projektet e mëposhtme:

Projekti i Fondit Global i Mjedisit nëpërmjet PNUD-it (GEF/UNDP)“ Ruajtja e Ekosistemit ligatinor dhe bregdetar në rajonin e mesdheut “ me një shumë prej 1,901,000 USD

Projekti i Fondit Global i Mjedisit nëpërmjet Bankës Botërore (GEF/BB) “Vlerësimi i nevojave për ngritjen e kapaciteteve për prioritetet e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin e Shqipërisë” me shumë prej 324 000 USD

Projekti i Fondit Global i Mjedisit nëpërmjet PNUD-it (GEF/UNDP) “Vetëvlerësimi i nevojave për kapacitetet kombëtare për menaxhimin e mjedisit global”, 215,000 USD

Projekti i Fondit Global i Mjedisit nëpërmjet Bankës Botërore (GEF/BB) “Menaxhimi i Integruar i Ekosistemit të Liqenit të Shkodrës” me një shumë prej 175, 000 USD

3. Adresimi i prioritetëve

3.1. Prioritet afatshkurtra

Prioritet afatshkurtra janë:

- *Përafrimi i legjislacionit me atë komunitar për natyrën lidhur me habitatet natyrore*

- *Zgjerimi i zonave të mbrojtura*

- *Zbatimi i konventave ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është palë në fushën e mbrojtjes së natyrës.*

- *Forcimi i kapaciteteve administrative dhe bashkërendimi në nivel kombëtar dhe vendor.*

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Ligji “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i cili do të përafrohet pjesërisht me direktivën e habitatve +Natura 2000

VKM “Për shpalljen e zonave të Mbrojtura”, i cili do të përafrohet pjesërisht me direktivën e habitatve +Natura 2000 dhe do të konsistojë në shpalljen e zonave të reja të mbrojtura çdo vit duke synuar që brenda vitit 2009 sipërfaqja e zonave të mbrojtura të arrijë në 14% të territorit të vendit.

Projektligji “Për tregtinë e specieve”, i cili do të përafrohet pjesërisht me direktivat 83/129/EEC dhe amendimet, Rregullorja 348/81/EEC, 1771/94/EC, 348/81/EC.

Ligji nr.8906, dt.06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura” do të plotësohet edhe me aktet e mëposhtme:

“Për shfrytëzime turistike të rezervateve natyrore të menaxhuar nga turistët”.

“Rregullore për monumentet e natyrës shqiptare”

3.1.2. Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Ndjekja e zbatimit të ligjit për Biodiversitetin

Forcimi i strukturave administrative të zonave të mbrojtura dhe zbatimi i planeve të menaxhimit

Përgatitja e kuadrit institucional për një Autoritet Shkencor dhe Menaxhimi për zbatimin e Konventës së CITES në Shqipëri

Përcaktimi i organit kompetent inspektues për monitorimin e aktiviteteve tregtare me speciet e faunës dhe florës së egër; përgatitja e planit të zbatimit të CITES

Tabela e mëposhtme tregon detaje më të hollësishme të investimeve që parashikohen të kryhen për forcimin e kapaciteteve administrative të institucione që merren me mbrojtjen e natyrës.

3.2. Prioritete afatmesme

Prioritet afatmesme janë:

- *përafrimi i legjislacionit me atë komunitar për natyrën lidhur me shpendet e egër dhe tregtinë e llojeve*

- *zbatimi i legjislacionit të përafëruar në fazën afatshkurtër*

- *dyfishimi i zonave të mbrojtura*

- *Zbatimi i konventave ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është palë në fushën e mbrojtjes së natyrës.*

- *Forcimi i kapaciteteve administrative dhe bashkërendimi në nivel kombëtar dhe vendor.*

3.2.1. Iniciativat ligjore afatmesme

Projekt - ligj “Për mbrojtjen e zogjve të egër” në përputhje me direktivën 79/409/EEC me amendimet.

Rregullore “Për tregtinë e specieve”

VKM për shpalljen e zonave të reja të mbrojtura

3.2.2. Aktivitete zbatuese afatmesme

Aktivitet që parashikohen të kryhen gjatë kësaj periudhe janë:

Ngritja e një skeme të rreptë liçencimi të detyruar për importet dhe eksportet e specieve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër; ngritja e një skeme për inspektimin e transportit në dogana;

Vlerësimi i nevojave për trajnim; hartimi dhe realizimi i programit të plotë të trajnimit për stafet e autoriteteve kompetente,

Rekrutimi i stafit shtesë për këtë nën-sektor.

3.3. Prioritete afatgjata

Prioritet afatgjata janë:

- Përafrimi i legjislacionit me atë komunitar për natyrën

- Zbatimi i legjislacionit të përafruar në fazën afatshkurtër dhe afatmesme

- Zbatimi i konventave ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është palë në fushën e mbrojtjes së natyrës.

- Forcimi i kapaciteteve administrative dhe bashkërendimi në nivel kombëtar dhe vendor.

3.3.1. Iniciativa ligjore afatgjata 2009-2012

Projektiligj “Për mbajtjen e kafshëve në kopshte zoologjike, përdorimin e tyre për qëllime eksperimentale dhe shkencore” në përputhje me Direktivat 2003/65/EC, 1999/22/EC, 86/609/EC dhe Vendimet e Komisionit 90/67/EEC, 1999/575/EC.

Projektiligj “Për tregtinë e gëzofit dhe lëkurave të fokave”. Në përputhje me Direktivën 83/129/CECC.

3.3.2. Aktivitete zbatuese afatgjata 2009-2012

Caktimi i organit kompetent për liçencimin e kopshteve zoologjike;

Ngritja e një sistemi monitorimi për liçencat, inspektimin dhe detyrimin;

Ngritja e një Komiteti Këshillimor për mbrojtjen e kafshëve të përdorura për qëllime shkencore;

Ngritja e një sistemi monitorimi për kontrollin e përdorimit të kafshëve për qëllime shkencore dhe eksperimente

Tabela 1 Forcimi i kapaciteteve institucionale të Strukturave të Mbrojtjes së Natyrës

AKTIVITETI	2007	2008	2009
Forcim	Administrata e	Administrata e	Administrata
struktur	Zonës së	Zonës së	e zonës
e	mbrojtur	mbrojtur	së
(shtim	të Dajtit	Tomor	mbrojtur
persona	dhe	Rajcë	r të
sh)	Divjakës	Shebeni	Bredhit
	5 persona	k	të
	1,500,00	2 persona	Hotovë
	0 lek	600,000	s dhe
		lek	Lurës
			2 persona
	Administrata e		600,00
	Zonës së		0 lek
	mbrojtur		
	Llogara		
	dhe		
	Kune		
	Vain 3		
	persona		
	900,000		
	lek		

Trajnime	Administrata e zonës Dajt /Divjake 1,300,000 lek	Zbatimin e direktivës së shpendëve në vendet e BE 2,500,000 lek	Administrata e zonës së mbrojtura të Bredhit të Hotove dhe Lures 1,300,000 lek
	Zbatimi i Ligjit të biodiversitetit 2,500,000 lek	Administrata e Zonës së mbrojtur Tomor Rajcë Shebeni 1,300,000 lek	
	Stafi që merr pjesë në lëshimin e certifikatave të CITES 1,300,000 lek	legjilacioni ndërkombëtar 2,000,000 lek	
	legjislacionin ndërkombëtar 2,000,000 lek		
	Administrata e Zonës së mbrojtur Llogara dhe Kune Vain 1,300,000 lek		

3.22.6 NDOTJA DHE RREZIQET INDUSTRIALE

Objektivi Politik

Rehabilitimi i vatrave të nxehta mjedisore dhe zhvillimi i një industrie sa më pak ndotëse, që zbaton normat dhe standartet mjedisore, është një prioritet edhe në Programin e Qeverisë Shqiptare 2005-2009, i cili stimulon zhvillimin e teknologjive të pastra, të cilat duhet të pakesojnë shkarkimet e demshme në mjedis (në ujë, ajër, tokë, etj). Programi i Qeverisë thekson se është e rëndësishme të kuptohet dhe zbatohet me rreptësi parimi “dëmtuesi paguan koston e plote”, mbi bazën e të cilit çdo aktivitet industrial duhet të bëjë investimet e nevojshme për trajtimet e ujrave teknologjike, për të pakesuar emetimet në ajër, asgjësimin e përshtatshëm mjedisor të mbetjeve të tij, por edhe të paguajë për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar, qoftë edhe aksidentalisht.

Nëni 108 i MSA-se thekson se “Palet do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin e tyre në

detyren shume te rendesishme te luftimit te degradimit mjedisor, me synim promovimin e qendrueshmerise ne mjedis. Bashkepunimi do te fokusohet kryesisht ne fusha prioritare qe lidhen me Acquis ne fushen e mjedisit.

Fushat prioritare ne sektorin e mjedisit jane percaktuar ne nje sere dokumentash te tjere si: ne Dokumentin e Partneritetit European per Shqiperine 2004 dhe 2005, te cilat kerkojne marrjen e masave per rehabilitimin e vatrave te nxehta mjedisore. Rendesi i kushtohet vecanerisht rehabilitimit te ndotjes historike dhe me pasoja te vazhdueshme ne mjedis, ne fushen naftembajtese te Patos -Marinzes dhe ne Rafinerine e naftes ne Ballsh.

Ne SAP 2004 percaktohet se “Shkalla e lartë e ndotjes nga Rafineria e Naftës në Ballsh dhe në zonën naftëmbajtëse rreth saj është e papranueshme. Aty ka çlirim hidrokarburesh në ajër dhe në tokë, ndërsa uji është mjaft i ndotur. Derdhjet e vazhdueshme të naftës në lumin Gjanicë po dëmtojnë biodiversitetin e vetë lumit, të detit Adriatik dhe shëndetin e njerëzve në përgjithësi. Ndotje po shkaktojnë edhe industria e bakrit dhe e kromit”. Ne periudhen afat-mesme, konsiderohet i rendesishem identifikimi i vatrave toksike. Sipas identifikimeve te ARM-ve dhe informacioneve te tjera eshte konstatuar prezenca e kimikateve aktive apo te skaduara te depozituara ne magazinat te vjetra, apo ne ndermarrje, te cilat e kane ndryshuar aktivitetin e tyre. Keto jane te rrezikshme si per mjedisin, ashtu edhe per banoret e komunitetit rreth tyre.

Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Jane nenshkruar /ratifikuar konventat dhe protokollet e meposhtme:

Protokolli i Konventes se Barcelones “Per prandalimin e ndotjes se Mesdheut nga levizja nderkufitare e mbetjeve te rrezikeshme dhe asgjesimi i tyre” .

Konventa e Bazelit per kontrollin e levizjeve nderkufitare te mbetjeve te rrezikshme dhe asgjesimi i tyre, nenshkruar ne 26.06.1999.

Konventa per efektet nderkufitare te aksidenteve industriale, ratifikuar ne 05.01.1994.

Konventa per mbrojtjen e shtreses se Ozonit. Protokolli i Montrealit.

Kuadri institucional ekzistues

Institucionet pergjegjese per ceshtjet e ndotjes industriale jane MMPAU, METE, MPPTT.

MMPAU nuk ka asnje specialist te dedikuar plotesisht ndaj kesaj ceshtje. Problemet e ndotjes dhe rrezikut prej industrise mbulohen respektivisht sipas llojit te problemit/komponentetit te mjedisit te rrezikuar, nga stafi prej 4 specialistesh i Drejtorise se Politikave te Parandalimit te Ndotjeve. Sektori juridik, angazhon sipas rastit, krahas shume fushave te tjera, 1 jurist per hartimin e legjislacionit ne kete fushë

2.3. Asistenca teknike dhe financiare

Ne fushen e reduktimit te ndotjes industriale jane duke u zhvilluar disa projekte:

Titulli i projektit: Ngritja e impiantit te trajtimit te mbetjeve ujore ne Rafinerine e Naftes ne Ballsh. Instucioni drejtues: MM; Kohezgjatja e priteshme e projektit: 2005-2006; Donori: CARDS 2002; Buxheti: 900,000EURO; Objektivi: Rehabilitimi i Rafinerise se Naftes ne Ballsh, per ta bere ate te punoje me kapacitet te plote ne perputhje me standartet e Bashkimit European. Projekti menaxhohet nga Delegacioni i KE –se ne Tirane.

Nje projekt tjeter ne vazhdim te te meparshmit eshte siguruar nga CARDS 2005 (1 MEUR) per eliminimin e ndotjeve ne Rafinerine e Naftes ne Ballsh.

Titulli i projektit: “Studim Fizibiliteti dhe Projektim Inxhinierik per Landfillin e Mbetjeve Industriale”, me fonde te siguruar nga CARDS 2002 qe arrin shumen prej 600,000 EURO dhe filloi me 16 gusht 2004.

Titulli i projektit: Ndertimi i landfillit te mbetjeve te rrezikshme. Ky projekt do pasoje projektin “Studim Fizibiliteti dhe Projektim Inxhinierik per Landfillin e Mbetjeve Industriale”, me nje fond prej 3,500,000 EURO nga CARDS 2004, per ndertimin e landfillit mbi bazen e ketij studimi

Nje projekt tjeter prej 3 MEUR eshte siguruar nga CARDS 2006 per transportin e mbetjeve nga zonat e nxehta ne landfillin e mbetjeve te rrezikeshme.

Nje projekt tjeter eshte siguruar nga CARDS 2005 (1.5 MEUR) per te vazhduar punen e nisur per eliminimin e sulcionit arsenikal ne ish-Uzinen e Nitrat Amonit ne Fier.

3. Adresimi i prioriteteve

Prioritetet afatshkurtra (2006 – 2007)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë shqiptare për periudhën 2006-2007 janë si më poshtë:

Të forcohen kapacitetet administrative dhe bashkërendimi në nivel kombëtar dhe vendor.

Të zbatohet legjislacioni për vlerësimin e ndikimit të mjedisit.

Të miratohet një strategji për harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit për mjedisin me acquis të BE-së dhe të zbatohet siç duhet legjislacioni ekzistues, veçanërisht për sa i përket ekzekutimit.

Të merren masa në vatrat problematike që ndotin mjedisin, si landfilli i inerteve në Sharrë dhe zona Patos-Marinëz e nxjerrjes së naftës.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Do të vazhdoje zbatimi i projektit për ngritjen e impiantit të trajtimit të mbetjeve ujore në Rafinerinë e Naftës në Ballsh dhe

projekti për azhurnimin e situatës në Patos Marinëz.

Prioritetet afatmesme (2008-2009)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008-2009 janë si më poshtë:

Të vazhdohet me përpjekjet për adresimin e vatrave toksike.

Të zvogëlohet ndotja që shkakton rafineria e Ballshit, përfshi edhe shkarkimet në lumin e Gjanicës dhe të merren masa kundër ndotjes së ujit në përgjithësi.

Të forcohet monitorimi i mjedisit dhe ndotësit të ndëshkohen me sanksione të rrepta.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Do të hartohet projektligji “Për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes”, që do të transpozohet direktivën e IPPC-se, si direktiva kuader me e rëndësishme në këtë fushë.

3.2.2. Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Do të vazhdoje zbatimi i projektit të Ballshit, faza e dytë e projektit të eliminimit të stokut të arsenikut në Fier dhe

do të punohet për forcimin e kapaciteteve në DPPN/MMPAU.

Prioritetet afatgjata (2010-2012)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2010-2012 janë si më poshtë:

Detyrat për përafrimin e legjislacionit në këtë fushë janë planifikuar kryesisht për periudhën 10 vjeçare. Realizimi i tyre kërkon sigurimin e një eksperti shtesë të dedikuar për këtë fushë.

3.3.1. Iniciativat ligjore afatgjata

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2010-2012 janë si më poshtë:

Do të hartohen ligje që do parandalojnë ndotjen e ajrit nga impiantet industriale dhe impiantet e medha të djegjes si: termocentralet, incineratorët, etj.

Do të hartohen edhe projektakte që vendosin norma dhe kufizime për shkarkimet e komponentëve organikë volatilë, si edhe për kontrollin e aksidentëve nga rreziqe të medha, lidhur me substanca të rrezikshme.

3.3.2 Aktivitetet zbatuese afatgjata

Për adresimin e prioritetëve afatgjata do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Forcimi kapaciteteve në MMPAU me 1 specialist për ndotjen industriale.

Realizimi i projekteve të rëndësishme investuese si: faza e dytë e projektit në Rafinerinë e Naftës në Ballsh;

faza e dytë e projektit të arsenikut si edhe çkontaminimi dhe rehabilitimi i territorit të ish-uzines së Nitrates Amonit në Fier. Nderkohe, duke patur parasysh problemet e medha të ndotjes së mjedisit që krijohen në fushën naftembajtëse të Patos-Marinës, parashikohet të bëhet azhurnimi i saj.

Vlerësimi i nevojave për trajnime dhe hartimit të programit përkatës në këtë fushë për IPPC-

ne si dhe trajnimi lidhur me përmbajtjen e detajuar të dokumentave për BREF-s.

Zhvillimi i aktiviteteve trajnuese me specialiste të DPPN-se dhe DVNML në MMPAU, inspektoreve të mjedisit dhe ARM-ve.

Tabela 1 Forcimi i kapaciteteve institucionale të strukturave të parandalimit të ndotjes

AKTIVITETI	2007	2008	2009
Forcim strukture (shtim personash)	0	0	1
Trajnime	0	0	1.200.000ALL

3.22.7 KIMIKATET

Objektivi politik i fushës

Menaxhimi i qëndrueshëm i kimikateve, përveçse një detyrim që rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, përbën dhe një nga objektivat e Qeverisë Shqiptare, përfshirë edhe në Programin e saj 2005-2009. Objektivi synon në stimulimin e zhvillimit të teknologjive të pastra, të cilat përveç të tjerave duhet të përdorin lëndë kimike të çertifikuara në mënyrë që të pakësojnë shkarkimet e dëmshme në mjedis (në ujë, ajër, tokë, etj). Për këto arsye, përafrimi i legjislacionit në fushën e kimikateve do të fillojë në periudhën afatmesme dhe do të vijojë në atë afatgjatë.

Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Legjislacioni mjedisor për kimikatet, përfshin:

Ligjin nr.9108, dt.17.07.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”, mbështetur në Konventën e Baselit “Për kalimin ndërkufitar të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre” dhe Konventën e Stokholmit për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm (POP-s);

VKM nr. 824, dt.11.12.2003 “Për klasifikimin, paketimin, etiketimin dhe ruajtjen e sigurtë të substancave dhe preparateve të rrezikshme”, mbështetur në Direktivën 1999/45/EC;

VKM nr.26, dt.31.01.1994 “Për mbetjet e rrezikshme dhe mbeturinat”;

VKM nr.447, dt.19.09.1994 “Për ndalimin e përdorimit të asbestit si material termoizolues në të gjitha llojet e ndërtimit”;

VKM nr.447, dt.16.09.1999 “Për shkatërrimin e mbetjeve toksike të magazinuara në depot e ushtrisë”;

Ligji nr.9263, dt. 29.07.2004 “Për ratifikimin e Konventës për ndotësit organike të qëndrueshëm”.

Kuadri institucional

Çështjet e menaxhimit të kimikateve janë detyrë e disa institucioneve si MMPAU, METE, MBUMK, MPPTT, MPCSSHB.

Në MMPAU nuk ka asnjë specialist teknik për menaxhimin e kimikateve, por specialisti për mbetjet dhe 1 jurist, sipas rastit, krahas çështjeve të tjera, mbulojnë edhe ato të kimikateve. Instituti i Mjedisit, në varësi të MMPAU është caktuar si Qendër Nacionale Reference e Agjencisë Europiane të Mjedisit për Kimikatet.

2.3. Asistenca e Huaj

Në fushën e menaxhimit të kimikateve, janë duke u zhvilluar projektet:

Titulli i projektit “Përgatitja e Planit Kombëtar në zbatim të Konventës së Stokholmit Ndotësit Organik të Qëndrueshëm”; Institucioni drejtues: MM; Kohëzgjatja e projektit: 2005-2006; Donori: UNDP/GEF; Buxheti: 378,400 USD; Objektivi: Për të forcuar aftësitë e Shqipërisë për të plotësuar detyrimet e saj nën Konventën e Stokholmit, përfshirë përgatitjen e Planit Kombëtar të Zbatimit të POP-seve. Ky plan do të përcaktojë burimet e NOQ-eve dhe rrugët për menaxhimin e vendeve të ndotura prej tyre.

Titulli i projektit “Plani Kombëtar i nxjerrjes nga përdorimi i substancave ozon-holluese” ;

Institucioni drejtues: MM; Kohëzgjatja e projektit: 2003-2009; Donori: UNEP/UNIDO; Buxheti: 672,125 USD; Objektivi: Qëllimi kryesor i projektit është forcimi i kuadrit ligjor dhe institucional për realizimin e Planit Kombëtar për Nxjerrjen Jashtë Përdorimit të Substancave Ozon-holluese, duke zbatuar një sistem të licencave sipas sasive.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Identifikimi i vatrave toksike;

Plotësimi nga ana e palës shqiptare të detyrimeve që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme **zbatuese:**

Zbatimi i projektit të UNDP/GEF "Përgatitja e Planit Kombëtar në zbatim të Konventës së Stokholmit për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm (POPs);

Krijimi i zyrës së regjistrimit të kimikateve.

3.2. Prioritetet afatmesme

Të forcohet monitorimi i mjedisit dhe ndotësit të ndëshkohen me sanksione të rrepta;

Të vazhdohet me zbatimin e angazhimeve rajonale dhe ndërkombëtare për mjedisin

3.2.1. Iniciativat ligjore afatmesme

Prioritetet e Qeverisë Shqiptare për periudhën 2008-2009 janë si më poshtë:

Hartimi i një sërë ligjesh të rëndësishme, bazuar në nëndarjen që ekziston në legjislacionin European në fushën e kimikateve;

Hartimi i listës së substancave dhe preparateve të rrezikshme, të cilat do të kufizohen ose ndalohen të hidhen në treg apo të përdoren në produkte të konsumit.

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Plotesimi i stafit të DPPN/MMPAU me 1 specialist për kimikate;

Funksionimi i Zyrës së Regjistrimit të Kimikateve, e cila do të krijojë, regjistrojë dhe administrojë të gjithë informacionin kombëtar për kimikate që do të hyjnë në Shqipëri, industritë dhe aktivitetet që do t'i përdorin ato, sasitë përkatëse, do të përcaktojnë rregullat për etiketimin, kushtet e ruajtjes, etj.

Trajnimi i inspektorëve të mjedisit, inspektorëve të punës dhe doganierëve.

3.3. Prioritetet afatgjata

3.3.1. Iniciativat ligjore afatgjata

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2010-2012 janë si më poshtë:

Hartimi i ligjeve që do t'i adresohen rregullave dhe procedurave për importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme;

Hartimi i masave të sigurisë në transportin e substancave apo preparateve kimike;

Hartimi i ligjeve që iu adresohen kimikateve të veçanta me impakt potencial në mjedis si: NOQ-të, Asbesti dhe kimikate që përdoren në formulimin e detergjenteve e pasojave në mjedis nga përdorimi tyre.

3.3.2 Aktivitetet zbatuese afatgjata

Për adresimin e prioriteteve afatgjata do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Pas perfundimit të projektit të UNDP/GEF "Përgatitja e Planit Kombëtar në zbatim të Konventës së Stokholmit për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm, do të vazhdojë puna për zbatimin e detyrave që do përcaktojnë ky plan.

Forcimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të inspektorëve të mjedisit, inspektorëve të punës dhe doganierëve, fushatat e trajnimit do të vazhdojnë edhe në këtë periudhë.

Tabela 1: Forcimi i kapaciteteve institucionale të Strukturave në fushën e kimikateve

AKTIVITETI	2007	2008	2009
Forcim strukture (shtim personash)	2	0	1

3.22.8 ORGANIZMAT E MODIFIKUAR GJENETIKISHT

1. Objektivi Politik

Organizmat e modifikuara gjenetikisht janë një prej nënfushave prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e mjedisit. Objektivi politik i kësaj fushe ka të bëjë me përafrimin e legjislacionit me acquis lidhur me standartet mjedisore dhe detyrën jetësore për të luftuar degradimin e mjedisit me qëllim që të promovohet qëndrueshmëria mjedisore.

2. Situata aktuale

2.1. Kuadri ligjor ekzistues

Kuadri ligjor mbështetet në ligjin Nr. 9279, datë 23.09.2004 “ Për aderimin e RSH –së në Protokollin e Kartagjenës për Biosigurinë të Konventës “ Për larminë biologjike””.

Në përputhje me metodën e përkujdesjes të parimit 15 të Deklaratës së Rios për mjedisin dhe zhvillimin, objektivi i këtij protokolli është të kontribuojë në sigurimin e një niveli të mjaftueshëm mbrojtjeje në fushën e transferimit, administrimit dhe përdorimit të sigurtë të organizmave të gjalla të modifikuara, që rezultojnë nga bioteknologjia moderne e që mund të kenë ndikim negativ në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të larmisë biologjike duke marrë parasysh rreziqet për shëndetin e njeriut dhe veçanërisht duke u fokusuar në lëvizjet ndërkufitare.

2.2. Kuadri institucional ekzistues

Politikat për OMGJ - në mbulohen nga këto institucione:

1. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, (mbjelljet, ushqimet dhe tregtimin)

2. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave – Drejtoria e Politikave të Mbrojtjes së Natyrës (introduktimin në mjedis)

3. Ministria e Shëndetësisë (mikroorganizmat në gjendje të mbyllur dhe ndikimet në shëndetin e njeriut) dhe

4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës (zhvillimin e bioteknologjisë).

Ministritë bashkëpunojnë me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për zbatimin e Protokollit të Biosigurisë lidhur me lëvizjet ndërkufitare të OMGJ -së. Institutet kërkimore shkencore dhe reference në varësi të Ministrive të përmendura së bashku me universitetet dhe Akademinë e Shkencave nëpërmjet Institutit të Kërkimeve Biologjike janë identifikuar për kryerjen e procedurës së vlerësimit të rrezikut të OMGJ -së.

2.3.Asistenca teknike dhe financiare të përfituara dhe në proces

Është duke u zbatuar projekti “Ndërtim kapaciteti për pjesëmarrje afektive në mekanizmin e Shkëmbimit të Informacionit për Biosigurinë i UNEP/GEF me shumë : 66,980 USD

3. Adresimi i prioriteteve

Prioritet është miratimi i legjislacionit të përfuar për OMGJ –të në periudhën afatgjatë.

3.1.1. Nismat ligjore afatshkurtra dhe afatmesme

përkthimi i direktivave për OMGJ- në

përgatitja e draft - ligjeve si më poshtë

3.1.2..Nismat ligjore afatgjata 2010-2014

Transpozimi i EU Acquis për OMGJ -të. Gjatë kësaj periudhe do të transpozohen në dy paketa ligjore kombëtare 11 akte europiane.²³

²³ Paketa e parë për t'u miratuar në 2011

1. Direktiva 2001/18/EC Directive 2001/18/EC of European Parliament and of council of 12 march 2001 on deliberate release into environment of genetically modified organisms and repealing council directive 90/220/EEC 2. Vendimi 2002/811/EC Council Decision 2002/811/EC of 3 October 2002 establishing guidance notes supplementing annex VII to directive 2001/18/EC of European parliament and of council on the deliberate release into environment of GMOs and repealing council directive 90/220/EEC 3. Vendimi 2002/623/EC Commission Decision 2002/623/EC of 24 July 2002 establishing guidance notes supplementing annex II to directive 2001/18/EC ... (text with EEA relevance) 4. Rregullorja 1830/2003 Regulation 1830/2003 of European Parliament and of Council of 22 September 2003 concerning the traceability and labeling of GMOs and the traceability of food and feed products produced from genetically modified organisms and amending directive 2001/18/EC 5. Vendimi 2002/813/EC Council decision 2002/813/EC of 3 October 2002 establishing pursuant to directive 2001/18/EC of European Parliament and of Council, the summary notification information format for notifications concerning the deliberate release into the environment of genetically modified organisms for purposes other than for placing on the market 6.Vendimi 2003/701Commission decision 2003/701/EC of 29 September 2003 establishing pursuant to directive 2001/18/EC of European Parliament and of council a format for presenting the results of the deliberate release into environment of genetically modified higher plants for purposes other than placing on the market.

3. Aktivitete zbatuese

Afatgjata 2009-2012

caktimi i autoritetit kompetent për OMGJ-të.

Ngritja e një mekanizmi për organizimin e inspektimeve.

Informimi i aplikuesve dhe publikut për procedurat.

Zhvillimi i një sistemi vlerësimi të rrezikut

Hartimi i kriterëve për planet emergjente

Ngritja e një sistemi të menaxhimit të dokumentave me sistem të dhënash në lidhje me të gjithë informacionin përkatës.

Ngritja e një sistemi të dhënash për t'u raportuar në Komisionin Europian.

3.22.9 ZHURMAT

Objektivi Politik

Gjatë fazës së parë të përcaktuar në Nenin 6 të kësaj MSA-se, përafrimi përqendrohet në elementët thelbësorë të acquis së Tregut të Brendshëm ashtu si dhe në fusha të tjera të rëndësishme si konkurrenca, të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, prokurimi publik, standardet dhe certifikimi, shërbimet financiare, transporti detar dhe tokësor – duke i kushtuar rëndësi të veçantë sigurisë dhe standardeve mjedisore si dhe aspekteve sociale –, ligji për shoqëritë tregtare, kontabiliteti, mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e të dhënave, shëndeti dhe siguria në punë dhe mundësi të barabarta. Gjatë fazës së dytë, Shqipëria përqendrohet në pjesët e mbetura të acquis.

Neni 108 i MSA-se – Mjedisi thekson se “Palet do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkepunimin e tyre në detyren shumë të rëndësishme të luftimit të degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë në mjedis. Bashkepunimi do të fokusohet kryesisht në fusha prioritare, që lidhen me Acquis në fushën e mjedisit”. Kjo do të thotë që përafrimi i legjislacionit do të përfshijë edhe fushën e menaxhimit të zhurmave në mjedis,

Sipas nenit 70/3 të MSA, zhurmat nga automjetet në transportin rrugor paraqiten me prioritet, për t'u trajtuar në periudhën afatshkurter. Kurse zhurmat nga aviacioni etj. janë planifikuar për periudhat pasuese.

Zhurmat urbane gjatë 10vjeçarit të fundit kanë patur një rritje të ndjeshme sidomos në Tiranë. Burimi kryesor është trafiku dhe pjesërisht dhe aktivitetet e tjera (qofte dhe industri të vogla që zhvillohen në zona urbane / të banuara).

Monitorimi i zhurmave në disa qytete të mëdha ka filluar vetëm në 2-3 vitet e fundit, të realizohet nga MMPAU. Mbi këtë është krijuar një bazë të dhënash për zhurmat, që mund të shërbejë për vlerësimin e trendit në këtë drejtim.

Në këtë plan është planifikuar që përafrimi i legjislacionit për zhurmat të mbështetet në direktivat përkatëse të KE-së dhe gjetjet e raporteve të monitorimit të zhurmave urbane në vitet e fundit. Përafrimi i legjislacionit për zhurmat është planifikuar të realizohet në periudhën afat-shkurter, afatmesme dhe afatgjatë.

Situata aktuale

Kuadri ligjor ekzistues

Në 2004 u miratua akti i parë dhe i vetëm për normat për zhurmat nga automjetet:

Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë të Mjedisit dhe Ministrisë të Transportit dhe Telekomunikacionit Nr. 6527, datë 24.12.2004 “Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmat shkaktuar nga mjetet rrugore dhe menyrat e kontrollit të tyre”.

Kuadri institucional ekzistues

Institucionet përgjegjëse janë MMPAU, MSH, MPPTT. MMPAU nuk ka asnjë specialist të

Paketa e dytë për t'u miratuar në 2012

1. Vendimi 2002/812/EC Council decision 2002/812/EC of 3 October 2002 establishing pursuant to directive 2001/18/EC of the European parliament and of council the summary information format relating to the placing on the market of genetically modified organisms as or in products 2. Vendimi 2004/204/EC Commission decision 2004/204/EC of 23 February 2004 laying down detailed arrangements for the operating of the registers for recording information on genetic modifications in GMOs, provided for in directive 2001/18/EC of European parliament and of council (text with EEA relevance) 3. Rregullore 65/2004/EC Commission regulation 65/2004/EC of 14 January 2004 establishing a system for the development and assignment of unique identifiers for GMOs 4. rekomandim 2004/787/EC Commission recommendation 2004/787/EC of 4 October 2004 on technical guidance for sampling and detection of GMOs and material produced from GMOs as or in products in the context of regulation 1830/2003/EC 5 direktiva 90/219/EEC e amenduar Council directive 90/219/EEC of 23 April 1990 on the contained use of genetically modified microorganisms amended by Council directive 98/81/EC

angazhuar me zhurmat, por sipas rastit, specialisti i monitorimit te ndotjes se mjedisit dhe 1 jurist mund te angazhohen ne kete fushe krahas shume fushave te tjera. Per kete arsye, behet e domosdoshme qe te sigurohet 1 specialist zhurmash ne Drejtorine e Politikave te Prandalimit te Ndotjeve, qe te mund t'i dedikohet teresisht kesaj fushe, si ne drejtim te hartimit, ashtu edhe te zbatimit te legjislacionit..

2.3. Asistenca teknike dhe financiare

Ne kete fushe, me perjashtim te monitorimit te zhurmave te financuar nga MMPAU, nuk ka pasur dhe as nuk ka projekte.

Adresimi i prioriteteve

3.1. Prioritetet afatshkurtra (2006 – 2007)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006-2007 janë si më poshtë:

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Do te hartohet Projektakti “Per nivelin e lejueshem te zhurmave urbane (nga atomjetet, motorcikletat dhe transporti hekurudhor).

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Do te vazhdoje monitorimi i zhurmave urbane nga institucionet vendase. Sic eshte theksuar edhe me lart, MMPAU nuk ka asnje ekspert te dedikuar per zhurmat. Per kete arsye, per te perballuar ngarkesen qe lidhet me perafkrimin e legjislacionit dhe zbatimin e tij ne kete fushe, eshte planifikuar te shtohet 1 specialist ne Drejtorine e Politikave te Prandalimit te Ndotjeve.

3.2. Prioritetet afatmesme (2008-2009)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008-2009 janë si më poshtë:

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Do te hartohet Projektligji “Per vleresimin dhe menaxhimin e zhurmave ne mjedis”.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Do te vazhdoje monitorimi i zhurmave urbane nga institucionet vendase dhe forcimi i kapaciteteve te DPPN ne kete fushe. Do te percaktohen autoritetet kompetente per zhurmat nga automjetet, do te trajnohet stafi i DPPN dhe aktore te tjere qe lidhen me kete fushe.

Prioritetet afatgjata (2009-2012)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2009-2012 janë si më poshtë:

3.3.1 Iniciativat ligjore afatgjata

Do te hartohet nje Projektakt “Per kufizimin e zhurmave nga aviacioni” si dhe nje tjetër projektakt “Per nivelet e zhurmave nga pajisjet e vendosura ne mjedisin e jashtem”.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Do te vazhdoje te kryhet monitorimi i zhurmave urbane nga institucionet vendase dhe do te forcohen ne vazhdimesi kapacitetet ne DPPN/MMPAU per zhurmat. Do te ngrihet nje sistem monitorimi per te verifikuar konformitetin e mjeteve, perfshire kontrollet ne vend. Do te vijohet me percaktimin e procedurave te penalizimit ne rast te mosrespektimit te rregullave dhe percaktimin e autoritetit kompetent ne certifikimin e aeroplanave ne lidhje me zhurmat. Do te kryhet nje vleresim i posacem per nevojat per trajnime dhe do te hartohet programi perkates, i cili me pas do te realizohet me stafet e institucioneve qe trajtojne zhurmat. Do te kryhet edhe certifikimi pajisjeve per testet e zhurmave. Kushtezimi i rregjistrimit te aeroplanave do te behet ne baze te certifikimit te tyre.

Tabela 1 Forcimi i kapaciteteve institucionale te strukturave te parandalimit te ndotjes

AKTIVITETI	2007	2008	2009
Forcim strukture (shtim personash)	1	0	0
Trajnime		1.200.000ALL	600.000ALL

3.22.10 SIGURIA BERTHAMORE DHE MBROJTJA NGA RREZATIMET

Objektivi Politik

Nje nga angazhimet e Shqiperise qe rrjedhin ne kuader te MSA-se, konkretisht nenit 108 te saj, eshte edhe perafrimi i legjislacionit ne fushen e sigurise berthamore dhe rrezatimeve.

Situata aktuale

Kuadri ligjor ekzistues

Aktualisht, per shkak te mungeses se prodhimeve radioaktive ne vend dhe perdorimit shume te kufizuar te burimeve radioaktive per qellime shendetesore dhe industriale, siguria berthamore dhe mbrojtja nga radioaktiviteti nuk kane qene prioritare ne Shqiperi dhe legjislacioni ne kete fushe nuk ka perparuar shume. Konventa per Sigurine Berthamore nuk eshte ratifikuar. Legjislacioni aktual ne kete fushe perfshin:

Ligjin nr.8095, dt.09.11.1995 “Per mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, mbeshtetur ne Konventen e Mbrojtjes nga Rrezatimet. Ai rregullon menaxhimin e mbetjeve radioaktive ne Shqiperi.

Ligjin nr. 8934, dt.05.09.2002, “Per mbrojtjen e mjedisit”.

VKM -n nr.103 dt. 31.03.2002 “Mbi monitorimin e mjedisit ne RSH”.

Kuadri institucional ekzistues

Institucionet pergjegjese ne lidhje me Sigurine berthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimet jane MSH, Komisioni Ndermisor per Mbrojtjen nga Rrezatimet (KNMRR), Akademia e Shkencave – Instituti i Fizikes Berthamore dhe MMPAU. MMPAU perfaqesohet ne KNMRR me 1 specialist.

Aktualisht, DPPN/MMPAU nuk ka asnje specialist te dedikuar per ceshtjet e sigurise berthamore dhe rrezatimeve. Keto mbulohen nga nje ekspert, i cili eshte ekspert edhe per shume fusha te tjera dhe nga nje jurist ne Sektorin Juridik.

2.3. Asistenca teknike dhe financiare

Ne kete fushe, nuk ka projekte, pervec monitorimit te pervitshem nga institucionet vendase te radioaktivitetit ne ajer dhe uje, dhe radonit ne mjediset e brendeshme, ne uje dhe toke, qe financohet nga MMPAU dhe realizohet nga institucionet vendase.

3. Adresimi i prioriteteve

3.1. Prioritetet afatshkurtra (2006 – 2007)

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Amendim i ligjit per Mbrojtjen nga rrezatimet No 8025 date 9/11/1995, ne perputhje me Direktiven e Keshillit 96/29 date 13 maj 96

Ndryshim i VKM -se mbi Import eksportet e materialeve radioaktive ne Republiken e

Shqiperise, ne perputhje me Kodin e Drejtimit IAEA IAEA/code/2004

Ndysim i Planit te Emergjencave Radiologjike

Rishikim i Regullores mbi Licencimin dhe Inspektimin

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Zbatimi i amendimit te ligjit per Mbrojtjen nga rrezatimet No 8025 date 9/11/1995

Pergatija e procedures dhe formulareve per import-eksportin

Percaktimi i strukture per zbatimin e planit te Emergjencave radiologjike

Riorganizimi i strukturave te kontrollit

Prioritetet afatmesme (2008-2009)

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Rishikim i gjithë regullores si transport, Mbetje etj

Projekt ligj "Per ekspozimin ne mjekesi"

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Riorganizim i komisionit te mbrojtjes nga rrezatimi

Prioritetet afatgjata (2010-2012)

3.3.1 Iniciativat ligjore afatgjata

Prioritetet e percaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2009-2012 janë si më poshtë:

Hartimi i nje Projektligji "Per transportin e mbetjeve radioaktive".

Aktivitetet zbatuese afatgjata

Forcimi i kapaciteteve ne DPPN/MMPAU.

Tabela 1 Forcimi i kapaciteteve institucionale te strukturave te parandalimit te ndotjes (Mbrojtja nga rrezatimet)

AKTIVITETI	2007	2008	2009
Forcim strukture (shtim personash)	0	0	0
Trajnime	0	0	0

3.22.11 NDRYSHIMET KLIMATIKE

1. Objektivi Politik

Ndryshimet klimatike përbejnë një sfide te përmasave globale, e cila kërkon përpjekjen dhe bashkëpunimin e te gjithë vendeve te botes, pavarësisht nga kontributi qe kane ne përqendrimin e gazeve serre ne atmosfere dhe ndikimet negative nga këto shkarkime. Shqipëria, si Pale ne Konventën e OKB-se për Ndryshimet Klimatike dhe Protokollin e Kiotos, ben përpjekje te vazhdueshme për te qene ne linje me Bashkimin Evropian dhe komunitetin ndërkombëtar, për te zbutur ndryshimet klimatike.

Shqipëria, ne kuader edhe te angazhimeve qe rrjedhin nga MSA-ja, duhet te hartoje dhe përafroje kuadrin ligjor me ate te BE –se, për te zbutur ritmin e rritjes se përqendrimit te gazeve serre ne territorin e saj dhe adaptimin ndaj ndryshimeve te pritshme klimatike. Ky objektivi është pjese integrale e dokumenteve strategjike sektoriale si: Plani i Veprimit Kombetar te Mjedisit dhe Strategjia Kombëtare e Energjisë, si sektori kryesor qe kontribuon me mbi 60% te shkarkimeve te gazeve serre nga territori i Shqipërisë dhe si i tille përben fokusin e përpjekjeve per reduktimin e këtyre gazeve.

2 Situata aktuale

Shqipëria e ka ratifikuar Konventen Kuader te OKB –se per Ndryshimet Klimatike ne 1995

dhe mban statusin e vendit qe nuk ben pjese ne Aneksin 1 te Konventes, dmth nuk permban detyrime per te reduktuar shkarkime te gazeve serre, siç kane vendet e industrializuara.

Ne vitin 2005 Shqiperia ka nenshkruar Protokollin e Kiotos te kesaj Konvente. Sipas detyrimeve qe ka ndaj Konventes, Shqiperia ka pergatitur raportimet kombetare: Komunikimin e Pare Kombetar (perfunduar ne 2002); hartimin e Planit te Veprimit per Ndryshimet Klimatike (perfunduar ne 2002); Vleresimin e Nevojave per Teknologji (perfunduar ne 2004); qe jane realizuar me asistencen financiare te Fondit per Mjedisin Global (GEF). Me asistencen e ketij fondi, aktualisht ka filluar edhe pergatitja e Raportimit te Dyte Kombetar.

Referuar raporteve te mesiperme, Shqiperia rezulton te jete nje vend qe shkarkon sasi neto relativisht te uleta te gazeve serre ne atmosfere, me vlera relativisht te uleta te shkarkimeve per fryme te popullsise, pasi mbi 90% e energjise qe prodhohet bazohet ne burime hidrike.

Shqiperia karakterizohet nga vlera relativisht te larta te shkarkimeve per njesi te GDP-se, pasi intensiteti i energjise ka qene relativisht i larte sidomos deri rreth 90-es. Parashikimet e bera per periudhen rreth 2020 flasin per rritje deri ne 5 here te shkarkimeve te gazeve serre, neqoftese nuk merren masa per uljen e tyre nepermjet futjes se teknologjive te reja pa karbon.

2.1. Kuadri ligjor ekzistues

Legjislacioni mjedisor ne fushen e ndryshimeve klimatike perfshin:

Akti i aderimit i "UN Framework Convention on Climate Change". Viti 1994.

Ligji "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne Protokollin e Kiotos", i dates 16 Dhjetor 2004.

2.2. Kuadri institucional ekzistues

Institucioni pergjegjes per ndryshimet klimatike ne pergjithesi dhe ne vecanti per Konventen e OKB per Ndryshimet Klimatike dhe Protokollin e Kiotos eshte MMPAU, prane se ciles, qe ne 1998, eshte ngritur Njesia per Ndryshimet Klimatike.

Njesia e Ndryshimeve Klimatike eshte e perbere nga nje staf prej kater personash dhe financohet kryesisht nga Fondi per Mjedisin Global, nepermjet UNDP. Kjo njesi, ne bashkepunim me nje ekip teknik nder-displinor e nder-institucional me perfaqesues te ministrive te linjes dhe institucioneve kerkimore-shkencore kryen detyrat e meposhtme:

harton inventarin e gazrave serre, nderton skenaret afat-gjate te shkarkimeve te ketyre gazrave;

vlereson ndryshimet e pritshme klimatike dhe ndikimin e tyre;

propozon masat per adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike dhe reduktimin e shkarkimeve;

harton dhe zbaton projekte per arritjen e objektivit kryesor te Konventes dhe Protokollit te Kiotos;

zbaton aktivite per rritjen e ndergjegjismit te publikut mbi ndryshimet klimatike dhe merr masa per shperndarjen e informacionit ne fushen e klimes;

kryen rolin e pikes fokale operationale per Konventen e Klimes dhe Protokollin e Kiotos.

Drejtoria e Politikave te Parandalimit te Ndotjeve nuk ka asnje specialist te dedikuar per ceshtjet e Ndryshimeve Klimatike. Per kete arsye, gjykohet e nevojshme qe t'i shtohet nje specialist per kete qellim.

2.3 Asistenca teknike dhe financiare

Ne kete fushe po zbatohen disa projekte, si me poshte:

Titulli i projektit (projekt rajonal – Europa Lindore dhe ish-BRSS): buxheti nacional: 58,000 USD; qellimi: permiresimi i cilesise se raportimit te inventarit kombetar te gazrave serre. Statusi: ne proces.

Titulli i projektit, (projekt global i GEF) faza e dyte: 405,000 USD; Qellimi i kesaj faze eshte: Pergatitja e komunikimit te dyte Kombetar per Konventen e Ndryshimeve Klimatike te Kombeve te Bashkuara. Statusi: Ne proces.

Titulli i projektit: Vetevleresimi i Nevojave te Kapacitetit Kombetar per Menaxhimin e Mjedisit Global (NCSA); Institucioni drejtues: MM; Kohezgjatja e projektit: 2004-2006; Donori: UNDP/GEF; Buxheti: 200,000 USD nga GEF; 15,000 USD; 15,000 USD in-kind Qeveria Shqiptare; Objektivi: Per te vleresuar nevojat dhe prioritetet ne lidhje me mjedisin global dhe brenda kontekstit te zhvillimit te qendrueshem, keshtu qe ai mund te plotesoje kerkesat e Konventave Mjedisore Globale. Statusi: Sapo ka filluar.

Titulli i projektit: Pergatitja e dokumentit te projektit (PDF B) "Krijimi i tregut te paneleve

diellore per ngrohjen e ujit”. Donori GEF/UNDP. Buxheti: 280,000 USD; Qellimi: promovimi i energjive te rinovueshme (diellore) permes kapercimit te barrierave dhe krijimit te mjedisit te favorshem ekonomik e ligjor per perdorimin e tyre. Projekti (i plote) i zbatimit: buxheti: 2.5-3 mln USD. Statusi: te ardhshme.

Titulli i projektit: Pergatitja e dokumentit te projektit PDF A ”Ndertimi i kapaciteteve adaptuese ne pergjigje te ndryshimeve te pritshme klimatike”. Donori GEF/UNDP. Buxheti: 50,000 USD. Projekti i plote: 500,000 USD. Statusi: te ardhshme.

Se shpejti pritet te fillojne projekte te tjera si:

Titulli i projektit: Projekt i madhesise se plote: “Krijimi i tregut te paneleve diellore per ngrohjen e ujit”. Donori GEF/UNDP. Qellimi: promovimi i energjive te rinovueshme (diellore) permes kapercimit te barrierave dhe krijimit te mjedisit te favorshem ekonomik e ligjor per perdorimin e tyre. Projekti (i plote) i zbatimit: buxheti: 2.5-3 mln USD. Statusi: te ardhshme.

Titulli i projektit: Projekt i madhesise mesatare:”Ndertimi i kapaciteteve adaptuese ne pergjigje te ndryshimeve te pritshme klimatike”. Donori GEF/UNDP. Buxheti: 900, 000 USD. Statusi: te ardhshme.

3. Adresimi i prioriteteve

Detyrat per përafrimin e legjislacionit ne ketë fushe jane planifikuar ne periudhën 5-10 vjeçare. Një vend te rendesishem ne 5 vjecarin e pare zë vënia ne përdorim dhe përfitimi nga Mekanizmat Financiare te Protokollit te Kiotos, si Mekanizmi per Zhvillim te Pastër, e per pasoje, edhe hartimi i kuadrit legjislativ ndihmës per te zbatuar ketë mekanizëm.

Prioritetet afatshkurtra (2006 – 2007)

Nder prioritetet e Qeverisë Shqiptare per periudhën 2006-2007 është hartimi i Raportimit te Dyte Kombëtar me Konventën e Ndryshimeve Klimatike dhe fillimi i zbatimit te Projekteve te Mekanizmit per Zhvillim te Pastër, ne kuadër te Protokollit te Kiotos.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra:

Zbatimi i projektit te GEF/UNDP "Pergatitja e komunikimit te dyte Kombetar per Konventen e Ndryshimeve Klimatike te Kombeve te Bashkuara" dhe përgatitja e raportimit te Dyte Kombëtar per Konventën;

Zbatimi i projektit te UNEP/UNIDO "Plani Kombetar i nxjerrjes nga perdorimi i substancave ozon-holluese";

Zbatimi i projektit te GEF/UNDP "Vetevleresimi i Nevojave te Kapacitetit Kombetar per Menaxhimin e Mjedisit Global (NCSA)";

Zbatimi i projektit te GEF/UNDP "Pergatitja e dokumentit te projektit (PDF B) “Krijimi i tregut te paneleve diellore per ngrohjen e ujit”;

Zbatimi i projektit "Pergatitja e dokumentit te projektit PDF A ”Ndertimi i kapaciteteve adaptuese ne pergjigje te ndryshimeve te pritshme klimatike”;

Zbatimi i projektit zbatues “Krijimi i tregut te paneleve diellore per ngrohjen e ujit”;

Vleresimi i nevojave per trajnime te stafit te te gjithë autoriteteve te perfshira per zbatimin e protokollit te Kiotos. Pergatitja e nje programi baze trajnimi sipas nevojave te identifikuar;

Forcimi kapacitetesh ne DPPN/MMPAU, ku eshte planifikuar te shtohet 1 ekspert, qe te ndjeke çështjet e Ndryshimeve Klimatike.

3.2. Prioritetet afatmesme (2008-2009)

Prioritet afat-mesëm eshte venia ne funksionim dhe përfitimi nga mekanizmat fleksibel dhe financiare te Protokollit te Kiotos. Kjo pritet te realizohet nëpërmjet zbatimit te marreveshjeve dypalëshe te firmosura deri me tani me Italinë dhe Danimarkën ne kuadër te Protokollit te Kiotos, si dhe zbulimi i mundësive te reja te bashkëpunimit me vendet e BE-se, ne kuadër te Protokollit te Kiotos.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Prioritetet e përcaktuara per Qeverinë Shqiptare per periudhën 2008-2009 janë si më poshtë:

Hartimi i kuadrit ligjor per zbatimin e mekanizmave financiare te Protokollit te Kiotos (Mekanizmi per Zhvillim te Pastër);

Përcaktimi i kriterëve te zhvillimit te qëndrueshëm per Projektet e Mekanizmit per Zhvillim te Pastër);

Procedurat e miratimit te projekteve per Mekanizmin per Zhvillim te Pastër nga pala

shqiptare;

Hartimi i formës standarte të letrës së miratimit nga Autoriteti Kombëtar për projektet e Mekanizmit për Zhvillim të Pastër.

Aktivitetet zbatuese afatmesme:

Zbatimi i projektit "Pergatitja e dokumentit të projektit PDF A "Ndertimi i kapaciteteve adaptuese në përgjigje të ndryshimeve të pritshme klimatike";

Zbatimi i projektit zbatues "Ndertimi i kapaciteteve adaptuese në përgjigje të ndryshimeve të pritshme klimatike";

Forcimi i kapacitetesh në DPPN/MMPAU;

Ngritja e regjistrave të tregimit të emisioneve të gazrave serre;

Përmirësimi dhe mbajtja e kapaciteteve për të identifikuar dhe zbatuar projekte të Mekanizmit për Zhvillim të Pastër;

Ndërtimi i kapaciteteve kombëtare për të vlerësuar projektet e Mekanizmit për Zhvillim të Pastër, kundrejt kriterëve të përcaktuara dhe nevojave të zhvillimit të vendit.

Prioritetet afatgjata (2010-2012)

Kjo periudhë ka si prioritet krijimin e një sistemi kombëtar, permanent dhe të qëndrueshëm, të raportimit ndaj konventës së OKB -se, kryesisht të inventarit të gazeve serre sipas kërkesave të parashtruara nga vendimet e Konferencës së Palëve të Konventës së OKB –se, për Ndryshimet e Klimës.

3.3.1 Iniciativat ligjore afatgjate

Projekti "Për përcaktimin e kriterëve të zhvillimit të qëndrueshëm për Projektet e Mekanizmit për Zhvillim të Pastër".

Aktivitetet zbatuese afatgjate:

Përmirësimi dhe mbajtja e kapaciteteve për të hartuar raportimet kombëtare me Konventën për Ndryshimet Klimatike;

Përmirësimi dhe mbajtja e kapaciteteve kombëtare për të hartuar dhe zbatuar projekte të Mekanizmit për Zhvillim të Pastër në kuadër të Protokollit të Kiotos.

Forcimi i kapacitetesh në DPPN/MMPAU.

Tabela 1 Forcimi i kapaciteteve institucionale të strukturave të parandalimit të ndotjes

AKTIVITETI	2007	2008	2009
Forcimi i strukture (shtimi i personave)	1	0	0
Trajnime	0	0	0

3.22.12 EMERGJENCAT CIVILE, MBROJTJA E POPULLATËS CIVILE NË KUADRIN MJEDISOR

Objektivi Politik

Zhvillimi i politikës shqiptare për emergjencat civile do të konsistojë në përmirësimin dhe përafrimin në standardet europiane të shërbimeve të mbrojtjes civile, në përmirësimin e indikatorëve që influencojnë në rritjen e sigurisë së qytetarëve të kërcënuar apo goditur nga fatkeqësi, që shkaktojnë emergjencat civile, zvogëlimin e çënueshmërinë e qytetarëve, pronës dhe mjedisit nga emergjencat civile dhe në ofrimin e mbrojtjes civile me shtrirje sa më të gjerë gjeografike dhe sipas zonave të vendit si dhe në kohë të shpejtë.

2. Situata aktuale

Kuadri ligjor ekzistues

Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile e ushtron veprimtarinë e saj në nënfushën e Mbrojtjes Civile në dy ligje bazë:

- Ligji nr.8756, datë 26. 03. 2001 "Për emergjencat civile".

- Ligji nr.8766, datë 02. 04. 2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin".

Plani Kombëtar i Emergjencave Civile është një dokument themelor i politikave të Shtetit Shqiptar për emergjencat civile, i cili synon në planifikimin dhe përdorimin me efektivitet të

kapaciteteve, duke synuar ndarjen e mire të përgjegjësive dhe mënjanimin e boshllëqeve dhe mbivendosjeve.

Kuadri institucional ekzistues

Në nënfushën e emergjencave civile në nivel ministror funksionon kjo strukturë:

Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile në Ministrinë e Brendshme, me nënndarjet dhe funksionet e tyre si më poshtë:

- Drejtoria e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile.

Kjo drejtori ushtron kontroll në 12 zyra të emergjencës civile në nivel prefekturë, bën vlerësimin e rreziqeve dhe paraqet mendimin e saj në drejtuesit e Ministrisë të Brendshme dhe ndërmjet tyre në Këshillin e Ministrave, kyesisht për miratimin e fondeve në raste emergjente. Bashkëpunimi me ministritë e linjës, institucionet qendrore, organet e qeverisjes vendore, shoqërinë civile dhe institucionet e huaja, përbën një aspekt tjetër të punës të kësaj drejtorie.

Drejtoria e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile zhvillon strategjitë e programeve të planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile, harton dhe rifreskon legjislacionin ekzistues dhe i paraqet ato për miratim në Këshillin e Ministrave.

- Drejtoria e Policisë dhe Mbrojtjes nga Zjarri.

Menaxhon sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit dhe të shpëtimit në 12 prefektura të vendit, si dhe ushtron kontroll në stacionet e policisë të Mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit.

- Në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, ekziston **Drejtoria e Politikave dhe Parandalimit të Ndotjeve (DPPN)**, ku njeri nga specialistet kesaj

Drejtorie mbulon ceshtje që lidhen me emergjencat civile në fushën e mjedisit. Për këtë arsye, për të mbuluar ceshtjet lidhur me hartimin dhe zbatimin e legjislaconit në këtë fushë, si edhe për të bashkëpunuar dhe koordinuar me institucionet e tjera, nevojitet që në DPPN/MMPAU të sigurohet 1 specialist shtesë.

2.3. Asistenca teknike dhe financiare

Gjatë vitit 2006, si Drejtori e Përgjithshme e Emergjencave Civile, është përfituar asistencë teknike dhe mbështetje financiare nga:

CMEP dhe

SEESIM, kryesisht në planifikimin dhe realizimin e stërvitjeve simuluese për gadishmërinë në emergjencat civile, me pjesëmarrjen e delegacioneve të vendeve të tjerë. Në kuadër të PIMS-it janë përfituar disa pajisje kompjuterike për sektorët e Drejtorisë të Përgjithshme të Emergjencave Civile.

Ndërsa në MMPAU nuk ekzistojnë projekte që mbështesin këtë lloj aktiviteti.

3. Adresimi i prioritetëve

Prioritetet afatshkurtra (2006 – 2007)

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioritetëve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Do të miratohen amendamentet e ligjit 8756, datë 26. 03. 2001 “Për emergjencat civile” dhe të ligjit 8766, datë 02. 04. 2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”

Do të rifreskohet Plani Kombëtar i Emergjencave Civile

Do të amendohet Vendimi nr. 206, datë 26. 03. 1998 “Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish”, si akt nënligjor kryesor në punën me emergjencat civile, do të ndryshohet dhe përmirësohet për t’iu përshtatur më mirë situatave emergjente dhe për të lehtësuar e saktësuar procedurat administrative në nivelin e qeverisjes vendore dhe në Ministrinë e Brendshme.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Takime dhe konsulta me përfaqësues dhe specialistë të Emergjencave Civile të ministrive të linjës, institucioneve qendrore dhe të qeverisjes vendore në kuadër të rinovimit të bazës ligjore dhe të organizimeve që do të ndërmerren.

Trajnime të ekipeve të emergjencave civile në Ministrinë e Brendshme dhe të institucioneve që janë ngarkuar me ligj për emergjencat civile.

Workshope për implementimin e metodave të reja të drejtimit, parandalimit, komunikimit dhe vlerësimit të emergjencave civile.

Stërvitje komplekse për emergjencat civile në kuadër të zbatimit të programeve

CMEP, SEESIM etj.

Studime për disa projekte të emergjencave civile.

Hartim- projekte teknike për disa reforma në sektorin e emergjencave civile.

Prioritetet afatmesme (2008-2009)

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Do të hartohen ligji dhe aktet nënligjore për ngritjen e IMC.

Do të hartohen projekt-aktet për bashkepunimin me vendet antare në rastet e fatkeqesive natyrore apo teknologjike, si dhe në fushën e ndotjes detare (aksidentale apo të qëllimshme)

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme 2008-2009

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme ligjore:

Vlerësimi i rreziqeve nga makro në kalimin në vlerësimin rajonal dhe lokal.

Zbatimi i detyrimeve ligjore për futjen në kurrikulat e shkollës të njohurive të Mbrojtjes Civile.

Forcimi i kapaciteteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile.

Ndërtimi i kapaciteteve	Viti				
	2006	2007	2008	2009	2010
Përgatitja e kushteve për kalimin e BMC në varësi të DPEC.			+2 1500		
Forcimi i kapacitetesh në DPPN/MMPAU për mbrojtjen civile				1	

--	--	--	--	--	--

3.23 SHËNDETI PUBLIK

Objektivi politik

Sigurimi dhe përmiresimi i vazhdueshëm i kujdesit shëndetësor për popullatën është objektiv madhor i qeverisë shqiptare. Për arritjen e këtij objektivi, prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme do të fokusohen në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit publik duke iu përshtatur ndryshimeve ekonomike, shoqërore dhe epidemiologjike të vendit; përmirësimin e politikave stimuluese për shërbimin shëndetësor privat, si dhe forcimin e ligjshmërisë, standarteve, strukturave kontrolluese e monitoruese ndaj tij për të mbrojtur shëndetin e popullatës nga abuzimet e praktikave të dëmshme; rishikimin dhe përmirësimin e legjislacionit lidhur me mbikqyrjen e situatave të sëmundjeve ngjitëse dhe inspektoriatit sanitar duke i adoptuar ato sipas standarteve të BE-së.

Forcimi i kapaciteteve teknike të Ministrisë së Shëndetësisë për hartimin e politikave, strategjive apo planeve kombëtare të zhvillimit të sistemit shëndetësor duke iu shmangur gradualisht rolit tradicional të menaxhimit direkt të shërbimeve shëndetësore është një tjetër aspekt i rëndësishëm i cili do të ndiqet nga zgjerimi i mbikqyrjes epidemiologjike duke përfshirë survejancën sindromike për sëmundjet seksualisht të transmetueshme, përfshirjen e institucioneve të tjera, etj, përforcimin e survejancës të gjeneratës së dytë për HIV/AIDS.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria e kontrollit të sistemit shëndetësor shqiptar rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore:

Ligji Nr 3766 i 1963 "Për kujdesin shëndetësor";

Ligji Nr 9106, datë 17.07.2003 "Për shërbimin spitalor në RSH";

Ligji Nr 8167 i 1996 "Për shërbimin shëndetësor të stomatologjisë";

Ligji Nr.9474, datë 09.02.2006, "Për ratifikimin e Konventës kuadër të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, "Për kontrollin e duhanit";

Ligji Nr.9518, datë 18.04.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit" i cili sapo është dekretuar;

Ligji Nr. 8032, datë 16.11.1995 "Për shërbimin e transfuzionit dhe kontrollin e gjakut e produkteve të tij".

Përveç ligjeve, ka dhe një sërë vendimesh, urdhërash dhe udhëzimesh të cilat rregullojnë veprimtarinë e fushës.

2.2 Kuadri Institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e sistemit të shëndetit publik është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

1) Ministria e Shëndetësisë (MSH) është organi qëndror në Sistemin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, misioni i së cilës është realizimi i politikës shëndetësore në shkallë vendi;

2) Instituti i Shëndetit Publik i cili është nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe ka për mision parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse, studimin e mjedisit dhe të efekteve të tij mbi shëndetin, prodhimin e vaksinave. Veprimtaritë kryesore të Institutit të Shëndetit Publik janë:

i. Monitorimi i gjendjes shëndetësore për të identifikuar dhe zgjidhur në kohë problemet shëndetësore të popullatës;

ii. Identifikimi dhe analizimi i shkaqeve të problemeve shëndetësore si dhe i risqeve për shëndetin në popullatë;

iii. Informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i njerëzve mbi problemet shëndetësore;

iv. Sigurimi i edukimit të vazhdueshëm dhe mbështetjes profesionale për specialistët e shëndetit publik;

v. Kërkimi shkencor për të ofruar zgjidhje inovative të problemeve shëndetësore dhe për ndërtimin e strategjive efektive të parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve.

3) Inspektoriat Sanitar Shtetëror është organi më i lartë i kontrollit sanitar dhe është nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë. Inspektoriat përbëhet nga Kryeinspektori sanitar shtetëror dhe

nga inspektorët sanitar në Institutin e Shëndetit Publik dhe në rrethe të cilët janë të specializuar. Ai kontrollon dhe mbikqyr masat e sigurisë dhe shëndetin në punë, funksionimin e shërbimit mjekësor në punë, informon rregullisht Drejtorinë e ISHP dhe Kryeinspektorin Sanitar Shtetëror.

Për realizimin e detyrimeve dhe angazhimeve të marra, për çështjet ndërsektoriale MSH ***bashkëpunon*** me:

Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave në lidhje me analizat e ajrit të ndotur, zhurmave ajrore dhe monitorimit të ujrave;

Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me analizat ushqimore;

Ministrinë e Arsimit dhe Shkencave në kuadër të Kurseve dhe trajnimeve të përbashkëta;

Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barbarta në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Inspektoriatit të Punës dhe Inspektoriatit Sanitar Shtetëror;

Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.

2.3. Asistenca e huaj

Sistemi shëndetësor shqiptar është mbështetur nga programe me financim të huaj nëpërmjet projekteve të ndryshme, komponentët kryesorë të të cilëve kanë qënë rehabilitimi i infrastrukturave, pajisjeve mjekësore dhe jo mjekësore, zhvillimi i kapaciteteve, etj.

Në qershor të vitit 2006, do të nisë projekti i tretë i Bankës Botërore “Modernizimi i Sistemit Shëndetësor Shqiptar” me një vlerë prej 15.4 milion dhe që do të përfundojë në shtator të vitit 2010.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Europian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Europian, prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme për fushën e shëndetit publik janë:

Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor të shëndetit publik duke i përshtatur ato sipas standardeve të BE-së;

Forcimi i kontrollit të sëmundjeve ngjitëse;

Mbrojtja e shëndetit nga produktet e duhanit.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritetet, për realizimin e tyre në periudhë afatshkurtër 2006-2007, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Shëndetësisë:

Hartimi dhe miratimi i projektligjit “Për mbrojtjen nga produktet e duhanit”. Ky projektligj do të harmonizojë në mënyrë “të pjesshme” (por në një shkallë të lartë) dispozitat e Direktivës 2003/33/EC “Për përafrimin e legjislacionit, rregulloreve dhe dispozitave administrative të shteteve anëtare përsa i përket reklamimit dhe sponsorizimit të duhanit” dhe të Direktivës 2001/37/EC “Për përafrimin e legjislacionit, rregulloreve dhe dispozitave administrative të shteteve anëtare përsa i përket fabrikimit, prezantimit dhe shitjes së produkteve të duhanit”.

Hartimi i ligjit të ri për shërbimin e transfuzionit dhe sigurinë e gjakut e produkteve të tij. Ligji do të sjellë një harmonizim “të plotë” me Direktivën 2005/61/EC, Direktivën 2005/62/EC, Direktivën 2004/33/EC, Direktivën 2002/98/EC.

Hartimi i projektligjit “Për infermieristikën”, i cili ka për qëllim përmirësimin e shërbimit infermieror në të gjithë strukturat shëndetësore dhe do të ketë harmonizim “të pjesshëm” me Direktivën 2005/36/EC.

Ndryshimi i ligjit “Për Inspektoriatin Sanitar Shtetëror”, i cili do të sjellë zgjerimin e fushës së veprimtarisë së inspektorëve sanitarë shtetërorë dhe do të fuqizojë dhe përmirësojë punën e tyre.

3.1.2. Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e këtyre prioritetëve, në periudhë afatshkurtër, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e strukturave të reja dhe rritja e kapaciteteve administrative të strukturave që veprojnë në sistemin shëndetësor;

Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, trajnime;

Përmirësimi i infrastrukturës

Ngritje sistemesh informacioni

Aktivitete specifike në lidhje me sektorë të ndryshëm do të jenë:

Krijimi i njësisë së hemovigjilencës, që deri tani nuk ekziston ende, në Tiranë, si në tabelën e

mëposhtme;

Qendra e Kontrollit të Jashtëm të Cilësisë, që deri tani nuk ekziston ende;

Përmirësimi i mirëmbajtjes së sistemit ALERT;

Përmirësimi i raportimit të HIV/AIDS dhe TB

Vendosja e mbikqyrjes sindromike për sëmundjet seksualisht të transmetueshme

Tryeza të rrumbullakta dhe fushata ndërgjegjësimi për sensibilizimin e aktorëve për zbatimin e Ligjit Nr 9518, datë 18.04.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit" dhe të ligjit "Për mbrojtjen nga produktet e duhanit"

3.1.3. Iniciativat ligjore afatmesme

Në përputhje me prioritetet e Partneritetit European për shëndetin publik, në periudhë afatmesme do të ndërmerret iniciativa e mëposhtme ligjore nga Ministria e Shëndetësisë:

Hartimi dhe miratimi i projektligjit "Për mbrojtjen nga alkooli", i cili do të sjellë harmonizim "të plotë" me Direktivën 87/250/EEC.

Tabela: Shtese e kapaciteve për Ministrinë e Shëndetësisë

INVESTIME	NJESIA E MATJES	GJENDJA AKTUALE	2006	2007	2008	2009
Burimet Njerëzore	Nenpunës	5		4	8	

3.24 BASHKËPUNIMI NË DREJTËSI DHE ÇËSHTJE TË BRENDSHME

3.24.1 BASHKËPUNIMI GJYQËSOR NDËRKOMBËTAR

1. Objektivi politik i fushës

Qeveria Shqiptare do të jetë tërësisht e angazhuar të rrisë bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtarë, duke iu përgjigjur me efektivitet programeve të ndërmarra nga partnerët rajonal dhe ndërkombëtarë në këtë fushë, në përputhje dhe me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (Neni 1,2,4,13 dhe 81 i MSA-së).

Qeveria Shqiptare do të respektojë angazhimet e marra dhe do të jetë plotësisht e hapur për një bashkëpunim institucional dhe kapilar me institucionet e specializuara ndërkombëtare dhe të vendeve të tjera, duke qenë mjaft aktive në zbatimin e angazhimeve që do të marrë në kuadër të këtij bashkëpunimi.

Gjithashtu, do të ndërmerren të gjitha hapat e nevojshme, si në kuadrin ligjor dhe atë institucional, për ta bërë sa më efektive dhe të plotë bashkëpunimin në këtë fushë.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor

Shqipëria ka ratifikuar një sërë Konventash dhe Traktatesh Ndërkombëtare në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, të cilat janë:

Konventa Europiane "Për ekstradimin" dhe protokollet e saj shtesë ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8322, datë 2.04.1998;

Konventa Europiane "Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale" dhe protokollet e saj shtesë ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8498, datë 10.06.1999;

Protokolli i dytë shtesë i Konventës Europiane "Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale" dhe protokollet e saj shtesë ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8883, datë 18.04.2002 ;

Konventa Europiane "Për transferimin e personave të dënuar" ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8499, datë 10.06.1999;

Konventa Europiane "Për transferimin e procedimeve penale" ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8497, datë 10.06.1999;

Konventa Europiane "Për vlefshmërinë e gjykimeve ndërkombëtare penale" ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 9068, datë 15.05.2003;

Konventa Europiane "Për mbikqyrjen e personave të dënuar apo të liruar me kusht" ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8724, datë 26.12.2000;

Konventa Europiane "Për pastrimin, kërkimin, kapjen, konfiskimin e produkteve të krimit"

ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8646, datë 20.07.2000;

Konventa Europiane “Për korrupsionin në fushën penale” ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr.8778, datë 26.04.2001;

Protokolli shtesë i Konventës Europiane “Për korrupsionin në fushën penale” ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 9245, datë 24.06.2004;

Marrevëshja Europiane “Për transmetimin e kërkesave për ndihmë gjyqësore”.

Konventa Europiane “Për informimin mbi të drejtën e huaj”, ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8703, datë 1.12.2000;

Konventa Europiane “Për shtypjen e terrorizmit”, ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8642, datë 13.07.2000;

Konventa Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” e ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996;

Protokolli VI i Konventës Europiane “ Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, e ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8641, datë 13.07.2000;

Konventa Europiane “Për krimin kibernetik”, e ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8888 datë 25.04.2002;

Protokolli ndryshues të Konventës Europiane për shtypjen e terrorizmit, miratuar me ligjin nr. 9230, datë 13.05.2004;

Konventa Europiane “ Për mbrojtjen e individeve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”;

Protokollit shtesë i Konventës Europiane “ Për mbrojtjen e individeve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale, “Mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale nga organet mbikqyrëse dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave;

“Marrevëshja Europiane për Transmetimin e Kërkesave për Ndihmë Juridike”, miratuar me ligjin nr. 8705, datë 1.12.2000;

“Konventa Europiane për Informimin për të Drejtën e Huaj”, ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8703, datë 1.12.2000;

“Konventa Europiane Civile kundër korrupsionit”, miratuar me ligjin nr. 8635, datë 6.07.2000.

“Konventa e Hagës “Për Heqjen e Kërkesës për legalizimin e dokumentave zyrtare të huaja”, miratuar me ligjin nr. 9060, datë 08.05.2003;

Konventa e OKB-së “Për krimin e organizuar ndërkufitar” dhe dy protokolleve të saj shtesë e ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002;

Konventa e OKB-se kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope, ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8722, datë 26.12.2000;

Gjithashtu, bashkëpunimi në këtë fushë mbështetet edhe në legjislacionin parësor të mëposhtëm:

Kushtetuta e Shqipërisë;

Ligji nr. 7895, date 27. 1. 1995 « Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr 7905, datë 21. 3. 1995 “Kodi i Proçedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 7850, date 29. 07. 1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 8116, datë 29. 3. 1996 “Kodi i Proçedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

2.2 Kuadri institucional

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, për fushën e policisë është përgjegjëse:

Drejtoria e Bashkëpunimit Gjyqësor Ndërkombëtar civil dhe penal, në Ministrinë e Drejtësisë, e cila realizon dhe ndjek marrëdhëniet e Ministrisë së Drejtësisë me organet e sistemit të drejtësisë, në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga instrumentat e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar.

Institucionet me të cilët Ministria e Drejtësisë bashkëpunon për realizimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar janë:

Prokuroria, bashkëpunim i cili konsiston në ndjekjen, realizimin brenda afateve kohore të procedurave lidhur me marrëdhëniet juridiksionale si dhe në zgjidhjen e problematikave të hasura në

kuadrin e praktikave të ndryshme midis dy institucioneve.

Gjykatat, roli i të cilave mbështetur në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, Kodin e Proçedurës Civile, Kodin Penal dhe Proçedurës Penale si dhe aktet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, është shumë i rëndësishëm në realizimin dhe ekzekutimin e kërkesave për ndihmë juridike. Bashkëpunimi konsiston në realizimin e proçedurave që lidhen me marrëdhëniet juridiksionale.

Zyra Qëndrore Kombëtare – Interpol Tirana, në Ministrinë e Brendshme. Mbështetur në aktet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë roli i këtij institucioni është mjaft i rëndësishëm në lokalizimin dhe kapjen e personave që kërkohen për shkak të një urdhëri arresti ndërkombëtar si dhe në realizimin me sukses kryesisht të ekstradimeve, transferimit të personave të dënuar si dhe marrëdhënieve të tjera juridiksionale.

Ministria e Punëve të Jashtme, e cila mbështetur në ligjin nr. 9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë” dhe aktet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë, është rruga diplomatike e komunikimit me autoritetet e huaja, rrugë e cila sa vlen e zbehet në praktikën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, por përsëri ajo vazhdon të jetë e pranueshme nga palët.

2.3 Asistenca e Huaj

Nuk ka pasur asistencë teknike të huaj në këtë fushë.

3. Prioritetet

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si me poshtë:

Të përfundohen dhe të zbatohen marrëveshjet me vendet fqinje dhe të sigurohet zbatimi efikas i tyre, veçanërisht për tregtinë, bashkëpunimin ndërkufitar, luftën kundër krimit të organizuar, trafikun dhe kontrabandën, bashkëpunimin gjyqësor, menaxhimin e kufijve, marrëveshjet e ripranimit, mjedisin, transportin dhe energjinë.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore.

Nënshkrimi i Marrëveshjeve dypalëshe “Për bashkëpunimin gjyqësor”;

Miratimi i Projektligjit “Për ratifikimin e Konventës së Hagë “Mbi proçedurë civile” e 1 Marsit 1954, iniciativë e cila është plotësisht në përputhje me Konventën 91999JHA 10146;

Miratimi i Projektligjit “Për ratifikimin e Konventës së Hagës “Për aksesin ndërkombëtar në drejtësi” e 25 Tetorit 1980, iniciativë e cila është plotësisht në përputhje me Konventën 91999JHA10150;

Miratimi i Projektligjit “Për ratifikimin e Konventës së Konferencës së Hagës “Mbi transmetimin, marrjen dhe dërgimin e dokumenteve gjyqësore e jashtëgjyqësore, jashtë territorit të shtetit, në çështjet civile dhe tregtare” e 15 Nëntorit 1965, iniciativë e cila është plotësisht në përputhje me Konventën 91999JHA10147;

Nënshkrimi i Marrëveshjes “Për Bashkëpunimin gjyqësor” me Eurojust, iniciativë e cila është plotësisht në përputhje me Veprimin e Përbashkët, të 29 qershorit 1998, të miratuar nga Këshilli mbi bazën e Nenit 3 të Traktatit të Bashkimit Europian “Mbi krijimin e Rrjetit Gjyqësor Europian;

Miratimi i Projektligjit “Për ratifikimin e Konventës së Hagës “Mbi Njohjen dhe Zbatimin e vendimeve të huaja për çështjet civile dhe tregtare” e 1 Shkurtit 1971, iniciativë e cila është pjesërisht në përputhje me Konventën mbi juridiksionin dhe zbatimin e vendimeve civile dhe tregtare, bërë në Lugano më 16 Shtator 1988.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese.

Pjesëmarrja e gjyqtarëve, prokurorë, oficerëve të policisë gjyqësore dhe stafit të Minsitrisë së Drejtësisë në aktivitetet rajonale dhe ndërkombëtare;

Forcimi i kapaciteteve administrative të Drejtorisë së Bashkëpunimit Gjyqësor Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë;

Trajnimi i gjyqtarëve e prokurorëve për njohjen e formave të reja të Bashkëpunimit Gjyqësor Ndërkombëtar;

Krijimi i infrastrukturës për komunikimin e drejtpërdrejtë në rrugë elektronike;

Krijimi i një zyre pune të veçantë për pikën e kontaktit për rrjetin gjyqësor europian dhe EUROJUST;

Krijimi i një zyre të veçantë për magistratët ndërlidhës;
Krijimi i infrastrukturës së nevojshme (ambjente) për organizimin e videokonferencave si dhe trajnimi i personelit përkatës.

3.2 Përparësitë afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008 – 2009 janë si më poshtë:

Të përfundohen dhe të zbatohen marrëveshjet me vendet fqinje dhe të sigurohet zbatimi efikas i tyre, veçanërisht për tregtinë, bashkëpunimin ndërkufitar, luftën kundër krimit të organizuar, trafikun dhe kontrabandën, bashkëpunimin gjyqësor, menaxhimin e kufijve, marrëveshjet e ripranimit, mjedisin, transportin dhe energjinë.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Miratimi i Projektligjit "Për të drejtën ndërkombëtare private", iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Konventën e Komunitetit Ekonomik Europian Nr. 80/934/EEC "Mbi ligjin që zbatohet në detyrimet Kontraktuale" dhe Veprimin e Përbashkët të aprovuar nga Këshilli i Ministrave të BE-së "Në lidhje me masat mbrojtëse kundër efekteve të zbatimit jashtë territorial të legjislacionit të aprovuar nga një vend i tretë, veprimet në të cilat bazohet dhe rezultatet që rrjedhin prej saj";

Miratimi i Projektligjit "Për ratifikimin e Konventës së Hagës "Mbi marrjen e provave jashtë territorit të shtetit në çështjet civile dhe tregtare", e 18 Marsit 1970;

Miratimi i Projektligjit "Për ratifikimin e Protokollit Plotësues të Konventës së Konferencës së Hagës " Mbi Njohjen dhe Zbatimin e vendimeve të huaja për çështjet civile dhe tregtare" e 1 Shkurtit 1971;

Miratimi i Projektligjit të ri "Për Bashkëpunimin Gjyqësor në Fushën Civile", iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Konventën 41997A0827(01) të Komunitetit Europian, Rregulloren e Komitetit Europian nr. 1348, Vendimin e Komisionit nr. 781, vendimin e Komisionit nr. 350 që amendon "Vendimin 2001/781/EC, Rregulloren e Këshillit Evropian Nr. 743/2002 dhe Marrëveshjen Europiane për Transmetimin e Kërkesave për Ndihmë Juridike (Marrëveshja e KE-së);

Miratimi i Projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal", i ndryshuar, iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me 2000/383/JHAOJC171, 98/699/JHA, 2001/220/JHA, Vendimin e datës 6 dhjetor 2001 amendues i 2000/383/JHA96/277/JHA, 98/428/JHA.,2002/187/JHA dhe 2003/659/JHA;

Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit "Për bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në fushën penale", iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me 42000A0712;

Miratimi i Projektligjit "Për shtesa dhe ndryshime në Kodin e Proçedurës Civile", i ndryshuar, iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Konventën 41997A0827(01) të Komunitetit Europian; Rregulloren e Komitetit Europian nr. 1348; Vendimin e Komisionit 781; Vendimin e Komisionit nr. 350 që amendon "Vendimin 2001/781/ ; Rregulloren e Këshillit Evropian Nr. 743/2002 , Rregulloren e Këshillit të Ministrave të Komunitetit Evropian Nr. 1206, date 28 Maj 2001 "Mbi bashkëpunimin ndërmjet gjykatave të vendeve anëtare në marrjen e provave në çështjet civile dhe tregtare", Konventën e Brukselit nr 41968A0927(01), Konventën e Luganos 4198A0592, Rregulloren e Këshillit të Komunitetit Evropian Nr. 44/2001 dhe Vendimin e Këshillit Nr. 740;

Miratimi i Projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin për Falimentin", iniciativë e cila është pjesërisht në përputhje me Rregulloren e Këshillit të Ministrave të Komunitetit Evropian Nr. 1346/2000 "Mbi proçesin gjyqësor të insolvencës (falimentimit)".

3.24.2 MBROJTJA E TE DHENAVE PERSONALE

1. Objektivit Politik

Qeveria shqiptare është plotësisht e angazhuar për zbatuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale (neni 70 dhe 79 i MSA). Në këtë mënyrë synohet që të përfaqësohet plotësisht legjislacioni Shqiptar me atë të Bashkimit Evropian si dhe të krijohet një Autoritet i pavarur që do të mbikqyrë mbrojtjen e të dhënave personale.

Në këtë kuader, do të bashkëpunohet ngushtësisht me partneret ndërkombëtarë për të adresuar boshllëqet e identifikuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave personale duke vendosur rregulla dhe

standarte te njejta me ato të Bashkimit European si dhe duke respektuar gjithashtu parimet e së drejtës ndërkombëtare të sanksionuara në instrumentat ndërkombëtare të nenshkruara nga Shqipëria në këtë fushë.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Ligjislacioni baze në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale janë:

Ligji Nr. 8517, dt. 22.07.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"

Ligjin nr.9288, datë 7.10.2004 "Për ratifikimin e Konventës "Për Mbrojtjen e Individëve nga Procedimi Automatik i të Dhenave Personale"

Ligjin nr.9287, datë 7.10.2004 "Për ratifikimin e Protokollit Shtesë të Konventës "Për Mbrojtjen e Individëve nga Procedimi Automatik i të Dhenave Personale, lidhur me autoritetet mbikqyrese dhe levizjen ndërkufitare të të dhënave personale"

2.2 Kuadri institucional ekzistues

Ligji ekzistues për Mbrojtjen e të Dhenave Personale, përcakton **Avokatin e Popullit** si institucionin ku individët mund të ankohen në rastet e shkeljes së të drejtës së privatesisë.

Duhet të theksohet se kuadri ligjor aktual, garanton mbrojtjen dhe përdorimin e ligjshëm të të dhënave personale gjatë trajtimit të tyre nga autoritetet publike, ndërkohë që nuk parashikon garanci të tilla për shkeljet e të drejtave të tyre nga ana e subjekteve private

Në Shqipëri nevojitet të ngrihet një autoritet publik, i pavarur, përgjegjës për monitorimin implementimit të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Një institucion i tillë duhet të gëzojë pushtet efektiv për të garantuar të drejtat e individëve gjatë procesit të trajtimit të të dhënave, ndryshe nga Avokati i Popullit tek i cili individët mund të ankohen pasi iu janë cënuar këto të drejta.

Aktualisht asnjë institucion Shqiptar nuk ka përgjegjësi direkte ligjore për adresimin e boshllëqeve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit është përgjegjëse vetëm për adoptimin e Direktives 2002/58 "Për trajtimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatesisë në komunikimeve elektronike".

2.3 Asistencë Teknike

Duke qenë se të dhënat personale përbejnë një fushë relativisht të re për Shqipërinë, nuk ka ekzistuar deri më sot asnjë asistencë konkrete në këtë fushë.

3. Adresimi i Prioriteteve

3.1 Prioritetet afatshkurtra (2006 – 2007)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si më poshtë:

Harmonizimi i legjislacionit shqiptar në lidhje me të dhënat personale me legjislacionin komunitar dhe legjislacionin tjetër European dhe ndërkombëtar mbi privacin

Krijimi i një strukture të pavarur mbikqyres me burime të nevojshme financiare dhe njerezore me qëllim që të monitorojë në mënyrë efektive dhe të garantojë zbatimin e legjislacionit kombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhënave

3.1.1 Iniciativat ligjore afat shkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerret iniciativa e mëposhtme ligjore.

Hartimi i një ligji të ri "Për mbrojtjen e të dhënave personale", initiative e cila do të jetë plotësisht në përputhje me Direktiven 95/46/EC të Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 24 Tetor 1995, "Mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe levizjen e tyre të këtyre të dhënave" dhe Direktiven 2002/58/EC të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 12 Korrik 2002, "Në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatesisë në sektorin e komunikimit elektronik" (Direktiva mbi privatesinë dhe komunikimin elektronik)

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerret aktiviteti i mëposhtëm zbatues.

Krijimi i një Autoriteti Mbikqyres për mbrojtjen e të dhënave personale

3.2.4.3 MENAXHIMI I KUFINJVE

1. Objektivi Politik

Menaxhimi dhe siguria në kufi, përbën një angazhim të Qeverisë Shqiptare si në raport me detyrimet ligjore, politike dhe sigurinë kombëtare brenda vendit, ashtu edhe në marrëdhëniet

ndërkombëtare veçanërisht në procesin e anëtarësimit në strukturat euroatlantike, për ndërtimin e besimit me shtetet fqinje dhe më gjerë, si dhe për të kontribuar në luftën kundër krimit të organizuar.

Në këtë kuadër, pritët të miratohet strategjia “Për kontrollin e kufirit dhe menaxhimin e integruar të tij” si dhe të planit të veprimit përkatës. Kjo strategji parashikon arritjen e të gjithë objektivave, të cilat dalin dhe nga udhëzuesi i BE- së për menaxhimin e integruar të kufinjve për vendet e Ballkanit Perëndimor si dhe është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Konferenca e Ohrit.

Menaxhimi eficient i kufirit dhe siguria në kufi janë të rëndësishme jo vetëm për Shqipërinë, por për gjithë rajonin. Për këtë arsye, Qeveria Shqiptare është e angazhuar të punojë së bashku me vendet e rajonit për të arritur, në shkallë rajonale, realizimin e kufijve të hapur, por në të njëjtën kohë të kontrolluar dhe të sigurt. Padyshim, që ky është një element i rëndësishëm në kuadër të procesit të stabilizim - asociimit.

Do të forcohet kontrolli i kufijve për të parandaluar aktivitetet kriminale si dhe çdo aktivitet tjetër që mund të vërë në rrezik sigurinë. Këto kontrolle do të synojnë të pengojnë kriminelët të kryejnë aktivitete ilegale ndërkufitare, duke parandaluar ose duke zbuluar aktivitetet e tyre. Lufta ndaj trafikeve të të gjitha llojeve, imigracionit të paligjshëm, terrorizmi dhe krimi i organizuar, do të jenë në fokusin e strukturave që merren me kontrollin e kufirit. Kontrolli i “dyerve” konsiderohet mjaft i dobishëm dhe eficient për parandalimin e zhvillimit dhe përhapjes së krimit, ndëshkimin e kriminelëve dhe pakësimin e përfitimeve të tyre të paligjshme.

Institucionet kombëtare (sidomos doganat, policia kufitare, autoritetet fito-sanitare, etj) do të forcojnë bashkëpunimin ndërinstitucional, për t’i bërë pikat e kalimit të kufirit më eficiente, si për sa i përket flukseve të mallrave dhe personave, ashtu edhe për sa i përket kontrollit të aktiviteteve kriminale ndërkufitare.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Kuadri ligjor bazë në këtë fushë fokusohet në:

Ligjin nr. 8771, datë 19.4.2001 “Për kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë”

Ligjin nr. 8772, datë 19.4. 2001 “Për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”

Ligjin nr.8663 , datë 18.9.2000 “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 nt”

Ligjin nr.8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”

Ligjin nr.8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”

Ligjin nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”

Ligjin nr.nr.8442, datë 21.1.1999 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8389, datë 5.8.1998 "për shtetësinë shqiptare”

2.2 Kuadri institucional ekzistues

Institucioni përgjegjës për kontrollin dhe ruajtjen e kufirit është **Policia Kufitare dhe e Migracionit**, e cila është pjesë përbërëse e Policisë së Shtetit. Misioni i saj është:

të ruajë dhe kontrollojë kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë;

të sigurojë kushtet e përshtatshme për kalimin legal të shtetasve shqiptarë e të huaj dhe të mjeteve nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë;

të marrë masa për parandalimin e kalimeve të paligjshme të kufirit, njerëzve, mallrave e mjeteve;

të organizojë punën për të parandaluar e goditur trafiket ilegale, që zhvillohen nëpërmjet kufirit shtetëror;

të sigurojë kushtet për kontrollin e shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë.

Aktualisht Policia Kufitare, si pjesë përbërëse e Policisë së Shtetit, është e organizuar:

Në qendër: Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Migracionit me 3 sektorë:

sektori i trajtimit të të huajve dhe migracionit;

sektori i shërbimeve në kufi;

sektori i menaxhimit të integruar të kufirit dhe trajnimeve.

Në baëe: 10 sektorë të policisë kufitare në Drejtoritë e Policisë së Qarqeve dhe 21 seksione të policisë kufitare në Komisarariatet e Policisë së rretheve, në përbërje të të cilëve janë 59 njësi të policisë kufitare.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila është përgjegjëse për :

kryerjen e të gjitha formaliteteve të përcaktuara në Kodin Doganor për mallrat në hyrje, në dalje ose tranzit të territorit doganor shqiptar, sipas rregullave të parashikuara në aktet nënligjore në zbatim të kodi doganor;

verifikimin dhe vjeljen e detyrimeve doganore që duhen paguar;

parandalimin, verifikimin dhe luftën e veprimtarisë kontrabandë, të shkeljeve dhe të trafikut të paligjshëm të mallrave të ndaluara ose të kufizuara,...

konstatimin dhe verifikimin e shkeljeve të dispozitave të Kodit doganor, të parashikura në pjesën VIII;

përgatitjen dhe nënshkrimin e marrëveshjeve e të konventave ndërkombëtare në fushën doganore;

përgatitjen, mbledhjen dhe, mbi bazën e një kërkesë me shkrim, dërgimin e të dhënave statistikore të tregtisë së jashtme për Ministrinë e Tregtisë dhe për organet e tjera publike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

Mbikqyrjen në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave që i nënshtrohen mbikqyrjes së autoriteteve doganore;

Shërbimi Fitosanitar, i organizuar në nivel qendror si Drejtori e Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit., ka këto detyra kryesore:

Kontrollin fitosanitar i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera në trafikun kufitar ndërkombëtar (import, transit, eksport);

Lëshimin i çertifikatës fitosanitare për ngarkesat e bimëve dhe produkteve bimore për eksport dhe ri-eksport;

Marrja e kampioneve për analizë nga bimët e produktet bimore për të përcaktuar pranië e parazitëve të dëmshëm”

Vendosja e masës fitosanitare (refuzim i hyrjes, trajtim, shkatërrim i ngarkesës etj.);

Kontrolli i zbatimit të masës fitosanitare të vendosur;

Kontrolli i importit të produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Shërbimi dhe inspektimi veterinar është organizuar në nivel qendror si Drejtori e Shërbimit dhe Inspektimit Veterinar në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Detyrat e këtij shërbimi janë:

Të bëjë inspektimin sanitaro-veterinar, si dhe kontrollin fizik të ngarkesave për eksport, import dhe tranzit së bashku me dokumentacionin shoqërues.

Të marrë kampione produktesh me origjinë shtazore, materialesh të pa përpunuara, mbeturina dhe produkte për kafshë për analizë laboratorike, kur është e nevojshme.

Të regjistrojë ngarkesat e eksportit, importit dhe tranzitit, të cilat kalojnë nëpër pikën e kalimit kufitar sipas përcaktimeve të bëra në ligj.

Të mbikqyre dezinfektimin dhe kushtet higjieno-sanitare të mjeteve të transportit dhe magazinave doganore.

Të kryejë të gjitha veprimet e tjera që parashikon ligji dhe aktet e tjera nënligjore.

Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Migracionit, bashkëpunon dhe me institucione të tjera shtetërore dhe konkretisht me:

Ministrinë e Punëve të Jashtme, përsa i përket hyrjes së të huajve në Republikën e Shqipërisë.

Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, përsa i përket hyrjes, qëndrimit dhe trajtimit të të huajve në Republikën e Shqipërisë.

Ministrinë e Transportit, në lidhje me organizimin e masave të përbashkëta për rritjen e sigurisë në aeroporte e porte; për organizimin e masave për sigurimin e kushteve normale për kalimin e shtetasve, mjeteve e mallrave në dhe nga Republika e Shqipërisë; për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ligjeve të aviacionit civil dhe të lundrimit.

Organet e pushtetit vendor, në lidhje me garantimin e jetës dhe pronës së shtetasve, që

banojnë ose ushtrojnë veprimtari pranë vijës së kufirit, parandalimin e incidenteve kufitare dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkufitare.

Ministrinë e Mbrojtjes, përsa i përket Rojes Bregdetare, që është në vartësi të Komandës së Forcave Detare, për zbatimin e regjimit të lundrimit të mjeteve lundruese në ujërat e brendshme dhe territoriale, si dhe për shkëmbim informacioni dhe në organizimin e masave për parandalimin e trafikeve.

2.3 Asistencë Teknike

Asistenca Teknike që është ofruar në këtë fushë fokusohet në:

Pajisje (përfshirë trajnime) për grupet e përbashkëta të punës, financuar nga CARDS 2002, me një shumë prej 0.4 mil Euro;

Ndërtimi i lehtësirave për inspektimin e mjeteve , financuar nga CARDS 2002, me një shumë prej 0.1763 mil Euro;

Rritja e menaxhimit të pikave të kalimit kufitar, financuar nga CARDS 2003, me një shumë prej 4 mil Euro;

Mbështetje për policinë kufitare dhe infrastrukturën doganore, financuar nga CARDS 2004, me një shumë prej 4 mil Euro;

Forcimin e Kontrollit Kufitar dhe të Drejtësisë Penale në Luftën Kundër Krimit të Organizuar në Shqipëri, UNDOC, me një shumë prej 0.8 mil Euro;

Përmirësimi i infrastrukturës dhe dhënia e asistencës teknike , financuar nga CARDS 2003, me një shumë prej 1 mil Euro.

3. Adresimi i Prioriteteve

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si me poshtë:

Dokumentet e udhëtimit që lëshohen, të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të vendoset një rrjet kompjuterik (IT) i centralizuar për administrimin e vizave.

Të amendohet ligji për të Huajt, për ta sjellë legjislacionin e vizave më pranë standardeve të BE-së.

Të vihen në zbatim angazhimet e Marrëveshjes së Ohrit për sigurinë dhe menaxhimin e kufijve, veçanërisht duke hartuar një strategji të integruar për menaxhimin e kufijve në përputhje me udhëzimet e BE-së.

Të shtohen burimet njerëzore dhe financiare në luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore dhe migracionit të paligjshëm.

Të garantohet menaxhimi i kufijve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, në portet e Durrësit dhe Vlorës, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Të rritet bashkëpunimi mes agjensive në kufi, ndërmjet doganave dhe policisë kufitare.

Të zbatohet marrëveshja e ripranimit KE/Shqipëri dhe të negociohen marrëveshjet e ripranimit me vendet e origjinës të emigrantëve tranzitë.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore.

Miratimi i projektligjit " Për Kufirin ", iniciativë e cila është në përputhshmëri të plotë me Konventën për zbatimin e Marrëveshjes Schengen të 14 Qershorit 1885, me Direktivën e Këshillit 2002/90/EC të datës 22 Nëntor 2002, që përkufizon mundësinë për hyrjen e paautorizuar, tranzitin dhe rezidencën si dhe me Vendimin e Këshillit të 22 Dhjetorit 1995 për monitorimin e instrumenteve të aprovuara deri tani, përsa i përket pranimit të shtetasve të vendeve të treta;

Hartimi dhe miratimi i ligjit 'Për të Huajt', iniciativë e cila është në përputhshmëri të plotë me Konventën për zbatimin e Marrëveshjes Schengen të 14 Qershorit 1885, me Direktivën e Këshillit 2002/90/EC të datës 22 Nëntor 2002, që përkufizon mundësinë për hyrjen e paautorizuar, tranzitin dhe rezidencën si dhe me Vendimin e Këshillit të datës 3 Dhjetor 1998 për standartet e përbashkëta,

përsa i përket formatit uniform për lejet e qëndrimit;

Miratimi i VKM - së, "Për miratimin e Strategjisë së re të Menaxhimit të Integruar të Kufinjve dhe Planit Kombëtar të Veprimit";

Miratimi i VKM –së për zbatimin e ligjit " Për Kufirin", iniciativë e cila është në përputhshmëri të plotë me Konventën për zbatimin e Marrëveshjes Schengen të 14 Qershorit 1885, me Direktivën e Këshillit 2002/90/EC të datës 22 Nëntor 2002, që perkufizon mundësinë për hyrjen e paautorizuar, tranzitin dhe rezidencën si dhe me Vendimin e Këshillit të 22 Dhjetorit 1995 për monitorimin e instrumenteve të aprovuara deri tani ,përsa i përket pranimi të shtetasve të vendeve të treta.

Miratim i Urdhërit të Ministrit të Brendshëm "Për krijimin e një Regjistri Kombëtar për të huajt";

Miratimi i Urdhërit të përbashkët të Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave, Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrit të Shëndetësisë, BU, MSH "Për bashkëpunimin e agjensive, në kufi sipas strategjisë së re të MIK;

Miratimi i VKM –së , në zbatim të ligjit të ri për të huajt , "Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e shtetasve të huaj në RSH" ; "iniciativë e cila është në përputhshmëri të plotë me Konventën për zbatimin e Marrëveshjes Schengen të 14 Qershorit 1885, me Direktivën e Këshillit 2002/90/EC të datës 22 Nëntor 2002, që perkufizon mundësinë për hyrjen e paautorizuar, tranzitin dhe rezidencën, si dhe me Vendimin e Këshillit të datës 3 Dhjetor 1998, për standartet e përbashkëta përsa i përket formatit uniform për lejet e qëndrimit;

Nxjerrja e Urdhërit të Ministrit të Brendshëm dhe udhëzimeve për zbatimin e ligjit "Për kufirin" ;

Nënshkrimi i Marrëveshjes me Italinë "Për shkëmbimin e informacionit";

Miratimi i VKM -së" Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë";

Ratifikimi i marrëveshjeve ndërshtetërore me Maqedoninë për ruajtjen dhe patrullimin e përbashkët të Kufirit ;

Rishikimi i ligjit "Për rojen bregdetare";

Hartimi i strategjive sektoriale për MIK ;

Miratimi i Strategjisë së Analizës dhe Riskut ;

Miratimi i VKM -së "Për miratimin e Dokumentit tip me elemente të lartë sigurie për të huajt", iniciativë e cila është në përputhshmëri të plotë me Vendimin e Këshillit të datës 3 Dhjetor 1998, për standartet e përbashkëta, përsa i përket formatit uniform për lejet e qëndrimit;

Miratimi i Udhëzimit të Përbashkët të MPJ -s dhe MB -s "Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e shtetasve të huaj në RSH";

Miratimi i Rregullores "Për funksionimin e shërbimeve të policisë kufitare dhe migracionit";

Miratimi i Urdhërit të Përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Brendshëm "Për bashkëpunimin në mes policisë kufitare e migracionit dhe ushtrisë, në situata të jashtëzakonshme dhe lufte";

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në mes të Policisë Kufitare dhe Migracionit dhe agjensive të tjera kombëtare, që operojnë në kufi , si Dogana, Shërbimi Fito-Sanitar;

Miratimi i Urdhërit të ri të Ministrit të Brendshëm "Për përbërjen dhe funksionimin e Komisioneve Sektoriale të përzier dhe atij Kryesor" në përputhje me Organizimin e ri të Policisë Kufitare dhe Migracionit;

Nënshkrimi i marrëveshjeve ndërshtetërore me vendet fqinje për shkëmbimin e informacionit;

Nënshkrimi i marrëveshjes se ripranimit me Bosnje –Hercegovinën, iniciativë e cila është në përputhje të plotë me Rekomandimin e Këshillit të datës, 30 Nëntor 1994 përsa i përket shembullit të marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit midis shteteve anëtare dhe një shteti të tretë;

Amendim i rregulloreve për organizimin e punës në aeroporte dhe porte në bazë të ndryshimeve në ligjin ‘Për kufirin’, dhe "Për forcën e sigurisë në porte”

Nënshkrimi i marrëveshjeve të Ripranimi me shtete anëtare të BE -së, vendet e rajonit dhe atyre të origjinës dhe tranzit, iniciativë e cila është në përputhje të plotë me Rekomandimin e Këshillit të datës 30 Nëntor 1994 ,përsa i përket shembullit të marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit midis

shteteve anëtare dhe një shteti të tretë si dhe me Rregulloren e Këshillit të datës 24 korrik 1995 për kriteret udhëzuese që duhen ndjekur për përgatitjen e protokolleve për zbatimin e Marrëveshjeve të Ripranimit midis Vendeve Anëtare, dhe një vendi të tretë.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese.

Ristrukturimi i Policisë Kufitare dhe Migracionit;
Përmirësimi i menaxhimit të pikave të kalimit kufitar;
Mbështetje për policinë kufitare dhe infrastrukturën doganore;
Përmirësimi i infrastrukturës së pikave të kalimit kufitar (ambjente, zyra shërbimi etj)
Sigurimi i nevojave për radio-ndërlidhje;
Sigurimi i nevojave për paisje me mjete e paisje personale për shërbim të efektivit të Policisë Kufitare dhe Migracionit;
Trajnimi i stafit që do të punojë në Qendrën e pritjes për të Huajt ;
Organizimi i një Konference Kombëtare "Për prezantimin e Strategjisë së re të MIK dhe Planit të saj të Veprimt";
Realizimi i një studimi "Mbi nevojat për ambjente zyra, në Vend-kalimet kufitare dhe rishpërndarja e tyre ndërmjet axhensive në VKK " ;
Realizimi i një studimi "Mbi përzgjedhjen e caktimit e vendeve të bllokimit për mjetet lundruese të sekuestruara" ;
Përzgjedhja e stafit dhe trajnimi i tij për të përdorur teknologjinë e përzgjedhur për shkëmbim informacioni ndërkufitar ;
Ngritja e Qendrës së Trajnimit të PKM -së;
Trajnimi i trajnuesve për efektivat e Policisë Kufitare dhe Migracionit;
Trajnimi i efektivave PKM nga trajnues të vendit dhe të huaj ;
Montimi dhe vënia në funksionim e urave ngritëse për kontroll të automjeteve në VKK;
Vazhdimi i implementimit të projektit të informatizimit TIMS ;
Identifikimi i vendeve të origjinës dhe atyre tranzit, me të cilat duhet nënshkruar marrëveshje ripranimi ;
Identifikimi i vendeve të origjinës dhe atyre tranzit, me të cilat duhet nënshkruar marrëveshje ripranimi ;
Krijimi i një banke të dhënash të përbashkëta me agjensitë që operojnë në kufi.

3.2 Përpjesëtim afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008 – 2009 janë si më poshtë:
Të sigurohet përputhje e plotë e dokumenteve shqiptare të udhëtimit me standardet ndërkombëtare.

Të zbatohet Strategjia e Integruar e Menaxhimit Kufitar dhe të gjitha angazhimet që Shqipëria ka ndërmarrë në fushën e menaxhimit të kufijve.

Të sigurohet që menaxhimi i kufirit në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, në portet e Durrësit dhe të Vlorës, të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Të negociohen marrëveshjet e ripranimit me të gjitha vendet e rajonit dhe me shtetet e origjinës së migrantëve që kalojnë tranzit nëpër Shqipëri.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:
Nënshkrimi i marrëveshjes së ripranimit me Bosnje - Hercegovinën
Amendim i rregulloreve për organizimin e punës në aeroporte dhe porte në bazë të ndryshimeve në ligjin "Për kufirin", dhe "Për forcën e sigurisë në porte"
Nënshkrimi i marrëveshjeve të Ripranimit me shtetet anëtare të BE -së, vendet e rajonit dhe atyre të origjinës dhe tranzit.

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese.
Sigurimi i nevojave me mjete transporti për shërbim në kufi dhe thellësi;
Sigurimi i nevojave për mjete lundruese shërbimi;
Ngritja dhe funksionimi i Qendrës së pritjes për të huajt;
Realizimi i studimit të fizibilitetit "Për përcaktimin e territoreve, hapësirave dhe ambjenteve

për instalimin e teknologjisë së përzgjedhur për shkëmbimin e informacionit ndërkufitar".

Tabela: Shtesë e kapaciteteve institucionale të Strukturave përgjegjëse për fushën e Menaxhimit të kufinjve

INVESTIME	NJESIA E MATJES	GJENDJA AKTUALE	2006	2007	2008	2009	2010
Shtese personeli	Nepunes		+378				
Investime IT	000/leke						
Investime infrastruktura	000/leke		5800	245340		2200000	
Konsulence (e huaj)	000/leke						
Trajnime	000/leke						

3.24.4 POLITIKAT E MIGRACIONIT

1. Objektivi Politik

Qeveria Shqiptare është e ndërgjegjshme për faktin që ekziston realisht një nevojë për të përballuar efektet negative që lëvizjet jo të rregullta të njerezve mund t'i imponojnë një demokracie të brishtë dhe shoqëri në zhvillim, si Shqipëria.

Bazuar në Stragjeninë Kombëtare për Migracionin si dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Marreveshjes së Stabilizimit Asociimit (nënet 46, 48 dhe 80), qeveria Shqiptare do të synojë një menaxhim dhe kontroll konstruktiv të flukseve migratore, në interes të stabilitetit të brendshëm dhe prosperitetit ekonomik, [ka do të kontribuonte në një përdorim më të mirë të burimeve të disponueshme njerezore mbi bazën e një tregu fleksibel punësimit dhe rritjen e mundësive për të hyrë në marreveshje formale, individuale apo kolektive, me vende të tjera evropiane me skema që nxisin liri më të madhe të lëvizjes dhe liberalizim eventual të regjimit të vizave.

Qeveria Shqiptare do të angazhohet në trajtimin e barabartë dhe të drejtë shtetasve të vendeve të tjera të cilët janë rezidentë të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit në këto fushë dhe aritjes së standarteve evropiane.

Qeveria Shqiptare do të angazhohet fuqimisht për respektimin e të drejtave të emigrantëve Shqiptarë në vendet ku ato jetojnë, duke kërkuar një trajtim të barabartë dhe respektim të standarteve ndërkombëtare në këto fushë.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Në dokumentat strategjike në fushën e migracionit mund të përmendet Strategjia Kombëtare e Migracionit, e miratuar me VKM nr. 760, datë 19.11.2004, **si dhe Plani Kombëtar të Veprimit të Migracionit**, miratuar me VKM nr.296, dt.06.05.2005.

Shqipëria ka ratifikuar një sërë Konventash dhe Traktatesh Nderkombëtare në fushën e migracionit të cilat janë:

Karta Sociale Evropiane, përfshirë edhe Nenin 19 "E drejta e punëtorëve migrues dhe familjeve të tyre për mbrojtje dhe asistencë", konkretisht për fushën e migrimit, ratifikuar 2003.

Konventa 97 "Migracioni për punësim" (e rishikuar) 1949, (Organizata Nderkombëtare e Punës) (ILO), ratifikuar, tetor 2004.

Konventa e OKB "Mbi statusin e personave pa shtetësi", ratifikuar, prill 2003.

Konventa e OKB "Mbi reduktimin e personave pa shtetësi", ratifikuar, në prill 2003.

Konventa e ILO-s, Nr 181 "Mbi Agjencitë Private të Punësimit", ratifikuar në 1998.

Konventa e Evropiane e 1977 "Për statusin ligjor të punëtorëve migrante", e ratifikuar në qershor 2006.

Në fushën e migracionit ekziston një bazë e gjerë legjislative, ku si legjislacion parësor mund të përmendet:

Ligji nr. 9034 Datë 20.03.2003 mbi "Emigrimin e shtetasve shqiptarë për qëllime punësimit";

Ligji nr. 8492, Date 27.5.1999 "Per te Huajt";

VKM nr 259, date 05.05.2006 "Per Ratifikimin e Konventes nr, 143, "Per Punetoret Migrante , (Dispozita Plotesuese), 1975, te Organizates Nderkombetare te Punes , bere ne Gjeneve";

VKM nr. 708 Date 16.10.2003 "Per Menyren e Licencimit dhe Funksionimit te Agjencie Private te Punesimit";

VKM, nr. 439, dt. 4/5/2000, "Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve", i ndryshuar;

VKM nr.262, date 25.05.2000, "Per dhenen e lejes per pune shtetasve te huaj";

VKM nr.194, dt.5.04.2006, "Per ngritjen dhe funksionimin e Institutit Kombetar te Diaspores, prane Ministrise se Puneve te Jashtme te Republikes se Shqiperise".

2.2 Kuadri institucional ekzistues

Drejtoria e Politikave te Migracionit ne Ministrine e Punes dhe Çeshtjeve Sociale, eshte institucioni pergjegjes per hartimin dhe zbatimin e politikave migratore per motive punesimi. Kjo Drejtori menaxhon flukset e hyrjes se shtetasve te huaj ne Republiken e Shqiperise dhe te shtetasve shqiptare qe emigrojne jashte vendit. Drejtoria e Migracionit (MPCS) perbehet nga dy sektore, ai i Emigracionit dhe i Imigracionit.

Komiteti Nderministror per Migracionin, eshte struktura me e larte ne nivel politik, me funksion konsultativ e koordinues per te gjithë strukturat qe mbulojne çeshtjet e migracionit, me qellim konvergimin dhe integrimin e te gjitha politikave/strategjiwe sektoriale ne nje politike kombetare gjithepershires migracioni. Per mbledhjet periodike dhe mbarevajtjen e tyre MPCSSHB ka rolin e institucionit organizues dhe koordinues.

Drejtoria e Politikave te Punesimit (reference tek pjesa e punesimit)

Inspektorati Shteteror i Punes (reference tek pjesa e ISHP).

Drejtoria e Pergjithshme e Policise Kufitare dhe Migracionit, si organi pergjegjës për të kontrolluar dokumentat e udhëtimit në Pikat e Kalimit të Kufirit, për të verifikuar vlefshmërinë e tyre, për të pranuar ose refuzuar dokumentat e udhëtimit, për të bllokuar dokumentat e dyshimta, për të vendosur gjoba dhe për të shoqëruar personat me dokumenta të dyshimta në Komisaritet e Policisë lokale.

Zyra për Pasaportat dhe për të Huajt në Komisaritet e Policisë, si organi pergjegjës për marrjen e aplikimeve për dokumenta udhëtimi të lëshuara nga autoritetet shqiptare.

Zyra për të Huajt, Sektori për Pasaportat dhe të Huajt ne Ministrine e Brendshme, si organi që e ngarkon ligji për të lëshuar pasaporta shqiptare për të udhëtuar jashtë shtetit. I njëjti sektor është pergjegjës për pajisjen me Kartë dhe Pasaportë për të Huajt.

Drejtoria e Pergjithshme e Çeshtjeve Juridike, Ndërkombëtare dhe Konsullore, ne Ministrine e Punëve të Jashtme si organ pergjegjës për leshimin e pasaportave te shërbimit dhe ato diplomatike.

Drejtoria e Pergjithshme e Transportit Detar, ne Ministrine e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, si organ pergjegjes për leshimin e pasaportave te detarëve.

2.3 Asistencë Teknike

Asistenca teknike qe eshte duke u zbatuar apo qe eshte siguruar per tua adresuar ne te ardhmen ne fushen e politikave te migracionit eshte si me poshte:

Lufta kunder migrimit te parregullt ne Shqiperi dhe rajon: Mbeshtetje e synuar per ngritjen e kapaciteteve ne kuadrin e mbeshtetjes se Shqiperise per Marreveshjen e Ripranimit, financuar nga Komisioni Evropian dhe Ministria Greke e Puneve te Brendshme dhe Decentralizimit me nje shume prej 874,318,34 euro;

ILO/Migrant "Mundesit punesimi dhe formimi profesional dhe masa politikash migratore per parandalimin dhe reduktimin e trafikimit te grave ne Shqiperi, Moldavi dhe Ukraine, financuar nga qeveria Irlandeze me nje shume prej 700,000 Euro;

Mbeshtetje per zbatimin e Startegjiwe Kombetare te Migracionit dhe ngritjen e kapaciteteve te Qendrave Pritese ne Linze dhe Babrru, financuar nga CARDS 2004 dhe IOM me nje shume prej 2 million Euro (600 000 Euro per SKM);

Mirëserdhet Përsëri: Reintegrimi i Emigranteve" – ĒARM (Programi AENEAS 2005), financuar nga Komisioni Evropian dhe CARITAS-i Italian, Rome me nje shume prej 1.5 milion Euro;

Maksimizimi i potencialeve të migrimit qarkullues për qëllim punësimi ndërmjet Greqisë, Italisë dhe Shqipërisë duke asistuar njëkohësisht edhe kthimin në Shqipëri"(AENEAS 2006),

financuar nga Komisioni Evropian me një shumë prej 1.8 milionë Euro .

3. Adresimi i Prioriteteve

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si më poshtë:

Permiresimi i kapaciteteve administrative dhe financiare për zbatimin e legjislationit për azilin dhe migracionin dhe në vecanti për zbatimin e strategjive kombëtare dhe planet e tyre të veprimit

3.1.1 Iniciativat ligjore afat shkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore.

Miratimi i Projektligjit të ri "Për të huajt", iniciative e cila do të jetë plotësisht në përputhje me Direktiven "Mbi statusin e shtetasve nga shtete jo anetare të BE-se që janë rezidentë afatgjatë"; Direktiven "Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve nga shtete jo anetare me qëllim ushtrimin e aktiviteteve ekonomike për punësim të paguar dhe vetpunësim"; Direktiven "Mbi kushtet e pranimit të shtetasve nga shtete jo anetare për qëllime studimi, shkëmbime nxënësish, trajnime pa pagesë, ose shërbime vullnetare" dhe Direktiven " Mbi të drejtën e bashkimit familjar".

Miratimi i Projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9034/2003, "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi".

Miratimi i Projekt-ligjit "Për ratifikimin e konventës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës Nr. 143 "Për punonjësit migrante".

Neshkrimi i marrëveshjeve ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe bankave të ndryshme në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore të emigrantëve

Nenshkrimi dhe ratifikimi i marrëveshjes me Rumaninë " Për mbrojtjen sociale me vendet pritëse të emigrantëve"

Miratimi i Projekt-ligjit "Për ratifikimin e Konventës së OKB-se "Mbi mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punonjësve migrante dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre"

Hartimi dhe miratimi i Projekt-Vendimit " Për dhënien e lejes së punës, shtetasve të huaj ", iniciative e cila do të jetë plotësisht në përputhje me Direktiva " Mbi statusin e shtetasve nga shtete jo anetare të BE-se që janë rezidentë afatgjatë".

Hartimi dhe miratimi i Projekt-Vendimit " Për nxitjen e kthimit vullnetar të emigrantëve shqiptarë dhe riintegrimi i tyre ", iniciative e cila do të jetë plotësisht në përputhje me Propozimin "Për një program të zbatimit mbi rikthimin"

Miratimi i ndryshimeve të Udhezimit të Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta nr. 786, datë 09.04.2001, "Për dhënien e lejes për punë shtetasve të huaj", iniciative e cila do të jetë plotësisht në përputhje me Direktiva " Mbi statusin e shtetasve nga shtete jo anetare të BE-se që janë rezidentë afatgjatë"

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese.

Kryerja e një raporti vlerësues mbi emigrimin në zonat rurale dhe identifikimi i zonave me emergjente për gjallërimin e sektorit bujqësor.

Kryerja e një studimi për identifikimin e zonave të prekura nga nivelet e larta të emigracionit.

Kryerja e një raporti vlerësues mbi mundësitë e formimit profesional që ofrohen aktualisht për emigrantët e kthyer dhe mbi nevojat dhe mangësitë ekzistuese.

Ngritja dhe funksionimi i komisioneve konsultative të nivelit të lartë ndërmjet institucioneve që mbulojnë çështjet migratore, me Italinë dhe Greqinë

Botimi i pamfletëve që ofrojnë informacion për procedurat e kthimit në Shqipëri, shërbimet sociale për riintegrim që disponohen, etj.

Realizimi i dokumentareve nga TVSH mbi fenomenin e emigracionit shqiptar

Realizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrave të saj, lokale dhe rajonale në kuadër të asistencës për të kthyerit

Vendosja e kontakteve dhe bashkëpunimit me autoritetet lokale/rajonale në Greqi dhe Itali si dhe identifikimi dhe vendosja e kontakteve me organizatat e këtyre vendeve që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe migrantëve

Negocimi me autoritetet greke mbi mundësinë e uljes së tarifave të lejeve të qëndrimit në Greqi në kuadër të rishikimit të mundësive për uljen e tarifave lidhur me legalizimin e dokumentave nëpër Perfaqësitë Shqiptare në bote.

Pajisja me kompjuterave e Zyrrave Rajonale te Punesimit

Trajnime per personelin e Zyrrave Rajonale te Punesimit qe do te merren me dhenien e informacionit per migracionin(sporteli per migracionin)

Krijimi i nje Data-Base i cili do te permbaje informacion ne lidhje me emigrantet e kualifikuar me qellim punesimin e tyre nga ndermarrjet shqiptare

Hartimi i manualeve praktike qe lidhen me ceshtjet e migracionit dhe vënia e tyre në dispozicion të nepunesve qe merren me zbatimin ne praktike te legjislacionit per migracionin

Organizimi i trajnimeve ne fushen e legjislacionit te brendshem dhe nderkombetar per ceshtjet e migracionit, ne bashkepunim me ITAP-in, bazuar ne modulet e hartuara sipas nevojave dhe grupeve te synuara.

Fuqizimi i kapaciteteve te Drejtorise se Migracionit ne MPCSSHB nepermjet rekrutimit te nje personi te specializuar ne te Drejten Migratore.

3.2 Përparësitë afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008 – 2009 janë si më poshtë:

Zbatimi i masave te strategjise kombetare te migracionit.

Ratifikimi dhe zbatimi progresiv I te gjitha konventave nderkombetare ne fushen e migracionit

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Nenshkrimi dhe ratifikimi i marreveshjeve me Italine dhe Greqine "Per mbrojtjen sociale me vendet pritese te emigranteve"

Negocimi dhe nenshkrimi i Marreveshjeve te Mirekuptimti me institucionet qe mbulojne ceshtjet migratore ne Itali dhe Greqi.

Nenshkrimi i Marreveshjeve mes Televizionit Publik Shqiptar dhe kanaleve televizive kombetare te vendeve pritese te emigranteve per transmetimin e nje fushate mediatike informuese ne lidhje me fenomenet e Migracionit

Vlen te theksohet qe masat ligjore dhe aktivitetet zbatuese te percaktuara per periudhen afatshkurter konsiderohen si angazhime qe do te adresojne ne teresi jo vetem prioritetet afatshkurtra por dhe ato afatmesme, duke pasur parasysh qe afatet e realizimit te plote te nje pjese te tyre shtrihen pertej afateve te periudhes afatshkurter.

Tabela: Shtesë e kapaciteteve institucionale të Strukturave ne kuader te Politikave te Migracionit

INVESTIME	NJESIA E MATJES	GJENDJA AKTUALE	2006
Shtese personel i	Nepunes	4	+1

3.24.5 AZILI

1. Objektivi Politik

Qeveria shqiptare është plotësisht e angazhuar për të dhënë kontributin maksimal për ngritje dhe zhvillimin e një sistemi të plotë të Azilit (fully-fledged Asylum System),, nëpërmjet rritjes dhe fuqizimit të kapaciteteve institucionale, në koherencë të plotë me standartet dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian dhe Konventave e instrumentave ndërkombëtare që ekzistojnë në këtë fushë.

Iniciativat që parashikohen të ndërmerren nga Qeveria Shqiptare do të jenë përputhje të plotë me angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (neni 80).

Në përmbushje të këtyre detyrimeve, Qeveria Shqiptare do të jetë e gatshme të bashkëpunojë duke u bazuar në konsultime të ndërsjellta me vendet e tjera, ku do të përfshihet asistencë teknike dhe administrative në çështje të tilla si: shkëmbimi i informacionit për legjislacionin dhe praktikën në fushën e azilit, hartimi i legjislacionit, forcimi i kapaciteteve institucionale etj.

Në këtë drejtim, bashkëpunimi do të përqëndrohet veçanërisht në fushën e azilit për zbatimin e legjislacionit të brendshëm, sipas standarteve të Konventës së Gjenevës, 1951 dhe Protokollit të New York-ut 1967, për të siguruar në këtë mënyrë respektimin e parimit të *non-refoulement* si dhe të të drejtave të tjera të azilkërkuesve dhe refugjatëve.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Ndër dokumentat strategjike që ekzistojnë për fushën e azilit mund të përmendim Planin Kombëtar për Azilin, të aprovuar nga Ministri i Rendit Publik me 29 Gusht 2003. Ky plan veprimi synon të rregullojë të gjitha procedurat që zbatohen gjatë aplikimit të sistemit të Azilit në Shqipëri.

Gjithashtu, Shqipëria është palë e një sërë instrumentesh ndërkombëtare dhe rajonale, të cilat janë të lidhura me zbatimin e Sistemit të Azilit, ndër të cilat mund të përmendet:

Konventa e Gjenevës për “Statusin e Refugjatit” 1951 dhe Protokoli i 1967

Konventa Mbi Personat pa Shtetësi.

Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR),

Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomiko Sociale dhe Kulturore,

Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racial,

Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAË),

Konventa Ndërkombëtare kundër torturës dhe çdo trajtimi tjetër mizor, johuman apo degradues, apo ndëshkimor (CAT),

Konventa mbi të drejtat e Fëmijëve (CRC),

Konventa Evropiane mbi të drejtat njerëzore dhe liritë themelore (ECHR),

Konventa e OKB -së mbi reduktimin e personave apatridë

Nga legjislacioni parësor në fushën e azilit mund të përmendet:

Kushtetuta e RSH -së 1998, neni 39, 40 mbi “mos- dëbimin, ekstradimin individual apo kolektiv të të huajve si dhe të drejtën e tyre për strehim në territorin shqiptar”.

Ligji “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, 1998, i cili është pjesërisht i përafuar me legjilacionin komunitar;

Ligji “Për Integrimin dhe Bashkimin familjar të shtetasve që kanë fituar azil në RSH”, 2003

Ligji “Për të Huajt”, 1999

Ligji “Për Ruajtjen dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror” 2001

2.2 Kuadri institucional ekzistues

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e azilit janë përgjegjëse këto institucione:

Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët, në Ministrinë e Brendshme, është struktura përgjegjëse për marrjen, dhënien dhe heqjen e të drejtës për azil, si shkallë e parë, si edhe për të zbatuar masat e nevojshme për mbrojtjen dhe asistencën për refugjatët. Kjo drejtori, gjithashtu ka nën mbikëqyrjen e saj Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve në Babrru, Tiranë.

Komisioni Kombëtar për Refugjatët, përbëhet nga 8 anëtarë të emëruar nga 8 institucione qendrore. Funkcioni i këtij komisioni është të marrë në shqyrtim kërkesat për apel të bëra kundër vendimeve të marra nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët, dhe në rastet e fluksit masiv ,ky komision ka kompetenca ekskluzive.

Gjykatat e shkallës së parë rishikojnë me kërkesë të të interesuarve, aktet administrative të marra nga autoritetet përgjegjëse për dhënien e azilit

Qendra Kombëtare Pritëse në Babru me një kapacitet prej 200 azilkërkuesish. Kjo qendër ka një staf prej 15 punonjësish, të cilët janë përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të kësaj qendre.

Në kuadër të politikave të azilit *Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët* , në Ministrinë e Brendshme bashkëpunon me:

Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, përsa i përket lejeve të punës, këshillimeve në tregun e punës, kurseve profesionale për azil-kërkuesit etj;

Ministrinë e Shëndetësisë në lidhje me kujdesin shëndetësor

Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, përsa i përket arsimimit dhe pranimin në sistemin arsimor

Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioni në lidhje me strehimin e refugjatëve,

Ministrinë e Punëve të Jashtme,

Shërbimin Informativ Shtetëror.

2.3 Asistencë Teknike

Asistenca teknike për fushën e azilit konsiston në:

Rehabilitimin e Qendrës së Azilkërkuesve në Babrru, projekt i financuar nga programi CARDS 2004 në shumën 0.2 mil Euro.

3. Adresimi i Prioriteteve

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si me poshtë:

Të angazhohen kapacitete të mjaftueshme administrative dhe financiare për zbatimin e legjislationit mbi azilin dhe migracionin, dhe veçanërisht të zbatohen strategjitë përkatëse kombëtare dhe planet e veprimeve.

3.1.1 Iniciativat ligjore afat shkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore.

Amendime të Ligjit Nr.8432, dt 14.12.1998 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë", iniciativë e cila do të jetë plotësisht në përputhje me Konventën e Gjenevës 1951 dhe Protokollin e New York-ut të 1967;

Ndryshime në Ligjin "Për të Huajt", për dhënien e lejes së punës për azilkërkuesit dhe refugjatët, iniciativë e cila do të jetë plotësisht në përputhje me Direktiven "Mbi statusin e shtetasve nga shtete jo anëtare të BE-së, që janë rezidentë afatgjatë" dhe Direktivën " Mbi të drejtën e bashkimit familjar";

Udhëzim i përbashkët i Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punës për "Përkrahjen Sociale", iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Vendimin e Këshillit nr.2000/596 datë 28.09.2000 "Mbi krijimin e një Fondi Europian për Refugjatët";

Udhëzim i Ministrit të Brendshëm "Për kriteret për përcaktimin e shumës së përfitimit", iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Vendimin e Këshillit nr.2000/596, datë 28.09.2000 "Mbi krijimin e një Fondi Europian për Refugjatët" ;

Udhëzimi "Për procedurat e përcaktimit të Statusit të Refugjatit", iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Rezolutën e Këshillit nr. 20.06.1995 "Mbi garancitë minimale për procedurat e azilit";

Rregullore "Për funksionimin e Qendrës Kombëtare pritëse në Babrru", iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Konkluzionet e Këshillit, datë 28.09.2000 "Mbi kushtet e pritjes për azilkërkuesit";

Urdhër "Për ndjekjen e procedurave për një aplikim "abuziv"ose "dukshëm të pabazuar", iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Rezolutën e Këshillit, datë 30.11.1992 "Mbi aplikimet për azil që janë dukshëm të pabaza";

Udhëzim i Ministrit të Brendshëm "Për pajisjen e shtetasve të huaj me Dokumente Udhëtimi", iniciativë e cila do të jetë plotësisht në përputhje me Konventën e Gjenevës 1951 dhe Protokollin e New York-ut të 1967.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese.

Fuqizimi i kapaciteteve administrative të Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme

Krijimi i Grupit të Punës për ndryshimin e Ligjit nr. 8432, datë 14.12.1998 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë"

Organizimi i një seminari për trajnimin e stafit të Qendrës Kombëtare Pritëse në Babrru mbi "Aplikimin e standarteve pritëse të azilkërkuesve"

Përmirësimi i qendrës së pritjes së azil kërkuesve në Babrru

Trajnim i stafit të Drejtorisë për Refugjatët për "Përcaktimin e Statusit të Refugjatit"

Ngritja e Qendrës për marrjen e Informacionit nga vendi i origjinës

3.2 Përparësitë afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008 – 2009 janë si më poshtë:

Të shtrëngohet legjislacioni që ka të bëjë me azilin dhe të ngrihet një sistem me status të plotë për azilin në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Të zbatohet Strategjia Kombëtare e Migracionit dhe Plan Veprimi Kombëtar për Azilin.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioritetëve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Miratimi i VKM -së “Mbi marrjen e informacionit nga vendi i origjinës”, iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Vendimin e Këshillit, datë 11.06.1992 “Për krijimin e CIREA -s (Qendra për informacion, Diskutim dhe Shkëmbim mbi çështjet e Azilit”)

Miratimi i Udhëzimit “Për të siguruar përputhshmërinë e plotë me standardet e mbrojtjes së të dhënave në lidhje me mbrojtjen e të gjithë azilkërkuesve dhe refugjatëve”, iniciativë e cila do të jetë plotësisht në përputhje me Direktivën nr. 95/46/EC e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24 tetor 1995 “Mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Duhet theksuar se masat zbatuese që kanë si afat fillimi periudhën afatshkurtër 2006 – 2007 për zbatimin e tyre shtrihen në kohë deri në vitin 2008, duke adresuar në këtë mënyrë dhe prioritetet afat mesme të Dokumentit të Partneritetit Evropian.

Tabela: Shtesë ei kapaciteteve institucionale të Strukturave të Azilit

INVESTIME	NJESIA E MATJES	GJENDJA AKTUALE	2006
Shtese personel i	Nepunes	4	+1

3.24.6 POLITIKA E VIZAVE

1. Objektivi Politik

Qeveria Shqiptare është thellesisht e angazhuar për të përqsur legjislacionin Shqiptarë në fushën e vizave me standartet dhe praktikën me të mira të Bashkimit Evropian, në përputhje të plote me angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marreveshjes së Stabilizim Asociimit (neni 80,64, 57 dhe 4).

Në këtë kuader, qeveria Shqiptare e konsideron lëvizjen e lirë të shtetasve shqiptarë në vendet e Bashkimit Evropian si një nga objektivat e saj kryesore dhe si një nga karakteristikat kryesore të integritetit evropian.

Qeveria Shqiptare është e ndërgjegjshme për rrugën që duhet të ndjekë dhe standartet që duhet të plotësojë në arritjen e këtij objekti. Për këtë arsye, do të bëhen të gjitha përpjekjet e nevojshme për thellimin e metejshëm të reformave në fushën e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme, në mënyrë të vecantë në lidhje me forcimin e shtetit ligjor, luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionin e migrimit të paligjshëm, forcimin e kapaciteteve administrative për kontrollin e kufirit dhe sigurinë e dokumentave.

Qeveria Shqiptare është e bindur se nënshkrimi dhe zbatimi i plote i Marreveshjes së Ripranimit me Komunitetin Evropian, konsiderohet si një hap shumë pozitiv drejt arritjes së standarteve të kërkuara për të përmirësuar liberalizimin e regjimit të vizave.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Strategjia Kombëtare e Migracionit dhe Plan i Veprimeve për Zbatimin e saj (PVSKM), të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, i kushtojnë pjesë të posaçme çështjeve të vizave dhe kthimit të personave në bazë të marrëveshjeve të ripranimit. Strategjia nxit strukturat shtetërore të

reformojnë sistemet e vizave në përputhje me Acquis Communautaire, njwkohsisht nxit kthimin vullnetar të personave me dokumenta tw parregullta, shtetas shqiptarë apo të huaj nga vende të treta.

Veprimtaria ne fushen e politikës se vizave mbështetet ne legjislacionin parwsor tw meposhtem :

Ligji nr. 8492, date 27/5/1999 "Per te Huajt";

Ligji nr. 9095, date 3/7/2003 "Për shërbimin e jashtëm të RSH";

Ligji nr. 8372, date 09.07.1998 "Per ushtrimin e funksioneve konsullore nga perfaqesite diplomatike ose konsullore";

Ligji nr. 8686, date 11/12/2000 "Për lëshimin e pasaportave për jashtë shtetit";

Ligji nr. 8977, date 12/12/2002 "Për sistemin fiskal në RSH",

VKM nr. 439, date 4/5/2000 "Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve", me shtesat dhe ndryshimet;

VKM nr. 335, date 2/9/1997 "Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit", me shtesat dhe ndryshimet;

2.2 Kuadri institucional ekzistues

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi ne fushen e politikës se vizave janë përgjegjëse këto institucione:

Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Juridike, Ndërkombëtare dhe Konsullore, ne Ministrinw e Puneve te Jashtme. Brenda Drejtorisw sw Përgjithshme tw Çështjeve Juridike, Ndërkombëtare dhe Konsullore , funksionon Drejtoria Konsullore, që në organikën e saj ka një sektor të posaçëm për çështjet e vizave, Sektorin e Vizë – Pasaportave, sektor ky qw përbëhet nga 3(tre) ekspertë.

Drejtoria e Pergjithshme e Policise Kufitare dhe Migracionit, ne perberje te se ciles funksionon Sektori i të Huajve dhe Migracionit si dhe Sektori i Pikave te Kontrollit te Kalimit Kufitar (PKKK).

Drejtoria e Politikave te Migracionit, ne Ministrinw e Punws, Çështjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, për aktivitetet e punësimit apo të vetëpunësimit tw tw huajve.

Sherbimi Informativ Shtetwrwr, kur bëhet fjalë për garantimin e sigurisë kombetare te Republikes se Shqiperise.

3. Adresimi i Prioriteteve

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si me poshtë:

Dokumentet e udhëtimit që lëshohen, të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të vendoset një rrjet kompjuterik (IT) i centralizuar për administrimin e vizave.

Të amendohet ligji për të Huajt, për ta sjellë legjislacionin e vizave më pranë standardeve të BE-së.

3.1.1 Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Miratimi i Projektligjit tw ri "Pwr tw huajt", iniciativw e cila do tw jete pjeserisht ne perputhje me Direktiven e Keshillit, date 28 Qershor 2001, pjese e paragrafeve te Nenit 26 te Konventes qe zbaton Marreveshjen Shengen te 14 Korrikut 1985;

Miratimi i Urdhërit te Përbashkët te Ministrit te Puneve te Jashtme dhe Ministrit te Brendshem për administrimin e vizave pullë, initiative e cila do te jete pjeserisht ne perputhje me Udhëzimet e Përbashkëta Konsullore "Për vizat në përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore" GZ C 310 , 19/12/2003 P. 0001 - 0108

Miratimi i ndryshimit te VKM, nr. 335, dt. 2/9/1997 "Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit", iniciativw e cila do tw jete pjeserisht ne perputhje me Rregulloren e Këshillit (KE), nr. 2252/2004, 13/12/2004, "Për standartet e sigurisë dhe biometrikën në pasaportat dhe dokumentet e udhëtimit të lëshuara nga shtetet anëtare"

Miratimi i Urdhërit te Kryeministrit për prodhimin e pullës vizë, iniciativw e cila do te jete pjeserisht ne perputhje me Rregulloren e Këshillit (KE), No 1683/95, 29/5/1995, "Për caktimin e formatit uniform të vizës" GZ L 164 , 14/07/1995 P. 0001 – 0004 si dhe me Rregulloren e Këshillit (KE), No 334/2002, 18/2/2002, "Për ndryshimin e Rregullores No 1683/95" GZ L 053 , 23/02/2002 P. 0007 – 0008.

Miratimi i ndryshimeve ne Ligjin nr. 8977, dt. 12/12/2002, "Për sistemin fiskal në RSH",

iniciative e cila do te jete pjeserisht ne perputhje me Rregulloren e KE, 454/2003, "Për tarifat e vizave";

Miratimi i ndryshimit te VKM, nr. 439, dt. 4/5/2000 "Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në RSH", initiative e cila do te jete pjeserisht ne perputhje me Direktiven e Keshillit, date 28 nentor 2002 "Mbi percaktimin e hyrjes se pa-autorizuar, treanzitit dhe qendrimit";

Miratimi i Ndryshimeve në VKM, 439, dt. 4/5/2000 "Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në RSH" ne kuader te hartimit te politikave të vizave në përputhje me politikat e BE-se, initiative e cila do te jete pjeserisht ne perputhje me Udhëzimet e Përbashkëta Konsullore "Për vizat në përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore" GZ C 310 , 19/12/2003 P. 0001 - 0108 .

Ndryshimi i VKM, nr. 439, dt. 4/5/2000, "Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në RSH", ne kuader rishikimit te listave pozitive dhe negative, initiative e cila do te jete pjeserisht ne perputhje me Rregulloren e Këshillit (KE), No 539/2001, 15/3/2001, "Për listimin e vendeve shtetasit e të cilëve kanë nevojë për viza dhe vendeve që nuk kanë nevojë" GZ L 081 , 21/03/2001 P. 0001 – 0007, me Rregulloren e Këshillit (KE), No 2414/2001, 7/12/2001, "Për ndryshimin e Rregullores No 539/2001" GZ L 327 , 12/12/2001 P. 0001 – 0002 si dhe me Rregulloren e Këshillit (KE), No 453/2003, 6/3/2003, "Për ndryshimin e Rregullores No 539/2001" GZ L 69, 06.03.2003, P 10;

Ndryshimi i Urdhërit të Përbashkët te Ministrit te Puneve te Jashtme dhe Ministrit te Brendshem nr. nr. 1460, date 21/5/2001 "Për hyrjen dhe qëndrimin e të huajve", initiative e cila do te jete pjeserisht ne perputhje me Udhëzimet e Përbashkëta Konsullore "Për vizat në përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore" GZ C 310 , 19/12/2003 P. 0001 – 0108, Vendimin e Komitetit Ekzekutiv, 28/4/ 1999, "Për versionin përfundimtar të Manualit të Përbashkët dhe Udhëzimeve të Përbashkëta Konsullore" (SCH/Com-ex (99) 13), Katalogun e rekomandimeve për aplikimin korrekt të Acquis së Shengenit dhe praktikat më të mira: Në lëshimin e vizave 07-02-2003 - Çështjet e vizave 21-11-2002 - Sistemi i Informacionit Shengen 24-10-2002 - Kufijtë dhe heqja e kontrolleve, ripranimi 08-02-2002 SIRENE Manual Official Journal C 038 , 17/02/2003 P. 0001 – 0024

Miratimi i ndryshime në Ligjin "Për të Huajt", per përmirësimin e procedurave të lëshimit të vizave në kufi, initiative e cila do te jete pjeserisht ne perputhje me Rregulloren e Këshillit (KE), No 415/2003, 27/2/ 2003, "Për lëshimin e vizave në kufi, përfshirë vizat e marinarëve në tranzit" GZ L 64 of 07.03.2003 dhe Udhëzimet e Përbashkëta Konsullore "Për vizat në përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore" GZ C 310 , 19/12/2003 P. 0001 - 0108

Miratimi i Udhëzimit te Ministrit të Punëve të Jashtme "Per hartimin e listave të personave te shpallur "non grata", iniciativw e cila do te jete pjeserisht ne perputhje me Udhëzimet e Përbashkëta Konsullore "Për vizat në përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore" GZ C 310 , 19/12/2003 P. 0001 - 0108

Miratimi i ndryshimeve ne VKM, nr. 439, dt. 4/5/2000, "Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në RSH" ne kuader te aplikimit te formularit për dokumentet e panjohura dhe formularit për vizat në grup, initiative e cila do te jete pjeserisht ne perputhje me Rregullorja e Këshillit (KE), Nr 333/2002, 18/2/2002, "Për një formular të unifikuar ku vendoset viza për personat që posedojnë dokumente të panjohura nga vendet anëtare" GZ L 053 , 23/02/2002 P. 0004 – 0006.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese.

Realizimi i trajnimeve per rritjen e kapaciteteve te personelit qe do te merret me përafrimin e listave pozitive dhe negative

Hartimi i listave të personave "non grata"/"grata" dhe organizimi i shpërndarjes.

Nxjerrja jashtë qarkullimit të pasaportave të tipit të vjetër (mod 95)

Hedhja në qarkullimit e pasaportave të reja diplo-shërbimi (mod 02)

Organizimi i moduleve të trajnimit të personeleve që trajnojnë per çwshtjet e vizave

Prodhimi dhe shpërndarja e vizave pullë

Përmirësimi i informacionit për të huajt dhe aksesit për të marrë informacion

Ngritja e Qendrës Kombëtare të Vizave (QKV).

Mbajtja i regjistrit kombëtar të vizave në përbërje të QKV

Përgatitja e formularit të vizës në grup

3.2 Përparësitë afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008 – 2009 janë si më poshtë:

Të sigurohet përputhje e plotë e dokumenteve shqiptare të udhëtimit me standardet ndërkombëtare

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Miratimi i Udhëtimit të Ministrit të Punëve të Jashtme "Për kryerjen e një studimi për përmirësimin e kapaciteteve të përpunimit të vizave në MPJ/PDK në kuadër të Trajnimit të personave që përpunojnë vizat", iniciative e cila do të jete pjesërisht në përputhje me Udhëzimet e Përbashkëta Konsullore "Për vizat në përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore" GZ C 310 , 19/12/2003 P. 0001 – 0108

Miratimi i Urdhërit të Kryeministrit "Për ngritjen e Qendës Kombëtare të Vizave", iniciative e cila do të jete pjesërisht në përputhje me Udhëzimet e Përbashkëta Konsullore "Për vizat në përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore" GZ C 310 , 19/12/2003 P. 0001 - 0108

Miratimi i Urdhërit të Ministrit të Punëve të Jashtme "Për pajisjen e përfaqësive me mjetet e nevojshme për zbulimin e dokumentave të falsifikimeve", iniciative e cila do të jete pjesërisht në përputhje me Udhëzimet e Përbashkëta Rekomandim i Këshillit, 29/4/1999, "Për pajisjen e njësive që trajtojnë vizat dhe përfaqësitë jashtë shtetit me mjetet për dedektimin e dokumenteve të falsifikuara" GZ C 140 , 20/05/1999 p. 0001 - 0002

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e Sistemit të Integruar(informatizuar) të trajtimit të Vizave (InViS)

Ndërprerja e lëshimit të vizave në kufi

Përgatitja e Manualit të Dokumenteve të Njohura, ku fiksohen vizat

Përgatitja e formularit të vizës në dokumentet e panjohura

Paisja e përfaqësive dhe QKV me mundësitë e dedektimit të falsifikimeve

Përmirësimi i kapaciteteve të MPJ dhe përfaqësive diplomatike

Tabela: Shtesë e kapaciteteve institucionale të Strukturave në kuadër të politikës së Vizave

INVESTIME	NJESIA E MATJES	GJENDJA AKTUALE	2006	2007	2008	2009	2010
Shtese personeli	Nepunes		+13 persona				
Investime IT	000/leke		1,704,000		180,000,000		
Investime infrastrukture	000/leke		25,800,000	4,800,000	32,400,000		
Konsulence (e huaj)	000/leke		15,000,000	3,000,000	1,200,000		
Trajnime	000/leke						

3.24.7 KRIMI I ORGANIZUAR DHE TRAFIQET E PALIGJSHME

1. Objektivi Politik

Fusha e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikëve të paligjshme është një ndër fushat prioritare për Qeverinë Shqiptare si dhe një element shumë i rëndësishëm në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Angazhimet e ndërmarra dhe objektivat e përcaktuara shkojnë në një linjë me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (nenet 4, 78, 81 dhe 85).

Këto detyrime parashtrojnë domosdoshmërinë e angazhimit të Shqipërisë në nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, për çështje që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar, migrimit të paligjshëm dhe trafikimit, duke përfshirë në veçanti atë të qënieve njerëzore, kontrabandën, trafikimin e paligjshëm të armëve dhe të makinave, etj. Këto detyrime përbëjnë një faktor kyç për zhvillimin e

marrëdhënieve të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në stabilitetin rajonal.

Qeveria shqiptare është plotësisht e angazhuar në forcimin e luftës ndaj fenomenit të krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme, duke synuar arritjen e standarteve të kërkuara dhe plotësimin e angazhimeve të marra.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Ndër dokumentat strategjike të miratuara për këtë fushë mund të përmendim Strategjinë Kombëtare të Luftës kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore, miratuar me VKM 624, dt 7.12.2001 dhe Planin e Veprimit për zbatimin e kësaj strategjie, në të cilën përcaktohen qartë masat dhe hapat që duhet të ndërmerren nga institucionet përkatëse për forcimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikimit.

Në fushën e krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme ekziston një bazë e gjerë legjislative, ku si legjislacion parësor mund të përmendet:

Ligji nr. 8920 dt. 11.7.2002, “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara, kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj; Protokollin e Palermos, i vitit 2000 “Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave veçanërisht të femrave dhe fëmijëve, në plotësim të konventës së OKB-së “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”.

Ligji nr. 8553 dt. 25.11.1999 “Për Policinë e shtetit”

Ligji nr. 8677 dt. 02.11.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë Gjqësore”.

Ligji nr. 7895 dt. 27.01.1995 “Kodi Penal” të cilit në mënyrë të vazhdueshme i janë bërë disa herë ndryshime duke shtuar figura të reja veprash penale kryesisht në fushën e luftës kundër krimit të organizuar.

Ligji Nr. 7905 date 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të cilit i janë bërë gjatë këtyre viteve një sërë ndryshimesh dhe përmirësimesh në lidhje me procedimin penal të autorëve të krimit dhe aplikimin e teknikave dhe metodave speciale të hetimit.

Ligji Nr. 9284 dt. 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e Krimit të Organizuar”

Gjithashtu në kuadër të bashkëpunimit me vendet e tjera në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit është nënshkruar dhe ratifikuar marrëveshja midis Qeverisë së Republikës Greke dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë “*Për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktimë të trafikimit*”, iniciativë e cila është në përputhje të plotë me Veprimin e Përbashkët, të 24 Shkurt 1997, i adoptuar nga Këshilli në bazë të nenit K. 3 të Traktatit të Bashkimit Evropian në lidhje me veprimin për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve.

2.2 Kuadri institucional ekzistues

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi janë përgjegjëse këto institucione:

Drejtoria e Luftës Kundër Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve, në Ministrinë e Brendshme, e përbërë nga 6 (gjashtë) sektorë, si dhe sektorët e luftës Kundër Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve që veprojnë në çdo Drejtori të Policisë.

Drejtoria e Luftës Kundër Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve ka për mision bashkërendimin, kontrollin, parandalimin, zbulimin dhe luftën ndaj organizatave kriminale.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme, Drejtoria e Luftës Kundër Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve bashkëpunon me:

Ministrinë e Drejtësisë në hartimin e legjislacionit në fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe të trafikeve të paligjshme.

Prokurorinë e Përgjithshme (Prokurorinë e Krimeve të Rënda) në hetimin e rasteve kriminale dhe ecurinë e tyre.

Shërbimin Informativ Shtetëror në kuadër të shkëmbimit të informacioneve dhe realizimit të operacioneve të përbashkëta.

Ministrinë e Punëve dhe Çështjeve Sociale, në kuadrin e akomodimit dhe riintegrit të viktimave të trafikut.

Ministrinë e Transporteve për të lidhur luftën e parandalimit të trafikut të mjeteve motorike.

Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Luftës kundër Pastrimit të Parave), për trafiket e paligjshme në mënyrë të veçantë kundër trafikut të

mjeteve motorike, armëve e municioneve si dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Ministrinë e Mbrojtjes si në drejtim të shkëmbimit të informacioneve (me SHIU-n) edhe në operacione të përbashkëta (me Distriktin Detar).

Organet e pushtetit vendor e qëndror.

Misionet e huaja policore që operojnë në Shqipëri

2.3 Asistencë Teknike

Asistenca teknike për fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme konsiston në disa projekte në kuadër të programit CARDS. Ndër to mund të përmendet:

Projekti për ndërtimin e një rrjeti për transmetimin e të dhënave, financuar nga CARDS 2002 me një shumë prej 6 milion euro;

Projekti për zhvillimin e kapaciteteve të njësive së analizës së informacionit kundër krimit të organizuar, financuar nga CARDS 2003 me një shumë prej 2 milion euro;

Projekti për mbështetje teknike, trajnime dhe paisje për Drejtorinë e Krimit të Organizuar, financuar nga CARDS 2004 me një shumë prej 2 milion euro;

Projekti për mbështetje teknike, trajnime dhe paisje për njësitë rajonale antitrafik, financuar nga CARDS 2004 me një shumë prej 0.5 milion euro;

Projekti për forcimin e kapaciteteve investiguese për krimin e organizuar dhe menaxhimin e çështjeve penale, financuar nga CARDS 2004 me një shumë prej 1.5 milion euro;

3. Adresimi i Prioriteteve

3.1 Prioritetet afatshkurtra (2006 – 2007)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si me poshtë:

Të arrihen rezultate të përmirësuara konkrete në luftën kundër krimit të organizuar, veçanërisht duke u mbështetur plotësisht në dispozitat e ligjeve të reja mbi krimin e organizuar dhe duke përsheptuar zbatimin e masave vepruese kundër krimit të organizuar.

Të përcaktohen më qartë përgjegjësitë përkatëse të strukturave të ndryshme shtetërore që merren me luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit; të merren masa për të rritur bashkëpunimin, veçanërisht midis autoriteteve gjyqësore dhe policisë.

Të forcohen sistemet e mbledhjes dhe përpunimit të informacionit që të garantojnë koherencë dhe bashkërendim.

Të rritet përdorimi i mjeteve speciale të hetimit, interceptimi i telekomunikimeve dhe përdorimi i informacionit të inteligjencës.

Të ndërmerren urgjentisht masa konkrete për garantimin e mbrojtjes së dëshmitarit.

Të merren masa të mëtejshme për ta sjellë sigurinë në aeroportin e Tiranës më pranë standardeve ndërkombëtare.

3.1.1 Iniciativat ligjore afat shkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore.

Disa shtesa në Ligjin nr. 7895 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", datë 27.01.1999, për nenin 297/1 "kontrabandimi i personave", iniciativë e cila do të jetë në përputhje të plotë me Protokollin e Palermos "Për luftën kundër kontrabandimit të njerëzve nga toka, deti dhe ajri (2000)"

Disa ndryshime në VKM Nr.8, dt 05.01.2002 "Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore", iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Vendimin Kuadër i Këshillit "Mbi luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore"

Hartimi dhe miratimi i një Vendimi të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Komiteteve lokale të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore në nivel qarku" iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Vendimin Kuadër i Këshillit "Mbi luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore";

Hartimi dhe miratimi i një Vendimi të Këshillit të Ministrave "Për standartet e trajtimit të viktimave të trafikimit";

Shtesat në Ligjin nr. 9205, datë 15/03/2004 "Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë", iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Rezolutën e Këshillit "Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve", datë 23 Nëntor 1995 ;

Hartimi i një urdhëri të Ministrit të Brendshëm "Për rastet e administrimit të pasurive të personave që merren në mbrojtje", iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Rezolutën e Këshillit "Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve", datë 23 Nëntor 1995

Hartimi i një urdhëri të Ministrit të Brendshëm "Për procedurat standarte të aplikimit të mjeteve speciale të hetimit" iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Rezolutën e Këshillit "Mbi interceptimet e ligjshme të telekomunikimeve", datë 17 Janar 1995;

Hartimi i një urdhëri të Ministrit të Brendshëm "Për procedurat e rekrutimit të punonjësve që aplikojnë mjete speciale"

Hartimi i një urdhëri të Ministrit të Brendshëm "Për trajtimin financiar të punonjësve të policisë gjatë aplikimit të metodave speciale"

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese.

Ngritja e një strukture të posaçme shtetërore të quajtur "Autoriteti Përgjegjës" i cili do të jetë komisioni i përbashkët për mbrojtjen e fëmijëve viktimë të trafikimit;

Përmirësimi i infrastrukturës së qendrës së viktimave të trafikut në Linzë;

Krijimi dhe vënia në funksionim si një drejtori më vete e Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, me një personel prej 16 vetash nga 6 që ka aktualisht kjo strukturë.

Krijimi i infrastrukturës së nevojshme për mjetet speciale të hetimit për ekzaminimet shkencore siç janë: përgjimet telefonike, ambientale dhe elektronike;urvejimi dhe dokumentimi filmik ose fotografik i veprimeve kriminale; përdorimi i veprimeve të simuluar, etj.

Zhvillimi i kapaciteteve të grumbullimit dhe analizimit të informacionit nga njësitë e inteligjencës së policisë kriminale

Paisja me IT për njësinë e analizës së inteligjencës së policisë kriminale

Përmirësimi i kapaciteteve të Drejtorisë së Luftës kundër Krimit të Organizuar nëpërmjet realizimit të trajnimeve të nevojshme dhe dhënies së asistencës teknike

Paisja e Drejtorisë së Luftës kundër Krimit të Organizuar me mjetet e nevojshme për të rritur efikasitetin në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit.

Përmirësimi i kapaciteteve të njësive rajonale të antikrimit nëpërmjet realizimit të trajnimeve të nevojshme dhe dhënies së asistencës teknike

Paisja e njësive rajonale të antikrimit me mjetet e nevojshme për të rritur efikasitetin në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit.

Vazhdim i trajnimeve në Akademinë e Policisë, në bashkëpunim me Misionin PAMECA dhe programin ICITAP, për të rritur profesionalizimin tek specialistët e rolit të mesëm dhe të lartë që punojnë në strukturat e luftës kundër krimit ekonomik dhe financiar.

Krijimi dhe funksionimi i njësive speciale të mbikqyrjes në Drejtorinë e Policisë së qarqeve për strukturat e luftës kundër krimit të organizuar.

Pajisja me infrastrukturën dhe mjetet e nevojshme për forcat e posaçme që veprojnë kundër krimit të organizuar (Task Force) në Prokuroritë e rretheve gjyqësore Tiranë, Shkodër, Durrës, Fier dhe Vlorë.

Mbledhja dhe përdorimi i përbashkët nga policia, prokuroria dhe institucionet e drejtësisë ligjore i statistikave të sakta dhe të verifikueshme, në formë tabelash, mbi arrestimet, ndjekjet penale, dënimet e masat e dënimit në fushën e trafikimit, si dhe analizimi dhe ndreqja e problemeve që hasen

3.2 Përpjesëtim afatmesme (2008 – 2009)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008 – 2009 janë si më poshtë:

Të rritet bashkëpunimi ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Të arrihet progres i konsiderueshëm në përqindjen, numrin dhe cilësinë e ndjekjeve penale për shkeljet që kanë lidhje me krimin e organizuar dhe trafikun, si dhe përsa i takon sekuestros së të ardhurave të krimit.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit rajonal me policitë homologe kundër krimit të organizuar.

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese.

Ngritja e grupit të punës për hartimin dhe negocimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit rajonal

Krijimi i infrastrukturës dhe mjeteve speciale të hetimit dhe të ekzaminimeve shkencore për të luftuar forma të ndryshme të krimit të organizuar si dhe ngritja e një laboratorit për analiza të hollësishme, veçanërisht të ADN-së.

Tabela: Shtesë e kapaciteteve institucionale të Strukturave të Luftës kundër Krimit të Organizuar dhe Trafikimit

VESTIMENTE	NJESIA	GJENDJA	2006	2007	2008	2009
	E M A TJ ES	AKT UAL E				
ntese personeli	Nepunes		+10			
vestime IT	000/leke		0.45 mil Euro (CARDS)			
vestime infrastrukturave	000/leke		3.95 mil euro (CARDS)			
onsulence (e huaj)	000/leke					
ajnjime	000/leke		0.35 mil Euro (CARDS)			

3.24.8 LUFTA KUNDËR DROGËS

1. Objektivi Politik

Qeveria Shqiptare, në përputhje me Strategjinë Anti-Drogë 2004-2010, synon që të krijojë një sistem efikas të vlerësimit të rrezikut, që lidhet me ofertën për drogë, konsumin dhe efikasitetin e veprimtarive antidrogë, të forcojë e të përmirësojë aksionet kundër trafikimit të drogave ilegale dhe prekursorëve si një pjesë integrale e luftës kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit, të përmirësojë ndërveprimin dhe bashkërendimin ndërmjet institucioneve shtetërore dhe jo shtetërore të angazhuara në luftën kundër drogave, të kontrollojë pasojat negative mbi shëndetin publik dhe mbi shoqërinë nga përdorimi i drogës, të forcojë bashkëpunimin me organizatat

ndërkombëtare dhe vendet e tjera.

Qeveria Shqiptare do të nxisë bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, për çështje që kanë të bëjnë me parandalimin trafikimit të paligjshëm të drogave dhe substancave psikotropike.

Bashkëpunimi në këtë fushë do të përqëndrohet dhe në përpjekjet për të siguruar një përjasje të balancuar dhe të harmonizuar në drejtim të problemeve të drogës. Politikat e drogës dhe veprimet do të përdoren për reduktimin e ofertës, trafikimin dhe kërkesën për drogat e paligjshme, si dhe për të ushtruar një kontroll më të efektshëm të shkelësve. Veprimet në këtë fushë do të bazohen në principe të rëna dakort sipas parimeve të Strategjisë Europiane për Drogën si dhe Koventave dhe instrumentave të tjera ndërkombëtare në këtë fushë.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Ndër dokumentat strategjike në fushën e luftës kundër drogës mund të përmendim Strategjinë Kombëtare Antidrogë 2004-2010 dhe Planin e saj të veprimit, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 292 datë 07.05.2004. Në këtë strategji përcaktohen hapat dhe veprimet që do të ndërmerren me synim reduktimin e ofertës, parandalimin dhe goditjen e linjave të trafikut të drogave të forta, parandalimin e kultivimit dhe trafikimit të marijuanës, rritjen e kapaciteteve të policisë për identifikimin e përdoruesve, rritjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera si dhe përdorimin e teknikave speciale të hetimit të këtij trafikut.

Ndër Ligjet parësore në fushën e luftës kundër drogës mund të përmendet:

Ligji nr. 8722, datë 26.12.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope, 1988”.

Ligji nr. 8723, datë 26.12.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën e Vetme Mbi Drogat Narkotike”, e ndryshuar nga Protokolli i vitit 1972 “Për ndryshimin e Konventës së Vetme mbi drogat narkotike, 1961”.

Ligji nr. 8965, datë 07.11.2002 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi substancat narkotike e psikotrope, 1971”.

Ligji nr. 8750, datë 26.03.2001 “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope”.

Ligji nr. 7975, datë 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”.

Ligji nr. 8874, datë 29.03.2002 “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”.

Kodi Penal Shqiptar (nenet 283 deri 286 të këtij Kodi). Në këto nene parashikohen sanksione penale për prodhimin, përgatitjen, shpërndarjen, trafikun, transportimin, mbajtjen, shitjen e lëndëve narkotike e psikotrope dhe kultivimin e bimëve narkotike.

2.2 Kuadri institucional ekzistues

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e luftës kundër trafikimit të drogës janë përgjegjëse këto institucione:

Sektori i Luftës Kundër Drogës (Shërbimi Qendror i Luftës kundër Drogës), në Ministrinë e Brendshme, i cili përbën organin e vetëm përgjegjës për trajtimin në mënyrë të unifikuar të veprimtarisë së strukturave të policisë për veprat penale në fushën e drogës. Minisori i këtij sektori qendror është:

kryerja e veprimtarisë koordinuese, bashkëvepruese, operacionale, administrative, hetimore për veprat penale në fushën e drogës dhe ato që i delegohen nga prokuroria në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe detyra të tjera që i ngarkohen nga Kodi Penal dhe legjislacioni aktual në këtë fushë;

bashkërendimi dhe koordinimi i veprimtarisë që buron nga bashkëpunimi policor ndërkombëtar dhe organizma të tjera ndërkombëtare që trajtojnë problemet e drogës;

koordinimi i veprimtarisë operacionale midis Seksioneve të Luftës Kundër Drogës (Zyrave Rajonale) dhe strukturave të tjera që merren me luftën kundër krimit.

Institucione të tjera përgjegjëse për luftën kundër drogës janë:

Prokuroria e Përgjithshme;

Shërbimi Informativ Shtetëror;

Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave), e cila bashkëpunon me

Ministrinë e Brendshme në zbatim të një memorandumit mirëkuptimi “Mbi bashkëpunimin ndërinstitucional për luftën kundër trafikut të drogës dhe Prekursorëve”;

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e cila bashkëpunon me Ministrinë e Brendshme në përmbushje të akt - marrëveshjes dy palëshe “Për luftën kundër fenomenit të përdorimit, abuzimit dhe shpërndarjes së drogës në mjediset shkollore” ;

Ministria e Bujqësisë e cila bashkëpunon me Ministrinë e Brendshme në përmbushje të akt-marrëveshjes dy palëshe “Për luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike” ;

Ministria e Shëndetësisë, e cila bashkëpunon me Ministrinë e Brendshme në përmbushje të akt- marrëveshjes dy palëshe “Për forcimin e masave të kontrollit kundër prekursorëve dhe drogave që përdoren në mjekësi”;

Qendra Kombëtare për kontrollin mbi drogën, e cila është përgjegjëse për analizat dhe mbikëqyrjen administrative në lidhje me kontrollin e drogave që përdoren në mënyrë të ligjshme.

Departamenti farmaceutik, i cili është përgjegjës për zbatimin e ligjit lidhur me monitorimin e aktiviteteve farmaceutike nëpërmjet Shërbimit të inspektimit farmaceutik.

Instituti i Shëndetit Publik, i cili monitoron praktikën lidhur me përshkrimet e recetave dhe përgatit udhëzues për përshkrimin e ilaçeve me përmbajtje narkotike.

2.3 Asistencë Teknike

Asistenca teknike për fushën e luftës kundër trafikimit të drogës konsiston në:

Sigurimin e paisjeve për zbulimin e lëndëve narkotike, financuar nga programi CARDS 2002 në shumën 0.14 mil euro.

3. Adresimi i Prioriteteve

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si me poshtë:

Të zbatohet Strategjia Kombëtare Kundër Drogës dhe plani veprimit përkatës.

Të përmirësohet trajnimi, pajisja dhe vazhdimësia në menaxhimin e oficerëve policorë që merren me luftën kundër drogës.

Të evidentohen dhe të ndiqen penalisht personat përgjegjës për korrupsion në lidhje me trafikun e drogës, në të gjitha hallkat e administratës publike.

Të merren masa për të siguruar bashkërendim më të mirë si brenda vendit, ashtu edhe me partnerë të vendeve të huaja në luftën kundër drogës.

Të sigurohet transparencë më e lartë në shifrat e drogës së kapur dhe të eliminohet fizikisht droga e kapur nga çështjet e vjetra.

3.1.1 Iniciativat ligjore afat shkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore.

Miratimi i shtesave në ligjin nr.7975, dt 26.07.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope", iniciativë e cila është plotësisht e përputhur me Konventën “Mbi Substancat Psikotrope (Vienë 21 Shkurt 1971);

Miratimi i një akti nënligjor për monitorimin e importimit të farërave dhe kultivimit të kanabisit, iniciativë e cila është pjesërisht në përputhje me Veprimin e Përbashkët, datë 29 Nëntor 1996, i adoptuar nga Këshilli në bazë të Nenit K.3 të Traktatit të Bashkimit Evropian, në lidhje me shkëmbimin e informacionit rreth profilizimit kimik të drogave për të lehtësuar një përmirësim të bashkëpunimit midis Shteteve Anëtare në luftën kundër trafikimit të drogës;

Miratimi i një akti nënligjor për funksionimin e Komitetit Kombëtar të Bashkërendimit të Luftës kundër Drogës, Sekretariatit të Komitetit dhe Qendrës Kombëtare të Grumbullimit të të dhënave për drogën, iniciativë e cila është pjesërisht në përputhje me Rregulloren e Këshillit (EEC) nr. 302/93 e datës 8 Shkurt 1993 mbi ngritjen e një Qendre Evropiane të Monitorimit të Drogës dhe Varësisë nga Droga - e amenduar;

Miratimi i një akti nënligjor për funksionimin e Komisionit Ndërmënsor për miratimin e licensave për prodhimin, fabrikimin, etj, të lëndëve narkotike e psikotrope;

Miratimi i një Udhëzimi të Përbashkët mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Brendshme për lëshimin e lejeve për përdorimin e objekteve për prodhimin, fabrikimin, tregtimin e substancave narkotike, iniciativë e cila është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin e Këshillit, datë. 25 Prill 2002, “Mbi nevojën për të rritur bashkëpunimin dhe shkëmbimet e informacionit rreth njësive të ndryshme operationale të specializuara në luftimin e trafikimit të prekursorëve në Shtetet

Anëtare të Bashkimit Evropian”

Miratimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit “Për parandalimin e fenomenit të përdorimit dhe shpërndarjes së substancave narkotike në mjediset shkollore”

Miratimi i një akti nënligjor për ruajtjen, administrimin dhe asgjësimin e lëndëve narkotike të sekuestruara

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese.

Nga Ministria e Brendshme, Sektori i Luftës Kundër Drogës:

Ngritja dhe funksionimi i zyrës për kontrollin e prekursorëve

Forcimi i kapaciteteve nëpërmjet pajisjes me automjete dhe pajisje kontrolli të disa seksioneve të luftës kundër drogës.

Ngritja e një ambienti të përshtatshëm për kontrollin e automjeteve në Vendkalimin Kufitar Qafë - Thanë si dhe vendosja e një sistemi komunikimi të drejtëpërdrejtë të tre Seksioneve të Luftës Kundër Drogës në bazë, me Sektorin e Luftës Kundër Drogës në Qendër.

Zhvillimi i kurseve të trajnimit për efektivat e Luftës Kundër Drogës lidhur me zbatimin e teknikave speciale të hetimit, "blerjen e stimuluar", "dorëzimin e kontrolluar", etj.

Krijimi i një magazine qendrore për ruajtjen e administrimin e drogave të sekuestruara.

Krijimi dhe funksionimi i zyrës së Sistemit të të Dhënave për Drogën pranë Këshillit të Ministrave.

Sigurimi i paisjeve të nevojshme për zbulimin e lëndëve narkotike

Krijimi i rrjetit të informacionit dhe përsosja e teknologjisë në funksion të luftës kundër drogës.

Nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave:

Trajnim i oficerëve doganore dhe stafit të sektorit antitrafik në rritjen e efikasitetit të luftës kundër trafikëve të paligjshme dhe lëndëve narkotike

Krijimi i një programi të mirëfilltë për parandalimin e trafikut të drogës

Krijimi i një database specifik për parandalimin e trafikut të drogës

3.2 Përpjesëtim afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008 – 2009 janë si më poshtë:

Të çohet më përpara zbatimi i Strategjisë Kombëtare Kundër Drogës dhe plani i veprimit përkatës.

Të arrihen rezultate akoma më të mira në luftën kundër trafikut të drogës, veçanërisht për sa u përket drogave sintetike, heroinës dhe kokainës.

Masat ligjore dhe aktivitetet zbatuese të përcaktuara për periudhën afatshkurtër konsiderohen si angazhime që do të adresojnë në tërësi jo vetëm prioritetet afatshkurtra por dhe ato afatmesme, duke pasur parasysh që afatet e realizimit të plotë të një pjese të tyre shtrihen përtej afateve të periudhës afatshkurtër.

Tabela: Shtesë e kapaciteteve institucionale të Strukturave përgjegjëse për fushën e Luftes kundër Drogës

INVESTIME	NJESIA	GJENDJA	2006	2007	2008	2009
	E	AKT				
	M	UAL				
	A	E				
	TJ					
	ES					
Shtese personeli	Nepunes					
Investime IT	000/leke					

Investime infrast ruktur e	000/leke	17500
Konsulence (e huaj)	000/leke	
Trajnime	000/leke	1250

3.24.9 PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE

1. Objektivi Politik

Qeveria shqiptare është plotësisht e angazhuar për të forcuar autoritetin e luftës kundër pastrimit të parave me origjinë nga trafiqet ilegale dhe terrorizmi si dhe për dekriminalizimin e aktivitetit ekonomik në vend. Në këtë mënyrë synohet që t'i shërbehet rritjes së besueshmërisë në vend dhe në sistemin e tij ekonomik e ligjor. Fuqizimi i kapaciteteve në këtë drejtim do të ketë vëmendjen kryesore me qëllim arritjen e rezultateve të dukshme dhe konkrete.

Të gjitha iniciativat që do të ndërmerren, do të jenë në përputhje me angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (neni 4 dhe 82), në të cilat parashtrohet domosdoshmëria e Përafrimit të Legjislacionit Shqiptar me atë Komunitar dhe zbatimin në mënyrë efektive të tij.

Në përmbushje të këtyre detyrimeve qeveria Shqiptare do të nxisë bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, për çështje që kanë të bëjnë veçanërisht me parandalimin e pastrimit të parave. Gjithashtu, qeveria Shqiptare do të bashkëpunojë me vendet e tjera me qëllim parandalimin e përdorimit të sistemeve të tyre financiare për pastrimin e të ardhurave nga aktivitete kriminale në përgjithësi, si dhe përdorimin e tyre për qëllime të financimit të terrorizmit.

Bashkëpunimi në këtë fushë do të mbështetet në zbatimin e standarteve dhe mekanizmave të përshtatshme, për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në standartet e Bashkimit Evropian dhe instrumentave të tjerë ndërkombëtare në këtë fushë.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Ligjet parësore në fushën e parandalimit të parave janë:

Ligji nr. 8610 datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave” i ndryshuar me ligjin nr. 9804 datë 19.06.2003, hartuar në përputhje me standartet e Bashkimit European sipas direktivës 91/308/EC të datës 10.06.1991 “Për parandalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar për pastrimin e parave” dhe direktivës 01/97/EC të datës 04.12.2001 e cila amendon direktivën 91/308/EC.

Ligji nr. 9258 datë 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

Gjithashtu, janë nënshkruar rreth 23(njëzet e tre) memorandume mirëkuptimi në fushën e bashkëpunimit në shkëmbimin e informacioneve financiare të lidhura me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit me njësitë homologe të vendeve të tjera si dhe 2 (dy) Memorandume Mirëkuptimi për bashkëpunimin ndërinstitutional në luftën për parandalimin e pastrimit të parave.

2.2 Kuadri institucional ekzistues

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e parandalimit të pastrimit të parave janë përgjegjëse këto institucione:

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), e cila është në rolin e njësisë së inteligjencës financiare. Misioni i kësaj Drejtorie konsiston në:

Parandalimin e “pastrimit të parave” dhe në luftën kundër financimit të terrorizmit, nëpërmjet grumbullimit, verifikimit, vlerësimit, kontrollit, ruajtjes së informacioneve nga subjektet e ligjit, pezullimit, bllokimit dhe ngrirjes të çdo veprimi me qëllim parandalimin e transferimit, tjetërsimit ose kalimit të pasurisë dhe produkteve që rrjedhin nga veprimtaria kriminale;

Bashkërendimin me struktura të tjera të zbatimit të ligjit të tilla si Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithëshme, Shërbimi Informativ Kombëtar dhe me Organizma homologe dhe Institucione ndërkombëtare;

Hartimin e programeve të bashkëpunimit dhe asistencave të ndërsjellta në drejtim të parandalimit të “pastrimit të parave” me vende të ndryshme, në bazë të konventave ndërkombëtare të nënshkruara dhe ratifikuara.

Komiteti Kombëtar i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave (KKBLKPP), Ky komitet drejtohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje të tij përfaqesues nga disa institucione shtetërore.. Komiteti ka për detyrë:

Pëcaktimin e drejtimeve të politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit të pastrimit të parave;

shqyrtimin dhe analizimin e raporteve 6 – mujore të veprimtarisë së kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave si dhe raporteve dhe dokumentave të përgatitura nga institucione dhe organizma ndërkombëtare që ushtrojnë veprimtari në fushën e parandalimit të pastrimit të parave;

Banka e Shqipërisë (Departamenti i Mbikëqyrjes), e cila ka këto kompetenca specifike: njoftimin e DPPPP -së në rast se vëren se ka elemente të pastrimit të parave, sipas së njëjtës formë dhe mënyrë, sikurse parashikohet për të gjithë subjektet e përcaktuara nga ligji;

veprimin në përputhje të plotë me programet kundër pastrimit të parave;

kontrollimin dhe zbatimin e programeve të përshtatshme kundër pastrimit të parave; hartimin dhe dhënien e ndihmës në hartimin e udhëzimeve ose rregulloreve për zbulimin e rasteve ose sjelljeve të dyshimta të klientit;

marrjen e masave për hartimin dhe zbatimin e rregulloreve të nevojshme për ruajtjen nga kontrollat, përvetësimet, depërtimet ose ndërhyrjet në subjektet që mbikëqyr, nga ana e grupeve, të elementëve kriminal ose bashkëpunëtorëve të tyre;

dhënien e bashkëpunimit dhe ndihmës së specializuar në rastet e ndjekjes dhe hetimit të pastrimit të parave, sipas kërkesave të autoriteteve përkatëse;

njoftimin e autoritetit përgjegjës për çdo rast të dyshimeve për pastrim parash.

Sektori i Luftës Kundër Pastrimit të Parave dhe Krimeve Ekonomiko-Financiare, në Drejtorinë e Luftës Kundër Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve, në Ministrinë e Brendshme. Detyra e këtij sektori është drejtimi, bashkërendimi, kontrolli dhe ushtrimi i veprimtarisë për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe ndërprerjen e aktivitetit kriminal në fushën e pastrimit të parave dhe krimeve në fushën ekonomike dhe financiare.

2.3 Asistencë Teknike

Asistenca teknike për fushën e parandalimit të pastrimit të parave konsiston në disa projekte në kuadër të programit CARDS. Ndër to mund të përmendet:

Rikonstruksioni i godinës ku aktualisht DPPPP -ja kryen veprimtarinë e saj, asistuar nga programi CARDS në shumën 370.000 Euro

Ndërtimi dhe zhvillimi i një baze bashkëkohore të dhënash me qëllim shkëmbimin e shpejtë të informacionit ndërmjet NIF- s dhe strukturave të tjera të zbatimit të ligjit dhe me NIF -të homologe të rajonit dhe të Evropës. Kjo bazë të dhënash do të ndihmojë në identifikimin e shpejtë dhe analizën elektronike të aktiviteteve të dyshimta. Harmonizimi i këtij sistemi me të gjitha vendet e rajonit dhe të Europës, parashikohet të asistohet nga programi CARDS në shumën 1 milion Euro

Projekti i binjakëzimit me një nga njësitë homologe të rajonit, projekt ky që parashikohet të asistohet po nga programi CARDS në shumën 1 milion Euro.

3. Adresimi i Prioriteteve

3.1 Prioritetet afatshkurtra (2006 – 2007)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si me poshtë:

Të merren masa urgjente për zbatimin më të mirë të legjislacionit kundër pastrimit të parave për sa i takon dënimeve, konfiskimeve, kapjen dhe ngrirjen e aseteve.

Të shtohen kapacitetet e Njësisë së Inteligjencës Financiare (FIU), prokurorive dhe Policisë së Krimit Ekonomik duke siguruar burimet e përshtatshme financiare dhe kompjuterike, si dhe të përmirësohet bashkëpunimi midis niveleve të ndryshme.

Të sigurohet përputhshmëria e ligjit ekzistues për Parandalimin e Pastrimit të Parave, me standardet e BE-së.

Të përmirësohet më tej bashkëpunimi me autoritetet e shteteve të tjera, veçanërisht duke vënë në përdorim në mënyrë më aktive Rrjetin Rajonal të Inteligjencës Financiare.

Të sigurohet zbatim i plotë i detyrimeve të raportimit dhe të shqyrtohen pragjet e raportimit të transaksionit.

3.1.1 Iniciativat ligjore afat shkurt

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore.

Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit 9258 "Për masat kundër financimit të terrorizmit" datë 17.05.2004, iniciativë e cila do jetë pjesërisht në përputhje me direktivën 2005/60/EC

Ndryshime në ligjin 8610 datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave" i ndryshuar, iniciativë e cila do jetë pjesërisht në përputhje me direktivën 2005/60/EC .

Firmosja e memorandumëve të bashkëpunimit me njësitë homologe të Australisë, Moldavisë, Kanadasë, Turqisë dhe Greqisë.

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese.

Nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave:

Inspektim dhe trajnim i autoriteteve doganore mbi legjislacionin e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit

Trajnimi i ekspertëve kontabël të autorizuar mbi legjislacionin e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit

Krijimi dhe funksionimi i një grupi punë për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ndryshimeve të ligjit nr.9258 , datë 17.05.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"

Ndërtimi dhe zhvillimi i një baze bashkëkohore të dhënash me qëllim shkëmbimin e shpejtë të informacionit ndërmjet NIF -s dhe strukturave të tjera të zbatimit të ligjit dhe me NIF - të homologe të rajonit dhe të Evropës.

Zhvillimi i tryezave të rumbullakta me grupin teknik ndërinstitutional, dhe strukturat e tjera lidhur me direktivat e BE-së dhe 40+9 rekomandimet e FATF -së;

Trajnimi i zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme mbi legjislacionin e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit

Nga Ministria e Brendshme, Sektori i Luftës Kundër Pastrimit të Parave dhe Krimeve Ekonomiko-Financiare:

Trajnimi i specialistëve të strukturave të luftës kundër pastrimit të parave dhe krimeve ekonomiko-financiare për teknikat e hetimit të veprave penale të pastrimit të parave.

Kompletimi i Infrastrukturës së transmetimit të informacionit të Sektorit të Luftës kundër Pastrimit të Parave dhe Krimeve Ekonomiko-Financiare.

3.2 Përpjesëtim afatmesme (2008 – 2009)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008 – 2009 janë si më poshtë:

Të përforcohet lufta kundër krimit ekonomik dhe financiar, përfshi pastrimin e parave dhe falsifikimin e kartëmonedhave.

Të ngrihet një agjenci ndërmministrorë për sekuestron e të ardhurave financiare të krimit.

Të shënohen rezultate të qarta në luftën kundër pastrimit të parave, si brenda ashtu edhe jashtë sektorit financiar.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ndryshimeve të ligjit nr.8610 "Për parandalimin e pastrimit të parave" i ndryshuar, iniciativë e cila do jetë pjesërisht në përputhje me direktivën 2005/60/EC ;

Rishikimi i udhëzimit të Ministrisë të Financave " Për format dhe procedurat e identifikimit dhe raportimit të organeve që liçensojnë personat fizikë e juridikë në funksion të parandalimit të pastrimit të parave", iniciativë e cila do jetë pjesërisht në përputhje me direktivën 2005/60/EC ;

Nënshkrimi i një Memorandumi të ri për Bashkëpunim Ndërinstitutional për parandalimin e pastrimit të parave në përputhje me ndryshimet e reja ligjore;

Hartimi i rregullores së përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Përgjithshme , Ministrinë e Brendshme për mënyrën e mbledhjes , shkëmbimit dhe për përdorimin e të dhënave;

Hartimi dhe miratimi i Strategjisë në fushën e Luftës kundër Pastrimit të Parave

3.2.2 Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese.

Nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave:

Organizimi i një konference rajonale për Bashkëpunimin Rajonal në Fushën e Parandalimit të Parave dhe Luftën kundër Financimit të Terrorizmit

Trajnimi i shoqërive të sigurimeve ose risigurimeve mbi legjislacionin e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit

Trajnimi i bankave të nivelit të dytë mbi legjislacionin e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit

Ngritja dhe funksionimi i grupit të punës për hartimin e Strategjisë në fushën e Luftës kundër Pastrimit të Parave

3.24.10 LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT

1. Objektivi Politik

Lufta kundër terrorizmit, e vlerësuar si një ndër sfidat më të mëdha të njerëzimit, përbën një ndër anagzhimet kryesore të qeverisë Shqiptare, në kuadër edhe të detyrimeve ndërkombëtare që rrjedhin nga konventat dhe instrumentat e tjera ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

Lufta kundër Terrorizmit përbën një detyrim për Qeverinë Shqiptare edhe si dhe një element shumë të rëndësishëm në kuadër të angzhimeve që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (paragrafi 9 i Preambules, neni 5 dhe 82). Bazuar në këto detyrime, Shqipëria angazhohet për t'i dhënë rëndësinë e duhur luftës kundër terrorizmi, mbështetur edhe në deklaratën e lëshuar nga Konferenca Europiane e 20 tetorit 2001.

Shqipëria do të vazhdojë të bashkëpunojë me vendet e tjera, me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e rregulloreve dhe funksionimin efikas të standarteve të përshtatshme dhe mekanizmave për luftën ndaj terrorizmit.

Shqipëria angazhohet plotësisht për të përmbushur në mënyrë aktive dhe t'u përkushtuar me të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e saj në luftën globale kundër terrorizmit, duke e konsideruar atë si rrezikun dhe armikun numër një të paqes, sigurisë dhe demokracisë në botë.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Ndër dokumentat strategjike të miratuara për këtë fushë mund të përmendim "Planin Kombëtar të veprimit kundër terrorizmit", miratuar me VKM nr.12, dt 28.01.2002 dhe "Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë", miratuar me Ligjin nr. 8930, datë 25.07.2002. Në këto dokumenta strategjike përcaktohen qartë masat dhe hapat që duhet të ndërmerren nga institucionet përkatëse për forcimin e luftës kundër krimit e terrorizmit.

Ndër Ligjet parësore në fushën e luftës kundër terrorizmit mund të përmendet:

Konventa për "Luftën ndaj akteve të paligjshme kundër sigurisë së aviacionit civil e Montrealit" më datë 23.09.1971 aderuar me ligjin nr.8197, datë 06.03.1997.

Konventa për "Parandalimin dhe ndëshkimin e krimeve kundër personave të mbrojtur ndërkombëtarisht përfshirë diplomatët", adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më datë 14.12.1973, aderuar me ligjin nr.8832, datë 22.11.2001.

Konventa Ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve, adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me datë 17.12.1979 aderuar me ligjin nr. 8837, datë 22.11.2001.

Konventa mbi Mbrojtjen fizike të materialit bërthamor", Vjenë më datë 03.03.1980.

Protokolli për "Luftën kundër akteve të paligjshme të dhunës në aeroportet", që i shërbejnë Aviacionit civil ndërkombëtar, suplement i Konventës për Luftën Kundër Akteve të Paligjshme, kundër Sigurisë së Aviacionit civil në Montreal më datë 24.02.1988, aderuar me ligjin nr. 8835, datë 22.11.2001.

Konventa për "Luftën ndaj akteve të paligjshme kundër sigurisë së lundrimit oqeanik" në Romë më datë 10.03.1998, aderuar me ligjin nr. 8850, datë 27.12.2001.

Protokolli për "Luftën kundër akteve të paligjshme kundër sigurisë së platformave fikse të vendosura në Shelfin Kontinental" në Romë më datë 10.03.1988, aderuar me ligjin nr. 8850, datë 27.12.2001

Konventa ndërkombëtare për "Luftën Kundër Bombardimeve terroriste" adoptuar nga

Asambleja e Kombeve të Bashkuara më datë 15.12.1997, aderuar me ligjin nr. 8836, datë 22.11.2001.

Konventa ndërkombëtare për "Luftën kundër financimit të terrorizmit" e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar më datë 14.03.2002.

Ligji nr. 9258, datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"

Ligji nr. 9074, datë 29.05.2003 "Për Shërbimin Ushtarak Informativ" neni 5/b

Ligji nr. 8930, datë 25.07.2002 "Strategjia ushtarake e Republikës së Shqipërisë"

Ligji nr. 8932, datë 25.07.2002 "Për dërgimin e kontigjenteve paqeruajtëse jashtë vendit", i aplikueshëm

Ligji nr. 9025, datë 13.03.2003 "Për dërgimin e kontigjenteve paqeruajtëse jashtë vendit", i aplikueshëm

Gjithashtu Ministria e Financave ka firmosur një sërë memorandumesh mirëkuptimi me vende të ndryshme nga e gjithë bota në lidhje me bashkëpunimin në shkëmbimin e informacioneve financiare të lidhura me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

2.2 Kuadri institucional ekzistues

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e luftës kundër terrorizmit janë përgjegjëse këto institucione:

Drejtoria Kundër Akteve Terroriste dhe Krimeve të Hapura, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka në përbërje të saj Sektorin e Antiterrorit, i cili e shtrin veprimtarinë e tij në qendër dhe në bazë në secilën drejtori policie në nivel qarku.

Zyra e Luftës kundër Terrorizmit në Shërbimin Informativ Ushtarak, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes është një tjetër strukturë që ka si objekt të saj, luftën kundër terrorizmit.

Misioni i strukturave antiterror është zbulimi, parandalimi dhe goditja e akteve të mundshme terroriste si dhe çdo veprimtari tjetër që lidhet me fenomenin terrorist, brenda dhe jashtë vendit.

Gjithashtu, në bazë të "Planit kombëtar të veprimit kundër terrorizmit" i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 12, datë 28.01.2002, të gjitha institucionet shtetërore kanë detyrimet e tyre në luftën kundër terrorizmit.

Kështu, krahas Drejtorisë së Antiterrorit dhe Krimeve të Hapura, detyrime të veçanta në luftën kundër terrorizmit kanë edhe Shërbimi Informativ Shtetëror, Shërbimi Informativ i Ushtrisë, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave dhe Prokuroria e Përgjithshme.

2.3 Asistencë Teknike

Asistenca teknike në fushën e luftës kundër terrorizmit konsiston në:

Projektin për Forcimin e Luftës kundër Krimit të Organizuar dhe Terrorizmit, e parashikuar të financohet në kuadër të Programit CARDS 2005 me një shumë prej 1 mil Euro.

3. Adresimi i Prioriteteve

3.1 Prioritetet afatshkurtra (2006 – 2007)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si me poshtë:

Të përcaktohen më qartë përgjegjësitë përkatëse të strukturave të ndryshme shtetërore që merren me luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit; të merren masa për të rritur bashkëpunimin, veçanërisht midis autoriteteve gjyqësore dhe policisë.

Të merren masa për sigurimin e ekspertëve dhe hetuesve të anti-terrorizmit, me mjete dhe trajnim më të mirë.

3.1.1 Iniciativat ligjore afat shkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Miratimi i projekt ligjit "Për luftën kundër terrorizmit", iniciativë e cila do të jetë pjesërisht në përputhje me Pozicionin e Përbashkët të Këshillit të Bashkimit Europian, dt 27.12.2001 "Për luftën kundër terrorizmit" si dhe Vendimi i Këshillit të Bashkimit Europian, dt 28.11.2002, "Krijimi i një mekanizmi për vlerësimin e sistemeve ligjore dhe implementimin e tyre në nivel kombëtar në luftën kundër terrorizmit"

Udhëzim i Ministrit të Brendshëm në bazë e për zbatim të ligjit "Për luftën kundër terrorizmit"

VKM për ndryshimin e rregullores së Sektorit anti - terror në Policinë e Shtetit

Urdhër dhe Udhëzim i Ministrit të Brendshëm për Sektorin Anti-terror në Policinë e Shtetit

Hartimi dhe miratimi i projekt ligjit "Për gjendjen e jashtëzakonshme"

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese.

Nga Ministria e Brendshme:

Krijimi i Komitetit Kombëtar Bashkëveprues të Luftës Kundër Akteve Terroriste nën drejtimin e Kryeministrit

Ngritja e një rrejtë qendror komunikimi kabllor të integruar dhe të koduar, dhe e një baze të dhënash të lidhur me agjencitë përkatëse që veprojnë në luftën kundër terrorizmit.

Krijimi i një Force Speciale Policie anti -Terror që do të operojë në të gjithë vendin

Nga Ministria e Mbrojtjes:

Përgatitja e Kontigjentit paqeruajtës për në Afganistan

Përgatitja e Kontigjentit paqeruajtës për në Bosnje-Hercegovinë

Përgatitja e Kontigjentit paqeruajtës për në Irak

3.2 Përparësitë afatmesme (2008 – 2009)

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008 – 2009 janë si më poshtë:

Të rritet bashkëpunimi ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Të përfshihen plotësisht në legjislacionin e brendshëm dhe të zbatohen konventat ndërkombëtare dhe protokollet mbi parandalimin e terrorizmit, në të cilat Shqipëria bën pjesë.

3.2.1 Iniciativat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe për bashkëpunim në luftën kundër terrorizmit.

Hartimi dhe miratimi i Strategjisë "Për Luftën kundër Terrorizmit"

3.24.11 POLICIA

1. Objektivi Politik

Krijimi i një policie në shërbim të komunitetit, të aftë profesionalisht, të paanëshme politikisht, fleksibël dhe dinamike në veprim, për të mbrojtur rendin e sigurinë publike dhe për të garantuar zbatimin e ligjit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për të rifituar besimin e publikut, duke respektuar liritë e të drejtat e njeriut dhe parimet kushtetuese të shtetit juridik, do të jetë objektivi kryesor politik i qeverisë Shqiptare.

Të gjitha reformat që parashikohen të ndërmerren, si në aspektin legjislativ dhe strukturor, do të konsistojnë në shndërimin e saj në një institucion të administratës publike, të depolitizuar, unik e të centralizuar, me atributë në fushën e sigurisë publike e të policisë gjyqësore si dhe në përputhje me stadartet dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian dhe deyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (neni 78).

Forcimi i bashkëpunimit policor, në funksion të luftës kundër kriminalitetit, me vendet e tjera të rajonit do të jetë një objektivi tjetër i rëndësishëm për arritjen e standarteve dhe objektivave të përcaktuara.

Motoja e Qeverisë Shqiptare është *"tolerancë zero ndaj krimit"*.

2. Situata aktuale

2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Në fushën e policisë ekziston një bazë e gjerë legjislative, ku si legjislacion parësor mund të përmendet:

Ligji nr. 8553, datë 25.11.1999 " Për Policinë e shtetit"

Ligji nr.7498 datë 05.07.1991 "Për ruajtjen e rendit e të qetësisë".

Ligji nr. 8677, datë 02.11.2002 " Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore"

Ligji nr.8770 datë 19.04.2001, "Për Shërbimin e Ruajtjes dhe të Sigurisë Fizike".

Ligji Nr.8292 datë 25.02.1998, "Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë".

Ligji nr.7566 datë 25.05.2002 "Për armët".

Ligji nr.8378 datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë".

Ligji nr.8291 datë 25.02.1998, "Kodi Etikës së Policisë".

Ligji nr.8290 datë 24.02.1998, "Për përdorimin e armëve të Zjarrit".

Ligji nr.8775 datë 23.04.2001, "Për Tubimet".

Ligji nr.8668 datë 23.11.2000 "Për paisjen e shtetasve me passportë për jashtë shtetit".

Ligji nr.7697 datë 07.04.1993, "Për kundravajtjet administrative".

Ligji nr.8331 datë 21.04 1998, "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale".

Ligji nr.8775 datë 23.04.2001, "Për Tubimet".

Ligji nr.7492 datë 08.06.1991, "Për departizimin dhe depolitizimin e disa organeve

shtetërore".

2.2 Kuadri institucional ekzistues

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, për fushën e policisë është përgjegjëse :

Drejtoria e Rendit dhe e Sigurisë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e përbërë nga 4 (katër) sektorë; Sektori i Rendit Publik, Sektori i Policisë Rrugore, Sektori i Policimit në Komunitet dhe Grumbullimit të Armëve dhe Sektori i Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë;

Drejtoria e Koordinimit dhe Kontrollit të Territorit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e përbërë nga 2 (dy) sektorë; Sektori i Koordinimit të Kontrollit të Territorit dhe Sektori i Emergjencave dhe Sallave Operative. Në varësi të kësaj Drejtorie janë edhe 12(dymbëdhjetë) Drejtoritë e Policisë në Qarqe.

Misioni i këtyre strukturave ka të bëjë me shërbimin në komunitet nëpërmjet vendosjes së rendit dhe sigurisë publike në të gjithë territorin e vendit.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe strukturat e saj përkatëse bashkëpunojnë me:

Ministrinë e Drejtësisë në hartimin e legjislacionit në fushën e rendit dhe sigurisë publike.

Prokurorinë e Përgjithshme për hetimin e rasteve kriminale dhe ecurinë e tyre.

Shërbimin Informativ Shtetëror në kuadër të shkëmbimit të informacioneve dhe realizimit të operacioneve të përbashkëta.

Ministrinë e Transporteve në lidhje me sigurinë rrugore.

Ministrinë e Mbrotjtjes si në drejtim të grumbullimit të armëve

Organet e pushtetit vendor e qëndror për sa i përket policimit në komunitet.

Misionet e huaja policore që operojnë në Shqipëri

2.3 Asistencë Teknike

Asistenca teknike që po zbatohet aktualisht për fushën e policisë si dhe projektet financuara në të ardhmen për këtë fushë fokusohen në:

Ngritjen e një rrjeti të komunikimit për të dhënat për Policinë Shqiptare, financiar nga CARDS 2002 me një shumë prej 4.715 mil euro;

Sigurimin e gjeneratorëve për rrjetin e komunikimit të të dhënave, financiar nga CARDS 2002 me një shumë prej 1.87 mil euro;

Mbështetjen e Reformave në Sektorët e Sigurisë/ Policimi në Komunitet, financiar nga CARDS 2002 dhe PNUD me një shumë prej 1 mil euro;

Rinovimin i Zyrave të Policisë (Supervizion, Punime, paisje), financiar nga CARDS 2004 me një shumë prej 1.5 mil euro;

Mirëmbajtjen e Rrugëve Shqipëri / Komponenti Siguria në Rrugë, financiar nga Banka Botërore me një shumë prej 0.27 mil euro;

Projektin RMIS (Sistemi i menaxhimit të burimeve; Paisje IT për sistemin RMIS; Asistence teknike RMIS), financiar nga CARDS 2002-03 me një shumë prej 1.92 mil euro;

Akademinë e Policisë (faza II) (Rishikim i projektit dhe supervizion; Punime; Paisje; Asistencë teknike), financiar nga CARDS 2004 me një shumë prej 1 mil euro;

Parkun dhe Garazhin Qendror të MRP -ës (Dizenjimi dhe supervizioni; Punime; Paisje), financiar nga CARDS 2004 me një shumë prej 1 mil euro;

Mbështetjen me logjistike dhe trajnimin për Policinë e Shtetit Shqiptar, financiar nga CARDS 2004 me një shumë prej 6 mil euro;

Përmirësimin e kapaciteteve të menaxhimit të turmave dhe trajnimin për oficerët e policisë së vijës së parë dhe forcave speciale, financiar nga CARDS 2005 me një shumë prej 1.6 mil euro;

Forcimin e kapaciteteve të njësisë së kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Brendshme me qëllim sigurimin e integritetit të policisë, financiar nga CARDS 2005 me një shumë prej 0.4 mil euro;

3. Adresimi i Prioriteteve

3.1 Prioritetet afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2006 – 2007 janë si me poshtë:

Të përmirësohet menaxhimi i Policisë së Shtetit dhe të menaxhojë burimet e saj në mënyrë të pavarur.

Të sigurohet zbatim i plotë i ligjit sipas gradave

Të forcohet Njësia e Policisë për Çështjet e Brendshme dhe të ndiqen penalisht oficerët e policisë për shkeljet ligjore

Të përshpejtohen përpjekjet për të arritur një marrëveshje me Europolin.

Të përcaktohet një manual procedure i konsoliduar për të gjithë oficerët e policies

Të forcohet ndërgjegjja e komunitetit për bashkëpunim me policinë

3.1.1 Iniciativat ligjore afat shkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore.

Ndryshimi i ligjit nr. 8553, date 25.11.1999 " Për Policinë e shtetit"

Miratimi i Strukturës së rë të Policisë së Shtetit

Hartimi dhe miratimi Strategjisë së Policimit në komunitet

Hartimi dhe miratimi Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë së Policimit në Komunitet

Miratimi i Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Lehta

Miratimi i Projekt-ligjit "Për disa ndryshime në ligjin nr.7566 dt. 27.5.1992 "Për armët"

Miratimi i Projekt- ligjit "Për disa ndryshime në ligjin nr.9018 datë 06/03.2003 "Për mbledhjen e armëve , municioneve dhe materialeve të tjera ushtarake"

Negocimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjes Strategjike për Bashkëpunim Policor me Europolin, iniciativë e cila do të jetë në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit, datë 22 Korrik 2002 "Për krijimin e një programi kuadër mbi bashkëpunimin policor dhe gjyqësor në çështjet penale (AGIS)

Hartimi dhe miratimi i Manualeve të procedurave për oficerët e policisë së shtetit

Miratimi i Projektvendimit "Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.112 datë 08.03.2001 "Për ruajtjen e sigurimin e objekteve më të rëndësishme shtetërore"

Miratimi i Projektligjit "Për disa ndryshime në ligjin nr.8292 datë 25.02.1998 "Për forcat speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë"

Miratimi i Projektvendimit "Për disa ndryshime në Rregulloren e Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me VKM nr.153 datë 07.04.2000

Hartimi dheMiratimi i Strategjisë së Policisë Rrugore

3.1.2 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese.

Përfundimi i Ristrukturimit të godinës së Policisë së Shtetit

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve të Policisë së Shtetit

Ngritja e rrjetit të komunikimit të të dhënave për Policinë e Shtetit

Instalimi i gjeneratorëve për funksionimin e rrjetit të komunikimit të të dhënave për Policinë e Shtetit

Përmirësimi i Policimit në Komunitet nëpërmjet rehabilitimit të ambjenteve të komunikimit me publikun.

Përgatitja dhe shpërndarja e broshurave dhe revistave, fletëpalosjeve, dhe materialeve të tjera për paraqitjen e policimit në komunitet.

Zhvillimi dhe përfundimi i trajnimeve me të gjithë personelin policor në lidhje me komunikimin që bëhet me komunitetin, sjellja gjatë shërbimit, mënyra e raportimit gjatë dhe pas shërbimit

Trajnimi i punonjësve dhe përmirësimi i infrastrukturës (pajisje) së policisë rrugore, me qëllim përmirësimin e sigurisë në rrugë.

Shtrirja e projektit të raportimit të aksidenteve (AIS) në të gjithë Komisariatet e Policisë.

Informatizimi i aktivitetit të administrimit të gjobave të policisë rrugore, leje-dretjimeve të pezulluara dhe mjeteve të bllokuara. Përfshirja në sistemet TIM-s dhe RIM-s

Hartimi dhe realizimi i projektit të kontrollit të dixhitalizuar (me kamera) të trafikut të Tiranës. Pajisja e mjeteve të Policisë Rrugore me pajisje GPS dhe me sistem të veçantë ndërlidhje.

Përmirësimi i infrastrukturës së Akademisë së Policisë (faza II)

Përmirësimi i infrastrukturës së Parkut dhe Garazhit Qendror të Ministrisë së Brendshme

Hartimi dhe kryerja e anketimit kombëtar për kontrollin e armëve.

Fillimi i procesit të Regjistrimit të armëve civile në bazë të programit kombëtar të kontrollit dhe regjistrimit të armëve.

Vazhdimi i projektit TIM-s lidhur me krijimin e sistemit të informatizuar të policisë së shtetit si dhe përgatitja e personelit të policisë për përdorimin e këtij sistemi

Trajnimi dhe përmirësimi i kapaciteteve të menaxhimit të turmave për oficerët e policisë së vijës së parë dhe forcat speciale

Forcimi i kapaciteteve të njësisë së kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Brendshme, me qëllim sigurimin e integritetit të policisë

3.2 Përparësitë afatmesme

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për periudhën 2008 – 2009 janë si më poshtë:

Të vazhdohet me përpjekjet për të afruar shërbimet policore me standardet Europiane, nëpërmjet trajnimeve të duhura dhe sigurimit të pajisjeve të nevojshme

Të sigurohet funksionimi i një sistemi të saktë të menaxhimit të çështjeve

Të arrihen rezultate të konsiderueshme në luftën kundër kriminalitetit, në luftën kundër korrupsionit, dhe sjellje të tjera kriminale në radhët e policisë

Masat ligjore dhe aktivitetet zbatuese të përcaktuara për periudhën afatshkurtër konsiderohen si angazhime që do të adresojnë në tërësi jo vetëm prioritetet afatshkurtra por dhe ato afatmesme, duke pasur parasysh që afatet e realizimit të plotë të një pjese të tyre shtrihen përtej afateve të periudhës afatshkurtër.

Tabela: Shtesë e kapaciteteve institucionale të Strukturav përgjegjëse për Reformen në Polici

INVESTIME	NJESIA E MATJES	GJENDJA AKTUALE	2006	2007	2008	2009	2010
Shtese personeli	Nepunes						
Investime IT	000/leke		1874375				
Investime infrastruktura	000/leke		983750				
Konsulence (e huaj)	000/leke		24375				
Trajnime	000/leke		1250	250000			

3.25 MENAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE

3.25.1 BUXHETI DHE KONTROLI FINANCIAR

1. Objektivi Politik i fushës

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e auditimit të brendshëm, për periudhën afatshkurtër 2006-2007, është zhvillimi i mëtejshëm i Letrës së Politikave të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe përkufizimi i qartë i funksionit të inspektimit, i ndarë nga funksionet e tjera të kontrollit dhe auditit të brendshëm. Gjatë kësaj periudhe, do të bëhet strukturimi i këtij kontrolli për të siguruar organizimin dhe funksionimin efektiv të tij. Për këtë qëllim forcimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të KBFP - së në Shqipëri në të ardhmen konsiston në krijimin dhe përmirësimin e kuadrit metodologjik bazë për zhvillimin e KBFP - së si dhe për përcaktimin e strukturave përgjegjëse për KBFP - në.

Në periudhën afatmesme 2008-2010, qeveria shqiptare do të sigurojë zhvillimin dhe zbatimin e parimeve të kontabilitetit manaxherial të decentralizuar dhe funksionimin e pavarur të auditit të brendshëm në lidhje me standartet ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të BE-së.

2 Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Zhvillimi dhe miratimi i “ Letër Politikave dhe Planit të Veprimit” përbën dokumentin bazë për zhvillimin e një sistemi të përmirësuar dhe të përditësuar të KBFP - së në Shqipëri. Mbi bazën e tij ka filluar dhe po zhvillohet hartimi i legjislacionit përkatës të KBFP - së (PIFC) në një kuadër gjithëpërfshirës dhe paralelisht rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor e nënligjor ekzistues, duke siguruar një konsensus me të gjitha palët e interesuara, grupet e interesit dhe e gjithë kjo në një mënyrë sa më koherente dhe të përparuar.

Veprimtaria e kontrollit të brendshëm financiar rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore :

Në fushën e Auditimit të brendshëm:

Ligji nr.9009 datë 13.02.2003 « Për auditimin e brendshëm në sektorin publik » është baza e veprimtarisë në fushën e auditimit të brendshëm, i cili ka një shkallë përputhshmërie me acquis « të pjesshme ». Në mbështetje të sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Brendshëm ka përgatitur një sërë aktesh me karakter metodologjik si :

Manuali i Auditimit,

Karta e audituesve ,

Kodi i Etikës për Audituesit e Brendshëm.

Në fushën e kontrollit të manaxhimit financiar:

Kontrolli i brendshëm në Republikën e Shqipërisë nuk përbën një sistem të mirëfilltë të organizuar sipas standarteve ndërkombëtare, por funksionet e tij tentojnë të ezaurohen pjesërisht nëpërmjet veprimit të disa ligjeve organike, të tilla si:

Ligji për qarkullimin dhe dokumentacionin e vlerave materiale;

Ligji organik i buxhetit;

Ligji për Kontabilitetin;

Ligji “Për Prokurimet Publike”;

Ligji “ Për statusin e nënpunësit civil; , etj

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e kontrollit të brendshëm financiar është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

Ministria e Financave ka për detyrë mbikqyrjen e përgjithshme të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik.

Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Struktura e auditimit të brendshëm në të gjitha ministrinë, institucionet qendrore dhe të varësisë.

Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave është e përbërë nga shtatë punonjës, ndarë në dy sektorë që konsistojnë në 6 specialistë (dy prej tyre përgjegjës /sektori) dhe një Drejtor i Përgjithshëm. Kjo Drejtori është përgjegjëse për:

përvijimin e kuadrit për kryerjen e auditimit të brendshëm në sektorin publik;

raportimin te Ministri i Financave dhe në Komitetin e Auditimit për politikat, programet, standardet dhe çdo aspekt tjetër auditimi;

sigurimin e një procesi me cilësi të auditimit të brendshëm në sektorin publik;

përgatitjen e raportit vjetor për auditimin e brendshëm, i cili, pas shqyrtimit dhe miratimit në Komitetin e Auditimit të Brendshëm, i paraqitet Ministrit të Financave dhe nëpërmjet tij Këshillit të Ministrave;

përgatitjen e raporteve tremujore për Komitetin e Auditimit të Brendshëm;

2.3. Asistenca e huaj

Mbështetja financiare për kontrollin e brendshëm financiar për Ministrinë e Financave është dhënë nga Programi CARDS 2001, konkretisht Projekti “Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik”, (PIFC) me vlerë rreth 1.5 milion Euro. Veprimtaritë e realizuar në kuadër të zbatimit të këtij projekti kanë synuar këto drejtime kryesore:

zhvillimi i kuadrit politik dhe ligjor;

forcimi i kapaciteteve institucionale;

forcimi i zhvillimit dhe manaxhimit të burimeve njerëzore.

Një folloë-up të projektit PIFC është parashikuar të realizohet nëpërmjet Programit CARDS 2005, projekti “PIFC II”, në një vlerë rreth 1 milion Euro, veprimtaritë e të cilit do të fokusohen kryesisht në fushën e Kontrollit të Manaxhimit Financiar.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Europian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Europian, prioritet afatshkurtra (2006-2007) për fushën e financave publike dhe auditimin e brendshëm janë:

Zhvillimi i mëtejshëm i “Letrës së Politikave dhe Planit të Veprimit” për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik, duke synuar krijimin e bazave për hartimin e një strategjie për KBFC dhe përkufizim i qartë i funksionit të inspektimit, i ndarë nga funksionet e tjera të kontrollit dhe auditimit të brendshëm.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritete afatshkurtra për periudhën 2006-2007, për realizimin e tyre, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Financave:

Ndryshimi i ligjit ekzistues Nr. 9009 datë 13.2.2003 për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i cili do të synojë përputhshmërinë pjesërisht me *acquis communautaire* në fushën e auditimit të brendshëm;

Hartimi dhe miratimi i VKM - së "Për disa ndryshime në manualin e procedurave të auditimit të brendshëm"; në hartimin dhe miratimin e VKM -së "Për miratimin e Manualit të Procedurave të Kontrollit të Menaxhimit Financiar";

Hartimi dhe miratimi i VKM -së "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për kualifikimin e punonjësve të KMFP -së (PIFC)" .

3.1.2. Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e prioriteteve afatshkurtra, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Do të krijohet një autoritet qendror për Harmonizimin e kontrollit financiar dhe metodologjisë së auditimit si një nga elementet kyç të sistemit të KBFP -së. Kjo do të realizohet nëpërmjet dy njësive të pavarura : një për auditimin e brendshëm dhe tjetra për kontrollin e brendshëm financiar. Këto dy njësi do të punojnë shumë ngushtë me njëra – tjetrën, por njëkohësisht do të jenë reciprokisht të pavarura. Krijimi i këtij autoriteti do të bëhet brenda vitit 2006 dhe parashikohen rreth 21 punonjës që të punojnë në të, rreth 15 punonjës më shumë se niveli ekzistues.

Ka filluar dhe po realizohet trajnimi i Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik.

Krijimi i Grupit të Punës për zhvillimin e mëtejshëm të Letër Politikave dhe Planit të Veprimit për KBFP.

Prioritetet Afatmesme

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Europin të dhëna në Dokumentin e Partneritetit European, prioritetet afatmesme (2008-2010) për fushën e financave publike dhe auditimin e brendshëm janë:

Zhvillimi dhe zbatimi i parimeve të kontabilitetit manaxherial të decentralizuar dhe funksionimi i pavarur i auditit të brendshëm në lidhje me standartet ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të BE-së.

Hartimi dhe zbatimi i një strategjie për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, e cila do të synojë zhvillimin e mëtejshëm të këtij sistemi në Shqipëri, në përputhje me rekomandimet e Komisionit European për arritjen e objektivit strategjik të KBFP për sigurimin e një manaxhimi dhe kontrolli financiar të mirë dhe transparent të fondeve publike dhe përdorimin e tyre me kursim, dobi dhe frytshmëri.

3.2.1. Iniciativat ligjore afatmesme

Në përputhje me këto prioritete afatmesme, për periudhën 2008-2010, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Financave:

Hartimi dhe miratimi i ligjit " Për Kontrollin e Menaxhimit Financiar" (të vitit 2007), i cili do të synojë përputhshmërinë e pjesshme me *acquis communautaire* në fushën e financave publike:

VKM "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik" (viti 2008),

Hartimi dhe miratimi i VKM - së në zbatim të "Ligjit për KBFP - ën dhe strategjinë e KBFP - së"" (viti 2010).

3.2.2. Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për realizimin e prioriteteve afatmesme, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Kryerja e auditimeve pilot;

Ndërmarrja e vizitave studimore në vendet anëtare të BE - së do të synojnë drejt rritjes së kapaciteteve administrative në përmirësimin e kryerjes së auditimit të brendshëm në Shqipëri;

Hartimi i Strategjisë Kombëtare për KBFP - ën;

Hartimi i “ Strategjisë Kombëtare për Trajnim” e cila do të pasohet nga realizimi praktik i saj;

Trajnimit e strukturave të KBFP - së në funksion të zhvillimit të burimeve njerëzore

Tabela: Shtesë e kapaciteve institucionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit të Brendshëm

INVESTIME	NJËSIA E MATJES Nëpunës	GJENDJA AKTUALE	2006	2007	2008	2009	2010
Krijimi i Autoritetit Qendror të Harmonizimit - Ministria e Financave		6	+15				
Trajnimi dhe Çertifikimi i "	000/ Lek		173240				
Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik"	nëpunës		+15				
	000/ Lek		73200				
Hartimi i Strategjisë për Trajnimit e stafit të KMFP	000/ Lek		29280				
Hartimi i Strategjisë Kombëtare për KBFP -në	000/ Lek				61000		
Trajnimi i stafit të KBFP - së	000/ Lek			73200	73200	73200	73200

3.25.2 PLANIFIKIMI BUXHETOR

1. Objektivi politik i fushës

Në fushën e programimit buxhetor, qeveria shqiptare synon të përmirësojë procesin e programimit afatmesëm dhe harmonizimin e plotë të tij me dokumentet strategjike, nën konceptet bazë të Sistemit të Planifikimit të Integruar. Kjo reformë synon shpërndarjen strategjike të burimeve, përdorimin e tyre në përputhje me objektivat dhe politikat e qeverisë, por edhe përmirësimin e lidhjes së objektivave afatmesme me ato të buxhetit vjetor.

Në ndryshim nga ciklet e mëparshme, për herë të parë procesi i planifikimit të buxhetit afatmesëm (PBA) po zbatohet në të gjitha ministritë, të cilat ndeshen me koncepte dhe procedura të reja të planifikimi të buxhetit si ajo e Rishikimit të Politikës së Programit (RPP) dhe ajo e Planifikimit të Shpenzimeve të Programit dhe të Investimeve (PSHPI). Këto procedura të reja do të bëjnë të mundur që politikat sektoriale të lidhen me burimet buxhetore, duke e orientur planifikimin e buxhetit drejt 'output budgeting'.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri ligjor

Veprimtaria e buxhetimit në Shqipëri rregullohet nëpërmjet aktit të mëposhtëm ligjor:

Ligji Nr.8379, datë 29.7.1998 "Për Hartimin dhe Zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë".

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e buxhetimit është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

Drejtoria e Buxhetit pranë Ministrisë së Financave, e cila ka rolin kryesor në drejtimin e menaxhimit të procesit të hartimit dhe ndjekjes së zbatimit të Buxhetit të Shtetit;

Gjithë ministritë e linjës.

2.3. Asistenca e huaj

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit e Ministrisë së Financave asistohet nga DFID nëpërmjet projektit "Forcimi i Menaxhimit të Shpenzimeve Publike", i cili është parashikuar të zgjasë deri në vitin 2009, me vlerë rreth 2.5 Milion Euro.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Europian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Europian, prioritet afatshkurtër dhe afatmesëm për fushën e financave publike – buxheti- është:

Përmirësimi i Menaxhimit të Financave Publike.

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këtë prioritet, në periudhën afatshkurtër 2006-2007, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Financave:

Hartimi dhe miratimi i Ligjit të Ri Organik të Buxhetit të Shtetit;

Përgatitja e VKM-së për politikën e pagave dhe pensione për vitin 2006;

Hartimi dhe miratimi i Programit Buxhetor Afatmesëm 2007-2009. Në këtë proces, Drejtorja e Buxhetit po luan rolin kryesor në trajnimin e stafëve të ministrive të linjës të ndihmuar nga asistencë e DFID;

Hartimi dhe miratimi i buxhetit suplementar për vitin 2006. Në këtë buxhet suplementar do të merren parasysh si ndikimi që do të ketë nënshkrimi i MSA-së në uljen e të ardhurave doganoare ashtu edhe rritja e të ardhurave tatimore e doganore për shkak të përmirësimit administrativ;

Miratimi i Manualit të shpenzimeve publike;

Hartimi dhe miratimi i Ligjit të Buxhetit për vitin 2007.

3.1.2. Aktivitet zbatues afatshkurtra

Për realizimin e prioritetit afatshkurtër, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Ngritja e Grupit të Punës për përgatitjen e Ligjit të Ri Organik të Buxhetit;

Ngritja e Grupeve të përgatitjes së PBA-së me specialistë të Drejtorisë së Buxhetit, Konsulentë të huaj dhe lokalë;

Përgatitja e PBA-së dhe buxhetit vjetor;

Ngritja e Grupit të Punës për përgatitjen e Manualit të Shpenzimeve Publike;

Përgatitja e PBA-së dhe buxhetit vjetor.

3.1.3. Iniciativat ligjore afatmesme

Në përputhje me këtë prioritet, për periudhën afatmesme 2008-2010, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Financave:

Përgatitja e VKM-së dhe udhëzimeve për zbatimin e Manualit të Shpenzimeve; Ky manual do të përgatitet në funksion të ligjit të ri organik të buxhetit, i cili do t'u shërbejë të gjithë institucioneve buxhetore për përgatitjen e buxhetit. Manuali i shpenzimeve publike do të zbatohet duke nxjerrë Vendime të Këshillit të Ministrave dhe udhëzime përkatëse nga Ministri i Financave;

Miratimi i Buxhetit Vjetor 2009;

Përgatitja e VKM-së dhe udhëzimeve për zbatimin e Manualit të Shpenzimeve;

Përgatitja e VKM-së dhe udhëzimeve për zbatimin e Manualit të Shpenzimeve;

Miratimi i Buxhetit Vjetor 2011.

3.1.4. Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për realizimin e prioritetit në fushën e buxhetimit, në periudhën afatmesme, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Përgatitja e projekt udhëzimeve në zbatim të Manualit të shpenzimeve Publike, çdo vit;

Përgatitja e PBA-së dhe buxhetit vjetor, çdo vit;

Përgatitja e projekt udhëzimeve në zbatim të Manualit të shpenzimeve Publike, çdo vit.

3.25.3 AUDITIMI I JASHTËM

1. Objektivi politik i fushës

Në kuadër të procesit të integrimit europian, fusha e Auditimit të Jashtëm ka një rëndësi specifike për vet natyrën e rekomandimeve të vazhdueshme të Komisionit Europian.

Kështu, forcimi i kapaciteteve operationale të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe sigurimi i panvarësisë së tij funksionale dhe financiare do të jetë një prioritet afatshkurtër në fushën e Auditimit të Jashtëm.

Në periudhën afatmesme, fokusi do të jetë në zhvillimin e procedurave dhe kapaciteteve administrative për të siguruar mbrojtje efektive të interesave financiare të BE-së.

Synimi do të jetë përmirësimi i Auditimit të Jashtëm në Shqipëri në përputhje me Direktivat e Organizatës Ndërkombëtare të KLSH-së (INTOSAI).

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria e kontrollit të Auditimit të Jashtëm rregullohet nëpërmjet këtyre akteve ligjore e nënligjore:

Ligji nr.8270, date 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”;

Ligji nr. 8599, datë 01.06.2000 “Për disa ndryshime në ligjin 8270, datë. 23.12.1997, “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”.

2.2. Kuadri Institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e Auditimit të Jashtëm është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), i cili është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar të Republikës së Shqipërisë. Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit përbëhet nga 6 departamente kontrolli, 1 drejtori funksionale dhe 2 departamente me sektorë brenda tyre. Organizimi i drejtimit funksionon në qendër dhe në 7 zyra kontrolli në rajone të vendit. Strukturat drejtuese (departamentet) të kontrollit në qendër përfshijnë: kontrollin mbi rregullaritetin në zbatimin e buxhetit qëndror, përdorimin e fondeve publike nga institucionet e administratës së lartë shtetërore, administrimin e të ardhurave buxhetore nga organet e sistemit fiskal e doganor, zbatimin e procedurave ligjore dhe efektshmerinë në privatizimin e pronës publike dhënien me qera dhe administrimin e pasurisë në ndërmarrje, shoqëri e institucione financiare me kapital shtetëror. Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk është institucion vendimmarrës por rekomandues. Ai raporton para Kuvendit të Shqipërisë dhe i paraqet atij raportin mbi zbatimin e buxhetit të shtetit, mendimin rreth raportit të qeverisë për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi dhe jep informacione nga rezultatet e kontrollit kur këto kërkohen prej tij. Kuvendit i paraqitet edhe raporti vjetor për veprimtarinë e institucionit.

Prokuroria e Përgjithshme, e cila bashkëpunon me KLSH për të ndjekur e zbatuar procedurat për fillimin e çështjeve penale të denoncuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe për çështje të tjera në të ardhmen, këmbimi i përvojës dhe informacionit në fushën e luftës kundër krimit në ekonomi. Përgjithësimet për dukuritë negative që shfaqen në fushën e administrimit të fondeve publike do të përbëjnë në vijimësi fusha të rëndësishme bashkëpunimi në luftën kundër korrupsionit dhe krimit në ekonomi. Në Maj 2005 është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me këtë organ.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, e cila bashkëpunon me KLSH-në për të realizuar kontrollin financiar në shkallë vendi.

2.3. Asistenca e Huaj

Auditimi i Jashtëm në Shqipëri është asistuar me projekte binjakëzimi, me fondet e BE-së. Në vitin 2004, Komisioni Evropian financoi blerjen për KLSH-në për liçensat e përdorimit të paketës të SoftWare-it, Analizat dhe Nxjerrjen Interaktive të të Dhënave (IDEA), projekt i cili do të vazhdojë.

Në vitin 2006, u nënshkrua një marrëveshje me NIK (Dhoma e Kontrollit të Lartë të Polonisë) e cila do të ofrojë trajnime dhe këmbim eksperience reciproke. Kjo marrëveshje u realizua nën asistencën e SIGMA-s.

Deri në fund të vitit 2007 do të disbursohen rreth 1 milion Euro për një nga institucionet homologe europiane e cila do të përzgjidhet me tender në mënyrë që të realizohet procesi i binakëzimit, proces i cili do të përfshijë trajnime, zhvillime strategjike të KLSH-së dhe përshtatje me manualët ndërkombëtare duke përfshirë dhe legjislacionin e brendshëm.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Evropian, dhe në nenin 90 të MSA-së, prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme për fushën e Auditimit të Jashtëm janë:

Forcimi i kapaciteteve operationale të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe sigurimi i panvarësisë funksionale financiare ;

Zhvillimi i procedurave dhe kapaciteteve administrative për të siguruar mbrojtje efektive të interesave financiare të BE-së ;

Zhvillimi i sistemeve efikase të auditit dhe kontrollit financiar në përputhje me standartet dhe metodologjitë e pranura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira europiane.

3.1.1 Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e këtyre prioritetëve, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese në

periudhën afatshkurtër nga Kontrolli i Lartë i Shtetit:

Ngritja e grupit të punës për ndryshimin e ligjit aktual;

Trajnim i një grupi kontrollorësh pranë tri SAI të BE-së;

Komputeri-Ndihmës për Teknikat e Kontrollit (CAAT) do të provohet në të gjithë Departamentet e Kontrollit për kontrollet e zbatimit të buxhetit të shtetit, prokurimeve, etj.

3.1.2 Iniciativat ligjore afatmesme

Në funksion të realizimit të prioriteve të fushës së auditimit të jashtëm, në periudhë afatmesme 2008-2010, do të ndërmerret iniciativat e mëposhtme ligjore nga Kontrolli i Lartë i Shtetit:

Ndryshim i ligjit Nr.8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit, i cili do të ketë harmonizim të pjesshëm me Standartet e Auditimit të INTOSAI-it. Në mënyrë të përmblëdhur, ndryshimi i ligjit do të konsistojë në : (i) dhënien e të drejtave dhe detyrave të reja për institucionin e KLSH-së (ii) rritjen e kapaciteteve administrative të KLSH-së; (iii) rregullimin në mënyrë themelore të panvarësisë së institucionit ; (iv) dhënien e së drejtës KLSH-së të bëjë kontrollet vlerësuese ; (v) dhënien e së drejtës KLSH-së të çertifikojë llogaritë financiare ; si dhe (vi) dhënien e së drejtës KLSH-së të kontrollojë donacionet e BE-së për Shqipërinë.

3.25.4 KONTABILITETI PUBLIK

1. Objektivi Politik

Zhvillimi dhe zbatimi i parimeve të kontabilitetit manaxherial të decentralizuar është objektivi kryesor i Qeverisë në fushën e kontabilitetit publik.

Në periudhë afatshkurtër do të bëhet përcaktimi i parimeve dhe rregullimeve të përgjithshme për mbajtjen e kontabilitetit, në përputhje me standartet evropiane, parimet dhe rregullat kryesore. Rritja e transparencës, përmirësimi i cilësisë të vendimmarrjes dhe reduktimi i informalitetit në ekonomi do të jenë disa nga angazhimet afatshkurta shqiptare në këtë fushë.

Në periudhë afatmesme, fokusi i Qeverisë Shqiptare do të jetë forcimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore, kryerja e investimeve në përmirësimin e rrjeteve dhe shkëmbimit të informacionit në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Synimi do të jetë përmirësimi i cilësisë së informacionit financiar si dhe rritja e efektivitetit dhe efikasitetit për transparencën e shpenzimeve publike, nëpërmjet manaxhimit më të mirë të tyre.

2. Situata Aktuale

2.1. Kuadri Ligjor

Veprimtaria e kontabilitetit në Shqipëri rregullohet nëpërmjet aktit ligjor:

Ligji Nr.9288, datë 25.04.2004 «Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare», i cili është në përputhje me Direktivën 4 dhe 7 dhe 8 të «Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit» (International Accounting Standards -IAS) dhe Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (International Financial Reporting Standards - IFRS), dhe nenit 2 të direktivës 78/660/EEC dhe nenit 16, paragrafi 3 i direktivës 83/349/EEC. Shkalla e përputhshmërisë me *acquis communautaire* është e pjesshme. Ky ligj përcakton detyrimet e përgjithshme, parimet dhe rregullat kryesore, në përputhje me standartet evropiane, për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e publikimit të pasqyrave financiare që mbështeten në të dhënat e kontabilitetit.

2.2. Kuadri institucional

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e kontrollit të brendshëm financiar është nën përgjegjësinë e institucionit të mëposhtëm:

Drejtoria e Kontabilitetit në Ministrinë e Financave, e cila është përgjegjëse për udhëheqjen metodologjike të problemeve të kontabilitetit të sektorit publik; koordinimin dhe përgatitjen e draft-ligjeve dhe akteve të tjera të fushës së kontabilitetit dhe standarteve ; ndjekjen e problemeve që dalin nga zbatimi i standarteve kontabël; aplikimin dhe ndjekjen e problemeve që dalin nga zbatimi i planit kontabël publik. Drejtoria është e ndarë në 2 sektorë me 8 specialistë .

3.2. Asistenca e Huaj

Në kuadrin e projektit me Bankën Botërore dhe në bashkëpunim me Njësinë e Zbatimit të Projekteve në Ministrinë e Financave nëpërmjet kompanisë "PRICEEATERHOUSE COOPERS" është realizuar drafti i 14 Standarteve kontabël kombëtare (SKK), ka mbaruar diskutimi përfundimtar i tyre në Këshilin Kombëtar të Kontabilitetit dhe pritet miratimi nga Ministri i financave brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2006

Me projektin e E- Government, dhe UNDP, do të realizohet drafti i ligjit "Për kontabilitetin

Publik”, Hartimi i standardeve kombëtare të kontabilitetit Publik, në linjë me ato Ndërkombëtare dhe një soft për manaxhimin e inventarit të njësive shpenzuese buxhetore.

Për konsolidimin e Pasqyrave Financiare të sektorit Publik, në Korrik 2005, u realizua një projekt nga Banka Botërore me dy konsulentë të huaj. Tashmë, Ministria e Financave disponon Raportin me rekomandimet e tyre. Mbi këtë bazë po punojmë për finalizimin e një Udhëzimi të Ministrit të Financave për konsolidimin e pasqyrave financiare të sektorit publik.

3. Prioritetet

3.1. Prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme

Bazuar në angazhimet që derivojnë nga zbatimi i neneve 1,4, 13; 14; dhe 15 të MSA -së, prioritetet afatshkurtra për fushën e financave publike dhe auditimin e brendshëm janë:

Zhvillimi dhe zbatimi i parimeve të kontabilitetit manaxherial ëe decentralizuar
Zhvillimi i politikave që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit për kontabilitetin dhe vendosja e detyrimeve të përgjithshme,

Përcaktimi i parimeve dhe rregullimeve të përgjithshme në përputhje me standartet europiane, parimet dhe rregullat kryesore për mbajtjen e kontabilitetit,

Përmirsimin e cilësisë së informacionit financiar, rritja e transparencës, përmirsimi i vendimmarrjes;

Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore

Reduktimi i informalitetit në ekonomi dhe integrimi me strukturat perëndimore

Rritja e transparencës dhe cilësisë së vendimmarrjes

3.1.1. Iniciativat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritete afatshkurtra për periudhën 2006-2007, për realizimin e tyre, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Financave:

Ndryshimi i Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i cili do të sjellë një përputhshmëri "të pjesshme" me acquis në këtë fushë, e konkretisht me Direktivat 4, 7, 8, 14 të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit IAS,

Hartimi dhe miratimi i projekt vendimit për miratimin e Standarteve (SKK) Kombëtare të kontabilitetit, i cili do të sjellë një përputhshmëri "të pjesshme" me acquis në këtë fushë e konkretisht me Direktivat 4, 7, 8, 14 të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit IAS dhe IFRS

Hartimi dhe miratimi i projekt ligjit "Për rregullimin e Profesioneve" , i cili do të sjellë një përputhshmëri "të pjesëshme" me acquis në këtë fushë e konkretisht me Direktiva 31984L0253

Hartimi dhe miratimi i projekt - ligjit për kontabilitetin Publik Projekti E-Government, i cili do të sjellë një përputhshmëri "të pjesëshme" me acquis në këtë fushë e konkretisht me Direktivat 4, 7, 8, 14 të Stadarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit IAS, IPSAS

Hartimi dhe miratimi i një akti ligjor "Për institutin për trajnimin kontabël", i cili do të sjellë një përputhshmëri "të pjesëshme" me acquis në këtë fushë, konkretisht me Direktivën (8) 31984L0253 EEC

3.1.2. Aktivitet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e prioriteteve afatshkurtra, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

Konsulencë, organizim tryeza diskutimi për Projekt - ligjin "Për rregullimin e Profesioneve";

Ngritja e grupit të punës për përgatitjen e dokumentacionit dhe termat e referencës për tenderim;

Përgatitja e softwareve për menaxhimin e inventarve të njësive shpenzuse, si në tabelën e mëposhtme.

Organizimi i trajnimeve me përfaqësues të sektorit publik mbi standartet ndërkombëtare IPSAS;

Trainim i kontabilistëve;

Ngritja e kapaciteteve të nevojshme për Institutin për Trajnimin Kontabël, si në tabelën e mëposhtme.

3.2. Prioritetet afatmesme

Bazuar në angazhimet që derivojnë nga zbatimi i neneve të MSA-së për fushën e kontabilitetit, prioritetet afatmesme janë:

Forcimi i institucioneve dhe përmirsimi i funksioneve ekzistuese

Përmirsimi i rrjeteve dhe shkëmbimit të informacionit në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar etj.

Rritja dhe përmirsimi i cilësisë së informacionit financiar

Rritja e efektivitetit dhe efikasitetit për transparencën e shpenzimeve publike, nëpërmjet menaxhimit më të mirë të tyre

3.2.1. Iniciativat ligjore afatmesme

Në përputhje me këto prioritete afatmesme, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Financave:

Hartimi dhe miratimi i projekt - vendimit "Për miratimin e Standarteve Ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit Financiar", i cili do të sjellë një përputhshmëri "të plotë" me acquis në këtë fushë e konkretisht me Rregulloren e Këshillit 32002R1606 për zbatimin e Standarteve Ndërkombëtare;

Hartimi dhe miratimi i Manualeve të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar për sektorin privat dhe për sektorin publik, i cili do të sjellë një përputhshmëri "të pjesshme" me acquis në këtë fushë e konkretisht me Direktivën 78/660/EEC

3.2.1. Aktivitete zbatuese afatmesme

Në përputhje me këto prioritete afatmesme, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Financave:

Përgatitja e Standarteve ndërkombëtare IFRS

Tabela : Shtesë e kapaciteteve institucionale të Ministrisë së Financave

INVESTIME	NJËSIA E MAT JES	GJENDJA AKTU ALE	2007
Personel shtesë për Institutin e Trainimit Kontabël	nëpunës/	0	+6
Investime infrastruktura për Institutin e Trainimit Kontabël	000.lek		46
Investime në IT për menaxhimin e inventarëve të njësive shpenzuese	000/lek		35